REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

BULETINI I PRAKTIKËS GJYQËSORE

2018

Botues:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës

Bordi redaktues:

Znj. Arta Rama-Hajrizi, Kryetare e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Prof. Dr. Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Z. Almiro Rodrigues, Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Prof. Dr. Snezhana Botusharova, Gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Z. Milot Vokshi, Sekretar i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Njësia Ligjore, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës;

Shënim: Gjyqtarëve - anëtarë të Bordit redaktues të Buletinit të Praktikës Ligjore 2018: Ivan Čukalović, Snezhana Botusharova dhe Almiro Rodrigues, u ka skaduar mandati 9-vjeçar në pozitën e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, në qershor të vitit 2018. Më 9 gusht 2018, gjyqtarë të rinj të Gjykatës Kushtetuese janë dekretuar: Safet Hoxha, Remzije Istrefi-Peci, Radomir Laban dhe Nexhmi Rexhepi.

Kontribuesit:

Anita Çavdarbasha
Bardh Bokshi
Burim Hoxha
Jeton Bytyqi
Veton Dula

© 2019 Gjykata Kushtetuese e Kosovës

Të drejtat e autorit:

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjetesh, elektronike apo mekanike, duke përfshirë fotokopjimin dhe incizimin, apo ruajtjen në sisteme ripërdorimi, pa lejen paraprake me shkrim nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, përveç nëse një kopjim i tillë në mënyrë të qartë lejohet nga ligji përkatës për të drejtat e autorit.

Përjashtim i përgjegjësisë:

Sipas nenit 116.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, e cila është burim primar për vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Ky Buletin nuk zëvendëson burimin primar për vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Në rast të ndonjë konflikti apo mospërputhje në mes të vendimeve të botuara në këtë Buletin dhe vendimeve të botuara në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, mbizotëron versioni i botuar në Gazetën Zyrtare.

Qëllimi i përmbledhjes së vendimeve është për të dhënë një pasqyrë të përgjithshme faktike dhe juridike të rasteve dhe një përmbledhje të shkurtër të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Përmbledhja e vendimeve dhe aktgjykimeve nuk zëvendëson vendimet e Gjykatës Kushtetuese, dhe nuk përfaqëson formulimin e vërtetë të vendimeve/aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese.

REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

BULETINI I PRAKTIKËS GJYQËSORE

2018

I GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Tabela e Përmbajtjes:

1. Parathënie: 9
2. KI150/16, Parashtrues, Mark Frrok Gjokaj, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, CLM. nr. 11/2016, të 13 shtatorit 2016 11
3. KI47/17, Parashtrues Selvete Aliji, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë të Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC. nr. 2812/2016, të 9 dhjetorit 2016 45
4. KO84/18, Parashtrues: Albin Kurti dhe 11 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 06/V-145 të Kuvendit të Republikës së Kosovës përkitazi me propozimin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje! për shkarkimin e Aida Dërgutit nga pozita e nënkryetares së Kuvendit të Republikës së Kosovës 65
5. KI 122/16 Parashtrues: Riza Dembogaj, i cili kërkon vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktvendimit CML. nr. 6/2016 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, të 13 shtatorit 2016 97
6. KI 115/16 Parashtrues: Branko Ljumović, Ranko Ljumović dhe Anica Vukićević-Ljumović, të cilët kërkojnë vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-II-12-0126, të 21 prillit 2016 118
7. KI 62/17 Parashtrues i kërkesës: Emine Simnica, e cila kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PN. II. nr. 1/17, të 31 janarit 2017, lidhur me Vendimin e Gjykatës Supreme PML. nr. 300/16, të 12 dhjetorit 2016 135
8. KI69/16 Parashtruese e kërkesës: Nora Dukagjini-Salihu, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 295/2015 të 9 dhjetorit 2015 153
9. KO12/18, Parashtrues: Albulena Haxhiu dhe 30 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 04/20, të 20 dhjetorit 2017 171
10. Rastet nr. KI146/17, KI147/17, KI148/17, KI149/17 dhe KI150/17, Parashtrues: Isni Thaçi, Zeqir Demaku, Fadil Demaku, Nexhat Demaku, dhe Jahir Demaku, vlerësim i kushtetutshmërisë së

Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës PML. KZZ. nr. 322/2016 të 19 korrikut 2017 218
11. KO45/18, Parashtrues: Glauk Konjufca dhe 11 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-060 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi 256
12. KI122/17, Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktvendimit Ae. nr. 185/2017 të Gjykatës së Apelit, të 11 gushtit 2017, dhe Aktvendimit IV. EK. C. nr. 273/2016 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të 14 qershorit 2017 281
13. KI97/16, Parashtrues "IKK Classic", Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, E. Rev. 15/2016, të 16 marsit 2016 329
14. KO79/18, Parashtrues: Presidenti i Republikës së Kosovës, Kërkesë për interpretim të nenit 139, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës 346
15. KI102/17, Parashtrues Meleq Ymeri, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Udhëzimit Administrativ nr. 09/2015 për kategorizimin e shfrytëzuesve të pensionit kontribut pagues sipas strukturës kualifikuese dhe kohëzgjatjes së pagesës së kontributeve-stazhit pensional të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale 368
16. KI152/17, Parashtrues, Shaqir Totaj, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, A. A. U. ZH. nr. 63/2017, të 7 dhjetorit 2017 374
17. KI53/18, Parashtrues Hajri Ramadani, Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. nr. 181/2016, të 13 shkurtit 2017 387
18. KI112/17, Parashtrues: Deno Denović, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ. nr. 7/2017, të 16 majit 2017. 397
19. Rasti nr. KI34/18, Parashtrues i kërkesës: Albert Berisha, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, PML. nr. 225/2017, të 18 dhjetorit 2017 411
20. KI143/16, Parashtrues: Muharrem Blaku dhe të tjerët, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që

lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ASC -11-0012, të 22 shtatorit 2016 432
21. KI76/18, Parashtrues: Pjetër Boçi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. nr. 279/2017, të 26 marsit 2018, dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN. nr. 462/2018, të 28 majit 2018 452
22. KI 110/17 Parashtrues i kërkesës: Sekule Stanković, i cili kërkon tërheqjen e kërkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 233/2014, të 3 shtatorit 2014 468
23. KI74/18, Parashtrues: Gëzim Murati, Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimeve ose akteve të paspecifikuara të autoriteteve publike 473
24. INDEKSI I SHPREHJEVE LIGJORE 479
25. INDEKSI I NENEVE TË KUSHTETUTËS 489
26. SHKELJE TË NENIT 24, 31, 46 DHE 108 TË KUSHTETUTËS 490

Parathënie:

Kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë që, në cilësinë e Kryetares së Gjykatës, të shkruaj këtë parathënie për Buletinin e 8-të të Praktikës Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese. Buletini është bërë pikë referimi, i dobishëm dhe i cituar shpesh nga ata që punojnë në fushën e së drejtës kushtetuese dhe të të drejtave e lirive themelore të njeriut. Edhe këtë herë jemi përkushtuar të tregojmë disa nga rezultatet kryesore të punës sonë gjatë vitit 2018.

Ky edicion i Buletinit përmban një numër të rasteve më të veçuara dhe më të rëndësishme, duke përfshirë kërkesat e dorëzuara nga deputetët e Kuvendit përkitazi me ushtrimin e funksionit të nënkryetares së Kuvendit, përkitazi me rritjen e pagave të funksionarëve shtetërorë, për vlerësim të ligjit për ratifikim të marrëveshjes për kufirin shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, si dhe kërkesa e dorëzuar nga Presidenti i Republikës për interpretim të nenit 139 të Kushtetutës përkitazi me emërimin e anëtarëve të Komisionit Qendror Zgjedhor.

Gjatë këtij viti, Gjykata po ashtu ka nxjerrë edhe vendime të tjera të rëndësishme që ndërlidhen me kërkesat individuale në të cilat janë trajtuar çështje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, për interpretim dhe zbatim të ligjit në pajtim me të drejtat themelore të njeriut: e drejta për vendim të arsyetuar, e drejta për zbatim të vendimeve të formës së prerë *res judicata* dhe e drejta për qasje në drejtësi.

Është e rëndësishme të theksohet që parashtruesit e ardhshëm dhe përfaqësuesit e tyre, të cilët synojnë të dorëzojnë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, të konsultojnë me vëmendje këtë Buletin, si dhe buletinët e mëparshëm, dhe të vlerësojnë nëse rasti i tyre mund të ketë ndonjë mundësi suksesi, duke iu referuar vendimeve të ngjashme të Gjykatës. Duhet kuptuar qartë që, parimisht, e drejta e ankesës nuk mund t'i mohohet asnjë parashtruesi, por që do të ishte e dobishme që ata paraprakisht të njoftohen me jurisprudencën e Gjykatës dhe të kenë vlerësim objektiv për suksesin e kërkesës së tyre.

Qëllimi i publikimit të vendimeve të Gjykatës në Buletin është t'i tregohet opinionit të gjerë se gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese i marrin vendimet e tyre në mënyrë të pavarur dhe plotësisht transparente, duke zbatuar standardet më të larta të të drejtave të njeriut dhe të drejtësisë kushtetuese.

Në fund, dëshiroj të falënderoj dhe të shpreh mirënjohjen time të veçantë për gjithë stafin e Gjykatës, me punën dhe me përkrahjen e të cilëve është bërë i mundur publikimi i këtij edicioni të Buletinit të Praktikës Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese.

Arta Rama-Hajrizi

Kryetare e Gjykatës Kushtetuese

KI150/16, Parashtrues, Mark Frrok Gjokaj, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, CLM. nr. 11/2016, të 13 shtatorit 2016

KI150/16, Aktgjykim i 19 dhjetorit 2018, publikuar më 31.12.2018

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, res judicata, kërkesë e pranueshme, mosshkelje e të drejtave kushtetuese*

Më 13 shtator 2016, Gjykata Supreme e Kosovës, nëpërmjet Aktvendimit [CLM. nr. 11/2016] kishte refuzuar si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit, kundër Aktvendimit [AC. nr. 1579/015] të 4 prillit 2016 të Gjykatës së Apelit të Kosovës, me të cilin ishte konsideruar e përfunduar procedura përmbarimore për shkak të arritjes së parashkrimit absolut dhe ishin shfuqizuar të gjitha veprimet e ndërmarra në këtë çështje përmbarimore.

Parashtruesi i kërkesës, në kërkesën e tij, kishte pretenduar se Aktvendimi [AC. nr. 1579/2015] i 4 prillit 2016 i Gjykatës së Apelit ishte nxjerrë në shkelje të së drejtave të tij të garantuara me nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.
Në thelb, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata e Apelit kishte tejkaluar autorizimet ligjore të përcaktuara me nenin 52 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, duke ndryshuar Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë [PPP. nr. 50/2015] të 2 prillit 2015; duke e konsideruar procedurën përmbarimore të përfunduar dhe duke shfuqizuar të gjitha veprimet paraprake që ndërlidhen me Aktvendimin [C. nr. 270/96] e 25 dhjetorit 1996 të Gjykatës Komunale në Gjakovë, që lejoi masën e përkohshme.

Gjykata konsideroi se rrjedha e rastit konkret ngërtheu rrethana të jashtëzakonshme, duke përfshirë vendime të formës së prerë e kundërthënëse me njëra-tjetrën të së njëjtës gjykatë në të njëjtën çështje përmbarimore. Rrjedhimisht, në rrethanat e rastit konkret, shfuqizimi i të gjitha veprimeve paraprake të ndërmarra në çështjen përmbarimore, duke i përfshirë edhe aktvendimet paraprake *res judicata,* është në funksion të "*korrigjimit të gabimeve gjyqësore dhe të gabimeve të drejtësisë*". Shmangia nga respektimi i tyre, në rrethanat e rastit konkret, justifikohet dhe është e nevojshme si rezultat i "*rrethanave të një karakteri substancial dhe bindës*", siç është përcaktuar me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së.
Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtruesit është e pranueshme dhe, duke marrë parasysh karakteristikat e veçanta të rastit, pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, Gjykata, duke u

mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, nuk gjen të jetë shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI150/16

Parashtrues

Mark Frrok Gjoka

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, CLM. nr. 11/2016, të 13 shtatorit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Mark Frrok Gjokaj, me banim në fshatin Osek Pashë, komuna e Gjakovës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson Teki Bokshi, avokat nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin [CLM. nr. 11/2016] e 13 shtatorit 2016 të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktvendimin [AC. nr.

1579/2015] e 4 prillit 2016 të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit).

3. Parashtruesi i kërkesës nuk ka specifikuar se kur e ka pranuar Aktvendimin të cilin e konteston.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Supreme, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë], nenin 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ), nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e Pronës) të KEDNJ-së, si dhe nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

6. Më 31 maj 2018, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) miratoi, në seancë administrative, plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata i referohet dispozitave juridike të Rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatë

7. Më 7 dhjetor 2016, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

8. Më 23 dhjetor 2016, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që të plotësojë formularin e kërkesës.

9. Më 27 dhjetor 2016, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi në Gjykatë formularin e kërkesës.

10. Më 16 janar 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi Gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Bekim Sejdiu.

11. Më 1 shkurt 2017, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të dorëzojë në Gjykatë autorizimin e përfaqësuesit të cilin pretendon se e ka para Gjykatës, si dhe kërkoi nga ai që të kompletojë kërkesën e tij me dokumentacion relevant, gjegjësisht me vendimet përkatëse të gjykatave të rregullta. Të njëjtën ditë Gjykata, e njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrim të kërkesës.

12. Më 6 prill 2017, Gjykata sërish kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që të dorëzojë në Gjykatë dokumentacionin relevant lidhur me kërkesën e tij.

13. Më 8 maj 2017, parashtruesi i kërkesës i dorëzoi në Gjykatë dokumentet e kërkuara.

14. Më 16 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Snezhana Botusharova dhe Almiro Rodrigues. Më 26 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.

15. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzie Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.

16. Më 10 shtator 2018, Kryetarja e Gjykatës nxori vendim për zëvendësimin e gjyqtarëve: Snezhana Botusharova dhe Ivan Čukalović, si anëtarë të Kolegjit shqyrtues, dhe në vend të tyre anëtarë të Kolegjit shqyrtues u caktuan gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi dhe Nexhmi Rexhepi.

17. Më 8 nëntor 2018, Gjykata njoftoi për kërkesën dhe i dërgoi një kopje të saj në cilësi të palës së interesuar të padituri, përkatësisht, debitorit

M.R. Gjykata njoftoi M.R. se komentet eventuale mund t'i paraqiste në Gjykatë në afat prej 7 (shtatë) ditësh.

18. Në afatin e caktuar prej 7 (shtatë) ditësh, Gjykatës nuk iu paraqit asnjë koment nga M.R., lidhur me kërkesën e parashtruesit të kërkesës.

19. Më 12 nëntor 2018, njoftimi dhe kopja e kërkesës u kthyen nga posta në Gjykatë, me sqarimin se M.R., nuk gjendej në adresën e shënuar.

20. Më 19 dhjetor 2018, Kolegji Shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe me shumicë votash i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

21. Në të njëjtën ditë, Gjykata votoi me shumicë votash, se kërkesa është e pranueshme, dhe se Aktvendimet e kontestuara, Aktvendimi [CLM. nr. 11/2016] i 13 shtatorit 2016 i Gjykatës Supreme në lidhje me Aktvendimin [AC. nr. 1579/2015] e 4 prillit 2016 të Gjykatës së Apelit janë në pajtueshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

Përmbledhja e fakteve

22. Në një datë të paspecifikuar, F.GJ., paraardhës i parashtruesit të kërkesës, kishte paraqitur padi në Gjykatën Komunale në Gjakovë kundër M.R., për përcaktimin e të drejtës së servitutit.

Aktvendimet për caktimin dhe lejimin e përmbarimit të masës së përkohshme

23. Më 25 dhjetor 1996, Gjykata Komunale në Gjakovë, përmes Aktvendimit [C. nr. 270/96], e kishte aprovuar kërkesën për masë të përkohshme, duke urdhëruar M.R. që të lejojë F.GJ. ta shfrytëzojë rrugën ekzistuese e cila e lidhë rrugën kryesore të fshatit me parcelat e paraardhësit të parashtruesit të kërkesës. Në Aktvendimin përkatës, ndër të tjera, ishte theksuar që masa e përkohshme do të zgjasë deri në përfundimin e kontestit në mes palëve me vendim të formës së prerë.

24. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës dhe bashkëndërgjyqësit e tjerë, si trashëgimtarë të F.GJ., paraqitën kërkesë në Gjykatën Komunale në Gjakovë, për lejim të ekzekutimit të Aktvendimit [C. nr. 270/96] të 25 dhjetorit 1996, të së njëjtës Gjykatë.

25. Më 3 shkurt 1997, Gjykata Komunale në Gjakovë, përmes Aktvendimit [E. nr. 419/97], e lejoi ekzekutimin e Aktvendimit [C. nr. 270/96] të 25 dhjetorit 1996, kundër debitorit M.R.

26. Nga shkresat e lëndës rezulton se ky Aktvendim asnjëherë nuk u ekzekutua. Për më tepër, nga të njëjtat rezulton se debitori, përkatësisht M. R., këtë Aktvendim e kishte pranuar më 9 qershor 2009.

Kërkesa e parashtruesit të kërkesës për përmbarimin e Aktvendimit për masë të përkohshme

27. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës Komunale në Gjakovë duke kërkuar përmbarimin e Aktvendimit [C.nr. 270/1996] të 25 dhjetorit 1996 të Gjykatës Komunale në Gjakovë, e që sipas pretendimit të tij, kishte marrë formën e prerë nga 16 qershori 1997.

28. Më 25 qershor 2010, Gjykata Komunale në Gjakovë, përmes Aktvendimit [E. nr. 419/97] lejoi rikonstruimin e shkresave të kësaj lënde përmbarimore.

29. Në 28 dhe 29 qershor 2010, respektivisht, debitori, përkatësisht M.R. ushtroi dy ankesa. Njërën ia drejtoi Gjykatës Komunale në Gjakovë kundër Aktvendimit [E. nr. 419/97] të 3 shkurtit 1997 të kësaj Gjykate, për lejimin e përmbarimit, duke kërkuar që të abrogohen të gjitha veprimet përmbarimore të ndërmarra në këtë çështje përmbarimore. Ndërsa tjetrën, ia drejtoi Gjykatës së Qarkut në Pejë kundër Aktvendimit [C.nr.270/97] të 25 dhjetorit 1996 të Gjykatës Komunale në Gjakovë, e cila kishte vendosur për masën e përkohshme, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar që Gjykata e Qarkut të ndryshojë Aktvendimin e atakuar duke e refuzuar caktimin e masës së përkohshme ose duke e kthyer çështjen kontestuese në rigjykim në shkallën e parë.

Procedura si rrjedhojë e ankesës së parë të debitorit M. R.

30. Më 31 maj 2011, Gjykata Komunale në Gjakovë, përmes Aktvendimit [E. nr. 419/97] aprovoi prapësimin e debitorit M.R., dhe pezulloi procedurën e përmbarimit të caktuar me Aktvendimin [E.nr.419/97] e 3 shkurtit 1997 të Gjykatës Komunale në Gjakovë. Gjykata Komunale në Gjakovë, ndër të tjera, arsyetoi se në pamundësi për të siguruar

dosjen burimore dhe duke marrë parasysh se që nga koha e Aktvendimit kanë kaluar 15 (pesëmbëdhjetë) vite dhe se përmbarimi i Aktvendimit asnjëherë nuk është realizuar, përkundër faktit që përmbarimi në rastin konkret duhej të konsiderohej si çështje urgjente, ekzekutimi i Aktvendimit mbi masën e përkohshme "*ka humbur kuptimin*". Për më tepër, sipas Aktvendimit përkatës, Gjykata nuk ka mundur të vërtetojë se Aktvendimi për caktimin e masës së përkohshme është i plotfuqishëm dhe i përmbarueshëm.

31. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës dhe bashkëndërgjyqësit e tjerë, paraqitën ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit [E. nr. 419/97] të 31 majit 2011 të Gjykatës Komunale në Gjakovë, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës përmbarimore, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

32. Më 2 maj 2013, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit [AC. nr. 4864/2012], refuzoi si të pabazuar ankesën e kreditorëve, përkatësisht parashtruesve të kërkesës. Gjykata e Apelit konfirmoi Aktvendimin [E. nr. 419/97] e 31 majit 2011 të Gjykatës Komunale në Gjakovë.

Procedura si rrjedhojë e ankesës së dytë të debitorit M. R.

33. Më 4 prill 2013, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit [CA. nr. 3662/2012], duke vepruar sipas ankesës së M.R. të 29 qershorit 2010, refuzoi ankesën e tij si të paafatshme. Gjykata e Apelit arsyetoi që Aktvendimi [C.nr.270/96] i 25 dhjetorit 1996 i Gjykatës Komunale në Gjakovë është bërë i formës së prerë më 16 qershor 1997. Ajo gjithashtu arsyetoi që ky Aktvendim i është dorëzuar debitorit më 9 qershor 2009, dhe se rrjedhimisht, debitori, përkatësisht i padituri, ankesën e ka paraqitur pas afatit 15 (pesëmbëdhjetë) ditor të përcaktuar me Ligjin nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejmë: LPK).

Kërkesa e dytë e parashtruesit të kërkesës për përmbarimin e Aktvendimit për masë të përkohshme

34. Më 7 nëntor 2013, parashtruesi i kërkesës dhe bashkëndërgjyqësit e tjerë, paraqitën në Gjykatën Themelore në Gjakovë, propozim për përmbarim të Aktvendimit [C.nr.270/96] të 25 dhjetorit 1996 të Gjykatës Komunale në Gjakovë, i cili ishte konfirmuar përmes Aktvendimit [Ca. nr. 3662/12] të 4 prillit 2013 të Gjykatës së Apelit, pasi kishte shpallur ankesën e debitorit si të paafatshme.

35. Më 11 nëntor 2013, Gjykata Themelore në Gjakovë, përmes Aktvendimit [Cp. nr. 1281/2013], caktoi përmbarimin në bazë të Aktvendimit [C. nr. 270/96] të 25 dhjetorit 1996 të Gjykatës Komunale në Gjakovë.

36. Më 11 dhjetor 2013, debitori, përkatësisht M.R., paraqiti prapësim në Gjykatën Themelore në Gjakovë kundër Aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Themelore. Debitori iu referua Aktvendimit [Ac.nr.4864/2012] të 2 majit 2013 të Gjykatës së Apelit e i cili e kishte konfirmuar pezullimin e procedurës përmbarimore në rrethanat e rastit konkret.

37. Më 14 maj 2014, parashtruesi i kërkesës dhe bashkëndërgjyqësit e tjerë, parashtruan kërkesë në Gjykatën Themelore në Gjakovë për transferimin e lëndës tek përmbaruesi privat.

38. Më 15 maj 2014, Gjykata Themelore në Gjakovë, sipas shkresave të lëndës, para se të ketë vendosur në lidhje me prapësimin e debitorit M.R. të datës 11 dhjetor 2013 kundër Aktvendimit [Cp.nr.1281/2013] të 11 nëntorit 2013, përmes Konkluzionit [E. nr. 1281/2013] e aprovoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës dhe e transferoi lëndën përmbarimore [E.nr.1281/13] te përmbaruesi privat. Sipas Udhëzimit Juridik, kundër këtij vendimi nuk ishte e lejuar ankesa.

39. Më 21 korrik 2014, Gjykata Themelore në Gjakovë, përmes Aktvendimit [CP. nr 281/13], refuzoi si të pathemeltë prapësimin e debitorit M.R., të parashtruar kundër Aktvendimit [CP.nr.1281/2013] të 11 nëntorit 2013 të Gjykatës Themelore në Gjakovë, duke e lejuar përmbarimin dhe duke theksuar se ankesa kundër këtij vendimi nuk e ndalon procedurën përmbarimore.

40. Më 24 korrik 2014, debitori M.R. paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër këtij Aktvendimi, përkatësisht Aktvendimit [CP. nr. 281/13] të 21 korrikut 2014 të Gjykatës Themelore në Gjakovë. Debitori sërisht iu referua Aktvendimit [Ac.nr.4864/2012] të 2 majit 2013 të Gjykatës së Apelit i cili e kishte konfirmuar pezullimin e procedurës përmbarimore në rrethanat e rastit konkret.

41. Më 7 tetor 2014, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit [AC. nr. 3356/14] refuzoi si të pabazuar ankesën dhe vërtetoi Aktvendimin [CP.nr.1281/2013] e 21 korrikut 2014 të Gjykatës Themelore në Gjakovë. Gjykata e Apelit arsyetoi se Aktvendimi [C. nr. 270/96] i 25 dhjetorit 1996 kishte marrë formën e prerë dhe ishte titull përmbarues

nga 4 prilli 2013, kur ishte vërtetuar përmes Aktvendimit [CA. nr. 3662/2012] të Gjykatës së Apelit.

42. Më 24 mars 2015, përmbaruesi privat, përmes Konkluzionit [P.nr.02/14] njoftoi debitorin M.R. për caktimin e përmbarimit më 31 mars 2015, sipas propozimit të parashtruesit të kërkesës, në bazë të Aktvendimit [C.nr.270/96] të 25 dhjetorit 1996 të Gjykatës Komunale në Gjakovë.

Shfuqizimi i Aktvendimit për masë të përkohshme

43. Më 30 mars 2015, debitori M.R., paraqiti kërkesë në Gjykatën Themelore në Gjakovë, duke kërkuar që të pezullohet procedura e përmbarimit te Përmbaruesi privat dhe të prishen të gjitha veprimet procedurale të ndërmarra në këtë çështje përmbarimore. Ndër të tjera, debitori M.R., sërish, iu referua Aktvendimit [Ac.nr.4864/2012] të 2 majit 2013, i cili e kishte konfirmuar pezullimin e procedurës përmbarimore. Kreditorët, përkatësisht, parashtruesit e kërkesës nuk kishin paraqitur përgjegje në këtë ankesë.

44. Më 2 prill 2015, Gjykata Themelore në Gjakovë, përmes Aktvendimit [PPP. nr. 59/15] refuzoi kërkesën si të pathemeltë, duke konstatuar se nuk ka vërejtur parregullsi në procedurën e përmbarimit. Për më tepër, Gjykata Themelore në Gjakovë, arsyeton se Aktvendimi [C.nr.270/96] i 25 dhjetorit 1996 ishte konfirmuar nga Aktvendimi [CA.nr.3660/2012] i 4 prillit 2013 dhe rrjedhimisht, Aktvendimi përmes të cilit ishte caktuar masa e përkohshme kishte marrë formën e prerë dhe mbi bazën e Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (në tekstin e mëtejme: LPP), ishte dokument përmbarues. Ankesa kundër këtij Aktvendimit, sipas të njëjtit, ishte e lejuar në Gjykatë të Apelit.

45. Më 13 prill 2015, debitori M.R., paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktvendimit [PPP. nr.59/15] të 2 prillit 2015 të Gjykatës Themelore në Gjakovë, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës përmbarimore dhe shkelje të dispozitave të së drejtës materiale. Debitori, ndër të tjera, kishte kërkuar, që procedura e përmbarimit të mbetet e pezulluar dhe të prishen të gjitha veprimet paraprake përmbarimore. Përgjegje në ankesë, kishin parashtruar edhe parashtruesit e kërkesës. Të dy palët, iu ishin referuar Aktvendimeve të Gjykatës se Apelit, Aktvendimit [CA. nr. 3662/2012] të 4 prillit 2013 dhe Aktvendimit [AC. nr. 4864/2012] të 2 majit 2013, respektivisht, kundërthënëse me njëra-tjetrën, në favorin e tyre përkatës.

46. Më 4 prill 2016, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit [AC.nr.1579/2015] pranoi si të bazuar ankesën e debitorit M.R., dhe ndryshoi Aktvendimin [PPP. nr.59/2015] e 2 prillit 2015 të Gjykatës Themelore në Gjakovë, duke konsideruar të përfunduar procedurën përmbarimore mbi bazën e nenit të 66 të LPP-së për shkak të parashkrimit absolut në lidhje me nenin 361 të LMD-së dhe i shfuqizoi të gjitha veprimet e ndërmarra në këtë çështje përmbarimore. Gjykata e Apelit, ndër të tjera kishte arsyetuar, se në bazë të nenit 66 të LPP-së, procedura përmbarimore përfundon sipas detyrës zyrtare, kur kalon afati absolut i parashkrimit për përmbarim, kusht ky që plotësohej në rrethanat e rastit konkret.

47. Më 25 maj 2016, me kërkesën e parashtruesve të kërkesës, Prokurori i Shtetit të Kosovës paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë [KMLC.nr.30/2016], kundër Aktvendimit [AC.nr.1579/015] të 4 prillit 2016 të Gjykatës së Apelit, duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, me propozimin që ky Aktvendim të prishet duke lënë në fuqi Aktvendimin [PPP. nr. 59/2015] e 2 prillit 2015 të Gjykatës Themelore në Gjakovë ose duke propozuar që lënda të kthehet në rigjykim.

48. Më 13 shtator 2016, Gjykata Supreme, përmes Aktvendimit [CLM. nr. 11/2016] refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit duke arsyetuar se ajo, mbi bazën e LPK-së është e kufizuar vetëm në ekzaminimin e shkeljeve që i thekson Prokurori Publik në kërkesën e vet, ndërsa kjo e fundit, sipas Gjykatës Supreme, "*nuk ka mbështetje ligjore në shkeljet thelbësore të përcaktuara me dispozitën e nenit 247, paragrafi 1 a) të LPK-së*".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

49. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktvendimin [CLM. nr. 11/2016] e 13 shtatorit 2016, të Gjykatës Supreme, i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë], nenin 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, nenin 46 [Mbrojta e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e pronës) të KEDNJ-së dhe nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës.

50. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi [CP. nr. 1281/13] i 21 korrikut 2014 i Gjykatës Themelore në Gjakovë, që kishte lejuar përmbarimin e Aktvendimit për masë të përkohshme dhe të cilin e kishte vërtetuar edhe Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [AC. nr. 3356/14] të 7 tetorit 2014, është i formës së prerë. Sipas këtyre vendimeve, Aktvendimi [C. nr. 270/96] i 25 dhjetorit 1996 kishte marrë formën e prerë dhe ishte titull përmbarues nga 4 prilli 2013, kur ishte vërtetuar përmes Aktvendimit [CA. nr. 3662/2012] të Gjykatës së Apelit.

51. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se Aktvendimi [AC. nr. 1579/2015] i 4 prillit 2016 i Gjykatës së Apelit është nxjerrë në shkelje të së drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, sepse sipas pretendimit, Gjykata e Apelit kishte tejkaluar autorizimet ligjore të përcaktuara me nenin 52 të LPP-së, duke ndryshuar Aktvendimin [PPP.nr.50/2015] të 2 prillit 2015 të Gjykatës Themelore dhe duke e konsideruar procedurën përmbarimore të përfunduar e duke shfuqizuar të gjitha veprimet paraprake të ndërlidhura me Aktvendimin fillestar për masë të përkohshme të vitit 1996.

52. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se kërkesa e tij ka lidhje me rastin e Gjykatës KI70/16, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 tetorit 2017.

53. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës me kërkesën që të anulohet Aktvendimi [CLM. nr. 11/2016] i 13 shtatorit 2016 i Gjykatës Supreme në lidhje me Aktvendimin [AC. nr. 1579/2015] e 4 prillit 2016 të Gjykatës së Apelit.

Pranueshmëria e kërkesës

54. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe të përcaktuara me Rregulloren e punës.

55. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
>
> *[...]*

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

56. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...".

57. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar dhe konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [CLM.nr.11/2016] e 13 shtatorit 2016 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit, dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

58. Në vijim, Gjykata gjithashtu i referohet kritereve të pranueshmërisë të përcaktuara me Rregullorën e saj të punës. Në këtë aspekt, Gjykata vëren së parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me pikat a), b) dhe c) të paragrafit 1 të Rregullit 39.

59. Megjithatë, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata i referohet gjithashtu pikës b) të paragrafit 3 të Rregullit 39, sipas të cilës, Gjykata

mund të konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse e njejta nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën.

60. Në këtë aspekt, Gjykata verën se duke marrë parasysh që në rrethanat e rastit konkret procedurat gjyqësore që kanë rezultuar në Aktvendimet e kontestuara për objekt shqyrtimi kanë pasur një "*masë të përkohshme*" dhe rrjedhimisht kanë të bëjnë me "*procedura paraprake*", mbi bazën e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në parim, nuk janë të aplikueshme.

61. Rrjedhimisht, për të konstatuar nëse kjo kërkesë është *rationae materiae* në pajtim me Kushtetutën, Gjykata së pari do të elaboroj e më pas aplikoj parimet e përcaktuara nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe praktika e Gjykatës, sa i përket aplikueshmërisë së garancive procedurale të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së në rrethanat e rastit konkret, përkatësisht në "*procedurat paraprake*".

Aplikueshmëria e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së në "procedurat paraprake"

62. Gjykata thekson që praktika e GJEDNJ-së kufizon aplikueshmërinë e nenit 6 të KEDNJ-së në "*procedurat paraprake*". Rrjedhimisht, aplikueshmërinë e garancive procedurale të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata do të përcaktojë duke u mbështetur në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. (Shih gjithashtu Aktgjykimin në rastin nr. KI122/17, parashtrues, *Česká Exportní Banka A. S.,* Aktgjykim i 30 prillit 2018*,* paragrafi 124).

63. Gjykata së pari vëren se fushëveprimi i nenit 6 të KEDNJ-së, në pjesën civile, zbatohet në procedurat që përcaktojnë të "*drejtat ose detyrimet civile*". (Shih rastin e GJEDNJ-së: *Ringeisen kundër Austrisë*, kërkesa nr. 2614/65, Aktgjykim i 22 qershorit 1972). GJEDNJ ka konstatuar se për të qenë neni 6 në kontekstin e tij civil i aplikueshëm, *"duhet të ekzistojë një kontest në lidhje me një "të drejtë civile", për të cilën mund të thuhet, të paktën në baza të argumentueshme, që është e njohur në të drejtën vendore, pavarësisht se a është e mbrojtur edhe me Konventë. Kontesti duhet të jetë i vërtetë dhe serioz; ai mund të ndërlidhet jo vetëm me vetë ekzistencën e së drejtës, por edhe me fushëveprimin dhe mënyrën e realizimit të saj; dhe së fundi, rezultati i procedurave duhet të jetë drejtpërsëdrejti determinues për të*

*drejtën në fjalë; lidhjet e paqarta ose pasojat e largëta nuk janë të mjaftueshme për aktivizimin e nenin 6 paragrafi 1". (*Shih GJEDNJ: *Mennitto kundër Italisë*, kërkesa nr. 33804/96, Aktgjykim i 5 tetorit 2000, paragrafi 23; *Gülmez kundër Turqisë*, kërkesa nr. 16330/02, Aktgjykim i 20 majit 2008, paragrafi 28; dhe *Micallef kundër Maltës*, nr. 17056/06, Aktgjykim i 15 tetorit 2009, paragrafi 74).

64. Gjykata më tutje thekson se "*procedurat paraprake*", si ato që kanë të bëjnë me dhënien e një mase të përkohshme/mase të sigurisë - nuk konsiderohen që përcaktojnë të "*drejta dhe detyrime civile*" dhe për këtë arsye, në parim, nuk hynë në kuadër të fushëveprimit të mbrojtjes së tillë të nenit 6 të KEDNJ-së. (shih rastet e GJEDNJ-së: *Wiot v. Francës*, kërkesa nr. 43722/98, Aktgjykimi i 7 janarit 2003; *APIS a.s. kundër Sllovakisë*, kërkesa nr. 39754/98, Aktgjykimi i 13 janarit 2000; *Verlagsgruppe NEËS GmbH kundër Austrisë*, kërkesa nr. 62763/00, Aktgjykim i 23 tetorit 2003; *Libert kundër Belgjikës*, kërkesa nr. 44734/98, Aktgjykim i 8 korrikut 2004; *Micallef kundër Maltës*, kërkesa nr. 17056/06, Aktgjykim i 15 tetorit 2009, paragrafi 83, shih gjithashtu rastin e Gjykatës KI 122/17, Parashtrues *Ceska Exportni Banka A.S*, Aktgjykim i 30 prillit 2018, paragrafi 126).

65. Megjithatë, në raste të caktuara, GJEDNJ ka aplikuar nenin 6 të KEDNJ-së në "*procedura paraprake*", kur konsideroi se masat e sigurisë ishin vendimtare apo determinuese për të drejtat civile të parashtruesit të kërkesës. (Shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së; *Aerts kundër Belgjikës*, kërkesa nr, 25357/94, Aktgjykimi i 30 korrikut 1998; *Boca kundër Belgjikës*, kërkesa nr. 50615/99, Aktgjykimi i 15 nëntorit 2012; *Micallef kundër Maltës*, kërkesa nr. 17056/06, Aktgjykim i 15 tetor 2009, paragrafi 75; shih gjithashtu rastin e Gjykatës KI 122/17, Parashtrues *Ceska Exportni Banka A.S*, Aktgjykim i 30 prillit 2018, paragrafi 127).

66. Përmes Aktgjykimit *Micallef kundër Maltës* në vitin 2009, GJEDNJ kishte ndryshuar qëndrimin e saj të mëparshëm përkitazi me mosaplikueshmërinë e garancive procedurale të nenit 6 të KEDNJ-së në "*procedurat paraprake*". (shih gjithashtu rastin e Gjykatës KI 122/17, Parashtrues *Ceska Exportni Banka A.S*, Aktgjykim i 30 prillit 2018, paragrafi 128). Në ndryshimin e këtij qëndrimi, GJEDNJ kishte arsyetuar, ndër të tjera, si në vijim:

> *"Përjashtimi i masave të përkohshme nga fushëveprimi i nenit 6 deri tani është justifikuar me faktin që ato, në parim, nuk përcaktojnë detyrime dhe të drejta civile. Megjithatë, në kushtet*

kur shumë Shteteve Kontraktuese u duhet të përballen me një akumulim të konsiderueshëm çështjesh për shkak të mbingarkesës së sistemeve të tyre të drejtësisë, gjë që çon në procese të tejzgjatura, vendimi i një gjyqtari për një urdhër ndalues shpesh ndodhë që është i barasvlershëm me një vendim për themelin e çështjes për një kohë të konsiderueshme, nganjëherë edhe përgjithmonë. Rrjedhimisht, shumë herë ndodhë që procedurat për masa të përkohshme dhe ato në lidhje me veprimin ligjor kryesor vendosin për të njëjtat "detyrime dhe të drejta civile" dhe japin të njëjtat efekte afatgjata apo edhe të përhershme. (Shih rastin e GJEDNJ-së: Micallef kundër Maltës, kërkesa. nr. 17056/06, Aktgjykim i 15 tetorit 2009, paragrafi 79).

67. Megjithatë, ky Aktgjykim nuk eliminoj të gjitha kufizimet sa i përket aplikueshmërisë së nenit 6 të KEDNJ-së përkitazi me masat e përkohshme. Aktgjykimi në fjalë, kushtëzoi aplikueshmërinë e nenit 6 të KEDNJ-së në "*proceduarat paraprake*" mbi kualifikueshmërinë e të njëjtave si të "*drejta ose detyrime civile*". (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Micallef kundër Maltës*, kërkesa nr. 17056/06, Aktgjykim i 15 tetorit 2009, paragrafi 83). Ndërsa, këtë kualifikueshmëri e kushtëzoi në plotësimin e dy kushteve thelbësore: a) "*procedura paraprake*" duhet të mbuloj një të drejtë "*civile*", dhe b) kjo procedurë duhet të përcaktojë në mënyrë efektive të drejtën civile. (Shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ, *Micallef kundër Maltës*, kërkesa nr. 17056/06, Aktgjykim i 15 tetorit 2009, paragrafët 84 dhe 85; dhe rastin e Gjykatës KI 122/17, Parashtrues *Ceska Exportni Banka A.S*, Aktgjykim i 30 prillit 2018, paragrafët 129-131).

68. Më specifikisht, sa i përket kushtit të parë, e drejta në fjalë duhet të jetë "*civile*", si në shqyrtimin gjyqësor ashtu edhe në procedurat lidhur me masën e përkohshme/sigurisë, brenda kuptimit autonom të këtij nocioni sipas nenit 6 të KEDNJ-së. (Shih*, inter alia*, rastet e GJEDNJ-së: *Rafineritë Greke dhe Stratis Andreadis kundër Greqisë*, kërkesa nr. 13427/87, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 39; *König kundër Gjermanisë*, kërkesa nr. 6232/73, Aktgjykim i 28 qershorit 1978, paragrafët 89-90; *Ferrazzini kundër Italisë*, kërkesa nr. 44759/98, Aktgjykim i 15 korrikut 1999, paragrafët 24-31; *Rochev. Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 32555/96, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 119; dhe *Micallef kundër Maltës*, kërkesa nr. 17056/06, Aktgjykim i 15 tetorit 2009, paragrafi 84).

69. Ndërsa, sa i përket kushtit të dytë, GJEDNJ-ja thekson se duhet të shtjellohet natyra e masës së përkohshme/masës së sigurisë, meqenëse sa herë që një masë e tillë konsiderohet që përcakton në

mënyrë efektive të drejtën civile ose detyrimin në fjalë - neni 6 i KEDNJ-së do të jetë i aplikueshëm. (Shih rastin e GJEDNJ-së *Micallef kundër Maltës*, kërkesa nr. 17056/06, Aktgjykim i 15 tetorit 2009, paragrafi 85).

Zbatimi i parimeve të lartpërmendura në rrethanat e rastit konkret

70. Në këtë aspekt, dhe në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren që masa e përkohshme ishte vendosur deri në zgjidhjen e kontestit civil në mes palëve e që ka të bëjë më të drejtën e servitutit. Gjykata gjithashtu vëren që "*procedura paraprake*", përkatësisht, masa e përkohshme në rrethanat e rastit konkret, mbulon një të drejtë "*civile*", duke plotësuar kështu kushtin e parë për aplikueshmërinë e garancive procedurale të nenit 6 të KEDNJ-së. Për më tepër, sa i përket, kushtit të dytë, Gjykata vëren masa e përkohshme fillimisht e caktuar në vitin 1996, në fakt përcakton në mënyrë efektive të drejtën civile në fjalë. Gjykata vëren se masa e përkohshme për të cilën u zhvilluan të gjitha procedurat gjyqësore me tej, në esencë dhe në mënyrë efektive zgjidh kontestin civil në mes palëve në favor të parashtruesit të kërkesës. Si rezultat, të gjitha procedurat gjyqësore ishin fokusuar në caktimin dhe kontestimin e masës së përkohshme, dhe nuk ishin drejtuar në zgjidhjen e kontestit civil.

71. Rrjedhimisht, duke marrë parasysh të drejtën e përfshirë në "*procedurat paraprake*", përkatësisht masën e përkohshme dhe natyrën e saj përcaktuese për të drejtën civile në fjalë, Gjykata konstaton që rrethanat e rastit konkret, bazuar në praktikën e GJEDNJ-së, i përmbushin kriteret për aplikimin e garancive procedurale të mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

72. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është *rationae materie* në pajtim më Kushtetutën.

73. Gjykata në fund gjithashtu vlerëson se kjo kërkesë nuk është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës dhe se nuk është e papranueshme në asnjë bazë tjetër bazuar në Rregullorën e punës. Rrjedhimisht, ajo duhet deklaruar e pranueshme. (shih rastin e GJEDNJ-së *Alimuçaj kundër Shqipërisë*, kërkesa nr. 20134/05, Aktgjykimi i 9 korrikut 2012, paragrafi 144; shih gjithashtu, rastin KI97/16, parashtrues IKK Classic, Aktgjykim i datës 9 janar 2018, paragrafi 38).

Dispozitat Relevante Ligjore

LIGJI NR. 04/L-139 PER PROCEDUREN PERMBARIMORE

KREU V
ZBATIMI I PËRMBARIMIT

[...]

Neni 52
Parregullsitë me rastin e kryerjes së përmbarimit
1. Pala ose pjesëmarrësi tjetër i procedurës mund të kërkojë nga Gjykata me anë të parashtresës që t'i eliminoj parregullsitë e bëra nga organi përmbarues gjatë kryerjes së veprimeve përmbarimore. Kjo kërkese i bëhet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve nga dita e ndodhjes së parregullsisë së pretenduar.
2. Sipas kërkesës nga paragrafi 1. i këtij neni, po qe se parashtruesi e ka propozuar këtë, Gjykata nxjerrë aktvendim brenda tre (3) ditësh nga dita e dorëzimit të parashtresës.

KREU VII
SHTYERJA, PEZULLIMI DHE PËRFUNDIMI I PËRMBARIMIT

[...]

Neni 66
Përfundimi i procedurës përmbarimore
1. Në qoftë se me këtë ligj nuk është paraparë ndryshe, përmbarimi do të përfundojë sipas detyrës zyrtare në qoftë se dokumenti përmbarimor është anuluar, ndryshuar, shfuqizuar, apo në ndonjë mënyrë tjetër është bërë i pa efekt, apo në qoftë se vërtetimi për përmbarueshmërin e tij anulohet me vendim të formës së prerë. Përmbarimi do të mbarojë gjithashtu sipas detyrës zyrtare nëse një rast është pezulluar dy (2) herë dhe për herë i plotëson kriteret për pezullim siç përcaktohet në paragrafin 1. neni 65. të këtij ligji.
2. Përmbarimi do të përfundohet sipas detyrës zyrtare edhe kur në pajtim me dispozitat ligjore me të cilat rregullohen marrëdhëniet detyrimore, personi i tretë e përmbushë obligimin në dobi të kreditorit në vend të debitorit.
3. Përmbarimi do të përfundohet edhe kur ai është bërë i pamundshëm apo kur nga shkaqe të tjera nuk mund të zbatohet, si dhe pas kalimit të afatit absolut të parashkrimit për përmbarim.
4. Pas përmbushjes se kredisë se kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbarimore.

KREU VIII
MJETET JURIDIKE

Neni 67
Mjetet e rregullta juridike
1. Në procedurën përmbarimore, mjetet e rregullta të goditjes janë:
1.1. Prapësimi dhe
1.2. Ankesa.

Neni 68
Mjetet e jashtëzakonshme juridike
1. Nuk është i lejuar revizioni dhe përsëritja e procedurës në procedurën përmbarimore.
2. Kthimi në gjendjen e mëparshme është i lejuar vetëm në rastet e mos ruajtjes së afateve për paraqitjen e prapësimit dhe ankesës kundër vendimeve të përmbarueshëm për përmbarimin me dhunë.

Neni 69
Prapësimi kundër vendimeve për përmbarim
1. Prapësimi mund të paraqitet vetëm kundër vendimeve të organit përmbarues me të cilin përmbarimi është i lejuar.
2. Prapësimi duhet të paraqitet me shkrim, në Gjykatën themelore e cila ka lëshuar vendimin përmbarues kundër të cilit prapësimi është paraqitur kur organi përmbarues është Gjykata.
3. Prapësimi duhet të paraqitet me shkrim në Gjykatën themelore, siç është përcaktuar me paragrafin 5. të nenit 5 të këtij ligji kur organin përmbarues është përmbaruesi privat.
4. Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet.
5. Prapësimi kundër vendimit përmbarues ose urdhrit përmbarues mund të paraqitet ekskluzivisht sipas dispozitave të nenit 71 të këtij ligji.
6. Prapësimi do të përmbaj të dhënat e vendimit përmbarimor kundër të cilit është bërë ankesa, arsyet e prapësimit dhe nënshkrimin e debitorit.
7. Vendimi me të cilin refuzohet propozimi për përmbarim mund të goditet vetëm me ankesë të kreditorit të përmbarimit në pajtim me nenin 77 të këtij ligji.

[...]

Neni 71
Shkaqet e prapësimit
1. Sipas nenit 69 të këtij ligji, prapësimi mund të bazohen vetëm nëse:
1.1. dokumenti, në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbarueshmerisë;
1.2. dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues është prishur, anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë e ka humbur efektin e tij ose është konkluduar se është pa efekt juridik;
[...]
1.4. ka skaduar afati kohor brenda të cilit, sipas ligjit, mund të kërkohet përmbarimi;
[...]

Neni 74
Forma e prerë dhe përmbarueshmeria e vendimeve në procedurën e përmbarimit
1. Vendimi kundër të cilit nuk është paraqitur brenda afatit ligjor prapësimi, bëhet i formës së prerë dhe i përmbarueshem.
2. Vendimi kundër të cilit është refuzuar prapësimi bëhet i përmbarueshem, e po që se kundër tij nuk lejohet ankesa, ai bëhet i formës së prerë.
3. Vendimi me të cilin refuzohet prapësimi bëhet i formës së prerë, po që se kundër tij nuk paraqitet ankesë brenda afatit ligjor, ose në qoftë se ankesa refuzohet si e pathemeltë.

[...]

Neni 77
Ankesa kundër vendimit lidhur me prapësimin
1. Palët kanë të drejtë ankese kundër vendimit mbi prapësimin.
2. Ankesa kundër vendimit mbi prapësimin parashtrohet përmes Gjykatës së shkallës së parë për Gjykatën e shkallës së dytë, në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit.
3. Një kopje e ankesës u dorëzohet palës kundërshtare dhe pjesëmarrësve tjerë të cilët mund të paraqesin përgjigje në ankesë në afat prej tre (3) ditëve.
4. Pas pranimit të përgjigjes në ankesë ose pas kalimit të afatit për përgjigje, lënda së bashku me të gjitha shkresat tjera i dërgohet Gjykatës së shkallës së dytë në afat prej tre (3) ditësh. Lidhur me

ankesën, Gjykata e shkallës së dytë do të vendosë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve.
5. Ankesa kundër vendimit nuk e ndalon procedurën përmbarimore përveç nëse janë dhënë garancitë për shumën e plotë të kredisë sipas nenit 78 të këtij ligji.
6. Në rast se debitori si palë ankuese është i suksesshëm në ankesën e tij dhe nëse pasuria e tij është përmbaruar në pajtim me vendimin përmbarimore, ai mund të kërkoj kundër përmbarim sipas dispozitave të këtij ligji për kundër përmbarimin.

[...]

Neni 79
Ankesat kundër parregullsive me rastin e kryerjes së përmbarimit
1. Pala ose pjesëmarrësi tjetër në procedurë mund të parashtrojë një ankesë në Gjykatë, lidhur me parregullsitë që janë kryer nga organi përmbarues gjatë kryerjes së procedurës së përmbarimit. Kjo kërkesë i bëhet Gjykatës me një parashtresë me shkrim në afat prej shtatë (7) ditësh nda dita e ndodhjes së parregullsisë së pretenduar.
2. Sipas kërkesës nga paragrafi 1. i këtij neni, nëse parashtruesi e ka propozuar këtë, Gjykata nxjerr vendimin brenda tre (3) ditësh nga dita e dorëzimit të parashtresës.
3. Palët ose pjesëmarrësit tjerë në procedurë kanë të drejtë ankese kundër vendimit të përmendur në paragrafin 2. të këtij neni në pajtim me dispozitat e nenit 77 të këtij ligji.

LIGJI NR. 04/L-077 PËR MARRËDHËNIET E DETYRIMEVE

NËNKREU 2
AFATI I PARASHKRIMIT

[...]

Neni 361
Kërkesat e vërtetuara nga gjykata ose organet tjera kompetente
1. Të gjitha kërkesat që janë vërtetuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose me vendim të organit tjetër kompetent, ose me ujdinë e palëve para gjykatës apo organit tjetër kompetent, parashkruhen për dhjetë (10) vjet, madje edhe ato për të cilat ligji edhe ashtu parashikon afat më të shkurtër për parashkrim.

2. Megjithatë, të gjitha kërkesat periodike që rrjedhin nga vendimet ose ujditë e tilla dhe arrijnë për pagesë në të ardhmen, parashkruhen në afatin e paraparë për parashkrimin e kërkesave periodike.

Meritat e kërkesës

74. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi i lartcekur i Gjykatës Supreme në lidhje me Aktvendimin [AC.nr.1579/2015] e 4 prillit 2016 të Gjykatës së Apelit, janë nxjerrë në shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë], nenin 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrojtja e Pronës) të KEDNJ-së, si dhe me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës.

75. Gjykata fillimisht vëren që, sa i përket pretendimeve për shkelje të neneve 22, 29, 30, 46 dhe 53 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës Gjykatës nuk i ofron asnjë arsyetim në mbështetje të shkeljeve të pretenduara të këtyre neneve. Rrjedhimisht, Gjykata do të fokusohet në shqyrtimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të garancive procedurale të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

76. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon që në nxjerrjen e Aktvendimit [AC. nr. 1579/2015] të 4 prillit 2016, Gjykata e Apelit kishte tejkaluar kompetencat e saj të përcaktuara me ligj duke ndryshuar Aktvendimin [PPP.nr.59/2015] e 2 prillit 2015 të Gjykatës Themelore në Gjakovë. Parashtruesi i kërkesës për më tepër pretendon se dy Aktvendime paraprake në rrethanat e rastit konkret, Aktvendimi [AC. nr. 3356/14] i 7 tetorit 2014 të Gjykatës së Apelit në lidhje me Aktvendimin [CP.Nr.281/13] e 21 korrikut 2014 të Gjykatës Themelore në Gjakovë, ishin bërë të formës së prerë dhe rrjedhimisht, *res judicata*.

77. Në këtë aspekt, Gjykata thekson që pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës, që kanë të bëjnë me shkeljet e pretenduara të garancive procedurale të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, janë interpretuar detajisht përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, Gjykata në

bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë. Rrjedhimisht, në interpretimin e pretendimeve për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së sa i përket respektimit apo mundësisë së ndryshimit të një vendimi të formës së prerë, Gjykata do t'i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së.

78. Në vlerësimin e këtyre pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata së pari do të i shtjellojë parimet e përgjithshme lidhur me të drejtën e sigurisë juridike dhe respektimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë, sic janë të përcaktuara nga GJEDNJ dhe nga Gjykata, për të i aplikuar më pas ato në rrethanat e rastit konkret.

Parimet e përgjithshme lidhur me të drejtën e sigurisë juridike dhe respektimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë

79. Gjykata fillimisht rikujton që e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm kërkon që një çështje që është bërë *res judicata* të konsiderohet e pakthyeshme, në pajtim me parimin e sigurisë juridike. (Shih rastin e GJEDNJ-së: *Brumărescu kundër Rumanisë*, kërkesa nr. 28342/95, Aktgjykim i 28 tetorit 1999, paragrafi 61; gjithashtu, rastin e Gjykatës KI 122/17, Parashtrues *Ceska Exportni Banka A.S*, Aktgjykim i 30 prillit 2018, paragrafi 149, dhe rastin KI 67/16, Parashtrues *Lumturije Voca*, Aktvendim për Papranueshmëri i 4 janarit 2017, paragrafi 87).

80. Ky qëndrim është në përputhshmëri me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së e cila ka theksuar se një nga aspektet themelore të sundimit të ligjit është parimi i sigurisë juridike, i cili presupozon respektimin e parimit *res judicata*, që është parimi i formës së prerë të vendimeve gjyqësore. (Shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së: *Ponomaryov kundër Ukrainës*, kërkesa nr. 3236/03, Aktgjykimi i 3 prillit 2008, paragrafi 40; *Ryabykh kundër Rusisë*, kërkesa nr. 52854/99, Aktgjykimi i 24 korrikut 2003, paragrafët 52 dhe 56; dhe rastin e Gjykatës KI 67/16, Parashtrues *Lumturije Voca*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 4 janarit 2017, paragrafi 85). Ky parim sipas GJEDNJ-së, përcakton se "*asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rishikimin e një vendimi të formës së prerë dhe të plotfuqishëm thjesht për qëllimin e fitimit të rishikimit dhe rishqyrtimit të freskët të rastit*". (Shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ *Ryabykh kundër Rusisë*, kërkesa nr. 52854/99, Aktgjykimi i 24 korrikut 2003, paragrafi 52 ; dhe rastin e Gjykatës KI67/16, Parashtrues *Lumturije Voca*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 4 janarit 2017, paragrafi 86).

Sipas GJEDNJ-së, *"një shmangie nga ky parim justifikohet vetëm kur bëhet e nevojshme nga rrethanat e një karakteri substancial ose bindës"*. (shih rastin e GJEDNJ *Ponomaryov kundër Ukrainës*, kërkesa nr. 3236/03, Aktgjykimi i 3 prillit 2008, paragrafi 40).

81. Në funksion të respektimit të këtij parimi, GJEDNJ përmes praktikës së saj gjyqësore, ka mbajtur se në shqyrtimin e ankesave, gjykatat më të larta duhet të ushtrojnë kompetencat e tyre ligjore në funksion të korrigjimit të gabimeve gjyqësore dhe të drejtësisë, por jo të kryejnë një shqyrtim të ri, thjeshtë për të paraqitur një pikëpamje të re. (Shih rastin e GJEDNJ-së *Ryabykh kundër Rusisë*, kërkesa nr. 52854/99, Aktgjykimi i 24 korrikut 2003, paragrafi 52 dhe rastin e Gjykatës KI 122/17, Parashtrues *Ceska Exportni Banka A.S*, Aktgjykim i 30 prillit 2018, paragrafët 152 e 153). Kjo e fundit sipas GJEDNJ-së është e mundshme, vetëm në rrethana të jashtëzakonshme. Më specifikisht, në këtë aspekt, GJEDNJ ka konstatuar se:

> *"Duhet të ushtrohet kompetenca e gjykatave më të larta për të korrigjuar gabimet gjyqësore dhe gabimet e drejtësisë, por jo për të kryer një shqyrtim të ri. Rishikimi nuk duhet të trajtohet si një ankesë e maskuar dhe mundësia e thjeshtë për të pasur dy pikëpamje mbi këtë temë nuk është një bazë për rishqyrtim. Largimi nga parimi justifikohet vetëm nëse një gjë e tillë bëhet e nevojshme nga rrethanat dhe nga karakteri substancial bindës dhe detyrues"*. [...] (Shih, për shembull, rastin e GJEDNJ-së *Ryabykh kundër Rusisë,* kërkesa nr. 52854/99, Aktgjykimi i 24 korrikut 2003, paragrafët 52 dhe 56).

82. Për më tepër, GJEDNJ përmes rastit *Nikiti kundër Rusisë* ka përcaktuar më tej definicionin e konceptit *res judicata*, duke përcaktuar kriteret e përgjithshme mbi bazën e të cilave një vendim do të konsiderohet si i tillë. (Shih gjithashtu rastin e Gjykatës KI 122/17, Parashtrues *Ceska Exportni Banka A.S*, Aktgjykim i 30 prillit 2018, paragrafi 150). Në bazë të Aktgjykimit në fjalë, një vendim do të jetë *res judicata* nëse: a) vendimi është i parevokueshëm sepse nuk ka mjete të mëtejshme në dispozicion; ose b) kur afati për shfrytëzimin e të njëjtave ka përfunduar. Më specifikisht, GJEDNJ ka theksuar:

> *"Sipas raportit shpjegues për Protokollin nr. 7, i cili i referohet Konventës Evropiane për Vlefshmërinë Ndërkombëtare të Gjykimeve Penale, "një vendim është final, 'nëse, sipas shprehjes tradicionale, ka fituar fuqinë e res judicata. Ky është rasti kur vendimi është i parevokueshëm, që do të thotë kur nuk ka mjete të mëtejshme të zakonshme në dispozicion ose kur palët i kanë shteruar këto mjete ose kanë lejuar që afati të mbarojë pa i*

shfrytëzuar ato". (shih rastin *Nikitin kundër Rusisë*, kërkesa nr. 50178/99, GJEDNJ, Aktgjykim i 15 dhjetorit 2004, paragrafi 37).

83. Rrjedhimisht, dhe bazuar në praktikën e GJEDNJ-së, në parim, një vendim merr formën e prerë dhe statusin *res judicata* nëse a) vendimi është i parevokueshëm sepse nuk ka mjete të mëtejshme në dispozicion; ose b) kur afati për shfrytëzimin e të njëjtave ka përfunduar. Të njëjtat konsiderohet të pakthyeshme në pajtim me parimin e sigurisë juridike, si një ndër aspektet themelore të sundimit të ligjit. Për më tepër, kompetencat e gjykatave nuk mund të tejkalohet në vlerësimin e vendimeve të tilla në funksion të shqyrtimit të ri të rastit apo dhënies së një pikëpamje të re e e cila nuk ka bazë për rishqyrtim.

84. Megjithatë, praktika e gjyqësore e GJEDNJ-së, përcakton një përjashtim nga këto parime: *rrethanat e karakterit substancial dhe bindës*. Më specifikisht, në ushtrimin e funksionit të gjykatave për të "*korrigjuar gabimet gjyqësore dhe gabimet e drejtësisë*", shmangia nga parimi i respektimit të një vendimi të formës së prerë, përkatësisht *res judicata*, justifikohet vetëm nëse një gjë e tillë bëhet e "*nevojshme nga rrethanat e një karakteri substancial dhe bindës*".

85. Në fund dhe në këtë aspekt, Gjykata rikujton se GJEDNJ ka përcaktuar se, përveç vendimeve përfundimtare për meritat, edhe vendimet e ndërlidhura me "*procedurat paraprake*" mund të bëhen *res judicata*. (shih ndër të tjera rastin, Okyay dhe të tjerë kundër Turqisë, Aktgjykim i 12 korrikut 2005, kërkesa nr. 36220/97, paragrafët 72-75 dhe referencat tjera të përfshiera në to; shih gjithashtu, rastin e Gjykatës nr. KI122/17, *Česká Exportní Banka A.S*, Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, i 18 prillit 2018, paragrafi 158).

Zbatimi i parimeve të lartpërmendura në rrethanat e rastit konkret

86. Gjykata fillimisht rikujton që palët në kontest që nga vitin 1996 e deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës Supreme të vitit 2016, të cilin parashtruesi i kërkesës e konteston në Gjykatë, kanë kaluar nëpër procedura gjyqësore rreth përmbarimit të Aktvendimit [C.nr.270/96] të 25 dhjetorit 1996 të Gjykatës Komunale në Gjakovë, përmes të cilit ishte aprovuar fillimisht kërkesa për masë të përkohshme. Përkundër faktit që e njëjta Gjykatë përmes Aktvendimit [E. nr. 419/97] të 3 shkurtit 1997, kishte lejuar ekzekutimin e kësaj mase, ajo nuk ishte ekzekutuar asnjëherë. Palët në kontest, që nga viti 2009 i janë drejtuar gjykatave të rregullta duke kërkuar, përkatësisht kundërshtuar, ekzekutimin e masës së përkohshme të vitit 1996. Procedurat

gjyqësore në vijim kishin rezultuar në një numër vendimesh, kontradiktore me njëra-tjetrën.

87. Nga njëra anë, më 4 prill 2013, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit [CA. nr. 3662/2012], refuzoi ankesën e të padituri, përkatësisht debitorit M.R., të parashtruar kundër Aktvendimit [C.nr.270/96] të 25 dhjetorit 1996 të Gjykatës Komunale në Gjakovë si të paafatshme, duke konfirmuar kështu plotëfuqishmërinë e masës së përkohshme të përcaktuar në vitin 1996. Gjykata vëren që kundër Aktvendimit të lartëcekur të Gjykatës së Apelit, nuk ishte e lejuar ankesa. Rrjedhimisht, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se pas këtij Aktvendimi, çështja e masës së përkohshme ishte bërë çështje e gjykuar.

88. Nga ana tjetër, një muaj më vonë, po e njejta gjykatë, përkatësisht, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit [AC. nr. 4864/2012] të 2 majit 2013, konfirmoi Aktvendimin [E. nr. 419/97] të 31 majit 2011 të Gjykatës Komunale në Gjakovë, duke konfirmuar aprovimin e ankesës së të padituri, përkatësisht debitorit M. R., dhe duke pezulluar kështu procedurën e përmbarimit të masës së përkohshme. Gjykata vëren që kundër Aktvendimit të lartëcekur të Gjykatës së Apelit, nuk ishte e lejuar ankesa. Rrjedhimisht, i padituri, përkatësisht debitori M.R., përgjatë të gjithë procedurave të mëtejme gjyqësore, kishte pretenduar se pas këtij Aktvendimi, çështja e masës së përkohshme ishte bërë çështje e gjykuar.

89. Gjykata thekson faktin që Gjykata e Apelit në rastin e njejtë kishte nxjerr dy Aktvendime të kundërta, njërën në favor të parashtruesit të kërkesës, ndërsa tjetrën në favor të debitorit M.R. Për më tepër, Gjykata rithekson që kundër Aktvendimeve përkatëse të Gjykatës së Apelit nuk ishte e lejuar ankesa dhe rrjedhimisht, në bazë të nenit 74 të LPP-së, të dy vendimet kishin marrë formën e prerë dhe rrjedhimisht ishin bërë *res judicata*.

90. Kjo gjë ishte theksuar gjithashtu në Aktvendimin e fundit të Gjykatës se Apelit, përkatësisht Aktvendimin [AC.nr.1579/2015] e 4 prillit 2016, të cilin parashtruesi i kërkesës e konteston në Gjykatë. Gjykata e Apelit në arsyetimin e saj, kishte tërhequr vëmendjen në faktin se Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [CA.nr.3662/2012] të 4 prillit 2013, kishte vërtetuar Aktvendimin [C. nr. 270/96] e 25 dhjetorit 1996 duke arsyetuar se ai ishte i formës së prerë dhe rrjedhimisht, ishte i përmbarueshëm. Ndërsa, e njëjta Gjykatë, një muaj më vonë, përkatësisht, me 2 maj 2013, përmes Aktvendimit [AC.nr.4864/2012] kishte konfirmuar Aktvendimin [E.nr.419/97] e 31 majit 2011 të

Gjykatës Themelore në Gjakovë, duke e konfirmuar pezullimin e përmbarimit të masës së përkohshme. Në këtë aspekt, Gjykata e Apelit, ndër të tjera, kishte theksuar:

> *"Si rezultat, në rastin konkret paraqiten dy aktvendime të shkallës së parë dhe dy aktvendime të shkallës së dytë - kontradiktor me njëri-tjetrin, edhe pse kanë të bëjnë për të njëjtën çështje përmbarimore, konkretisht me përmbarimin e të njëjtit titull përmbarimor që është Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Gjakovë, C. nr. 270/1996, i datës 25.12.1996, për caktimin e masës së përkohshme - e caktuar para 20 vitesh nga momenti aktual (1996-2016)".*

91. Megjithatë, sa i përket këtyre dy Aktvendimeve, Gjykata vëren që vendimi i fundit, në këtë fazë të procedurës, ishte Aktvendimi [AC.nr.4864/2012] i 2 majit 2013 i Gjykatës së Apelit dhe i cili kishte pezulluar procedurën përmbarimore, vazhdimin e të cilës parashtruesi i kërkesë asnjëherë nuk e kishte kërkuar, përkundër faktit që mënyra e vazhdimit të një procedurë të pezulluar është e përcaktuar me dispozitat e LPP-së, specifikisht nenin 65 të tij, dhe e cila në të kundërtën, me kalimin e afatit 6 mujor, konsiderohet e përfunduar. Një gjë të tillë e kishte theksuar edhe Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit të kontestuar në Gjykatë nga parashtruesit e kërkesës. Në këtë aspekt, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit [AC. nr. 1579/2015] të 4 prillit 2016, kishte theksuar:

> *"Ndërkaq, herën e dytë, kreditorët as që kanë pasur të drejtë të ushtrojnë propozim të ri për përmbarim me datë 11.11.2013, i cili herën e dytë është lejuar nga gjykata e shkallës së parë sipas aktvendimit E.nr. 1281/2013 i datës 11.11.2013, i vërtetuar me aktvendimin e shkallës së dytë Ac.nr.3356/2014 i datës 21.7.2014 – por kanë mundur të kërkojnë vazhdimin e procedurës së pezulluar përmbarimore në kuptimin e dispozitave të LPP-së."*

92. Përkundër kësaj, Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës fokusuan veprimet e tyre në drejtim të përmbarimit të Aktvendimit paraprak të Gjykatës se Apelit, përkatësisht Aktvendimit [CA. nr. 3662/2012] të 4 prillit 2013 dhe i cili duke shpallur të pasafatshme ankesën e debitorit, kishte konfirmuar Aktvendimin [C.nr.270/96] e 25 dhjetorit 1996 të Gjykatës Komunale në Gjakovë për përcaktimin e masës së përkohshme. Si rezultat, më 7 nëntor 2013, parashtruesi i kërkesës i ishte drejtuar Gjykatës Themelore në Gjakovë me propozim për përmbarim të Aktvendimit të lartëcekur të së njejtës Gjykatë.

93. Pas kësaj kërkesë të parashtruesit të kërkesës, vijojnë edhe një numër vendimesh të gjykatave, e të cilat bazohen vetëm në Aktvendimin [CA.nr. 3662/2012] e 4 prillit 2013, përkundër faktit që, i padituri, përkatësisht, debitori M.R., përmes prapësimeve dhe ankesave, kishte ngritur faktin që ekzistonte edhe një Aktvendim tjetër i formës së prerë, përkatësisht, Aktvendimi [AC. nr. 4864/2012] i 2 majit 2013 të Gjykatës së Apelit.

94. Si rrjedhojë dhe fillimisht, Gjykata Themelore në Gjakovë, përmes Aktvendimit [Cp.nr. 1281/2013] të 11 nëntorit 2013 caktoi përmbarimin. Përmbarimi ishte konfirmuar edhe përmes Aktvendimit [CP. nr 281/13] të 21 korrikut 2014 të Gjykatës Themelore në Gjakovë pasi kishte refuzuar prapësimin e debitorit, M.R. Çështja përmbarimore në ndërkohë ishte transferuar të përmbaruesi privat. Për më tepër, edhe ankesa e debitorit M.R., parashtruar në Gjykatë të Apelit kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore ishte refuzuar përmes Aktvendimit [AC.nr.3356/14] të 7 tetorit 2014, dhe rrjedhimisht ishte konfirmuar Aktvendimi [CP.nr.1281/2013] i 21 korrikut 2014 i Gjykatës Themelore në Gjakovë. Më pas, në marsin e vitit në vijim, përkatësisht në 2015, debitori M.R. ishte njoftuar për caktimin e përmbarimit.

95. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi [AC. nr. 3356/14] i 7 tetorit 2014 ishte *res judicata*. Ai gjithashtu pretendon, se pas caktimit të përmbarimit përmes Konkluzionit [P. nr. 02/14] të 24 marsit 2015, ankesat e debitorit, M.R., do të mund të ndërlidheshin vetëm me parregullësitë gjatë kryerjes se përmbarimit në kuptimin e nenit 52 të LPP-së, dhe se në asnjë mënyrë përmes vendimeve të mëtejme të gjykatave nuk do të mund të shqyrtohej lejueshmëria e përmbarimit, por vetëm parregullësitë në zbatimin e tij. Prandaj, sipas parashtruesit të kërkesës, në nxjerrjen e Aktvendimit [AC. nr. 1579/2015] të 4 prillit 2016, Gjykata e Apelit kishte tejkaluar kompetencat e përcaktuara me ligj, duke shqyrtuar edhe lejueshmërinë e përmbarimit përtej parregullësive në zbatimin e përmbarimit, dhe se rrjedhimisht kishte shkelur të drejtat kushtetuese të parashtruesit të kërkesës.

96. Në këtë aspekt, dhe në vijim, Gjykata do të shqyrtoj pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me Aktvendimin e kontestuar të Gjykatës se Apelit, përkatësisht, Aktvendimin [AC. nr. 1579/2015] e 4 prillit 2016. Gjykata do të shtjelloje tri çështje thelbësore që ndërlidhen me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij: a) nëse Aktvendimi [AC. nr. 3356/14] i 7 tetorit 2014 i Gjykatës së Apelit në lidhje me Aktvendimin

[CP. nr 281/13] e 21 korrikut 2014 të Gjykatës Themelore në Gjakovë kishte marrë formën e prerë; b) nëse Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit të kontestuar kishte shkelur të drejtat dhe liritë themelore të parashtruesit të kërkesës duke ndryshuar Aktvendimin [PPP.nr.59/2015] e 2 prillit 2015 të Gjykatës Themelore në Gjakovë, dhe duke e konsideruar të përfunduar procedurën përmbarimore e duke shfuqizuar të gjitha veprimet paraprake të ndërmarra në çështjet përmbarimore në rrethanat e rastit konkret; dhe c) nëse Aktvendimi [CLM. nr. 11/2016] i 13 shtatorit 2016 i Gjykatës Supreme kishte rezultuar në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të parashtruesit të kërkesës.

97. Sa i përket çështjes së parë, Gjykata fillimisht vëren që LPP përcakton mundësinë e ankesës për parregullsitë me rastin e kryerjes së përmbarimit jo vetëm përmes nenit 52 të LPP-së të cilit i referohet parashtruesi i kërkesës, por edhe përmes nenit 79 të LPP-së. Të dy këto nene përcaktojnë mundësinë e palëve në procedurë që përmes ankesës të kërkojnë eliminimin e parregullsive gjatë kryerjes së veprimeve përmbarimore. Për më tepër, neni 52 dhe 79 i referohen edhe nenit 77 të LPP-së. Ky i fundit rregullon ankesat kundër vendimeve për prapësim, duke përcaktuar gjithashtu se ankesat nuk ndalojnë procedurën përmbarimore, përpos në rastet e përcaktuara me ligj, dhe duke lënë mundësinë e kundërpërmbarimit në rast të ankesave të suksesshme. Megjithatë, neni 77 i LPP-së, nuk kufizon shprehimisht kompetencën e gjykatës në rast të ankesës që ndërlidhet me parregullsitë me rastin e kryerjes së përmbarimit. Rrjedhimisht, Aktvendimi [AC. nr. 3356/14] i 7 tetorit 2014 i Gjykatës së Apelit në lidhje me Aktvendimin [CP. nr 281/13] e 21 korrikut 2014 të Gjykatës Themelore në Gjakovë nuk ishte bërë i formës së prerë në kontekstin e nenit 52 të LPP-së, të cilit i referohet parashtruesi i kërkesës, por në kontekstin e nenit 74 të LPP-së.

98. Në këtë aspekt, Gjykata i referohet nenit 74 të LPP-së i cili përcakton formën e prerë dhe përmbarueshmërinë e vendimeve në procedurën përmbarimore. Sipas këtij neni, ndër të tjera, "*vendimi me të cilin refuzohet prapësimi bëhet i formës së prerë, po që se kundër tij nuk paraqitet ankesë brenda afatit ligjor, ose në qoftë se ankesa refuzohet si e pathemeltë*".

99. Gjykata vëren se Aktvendimi [Cp. nr. 1281/2013] i 11 nëntorit 2013 i Gjykatës Themelore në Gjakovë kishte caktuar përmbarimin. Prapësimi kundër Aktvendimit ishte refuzuar përmes Aktvendimit [CP. nr 281/13] të 21 korrikut 2014 të Gjykatës Themelore në Gjakovë. Kundër këtij Aktvendimi ishte ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit e

cila përmes Aktvendimit [AC. nr. 3356/14] të 7 tetorit 2014 kishte refuzuar të njejtën si të pathemeltë. Rrjedhimisht, ishte refuzuar edhe prapësimi edhe ankesa dhe mbi bazën e paragrafit 3 të nenit 74 të LPP-së, Aktvendimi [AC. nr. 3356/14] i 7 tetorit 2014 të Gjykatës së Apelit në lidhje me Aktvendimin [CP. nr 281/13] e 21 korrikut 2014 të Gjykatës Themelore në Gjakovë, ishte bërë i formës së prerë.

100. Sa i përket çështjes së dytë, përkatësisht vlerësimit nëse Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit të kontestuar ka shkelur të drejtat dhe liritë themelore të parashtruesit të kërkesës duke shfuqizuar një vendim *res judicata*, Gjykata do të i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të elaboruar më lartë, për sa i përket respektimit të vendimeve *res judicata,* dhe përjashtimeve përkatëse. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton që GJEDNJ përmes praktikës së saj gjyqësore ka përcaktuar se shmangia nga parimi i respektimit të një vendimi të formës së prerë, përkatësisht *res judicata*, justifikohet vetëm nëse një gjë e tillë bëhet e "*nevojshme nga rrethanat* e *karakteri substancial dhe bindës*".

101. Në këtë aspekt, Gjykata iu referohet argumenteve kryesore të Aktvendimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit mbi bazën e të cilave e njejta përfundoj procedurën përmbarimore dhe shfuqizoj të gjitha veprimet e ndërmarra në këtë çështje përmbarimore, si në vijim: a) arritjes se parashkrimit absolut në rrethanat e rastit konkret sipas nenit 361 të LMD-së, bazë kjo për përfundimin e procedurës përmbarimore sipas detyrës zyrtare sipas nenit 66 të LPP-së; b) Aktvendimit [AC.nr.4864/2012] të 2 majit 2013 të Gjykatës së Apelit, i cili kishte pezulluar procedurën përmbarime, e vazhdimin e të cilës parashtruesi i kërkesës nuk e kishte kërkuar brenda afatit 6 mujor të përcaktuar me dispozitat e LPP-së, duke rezultuar kështu në përfundimin e procedurës përmbarimore, sipas dispozitave të të njëjtit; dhe c) dy Aktvendimeve të Gjykatës së Apelit të vitit 2013, Aktvendimit [CA.nr.3662/2012] dhe Aktvendimit [AC.nr. 4864/2012], respektivisht, të dyja të formës së prerë, e kundërthënëse me njëra tjetrën.

102. Në këtë aspekt, Gjykata i referohet Aktvendimit [AC. nr. 1579/2015] të 4 prillit 2016 të Gjykatës së Apelit, e cila ndër të tjera, kishte arsyetuar, si në vijim:

> *Me nenin 71 të LPP-së, janë paraparë shkaqet e prapësimit, e që në paragrafin 1 pika 1.4 të këtij neni, si shkak i prapësimit është paraparë "skadimi i afatit kohor brenda të cilit, sipas ligjit, mund të kërkohet përmbarimi".*

Ndërkaq, në nenin 379 paragrafi 1 i LMD-së (i vjetri), është paraparë se "të gjitha kërkesat të cilat janë të vërtetuara me vendim të plotfuqishëm të gjykatës apo organit tjetër kompetent, me ujdi përpara gjykatës apo para organit tjetër kompetent - vjetërsohen për dhjetë vjet, e edhe ato për të cilat ligji parasheh afate më të shkurta të vjetërsimit", e që njësoj parashihet edhe me nenin 361 paragrafi 1 i LMD-së të Republikës së Kosovës, nr. 04/L-077, në fuqi nga data 19.1.12.2012.

Në rastin konkret, në kuptim të këtij neni të LMD-së, ka arritur parashkrimi absolut për përmbarimin e aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë C. nr. 270/1996, i datës 25.12.1996, i formës së prerë nga data 16.6.1997, që ka të bëjë me masë të përkohshme, pasi që kanë kaluar gati 20 vjet nga plotfuqishmëria e aktvendimit të gjykatës përmbarimi i të cilit kërkohet, prandaj, kjo gjykatë, si gjykatë e shkallës së dytë, vlerëson se janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 71 paragrafi 1 pika 1.4, lidhur me nenin 66 paragrafi 3 i LPP-së, për përfundimin e procedurës përmbarimore në këtë çështje përmbarimore".

103. Gjykata verën dy efekte të këtij Aktvendimi në rrethanat e rastit konkret: a) përfundimin e procedurës përmbarimore dhe b) shfuqizimin e të gjitha veprimeve paraprake përmbarimore, duke përfshierë Aktvendimet e formës së prerë.

104. Përfundimin e procedurës përmbarimore, Gjykata e Apelit e bazoi mbi bazën e paragrafit të tretë të nenit 66 të LPP-së, sipas të cilit procedura e përmbarimit përfundon sipas detyrës zyrtare, nëse ndër të tjera, përmbarimi është bërë i pamundshëm, për shkaqe tjera nuk mund të zbatohet edhe kur kalon afati absolut i parashkrimit për përmbarim. Kjo e fundit është e përcaktuar përmes nenit 361 të LMD-së.

105. Me përfundimin e procedurës përmbarimore, Gjykata e Apelit gjithashtu shfuqizoj të gjitha veprimet paraprake përmbarimore, ndër to edhe 3 Aktvendime të cilat kishin marrë formën e prerë në ketë procedurë përmbarimore, përkatësisht, Aktvendimin [AC. nr. 3356/14] e 7 tetorit 2014, Aktvendimin [AC. nr. 4864/2012] e 2 majit 2013, dhe Aktvendimin [CA. nr. 3662/2012] e 4 prillit 2013 të Gjykatës së Apelit në lidhje aktvendimet përkatëse të gjykatës më të ulët. Këto Aktvendime të formës së prerë, sic është theksuar më lartë, ishin kundërthënëse me njëra tjetrën, duke i dhënë të drejtë edhe kreditorit dhe debitorit, në të njejtën çështje përmbarimore, përkatësisht përmbarimit të Aktvendimit për masë të përkohëshme të vitit 1996.

106. Në rrethana të tilla të jashtëzakonshme, Gjykata konsideron që shfuqizimi i vendimeve kundërthënëse e të formës së prerë të së njejtës gjykatë në të njejtën çështje përmbarimore, është në funksion të "*korrigjimit të gabimeve gjyqësore dhe gabimeve e drejtësisë*", siç është përcaktuar me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, dhe se shmangia nga respektimi i një vendimi të formës së prerë në rrethanat e rastit konkret, justifikohet dhe është i nevojshëm si rezultat i rrethanave të një "*karakteri substancial dhe bindës*".

107. Gjykata rikujton që rrethanat e rastit konkret ngërthejnë një histori gati njëzetvjeçare përcaktimi e kundërshtimi të një masë të përkohëshme dhe fillimisht dy Aktvendime të formës së prerë e kundërthënëse të të njejtës Gjykatë e të nxjerra në një diference kohore prej një muaji në vitin 2013. Sic është e elaboruar më lartë, njëri, përkatësisht, Aktvendimi [AC. nr. 4864/2012] i 2 majit 2013 i Gjykatës së Apelit, kishte pezulluar procedurën përmbarimore, dhe duke marrë parasysh që vazhdimi i të njejtës nuk ishte kërkuar brenda afatit të caktuar kohorë sipas LPP-së, procedura përmbarimore kishte përfunduar. Përkundër këtij fakti, gjykatat kishin vazhduar të merren me procedurën përmbarimore mbi bazën e Aktvendimit tjetër të formës së prerë, përkatësisht Aktvendimit [CA.nr.3662/2012] të 4 prillit 2013 të Gjykatës së Apelit, përkundër faktit që debitori kishte tërhequr vëmendjen se ekzistonte edhe një vendim tjetër i formës së prerë në favor të tij, përgjatë të gjitha prapësimeve dhe ankesave. Procedurat në vijim kishin rezultuar edhe një Aktvendim tjetër të formës së prerë, përkatësisht Aktvendimin [AC. nr. 3356/14] të 7 tetorit 2014 të Gjykatës së Apelit në lidhje me Aktvendimin [CP. nr 281/13] e 21 korrikut 2014 të Gjykatës Themelore në Gjakovë, e të cilat kishin konfirmuar edhe një herë përmbarimin e masës së përkohëshme të vitit 1996. Gjykata vëren që këto fakte ngërthejnë rrethana të jashtëzakonshme dhe reflektojnë "*gabime gjyqësorë dhe të drejtësisë*" dhe të cilat plotësojnë kushtin e përcaktuar me GJEDNJ e mbi bazën e të cilit gjykatat më të larta kanë arsye të "*karakterit substancial dhe bindës*" për të bërë përjashtim apo për të shmangur respektimin e një vendimi *res judicata*.

108. Për më tepër, Gjykata gjithashtu rikujton që palët në procedurë, sipas shkresave të lëndës, asnjëherë nuk kishin vazhduar kontestin civil mbi të drejtën e servitutit. Të njejtën e kishte theksuar edhe Gjykata e Apelit, e cilat kishte sqaruar që Aktvendimi i saj është i kufizuar në shqyrtimin e objektit të çështjes, përkatësisht masës së përkohshme, ndërsa kishte sqaruar se palët mund të vazhdojnë procedurën kontestimore lidhur me të drejtën e servitutit. Më specifikisht, Gjykata e Apelit, kishte theksuar:

"Sidoqoftë, kreditorëve nuk i mohohet e drejta që të vazhdojnë procedurën kontestimore lidhur me të drejtën e servitutit të kalimit në lëndën e ripërtërirë (nëse ekziston) ose më padi tjetër të re të veçantë të kërkojnë realizimin e kësaj të drejte në të cilin ata pretendojnë se iu takon".

109. Rrjedhimisht dhe duke marrë parasysh karakteristikat e veçanta të rastit, pretendimet e ngritura nga parashtruesit e kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ata, Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, nuk gjen që Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit, përkatësisht Aktvendimi [AC. nr. 1579/2015] i 4 prillit 2016, të jetë nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

110. Ndërsa sa i përket çështjes së tretë, Gjykata verën se Aktvendimi i mëpasshëm i Gjykatës Supreme, i nxjerrë pas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të ushtruar nga Prokurori i Shtetit, nuk kishte trajtuar meritat e rastit, sepse, sipas Gjykatës Supreme, mbi bazën e LPK-së, ajo është e kufizuar vetëm në ekzaminimin e shkeljeve që i thekson Prokurori Publik në kërkesën e vet, ndërsa kjo e fundit, nuk ka mbështetje ligjore në shkeljet thelbësore të përcaktuara me dispozitën e nenit 247 paragrafi 1 a) të LPK-së.

111. Për më tepër që në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se procedurat në Gjykatën Supreme kanë qenë të padrejta apo arbitrare, apo që të drejtat dhe liritë themelore të tij të mbrojtura me Kushtetutë janë shkelur si rrjedhojë e aktvendimeve të kontestuara. Gjykata rithekson se interpretimi i ligjit është detyrë e gjykatave të rregullta dhe është çështje e ligjshmërisë. Asnjë çështje kushtetuese nuk është dëshmuar nga parashtruesi i kërkesës. (Shih, rasti KI63/16, parashtrues i kërkesës *Astrit Pira*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 gushtit 2016, paragrafi 44 dhe shih, gjithashtu rastin KI150/15; KI161/15; KI162/15; KI14/16; KI19/16; KI60/16 dhe KI64/16, parashtrues të kërkesës: *Arben Gjukaj, Hysni Hoxha, Driton Pruthi, Milazim Lushtaku, Esat Tahiri, Azem Duraku dhe Sami Lushtaku*, Aktvendim për papranueshmëri, i 15 nëntorit 2016, paragrafi 62).

112. Rrjedhimisht dhe duke marrë parasysh karakteristikat e veçanta të rastit, pretendimet e ngritura nga parashtruesit e kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ata, Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe

praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, nuk gjen që Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, përkatësisht Aktvendimi [CLM. nr. 11/2016] i 13 shtatorit 2016 të Gjykatës Supreme, të jetë nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

113. Në fund, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se kërkesa e tij duhet trajtuar si çështje e njëjtë me rastin e Gjykatës KI70/16 (Aktvendim për papranueshmëri i 4 shtatorit 2017), ku parashtrues i kërkesës është personi F. K., dhe ku kërkohet vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [Rev.nr.185/2015] të 28 dhjetorit 2015 të Gjykatës Supreme.

114. Përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për lidhshmërinë e kërkesës së tij me rastin KI70/16, Gjykata përsëritë se, përkundër kërkesës së saj, parashtruesi i kërkesës nuk ka qartësuar fare këtë pretendim, përkatësisht nuk ka ofruar asnjë argument që do dëshmonte ekzistimin e ndërlidhjes në mes të dy rasteve në fjalë. Për më tepër, Gjykata nuk ka gjetur asnjë ndërlidhje në mes të kërkesës së parashtruesit të kërkesës dhe Aktvendimit për papranueshmëri në rastin KI 70/16.

Përfundim

115. Gjykata thekson që një nga aspektet themelore të sundimit të ligjit është parimi i sigurisë juridike, i cili presupozon respektimin e parimit *res judicata*, që është parimi i formës së prerë të vendimeve gjyqësore. Të njëjtat konsiderohet të pakthyeshme në pajtim me parimin e sigurisë juridike. Shmangia nga ky parim, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të jetë rezultat vetëm i "*rrethanave të një karakteri substancial dhe bindës*". Siç është elaboruar më lartë, Gjykata konkludon se rrethanat e rastit konkret bien në këtë kategori përjashtimi.

116. Gjykata konsideron se rrjedha e rastit konkret ngërthen rrethana të jashtëzakonshme, duke përfshirë vendime të formës së prerë e kundërthënëse me njëra tjetrën të të njejtës gjykatë në të njejtën cështje përmbarimore. Rrjedhimisht, në rrethanat e rastit konkret, shfuqizimi i të gjitha veprimeve paraprake të ndërmarra në çështjen përmbarimore, duke i përfshirë edhe aktvendimet paraprake *res judicata,* është në funksion të "*korrigjimit të gabimeve gjyqësore dhe gabimeve e drejtësisë*". Shmangia nga respektimi i tyre, në rrethanat e rastit konkret, justifikohet dhe është i nevojshëm si rezultat i

"*rrethanave të një karakteri substancial dhe bindës*", siç është përcaktuar me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së.

117. Rrjedhimisht, dhe bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh karakteristikat e veçanta të rastit, pretendimet e ngritura nga parashtruesit e kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ata, Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, nuk gjen të jetë shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe rrjedhimisht konstaton se Aktvendimi [CLM. nr. 11/2016] i 13 shtatorit 2016 i Gjykatës Supreme në lidhje me Aktvendimin [AC. nr. 1579/2015] e 4 prillit 2016 të Gjykatës së Apelit është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 113 (7) dhe 116 (1) të Kushtetutës, nenet 47 dhe 48 të Ligjit dhe rregullat 56 (1), 63 (1) (5) dhe 74 (1) të Rregullores së punës, më 19 dhjetor 2018

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË me shumicë votash se Aktvendimi [CLM. nr. 11/2016] i 13 shtatorit 2016 i Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Aktvendimi [AC. nr. 1579/2015] i 4 prillit 2016 i Gjykatës së Apelit të Kosovës, është në pajtueshmëri me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së;

V. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve;

VI. TË PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

VII. TË SHPALLË që ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Gresa Caka-Nimani	Arta Rama- Hajrizi

KI47/17, Parashtrues Selvete Aliji, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë të Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC. nr. 2812/2016, të 9 dhjetorit 2016

KI47/17, Aktgjykim, shkelje e nenit 31 të Kushtetutës, i 21 nëntorit 2018, publikuar më 28.12.2018

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, barazi e armëve, shkelje kushtetuese*

Më 11 mars 2016, sipas pohimeve të parashtrues, e njëjta ka shkuar në Zyrën e Gjendjes Civile për të nxjerrë një ekstrakt dhe nga ekstrakti i marrë ka mësuar se gjendja e saj martesore ka ndryshuar dhe se "*në regjistrin qendror të gjendjes civile evidentohet si e shkurorëzuar".* Në Zyrën e Regjistrit Qendror të Gjendjes Civile në Prishtinë, pas kërkesës për sqarim, ka marrë kopjen e Aktgjykimit C. nr. 280/2014, të datës 16 tetor 2015, nga i cili konstatohej se martesa e saj me ish-bashkëshortin ishte zgjidhur me aktgjykim nga Gjykata Themelore në Prishtinë.

Meqë nuk ka pasur asnjë dijeni për aktgjykimin për zgjidhje të martesës, ajo ka filluar një proces gjyqësor për përsëritje të procedurës.

Me Aktvendimin CN. nr. 49/2016, të 13 qershorit 2016, gjyqtari individual, hodhi poshtë si të palejuar kërkesën e parashkrueses për përsëritje të procedurës. Në arsyetimin e këtij aktvendimi theksohet se neni 88 i Ligjit për Familjen ka paraparë se *"nëse martesa është zgjidhur ose është anuluar me aktgjykimin e formës se prerë".*

Gjykata e Apelit e Kosovës, më 9 dhjetor 2016, me Aktvendimin Ac. nr. 2812/2016, refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtrueses, ndërsa e vërtetoi Aktvendimin CN. nr. 49/2016 të po kësaj gjykate, të nxjerrë në shkallë të parë.

Parashtruesja, në Gjykatën Kushtetuese, pretendoi shkeljen e nenit 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm] të Kushtetutës lidhur me nenin 6 të KEDNJ-së [E drejta për një proces të rregullt].

Gjykata, pas shqyrtimit të kërkesës, konstatoi se "zhvillimi i procedurës gjyqësore pa prezencën a palës së paditur (parashtrueses) dhe nxjerrja e aktgjykimit për zgjidhjen e martesës pa asnjë njoftim për parashtruesen, kanë shkelur garancitë e nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ dhe, në këtë rast, gjeti se ka shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, shfuqizoi të gjitha vendimet gjyqësore që kanë të bëjnë me parashtruesen në këtë çështje juridike dhe urdhëroi procedurë të sërishme

duke kërkuar njëkohësisht respektimin e të drejtave kushtetuese të parashtrueses sikur janë cekur në Aktgjykim.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI47/17

Parashtrues

Selvete Aliji

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC. nr. 2812/2016, të 9 dhjetorit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është Selvete Aliji nga Gjilani (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e kërkesës), të cilën e përfaqëson Elmi Qerimi, avokat nga Gjilani.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC. nr. 2812/2016, të 9 dhjetorit 2016, të cilin e ka pranuar më 13 janar 2017 dhe me të cilin i ishte refuzuar kërkesa për përsëritjen e procedurës ndaj Aktvendimit

CN. nr. 49/2016, të nxjerrë nga gjyqtari individual në Gjykatën e Apelit.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, me të cilin parashtruesja e kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), përkatësisht nenet 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] dhe 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt], të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut [KEDNJ].

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113, paragrafët 1 dhe 7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), dhe rregullin 32 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

5. Më 31 maj 2018, Gjykata Kushtetuese miratoi në seancën administrative plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata i referohet dispozitave juridike të rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 14 prill 2017, parashtruesja e kërkesës, nëpërmjet postës, e dërgoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 19 prill 2017, Kryetarja e Gjykatës e caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Ivan Čukalović (anëtar).

8. Më 16 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Snezhana Botusharova dhe Almiro Rodrigues. Më 26 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.

9. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Ljatifi, Radomir Laban, Safet Hoxha, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.

10. Më 21 shtator 2018, Kryetarja e Gjykatës nxori vendimin për zëvendësimin e Kolegjit shqyrtues dhe në kolegj u caktuan gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese) dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi e Gresa Caka-Nimani (anëtare).

11. Më 19 maj 2017, Gjykata njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës së Apelit.

12. Më 29 nëntor 2017, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore) dosjen e plotë të lëndës, që lidhet me kërkesën e parashtrueses. Kjo kërkesë u përsërit edhe dy herë të tjera.

13. Më 17 janar 2018, Gjykata pranoi dosjen e kërkuar.

14. Më 11 tetor 2018, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

15. Më 11 tetor, Gjykata vendosi që të njoftojë për kërkesën palët e treta në procedurë, të cilat mund të kenë interes të drejtpërdrejtë në lidhje me gjykimin e çështjes së referuar me kërkesë kushtetuese.

16. Më 15 tetor 2018, Gjykata njoftoi lidhur me kërkesën personin S. H., i cili si ish-bashkëshort, në procedurë pranë gjykatave të rregullta ishte palë kundërshtare e parashtrueses së kërkesës. Personit S. H., iu dërgua një kopje e kërkesës dhe njëkohësisht ai u njoftua që komentet eventuale lidhur me kërkesën mund t'ia paraqiste Gjykatës në afatin prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e marrjes së njoftimit.

17. Më 15 tetor 2018, Gjykata njoftoi për kërkesën dhe i dërgoi një kopje të saj avokatit të S. H., i cili në procedurat para gjykatave të rregullta kishte përfaqësuar atë. Gjykata njoftoi avokatin në fjalë se komentet eventuale mund t'i paraqiste në Gjykatë në afat prej 7 (shtatë) ditësh.

18. Në afatin e caktuar prej 7 (shtatë) ditësh, Gjykatës nuk iu paraqit asnjë koment, as nga S. H., e as nga avokati i tij që e kishte përfaqësuar në procedurë pranë gjykatave të rregullta, lidhur me kërkesën e parashtrueses.

19. Më 19 tetor 2018, njoftimi dhe kopja e kërkesës u kthyen nga posta në Gjykatë, me sqarimin se S. H. nuk gjendej në adresën e shënuar.

20. Më 21 nëntor 2018, Gjykata vendosi njëzëri që ta shpallë kërkesën të pranueshme dhe të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt], të KEDNJ-së.

Përmbledhja e fakteve të rastit

21. Më 22 tetor 2014, S. H. (ish-bashkëshorti i parashtrueses) nëpërmjet përfaqësuesit të tij paraqiti padi në Gjykatën Themelore për zgjidhjen e martesës, me arsyetimin se "*raportet martesore të ndërgjyqësve janë keqësuar dhe çrregulluar në mënyrë të pa kthyeshme*".

22. Më 6 nëntor 2014, përfaqësuesi i paditësit në Gjykatën Themelore paraqiti propozimin për caktimin e avokatit, si përfaqësues të përkohshëm ligjor për palën e paditur – përkatësisht parashtruesen e kërkesës – për shkak se, sipas tij, nuk dihej vendbanimi e as adresa e saj.

23. Propozimi përmbante emrin konkret të avokatit, H. J., i cili propozohej të caktohej nga gjykata si përfaqësues i përkohshëm ligjor i palës së paditur (parashtrueses së kërkesës).

24. Më 26 mars 2015, Gjykata Themelore me Aktvendimin C. nr. 2869/2014, caktoi pikërisht avokatin H. J., si përfaqësues të përkohshëm ligjor për parashtruesen e kërkesës.

25. Më 14 prill 2015, ky aktvendim ishte publikuar në gazetën ditore "Epoka e Re".

26. Më 15 tetor 2015, Gjykata Themelore caktoi seancën e tentimit të pajtimit në të cilën morën pjesë paditësi, avokati i tij dhe përfaqësuesi i përkohshëm i parashtrueses.

27. Nga procesverbali i seancës shihet se kryetari i trupit gjykues ka konstatuar se seanca e tentim pajtimit nuk do të mbahej "*pasi që mungon e paditura por kanë angazhuar përfaqësuesin e saj*". Megjithatë, nga po i njëjti procesverbal Gjykata konstaton se palët e pranishme në atë seancë janë deklaruar për padinë dhe kanë shprehur qëndrimet e tyre lidhur me bazueshmërinë e padisë së paraqitur.

28. Më 15 tetor 2015, në po të njëjtën ditë, Gjykata Themelore mbajti seancën gjyqësore në prani të paditësit dhe të përfaqësuesve të palëve ndërgjyqëse dhe nxori Aktgjykimin C. nr. 2860/2014, me të cilin zgjidhi martesën në mes të parashtrueses dhe ish-bashkëshortit të saj.

29. Më 6 janar 2016, aktgjykimi u bë i plotfuqishëm sepse ndaj tij nuk u ushtrua ankesë nga asnjëra palë në procedurë.

30. Më 11 mars 2016, sipas pohimeve të parashtrueses, ajo ka shkuar në Zyrën e Gjendjes Civile për të nxjerrë një ekstrakt dhe nga ekstrakti i marrë ka mësuar se gjendja e saj martesore ka ndryshuar dhe se "*në regjistrin qendror të gjendjes civile evidentohet si e shkurorëzuar*".

31. Më 18 mars 2016, parashtruesja ka shkuar në zyrën e Regjistrit Qendror të Gjendjes Civile në Prishtinë dhe aty ka marrë kopjen e Aktgjykimit C. nr. 280/2014, të 16 tetorit 2015, nga i cili konstatohej se martesa e saj me ish-bashkëshortin ishte zgjidhur me aktgjykim nga Gjykata Themelore në Prishtinë.

32. Më 21 mars 2016, parashtruesja e kërkesës nëpërmjet përfaqësuesit ligjor, tani të zgjedhur nga ana e saj, parashtroi në Gjykatën Themelore për Gjykatën e Apelit, propozim për përsëritjen e procedurës së përfunduar me aktgjykim të plotfuqishëm në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

33. Në kërkesë parashtruesja kishte theksuar se asaj nuk i është mundësuar pjesëmarrja në seancën e shqyrtimit kryesor të çështjes, pasi që nuk është njoftuar asnjëherë për fillimin e procedurës gjyqësore në të cilën do të ishte palë e paditur edhe pse "*paditësi dhe përfaqësuesi i tij e kanë ditur se ku gjendet e paditura",* ndërsa edhe pse kanë qenë në dijeni të këtyre fakteve ato nuk i kanë prezantuar.

34. Më 26 prill 2016, pala kundërshtare në proces paraqiti përgjigje kundër kërkesës së parashtruar për përsëritjen e procedurës, duke kundërshtuar argumentet e parashtrueses se paditësi ka ditur vendbanimin e saj dhe duke potencuar se, mu për këtë arsye, ka kërkuar që asaj t'i caktohet një përfaqësues i përkohshëm ligjor.

35. Më 13 qershor 2016, Gjykata e Apelit me Aktvendimin CN. nr. 49/2016, të nxjerrë nga gjyqtari individual, hodhi poshtë si të palejuar kërkesën e parashkrueses për përsëritje të procedurës. Në arsyetimin e këtij aktvendimi theksohet se neni 88 i Ligjit për Familjen ka paraparë se "*nëse martesa është zgjidhur ose është anuluar me aktgjykimin e formës se prerë, vendimi për shkurorëzimin, përkatësisht për anulimin e martesës, nuk mund të goditet me mjete të jashtëzakonshme juridike, që do të thotë se në rastin konkret aktgjykimi është bërë i plotfuqishëm me datë 06.01.2016*".

36. Gjykata e Apelit, përtej aspektit procedural mbi bazën e të cilit e ka hedhur poshtë kërkesën për përsëritje të procedurës, nuk ka dhënë asnjë shpjegim apo arsyetim tjetër lidhur me procesin e zhvilluar në Gjykatën Themelore.

37. Më 8 korrik 2016, parashtruesja e kërkesës, bazuar në udhëzimin juridik të dhënë në Aktvendimin CN. nr. 49/2016, paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar ekzistimin e shkeljes thelbësore të rregullave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

38. Në ankesën e saj, parashtruesja e kërkesës pretendoi ekzistimin e shkeljeve kushtetuese të së drejtës së saj për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, veçanërisht shkeljen e parimit të barazisë së armëve, duke përsëritur argumentin se asaj nuk i ishte mundësuar pjesëmarrja në gjykim.

39. Më 9 dhjetor 2016, Gjykata e Apelit me Aktvendimin Ac. nr. 2812/2016, refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtrueses, ndërsa e vërtetoi Aktvendimin CN. nr. 49/2016 të po kësaj gjykate, të nxjerrë në shkallë të parë.

40. Gjykata e Apelit në aktvendimin e saj, në mes tjerash, arsyetoi se "*[...] gjyqtari individual i kësaj gjykate me rastin e vendosjes sipas aktvendimit të ankimuar, drejtë ju ka referuar dhe ka aplikuar dispozitën ligjore të nenit 88 të LFK-së, kur ka gjetur se propozimi për lejimin e përsëritjes së procedurës së përfunduar me aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C-nr. 2860/2014 i datës 15.10.2015, është i palejuar dhe si i tillë duhet hedhur poshtë, qëndrim ky të cilin si të drejtë dhe të ligjshëm e përkrah edhe kolegji i kësaj gjykate*".

41. Gjykata e Apelit më tej ka arsyetuar se ajo "*pati parasysh të gjitha pretendimet ankimore të të autorizuarit të paditurës, që i referohen shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat kolegji i kësaj gjykate nuk e ka parë të arsyeshme që t'i elaboroj secilën veç e veç ...*".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

42. Parashtruesja e kërkesës, në thelb, pretendon se procedura gjyqësore e zhvilluar në Gjykatën Themelore dhe në mungesë të saj, pa e njoftuar fare, por edhe procedurat e zhvilluara mbi bazën e ankimit të saj në Gjykatën e Apelit, kanë rezultuar me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës

dhe nenit 6 të KEDNJ-së, përkatësisht asaj i është cenuar e drejta për një shqyrtim publik dhe të paanshëm, si dhe parimi i barazisë së armëve.

43. Parashtruesja pohon se pretendimet për të njëjtat shkelje i ka ngritur edhe në Gjykatën e Apelit, në të dyja rastet, ku përpos vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, si shkaqe ligjore për anulimin e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, ajo ka theksuar se edhe aktgjykimi i shkallës së parë edhe aktvendimi i shkallës së dytë nga gjyqtari individual janë nxjerrë "pa respektimin e standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut".

44. Më tutje, parashtruesja thekson se "*të paditurës nuk i mundësohet që të marrë pjesë në shqyrtimin kryesor dhe se procedura kontestimore është përfunduar pa pjesëmarrjen e saj, e neni 6 (1) i KEDNJ-së parasheh se në përcaktimin e të drejtave të tij/saj çdo kush ka të drejtë për dëgjim korrekt dhe publik brenda kohës së arsyeshme nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e themeluar me ligj*".

45. Në ndërlidhje me këtë, parashtruesja e kërkesës vë në pah se "*në vitin 2014, ka shkëputur jetën faktike me paditësin, dhe paditësi ka qenë në dijeni se ku jeton e paditura në çfarë adrese, sepse me parashtruesen e kërkesës bashkërisht kanë jetuar një periudhë të gjatë kohore së bashku në adresën e njëjtë, ka kontaktuar me te dhe i ka thënë se kur të fillohet procedura për zgjidhjen e martesës me shkurorëzime e njëjta do të njoftohet lidhur me këtë, sepse do të marr ftesën nga ana e organit kompetent*".

#

46. Parashtruesja e kërkesës, gjithashtu, thekson se "*konstatimet e gjyqtarit individual të Gjykatës së Apelit, në aktvendimin e tij janë në kundërshtim me dispozitën e nenit 83 të LPK-së, sepse sipas kësaj dispozite Gjykata brenda afatit prej 7 ditësh, kur të padituri i është caktuar përfaqësuesi i përkohshëm duhet të japë shpalljen e cila do të votohet në Gazetën Zyrtare dhe të afishohet në tabelën e shpalljeve të Gjykatës së çështjes, e jo që vendimet për përfaqësues të përkohshëm të shpallen në Gazeta ditore*".

47. Parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata që ta shpallë kërkesën e saj të pranueshme; të anulojë vendimet e kontestuara gjyqësore dhe të lejojë përsëritjen e procedurës, të përfunduar me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Dispozitat relevante ligjore

Ligji Për Familjen i Kosovës - Ligji Nr. 2004/32

III. SHKURORËZIMI

Neni 68. Shkurorëzimi

(1) Martesa mund të zgjidhet me shkurorëzim vetëm në bazë të vendimit të gjykatës.
(2) Njëri apo të dy bashkëshortët me marrëveshje të dyanshme mund të kërkojnë
shkurorëzim duke parashtruar padi në gjykatën kompetente.
(3) E drejta për ngritjen e padisë për shkurorëzim nuk mund të kalohet te trashëgimtarët, por trashëgimtarët e paditësit mund të vazhdojnë procedurën e filluar për të verifikuar bazën e padisë.
(4) Nëse njëri nga bashkëshortët paraqet padi për shkurorëzim, kurse bashkëshorti tjetër më së voni deri në përfundimin e seancës kryesore gjyqësore, deklaron shprehimisht se nuk e kundërshton bazueshmërinë e kërkesëpadisë, do të konsiderohet se bashkëshortët kanë paraqitur propozimin për shkurorëzim me marrëveshje.

Neni 85. Përcaktimi i fakteve, në të cilat mbështetet kërkesa

Në kontestet martesore nuk mund të nxirret aktgjykim për shkak të mungesës ose aktgjykimit në bazë të pranimit.

Neni 88. Nuk lejohen mjetet e jashtëzakonshme juridike

Nëse martesa është zgjidhur ose është anuluar me aktgjykimin e formës së prerë, vendimi për shkurorëzimin, përkatësisht për anulimin e martesës nuk mund të goditet me mjete të jashtëzakonshme juridike.

Ligji nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore

e) Aktgjykimi për shkak të mungesës

Neni 151

151.1 Kur të paditurit padia nuk i është dërguar për përgjigje, por vetëm bashkë me letërthirrje për në seancë përgatitore, e ai nuk vjen në seancë deri në përfundimin e saj, apo në seancën e parë

për shqyrtim kryesor, nëse seanca përgatitore nuk është caktuar fare, gjykata me propozimin e paditësit apo sipas detyrës zyrtare e jep aktgjykimin me të cilin aprovohet kërkesëpadia (aktgjykimi për shkak të mungesës) po që se plotësohen këto kushte:

a) nëse i padituri është thirr rregullisht për në seancë;

b) nëse i padituri nuk e ka kontestuar kërkesëpadinë me anë të parashtresës;

[...]

KREU XXIV
SHQYRTIMI KRYESOR

#

1) Zhvillimi i shqyrtimit kryesor
Neni 423

423.4 Po që se në seancën për shqyrtim kryesor nuk vjen i padituri që është thirrur rregullisht, atëherë shqyrtimi kryesor i çështjes bëhet pa praninë e tij.

Pranueshmëria e kërkesës

48. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i përmbush kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

49. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

50. Në vazhdim, Gjykata vlerëson nëse parashtruesja i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç specifikohet më tej në Ligj dhe në

Rregullore të punës. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 48
Saktësimi i kërkesës

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Neni 49 i Ligjit
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. [...]"

51. Më tutje, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse parashtruesja i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës.
#

52. Në këtë drejtim, Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 39 të Rregullores, ku përcaktohet:

"(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

(d) kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese".

53. Gjykata konstaton se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar, i ka shteruar mjetet juridike dhe po ashtu kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor.

54. Për sa i përket afatit, Gjykata e konsideron të nevojshme të vë në pah se Gjykata e Apelit (Aktvendimi CN. nr. 49/2016) fillimisht hodhi poshtë propozimin e parashtrueses për përsëritjen e procedurës së përfunduar me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Sipas udhëzimit të dhënë në këtë aktvendim, parashtruesja paraqiti ankesë kundër tij në Gjykatën e Apelit, e cila po ashtu iu refuzua (Aktvendimi Ac. nr.

2812/2016). Në të dyja rastet, Gjykata e Apelit ka arsyetuar se, sipas legjislacionit në fuqi, vendimi për shkurorëzim, përkatësisht për anulim të martesës nuk mund të goditet me mjete të jashtëzakonshme juridike.

55. Më tej, Gjykata vë në pah se në rastin konkret, parashtruesja e kërkesës paraqet një pretendim të argumentuar se ajo është viktimë e shkeljes së të drejtave të saj të garantuara me Kushtetutë, jo si pasojë e vetëm një akti të veçantë por si pasojë e një situate të vazhdueshme, të shkaktuar pa fajin e saj.

56. Gjykata i referohet praktikës së GJEDNJ-së, sipas së cilës në rastin e situatës së vazhdueshme që shkakton shkelje të të drejtave të njeriut, afati fillon të rrjedhë prej fillimi, secilën ditë dhe se vetëm kur ndërpritet situata e vazhdueshme, fillon të llogaritet afati 6 (gjashtë) mujor që parashikon KEDNJ për paraqitjen e kërkesave (shih *mutatis mutandis*, *Cakir kundër Qipros; Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë,* Aktgjykim i GJEDNJ-së i 18 shtatorit 2009; *Mocanu dhe të tjerët kundër Rumanisë,* Aktgjykim i GJEDNJ-së i 17 shtatorit 2014, paragrafët 263-267).

57. Në dritën e këtyre shpjegimeve, Gjykata konsideron se në rastin konkret kemi të bëjmë me pretendimin për shkeljet e të drejtave kushtetuese si pasojë e një situate të vazhdueshme – përkatësisht pamundësimit të parashtrueses për të pasur një gjykim që respekton standardet e përcaktuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

58. Po ashtu, Gjykata konsideron se kërkesa ngre një pretendim kushtetues të arsyetuar *prima facie*, ndërkohë që ajo nuk është qartazi e pabazuar.

59. Rrjedhimisht, Gjykata do të vlerësojë meritat e rastit, duke shqyrtuar pretendimet ashtu sikur janë paraqitur në kërkesë.

Vlerësimi i meritave të kërkesës

60. Gjykata rikujton se thelbi i kërkesës së parashtrueses ka të bëjë me pretendimin për cenimin e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

#

61. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtrueses për cenimin e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së kanë

të bëjnë kryesisht me cenimin e të drejtës për shqyrtim të drejtë, përkatësisht të dy komponenteve thelbësore përbërëse të kësaj të drejte:

a. E drejta për të qenë i pranishëm gjatë shqyrtimit gjyqësor
b. Parimi i barazisë së armëve

62. Gjykata këto pretendime për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së do t'i trajtojë secilën veç e veç sipas radhës që janë paraqitur në kërkesë:

Neni 31 [E drejta në gjykim të drejtë e të paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]

Neni 6 i KEDNJ-së [E drejta për një proces të rregullt]

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e Gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

[...]

Vlerësimi i Gjykatës

63. Në trajtimin e pretendimeve për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, Gjykata i referohet praktikës së saj gjyqësore në rastet e ngjashme, si dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane

për të Drejtat e Njeriut (në harmoni me detyrimin kushtetues që rrjedh nga neni 53 i Kushtetutës).

64. Gjykata vëren se praktika e qëndrueshme e GJEDNJ-së thekson se drejtësia e një procedure vlerësohet në bazë të procedurës si tërësi (shih: Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 6 dhjetorit 1988, *Barbera, Messegué dhe Jabardo kundër Spanjës,* nr. 10590/83, paragrafi 68). Rrjedhimisht, gjatë vlerësimit të meritave të pretendimeve të parashtrueses së kërkesës, Gjykata do t'i përmbahet këtij parimi (shih Aktgjykimin e Gjykatës për rastin KI104/16, të parashtruesit *Miodrag Pavić* të 4 gushtit 2017).

65. Gjykata gjithashtu thekson se e drejta për një proces të rregullt, e garantuar nga neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6, paragrafi 1 i KEDNJ-së, duhet interpretuar në dritën e parimit të sundimit të ligjit, që kërkon ekzistencën e një rruge gjyqësore efektive e cila mundëson të mbrohen të drejtat civile (*Beleš dhe të tjerët kundër Republikës së Çekisë,* Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 12 nëntorit 2012, paragrafi 49).

E drejta për të qenë i pranishëm gjatë shqyrtimit gjyqësor

(a) Parimet e përgjithshme

66. Gjykata i referohet praktikës së GJEDNJ-së e cila ka përcaktuar se, edhe pse nuk parashihet shprehimisht në nenin 6 të KEDNJ-së, e drejta për të qenë i pranishëm gjatë shqyrtimit është pjesë e të drejtës për shqyrtim të drejtë dhe të paanshëm.
#

67. Për më tepër, sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, e drejta e palës në procedurë për të qenë e pranishme gjatë shqyrtimit gjyqësor është e ndërlidhur pandashëm me të drejtën për pjesëmarrje efektive në gjykim si dhe parimin e kontradiktoritetit procedural (shih *Sejdović kundër Italisë* GC nr. 56581/00, paragrafët 81-95, GJEDNJ 2006-II.)

68. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur procedimet kanë natyrë kontradiktore. Shteti ka detyrimin për t'i dhënë të pandehurit një njoftim efektiv dhe të përshtatshëm për seancën dhe të marrë masa për të siguruar praninë e tij (shih rastin *Poitrimol kundër Francës,* Aktgjykimi i GJENDJ-së i 23 nëntorit 1993).
#

69. Megjithatë, GJEDNJ-ja gjithashtu pohon se në konteste jo penale e drejta e palës për të qenë e pranishme, personalisht, në procedurë garantohet gjithmonë vetëm në rastet kur karakteri personal, mënyra

e jetesës apo sjellja e palës kanë rëndësi të drejtpërdrejtë për gjykimin e rastit (shih *Muyldermans kundër Belgjikës*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 23 tetorit 1991 nr. i aplikimit 12217/86). Në raste të tjera, është e mjaftueshme që pala të përfaqësohet nga avokati, gjegjësisht përfaqësuesi.

Aplikimi i praktikës së Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ-së në rrethanat e rastit konkret

70. Gjykata rikujton se në rastin konkret, parashtruesja e kërkesës ishte palë në një rast civil, dhe pretendon se nuk mori pjesë në seancën pranë gjykatës së shkallës së parë dhe se nuk pati një mundësi ankimi, si pasojë e mungesës se informimit për gjykimin.

71. Gjykata konstaton se një seancë e shqyrtimit kryesor, ku janë elaboruar faktet e rastit, ishte mbajtur në Gjykatën Themelore në Prishtinë, me pjesëmarrjen e palës paditëse dhe ku e paditura (parashtruesja e kërkesës) ishte përfaqësuar nga një avokat i zgjedhur nga gjykata pa dijeninë e saj.

72. Gjykata, më tej, vëren se parashtruesja nuk kishte asnjë informacion për përmbajtjen e seancës kryesore gjyqësore dhe se nga dosja e lëndës nuk mund të konstatohet se Gjykata Themelore kishte bërë përpjekje për ta njoftuar parashtruesen lidhur me mbajtjen e seancës.

73. Nga dosja e lëndës së Gjykatës Themelore, konstatohet qartë se asnjë nga fletëdërgesat që lidhen me zhvillimin e procedurave në këtë rast nuk janë dërguar në emër të parashtrueses së kërkesës e cila kishte cilësinë e palës së paditur në procedurë, por i tërë komunikimi zyrtar ishte bërë me përfaqësuesin e përkohshëm i cili ishte caktuar nga gjykata.

74. Gjykata më tej konstaton se Gjykata e Apelit ka refuzuar kërkesën e parashtrueses për përsëritje të procedurës, dhe pastaj edhe ankesën kundër aktvendimit me të cilin u refuzua përsëritja e procedurës për çështje procedurale, gjegjësisht duke u thirrur në palejushmërinë e ushtrimit të mjetit juridik mbi bazën e ligjit dhe pa shqyrtuar fare pretendimet e ngritura nga parashtruesja e kërkesës, dhe pa mbajtur seancë dëgjimore me palët në procedurë.

75. Prandaj, Gjykata tani duhet të shqyrtojë nëse parashtruesja e kërkesës do të duhej të kishte përfituar nga garancitë e plota të një seance dëgjimore në procedurën e zhvilluar në Gjykatën Themelore, dhe më pastaj në procedurat e zhvilluara sipas ankesës në Gjykatën e Apelit.

76. Gjykata vë në dukje se, sikur u përmend më sipër, GJEDNJ në aktgjykimin e saj në rastin *Döry kundër Suedisë*, [shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 12 nëntorit 2002], qartë ka theksuar se "*në rastet në të cilat ka pasur një seancë dëgjimore në shkallë të parë, ose për të cilën është hequr dorë në atë nivel, nuk ka të drejtë absolute për një seancë dëgjimore në çdo procedurë ankimore që jepet*".

77. Në rastin konkret, Gjykata konsideron se për parashtruesen e kërkesës nuk ka pasur një seancë dëgjimore në të cilën ajo ka marrë pjesë efektivisht në gjykimin e shkallës së parë, dhe gjithashtu parashtruesja nuk ka hequr dorë vullnetarisht nga kjo e drejtë. Përkitazi me këtë të dejtë, ajo ishte ankuar në instanca më të larta të gjykatave vendore dhe ankesat e saj nuk ishin marrë parasysh, përkatësisht nuk ka marrë trajtim meritor. Për më tepër, parashtruesja është ankuar, përkatësisht ka ngritur pretendime edhe lidhur me mënyrën se si asaj i ishte caktuar përfaqësuesi i përkohshëm.

78. Gjykata, gjithashtu, nga dosja e lëndës vëren se Gjykata Themelore nuk kishte bërë përpjekjeje për ta kontaktuar parashtruesen edhe pse ajo kishte cilësinë e palës në procedurë dhe nuk ka dhënë asnjë shpjegim lidhur me këtë çështje.

79. Gjykata më tej, mbështetur në interpretimin e GJEDNJ-së në rastin *Muyldermans kundër Belgjikës* (Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 23 tetorit 1991 nr. i aplikimit. 12217/86), konstaton se "*karakteri personal, mënyra e jetesës apo sjellja e palës kanë rëndësi të drejtpërdrejtë për gjykimin e rastit",* deri në atë masë sa që një seancë dëgjimore me praninë e saj do të ishte e domosdoshme për të përmbushur garancitë e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të GJEDNJ-së, në kuptimin e të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

80. Në këto rrethana të rastit, Gjykata konstaton se ka shkelje të nenit 31 të Kushtetutës lidhur me nenin 6 të KEDNJ-së, të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm sa i përket të drejtës për të qenë i pranishëm gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Barazia e armëve

81. Në praktikën e saj gjyqësore, GJEDNJ ka përcaktuar se parimi i "barazisë së armëve" është një nga elementet kyçe të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor (Shih rastin *Neumeister kundër Austrisë*, GJEDNJ, aplikacioni nr. 1936/63, Aktgjykimi i 27 qershorit 1968, paragrafi 2), sipas të cilës "*secilës palë në proces duhet t'i ofrohet mundësia e arsyeshme të parashtrojë çështjen e saj – duke përfshirë provat - nën kushtet të cilat në mënyrë të ndjeshme nuk do ta vënin*

në pozitë të pabarabartë në raport me palën kundërshtare", (shih po ashtu: *Nideröst-Huber v. Sëitzerland, 18 shkurt 1997, § 23; Kress v. France [GC], nr. 39594/98, § 72, ECHR 2001-VI; Yvon v. France, nr. 44962/98, § 31, ECHR 2003-V; and Gorraiz Lizarraga and Others v. Spain, nr. 62543/00, § 56, ECHR 2004-III dhe Grozdanoski kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nr. 21510/03, i 31 majit 2007*).

82. Parimi i barazisë së armëve më tej nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij/saj dhe se duhet të përcaktohet një "ekuilibër i drejtë" mes palëve [Shih: *Dombo Beheer B.V kundër Holandës,* Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 27 tetorit 1993]

83. Në këtë drejtim, e drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t'u garantohet thjeshtë prania fizike gjatë procesit civil por, përkundrazi, duhet që legjislacioni procedural në radhë të parë sikundër edhe më pas gjyqtari gjatë gjykimit, t'u japë mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Mosrespektimi i këtij parimi nuk varet nga të vërtetuarit e drejtë apo të padrejtë të fakteve. Shkelja e këtij garancioni procedural vetvetiu rezulton në shkelje të së drejtës në gjykim të drejtë (shih *Bulut kundër Austrisë*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 22 shkurtit 1996; shih po ashtu: *Komanicky kundër Sllovakisë*, GJEDNJ, 4 qershor 2002 paragrafi 45).

Aplikimi i parimeve në rastin konkret

84. Gjykata vëren se në gjykimin e shkallës së parë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, parashtruesja e kërkesës jo vetëm që nuk mori pjesë personalisht por as nuk kishte informacion për mbajtjen e gjykimit. Parashtruesja, për më tepër, nuk ishte njoftuar as me përmbajtjen e padisë dhe nuk kishte asnjë mundësi të paraqiste një përgjigje ndaj padisë.

85. Gjykata, më tej, vëren se përfaqësuesi ligjor i përkohshëm u caktua nga gjykata, bazuar në propozimin e palës paditëse, nuk e kundërshtoi padinë dhe kur u nxor aktgjykimi nuk paraqiti fare ankesë.

86. Është thelbësore për konceptin e një procesi të rregullt gjyqësor, si në procedurën penale ashtu edhe në atë civile, që një palë në kontest të mos i jetë mohuar mundësia për të paraqitur rastin në mënyrë efektive para gjykatave dhe se ai ose ajo të jetë në gjendje të gëzojë barazinë e armëve, si element qenësor i gjykimit të drejtë (shih, ndër të tjera, *De Haes dhe Gijsels kundër Belgjikës*, 24 shkurt 1997, paragrafi 53,

Raportet e aktgjykimeve dhe vendimeve 1997-I; *Steel dhe Morris* , cituar më lart, paragrafi 59).

87. Në situatën kur parashtruesja e kërkesës nuk merr pjesë fare në seancën dëgjimore të shkallës së parë; kur nuk i jepet mundësia për të paraqitur argumentet e saj, qoftë drejtpërdrejtë apo përmes përfaqësuesit ligjor; kur argumentet e palës kundërshtare dëgjohen dhe merren parasysh dhe kur pala, përkatësisht parashtruesja nuk ka asnjë lloj mundësie t'i kundërshtojë ato, është e qartë se parimi i barazisë së armëve në procedurë nuk është respektuar.

88. Më tutje, Gjykata vëren se gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, kur hodhi poshtë si të palejuar kërkesën e parashtrueses për përsëritje të procedurës, sikundër edhe Gjykata e Apelit kur e vërtetoi një aktvendim të tillë - për shkak se sipas ligjit në fuqi mjetet juridike të jashtëzakonshme nuk ishin të lejuara kur aktgjykimi për zgjidhje të martesës bëhej i plotfuqishëm – nuk kishin marrë fare parasysh pretendimet e parashtrueses se në cilat kushte e rrethana aktgjykimi i shkallës së parë ishte bërë i plotfuqishëm dhe në asnjë moment nuk kishin adresuar pretendimet për shkelje kushtetuese të ngritura nga parashtruesja.

89. Gjykata me tej konstaton se Gjykata e Apelit edhe pse kishte theksuar se ishte në dijeni të pretendimeve të parashtrueses vlerësoi se "*nuk e ka parë të arsyeshme që t'i elaboroj secilën veç e veç …".*

90. Gjykata thekson se gjykatat e rregullta nuk janë të obliguara t'i adresojnë të gjitha pretendimet e parashtruara nga parashtruesi i kërkesës. Megjithatë, ato duhet të adresojnë pretendimet që janë relevante për çështjen në shqyrtim, për më tepër nëse ato ngrihen në faza të ndryshme të procedurës, siç ka ndodhur me kërkesën e tanishme (shih në këtë drejtim rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI135/14, Aktgjykimi i 8 shkurtit 2016). Dështimi i adresimit të pretendimeve aq serioze të parashtrueses, pavarësisht bazës juridike me të cilën ishte hedhur si e palejueshme kërkesa e parashtrueses, apo edhe ankesa e saj kundër aktvendimit të gjyqtarit individual, ato vendime gjyqësore i bënë të papajtueshme me garancitë kushtetuese të nenit 31 të Kushtetutës apo të nenit 6 të KEDNJ-së.

91. Gjykata vë në pah se në bazë të nenit 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] pikës 3, të Kushtetutës *" Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit"*. Andaj, gjatë shqyrtimit të rasteve para tyre gjykatat gjithashtu kanë obligim mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut të cilat i garanton Kushtetuta.

92. Si përfundim nga sa u argumentua më sipër, Gjykata gjen se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore, C. nr. 2860/2014 si dhe aktvendimet e Gjykatës së Apelit, CN. nr. 49/2016 dhe Ac. nr. 2812/2016, nuk kanë respektuar standardet kushtetuese të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe, për rrjedhojë, Gjykata konstaton se ka shkelje të nenit 31 të Kushtetutës [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], në ndërlidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së [E drejta për një proces të rregullt].

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullin 59 (1) të Rregullores së punës, më 21 nëntor 2018, njëzëri

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË, se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1, të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut;

III. TË SHPALLË të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë. C. nr. 2860/2014, të 15 tetorit 2015, dhe aktvendimet e Gjykatës së Apelit, CN. nr. 49/2016 dhe Ac. nr. 2812/2016;

IV. TË KTHEJË Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, C. nr. 2860/2014, të 15 tetorit 2015, për rigjykim në pajtim me aktgjykimin e kësaj Gjykate;

V. TË URDHËROJË Gjykatën Themelore në Prishtinë që ta njoftojë Gjykatën në pajtim me rregullin 66 (5) të Rregullores së punës, lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e aktgjykimit të Gjykatës;

VI. TË MBETET fuqimisht e angazhuar në këtë çështje, në pritje të pajtimit me këtë urdhër;

VII. TË URDHËROJË që ky aktgjykim t'u komunikohet palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, të publikohet në Gazetën Zyrtare;

VIII. Ky aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Bekim Sejdiu	Arta Rama-Hajrizi

KO84/18, Parashtrues: Albin Kurti dhe 11 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 06/V-145 të Kuvendit të Republikës së Kosovës përkitazi me propozimin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje! për shkarkimin e Aida Dërgutit nga pozita e nënkryetares së Kuvendit të Republikës së Kosovës

KO84/18, Aktgjykim i miratuar më 3 dhjetor 2018, publikuar më 24 dhjetor 2018

Fjalët kyç: kërkesë institucionale, Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës, grupet parlamentare, nënkryetari/ja e Kuvendit,

Kërkesa ishte paraqitur nga 12 (dymbëdhjetë) deputetë të Kuvendit, në bazë të nenit 113. 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
Parashtruesit e kërkesës kërkuan nga Gjykata Kushtetuese vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 06/V145 të Kuvendit të Republikës së Kosovës përkitazi me propozimin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje! për shkarkimin e Aida Dërgutit nga pozita e nënkryetares së Kuvendit (në tekstin e mëtejmë: Vendimi i kontestuar), miratuar nga Kuvendi më 4 qershor 2018. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu kërkuan vendosjen e masës së përkohshme, përkatësisht kërkuan *"pezullimin e ushtrimit të funksionit të nënkryetares së Kuvendit të Kosovës [Aida Dërguti]"*.
Parashtruesit e kërkesës pretenduan se vendimi i kontestuar nuk është në pajtueshmëri me nenet 7 [Vlerat] dhe 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve] të Kushtetutës.
I. Gjykata fillimisht vlerësoi nëse kërkesa e parashtruar i plotëson kushtet e pranueshmërisë, sikurse që janë përcaktuar me Kushtetutë dhe që janë saktësuar më tej në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në Rregulloren e punës së Gjykatës. Gjykata vlerësoi se kërkesa i plotëson kërkesat e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë e të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës, si dhe ngre çështje të rëndësishme kushtetuese lidhur me zgjedhjen dhe shkarkimin e nënkryetarëve të Kuvendit. Rrjedhimisht, Gjykata konstatoi se kërkesa e parashtruesve është e pranueshme.
II. Në lidhje me meritat e kërkesës, Gjykata, duke shqyrtuar dhe adresuar secilin pretendim të parashtruesve të kërkesës, vlerësoi dhe konstatoi si në vijim:
Së pari, Gjykata shqyrtoi pretendimin e parashtresave të kërkesës se pozita e nënkryetarit/es të Kuvendit, sipas nenit 67, paragrafi 3 të Kushtetutës, është e rezervuar ekskluzivisht për tri grupet më të mëdha parlamentare, të cilat dalin nga partitë politike apo nga koalicionet që kanë fituar më së shumti

ulëse në Kuvend si rezultat i zgjedhjeve për Kuvend. Në lidhje me këtë, Gjykata vlerësoi se nga interpretimi i paragrafit 3, të nenit 67 të Kushtetutës, rezulton që mbajtja e pozitës së nënkryetarit të Kuvendit nuk është e lidhur drejtpërsëdrejti dhe nuk përfaqëson interesat e grupit parlamentar që i ka propozuar për atë pozitë në Kryesinë e Kuvendit. Rrjedhimisht, Gjykata konstatoi se pretendimi i parashtruesve të kërkesës, pozita e nënkryetarit/es të Kuvendit, sipas nenit 67, paragrafi 3 të Kushtetutës, është e rezervuar ekskluzivisht për tri grupet më të mëdha parlamentare, të cilat dalin nga votat e partive politike apo e koalicioneve që kanë fituar ulëse në Kuvend si rezultat i zgjedhjeve për Kuvend, nuk është i bazuar.

Së dyti, në lidhje me procedurën e ndjekur për shkarkimin e nënkryetares së Kuvendit, Gjykata rikujtoi se sipas paragrafit 5, të nenit 67 të Kushtetutës, është paraparë që nënkryetarët e Kuvendit shkarkohen me shumicën prej dy të tretave (2/3) të numrit të përgjithshëm të deputetëve. Në lidhje me këtë, Gjykata po ashtu rikujtoi se më 4 qershor 2018, pas diskutimeve në Kuvend, që ishin zhvilluar në lidhje me propozimin e LVV-së për shkarkimin e Aida Dërgutit nga pozita e nënkryetares së Kuvendit, ku në sallë ishin të pranishëm 94 (nëntëdhjetë e katër) deputetë, 16 (gjashtëmbëdhjetë) deputetë kishin votuar për propozimin e LVV-së, 26 (njëzetë e gjashtë) deputetë kishin votuar kundër dhe 47 (dyzetë e shtatë) deputetë kishin abstenuar. Rrjedhimisht, propozimi i LVV-së nuk mori votat e nevojshme sipas nenit 67, paragrafi 5, të Kushtetutës, për shkarkimin e Aida Dërgutit nga pozita e nënkryetares së Kuvendit dhe, me këtë rast, nuk u plotësuan kërkesat e parapara në nenin 67, paragrafi 5, që Aida Dërguti të shkarkohet nga pozita e nënkryetares.

Së treti, parashtruesit e kërkesës kishin pretenduar se *"[r]efuzimi i shkarkimit të nënkryetares në fjalë, e cila nuk e përfaqëson më fuqinë politike dhe votën* demokratike *siç e parasheh Kushtetuta, është abuzim me të drejtën e votimit dhe cenon qëllimin kushtetues që qëndron prapa dispozitave që e rregullojnë përbërjen e Kryesisë së Kuvendit."* Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata duke iu referuar dispozitave kushtetuese, të Rregullores së punës dhe praktikës së saj gjyqësore, vlerësoi se deputetët kanë për obligim të marrin pjesë në punimet e Kuvendit, duke përfshirë edhe pjesëmarrjen e tyre në votim përkitazi me propozimet e paraqitura në bazë të Kushtetutës dhe të rregullave tjera të ndërlidhura. Megjithatë, Gjykata ritheksoi se deputetët janë të lirë të vendosin se si do të votojnë në lidhje me propozimet që janë paraqitur para tyre dhe mund të votojnë për, kundër apo të abstenojnë duke marrë parasysh interesin më të mirë të Shtetit në pajtim me Kushtetutën dhe me rregullat tjera.

Si përfundim, Gjykata konstatoi se Vendimi nr. 06/V-145 i Kuvendit të Republikës së Kosovës përkitazi me propozimin e Grupit Parlamentar të LVV-së për shkarkimin e Aida Dërgutit nga pozita e nënkryetares së Kuvendit të Republikës së Kosovës, është në pajtueshmëri me nenet 7 dhe 67 të Kushtetutës.

III. Në lidhje me kërkesën e parashtruesve për vendosjen e masës së përkohshme, Gjykata, pas konstatimit të saj se vendimi i kontestuar është në pajtueshmëri me nenet 7 [Vlerat] dhe 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve] të Kushtetutës, përfundoi se kërkesa është pa objekt shqyrtimi dhe, si e tillë, kërkesa për masë të përkohshme u refuzua.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KO84/18

Parashtrues

Albin Kurti dhe 11 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 06/V-145 të Kuvendit të Republikës së Kosovës përkitazi me Propozimin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje! për shkarkimin e Aida Dërgutit nga pozita e nënkryetares së Kuvendit të Republikës së Kosovës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi- Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u parashtrua nga Albin Kurti, Glauk Konjufca, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, Liburn Aliu, Drita Millaku, Xhelal Sveçla, Arbër Rexhaj, Fitore Pacolli, Rexhep Selimi, Arbërie Nagavci, Shemsi Syla dhe Sami Kurteshi (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës), të

gjithë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kuvendi).

2. Parashtruesit e kërkesës kanë autorizuar deputetin e Kuvendit, Sami Kurteshi, që t'i përfaqësojë ata në procedurat para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

Akti i kontestuar

3. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e Vendimit nr. 06/V145 të Kuvendit të Republikës së Kosovës përkitazi me Propozimin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje! për shkarkimin e Aida Dërgutit nga pozita e nënkryetares së Kuvendit (në tekstin e mëtejmë: Vendimi i kontestuar), miratuar nga Kuvendi më 4 qershor 2018.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vendimi i kontestuar, i cili pretendohet se nuk është në pajtueshmëri me nenet 7 [Vlerat], dhe 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

5. Parashtruesit e kërkesës më tej kërkojnë nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme, përmes së cilës kërkojnë *"pezullimin e ushtrimit të funksionit të nënkryetares së Kuvendit të Kosovës [Aida Dërguti]"*.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në paragrafin 5, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës dhe në nenet 27 [Masat e Përkohshme], 42 [Saktësimi i kërkesës] dhe 43 [Afatet] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), si dhe në rregullat 56 [Kërkesa për masë të përkohshme] dhe 74 [Kërkesa në pajtim me nenin 113. 5 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

7. Më 31 maj 2018, Gjykata miratoi, në seancë administrative, plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata i referohet dispozitave juridike të rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatë

8. Më 12 qershor 2018, parashtruesit i paraqitën Gjykatës kërkesën me dokumentet e bashkëngjitura.

9. Më 16 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Snezhana Botusharova dhe Almiro Rodrigues. Më 26 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.

10. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.

11. Më 17 gusht 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Radomir Laban dhe Nexhmi Rexhepi.

12. Më 24 gusht 2018, Gjykata i njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës, Presidentin e Republikës së Kosovës, Kryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kryetari i Kuvendit) dhe Kryeministrin e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kryeministri).

13. Kryetarit të Kuvendit iu kërkua që të njoftojë deputetët se mund të dorëzojnë komentet e tyre në lidhje me kërkesën e parashtruesve, nëse kanë, deri më 20 shtator 2018. Sekretariatit të Kuvendit iu kërkua që të dorëzojë në Gjykatë, dokumentet relevante në lidhje me vendimin e kontestuar.

14. Më 28 gusht 2018, Sekretariati i Kuvendit i dorëzoi Gjykatës dokumentet si në vijim:

    a. Transkriptin e Seancës Konstituive të Kuvendit, mbajtur më 3, 4, 10, 14, 24 gusht dhe më 7 shtator 2017;
    b. Vendimin e Kuvendit për zgjedhjen e 3 (tre) nënkryetarëve të Kuvendit, nr. 06-V-003, të 7 shtatorit 2017;
    c. Njoftimin për Themelimin e Grupit të ri Parlamentar - Grupi i Deputetëve të Pavarur (GOP), nr. 06/S701D0-52, i 14 marsit 2018;
    d. Propozimin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje për shkarkimin e nënkryetares së Kuvendit, Aida Dërguti, nr. 06/1108/D0-615, i 17 prillit 2018;

e. Transkriptin e Seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, mbajtur më 3 maj, 1 dhe 4 qershor 2018 (në tekstin e mëtejmë: Transkripti); dhe
f. Vendimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës për mosshkarkimin e nënkryetares së Kuvendit, Aida Dërguti, nr. 06-V -14, të 4 qershorit 2018.

15. Më 19 shtator 2018, Gjykata i parashtroi Forumit të Komisionit të Venecias pyetjet si në vijim:

1) Cila është procedura për shkarkimin e zëvendëskryetarit të Kuvendit në vendin tuaj?
a) Nëse zëvendëskryetari i Kuvendit largohet nga Grupi Parlamentar që e propozoi atë për këtë post, a do ta humbë automatikisht pozitën e zëvendëskryetarit?
b) Në këtë rast, a është e nevojshme që Kuvendi të votojë për shkarkim?
c) Nëse përgjigja në pyetjen b) është pozitive, a janë anëtarët e Kuvendit të detyruar të votojnë për propozimin e tillë?

2) A ekziston ndonjë praktikë gjyqësore relevante në lidhje me:
a) shkarkimin e zëvendëskryetarit të Kuvendit? dhe
b) Çfarëdo praktike gjyqësore që ka konsideruar se një votë kundër një propozimi të caktuar është cilësuar si "abuzim i së drejtës së votës" së deputetëve të Kuvendit?

16. Më 20 shtator 2018, Visar Ymeri, në cilësinë e përfaqësuesit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate (në tekstin e mëtejmë: PSD), dorëzoi komentet përkitazi me kërkesën.

17. Më 24 shtator 2018, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës përkitazi me komentet e dorëzuara nga PSD-ja dhe i ftoi që të dorëzojnë komentet e tyre, nëse kanë, deri më 1 tetor 2018.

18. Të njëjtën ditë, Gjykata po ashtu njoftoi Presidentin e Republikës së Kosovës, Kryetarin e Kuvendit dhe Kryeministrin përkitazi me komentet e dorëzuara nga PSD-ja. Kryetarit të Kuvendit iu kërkua që kopjet e të gjitha komenteve t'u dorëzohen të gjithë deputetëve të Kuvendit.

19. Më 1 tetor 2018, parashtruesit e kërkesës dorëzuan përgjigjen ndaj komenteve të PSD-së.

20. Më 3 tetor 2018, Gjykata njoftoi Presidentin e Republikës së Kosovës, Kryetarin e Kuvendit dhe Kryeministrin përkitazi me përgjigjen e

parashtruesve të kërkesës ndaj komenteve të PSD-së. Kryetarit të Kuvendit iu kërkua që kopjet e të gjitha komenteve t'u dorëzohen të gjithë deputetëve të Kuvendit.

21. Ndërmjet 19 shtatorit dhe 28 tetorit 2018, Gjykata pranoi përgjigjet në pyetjet e parashtruara nëpërmjet Forumit të Komisionit të Venecias nga gjykatat kushtetuese ose supreme të Austrisë, të Holandës, të Luksemburgut, të Gjermanisë, të Kroacisë, të Suedisë, të Çekisë, të Bullgarisë, të Sllovakisë, të Afrikës së Jugut, të Norvegjisë, të Kosta Rikës, të Maqedonisë dhe të Letonisë.

22. Më 3 dhjetor 2018, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

23. Në të njëjtën ditë, Gjykata votoi me shumicë se Vendimi i kontestuar është në pajtueshmëri me Kushtetutën.

Përmbledhja e fakteve

24. Më 11 qershor 2017, u mbajtën zgjedhjet për Kuvend.

25. Më 8 korrik 2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve certifikoi rezultatet e zgjedhjeve.

26. Më 24 korrik 2017, Presidenti i Republikës së Kosovës vendosi që seanca konstituive e Kuvendit të mbahet më 3 gusht 2017.

27. Më 3 gusht 2017, Kuvendi mbajti seancën konstituive të kryesuar nga deputeti me i vjetër i Kuvendit.

28. Sipas rendit të ditës, Kuvendi formoi Komisionin *ad hoc* për verifikimin e kuorumit dhe mandateve (në tekstin e mëtejmë: Komisioni *ad hoc*).

29. Të njëjtën ditë, Komisioni *ad hoc* paraqiti raportin, bazuar në listën e rezultateve të certifikuara të zgjedhjeve dhe konstatoi mandatet si në vijim:

    a) Partia Demokratike e Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Nisma për Kosovën, Partia e Drejtësisë, Lëvizja për Bashkim Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës, Partia Konservatore e Kosovës, Alternativa Demokratike e Kosovës, Republikanët e Kosovës, Partia e Ballit, Partia

Socialdemokrate, Balli Kombëtar i Kosovës (në tekstin e mëtejmë: PDK, AAK dhe Nisma), 39 deputetë;
b) Lëvizja "Vetëvendosje!" (në tekstin e mëtejmë: LVV), 32 deputetë;
c) Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Aleanca Kosova e Re (në tekstin e mëtejmë: LDK dhe AKR), 29 deputetë;
d) Građanska Iniciativa Srpska lista, 9 deputetë;
e) Kosova Demokratik Tyrk Partisi, 2 deputetë;
f) Koalicija "Vakat", 2 deputetë;
g) Nova Demokratska Stranka, 1 deputet;
h) Samostalna Liberalna Stranka, 1 deputet;
i) Partia Demokratike e Ashkalinjve të Kosovës, 1 deputet;
j) Partia Liberale Egjyptiane, 1 deputet;
k) Jedinstvena Goranska Partije, 1 deputet;
l) Partia e Ashkalinjve për Integrim, 1 deputet; dhe,
m) Partia Rome e Bashkuar e Kosovës, 1 deputet.

30. Kryesuesi vazhdoi me rendin e ditës për seancën konstituive të Kuvendit, zgjedhja e kryetarit të Kuvendit dhe e nënkryetarëve, e cila u ndërpre.

31. Më 7 shtator 2017, pas disa ndërprerjeve, vazhdoi mbledhja konstituive e Kuvendit me rendin e ditës: zgjedhja e Kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit.

32. Me propozimin e PDK-së, AAK-së dhe Nisma, Kadri Veseli, u zgjodh Kryetar i Kuvendit.

33. Pastaj, Kuvendi vazhdoi me zgjedhjen e nënkryetarëve, ku PDK-ja, AAK-ja dhe Nisma propozoi deputetin Xhavit Haliti, LVV-ja propozoi deputeten Aida Dërguti, ndërsa LDK-ja dhe AKR-ja propozuan deputetin Kujtim Shala. Pas procesit të votimit, u konstatua po ashtu se të propozuarit morën votat e nevojshme për të qenë nënkryetarë të Kuvendit.

34. Në të njëjtën ditë, Kuvendi zgjodhi edhe një nënkryetar nga komuniteti joshumicë: deputeten Müfera Şinik, si dhe një nënkryetar nga Grupi Parlamentar i Listës Serbe: deputetin Slavko Simić.

35. Më 14 mars 2018, 12 (dymbëdhjetë) deputetë, në mesin e tyre edhe nënkryetarja e Kuvendit, Aida Dërguti, njoftuan Kryetarin e Kuvendit për themelimin e Grupit të ri Parlamentar: Grupi i Deputetëve të Pavarur.

36. Më 19 prill 2018, Kryesia e Kuvendit shqyrtoi dhe vendosi në rend të ditës për seancën e 3 majit 2018, propozimin e Grupit Parlamentar të LVV-së për shkarkimin e nënkryetares së Kuvendit, Aida Dërguti.

37. Më 1 qershor 2018, Kuvendi vazhdoi diskutimet përkitazi me propozimin e Grupit Parlamentar të LVV-së për shkarkimin e nënkryetares së Kuvendit, Aida Dërguti. Megjithatë, për shkak të mungesës së kuorumit, votimi për këtë propozim u shty.

38. Më 4 qershor 2018, Kuvendi votoi në lidhje me propozimin e Grupit Parlamentar të LVV-së për shkarkimin e nënkryetares së Kuvendit, Aida Dërguti. Sipas transkriptit, në sallë ishin të pranishëm 94 (nëntëdhjetë e katër) deputetë, 16 (gjashtëmbëdhjetë) deputetë votuan për, 26 (njëzetë e gjashtë) deputetë votuan kundër dhe 47 (dyzetë e shtatë) deputetë abstenuan.

39. Rrjedhimisht, Kuvendi nuk e shkarkoi Aida Dërgutin nga pozita e nënkryetares së Kuvendit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

40. Parashtruesit e kërkesës pohojnë se vendimi i kontestuar nuk është në pajtueshmëri me nenet 7 [Vlerat] dhe 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve] të Kushtetutës.

41. Parashtruesit e kërkesës fillimisht pohojnë se Kushtetuta, në nenin 64, paragrafi 1, përcakton se, me rastin e konstituimit të organeve të Kuvendit, vendet duhet të ndahen në proporcion me numrin e votave të fituara në zgjedhjet për Kuvend. Sipas tyre, *"[...] partive, koalicioneve, iniciativave qytetare, dhe kandidatëve të pavarur u jepet ai numër i vendeve, barazuar me mandate të deputeteve, që korrespondon proporcionalisht me votat që kanë fituar në zgjedhje"*.

42. Parashtruesit e kërkesës argumentojnë se *"grupi më i madh parlamentar, sipas nenit 67. 2 të Kushtetutës, duhet të konsiderohet partia, koalicioni [...] që kanë më shumë vende në Kuvend, në kuptim të nenit 64. 1 të Kushtetutës, se çdo parti tjetër, koalicion, iniciativë qytetare dhe kandidatë të pavarur që kanë marrë pjesë si të tillë në zgjedhje"*.

43. Parashtruesit e kërkesës pohojnë se *"sipas nenit 67, par. 3, i Kushtetutës, pozita e nënkryetarit/es të Kuvendit është e rezervuar ekskluzivisht për tri grupet më të mëdha parlamentare të cilat kanë të drejtë të propozojnë nga një nënkryetar të cilët zgjedhen me të*

njëjtën shumicë të votave siç zgjedhet edhe Kryetari i Kuvendit të Kosovës".

44. Parashtruesit po ashtu sqarojnë se *"Kushtetuta e Kosovës, konkretisht neni 67, par. 6, përcakton se me zgjedhjen e Kryetarit dhe nënkryetarëve formohet Kryesia e Kuvendit. Kjo është formula juridiko-politike e konstituimit të Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, që në mënyrë eksplicite përmban normën për përcaktimin e tri subjekteve më të mëdha që kualifikohen automatikisht për përfaqësim në Kryesinë e Kuvendit me nga një nënkryetar/e. Përbërja e Kryesisë së Kuvendit reflekton fuqinë e partive politike të dala nga zgjedhjet parlamentare përmes votës demokratike dhe rrjedhimisht fuqinë apo madhësinë e grupit parlamentar në Kuvendin e Kosovës".*

45. Parashtruesit më tej theksojnë se *"të drejtën për të propozuar dhe për të pasur përfaqësuesin e tyre politik, e kanë në mënyrë ekskluzive gjatë tërë legjislaturës, tri grupet më të mëdha parlamentare të cilat rrjedhin nga votat e partive politike të fituara gjatë zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare".*

46. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se *"ushtrimi i funksionit të pozitës së nënkryetarit nga deputetja [Aida Dërguti] dërgon në çrregullim të plotë të punës në Kryesinë e Kuvendit dhe në mohimin absolut të përfaqësimit të grupeve parlamentare të cilat kanë fuqi më të madhe politike në raport me grupin parlamentar i cili ka uzurpuar pozitën e nënkryetarit në kundërshtim me nenin 67, par. 3, 6, 8, dhe me nenin 7, par. 1, të Kushtetutës. Gjithashtu, mbajtja e pozitës së nënkryetarit nga znj. Aida Dërguti, duke përfaqësuar tashmë grupin e katërt parlamentar, ka cenuar rëndë barazinë në përfaqësimin e grupit parlamentar [të LVV] në raport me grupet e tjera parlamentare në ushtrimin e funksioneve përbrenda Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, në kundërshtim të plotë me nenin 67, par. 3, 6 dhe 8, dhe me nenin 7, par. 1, të Kushtetutës".*

47. Parashtruesit e kërkesës po ashtu pretendojnë se "*qëllimi i nenit 67, par. 3, i cili në përmbajtjen e tij shpreh, promovon të drejtën që nga tri grupet më të mëdha parlamentare të cilat rrjedhin nga fuqia e koalicioneve apo partive politike të fituar përmes votës demokratike të përfaqësohen në të gjitha trupat e Kuvendit, respektivisht në Kryesinë e Kuvendit të Kosovës [...]. E kundërta e kësaj kualifikohet si cenim i nenit 67, par. 3, 6 dhe 8, dhe nenit 7, par. 1, të Kushtetutës së Kosovës".*

48. Parashtruesit më tej pretendojnë se *"për sa i përket votimit të deputetëve për shkarkimin e znj. Dërguti nga pozita e nënkryetares, siç e ka shprehur Gjykata Kushtetuese, se ata "mund të votojnë si të dëshirojnë", sipas Gjykatës Kushtetuese, edhe vota e deputetëve duhet të jetë në pajtim me dispozitat kushtetuese duke e marrë parasysh qëllimin e dispozitave përkatëse dhe të mos jetë abuzive dhe në kundërshtim me parimin e mirëbesimit, që zbatohet edhe në të drejtën kushtetuese. Nëse votimi si veprim nuk përbën normë themelore, por mjet për zbatimin dhe jetësimin e normës si qëllim parësor, ajo nuk mund ta rrëzojë normën. Refuzimi i shkarkimit të nënkryetares në fjalë, e cila nuk e përfaqëson më fuqinë politike dhe votën demokratike siç e parasheh Kushtetuta, është abuzim me të drejtën e votimit dhe cenon qëllimin kushtetues që qëndron prapa dispozitave që e rregullojnë përbërjen e Kryesisë së Kuvendit"*.

49. Në lidhje me kërkesën për masë të përkohshme, parashtruesit pohojnë se *"meqenëse [LVV-ja] është renditur si parti e dytë përmes zgjedhjeve demokratike të lira dhe të përgjithshme dhe meqenëse grupi parlamentar [LVV-ja] është formuar si grupi i dytë parlamentar mbi bazën e rezultatit të zgjedhjeve, mospërfaqësimi i tij në kryesinë e Kuvendit po shkakton dëme të pariparueshme për vet grupin parlamentar si bartëse e vullnetit të qytetarëve të konfirmuar përmes zgjedhjeve të lira demokratike dhe të përgjithshme. Pra ushtrimi i funksionit të tillë nga deputetja në fjalë, e cila është pjesë e grupit të katërt parlamentar që nuk ka dalë apo formuar nga zgjedhjet parlamentare, paraqet mospërfaqësim të vullnetit të plotë të qytetarëve të cilët kanë votuar përmes zgjedhjeve të lira, demokratike [LVV-ja] mbi bazën e së cilës është krijuar grupi parlamentar [LVV-ja] brenda Kuvendit të Kosovës"*.

50. Në fund, parashtruesit kërkojnë nga Gjykata që të shpall kërkesën të pranueshme si dhe të shpall jokushtetues vendimin e kontestuar.

Përmbledhja e komenteve të pranuara nga PSD

51. Në përgjigjen e tyre ndaj kërkesës së parashtruesve të kërkesës, PSD-ja pohon se *"Kryesia e Kuvendit është organ administrativ i Kuvendit, karakter ky i cili i mëveshet edhe në bazë të dispozitave të nenit 67, paragrafi 6, të Kushtetutës. […] Duke iu mëveshur karakteri administrativ, natyra juridike e Kryesisë së Kuvendit përkufizohet si organ kolegjial"*. Duke u thirrur edhe në dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nr. 05/L -03, neni 37, PSD-ja pohon se *"në rastin konkret kemi të bëjmë me një organ, siç është Kryesia e Kuvendit, që është i përbërë nga disa persona të mandatuar sipas bazës kushtetuese dhe të cilët ushtrojnë rol*

vendimmarrës për çështje, siç i ka përkufizuar edhe dispozita kushtetuese, se vendimmarrja e këtij organi kolegjial konsiston në sigurimin e funksionimit administrativ të Kuvendit".

52. Më tej, PSD-ja pretendon se *"ndonëse dispozitat e nenit 67 të Kushtetutës nuk kanë përcaktuar në mënyrë taksative mandatin e Kryesisë së Kuvendit, është e nënkuptueshme se Kryesia e Kuvendit e kufizon mandatin e saj si organ i Kuvendit në përputhje me nenin 66 të Kushtetutës, respektivisht paragrafin 1, dispozitë kjo e cila e ka përcaktuar rrjedhën e mandatit nga dita e seancës konstituive e cila mbahet brenda tridhjetë ditëve nga dita e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve. Madje në kuptim të dispozitës së tillë, meqë kushti i konstituimit të Kuvendit është zgjedhja e Kryesisë së Kuvendit, mandati i Kryesisë së Kuvendit është i ndërlidhur me mandatin e Kuvendit si organ dhe jo me mandatin e deputetëve".*

53. Sipas PSD-së, "*dispozitat e Kushtetutës kanë përcaktuar se zgjedhja e Kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit duhet bërë në një procedurë të votimit ku kërkohet shumica e votave të të gjithë deputeteve, që paraqet teorikisht një shumicë absolute. Ndërkaq, për shkarkimin e tyre kërkohet një shumicë e kualifikuar që nënkupton votën e 2/3 të numrit të përgjithshëm të deputetëve.* Andaj, sipas tyre, *"kërkesë kushtetuese është konsensusi parlamentar për shkarkimin e cilitdo nga anëtarët e Kryesisë së Kuvendit […]. Madje, funksionet e tilla duhet kuptuar në përfaqësim në nivel të Kuvendit, që nënkupton se as Kryetari dhe as nënkryetarët nuk janë funksionar të partisë, por të një organi të Kuvendit i cili drejton Kuvendin në kuptimin organizativ-administrativ".*

54. PSD-ja, po ashtu, pohon se *"parashtruesit e kërkesës K084/18, tentojnë të interpretojnë mandatin e anëtarëve të Kuvendit në suaza të mandatit imperativ […]. Anëtarët e Kryesisë kanë mandat të lirë dhe kjo është tërësisht në frymën bashkëkohore të rregullimit juridiko-politik në sistemet kushtetuese. Madje, ndërprerjen e sistemit të mandateve imperativë, shumë autorë, siç është Pasquale Pasquino, në esenë e tij "One and Three: Separation of Powers and the Independence of Judicare in Italian Constituion", e konsideron se zhbërja e mandateve imperative është një nga principet themelore të qeverisjes bashkëkohore përfaqësuese".* Sipas PSD-së, pretendimi i parashtruesve se *"deputetët është dashur të votojnë për mocionin për shkarkimin të nënkryetares së Kuvendit, cenon lirinë e ushtrimit të mandatit të deputetëve, e drejtë kushtetuese e garantuar me nenin 70, paragrafi 1, të Kushtetutës, i konkretizuar me nenin 3, paragrafët 1 dhe 2, të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit".*

55. Përkitazi me kërkesën për masë të përkohshme, PSD-ja e konsideron si "*të panevojshëm çfarëdo komentimi në raport me propozimin e parashtruesve për masë të përkohshme, duke marrë parasysh përmbajtjen e kërkesës, objektin e kërkesës për mbrojtje dhe pamundësisë juridike të shkaktimit të çfarëdo dëmi i cili do të duhej të ishte i pariparueshëm*".

56. Në fund, PSD-ja konsideron se kërkesa e parashtruesve është qartazi e pabazuar dhe duhet të shpallet e papranueshme.

Përmbledhja e përgjigjeve të LVV-së ndaj komenteve të PSD-së

57. Në përgjigjen e tyre ndaj komenteve të PSD-së, LVV-ja pohon se *"meqenëse përfaqësimi në Kryesinë e Kuvendit përbëhet nga deputetet e tri grupeve më të mëdha parlamentare, përfaqësimi në Kryesi ka karakter politik, duke u mëveshur me përgjegjësi kushtetuese për funksionimin administrativ të Kuvendit të Kosovës"*. Në vazhdim, LVV-ja sqaron se *"zëvendësimi i Kryetarit nga nënkryetarët e Kuvendit, i cili mund të ishte nga radhët e [LVV-së], ka karakter politik në raport me kompetencat që ushtron Kryetari i Kuvendit, e sidomos në përfaqësim të Kuvendit [...]. Prandaj, konsiderojmë që Kryesia e Kuvendit ka karakter të pastër politik dhe ushtron funksione politiko-administrative [...]"*.

58. LVV-ja, po ashtu, pohon *"se mandati i lirë duhet të interpretohet në kuadër të mosndikimit politik apo të çfarëdo natyre tjetër, mbarimit dhe pavlefshmërisë së mandatit të deputetëve. Mocioni i Grupit parlamentar të [LVV-së] nuk ishte i drejtuar në marrjen e mandatit të deputetes në fjalë [...]"*, duke theksuar më tej se *"Grupi Parlamentar i [LVV-së] dhe roli i saj përfaqësues në trupat e Kuvendit, konkretisht në Kryesinë e Kuvendit, është i pakrahasueshëm me mbajtjen e një pozicioni nga një deputet që tashmë përfaqëson një grup tjetër parlamentar, gjegjësisht një subjekt tjetër politik. Kjo e bën të domosdoshme për nga prioriteti dhe rëndësia zbatimin e dispozitës kushtetuese, respektivisht nenit 67 par. 3 të Kushtetutës [...]"*.

Komentet e përmbledhura, të pranuara nga Forumi i Komisionit të Venecias

59. Gjykata fillimisht vëren se nga përgjigjet e pranuara të Forumit të Komisionit të Venecias ekzistojnë praktika të ndryshme Kushtetuese, sa i përket çështjes së zgjedhjes dhe shkarkimit të nënkryetarëve të Kuvendit.

60. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese e Austrisë u shpreh se *"Kryetari, Kryetari i Dytë dhe Kryetari i Tretë zgjedhen nga të gjithë deputetët e Parlamentit. Nuk ka kushte tjera formale për zgjedhjen e tyre, megjithëse në praktikë, të tre presidentët zgjedhen nga tri grupet më të mëdha parlamentare. Nëse njëri nga presidentët e lëshon grupin parlamentar që e ka propozuar për kryesi, ai apo ajo nuk e humb pozitën me automatizëm, dhe as nuk mund të largohet nga pozita. Në fakt, një rast i tillë ka ndodhur: në vitin 1993, Presidenti i Tretë i Këshillit Kombëtar që ishte nominuar nga grupi i tretë më i madh parlamentar, ka lëshuar grupin dhe i është bashkuar anëtarëve tjerë të grupit për të formuar një parti të re, por ai ka mbajtur pozitën në mënyrë të suksesshme deri në përfundimit e mandatit"*.

61. Gjykata Supreme e Holandës qartësoi se *"neni 61 i Kushtetutës dhe rregullat e brendshme të Parlamentit, parashohin vetëm se deputetët e parlamentit zgjedhin Kryesuesin nga mesi i tyre. Kryesuesi zgjedhet pas së cilave palë zgjedhje dhe mandati i tij përfundon kur të mbahen zgjedhjet e reja"*.

62. Gjykata Kushtetuese e Luksemburgut, sqaroi: *"Ligji përkatës i Luksemburgut përkitazi me Kuvendin (ndryshe e quajtur si "Dhoma e Deputetëve") nuk ka ndonjë procedurë për shkarkimin e nënkryetarit [...]*. Sipas tyre, *"deputetët, të cilët, sipas nenit 3 të Kushtetutës përfaqësojnë (përmes Dhomës së Deputetëve), shtetin e tyre dhe që votojnë pa u thirrur në zgjedhësit e tyre dhe gjatë votimit kanë parasysh vetëm interesat e Dukatit të Madh [të Luksemburgut], vazhdojnë të mbeten si deputetë të Kuvendit, pavarësisht edhe nëse gjatë mandatit të tyre ata largohen nga grupi politik në të cilin ata bënin pjesë më parë edhe me të cilën parti ata u zgjodhën. Në këtë rast, edhe pse një rast i tillë akoma nuk është paraqitur në praktikë, një nënkryetar i zgjedhur, nuk mund të shkarkohet nëse nuk largohet vullnetarisht nga kjo pozitë"*.

63. Gjykata Kushtetuese e Gjermanisë sqaroi se, në Parlamentin Federal të Gjermanisë, *"secili grup parlamentar përfaqësohet nga të paktën një zëvendëskryetar; Kryetari dhe zëvendëskryetarët zgjedhen me shumicë të thjeshtë votash. Nëse një kandidat nuk arrin shumicën e votave, atëherë votimi përsëritet. Kushtetua [Gjermane] dhe Rregullorja e punës së Bundestagut, nuk parashohin dispozita për largimin e Kryetarit dhe zëvendëskryetarëve"*.

64. Gjykata Kushtetuese e Kroacisë u shpreh se *"shkarkimi i zëvendëskryetarit të Parlamentit mund të propozohet nga grupet parlamentare ose nga 40 (dyzet) deputet të Parlamentit [...] dhe*

parlamenti miraton me shumicë votash, me kusht që shumica e deputetëve të jenë prezent në seancë".

65. Gjykata Supreme Administrative e Suedisë theksoi se *"anëtarët e Parlamentit zgjedhin Kryesuesin dhe 3 (tre) zëvendëskryesues nga radhët e tyre për një mandat elektoral (katër vjet). Janë grupet parlamentare në Parlament që nominojnë kandidatët për pozitat e ndryshme".* Ata po ashtu shtojnë se gjatë periudhës deri në zgjedhjet parlamentare, Kryesuesi dhe zëvendësit e tij *"nuk mund të shkarkohen nga pozita me vendim Parlamenti. Ata mund, megjithatë, të japin dorëheqje nga pozita e tyre".*

66. Gjykata Kushtetuese e Çekisë qartësoi se, në Republikën e Çekisë, "*nënkryetari i Parlamentit mund të shkarkohet vetëm me propozimin e 2/5 të të gjithë deputetëve [...]; 1/3 e të gjithë deputetëve [...] duhet të jenë prezent gjatë votimit dhe propozimi duhet të pranohet nga shumica e tyre".* Sipas tyre, e vetmja mënyrë për shkarkimin e nënkryetarit të Kuvendit është nëse propozimi për shkarkim merr numrin e nevojshëm të votave të parapara më lart.

67. Gjykata Kushtetuese e Bullgarisë sqaroi se "*shkarkimi i Kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit nuk është subjekt i trajtimit kushtetues dhe është kompetencë ekskluzive e vetë Kuvendit".* Kjo pasi çështja e shkarkimit të nënkryetarëve rregullohet me Rregulloren e punës së Kuvendit Kombëtar të Bullgarisë dhe shkelja e mundshme e saj nuk mund të përbëjë shkelje kushtetuese. Ata, po ashtu, sqarojnë se Rregullorja e punës e Kuvendit Kombëtar të Bullgarisë, neni 5, paragrafi 2, parasheh se nënkryetarët e Kuvendit shkarkohen nga pozitat para skadimit të mandatit kur e lëshojnë grupin parlamentar i cili i ka nominuar, me shkarkim nga ai grup apo nëse grupi parlamentar shuhet. Në raste të tilla, shkarkimi bëhet pa debat apo votim.

68. Gjykata Kushtetuese e Sllovakisë u shpreh se, në Sllovaki, nëse nënkryetari i Kuvendit largohet nga partia parlamentare që e ka propozuar për atë pozitë, ai apo ajo nuk e humb pozitën e nënkryetarit të Kuvendit. Ata theksojnë se një rast i tillë ka ndodhur së fundi, duke shtuar se *"pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2016 të cilat u përcollën me formimin e një koalicioni me katër parti, (njëra nga to e quajtur Sieť). Njëri nga anëtarët e Sieť ishte zgjedhur nënkryetar (një nga katër nënkryetarët). Më vonë gjatë vitit 2016, ai doli nga Sieť dhe iu bashkua një partie tjetër të koalicionit. Megjithatë, ai mbajti pozitën e nënkryetarit [të Kuvendit]".*

69. Gjykata Kushtetuese e Afrikës së Jugut u shpreh se në Afrikën e Jugut kur nënkryetari i Parlamentit nuk është më anëtar i ndonjë partie politike, nuk e humb pozitën e nënkryetarit të Parlamentit me automatizëm. Përveç nëse ndiqet një proces kushtetues për shkarkimin e tij/saj, është e mundur që një nënkryetar të mbetet në atë pozitë edhe kur ai nuk i përket më asnjë partie politike. Andaj, për të shkarkuar një nënkryetar të Parlamentit, është e nevojshme që shumica e deputetëve të votojnë propozimin për shkarkim. Gjithashtu, sipas përgjigjes së Gjykatës Kushtetuese të Afrikës së Jugut, kur një propozim paraqitet për votim në Parlament, deputetët "*kanë tri opsione, (a) të votojnë në favor, (b) të votojnë kundër, ose (c) të abstenojnë*".

70. Gjykata Kushtetuese e Norvegjisë u shpreh se, në Norvegji, Parlamenti zgjedh Kryetarin dhe 5 (pesë) nënkryetarë me shumicën e thjeshtë të votave të deputetëve të Parlamentit. Për shkarkimin e nënkryetarëve nga pozita është e nevojshme që propozimi për shkarkim të bëhet nga 1/5 e deputetëve dhe propozimi për shkarkim të votohet nga shumica e thjeshtë e deputetëve.

71. Gjykata Kushtetuese e Kosta Rikës u shpreh se Parlamenti zgjedh Kryesinë në fillim të secilës legjislaturë. Kryetari i Parlamentit dhe nënkryetarët duhet të plotësojnë kushtet e njëjta si Presidenti i Republikës. Ata, po ashtu, u shprehën se, sipas Kushtetutës së tyre, nuk parashihen sanksione ndaj deputetëve që lëshojnë partitë politike që i kanë ndihmuar të zgjedhen. Sipas tyre, *"është e rëndësishme të ceket se shumica e këtyre deputetëve e ushtrojnë deri në fund të legjislaturës mandatin e tyre pa u bërë pjesë e ndonjë grupi tjetër politik"*.

72. Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë sqaroi se dispozitat e vetme kushtetuese në lidhje me nënkryetarët e Parlamentit janë ato të nenit 67 të Kushtetutës së Maqedonisë, të cilat përcaktojnë se Parlamenti, nga radhët e deputetëve, zgjedh Kryetarin dhe një ose disa nënkryetarë, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve. Ata shtojnë se, sipas nenit 21 të Rregullores së punës së Parlamentit, numri i nënkryetarëve vendoset nga Kryetari i Parlamentit, dhe ata zgjedhen nga deputetët që iu përkasin partive të ndryshime politike të përfaqësuara në Parlament. Një nga nënkryetarët zgjedhet nga partia më e madhe opozitare. Ata gjithashtu sqarojnë se, Rregullorja e punës së Parlamentit nuk parasheh dispozita në lidhje me shkarkimin e nënkryetarëve.

73. Gjykata Kushtetuese e Letonisë u shpreh se në Letoni, pozita e nënkryetarit të Kuvendit nuk është e lidhur me anëtarësimin në grupet

parlamentare. Nëse nënkryetari vendos të dal nga grupi parlamentar që e ka propozuar për atë pozitë, nuk ka pasoja automatike për mbajtjen e pozitës së tij. Ata po ashtu u shprehën se sipas sistemit të tyre juridik, deputetët nuk kanë obligim që të votojnë për një propozim të caktuar dhe nëse kjo do të ndodhte ky obligim do të ishte në kundërshtim me nenin 28 të Kushtetutës së Letonisë që parasheh se anëtarët e Kuvendit (Seimas) nuk mund të merren në përgjegjësi në ndonjë proces gjyqësor, administrativ apo disiplinor në lidhje me votimin e tyre.

Dispozitat relevante të Kushtetutës

"Neni 7 [Vlerat]

1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.

2. Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore.

[...]

Neni 64 [Struktura e Kuvendit]

1. Kuvendi ka 120 (njëqind e njëzet) deputetë të zgjedhur me votim të fshehtë bazuar në listat e hapura. Vendet në Kuvend ndahen midis të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara prej tyre, në zgjedhjet për Kuvendin.
2. Në kuadër të kësaj ndarjeje, 20 (njëzet) prej 120 (njëqind e njëzet) vendeve janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë, [...].
[...]

Neni 65 [Kompetencat e Kuvendit]

Kuvendi i Republikës së Kosovës:
[...]

(6) zgjedh dhe shkarkon Kryetarin dhe nënkryetarët e Kuvendit; […].

Neni 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe nënkryetarëve]

1. *Kuvendi i Kosovës nga radhët e veta zgjedh Kryetarin dhe 5 (pesë) nënkryetarë.*

2. *Kryetari i Kuvendit propozohet nga grupi më i madh parlamentar dhe zgjedhet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.*

3. *Tre (3) nënkryetarët të propozuar nga tri grupet më të mëdha parlamentare, zgjedhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.*

4. *Dy (2) nënkryetarë përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë në Kuvend dhe ata zgjedhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve. Njëri nënkryetar do të jetë nga radhët e deputetëve të Kuvendit që mbajnë vendet të rezervuara ose të garantuara të komunitetit Serb, dhe tjetri nënkryetar nga radhët e deputetëve të Kuvendit që mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara nga komunitetet tjera që nuk janë shumicë.*

5. *Kryetari dhe nënkryetarët e Kuvendit shkarkohen me votën e shumicës prej dy të tretave (2/3) të numrit të përgjithshëm të deputetëve.*

6. *Kryetari dhe nënkryetarët formojnë Kryesinë e Kuvendit. Kryesia është përgjegjëse për funksionimin administrativ të Kuvendit në mënyrën e përcaktuar me Rregulloren e Punës të Kuvendit.*

7. *Kryetari i Kuvendit:*
   (1) përfaqëson Kuvendin;
   (2) përcakton rendin e ditës, thërret dhe kryeson seancat;
   (3) nënshkruan aktet e miratuara nga Kuvendi;
   (4) ushtron edhe funksione të tjera, në bazë të kësaj Kushtetute dhe Rregullores së punës të Kuvendit.

8. *Në rast mungese ose pamundësie për të ushtruar funksionin, Kryetarin e Kuvendit e zëvendëson njëri nga nënkryetarët.*
   […]

Neni 70 [Mandati i Deputetëve]

1. Deputetët e Kuvendit janë përfaqësues të popullit dhe nuk i nënshtrohen asnjë mandati detyrues.
[...].

Neni 74 [Ushtrimi i Funksionit]

Deputetët e Kuvendit të Kosovës ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me këtë Kushtetutë, ligjet dhe rregullat e procedurës së Kuvendit.

Dispozitat relevante të Rregullores së punës së Kuvendit

Neni 12 [Zgjedhja e Kryetarit dhe e nënkryetarëve të Kuvendit]

1. Në mbledhjen konstituive të Legjislaturës IV, Kuvendi nga radhët e veta i zgjedh Kryetarin dhe nënkryetarët. Kryetari dhe nënkryetarët e përbëjnë Kryesinë e Kuvendit.

2. Kryesuesi i mbledhjes konstituive kërkon nga grupi më i madh parlamentar ta propozojë kandidatin për Kryetar të Kuvendit. Kryetari i Kuvendit zgjedhet me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit.

3. Kryesuesi i mbledhjes konstituive të legjislaturës kërkon nga tri grupet më të mëdha parlamentare ta propozojnë nga një kandidat për nënkryetar të Kuvendit, të cilët zgjedhen me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit.

4. Në përbërje të Kryesisë dhe në trupat e tjerë të punës të Kuvendit respektohet përbërja gjinore e Kuvendit.

5. Kryesuesi i mbledhjes konstituive të legjislaturës kërkon nga deputetët që mbajnë vende të garantuara për komunitetin serb dhe nga deputetët, që mbajnë vende të garantuara për komunitetet e tjera, që nuk janë shumicë, ta propozojnë nga një kandidat për nënkryetar të Kuvendit. Nënkryetarët, sipas kësaj pike, zgjedhen me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit.

6. Kryesuesi i mbledhjes konstituive të legjislaturës e shpall rezultatin e votimit për zgjedhjen e Kryetarit dhe të

nënkryetarëve të Kuvendit. Kryetarin e sapozgjedhur të Kuvendit e fton ta zërë vendin e tij.

Neni 14 [Mandati i Kryesisë]

1. *Mandati i Kryetarit të Kuvendit dhe i anëtarëve të Kryesisë është në përputhje me mandatin e Kuvendit.*
   [...]
3. *Kryetari i Kuvendit mund t'ia paraqesë dorëheqjen Kuvendit. Aktin e dorëheqjes me shkrim ia dorëzon paraprakisht Kryesisë së Kuvendit. Pas miratimit të dorëheqjes, partia politike ose koalicioni, që e ka emëruar Kryetarin e mëparshëm të Kuvendit propozon kandidat të ri për kryetar.*
4. *E njëjta procedurë zbatohet edhe në rast të dorëheqjes së ndonjërit nga anëtarët e Kryesisë.*

5. *Shkarkimi i Kryetarit ose i anëtarit të Kryesisë së Kuvendit, me propozim të partisë politike ose të grupit, që e ka propozuar, bëhet sipas procedurës së zgjedhjes së tyre.*

Neni 16 [Mbledhjet e Kryesisë]

1. *Mbledhjet e Kryesisë i thërret dhe i kryeson Kryetari i Kuvendit.*

2. *Kryetari i Kuvendit e thërret mbledhjen e Kryesisë, nëse kërkohet nga një grup parlamentar ose së paku nga 5 për qind, përkatësisht nga 6 (gjashtë) deputetë të Kuvendit.*

3. *Vendimet e Kryesisë merren me konsensus. Në mungesë të konsensusit vendoset me shumicë votash të atyre që votojnë. Në rast të votave të barabarta, vendos vota e Kryetarit.*

4. *Në mbledhje të Kryesisë mund të marrin pjesë, pa të drejtë vote, përfaqësuesi i Presidentit të Republikës së Kosovës dhe i Qeverisë. Sekretari i Kuvendit merr pjesë në mbledhjet e Kryesisë, sipas detyrës zyrtare.*

5. *Kryesia e Kuvendit, për çështje të caktuara, i fton në mbledhjet e Kryesisë edhe kryetarët e grupeve parlamentare.*

Neni 51 [Kuorumi dhe votimi në mbledhjet e Kuvendit]

1. Kuvendi ka kuorum kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e deputetëve të Kuvendit.

2. Prania e deputetëve në mbledhje verifikohet me sistem elektronik të votimit, me ngritje të dorës ose me thirrje të emrave. Për mënyrën e verifikimit të pranisë së deputetëve, vendos kryesuesi i mbledhjes.

3. Vendimet e mbledhjeve të Kuvendit janë të vlefshme, në qoftë se në kohën kur ato janë marrë, në sallë kanë qenë më shumë se gjysma e deputetëve të Kuvendit. Ligjet, vendimet dhe aktet e tjera të Kuvendit konsiderohen të miratuara nëse për to votojnë shumica e deputetëve të pranishëm dhe që votojnë. Përjashtim bëjnë rastet kur me Kushtetutën e Republikës së Kosovës parashihet ndryshe.

4. Votimi bëhet në këto mënyra:

a) votimi i hapur, me ngritje të dorës: "për", "kundër" dhe "abstenim",
b) votimi i fshehtë ose
c) votimi i regjistruar, që e përfshin votimin elektronik dhe
d) votimin duke e thirrur secilin deputet, veç e veç.

5. Votimi i regjistruar bëhet kur këtë mënyrë e kërkon kryetari i Kuvendit ose një grup parlamentar dhe kur për këtë vendos Kuvendi. Kur mbahet votimi i regjistruar, vota e secilit deputet "për", "kundër" ose "abstenim" regjistrohet me emër e me mbiemër. Kur votimi është në formën elektronike, në ekran paraqitet numri i pjesëmarrësve, numri i votuesve dhe rezultati i plotë i votimit për secilin, veç e veç. Deputeti ka të drejtë ta shpjegojë votën e vet "për", "kundër" ose "abstenim" dhe ta kërkojë kopjen elektronike të rezultatit të votimit.

6. Kur kemi numër të barabartë të votave "për" dhe "kundër" konstatohet se propozimi nuk është miratuar.

7. Publikimi i votimit elektronik të deputetëve, bëhet brenda tri ditë pune, pas mbledhjes plenare.

Pranueshmëria e kërkesës

74. Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa i plotëson kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë e të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

75. Fillimisht, Gjykata i referohet paragrafit 1, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar".*

76. Përveç kësaj, Gjykata po ashtu i referohet nenit 113.5 të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur".*

77. Fillimisht, Gjykata rikujton se parashtruesit e kontestojnë kushtetutshmërinë e vendimit të kontestuar vetëm në lidhje me përmbajtjen e tij.

78. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se kërkesa ishte paraqitur nga 12 (dymbëdhjetë) deputetë të Kuvendit, në pajtueshmëri me nenin 113. 5 të Kushtetutës. Prandaj, parashtruesit e kërkesës janë palë e autorizuar.

79. Në vijim, Gjykata merr parasysh nenin 42 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili përcakton:

> *"1. Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 6, të Kushtetutës, ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme:*
> *1.1. emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit apo vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës;*
> *1.2. dispozitat e Kushtetutës apo të ndonjë akti apo ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe*
> *1.3. paraqitjen e provave mbi të cila mbështetet kontesti".*

80. Gjykata, po ashtu, i referohet rregullit 74 [Kërkesa në pajtim me nenin 113. 5 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit] të Rregullores së punës, që parasheh:

"[...]

(2) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli, duhet, inter alia, të paraqesë informatat e mëposhtme:

(a) emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e një ligji ose të një vendimi të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës;

(b) dispozitat e Kushtetutës ose të aktit tjetër ose legjislacionit relevant për këtë kërkesë; dhe

(c) provat mbi të cilat mbështetet kontesti.

(3) Parashtruesit i bashkëngjisin kërkesës një kopje të ligjit të kontestuar ose vendimit të miratuar nga Kuvendi, regjistrin dhe nënshkrimet personale të deputetëve që paraqesin kërkesën dhe autorizimin e personit që i përfaqëson ata para Gjykatës".

81. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës shënuan emrat e deputetëve me nënshkrime, paraqitën autorizimin për personin që i përfaqëson ata para Gjykatës, specifikuan vendimin që kontestojnë dhe dorëzuan kopjen e tij, iu referuan dispozitave relevante kushtetuese për të cilat ata pretendojnë se vendimi i kontestuar nuk është në pajtueshmëri dhe paraqitën prova dhe dëshmi për të mbështetur pretendimet e tyre. Andaj, Gjykata konsideron se kriteret e përcaktuara me nenin 42 të Ligjit dhe të specifikuara më tej me rregullin 74 të Rregullores së punës janë plotësuar.

82. Lidhur me afatin e përcaktuar prej *"8 (tetë) ditësh nga data e miratimit"*, Gjykata vëren se vendimi i kontestuar është miratuar më 4 qershor 2018, ndërsa kërkesa është parashtruar në Gjykatë më 12 qershor 2018.

83. Gjykata rikujton që, në pajtim me rregullin 30 (1) të Rregullores së punës, afati i fundit për dorëzimin e kërkesës, "*kur periudha shprehet me ditë, ajo duhet të llogaritet duke filluar nga dita pasuese pasi kishte ndodhur një ngjarje"*.

84. Në rastin e kërkesës së tanishme, kjo është dita e nesërme pas miratimit të vendimit të kontestuar. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa u parashtrua brenda afatit kohor të përcaktuar me nenin 113. 5 të Kushtetutës.

85. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se parashtruesit kanë respektuar kërkesat e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë e të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

86. Gjithashtu, Gjykata konsideron se kërkesa ngre çështje të rëndësishme kushtetuese lidhur me zgjedhjen dhe shkarkimin e nënkryetarëve të Kuvendit prandaj, rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesve është e pranueshme.

Meritat e kërkesës

87. Gjykata rikujton se parashtruesit pretendojnë se vendimi i kontestuar nuk është në pajtueshmëri me nenet 7 [Vlerat] dhe 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve], të Kushtetutës.

88. Në lidhje me kërkesën e parashtruesve, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës në thelb pretendojnë se pozita e nënkryetarit/es të Kuvendit, sipas nenit 67, paragrafi 3, të Kushtetutës, është e rezervuar ekskluzivisht për 3 (tri) grupet më të mëdha parlamentare, të cilat dalin nga partitë politike apo koalicionet që kanë fituar më së shumti ulëse në Kuvend si rezultat i zgjedhjeve për Kuvend. Ata shtojnë se përfaqësimi në Kryesinë e Kuvendit ka karakter politik dhe aty duhet të përfaqësohen 3 (tri) grupet më të mëdha parlamentare gjatë gjithë legjislaturës së Kuvendit.

89. Rrjedhimisht sipas tyre, vendimi i kontestuar, për mosshkarkimin e nënkryetares së Kuvendit, Aida Dërguti (tani si pjesë e një grupi të ri parlamentar), i mohon LVV-së, si subjekti i dytë më i votuar në zgjedhjet e 11 qershorit 2017, pozitën e nënkryetarit të Kuvendit, të garantuar me nenin 67, paragrafi 3 të Kushtetutës.

90. Për më tepër, sipas parashtruesve të kërkesës, duke pasur parasysh se e drejta ekskluzive për tu përfaqësuar në kryesinë e Kuvendit i takon 3 (tri) grupeve më të mëdha parlamentare, votimi i deputetëve për mos shkarkimin e nënkryetares, përbën abuzim me “drejtën e tyre për votim”.

Përkitazi me nenin 67, paragrafi 3, të Kushtetutës

91. Gjykata fillimisht do të vlerësojë nëse dispozitat e nenit 67, paragrafi 3, të Kushtetutës, dhe dispozitat e tjera të ndërlidhura, i japin të drejtë grupeve të caktuara parlamentare që gjatë gjithë legjislaturës të përfaqësohen në kryesinë e Kuvendit me deputetë që i përkasin grupit parlamentar që i ka propozuar.

92. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se neni 67, paragrafi 3, i Kushtetutës rregullon çështjen e propozimit dhe votimit të propozimit të nënkryetarëve të Kuvendit, duke përcaktuar se *"3 (tre) nënkryetarët të propozuar nga tri grupet më të mëdha parlamentare, zgjedhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit"*.

93. Sipas dispozitës së cekur më lart, për zgjedhjen e 3 (tre) nënkryetarëve, duhet të plotësohen dy kushte, dhe atë, *a)* të propozohen nga tri grupet më të mëdha parlamentare dhe *b)* të marrin votat e shumicës së të gjithë deputetëve të Kuvendit.

94. Sa i përket kushtit të parë, Gjykata vëren se Kushtetuta, në nenin 67, paragrafi 3, në mënyrë të qartë përcakton se e drejta për të propozuar 3 (tre) kandidatë për pozita të nënkryetarëve u takon ekskluzivisht 3 (tri) grupeve më të mëdha parlamentare. Gjykata vlerëson se e drejta e 3 (tri) grupeve më të mëdha parlamentare për të propozuar kandidatët për pozitën e nënkryetarit të Kuvendit është thelbësore për ruajtjen e themeleve të një demokracie efektive dhe kuptimplotë në konstituimin e Kuvendit, të qeverisur nga sundimi i ligjit. Rrjedhimisht, Gjykata vëren se përderisa e drejta e propozimit u takon 3 (tri) grupeve me te mëdha parlamentare, këto grupe jo detyrimisht janë të kufizuara që të propozojnë kandidatë nga grupi i tyre parlamentar. Gjykata vë në pah se paragrafi 3, i nenit 67 të Kushtetutës, mundëson një liri të gjerë të propozimit të kandidatit për pozitën e nënkryetarit të Kuvendit duke mos kufizuar propozimin nga një grup i caktuar parlamentar.

95. Për dallim nga gjuha e paragrafit 3 të nenit 67 që mundëson liri më të gjerë të propozimit, në paragrafin 4 të nenit 67, të Kushtetutës shprehimisht përcaktohet se *"2 (dy) nënkryetarë përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë në Kuvend, dhe ata zgjedhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve"*. Me tutje, në të njëjtin paragraf, Kushtetuta shprehimisht përcakton se "n*jëri nënkryetar do të jetë nga radhët e deputetëve të Kuvendit që mbajnë vendet të rezervuara ose të garantuara të komunitetit serb, dhe tjetri nënkryetar nga radhët e deputetëve të Kuvendit që mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara nga komunitetet tjera që nuk janë shumicë.*"

96. Ndërsa, sa i përket kushtit të dytë, Gjykata rikujton se për t'u konsideruar të zgjedhur të propozuarit nga grupet parlamentare nuk zgjedhen automatikisht nënkryetarë të Kuvendit pas propozimit të grupeve parlamentare por i nënshtrohen procesit të votimit në Kuvend. Të propozuarit e grupeve parlamentare zgjedhen nënkryetarë

të Kuvendit vetëm nëse marrin votat e shumicës së të gjithë deputetëve të Kuvendit. Andaj, nënkryetarët e Kuvendit, megjithëse propozohen nga grupe të caktuara parlamentare, ata janë të zgjedhurit e Kuvendit, për të ushtruar pozitën e nënkryetarit të Kuvendit, përveç nëse shkarkohen apo nëse humbin mandatin e tyre të deputetit në bazë të dispozitave të Kushtetutës apo dispozitave tjera të ndërlidhura.

97. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton nenin 67, paragrafi 6, të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"Kryetari dhe nënkryetarët formojnë Kryesinë e Kuvendit. Kryesia është përgjegjëse për funksionimin administrativ të Kuvendit në mënyrën e përcaktuar me Rregulloren e punës të Kuvendit".*

98. Pas përfundimit të procesit të votimit, anëtarët e Kryesisë së Kuvendit, në cilësinë e tyre si nënkryetarë të Kuvendit, nuk përfaqësojnë interesat e grupeve parlamentare që i kanë propozuar ata, por para së gjithash përfaqësojnë interesat e Kuvendit si tërësi, duke siguruar funksionimin e Kuvendit dhe të organeve të tij. Prandaj, Gjykata vlerëson se, sipas paragrafit 6 të nenit 67 të Kushtetutës, anëtarët e Kryesisë së Kuvendit, nuk janë përfaqësues të grupeve parlamentare apo të partive politike në këtë organ dhe në cilësinë e anëtarit të Kryesisë së Kuvendit nuk janë të thirrur që të mbrojnë interesat e grupeve parlamentare apo të partive politike të Kuvendit.

99. Kjo, për më tepër, duke pasur parasysh edhe faktin që numri i nënkryetarëve të Kuvendit është i përcaktuar shprehimisht me Kushtetutë dhe jo të gjitha grupet parlamentare apo partitë politike kanë të drejtë të propozojnë kandidatë për nënkryetar të Kuvendit, por kjo e drejtë u njihet vetëm 3 (tri) grupeve më të mëdha parlamentare.

100. Për më tepër, Gjykata rikujton po ashtu nenin 16, paragrafët 2 dhe 5 të Rregullores së punës së Kuvendit, që përcaktojnë:

> *"2. Kryetari i Kuvendit e thërret mbledhjen e Kryesisë, nëse kërkohet nga një grup parlamentar ose së paku nga pesë (5) për qind, përkatësisht nga gjashtë (6) deputetë të Kuvendit"*
>
> *[...]*
>
> *"5. Kryesia e Kuvendit, për çështje të caktuara, i fton në mbledhjet e Kryesisë edhe kryetarët e grupeve parlamentare".*

101. Gjykata vëren se, sipas Kushtetutës dhe Rregullores së punës së Kuvendit, për çështje të caktuara që prekin interesat e grupeve parlamentare në Kryesinë e Kuvendit, të gjitha grupet parlamentare përfaqësohen nga kryetarët e grupeve parlamentare.

102. Gjykata, po ashtu, vëren se në vendet demokratike ka praktika të ndryshme në lidhje me zgjedhjen dhe shkarkimin e nënkryetarëve të Kuvendit. Megjithatë, në të gjitha shtetet që kanë dërguar përgjigje në lidhje me pyetjet e Gjykatës Kushtetuese drejtuar gjykatave kushtetuese përmes Forumit të Komisionit të Venecias, me përjashtim të Bullgarisë ku një gjë e tillë është e definuar në mënyrë specifike me Rregulloren e punës së Kuvendit, dalja nga një grup i caktuar parlamentar nuk nënkupton edhe largimin automatik nga pozita e nënkryetarit. Andaj, në praktikën e këtyre vendeve, për shkarkimin e nënkryetarëve të Kuvendit, kërkohet votim i veçantë dhe numër i caktuar i votave që një shkarkim i tillë të realizohet.

103. Për më tepër, në lidhje me pretendimin e parashtruesve të kërkesës së pozita e nënkryetarit/es të Kuvendit, sipas nenit 67, paragrafi 3 të Kushtetutës, është e rezervuar ekskluzivisht për (3) tri grupet më të mëdha parlamentare, të cilat dalin nga votat e partive politike apo koalicioneve që kanë fituar ulëse në Kuvend si rezultat i zgjedhjeve për Kuvend, Gjykata i referohet rastit KO119/14, ku kishte konstatuar se *"grupi me i madh parlamentar, sipas nenit 67 (2) të Kushtetutës, duhet të konsiderohet partia, koalicioni, iniciativa qytetare dhe kandidatë të pavarur që kane më shume vende në Kuvend, në kuptim të nenit 64 (1) të Kushtetutës, se çdo tjetër parti, koalicion, iniciative qytetare dhe kandidatë të pavarur që kanë marrë pjesë si të tille në zgjedhje"*. (shih Aktgjykimin në rastin KO119/14, Parashtrues *Xhavit Haliti dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, paragrafi 116).

104. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se si rezultat i zgjedhjeve për Kuvend të mbajtura më 11 qershor 2017, LVV-ja, si grupi i dytë më i madh parlamentar, siguroi të drejtën për të propozuar kandidatin për pozitën e nënkryetarit të Kuvendit. Në bazë të kësaj të drejte, LVV-ja propozoi znj. Aida Dërguti si kandidate për pozitën e nënkryetares së Kuvendit, e cila mori votat e nevojshme për të qenë anëtare e Kryesisë.

105. Megjithatë, Gjykata vlerëson se neni 67, paragrafi 3, i Kushtetutës përcakton që 3 (tri) grupet më të mëdha parlamentare në fillim të legjislaturës kanë të drejtën e propozimit të kandidatëve për nënkryetarë të Kuvendit. Megjithatë, pas zgjedhjes së kandidatëve të propozuar për nënkryetarë, e drejta e grupeve parlamentare për të propozuar kandidatë për nënkryetarë rilind vetëm nëse ndonjë nga

nënkryetarët e humb mandatin e deputetit sipas nenit 70 të Kushtetutës, apo nëse shkarkohet sipas procedurës së përcaktuar në nenin 67, paragrafi 5, të Kushtetutës.

106. Bazuar në atë që u tha më sipër, Gjykata konsideron se pretendimi i parashtruesve të kërkesës se pozita e nënkryetarit/es të Kuvendit, sipas nenit 67, paragrafi 3, të Kushtetutës, është e rezervuar ekskluzivisht për 3 (tri) grupet më të mëdha parlamentare të cilat dalin nga votat e partive politike apo koalicioneve që kanë fituar ulëse në Kuvend si rezultat i zgjedhjeve për Kuvend, nuk është e bazuar.

Përkitazi me procedurën e ndjekur për shkarkimin e nënkryetares së Kuvendit

107. Në vijim, Gjykata rikujton se shkarkimi i nënkryetarëve të Kuvendit është e rregulluar me dispozitat specifike të Kushtetutës, konkretisht me nenin 67, paragrafi 5, të Kushtetutës, që përcakton se *"Kryetari dhe nënkryetarët e Kuvendit shkarkohen me votën e shumicës prej dy të tretave (2/3) të numrit të përgjithshëm të deputetëve"*.

108. Rrjedhimisht, për shkarkimin e nënkryetarëve të Kuvendit është e nevojshme që të plotësohen kërkesat e nenit 67, paragrafi 5, të Kushtetutës.

109. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se sipas paragrafit 5 të nenit 67 të Kushtetutës, është paraparë që nënkryetarët e Kuvendit shkarkohen me shumicën prej dy të tretave (2/3) të numrit të përgjithshëm të deputetëve, për dallim nga paragrafi 3, i nenit 67, që parasheh se për zgjedhjen e tyre kërkohet vota e shumicës së të gjithë deputetëve.

110. Në rastin e kërkesës, Gjykata rikujton se LVV-ja kishte paraqitur propozimin për shkarkimin e nënkryetares së Kuvendit, Aida Dërguti.

111. Më 19 prill 2018, Kryesia e Kuvendit shqyrtoi dhe vendosi këtë propozim në rend të ditës për seancë.

112. Gjykata, po ashtu, rikujton se pas diskutimeve të 1 qershorit 2018, që ishin zhvilluar në lidhje me propozimin e LVV-së, më 4 qershor 2018, Kuvendi votoi në lidhje me propozimin e LVV-së, ku në sallë ishin të pranishëm 94 (nëntëdhjetë e katër) deputetë, me ç 'rast u konstatua se ka kuorum për vendimmarrje. Nga ta, 16 (gjashtëmbëdhjetë) deputetë kishin votuar për propozimin e LVV-së, 26 (njëzetë e gjashtë) deputetë kishin votuar kundër, dhe 47 (dyzetë e shtatë) deputetë kishin abstenuar.

113. Si përfundim, Gjykata konstaton se, në rastin konkret, propozimi i LVV-së nuk mori votat e nevojshme, dhe rrjedhimisht nuk u plotësuan kushtet për shkarkimin e Aida Dërgutit nga pozita e nënkryetares së Kuvendit, ashtu siç përcaktohet shprehimisht me nenin 67, paragrafi 5, të Kushtetutës.

Përkitazi me pretendimin e parashtruesve për "abuzimin me të drejtën e votimit"

114. Në vazhdim, Gjykata rikujton edhe një herë që parashtruesit pretendojnë se, sipas nenit 67 të Kushtetutës, pozitat e nënkryetarëve të Kuvendit janë të rezervuara ekskluzivisht për 3 (tri) grupet më të mëdha parlamentare, dhe si rrjedhojë *"[r]efuzimi i shkarkimit të nënkryetares në fjalë, e cila nuk e përfaqëson më fuqinë politike dhe votën demokratike siç e parasheh Kushtetuta është abuzim me të drejtën e votimit dhe cenon qëllimin kushtetues që qëndron"*.

115. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton që ajo ka konstatuar më lart se sipas nenit 67, paragrafi 3, të Kushtetutës, nuk është i garantuar përfaqësimi i 3 (tri) grupeve më të mëdha parlamentare në Kryesinë e Kuvendit, por është e garantuar e drejta e tyre për propozimin e kandidatëve për pozitën e nënkryetarit, të cilët më pas votohen nga Kuvendi.

116. Rrjedhimisht, me rastin e votimit për propozimin për shkarkimin e nënkryetares znj. Aida Dërguti, Kuvendi nuk ka vepruar në papajtueshmëri me nenin 67 të Kushtetutës.

117. Për më tepër, në lidhje me votimin në Kuvend, Gjykata i referohet paragrafit 1 të nenit 70 [Mandati i Deputeteve] të Kushtetutës, që përcakton:

> *"1. Deputetët e Kuvendit janë përfaqësues të popullit dhe nuk i nënshtrohen asnjë mandati detyrues"*.

118. Gjykata, po ashtu, i referohet nenit 74 [Ushtrimi i Funksionit] të Kushtetutës, që përcakton:

> "*Deputetët e Kuvendit të Kosovës ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me këtë Kushtetutë, ligjet dhe rregullat e procedurës së Kuvendit*".

119. Gjykata, po ashtu, rikujton nenin 3 [Mandati i Lirë] të Ligjit nr. 03/L-111 për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit (publikuar në Gazetën Zyrtare, më 20 korrik 2010), i cili parasheh:

"1. Deputeti është përfaqësues i qytetarëve dhe gjatë mandatit të tij i nënshtrohet vetëm ndërgjegjes së tij.
2. Deputeti i ushtron detyrat e tij në pajtim me dispozitat kushtetuese, ligjin dhe me Rregulloren e punës së Kuvendit".

120. Gjykata, gjithashtu, i referohet edhe paragrafëve 4 dhe 6 të nenit 51 [Kuorumi dhe votimi në mbledhjet e Kuvendit] të Rregullores së punës së Kuvendit që përcaktojnë:

"4. Votimi bëhet në këto mënyra:

e) votimi i hapur, me ngritje të dorës: "për", "kundër" dhe "abstenim",
f) votimi i fshehtë ose
g) votimi i regjistruar, që e përfshin votimin elektronik dhe
h) votimin duke e thirrur secilin deputet, veç e veç.

[...]
6. Kur kemi numër të barabartë të votave "për" dhe "kundër" konstatohet se propozimi nuk është miratuar."

121. Në lidhje me këtë, Gjykata gjithashtu rikujton praktikën e saj gjyqësore ku kishte konstatuar se "*në konstituimin e Kuvendit, të gjithë deputetët duhet të jenë të pranishëm dhe të votojnë si të dëshirojnë, në mënyrë të hapur ose të fshehtë, të votojnë "për", "kundër" ose të "abstenojnë", dhe nuk mund të lirohen nga të vepruarit kështu".* (shih rastin KO119/14, Parashtrues *Xhavit Haliti dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës përkitazi me vlerësimin e kushtetutshmërisë se Vendimit nr. 05-V-001, të votuar nga 83 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës,* Aktgjykim i 17 korrikut 2014, paragrafi 128).

122. Duke pasur parasysh atë që u tha më sipër, Gjykata konsideron se deputetët kanë për obligim të marrin pjesë në punimet e Kuvendit, duke përfshirë edhe pjesëmarrjen e tyre në votim përkitazi me propozimet e paraqitura në bazë të Kushtetutës dhe rregullave tjera të ndërlidhura. Megjithatë, Gjykata rithekson se deputetët janë të lirë të vendosin se si do të votojnë në lidhje me propozimet që janë paraqitur para tyre dhe mund të votojnë për, kundër apo të abstenojnë duke marrë parasysh interesin më të mirë të Shtetit në pajtim me Kushtetutën dhe rregullat e tjera.

123. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron që pretendimi i parashtruesve të kërkesës se refuzimi i shkarkimit të nënkryetares në fjalë, e cila nuk e

përfaqëson më fuqinë politike dhe votën demokratike siç e parasheh Kushtetuta *"është abuzim me të drejtën e votimit dhe cenon qëllimin kushtetues që qëndron prapa dispozitave që e rregullojnë përbërjen e Kryesisë së Kuvendit"* nuk është i bazuar.

124. Në fund, Gjykata po ashtu rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Kuvendi, duke mos votuar propozimin e LVV-së për shkarkimin e nënkryetares së Kuvendit, ka shkelur po ashtu nenin 7 [Vlerat] të Kushtetutës. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës nuk kanë paraqitur ndonjë dëshmi dhe as nuk e kanë mbështetur pretendimin e tyre për shkelje të këtij neni të Kushtetutës.

Përfundim

125. Si përfundim, Gjykata konstaton që pretendimi i parashtruesve të kërkesës se pozita e nënkryetarit/es të Kuvendit sipas nenit 67, paragrafi 3, të Kushtetutës, është e rezervuar ekskluzivisht për 3 (tri) grupet më të mëdha parlamentare të cilat dalin nga votat e partive politike apo të koalicioneve, që kanë fituar ulëse në Kuvend si rezultat i zgjedhjeve për Kuvend, nuk është i bazuar.

126. Gjykata, po ashtu, konstaton që pretendimi i parashtruesve të kërkesës se refuzimi i shkarkimit të nënkryetares në fjalë, e cila nuk e përfaqëson më fuqinë politike dhe votën demokratike siç e parasheh Kushtetuta *"është abuzim me të drejtën e votimit dhe cenon qëllimin kushtetues që qëndron prapa dispozitave që e rregullojnë përbërjen e Kryesisë se Kuvendit",* nuk është i bazuar.

127. Rrjedhimisht, Gjykata gjen se Vendimi nr. 06/V-145 i Kuvendit të Republikës së Kosovës përkitazi me Propozimin e Grupit Parlamentar të LVV, për shkarkimin e Aida Dërgutit nga pozita e nënkryetares së Kuvendit të Republikës së Kosovës, është në pajtueshmëri me nenet 7 [Vlerat] dhe 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve] të Kushtetutës.

Kërkesa për masë të përkohshme

128. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës gjithashtu kërkojnë nga Gjykata që të nxjerrë vendim për caktimin e masës së përkohshme, përkatësisht *"pezullimin e ushtrimit të funksionit të nënkryetares së Kuvendit të Kosovës [Aida Dërguti]"*.

129. Gjykata më sipër ka konkluduar se vendimi i kontestuar është në pajtueshmëri me nenet 7 [Vlerat] dhe 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve] të Kushtetutës.

130. Prandaj, në pajtim me nenin 27. 1 [Masat e Përkohshme] të Ligjit dhe me rregullin 57 [Vendimi për masë të përkohshme] të Rregullores së punës, kërkesa për masë të përkohshme, është pa objekt shqyrtimi dhe, si e tillë, refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 113.5 dhe 116.2 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 42 të Ligjit dhe në mbështetje të rregullit 59 (1) (a) të Rregullores së punës, më 3 dhjetor 2018,

VENDOS

I. TË DEKLAROJË, njëzëri, kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË, me shumicë votash, që Vendimi nr. 06/V-145 i Kuvendit të Republikës së Kosovës përkitazi me Propozimin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje! për shkarkimin e Aida Dërgutit nga pozita e nënkryetares së Kuvendit të Republikës së Kosovës, është në pajtueshmëri me nenet 7 [Vlerat] dhe 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve] të Kushtetutës;

III. TË REFUZOJË, njëzëri, kërkesën për masë të përkohshme;

IV. T'UA KUMTOJË këtë aktgjykim parashtruesve të kërkesës, Presidentit të Republikës së Kosovës, Kryetarit të Kuvendit të Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës;

V. TË PUBLIKOJË këtë aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit; dhe

VI. TË SHPALLË që ky aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Remzije Istrefi-Peci Arta Rama-Hajrizi

KI 122/16 Parashtrues: Riza Dembogaj, i cili kërkon vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktvendimit CML. nr. 6/2016 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, të 13 shtatorit 2016

Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi [CML. nr. 6/2016] i 13 shtatorit 2016 i Gjykatës Supreme, ishte nxjerrë në shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje më nenin 6 të KEDNJ-së, nenin 49 të Kushtetutës, nenin 54 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së dhe 102 të Kushtetutës, sepse gjykatat e rregullta kishin zbatuar ligjin e gabuar në vlerësimin e afateve kohore të padisë së tij. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta kishin aplikuar dhe interpretuar qartazi gabimisht ligjin në rastin e tij.
Marrëdhënia e punës së parashtruesit të kërkesës me Inspektoratin Policor të Kosovës ishte ndërprerë në vitin 2007. Parashtruesi e ka kontestuar vendimin për ndërprerje që nga viti 2007, fillimisht në procedurën administrative dhe më pas në procedurë gjyqësore, të cilën ai e kishte iniciuar më 7 nëntor 2007. Data e fillimit të procedurave gjyqësore, domethënë afatet e ankesës së tij, iu nënshtruan shqyrtimit të tetë vendimeve të gjykatave të rregullta, të cilat zbatuan tri ligje të ndryshme, të gjitha përmbanin afate të ndryshme për paraqitjen e ankesave, në kontestin e parashtruesit. Në fund, me refuzimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë së Prokurorit të Shtetit, Gjykata Supreme konkludoi se kërkesa fillestare e parashtruesit ishte e paafatshme, megjithëse e arsyetonte atë në bazë të Ligjit për KPMK-në e vitit 2010, jo në fuqi kur kishte filluar kontesti i parashtruesit të kërkesës.
Pas vlerësimit të rastit në tërësi, Gjykata konstatoi se në rastin e parashtruesit të kërkesës, ligji ishte aplikuar qartazi në mënyrë të gabuar dhe kishte rezultuar në përfundime arbitrare për parashtruesin e kërkesës. Prandaj, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata konstatoi se ishin shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI122/16

Parashtrues

Riza Dembogaj

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit CML. nr. 6/2016 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, të 13 shtatorit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Riza Dembogaj nga fshati Llabjan, Komuna e Pejës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin [CML. nr. 6/2016] e 13 shtatorit 2016 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, përmes të cilit është refuzuar, si e pabazuar, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e ushtruar nga Prokurori i Shtetit kundër Aktvendimit [C.nr.437/2015] të 25 janarit 2016 të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar, me të cilin, siç pretendohet, parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në lidhje më nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ), nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës, nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] në lidhje me 13 nenin (E drejta për mjet efektiv) të KEDNJ-së dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i

kërkesës], 47 [Kërkesa Individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 21 tetor 2016, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 14 nëntor 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Bekim Sejdiu.

7. Më 21 nëntor 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai t'i dorëzojë vendimet e kontestuara në Gjykatë. Njëkohësisht, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

8. Më 29 nëntor 2016, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë Aktvendimin [C. Nr. 437/15] të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe parashtresën me të cilën e precizoi më tej kërkesën e tij.

9. Më 26 janar 2017, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që t'i dorëzoj të gjitha vendimet përkatëse.

10. Më 31 janar 2017, parashtruesi i kërkesës plotësoi kërkesën dhe dorëzoi në Gjykatë vendimet e Gjykatës së Qarkut dhe Gjykatës së Apelit, si dhe kërkesat e dorëzuara në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPMK) dhe kërkesën e Prokurorit të Shtetit për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatës Supreme.

11. Më 6 shkurt 2018, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës KPMK-së duke kërkuar dokumentacionin e plotë lidhur me rastin e parashtruesit të kërkesës dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë duke kërkuar dosjen e plotë të lëndës.

12. Më 8 shkurt 2018, Gjykata Themelore në Prishtinë e njoftoi Gjykatën që, sipas ankesës së parashtruesit të kërkesës të 5 dhjetorit 2016, kjo lëndë gjendet në Gjykatën e Apelit.

13. Më 9 shkurt 2018, KPMK-ja dorëzoi në Gjykatë dosjen e plotë të lëndës.

14. Më 26 shkurt 2018, Gjykata kërkoi nga Gjykata e Apelit informata lidhur me statusin e lëndës së parashtruesit të kërkesës në Gjykatën e Apelit.

15. Më 2 mars 2018, Gjykata e Apelit i dorëzoi Gjykatës informata se sipas ankesës së parashtruesit të kërkesës të 5 dhjetorit 2016, kjo lëndë gjendet në Gjykatën e Apelit.

16. Më 7 mars 2018, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që të dorëzoj informata lidhur me statusin e ankesës së tij në gjykatat e rregullta.

17. Më 19 mars 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë Aktvendimin [CA. nr. 4504/2016] të 9 marsit 2018 të Gjykatës së Apelit.

18. Më 30 maj 2018, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

19. Më 01 maj 2007, parashtruesi i kërkesës ka nënshkruar kontratë për periudhë tre vjeçare, përkatësisht deri me 1 Maj 2010, si Inspektor Policor në Njësinë e Hetimeve në Inspektoratin Policor të Kosovës, me statusin e shërbyesit civil. (në tekstin e mëtejmë: IPK).

20. Më 04 maj 2007, parashtruesi i kërkesës kishte dorëzuar dorëheqjen nga Shërbimi Policor i Kosovës (në tekstin e mëtejmë: SHKP), ku kishte punuar për disa vite me radhë para fillimit të punës si Inspektor Policor në IPK. Në bazë të shkresave të lëndës, rezulton se para dorëheqjes, parashtruesi i kërkesës kishte qenë nën hetime nga Njësiti për Standarde Profesionale në kuadër të SHPK-së.

21. Më 28 maj 2007, IPK e njoftoi parashtruesin e kërkesës se ai është suspenduar përkohësisht deri në hetimin përfundimtar në lidhje me përfshirjen e tij të mundshme në shkeljen e rëndë disiplinore në SHPK. Më 31 maj 2007, parashtruesi i kërkesës kishte dorëzuar ankesë kundër suspendimit të përkohshëm.

22. Më 13 qershor 2007, IPK nxori Vendimin nr. 1306/2007 (në tekstin e mëtejmë: Vendimi) për shkëputjen e kontratës së punës me parashtruesin e kërkesës, me arsyetimin se informatat e siguruara

gjatë procesit të verifikimit të së kaluarës kanë treguar se parashtruesi i kërkesës ka qenë në hetime nga Njësiti i Standardeve Profesionale të SHPK-së për shkelje të rënda disiplinore.

Procedura administrative

23. Më 18 qershor 2007, parashtruesi i kërkesës i paraqiti ankesë menaxhmentit të personelit të Ministrisë së Punëve të Brendshme (në tekstin e mëtejmë: MPB), në të cilën ai, sipas pretendimit, nuk mori asnjëherë përgjigje. Të njëjtën ditë, parashtruesi i kërkesës gjithashtu paraqiti ankesë pranë KPMK-së, duke pretenduar se ndërprerja e marrëdhënies së punës është bërë në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm.

24. Më 21 qershor 2007, parashtruesi i kërkesës ka bërë kërkesë për ripunësim në SHPK, e drejtë kjo, që sipas dispozitave përkatëse ligjore, brenda një periudhe të caktuar kohore u mundësohet pjesëtarëve të SHPK-së të cilët vullnetarisht e kanë lëshuar shërbimin. Më 06 shtator 2007, kërkesa e tij u refuzua nga SHKP, me arsyetimin se në rast të dorëheqjes gjatë procesit të hetimit, bazuar mbi parimet e udhëzuesit të SHPK-së, ish-pjesëtarëve të SHPK-së nuk mund të u miratohen kërkesat për rikthim në shërbim.

25. Më 14 gusht 2007, KPMK përmes Vendimit [02/259/207] hodhi poshtë ankesën e parashtruesit të kërkesës si të parakohshme dhe e detyroi IPK-në ta shqyrtojë ankesën e parashtruesit të kërkesës të paraqitur menaxhmentit të personelit dhe të merr vendimin meritor lidhur me çështjen. Në arsyetimin e vendimit, KPMK u bazua në dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja 2001/36).

26. Më 24 gusht 2007, parashtruesi i kërkesës iu drejtua edhe një herë menaxhmentit të personelit në MPB, por edhe dorëzoi një kërkesë shtesë për rishqyrtim të vendimit në KPMK.

27. Më 29 gusht 2007, duke marrë parasysh që parashtruesi i kërkesës, sipas pretendimit, asnjëherë nuk kishte marrë përgjigje në ankesën e bërë në MPB, ai përsëri i drejtohet KMPK-së me ankesë, duke pretenduar sërish se ndërprerja e marrëdhënies së punës së tij me IPK-në, ishte bërë në shkelje të ligjit të aplikueshëm.

28. Më 6 nëntor 2007, pasi që MPB edhe më tej nuk është përgjigjur në ankesë, parashtruesi i kërkesës i është drejtuar përsëri KPMK-së me kërkesë për rishqyrtimin e rastit. Sipas parashtruesit te kërkesës, ai asnjëherë nuk morri përgjigje në ankesën e tij as nga KMPK-ja.

Grupi i Parë i Procedurave në Gjykata

29. Më 7 dhjetor 2007, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë, duke pretenduar se në ndërprerjen e marrëdhënies së punës së tij me IPK, ishte shkelur Rregullorja 2001/36 dhe udhëzimet administrative përkatëse, dhe rrjedhimisht Vendimi ishte i kundërligjshëm.

30. Më 9 korrik 2008, Gjykata Komunale në Prishtinë përmes Aktgjykimit [Cl. 520/2007] e aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës si të bazuar, duke e shpallur Vendimin e IPK-së si të kundërligjshëm, ndër të tjera me arsyetimin se, nuk ishte zbatuar procedura për ndërprerjen e marrëdhënies së punës gjatë periudhës provuese. Gjykata Komunale përmes këtij Aktgjykimi kishte detyruar MPB-në që parashtruesin e kërkesës të kthej në vendin e punës dhe të ia kompensojë të ardhurat për periudhën dhe në mënyrën e përcaktuar më Aktgjykim në fjalë. Në arsyetimin e Aktgjykimit në fjalë, Gjykata Komunale ishte bazuar në dispozitat e Rregullores 2001/36.

31. Kundër këtij Aktgjykimi, IPK paraqiti ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, duke kërkuar që të ndryshohet Aktgjykimi i atakuar dhe të refuzohet kërkesëpadia e paditësit, përkatësisht, parashtruesit të kërkesës si e pabazuar, ose të anulohet Aktgjykimi dhe çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim.

32. Me 6 prill 2009, sipas shkresave të lëndës, gati dy vite pas paraqitjes së ankesës, KPMK përmes Vendimit [02/278/07] e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pa bazë dhe vërtetoi Vendimin e Kryeshefit Ekzekutiv të IPK-së [Nr. 1306/2007] të datës 13 qershor 2007, si të ligjshëm. KPMK, duke u bazuar në nenin 11.1 të Regullores së UNMIK-ut 2008/12 për ndryshimin e Rregullores 2001/36, ndër të tjera, arsyetoi se procedura e ndërprerjes së marrëdhënies së punës gjatë periudhës provuese është zhvilluar konform dispozitave të aplikueshme ligjore. KPMK arsyetoi se dispozitat ligjore qartë përcaktojnë se autoriteti punëdhënës mund ta ndërpresë marrëdhënien e punës gjatë periudhës provuese nëse "*informatat e siguruara gjatë procesit të rekrutimit janë vërtetuar si të pavërteta*".

33. Më 12 janar 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 199/2009] e aprovoi ankesën e IPK-së, anuloi Aktgjykimin

[C1. 520/2007] e 9 korrikut 2008 të Gjykatës Komunale në Prishtinë, dhe e ktheu çështjen për rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë.

34. Gjykata e Qarkut anulimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale e arsyetoi, ndër të tjera, duke u bazuar në lejueshmërinë dhe afatshmërinë e ankesës. Sipas Gjykatës, bazuar në nenin 83 të Ligjit mbi të Drejtat Themelore të Marrëdhënies së Punës në fuqi (Publikuar në "Gazetën Zyrtare të RSFJ-së", Nr. 60/89, 42/90 dhe "Gazeta Zyrtare e RFJ-së", nr. 42/92, 24/94) (në tekstin e mëtejmë: Ligji i Punës), afati i ngritjes së padisë në gjykatën kompetente ishte 15 ditë pas përfundimit të afatit 30 ditorë për nxjerrjen e vendimit nga organi kompetent, dhe rrjedhimisht, ankesa e paditësit, përkatësisht parashtruesit të kërkesës ishte e pasafatshme.

Grupi i Dytë i Procedurave në Gjykata

35. Më 30 tetor 2012, Gjykata Themelore në Prishtinë, përmes Aktgjykimit [C. nr. 290/12], shpalli padinë e paditësit, përkatësisht parashtruesit të kërkesës, si të afatshme, dhe sërish e aprovoi kërkesëpadinë si të bazuar, duke e shpallur vendimin e IPK-së si të kundërligjshëm, ndër të tjera me arsyetimin se nuk ishte zbatuar procedura për ndërprerjen e marrëdhënies së punës gjatë periudhës provuese. Përmes Aktgjykimit në fjalë, Gjykata e detyroi IPK-në që parashtruesin e kërkesës të kthej ne vend të punës dhe t'ia kompensojë të ardhurat për periudhën dhe në mënyrën e përcaktuar me Aktgjykimin në fjalë. Në arsyetimin e Aktgjykimit në fjalë, Gjykata Komunale ishte bazuar në dispozitat e Rregullores 2001/36.

36. Më 27 dhjetor 2012, kundër Aktgjykimit [C. nr. 290/12] të Gjykatës Themelore, IPK paraqiti ankesë duke pretenduar shkelje së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, duke kërkuar që të ndryshohet Aktgjykimi i atakuar dhe të refuzohet kërkesëpadia e paditësit, përkatësisht parashtruesit të kërkesës si e pabazuar, ose të anulohet Aktgjykimi dhe çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim.

37. Më 12 shkurt 2015, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [CA. nr. 1977/2013] e aprovoi ankesën e IPK-së dhe e prishi Aktgjykimin [C. nr. 290/2012] e 30 tetorit 2012 të Gjykatës Themelore dhe e ktheu çështjen në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim. Gjykata e Apelit ndër të tjera kishte argumentuar që Gjykata Themelore, në shpalljen si të kundërligjshëm të vendimit të IPK-së për shkëputjen e kontratës së parashtruesit të kërkesës do të duhej të merrte parasysh edhe Vendimin [02/278/07] e 6 prillit 2009 të KPMK-së, i cili ishte nxjerrë

në ndërkohë. Në arsyetimin e Aktgjykimit në fjalë, Gjykata e Apelit kishte sqaruar specifikisht që në kontestin në fjalë aplikohen dispozitat e Rregullores 2001/36.

Grupi i Tretë i Procedurave në Gjykata

38. Më 25 janar 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë përmes Aktvendimit [C. nr. 437/15] hodhi poshtë padinë e parashtruesit të kërkesës si të pasafatshme. Gjykata Themelore në Prishtinë, duke i referuar nenit 83 të Ligjit të Punës, arsyetoi se parashtruesi i kërkesës kishte pasur në dispozicion vetëm 15 ditë për ushtrimin e padisë, pas afatit 30 ditorë në kuadër të cilit organi kompetent do të ketë marrë një vendim.

39. Më 3 mars 2016, parashtruesi i kërkesës iu drejtua Gjykatës Themelore, me kërkesë për kthimin në gjendjen e mëparshme lidhur me Aktvendimin e datës 25 janar 2016, duke arsyetuar se avokati nuk ia kishte dorëzuar shkresat me kohë, dhe rrjedhimisht, kishte humbur afatin e atakimit të Aktvendimit të 25 janarit 2016 në Gjykatën e Apelit.

40. Më 07 mars 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë përmes Aktvendimit [Cnr 437/15], e refuzoj kërkesën e parashtruesit të kërkesës për kthim në gjendjen e mëparshme. Këtë Aktvendim, parashtruesi i kërkesës e atakoj në Gjykatën e Apelit.

41. Më 9 mars 2018, Gjykata e Apelit hodhi poshtë si të papranueshme ankesën e parashtruesit të kërkesës kundër Aktvendimit [C. nr. 437/15] të 7 marsit 2016, me të cilin ishte hedhur poshtë kërkesa e parashtruesit për kthim në gjendjen e mëparshme.

Kërkesa për Mbrojtjen e Ligjshmërisë

42. Më 12 prill 2016, Prokurori i Shtetit të Kosovës, sipas kërkesës së parashtruesit të kërkesës, ushtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë (KMLC. nr. 20/2016) kundër Aktvendimit [C. nr. 437/15] të 25 janarit 2016 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke argumentuar se Gjykata Themelore ka aplikuar ligjin e gabueshëm në Aktgjykimin e saj. Sipas Prokurorit të Shtetit, po të aplikohej rregullativa ligjore e saktë, Rregullorja 2001/36 në vend të Ligjit të Punës, ankesa e parashtruesit të kërkesës do të duhej të shpallej e afatshme dhe do të shqyrtoheshin meritat e kërkesëpadisë së tij.

43. Më 13 shtator 2016, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [CML. nr. 6/2016] refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë së

Prokurorit të Shtetit. Gjykata Supreme arsyetoi Aktvendimin e saj me faktin se padia fillestare e parashtruesit të kërkesës në Gjykatën Komunale në Prishtinë ishte dorëzuar pas afatit. Megjithatë, Gjykata Supreme theksoi se në kontestin konkret nuk aplikohet Ligji i Punës, por Rregullorja 2001/36 edhe Ligji Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i vitit 2010 (në tekstin e mëtejmë: Ligji për KMPK-në).

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

44. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi [CML. nr. 6/2016] i datës 13 shtator 2016 i Gjykatës Supreme, është nxjerrë në shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje më nenin 6 (E drejta për gjykim të drejtë) të KEDNJ, nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës, nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] në lidhje me 13 nenin (E drejta për mjet efektiv) të KEDNJ-së dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës.

45. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta kishin aplikuar ligjin e gabueshëm në rastin e tij. Sipas pretendimeve të tij, aplikimi i ligjit të gabueshëm kishte rezultuar në shpalljen e pasaftshme të kërkesëpadisë së tij, dhe rrjedhimisht, atij i ishte pamundësuar që të merr një përgjigje përfundimtare nga gjykatat sa i përket meritave të rastit të tij. Në këtë aspekt parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij në gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

46. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se duke e aplikuar ligjin e gabuar që ka të bëjë me afatshmërinë e kërkesëpadisë së tij, gjykatat e rregullta i kanë pamundësuar atij mbrojtjen gjyqësore të të drejtave të garantuara me nenin 54 të Kushtetutës. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta kanë vepruar në shkelje të nenit 102 të Kushtetutës, dukë mos vendosur në bazë të ligjit të aplikueshëm siç kërkohet me Kushtetutë.

47. Në fund, parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se ndërprerja e pretenduar e kundërligjshme e marrëdhënies së punës së tij, i shkel të drejtat e tij të garantuara me nenin 49 të Kushtetutës.

48. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të anuloj vendimin [CML 06/2016] e 13 shtatorit 2016 të Gjykatës Supreme dhe të kthej çështjen në rigjykim.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

49. Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

50. Në këtë kuptim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcakton:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
>
> *[...]*
>
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

51. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

> *"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik."*
>
> *2. Individi mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë."*

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor…".

52. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në cilësinë e palës së autorizuar, duke e kontestuar një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [CML. nr. 6/2016] e 13 shtatorit 2016 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

53. Gjykata në fund vlerëson se kjo kërkesë nuk është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (1) (d) të Rregullores së punës. Gjykata më tej thekson se nuk është e papranueshme në asnjë bazë tjetër. Prandaj ajo duhet deklaruar e pranueshme (shih gjithashtu rastin e GJEDNJ-së *Alimuçaj kundër Shqipërisë*, kërkesa nr. 20134/05, Aktgjykimi i 9 korrikut 2012, § 144; shih gjithashtu, rastin KI97/16, parashtrues IKK Classic, Aktgjykim i datës 9 janar 2018, paragrafi 38).

Dispozitat Përkatëse Ligjore

LIGJI PËR TË DREJTAT THEMELORE TË MARRËDHËNIES SË PUNËS

(Botuar në "Gazetën Zyrtare të RSFJ-së", nr. 60/89, 42/90 dhe "Gazetën Zyrtare të RFJ-së" Nr. 42/92, 24/94)

Neni 83

"Punonjësi i cili nuk është i kënaqur me vendimin përfundimtar të autoritetit kompetent brenda organizatës ose nëse ky autoritet nuk merr vendim brenda 30 ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës për ankesë, ka të drejtë të kërkojë mbrojtjen e të drejtat e tij para gjykatës kompetente brenda 15 ditëve pasuese."

(…)

RREGULLORE PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS NR. 2001/36 UNMIK/ REG/2001/36 të 22 DHJETORIT 2001

Neni 11
Apelimi

(...)

"(ç) Që për çdo apelim që paraqitet para tij, Këshilli brenda afatit prej nëntëdhjetë (90) ditësh pas përfundimit të procedurës së apelimit duhet të lëshojë një vendim me shkrim, duke arsyetuar vendimin e tij dhe bazën ligjore e faktike të atij vendimi;"

(...)

LIGJI PËR KËSHILLIN E PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS NR. 03/L-192 TË 16 GUSHTIT 2008

Neni 12
Ankesat

"1. Nëpunësi civil i cili është i pa kënaqur me vendim të organit të punësimit, lidhur me pretendimin për shkeljen e rregullave dhe parimeve të parashtruara në Ligjin për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës, ka të drejtë të ankohet në Këshill.

(...)

3.4. që për çdo ankesë që paraqitet para tij, Këshilli brenda afatit prej (60) ditësh pas përfundimit të procedurës së ankesës duhet të lëshojë një vendim me shkrim, duke arsyetuar vendimin e tij dhe bazën ligjore e faktike të atij vendimi."

(...)

Neni 14
E drejta e ankesës

"Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të inicioj konflikt administrative në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të Këshillit."

Meritat e kërkesës

54. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi [CML. nr. 6/2016] i datës 13 shtator 2016 i Gjykatës Supreme, është nxjerrë në shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje më nenin 6 të KEDNJ, nenin 49 të Kushtetutës, nenin 54 në lidhje me 13 nenin të KEDNJ-së dhe 102 të Kushtetutës, sepse gjykatat e rregullta kishin aplikuar ligjin e gabueshëm në vlerësimin e afatshmërisë së padisë së tij. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta në rastin e tij, kanë aplikuar dhe interpretuar në mënyrë qartazi të gabuar ligjin duke shkelur kështu të drejtat e tij në gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuara me Kushtetutë.

55. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht thekson se e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe zbatimi i saj, është interpretuar gjerësisht nga Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ) përmes praktikës së saj gjyqësore, në harmoni me të cilën, Gjykata bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë. Rrjedhimisht, sa i përket interpretimit të pretendimeve për shkeljen e së drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm si rezultat i "aplikimit dhe interpretimit qartazi të gabuar të ligjit", Gjykata do t'i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së.

56. Si rregull i përgjithshëm, pretendimet për interpretimin të gabuar të dispozitave të ligjit që pretendohet të jetë bërë nga gjykatat e rregullta, kanë të bëjnë me fushën e ligjshmërisë dhe si të tilla, nuk janë në juridiksionin e Gjykatës, dhe për këtë arsye, në parim, Gjykata nuk mund ta shqyrtojë ato. (Shih rastin nr. KI06/17, Parashtrues L. G. dhe pesë të tjerët, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 tetorit 2016, paragrafi 36).

57. Gjykata ka përsëritur vazhdimisht se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "*shkallës së katërt*", që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës

procedurale dhe materiale. (Shih, rasti *García Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ nr. 30544/96, i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe shih, gjithashtu rastet: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima,* Aktvendim për papranueshmëri i 16 dhjetorit 2011; KI06/17, parashtrues L. G. dhe pesë të tjerët, Aktvendim për papranueshmëri i 25 tetorit 2016, paragrafi 37).

58. Ky qëndrim është mbajtur vazhdimisht nga Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ, që në mënyrë të qartë thekson se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale. (shih, GJEDNJ-së, *Pronina kundër Rusisë,* Vendimi për pranueshmëri, të 30 qershorit 2005, kërkesa nr. 65167/01; KI06/17, parashtrues L. G. dhe pesë të tjerët, Aktvendim për papranueshmëri i 25 tetorit 2016, paragrafi 38).

59. Gjykata, megjithatë, thekson se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së gjithashtu përcakton rrethanat nën të cilat duhet të bëhen përjashtime nga ky qëndrim. GJEDNJ ka theksuar se përderisa autoritet vendore, përkatësisht gjykatat, kanë detyrë primare të zgjedhin problemet rreth interpretimit të legjislacionit, roli i Gjykatës është që të sigurohet apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë kompatibile me Konventën. (Shih rastet e GJEDNJ-së, *Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës*, no.38366/97, paragrafët 33-39; Koshoglu kundër Bulgarisë, No.48191/99, Aktgjykim i datës 10 maj 2007, paragrafi 50). Rrjedhimisht, edhe pse roli i Gjykatës është i kufizuar në kuptimin e vlerësimit të interpretimit të ligjit, ajo duhet të sigurohet dhe të ndërmerr masa kur vëren se një gjykatë ka aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar në një rast specifik i cili mund të ketë rezultuar në "konkluzione arbitrare". (Shih rastet e GJEDNJ-së, *Anheuser-Busch Inc.,* Aktgjykim, paragrafi 83, *Kuznetsov dhe të tjerët kundër Rusisë*, no. 184/02, paragrafët 70-74 dhe 84; Păduraru kundër Rumanisë, no. 63252/00, paragrafi 98; *Sovtransavto Holding kundër Ukrainës*, no. 48553/99, paragrafët 79, 97 dhe 98; *Beyeler kundër Italisë* [GC], no. 33202/96, paragrafi 108; *Koshoglu kundër Bulgarisë*, Aktgjykim i 10 majit 2007, paragrafi 50; shih gjithashtu, rastin KI06/17, parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 25 tetorit 2016, paragrafi 40).

60. Ndër të tjera, në rastin *Angjelkoviq kundër Serbisë* (Aktgjykimi i 9 prillit 2013, nr. 1401/08, paragrafi 24), GJEDNJ përsëriti se nuk do të vë në dyshim interpretimin e ligjit nga gjykatat, përveç nëse është dukshëm arbitrar ose vendimet e atyre gjykatave janë arbitrare apo në ndonjë mënyrë qartazi të paarsyeshme. Në këtë rast, GJEDNJ pohon:

"*Gjykata në fillim, rikujton se detyra e saj nuk është ta merr rolin e gjykatave vendase. Para së gjithash, autoritetet vendase, në veçanti gjykatat, duhet t'i zgjidhin problemet e interpretimit të legjislacionit vendor* (shih, në mes tjerash, *Brualla Gómez de la Torre kundër Spanjës*, të 19 dhjetorit 1997, paragrafi 31, Raport i aktgjykimeve dhe vendimeve 1997-VIII). *Në këtë rast, Gjykata nuk do të ngrejë çështje të interpretimit të ligjit vendor nga gjykatat vendase, përveç rasteve të arbitraritetit të dukshëm* (shih, *mutatis mutandis, Ādamsons kundër Letonisë*, nr. 3669/03, paragrafi 118, 24 qershor 2008)*, me fjalë të tjera, kur vëren se zbatimi i ligjit nga gjykatat vendase në raste të caktuara ishte qartazi i gabuar ose ishin marrë konkluzione arbitrare dhe/ose ishte mohuar drejtësia (shih, mutatis mutandis, Farbers dhe Harlanova kundër Lituanisë (vendimi), numër 57313/00, 6 shtator 2001, dhe megjithëse në kontekstin e nenit 1 të Protokollit 1, Beyeler kundër Italisë [DHM], numër 33202/96, paragrafi 108, GJEDNJ 2000-I)*".

61. Rrjedhimisht, në pajtim me praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, është detyrë e gjykatave të rregullta që t'i vlerësojnë faktet dhe provat të cilat i kanë administruar. (shih arsyetimin e GJEDNJ-së, *Thomas kundër Mbretërisë së Bashkuar,* të 10 majit 2005, kërkesa nr. 19354/02). Detyra e Gjykatës është që të shqyrtojë nëse ka ndodhur shkelja e të drejtave kushtetuese (e drejta për gjykim të drejtë, e drejta për qasje në gjykatë, e drejta për mjete efektive juridike, etj.), si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë, eventualisht, arbitrar ose diskriminues. (Shih, për shembull, rastet e GJEDNJ-së *Koshoglu kundër Bullgarisë*, Aktgjykimi i 10 majit 2007, nr. 48191/99; *Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë*, Aktgjykimi i 11 janarit 2007, nr. 73049/01; *Kuznetsov dhe të tjerët kundër Rusisë* i 11 janarit 2007, nr. 184/02; *Khamidov kundër Rusisë*, Aktgjykimi i 15 nëntorit 2007, nr. 72118/01; *Angjelkoviq kundër Serbisë*, Aktgjykim i 9 prillit 2013, nr. 1401/08; *Dulaurens kundër Francës*, Aktgjykimi i 21 marsit 2000, nr. 34553/97; shih gjithashtu rastin KI06/17, parashtrues L. G. dhe pesë të tjerët, Aktvendim për papranueshmëri i 25 tetoritit 2016, paragrafi 41).

62. Sa i përket, aplikimit të parimeve të vendosura nga GJEDNJ mbi aplikimin apo interpretimin qartazi të gabuar të ligjit në rastin konkret, Gjykata fillimisht rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon që gjykatat e rregullta, në fakt, kishin aplikuar ligjin e gabueshëm në rastin e tij sa i përket vlerësimit të afatshmërisë së kërkesëpadisë, duke i pamundësuar kështu, shqyrtimin e çështjes së tij në merita. Parashtruesi i kërkesës vazhdimisht ka pretenduar përgjatë gjykatave të rregullta se në kontestin e tij aplikohet

Rregullorja 2001/36 dhe udhëzimet përkatëse administrative në fuqi në vitin 2007, përkatësisht në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së tij të punës. Aplikimi i Ligjit të Punës dhe Ligjit për KMPK-në të vitit 2010, kishte rezultuar, sipas pretendimit, në determinimin e gabuar të pasaftshmërisë së kërkesëpadisë së tij. Sipas parashtruesit të kërkesës, aplikimi i gabuar i ligjit, rezultoi në shkeljen e të drejtave të tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me Kushtetutë.

63. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se kontesti i parashtruesit të kërkesës kishte filluar në vitin 2007, kur ishte ndërprerë marrëdhënia e tij e punës me IPK-në. Parashtruesi i kërkesës kishte punuar në SHKP për disa vite, prej të cilës kishte dhënë dorëheqje pas punësimit në IPK. IPK-ja i kishte ndërprerë marrëdhënien e punës gjatë periudhës provuese, sepse gjatë procesit të verifikimit të së kaluarës së tij, kishte rezultuar se parashtruesi i kërkesës nuk kishte deklaruar faktin që gjatë punësimit të mëparshëm në SHPK kishte qenë nën hetime. Pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës nga IPK, parashtruesi i kërkesës kishte bërë kërkesë për rikthim në SHKP, kërkesë kjo që i ishte refuzuar. Parashtruesi i kërkesës në fakt përgjatë procedurave gjyqësore nuk konteston asnjë vendim që ndërlidhet me raportin e tij me SHKP-në, por me IPK-në. Eshtë Vendimin [nr. 1306/2007] i 13 qershorit 2007 i IPK-së, të cilin parashtruesi i kërkesës e kishte kontestuar që nga viti 2007 fillimisht në procedurë administrative, e me pas në procedurë gjyqësore.

64. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton që KPMK, përmes Vendimit [02/259/207] të 14 gushtit 2007, fillimisht kishte refuzuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës si të parakohshme. Kërkesën e dytë në KPMK, parashtruesi i kërkesës e kishte bërë me datë 29 gusht 2007. Parashtruesi i kërkesës nuk kishte marrë përgjigje nga KMPK, dhe rrjedhimisht, me 7 nëntor 2007, kishte dorëzuar padinë duke filluar procedurat gjyqësore. Janë këto dy data, data e dorëzimit të kërkesës në KMPK me 29 gusht 2007 dhe data e dorëzimit të padisë në Gjykatën Komunale në Prishtinë me 7 nëntor 2007, që ishin bërë objekt vlerësimi përgjatë gjykatave të rregullta në aspektin e afatshmërisë së padisë së parashtruesit të kërkesës, por duke aplikuar tri ligje të ndryshme nga gjykatat e rregullta, Rregulloren 2001/36 në fuqi në vitin 2007, Ligjin e Punës, dhe Ligjin e KMPK-së të vitit 2010. Të gjitha përcaktojnë afate të ndryshme kohore rreth fillimit të procedurave gjyqësore në konteste të punës.

65. Gjykata vëren që të tri ligjet përcaktojnë afate të ndryshme rreth inicimit të procedurës gjyqësore në konteste të punës: a) Ligji i Punës, në bazë të nenit 83 përcakton që: "*punëtori i cili nuk është i kënaqur me vendimin përfundimtar të autoritetit kompetent në organizatë*

ose nëse ai organ nuk merr vendim brenda 30 ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës ose ankesës, ka të drejtë të kërkojë mbrojtjen e të drejtave të tij para gjykatës kompetente brenda 15 ditëve të ardhshme"; b) Rregullorja ne 2001/36, në bazë të nenit 11.2, pika (ç) përcakton që: "*Këshilli brenda afatit prej nëntëdhjetë (90) ditësh pas përfundimit të procedurës së apelimit duhet të lëshojë një vendim me shkrim, duke arsyetuar vendimin e tij dhe bazën ligjore e faktike të atij vendimi*", ankesa kundër të cilit në gjykatë kompetente duhet të ngrihet brenda 30 ditësh; ndërsa c) Ligji për KPMK i vitit 2010, përcakton që Këshilli duhet të vendos brenda afatit 60 ditësh (12.3.4), ankesa kundër të cilit në gjykatën komptente duhet të ngrihet brenda 30 ditësh (neni 14).

66. Gjykata gjithashtu rikujton gjykatat e rregullta aplikuan të tri ligje të ndryshme në gjithsej tetë vendime gjyqësore në rastin e parashtruesit të kërkesës. Katër të Gjykatës Komunale, respektivisht Themelore, tri prej të cilave kanë të bëjnë me kërkesëpadinë e tij, ndërsa e katërta vetëm me kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme. Tri të parat aplikojnë dy ligje të ndryshme në vlerësimin e afatshmërisë së kërkesëpadisë së tij. Aktgjykimet [Cl.520/2007] të datës 9 korrik 2008 dhe [C.nr.290/12] të datës 30 tetor 2012, respektivisht, që kishin shpallë kërkesëpadinë e tij të afatshme dhe rrjedhimisht kishin shqyrtuar meritat e rastit, aplikojnë Rregulloren 2001/36, ndërsa tjera, Aktvendimi [C.nr.437/15] i 25 janarit 2016, kishte shpallë kërkesën e pasafatshme duke e aplikuar Ligjin e Punës.

67. Parashtruesit i kërkesës gjithashtu ka tri vendime të Gjykatës së Qarkut e Apelit, respektivisht, dy prej të cilave shqyrtojnë rastin e tij, ndërsa e treta vetëm ankesën kundër refuzimit të kthimit në gjendje të mëparshme. Dy të parat, Aktgjykimi [Ac.nr.199/2009] i 12 janarit 2012 dhe Aktvendimi [Ca.nr.1977/2013] i 12 shkurtit 2015, respektivisht, aplikojnë dy ligje të ndryshme, e para Ligjin e Punës, ndërsa e dyta, Rregulloren 2001/36.

68. Në fund, Gjykata Supreme gjithashtu refuzon kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë së Prokurorit të Shtetit me arsyetimin se kërkesa është e pasaftshme, por duke sqaruar specifikisht se në këtë kontest nuk aplikohet Ligji i Punës, por Rregullorja 2001/36. Megjithatë, në vlerësimin e afatshmërisë së padisë fillestare, Gjykata Supreme aplikon një ligj të tretë, përkatësisht Ligjin për KMPK-në të 2010, ligj i cili nuk ishte në fuqi në kohën e kontestit.

69. Specifikisht, Gjykata Supreme, në Aktvendim e saj, sqaron që në rastin konkret nuk aplikohet Ligji i Punës, por Rregullorja 2001/36.

Megjithatë, Gjykata Supreme gjithashtu i referohet Ligjit të KMPK-së të vitit 2010. Gjykata Supreme, thekson:

> *"…. Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se Gjykata Themelore në Prishtinë, ka vendosur drejt kur ka hedhur padinë e paditësit si të pasaftshme, mirëpo në rastin konkret duhet të zbatohet Rregullorja mbi Shërbimin Civil të Kosovës nr. 2001/36 dhe Urdhëresa Admninistrative për zbatimin e kësaj Rregulloreje nr. 2003/2, në bazë të së cilës paditësi ka pasur statusin e shërbyesit civil. Prandaj, procedura për mbrotjen e të drejtave nga marrëdhënia e punës të shërbyesve civil realizohet në bazë të këtij ligji dhe Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (nr. 03/L-192) e cila ka qenë në fuqi në kohën kur paditësit i është shkëputur kontrata e punës"*

70. Ndërsa, në kalkulim e afateve kohore mbi të cilën Gjykata Supreme refuzon kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë së Prokurorit të Shtetit, duke u pajtuar me konkludimin e Gjykatës Themelore për pasafatshmërinë e padisë së parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme nuk zbaton dispozitat e Rregullores 2001/36, që ajo vet e konsideron të zbatueshme në rastin e kërkesës, por në vend të saj zbaton Ligjin për KPMK-në të vitit 2010, që nuk ishte në fuqi në kohën e kontestit në vitin 2007, afatet për paraqitjen e padisë të së cilës ndryshojnë nga ato të përcaktuara në Rregulloren 2001/36. Gjykata Supreme thekson:

> *"Paditësi si shërbyes civil është dashtë qe brenda afatit prej 30 ditësh, nga dita kur autoriteti i punëdhënësit është dashtë të marrë vendimin lidhur më ankesën e tij, të bëjë ankesë në Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në bazë të nenit 12.2 të Ligjit Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (Ligji nr. 03/L-192). Për çdo ankesë që i paraqitet Këshillit ai duhet brenda afatit prej 60 ditësh të lëshoj vendim (neni 12.3.4). Kjo është përcaktuar edhe me Udhëzimin Administrativ nr. 2005/02 Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në KPMK. Paditësi ankesën Menaxherit të personelit të MPB e ka paraqitur me datën 18.06.2007, ndërsa në KPMK me datën 29.08.2007, ndërsa padinë gjykatës ka parashtruar më dt. 7.12.2007 dhe se afati i fundit për padi ka qenë 30.11.2007, nga kjo del se padia është parashtruar pas afatit ligjor."*

71. Dhe në fund, në përgjigjen e pretendimeve të Prokurorit të Shtetit mbi aplikimin e afateve të Rregullores 2001/36 në rastin konkret, Gjykata Supreme vazhdon t'i aplikojë afatet e Ligjit të KPMK-së të vitit 2010. Gjykata Supreme, arsyeton si në vijim:

"Thëniet e Prokurorit të Shtetit në kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë se në rastin konkret duhet të zbatohet Rregullorja nr. 31/2006 dhe se afati i ka kaluar më 29.12.2007, ndërsa padia është ngritur më 07.12.2007, nuk qëndrojnë nga arsyeja se si u tha më lartë paditësi ka ngritur padinë pas afatit prej 90 ditësh dhe KPMK është dashtë të vendos në afat prej 60 ditësh e jo 90 ditësh si pretendon Prokurori i Shtetit në kërkesën e tij".

72. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton që në refuzimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë së Prokurorit të Shtetit, Gjykata Supreme kishte konkluduar që në rastin konkret nuk aplikohet Ligji i Punës, por Rregullorja 2001/36, ndërsa në arsyetimin për refuzimin e kërkesës kishte aplikuar afatet e Ligjit për KMPK-në të 2010, duke rezultuar kështu në rezultat të ndryshëm rreth afatshmërisë së padisë së parashtruesit të kërkesës, nga ai që do të ishte nëse do të ishte zbatuar Rregullorja 2001/36.

73. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se në arsyetimin e saj, Gjykata Supreme zbaton një ligj që ka hyrë në fuqi në vitin 2010, përkatësisht Ligjin për KPMK, në kontestin e vitit 2007, përkundër faktit se vetë pranon që Rregullorja 2001/36 është e zbatueshme. Gjykata tashmë ka vërejtur se afatet për paraqitjen e padisë siç është përcaktuar në të dy ligjet, janë të ndryshme. Gjykata gjithashtu vë në dukje se dispozitat e Ligjit për KPMK nuk ishin të zbatueshme në kohën kur parashtruesi i kërkesës paraqiti padinë fillestare në vitin 2007.

74. Gjykata, rrjedhimisht, vëren se Gjykata Supreme ka aplikuar qartazi në mënyrë të gabuar ligjin duke rezultuar në konkluzione arbitrare për parashtruesin e kërkesës. Për më tepër, Gjykata Supreme nuk ka ofruar ndonjë arsye për zbatimin e Ligjit për KPMK-në të vitit 2010 në rrethanat e rastit konkret.

75. Përveç kësaj, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe posaçërisht rastit *Barac dhe të Tjerët kundër Malit të Zi* (Aktgjykim i GJEDNJ-së i 13 dhjetorit 2011, paragrafi 32), ku thuhet *"nuk mund të konsiderohet se është mbajtur gjykim i drejtë aty ku arsyeja e dhënë në vendimin përkatës nuk ishte paraparë me legjislacionin vendor dhe, prandaj, nuk ishte ligjërisht i vlefshëm*". (Shih gjithashtu, *mutatis mutandis*, *De Moor kundër Belgjikës*, 23 qershor 1994, paragrafi 55, Seria A nr.292-A dhe *Dulaurans kundër Francës*, nr 34553/97, paragrafët 33-39, 21 mars 2000).

76. Rrjedhimisht, Gjykata duhet të konstatoj se Aktvendimi [CML. nr. 6/2016] i 13 shtatorit 2016 të Gjykatës Supreme me të cilin është

refuzuar, si e pabazuar, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e ushtruar nga Prokurori i Shtetit kundër Aktvendimit [C.nr.437/2015] të 25 janarit 2016 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, nuk i ka plotësuar kriteret e një "*gjykimi të drejtë*" sipas nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak të aplikimit dhe interpretimit qartazi të gabuar apo arbitrar të ligjit.

77. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se ky përfundim ekskluzivisht ka të bëjë me Aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme nga këndvështrimi i aplikimit të ligjit adekuat në rrethanat e rastit të parashtruesit të kërkesës dhe në asnjë mënyrë nuk paragjykon rezultatin e meritave të rastit të tij.

78. Në fund, Gjykata konsideron se nuk është e nevojshme të shqyrtohen pretendimet e parashtruesit të kërkesës sa i përket nenit 54 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së dhe nenet 49 e 102 të Kushtetutës, pasi që ka konstatuar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

Përfundim

79. Në përfundim, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata konstaton se duke marrë parasysh që në rrethanat e rastit konkret, arsyetimi i vendimit të Gjykatës Supreme rezultoi në konkluzione arbitrare për parashtruesin e kërkesës, është shkelur e drejta e parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

80. Si përmbledhje, në pajtim me rregullin 74 (1) të Rregullores së punës, Aktvendimi [CML. nr. 6/2016] i 13 shtatorit 2016 të Gjykatës Supreme shpallet i pavlefshëm dhe çështja i kthehet Gjykatës Supreme për rishqyrtim.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 113 (7) dhe 116 (1) të Kushtetutës, nenet 47 dhe 48 të Ligjit dhe rregullat 56 (1), 63 (1) (5) dhe 74 (1) të Rregullores së punës, më 30 maj 2018, me shumicë

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut;

III. TA SHPALLË të pavlefshëm Aktvendimin CML. nr. 6/2016 e Gjykatës Supreme të 13 shtatorit 2016;

IV. TA KTHEJË Aktvendimin CML. nr. 6/2016 e Gjykatës Supreme të 13 shtatorit 2016 për rishqyrtim në pajtim me këtë Aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese;

V. TA URDHËROJË Gjykatën Supreme që ta njoftojë Gjykatën, në pajtim me rregullin 63 (5) të Rregullores së punës, për masat e ndërmarra për ta zbatuar Aktgjykimin e Gjykatës;

VI. TË MBETET fuqimisht e angazhuar në këtë çështje në pritje të pajtimit me këtë urdhër;

VII. TË NJOFTOJË që ky Aktgjykim t'u komunikohet palëve;

VIII. TA PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IX. TË DEKLAROJË se ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Gresa Caka-Nimani	Arta Rama-Hajrizi

KI 115/16 Parashtrues: Branko Ljumović, Ranko Ljumović dhe Anica Vukićević-Ljumović, të cilët kërkojnë vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-II-12-0126, të 21 prillit 2016

KI 115/16, aktgjykimi i 29 majit 2018, i publikuar më 19 qershor 2018

Fjalët kyçe: *kërkesë individuale, kontest pronësor, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, kërkesë e pranueshme, është shkelur e drejta e parashtruesve për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, u është mohuar e drejta e parashtruesve për një vendim gjyqësor të arsyetuar*

Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Aktgjykimin [AC-II-12-126] e 21 prillit 2016 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Apelit) në lidhje me Aktgjykimin [C. nr. 2021/2007] të 29 korrikut 2010 të Gjykatës Komunale në Prishtinë.

Kolegji i Apelit përmes Aktgjykimit të kontestuar [AC-II-12-126] e aprovoi ankesën e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe e anuloi Aktgjykimin [C. nr. 2021/2007] e Gjykatës Komunale në Prishtinë, i cili kishte konfirmuar të drejtat pronësore të parashtruesëve të kërkesës.

Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e garantuara me a) nenin 24 të Kushtetutës, sepse sipas pretendimit, Kolegji i Apelit i kishte vendosur ata në pozitë të pabarabartë duke vepruar kundër vetë praktikës së saj gjyqësore; b) nenin 31 të Kushtetutës, sepse Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit nuk ishte arsyetuar në raport me pretendimet thelbësore të parashtruesve të kërkesës dhe për më tepër që, me kalimin e afatit ligjor për ankesë, Aktgjykimi i Gjykatës Komunale ishte bërë *res judicata*; dhe c) nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokolit nr. 1 të KEDNJ-së, sepse sipas pretendimit, me plotfuqishmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, ata kishin fituar edhe "*pritjet legjitime*" për të drejtën e pronës, të definuara mbi bazën e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe pasi shqyrtoi pretendimet e parashtruesëve të kërkesës, konstatoi se Kolegji i Apelit, duke mos i arsyetuar pretendimet thelbësore të parashtruesve të kërkesës rreth afatshmërisë së ankesës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit, si rezultat i së cilës e anuloi Aktgjykimin e Gjykatës

Komunale, ka shkelur të drejtën e parashtruesve të kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Si rezultat i kësaj shkeljeje, parashtruesit e kërkesës u privuan nga e drejta e tyre për vendim të arsyetuar gjyqësor.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI115/16

Parashtrues

Branko Ljumović, Ranko Ljumović dhe Anica Vukićević-Ljumović

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-II-12-0126, të 21 prillit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Branko Ljumović, Ranko Ljumović dhe Anica Vukićević-Ljumović (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës), të cilët i përfaqëson Visar Vehapi, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Aktgjykimin [AC-II-12-126] e 21 prillit 2016 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës

Supreme të Kosovës për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Apelit) në lidhje me Aktgjykimin [C. nr. 2021/2007] të 29 korrikut 2010 të Gjykatës Komunale në Prishtinë.

3. Aktgjykimi i kontestuar iu dorëzua parashtruesve të kërkesës më 17 maj 2016.

Objekti i çështjes

4. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se ka pasur shkelje të të drejtave të parashtruesve të kërkesës të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenit 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenit 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin mëtejmë: KEDNJ) dhe nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 29 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 17 shtator 2016, parashtruesit e kërkesës nëpërmjet postës dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 19 tetor 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.

8. Më 9 nëntor 2016, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës dhe Kolegjin e Apelit për regjistrimin e kërkesës.

9. Më 29 maj 2018, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 2 shkurt 1959, nëna e parashtruesve të kërkesës kishte lidhur Kontratë të shitblerjes [nr. Vr. 570/60] me Kooperativën Bujqësore "Orloviq" (në tekstin e mëtejmë: Kooperativa Bujqësore) për shitjen e patundshmërisë. Kontrata ishte vërtetuar në Gjykatën e Rrethit në Prishtinë më 2 mars 1960. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë që asnjëherë nuk u është kompensuar çmimi i përcaktuar me kontratën në fjalë.

11. Më 14 gusht 2007, parashtruesit e kërkesës paraqitën padi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (në tekstin e mëtejmë: DHPGJS), ndërsa më 17 shtator 2007, parashtruesit e kërkesës parashtruan padi edhe në Gjykatën Komunale në Prishtinë.

12. Përmes padive përkatëse, parashtruesit e kërkesës kërkuan të vërtetohet që Kontrata për shitblerjen e patundshmërisë është nule dhe të obligohet Ndërmarrja Shoqërore KBI "Kosova Export" në Fushë Kosovë (në tekstin e mëtejmë: "Kosova Export"), si trashëgimtar juridik i Kooperativës Bujqësore, që paditësve, përkatësisht parashtruesve të kërkesës, t'ua kthejë në pronësi patundshmëritë kontestuese.

13. Më 20 nëntor 2007, DHPGJS përmes Aktvendimit [SCC-07-0322], padinë e parashtruesve të kërkesës e referoi në Gjykatën Komunale në Prishtinë. Aktvendimi në fjalë, ndër të tjera, kishte theksuar se çfarëdo ankese kundër vendimit të Gjykatës Komunale, duhet të parashtrohet në DHPGJS.

14. Më 29 korrik 2010, Gjykata Komunale në Prishtinë, nëpërmjet Aktgjykimit [C. nr. 2021/2007] e aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës, duke shpallur nule Kontratën e shitblerjes [nr. Vr. 570/60] në mes parashtruesve të kërkesës dhe Kooperativës Bujqësore, meqë sipas Aktgjykimit, nuk ishte vërtetuar që ishte paguar çmimi i dakorduar me Kontratën e shitblerjes, duke e obliguar të padituren "Kosova Eksport" t'i kompensojë parashtruesit e kërkesës në mënyrën e përcaktuar me këtë Aktgjykim. Nëpërmjet Këshillës Juridike, Aktgjykimi i Gjykatës Komunale kishte udhëzuar palët që kundër Aktgjykimit në fjalë, ankesa është e lejuar në afatin prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh.

15. Më 18 nëntor 2010, Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP), duke vepruar si administratore e "Kosova Export", paraqiti ankesë në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së kundër Aktgjykimit [C. nr. 2021/2007] të Gjykatës Komunale në Prishtinë, duke u thirrur në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe shkelje të ligjit material.

16. Më 26 nëntor 2010, Ndërmarrja Shoqërore "Ratar" (në tekstin e mëtejmë: "Ratar"), gjithashtu parashtroi ankesë kundër Aktgjykimit [C. nr. 2021/2007] të Gjykatës Komunale, duke kërkuar që të anulohet Aktgjykimi i ankimuar dhe të kthehet lënda në rigjykim, ose të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar dhe të refuzohet kërkesëpadia.

17. Më 20 shtator 2011, parashtruesit e kërkesës paraqitën parashtresë në Kolegjin e Apelit, duke kontestuar legjitimitetin e "Ratar", si palë procedurale, dhe duke arsyetuar se vetëm AKP-ja ka legjitimitet për të përfaqësuar ndërmarrjet shoqërore në procedurë gjyqësore. Të njëjtin pretendim, parashtruesit e kërkesës e përsëritën nëpërmjet parashtresës së 22 korrikut 2013.

18. Nëpërmjet shkresës së 22 korrikut 2013, parashtruesit e kërkesës gjithashtu kontestuan afatin ligjor, brenda së cilit ishte paraqitur ankesa e AKP-së kundër Aktgjykimit [C. nr. 2021/2007] të 29 korrikut 2010 të Gjykatës Komunale. Parashtruesit e kërkesës argumentuan që në bazë të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2008/4 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/13 Mbi Themelimin e Dhomës së Posaçme në Gjykatën Supreme mbi Çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja 2008/4), ankesa e AKP-së kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore ishte e paafatshme.

19. Më 27 maj 2014, parashtruesit e kërkesës parashtruan propozim pranë Kolegjit të Apelit për aprovimin e urdhrit paraprak gjyqësor, që e parandalon AKP-në nga ndërmarrja e çfarëdo aktiviteti rreth pronave kontestuese. Më 25 shtator 2014, Kolegji i Apelit nëpërmjet Aktvendimit e hodhi poshtë kërkesën e parashtruesve të kërkesës lidhur me urdhrin paraprak gjyqësor.

20. Më 18 shkurt 2016, ankesa e AKP-së e 18 nëntorit 2010 dhe ankesa e "Ratar" e 26 nëntorit 2010, iu dorëzuan parashtruesve të kërkesës për komente brenda 21 ditëve. Parashtruesit e kërkesës nuk dorëzuan komente në Kolegjin e Apelit brenda këtij afati.

21. Më 31 mars 2016, parashtruesit e kërkesës iu drejtuan edhe një herë Kolegjit të Apelit, duke kontestuar legjitimitetin procedural të "Ratar"

në procedurë dhe duke përsëritur pretendimet lidhur me afatshmërinë e ankesës së AKP-së kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, duke i bazuar argumentet e tyre, përveç në Rregulloren 2008/4 edhe në praktikën gjyqësore të Kolegjit të Apelit.

22. Më 21 prill 2016, Kolegji i Apelit nëpërmjet Aktgjykimit [AC-II-12-126] e aprovoi ankesën e AKP-së dhe e anuloi Aktgjykimin [C. nr. 2021/2007] e Gjykatës Komunale në Prishtinë.

23. Kolegji i Apelit e bazoi arsyetimin për Aktgjykimin e tij përmes paragrafit në vijim:

> *"Gjykata e shkallës së parë e aprovoi mjetin juridik i cili nuk ekziston si çështje e së drejtës. Nga kjo padi është e qartë se i padituri nuk është pronarë i pasurive të patundshme që kishin qenë objekt i kontratës se vitit 1959. Pretendimi i një prone të ndryshme në vend të asaj fillestare, është ligjërisht i pamundur. Në raste të tilla - kur kontrata revokohet, anulohet, ose ndërpritet dhe i padituri nuk është pronar i objektit origjinal të kontratës në dispozicion është vetëm kompensimi monetar. Kështu, aktvendimi i ankimuar është i gabuar dhe duhet të prishet dhe padia të refuzohet si e pabazuar".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkelje të të drejtave të tyre të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenit 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenit 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së dhe nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës.

25. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë që Aktgjykimi [C. nr. 2021/2007] i 29 korrikut 2010 i Gjykatës Komunale në Prishtinë ishte bërë i plotfuqishëm me kalimin e afatit ligjor për t'u apeluar, siç është përcaktuar më Rregulloren 2008/4, dhe rrjedhimisht ishte bërë vendim *res judicata*. Në këtë aspekt, parashtruesit e kërkesës pretendojnë që ankesa e AKP-së kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale ishte dorëzuar në Kolegj të Apelit jashtë afatit 30 (tridhjetë) ditorë të përcaktuar me Rregulloren 2008/4 dhe se Kolegji e Apelit, duke e pranuar këtë ankesë si të afatshme, u'a kishte shkelur të drejtat kushtetuese për barazi para ligjit dhe për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuara me nenet 24 dhe 31 të Kushtetutës, respektivisht.

26. Sa i përket pretendimeve specifike për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës theksojnë se duke e pranuar ankesën e AKP-së si të afatshme, Kolegji i Apelit të DHPGJS-së, kishte vepruar në kundërshtim me praktikën e vet gjyqësore sa i përket afatshmërisë së ankesave, dhe kështu kishte vendosur parashtruesit e kërkesës në pozitë të ndryshme në rrethana të njëjta. Në këtë aspekt, parashtruesit e kërkesës i referohen Aktvendimeve të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, [ASC-10-0012] të 29 prillit 2010; [ASC-10-005] të 17 gushtit 2010; [ASC-10-0040] të 17 gushtit 2010; [SCA-09-0096] dhe [AC-2-II-12-0120] të 20 qershorit 2013. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se kjo praktikë gjyqësore e Kolegjit të Apelit ishte konfirmuar gjithashtu nëpërmjet Aktvendimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin KI145/13. (Aktvendim për papranueshmëri i 8 majit 2014).

27. Sa i përket pretendimeve specifike për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës pretendojë shkelje të parimit të sigurisë juridike, duke argumentuar se Aktgjykimi i Gjykatës Komunale ishte bërë i plotfuqishëm dhe se ankesa e ushtruar kundër tij ishte e paafatshme. Në këtë aspekt, parashtruesit e kërkesës i referohen praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ) në rastet *Stere dhe të Tjerët kundër Rumanisë*; *Bronowski kundër Polonisë*; *Sovtransavto Holding kundër Ukrainës*; dhe *Ryabykh kundër Rusisë*. Gjithashtu, parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkelje të së drejtës në vendim të arsyetuar, duke theksuar, ndër të tjera, që Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit nuk kishte adresuar asnjë nga pretendimet e tyre, dhe posaçërisht ato që kanë të bëjnë me afatshmërinë e ankesës së AKP-së.

28. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretendojnë shkeljen e të drejtave të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Ata pretendojnë që me plotfuqishmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, atyre u ishte konfirmuar e drejta në pronë. Aktgjykimi në fjalë ishte bërë, sipas pretendimit, *res judicata*, dhe rrjedhimisht, parashtruesit e kërkesës, përpos konfirmimit të pronësisë, kishin fituar edhe "*pritjet legjitime*" të definuara mbi bazën e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së. Në këtë aspekt, parashtruesit e kërkesës i referohen rasteve *Sporrong dhe Lonnroth kundër Suedisë*; *Sovtransavto Holding kundër Ukrainës*; *Slivenko kundër Letonisë*; dhe *Beyeler kundër Italisë*.

29. Në fund, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që të konstatojë që Aktgjykimi i kontestuar është nxjerrë në shkelje të neneve 3, 22, 24, 31, 46 dhe 53 të Kushtetutës; të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin [AC-II-12-0126] e 21 prillit 2016 të Kolegjit të Apelit; dhe Aktgjykimin [C.

nr. 2021/2007] të 29 korrikut 2010 të Gjykatës Komunale në Prishtinë ta lërë në fuqi si *res judicata*.

Pranueshmëria e kërkesës

30. Gjykata shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

31. Në këtë kuptim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
>
> *[...]*
>
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

32. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

> *"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik".*
>
> *2. Individi mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".*

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej 4 (katër) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor…".

33. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës e dorëzuan kërkesën në cilësinë e palës së autorizuar, duke e kontestuar një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [AC-II-12-126] të 21 prillit 2016 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, pasi i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu kanë qartësuar të drejtat dhe liritë themelore që pretendojnë se u janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

34. Gjykata në fund vlerëson se kjo kërkesë nuk është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (1) (d) të Rregullores së punës. Gjykata më tej thekson se nuk është e papranueshme mbi asnjë bazë tjetër. Prandaj, ajo duhet deklaruar e pranueshme. (Shih, gjithashtu, rastin e GJEDNJ-së *Alimuçaj kundër Shqipërisë*, kërkesa nr. 20134/05, Aktgjykimi i 9 korrikut 2012, paragrafi 144; shih, gjithashtu, rastin KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykim i 9 janarit 2018, paragrafi 38).

Dispozitat relevante ligjore

UNMIK / Rregullore / 2008/4
5 shkurt 2008

PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-ut NR. 2002/13 MBI THEMELIMIN E DHOMËS SË POSAÇME NË GJYKATËN SUPREME TË KOSOVËS MBI ÇËSHTJET QË KANË TË BËJNË ME AGJENCINË KOSOVARE TË MIRËBESIMIT
[…]

Neni 9 - Aktvendimet, vendimet dhe ankesat

Neni 9.5
Aktgjykimi apo vendimi i panelit gjykues i dërgohet palëve brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga miratimi. Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga marrja e tij pala mund të paraqesë ankesë në panelin e apelit për rishqyrtim të aktgjykimit apo vendimit të tillë.

[...]
Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut 2008/6
11 korrik 2008

E CILA NDRYSHON DHE IMPLEMENTON URDHËRESËN ADMINISTRATIVE 2006/17, QË IMPLEMENTON RREGULLOREN E UNMIK-UT 2002/13 MBI THEMELIMIN E ODËS SË VEÇANTË TË GJYKATËS SUPREME PËR ÇËSHTJET QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË MIRËBESIMIT

[...]

Neni 59
Paraqitja e ankesës

59.1 Ankesa duhet të paraqitet në Dhomën e Posaçme në afat prej dy muaj nga dita e dorëzimit të aktgjykimit nga pala e cila paraqet ankesë.

Meritat e kërkesës

35. Gjykata rikujton që parashtruesit e kërkesës kontestojnë Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit i cili anuloi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale, me të cilin fillimisht ishte konfirmuar e drejta e pronës e parashtruesve të kërkesës mbi pronat kontestuese. Gjykata gjithashtu vëren se çështja esenciale në rrethanat e rastit konkret është afatshmëria e ankesës së AKP-së kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale.

36. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se Aktgjykimi i Gjykatës Komunale ishte nxjerrë më 29 korrik 2010. Sipas shkresave të lëndës, rezulton se ai ishte pranuar nga AKP-ja më 30 shtator 2010. Aktgjykimi në fjalë, përmes Këshillës Juridike kishte udhëzuar palët që çdo ankesë kundër këtij vendimi duhet të paraqitej në Kolegjin e Apelit brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh. Nga ana tjetër, Rregullorja e UNMIK-ut 2008/4 përcakton që afati i ankesës është 30 (tridhjetë) ditë nga marrja e vendimit nga pala, ndërsa, Urdhëresa Administrative 2008/6 përcakton që afati i ankesës është 60 (gjashtëdhjetë) ditë. AKP e dorëzoi ankesën më 18 nëntor 2010, respektivisht më shumë se një muaj pas pranimit të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale.

37. Dallimi në afate për dorëzimin e ankesave në Kolegjin e Apelit, siç përcaktohet nga Rregullorja 2008/4 dhe Urdhëresa Administrative 2008/6, në fakt përbën esencën e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës. Këta të fundit pretendojnë që Kolegji i Apelit kishte pranuar

ankesën e AKP-së përkundër faktit që kishte kaluar afati 30 (tridhjetë) ditor i përcaktuar me Rregullore, dhe për më tepër, sipas pretendimit, në kundërshtim me praktikën e vendosur të Kolegjit të Apelit, përveç që nuk adresuan dhe nuk arsyetuan pretendimet e vazhdueshme të parashtruesve të kërkesës për paafatshmërinë e ankesës së AKP-së.

38. Në këtë aspekt, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e garantuara me a) nenin 24 të Kushtetutës, sepse sipas pretendimit, Kolegji i Apelit i kishte vendosur ata në pozitë të pabarabartë duke vepruar kundër vetë praktikës së saj gjyqësore; b) nenin 31 të Kushtetutës, sepse Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit nuk ishte arsyetuar në raport me pretendimet thelbësore të parashtruesve të kërkesës dhe për më tepër që, me kalimin e afatit ligjor për ankesë, Aktgjykimi i Gjykatës Komunale ishte bërë *res judicata*; dhe c) nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokolit nr. 1 të KEDNJ-së, sepse sipas pretendimit, me plotfuqishmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, ata kishin fituar edhe "*pritjet legjitime*" për të drejtën e pronës, të definuara mbi bazën e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së.

39. Në adresimin e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën Gjykata, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, duhet të bëj interpretimin e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë. Në këtë aspekt, Gjykata së pari do t'i adresojë pretendimet e parashtruesve të kërkesës sa i përket shkeljes së të drejtës në vendim të arsyetuar gjyqësor dhe specifikisht sa i përket mungesës së arsyetimit rreth afatshmërisë së ankesës së AKP-së në dritën e praktikës gjyqësore të DHPGJS-së.

40. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se e drejta për një proces të rregullt gjyqësor përfshin të drejtën për një vendim të arsyetuar. GJEDNJ ka vërejtur se, sipas jurisprudencës së saj, e cila pasqyron një parim të lidhur me administrimin e duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave dhe tribunaleve duhet të tregojnë në mënyrë adekuate arsyet në të cilat ato janë bazuar. (Shih *Tatishvili kundër Rusisë*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 22 shkurtit 2007, paragrafi 58).

41. GJEDNJ gjithashtu ka konstatuar se, edhe pse autoritetet gëzojnë liri të konsiderueshme në zgjedhjen e mjeteve të përshtatshme për të siguruar që sistemet e tyre gjyqësore të jenë në përputhje me kërkesat e nenit 6 (1) të KEDNJ-së, gjykatat e tyre duhet "*të tregojnë me qartësi të mjaftueshme arsyet në të cilat ata bazuan vendimin e tyre*". (Shih *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 16 dhjetorit 1992, paragrafi 33; shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës KI97/16, parashtrues "*IKK Classic",* Aktgjykim i 9 janarit 2018, paragrafi 45).

42. Funksioni i një vendimi të arsyetuar, sipas GJEDNJ-së, është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar. Për më tepër, një vendim i arsyetuar i jep një pale mundësinë për të apeluar kundër tij, si dhe mundësinë e shqyrtimit të vendimit nga një organ i apelit. Vetëm duke dhënë një vendim të arsyetuar mund të ketë shqyrtim publik të administrimit të drejtësisë. (Shih *Hirvisaari kundër Finlandës*, nr 49684/99, 27 shtator 2001, paragrafi 30; *Tatishvili kundër Rusisë*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 22 shkurtit 2007, paragrafi 58; rastin e Gjykatës KI97/16, parashtrues "*IKK Classic",* Aktgjykim i 9 janarit 2018, paragrafi 46; dhe KI22/16, parashtrues *Naser Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017, paragrafi 40).

43. Megjithatë, edhe pse GJEDNJ pohon se neni 6 i KEDNJ-së obligon gjykatat të japin arsyet për vendimet e tyre, ajo gjithashtu ka konstatuar se kjo nuk mund të kuptohet si kërkesë për një përgjigje të hollësishme në çdo argument. (Shih rastet e GJEDNJ-së *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994, paragrafi 61; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, nr. 134/1996/753/952, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998, paragrafi 42; dhe rastin e Gjykatës KI97/16, parashtrues "*IKK Classic",* Aktgjykim i 9 janarit 2018, paragrafi 47).

44. Shkalla në të cilën zbatohet obligimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit. (Shih rastet e GJEDNJ-së *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 29; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, *Ibidem,* paragrafi 42; gjithashtu, rastin e Gjykatës KI97/16, parashtrues "*IKK Classic"*, Aktgjykim i 9 janarit 2018, paragrafi 48; dhe KI22/16, parashtrues *Naser Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017, paragrafi 44).

45. Për shembull, në hedhjen poshtë të një ankese, një gjykatë apeli mundet në parim, thjesht të miratojë arsyet për nxjerrjen e vendimit të gjykatës më të ulët. (Shih rastet e GEJDNJ-së *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 26 dhe *Helle kundër Finlandës*, Aktgjykimi i 19 dhjetorit 1997, paragrafët 59 e 60). Autoriteti ose gjykata më e ulët duhet të japin arsye të tilla që t'u mundësojnë palëve që të shfrytëzojnë në mënyrë efektive çdo të drejtë ekzistuese të ankesës. (Shih rastin e GJEDNJ-së *Hirvisaari kundër Finlandës*, kërkesa 49684/99, Aktgjykimi i 27 shtatorit 2001, paragrafi 30; dhe rastin e Gjykatës KI97/16, parashtrues "*IKK Classic",* Aktgjykim i 9 janarit 2018, paragrafi 49).

46. Megjithatë, GJEDNJ gjithashtu ka vërejtur se, edhe pse gjykatat kanë liri të caktuar të vlerësimit në zgjedhjen e argumenteve në një rast të

veçantë dhe në pranimin e provave në mbështetje të parashtresave të palëve, një gjykatë është e detyruar të justifikojë aktivitetet e saj duke dhënë arsyet për vendimet e saj. (Rasti i GJEDNJ-së shih *Suominen kundër Finlandës*, kërkesa nr. 37007/97, i 1 korrikut 2003, paragrafi 36; dhe rastin e Gjykatës KI97/16, parashtrues "*IKK Classic",* Aktgjykim i 9 janarit 2018, paragrafi 50).

47. Prandaj, përderisa nuk është e nevojshme që gjykata të merret me çdo pikë të ngritur në argument (shih gjithashtu *Van de Hurk kundër Holandës*, *Ibidem*, paragrafi 61), argumentet kryesore të parashtruesve të kërkesës duhet të adresohen. (Shih rastet e GJEDNJ-së *Buzescu kundër Rumanisë,* kërkesa nr. 61302/00, Aktgjykimi i 24 majit 2005, paragrafi 63; *Pronina kundër Ukrainës,* Aktgjykim i 18 korrikut 2006, paragrafi 25). Po ashtu, dhënia e një arsyeje për një vendim që nuk është mirë e bazuar në ligj, nuk do të përmbushë kriteret e nenit 6 të Konventës. (Shih rastin e Gjykatës KI97/16, parashtrues "*IKK Classic",* Aktgjykim i 9 janarit 2018, paragrafi 51).

48. Për më tepër, Gjykata gjithashtu i referohet praktikës së saj gjyqësore ku ajo konsideron që arsyetimi i vendimit duhet të theksojë raportin ndërmjet gjetjeve në merita dhe vlerësimeve lidhur me provat e propozuara, nga njëra anë, dhe konkluzioneve ligjore të gjykatës, nga ana tjetër. Aktgjykimi i Gjykatës do të shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk përmban fakte të vërtetuara, dispozitat ligjore përkatëse dhe marrëdhënien logjike midis tyre. (Shih rastet KI72/12, *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri,* Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012, paragrafi 61, dhe KI97/16, parashtrues *"IKK Classic",* Aktgjykim i 9 janarit 2018, paragrafi 52).

49. Në këtë aspekt, Gjykata vëren që Aktgjykimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit nuk kishte adresuar pretendimet thelbësore të parashtruesve të kërkesës rreth afatshmërisë së ankesës së AKP-së kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale. Parashtruesit e kërkesës kishin pretenduar vazhdimisht se ankesa e AKP-së nuk ishte e afatshme dhe se pranimi i saj nga Kolegji i Apelit ishte në kundërshtim jo vetëm me Rregulloren 2008/6 por edhe me vetë praktikën e tij gjyqësore.

50. Më konkretisht, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës vazhdimisht kishin ngritur këto argumente në Kolegjin e Apelit: a) që kërkesa e AKP-së ishte e paafatshme sepse Rregullorja 2008/6 përcakton qartë që afati i ankesës në Kolegjin e Apelit ishte 30 (tridhjetë) ditë, ndërsa AKP-ja e kishte dorëzuar ankesën pas këtij afati bazuar në Këshillën Juridike të dhënë përmes Aktgjykimit të Gjykatës Komunale dhe Urdhëresën Administrative 2008/6; dhe se b) praktika gjyqësore e

Kolegjit të Apelit në mënyrë konsistente kishte aplikuar Rregulloren 2008/6, si akt juridik më i lartë se Urdhëresa Administrative 2008/6, në kalkulimin e afatshmërisë së ankesave. Kolegji i Apelit, në Aktgjykimin e tij, ka dështuar të adresojë dhe arsyetojë këto pretendime.

51. Në fakt, Kolegji i Apelit, duke aprovuar ankesën e të paditurës, përkatësisht AKP-së, si të bazuar dhe duke e prishur Aktgjykimin e Gjykatës Komunale, e bazoi arsyetimin e tij vetëm në paragrafin vijues:

> *"Gjykata e shkallës së parë e aprovoi mjetin juridik i cili nuk ekziston si çështje e së drejtës. Nga kjo padi është e qartë se i padituri nuk është pronarë i pasurive të patundshme që kishin qenë objekt i kontratës së vitit 1959. Pretendimi i një prone të ndryshme në vend të asaj fillestare, është ligjërisht i pamundur. Në raste të tilla - kur kontrata revokohet, anulohet, ose ndërpritet dhe i padituri nuk është pronar i objektit origjinal të kontratës në dispozicion është vetëm kompensimi monetar. Kështu, aktvendimi i ankimuar është i gabuar dhe duhet të prishet dhe padia të refuzohet si e pabazuar".*

52. Arsyetimi i Kolegjit të Apelit, në fakt, dështon të trajtoj çështjen e pranueshmërisë se ankesës së AKP-së dhe pretendimet e parashtruesve të kërkesës për paaftshmërinë e saj. Gjykata rithekson, duke iu referuar edhe praktikës konsistente gjyqësore të GJEDNJ-së e të elaboruar më lart, se përderisa gjykatat nuk janë të detyruara që të japin një përgjigje të hollësishme në çdo argument, argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës duhet të adresohen. Përcaktimi nëse argumentet thelbësore janë adresuar ose jo, varet nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit.

53. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata konsideron që pretendimet përkitazi me afatshmërinë e ankesës së AKP-së kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në bazë të legjislacionit të aplikueshëm dhe praktikës gjyqësore të Kolegjit të Apelit janë pretendime dhe argumente thelbësore të parashtruesve të kërkesës e të cilat duhet të adresohen dhe të arsyetohen nga Kolegji i Apelit.

54. Prandaj, Gjykata konsideron se dështimi i Kolegjit të Apelit për të dhënë arsyetim lidhur me pretendimet thelbësore të parashtruesve të kërkesës, paraqet shkelje të së drejtës së parashtruesit të kërkesës për t'u dëgjuar dhe të drejtës për një vendim të arsyetuar, si pjesë përbërëse e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. (Shih, ndër të tjera, Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në rastin nr. KI97/16, paragrafi 64).

55. Rrjedhimisht, në dritën e vlerësimeve të mësipërme dhe duke marrë parasysh procedurat në tërësi, Gjykata konsideron se Aktgjykimi [AC-II-12-0126] i 21 prillit 2016 i Kolegjit të Apelit nuk i plotëson kriteret e një "gjykimi të drejtë" siç kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së. (Shih rasti i GJEDNJ-së *Grădinar kundër Moldavisë,* Kërkesa nr. 7170/02, Aktgjykim i 8 prillit 2008, paragrafi 115)

56. Gjykata thekson se ky përfundim ekskluzivisht ka të bëjë me Aktgjykimin e kontestuar të Kolegjit të Apelit nga perspektiva e mungesës së arsyetimit lidhur me pretendimet thelbësore të parashtruesve të kërkesës, dhe në asnjë mënyrë nuk paragjykon rezultatin e meritave të rastit. (Shih, ndër të tjera, gjithashtu Aktgjykimin e Gjykatës në rastin nr. KI97/16, paragrafi 68).

57. Në fund, Gjykata rikujton që parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretendojnë shkelje të parimit të sigurisë juridike, duke theksuar se Aktgjykimi i Gjykatës Komunale ishte bërë *res judicata* me kalimin e pretenduar të afatit të ankesës dhe kërkojnë nga Gjykata që Aktgjykimin [C. nr. 2021/2007] e 29 korrikut 2010 të Gjykatës Komunale në Prishtinë ta lë në fuqi si *res judicata*. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës pretendojnë që Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit është nxjerrë duke shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Në ndërtimin e këtyre pretendimeve, parashtruesit e kërkesës iu referohen një numri rastesh të GJEDNJ-së.

58. Në këtë aspekt, Gjykata vëren që të dy këto pretendime, në esencë, ndërlidhen me interpretimin dhe arsyetimin e Kolegjit të Apelit rreth afatshmërisë së ankesave. Rrjedhimisht, duke marrë parasysh që Gjykata ka konstatuar shkelje të së drejtës në vendim të arsyetuar gjyqësorë, duke e shpallur të pavlefshëm Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit dhe duke ia kthyer çështjen Kolegjit të Apelit në rishqyrtim në përputhje me këtë Aktgjykim, Gjykata konsideron se nuk është e nevojshme të shqyrtohen këto pretendime.

Përfundim

59. Në përfundim, Gjykata konstaton se Kolegji i Apelit, duke mos i arsyetuar pretendimet thelbësore të parashtruesve të kërkesës rreth afatshmërisë së ankesës, si rezultat i së cilës e anuloi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale, ka shkelur të drejtën e parashtruesve të kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së. Si rezultat i kësaj

shkeljeje, parashtruesit e kërkesës u privuan nga e drejta e tyre për vendim të arsyetuar gjyqësor.

60. Si përmbledhje, në pajtim me rregullin 74 (1) të Rregullores së punës, Aktgjykimi [AC-II-12-0126] i 21 prillit 2016, i Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së shpallet i pavlefshëm dhe çështja i kthehet Gjykatës Supreme për rishqyrtim.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 113. 7 dhe 116. 1 të Kushtetutës, në nenet 47 dhe 48 të Ligjit dhe rregullat 56 (1), 63 (1) (5) dhe 74 (1) të Rregullores së punës, më 29 maj 2018, me shumicë votash

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1, të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

III. TA SHPALLË të pavlefshëm Aktgjykimin AC-II-12-0126 të 21 prillit 2016, të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme;

IV. TA KTHEJË Aktgjykimin AC-II-12-0126 të 21 prillit 2016 për rishqyrtim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, në pajtim me këtë Aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese;

V. TA URDHËROJË Gjykatën Supreme që ta njoftojë Gjykatën, në pajtim me rregullin 63 (5) të Rregullores së punës, për masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës;

VI. TË MBETET fuqimisht e angazhuar në këtë çështje në pritje të respektimit të këtij urdhri;

VII. T'UA KUMTOJË këtë aktgjykim palëve;

VIII. TA PUBLIKOJË këtë aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IX. Ky aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Gresa Caka-Nimani

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

KI 62/17 Parashtrues i kërkesës: Emine Simnica, e cila kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PN. II. nr. 1/17, të 31 janarit 2017, lidhur me Vendimin e Gjykatës Supreme PML. nr. 300/16, të 12 dhjetorit 2016

KI 62/17, Aktgjykim i 29 majit 2018, i publikuar më 18 qershor 2018

Fjalët kyçe: *kërkesë individuale, e drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm – e drejta e qasjes ne gjykate*

Prokuroria Themelore në Prishtinë ngriti aktakuzën kundër parashtrueses së kërkesës. Gjykata Themelore në Prishtinë nxori aktgjykimin, me të cilin e shpalli parashtruesen e kërkesës fajtore për kryerjen e veprës penale.

Prokurori i Shtetit parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit nxori aktgjykimin, me të cilin e aprovoi ankesën e Prokurorit të Shtetit dhe ndryshoi aktgjykimin e shkallës së parë.

Parashtruesja parashtroi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit. Gjykata Supreme nxori vendimin duke hedhur poshtë, si të papranueshme, kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë së përfaqësuesit ligjor të parashtrueses së kërkesës pa verifikuar autorizimin e saj.

Kundër aktvendimit të Gjykatës Supreme, parashtruesja paraqiti kërkesën për anulimin e vendimit të mëparshëm të Gjykatës Supreme, me pretendimin se Gjykata Supreme në vendimin e saj të mëparshëm nuk e përmbushi detyrimin e saj të parashikuar me ligj dhe në këtë mënyrë i mohoi të drejtat e saj për qasje ne Gjykate.

Gjykata konsideron se në këto rrethana, parashtrueses së kërkesës iu mohua e drejta për qasje në gjykatë, si parim i gjykimit të drejtë dhe të paanshëm në pajtim me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI62/17

Parashtrues

Emine Simnica

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PN. II. nr. 1/17, të 30 janarit 2017 në lidhje me Aktvendimin e Gjykatës Supreme, PML. nr. 300/16, të 12 dhjetorit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Emine Simnica nga Prishtina (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e kërkesës), e përfaqësuar nga avokatët Abit Asllani dhe Teuta Zhinipotoku.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme, PN. II. nr. 1/17, të 30 janarit 2017, në ndërlidhje me Aktvendimin Gjykatës Supreme PML. nr. 300/16, të 12 dhjetorit 2016.

3. Vendimi i kontestuar iu dorëzua parashtrueses së kërkesës më 7 shkurt 2017.

Objekti i çështjes

4. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtrueses së kërkesës të garantuara me nenin 16 [Epërsia e Kushtetutës], nenin 19 [Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare], nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit] dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 31 maj 2017, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 1 qershor 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.

8. Më 13 qershor 2017, Gjykata njoftoi parashtruesen e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës. Me këtë, Gjykata kërkoi nga parashtruesja që ta plotësojë kërkesën duke dorëzuar formularin e plotësuar të kërkesës.

9. Më 18 korrik 2017, parashtruesja e kërkesës dorëzoi kërkesën e plotësuar në Gjykatë.

10. Më 30 gusht 2017, Gjykata kërkoi nga Gjykata Supreme dhe Gjykata Themelore në Prishtinë të dorëzojnë vërtetimin që dëshmon se Gjykata Supreme kërkoi nga parashtruesja e kërkesës të dorëzojë autorizim për përfaqësuesin ligjor.

11. Më 13 shtator 2017, Gjykata përsëri kërkoi nga Gjykata Supreme dhe Gjykata Themelore në Prishtinë të dorëzojnë dokumentet e kërkuara më parë.

12. Më 14 nëntor 2017, duke marrë parasysh faktin se Gjykata nuk ka pranuar ndonjë përgjigje ndaj kërkesave të mëparshme, Gjykata kërkoi nga Gjykata Supreme dhe Gjykata Themelore të dorëzojnë shkresat e plota të lëndës sipas Aktvendimit [PN. II. nr. 1/17] të Gjykatës Supreme, të 30 janarit 2017 dhe Aktvendimit [PML. nr. 300/16] të Gjykatës Supreme, të 12 dhjetorit 2016.

13. Më 18 dhjetor 2017, Gjykata Supreme u përgjigj: *"Ju njoftojmë se ky rast është vendosur dhe është dorëzuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë më 02.02.2017. Prandaj, ju mund të kërkoni shkresat e lëndës nga Gjykata Themelore në Prishtinë".*

14. Më 25 janar 2018, duke marrë parasysh përgjigjen e Gjykatës Supreme dhe faktin se Gjykata nuk ka marrë përgjigje ndaj kërkesave të mëparshme të parashtruara në Gjykatën Themelore, Gjykata përsëri kërkoi nga Gjykata Themelore të dorëzojë shkresat e plota të lëndës në fjalë.

15. Më 9 shkurt 2018, Gjykata Themelore dorëzoi shkresat e plota të rastit në fjalë.

16. Më 29 maj 2018, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

17. Më 18 shtator 2015, Prokuroria Themelore në Prishtinë parashtroi aktakuzën [PP. I. nr. 572/2015] kundër parashtrueses së kërkesës me dyshim për kryerjen e veprës penale të mashtrimit në shpërndarjen e barërave në Qendrën Klinike Universitare në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: QKUK) në dëm të buxhetit të Kosovës.

18. Më 30 maj 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktgjykimin PKR. nr. 353/2015, pas pranimit të fajësisë së parashtrueses së kërkesës, shpalli parashtruesen e kërkesës fajtore për kryerjen e veprës penale. Me këtë aktgjykim parashtrueses së kërkesës i është shqiptuar dënim me kusht dhe gjykata gjithashtu e ka detyruar parashtruesen të kompensojë dëmin material të shkaktuar nga vepra penale e kryer.

19. Pas kësaj, parashtruesja e kërkesës, ka paguar kompensimin të cilin është urdhëruar ta bëjë për shkak të dëmit material në shumën prej 27,527.00 euro buxhetit të Republikës së Kosovës-Ministrisë së Shëndetësisë.

20. Parashtruesja e kërkesës, Prokurori i Shtetit dhe QKUK, në cilësinë e palës së dëmtuar, parashtruan ankesat në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, PKR. nr. 535/2015, të 30 majit 2016.

21. Më 13 korrik 2016, Prokurori i propozoi Gjykatës së Apelit: *"ndryshimin e aktgjykimit të kontestuar me qëllim që t'i shqiptojë të dënuarit dënim më të rëndë me burgim".*

22. Më 29 korrik 2016, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin PAKR. nr. 398/2016, aprovoi ankesën e Prokurorit të Shtetit dhe ndryshoi aktgjykimin e shkallës së parë lidhur me vendimin mbi dënimin e shqiptuar me burg, në mënyrë që parashtrueses së kërkesës t'i shqiptohet dënim efektiv me burg në vend të dënimit me kusht.

23. Arsyetimi i Aktgjykimit i Gjykatës së Apelit, lidhur me ndryshimin e dënimit me kusht në dënim efektiv, *inter alia,* thekson:

> *"Rrethanat e vlerësuara të cilat i ka konstatuar dhe vlerësuar gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarës E. S., sipas vlerësimit të kësaj gjykate, nuk janë të natyrës së atillë që të ndikojnë që në rastin konkret të akuzuarës, për ketë vepër penale t'i shqiptohet një dënim kaq i butë – dënim me kusht".*

24. Më 31 gusht 2016, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, PAKR. nr. 398/2016, parashtruesja parashtroi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme "*për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe të shkeljeve të kodit penal duke i propozuar Gjykatës Supreme të anulojë aktgjykimet e kontestuara dhe ta kthejë çështjen në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim ose ta ndryshojë atë në mënyrë që të vendosë dënim më të butë".*

25. Më 12 dhjetor 2016, Gjykata Supreme (Aktvendimi PML. nr. 300/2016), refuzoi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë si të papranueshme. Në arsyetimin e vendimit, Gjykata Supreme thotë:

> *"Nga aktgjykimet e kundërshtuara, rezulton se e dënuara Emine Rama-Simnica, në të gjitha fazat të procedurës penale për mbrojtës e ka pasur Abit Asllanin avokat nga Prishtina, i cili e ka paraqitur edhe ankesën kundër aktgjykimit të shkallës së parë.*

Kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë e ka paraqitur Teuta Zhinipotoku avokate nga Prishtina, ndërsa në shkresat e lëndës nuk ka ndonjë provë se mbrojtësja në fjalë ka pasur autorizim për ushtrimin e këtij mjeti juridik".

26. Më 28 dhjetor 2016, kundër Aktvendimit të Gjykatës Supreme, PML. nr. 300/2016, parashtruesja parashtroi kërkesë për anulimin e aktvendimit për shkak se *"ajo autorizimin e ka dorëzuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë së bashku me kërkesën që vërtetohet me vulën e pranimit, se në bazë të nenit 442 par. 4 të KPPK është paraparë se nëse parashtresa nuk është e kuptueshme apo nuk përmban atë që është e nevojshme për të vepruar lidhur me parashtresën, Gjykata e thërret palën për ta plotësuar apo korrigjuar atë, dhe se për t'u dhënë drejtësi dhe për t'u realizuar parimi i drejtësisë".*

27. Më 30 janar 2017, Gjykata Supreme [Aktvendimi PN. II. nr. 1/2017], duke refuzuar si të papranueshme kërkesën për anulimin e Aktvendimit të Gjykatës Supreme PML. nr. 300/2016. Në arsyetimin e vendimit, Gjykata Supreme deklaroi:

"Në dispozitën e nenit 418 të KPPK, në mënyrë decidive janë të përcaktuara rastet se kur mund të ushtrohen mjetet e jashtëzakonshme juridike kundër vendimit të formës së prerë, ndërsa në rastin konkret mbrojtësi i të dënuarës ka parashtruar kërkesë për anulimin e aktvendimit dhe vendosjen meritore për kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë kundër vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, kërkesë e cila nuk mund të konsiderohet si mjet i jashtëzakonshëm, andaj si e tillë kjo Gjykatë konsideron se duhet të hedhet poshtë si e palejuar".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

28. Parashtruesja e kërkesës pretendon se ne Aktgjykimin PAKR. nr. 398/2016, Gjykata e Apelit kishte shkelur të drejtën e saj për gjykim të drejtë, sepse ndryshoi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe e ndryshoi dënimin me kusht në dënim me burg efektiv, në mungesë të parashtrueses së kërkesës. Gjykata e Apelit ka qenë e obliguar ta thërras parashtruesen e kërkesës për të marrë pjesë në seancën pranë gjykatës së shkallës së dytë. Gjykata e Apelit nuk e ka bërë këtë dhe kështu ka shkelur edhe nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

29. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu pretendon se Gjykata Supreme pas pranimit të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, ishte e obliguar sipas ligjit "*në mungesë të autorizimit ose të ndonjë shkrese relevante*

në shkresat e lëndës, t'i drejtohet palës përfaqësuese me një shkresë duke i dhënë afat ligjor/gjyqësor të shkurtër që të eliminoj të metën eventuale në mënyrë që procesi të vazhdoj sipas ligjit". Megjithatë, Gjykata Supreme, në vendimin e saj PML. nr. 300/2016, nuk respektoi detyrimet e saj ligjore dhe refuzoi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë me arsyetimin se autorizimi i pretenduar nuk ishte në shkresat e lëndës. Në këtë mënyrë, Gjykata Supreme ia mohoi parashtrueses së kërkesës çfarëdo qasje në gjykatë, sepse ia refuzoi asaj mundësinë e mëparshme të korrigjimit dhe plotësimit të parashtresave të saj.

30. Në të njëjtën kohë, parashtruesja e kërkesës pretendon se pas refuzimit të kërkesës së saj për mbrojtjen e ligjshmërisë, ajo adresoi në Gjykatën Supreme një kërkesë për "*për të anuluar aktvendimin e saj të datës 12.12.2016 dhe për të kthyer çështjen në vendosje meritore njëherësh duke e njoftuar gjykatën me obligimet ligjore nga neni 442 par.4 i Kodit të Procedurës Penale në fuqi*". Megjithatë, kjo kërkesë u refuzua gjithashtu nga Gjykata Supreme, dhe kështu i ishte mohuar e drejta për gjykim të drejtë dhe qasje në gjykatë.

31. Parashtruesja kërkon që Gjykata ta aprovojë kërkesën, dhe "*si të bazuar në Kushtetutë, [...], të* ***konstatohet*** *shkelja e dispozitave kushtetuese, [...],* ***të rekomandohet kthimi*** *i rastit pranë Gjykatës së Apelit në rishqyrtim dhe rivendosje [...]*".

Pranueshmëria e kërkesës

32. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

33. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

34. Gjykata më tutje shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës ka përmbushur kërkesat e pranueshmërisë siç parashihet me Ligj. Në

lidhje me këtë, Gjykata i referohet neneve 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilat parashohin:

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej 4 (katër) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor".

35. Lidhur me përmbushjen e këtyre kërkesave, Gjykata vëren se parashtruesja e ka parashtruar kërkesën si individ dhe në cilësinë e palës së autorizuar, duke e kontestuar aktin e autoritetit publik, përkatësisht Aktvendimin e Gjykatës Supreme, PN. II. nr. 1/17, të 31 janarit 2017, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu sqaroi të drejtat dhe liritë që ajo pretendon se i janë shkelur në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe ka parashtruar kërkesën në përputhje me afatet e parapara me nenin 49 të Ligjit.

36. Megjithatë, Gjykata duhet të shqyrtojë më tej nëse janë plotësuar kërkesat e përcaktuara në rregullin 36 të Rregullores së punës.

37. Rregulli 36 [Kriteret e pranueshmërisë], paragrafi (1) (d) dhe (2) (d) i Rregullores së punës, parasheh:

"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:
[...]
d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar;

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

38. Gjykata së pari vëren se parashtruesja e kërkesës pretendon shkelje të epërsisë së Kushtetutës, zbatimit të së drejtës ndërkombëtare, parimet

e përgjithshme, zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare, barazinë para ligjit, të drejtën e qasjes në gjykatë dhe të drejtën në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me Kushtetutë.

39. Gjykata po ashtu vëren se, në thelb, kërkesa e parashtrueses bazohet në shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

40. Në fund, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës ka qartësuar saktësisht shkeljet e pretenduara të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së. Prandaj, Gjykata konstaton se kjo kërkesë nuk është qartazi e pabazuar në kuptim të rregullit 36 (1) (d) të Rregullores së punës. Përveç kësaj, ajo vëren se kërkesa nuk është e papranueshme për asnjë arsye tjetër. Prandaj, kërkesa duhet të deklarohet e pranueshme (shih: rastin *Alimuçaj kundër Shqipërisë*, GJEDNJ, kërkesa nr. 20134/05, Aktgjykimi i 9 korrikut 2012, paragrafi 144).

Meritat

41. Gjykata rikujton se pretendimi kryesor i parashtrueses së kërkesës është shkelja e të drejtave të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, sepse:

> *"Gjykata Supreme pa vërtetuar paraprakisht faktet që kanë rëndësi për vazhdimin e procedurës e refuzoi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë së përfaqësuesit ligjor të parashtrueses së kërkesës, sepse sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, kërkesa ishte dorëzuar nga pala e paautorizuar".*

42. Gjykata i referohet dispozitave përkatëse të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së:

> Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]:
>
> *"Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
>
> *Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj".*

Neni 6 (E drejta për një proces të rregullt) i KEDNJ-së:

"1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë".

[...]

3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:

[...]

(c) të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë".

43. Gjykata gjithashtu përsërit se në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës *"[Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".*

44. Në këtë drejtim, Gjykata së pari vëren se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së vazhdimisht konsideron se drejtësia e procedurës vlerësohet në bazë të procedurës si tërësi (shih Aktgjykimi i GJEDNJ-së, *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, nr. 146, paragrafi 68). Prandaj, në procedurën e vlerësimit të bazës së pretendimeve të parashtrueses së kërkesës, Gjykata do t'u përmbahet këtyre parimeve.

45. Gjykata vëren se pretendimi kryesor i parashtrueses së kërkesës është shkelja e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Parashtruesja e kërkesës pretendon se Gjykata Supreme ka pasur

detyrim ligjor për të kërkuar zyrtarisht autorizimin nga parashtruesja ose përfaqësuesi i saj ligjor. Parashtruesja më tej pretendon se Gjykata Supreme me këtë mosveprim e ka privuar atë nga e drejta për një gjykim të drejtë.

46. Parashtruesja i paraqiti këto argumente në Gjykatën Supreme në ankesën e 28 dhjetorit 2016 kundër Aktvendimit të parë [PML. nr. 300/2016] të Gjykatës Supreme, të cilin, Gjykata Supreme e refuzoi si të papranueshme [Aktvendimi PN. II. jo. 1/2017].

47. Në rastin konkret, parashtruesja konsideron se Aktvendimi i Gjykatës Supreme PML. nr. 300/2016, i 12 dhjetorit 2016, ka shkelur të drejtën për gjykim të drejtë, sepse Gjykata Supreme nuk e mori parasysh kërkesën e saj për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, PAKR. nr. 398/2016, me arsyetimin se *"nga aktgjykimet e kundërshtuara, rezulton se e dënuara Emine Rama-Simnica, në të gjitha fazat të procedurës penale për mbrojtës e ka pasur Abit Asllanin avokat nga Prishtina, i cili e ka paraqitur edhe ankesën kundër aktgjykimit të shkallës së parë. Kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë e ka paraqitur Teuta Zhinipotoku avokate nga Prishtina, ndërsa në shkresat e lëndës nuk ka ndonjë provë se mbrojtësja në fjalë ka pasur autorizim për ushtrimin e këtij mjeti juridik"*.

48. Një qëndrim i tillë i Gjykatës Supreme, sipas mendimit të parashtrueses së kërkesës, është në kundërshtim me obligimet e gjykatës të parapara me nenin 442.4 të KPPK-së, që e pengoi atë të vazhdonte me procedurat e mëtejme dhe me këtë kishte ardhur deri te shkelja e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Gjykata deklaron se në thelb, parashtruesja e kërkesës pretendon shkelje të së drejtës për qasje në gjykatë, pasi Gjykata Supreme e refuzoi ankesën e saj pa hyrë në thelbin e kërkesës.

49. Rrjedhimisht, Gjykata do të shqyrtojë pretendimet e parashtrueses në lidhje me të drejtën e "qasjes në gjykatë", si një nga parimet e një gjykimi të drejtë në pajtim me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

Parimet e përgjithshme (Qasja në gjykatë)

50. Së pari, Gjykata rikujton se në rastin *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, në paragrafin 36, GJEDNJ-ja konstatoi: "36. (...) *e drejta e qasjes përbën një element që është i pandarë në të drejtën e përcaktuar në nenin 6 paragrafi. 1. Neni 6 para. 1 u siguron të gjithëve të drejtën për të iniciuar procedurë për përcaktimin e të*

drejtave dhe detyrimeve të tij civile pranë një gjykate ose tribunali. Në këtë mënyrë, ky nen përfshin "të drejtën për një gjykatë", nga e cila e drejta e qasjes, përkatësisht e drejta për të filluar procedura pranë gjykatave në çështjet civile, përbën vetëm një aspekt. (shih rastin *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 21 shkurt 1975, §§ 28-36, Seria A. nr. 18)

51. Prandaj, GJEDNJ-ja, me interpretimin e saj ligjor të nenit 6 të KEDNJ-së, ka pranuar "të drejtën e qasjes në gjykatë" si parim që nuk është përcaktuar nga kjo dispozitë, por sipas kuptimit të GJEDNJ-së, ajo përfshihet në mënyrë implicite në vetë dispozitën.

52. Përveç kësaj, në rastin *Kreuz kundër Polonisë*, GJEDNJ-ja deklaroi "*Gjykata përsërit, siç ka theksuar në shumë raste, se neni 6 para. 1 u siguron të gjithëve të drejtën për të paraqitur kërkesë në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij civile pranë një gjykate ose tribunali. Në këtë mënyrë, kjo dispozitë përmban "të drejtën në gjykatë", të drejtën e qasjes, si një parim që në të vërtetë mundëson përfitim nga garancitë e mëtejshme të parashtruara në paragrafin 1 të nenit 6* (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së: *Kreuz v Polonia*, kërkesa nr. 2824/95 i 20 prillit 1998 paragrafi 52)

53. Gjykata Evropiane gjithashtu në aktgjykimin *Lesjak kundër Kroacisë* (2010), përsërit atë që përbën një qasje përfundimtare në gjykatë ose të drejtën e qasjes në gjykatë: "*35. Gjykata përsërit se neni 6 para. 1 i Konventës u siguron të gjithëve të drejtën për të parashtruar kërkesë në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij civile pranë një gjykate ose tribunali. E drejta e qasjes, përkatësisht e drejta për të filluar procedura pranë një gjykate në çështjet civile përbën një aspekt të kësaj "të drejte në gjykatë*" (shih, veçanërisht, *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, të 21 shkurtit 1975, §§ 28-36 , Seria A nr. 18). Në mënyrë që e drejta e qasjes të jetë efektive, individi duhet të ketë një mundësi të qartë dhe praktike për të kontestuar një akt që i pengon të drejtat e tij ose të saj (...). (...) (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Lesjak kundër Kroacisë*, kërkesa nr. 25904/06, i 18 shkurtit 2010).

54. Për më tepër, Gjykata rikujton që GJEDNJ ka konstatuar se e drejta e qasjes në gjykatë vlen edhe për rastet penale (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 13 majit 2001, *Krombach kundër Francës*, nr. 29731/96, paragrafi 96).

55. Prandaj, në pajtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, e drejta e qasjes në gjykatë nuk nënkupton vetëm të drejtën për të filluar procedurat pranë një gjykate, por, me qëllim që e drejta e qasjes në gjykatë të jetë efektive, individi duhet të ketë gjithashtu një mundësi

të qartë dhe reale për të kontestuar vendimin që shkel të drejtat e tij/saj. Me fjalë të tjera, e drejta e qasjes në gjykatë nuk shterohet vetëm në të drejtën për të filluar procedurën në gjykatë, por kuptimi i saj është shumë më i gjerë pasi që përfshin të drejtën për "zgjidhjen" e mosmarrëveshjes nga gjykata kompetente.

56. Gjykata më tej thekson se e drejta për qasje në gjykatë nuk është absolute, por mund t'i nënshtrohet kufizimeve, pasi që nga vetë natyra e saj kërkon rregullim nga shteti, i cili gëzon një liri të caktuar vlerësimi në këtë drejtim.

57. Gjykata rikujton arsyetimin e Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut (Raporti i 5 prillit 1995, *Société Levages Prestations Services kundër Francës*, nr. 21920/93, paragrafi 40): *"[...] Komisioni konsideron se vendimi i [Gjykatës Supreme] i cili në këtë rast çoi në papranueshmërinë e ankesës për çështje të ligjit, kishte pasoja joproporcionale dhe të pabarabarta në të drejtën e parashtruesit për qasje në gjykatë dhe ia ka mohuar [atij] në praktikë mundësinë e ushtrimit të mjetit juridik që ishte efektiv në ligjin e [brendshëm]"*.

58. Me fjalë të tjera, çdo kufizim i të drejtës së qasjes në gjykatë nuk duhet të kufizojë ose zvogëlojë qasjen e një personi në atë mënyrë apo në një masë të tillë që të dëmtohet vetë thelbi i "së drejtës në gjykatë". Kufizimet e tilla nuk do të jenë të pajtueshme nëse ato nuk ndjekin një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një raport i arsyeshëm i proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që dëshirohet të arrihet (shih rastet: *Sotiris dhe Nikos Koutras*, *ATTEE kundër Greqisë* (2000), para. 15, *Běleš dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* (2002),§ 61*)*.

59. Prandaj, në bazë të vendimeve të Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut dhe të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata konsideron se kufizimet nuk do të jenë në pajtim me nenin 6, par. 1. Nëse: a) nuk ndjekin një qëllim legjitim; dhe b) nëse nuk ka një marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit të kërkuar (shih Gjykata Evropiane, *Stubbings dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykimi i 22 tetorit 1996, Raporti i aktgjykimeve dhe vendimeve 1996 - IV, paragrafi 50; dhe, *mutatis mutandis*, *Lončar kundër Bosnjës dhe Hercegovinës*, kërkesa nr. 15835/08, Aktgjykimi i 25 shkurtit 1996, paragrafi 37).

Zbatimi i këtyre parimeve dhe garancive në rastin aktual

60. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës në rastin konkret ka pasur qasje në gjykata, si edhe në Gjykatën Supreme, por vetëm deri në

momentin e dorëzimit të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit.

61. Megjithatë, fakti i thjeshtë se parashtruesja e kërkesës kishte mundësi ligjore për të parashtruar këtë kërkesë në Gjykatën Supreme nuk çon domosdoshmërisht drejt përmbushjes së të drejtës së qasjes në gjykatë që rrjedh nga neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Prandaj, mbetet të përcaktohet nëse vendimi i Gjykatës Supreme me të cilën u hodh poshtë kërkesa e parashtrueses për mbrojtjen e ligjshmërisë pa verifikim i cili kërkohet me ligj dhe nën arsyetimin se përfaqësuesi i saj ligjor nuk ishte i autorizuar, në mënyrë efektive ia mohoi parashtrueses "të drejtën e qasjes në gjykatë" nga këndvështrimi i parimit të sundimit të ligjit në një shoqëri demokratike, si dhe garancitë e parapara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

62. Në këtë drejtim, Gjykata thekson që "e drejta në ankesë" nuk është definuar ose nënkuptuar në nenin 6 të KEDNJ-së, por nëse ankesa është lejuar me ligj dhe nëse është parashtruar, dhe në këtë rast Gjykata Supreme, ishte njoftuar për këtë dhe ishte thirrur për të përcaktuar faktet që janë thelbësore për vazhdimin e procedurave në aspektin procedural, atëherë sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, është i zbatueshëm paragrafi i parë i nenit 6 të KEDNJ-së (shih GJEDNJ *Delcourt kundër Belgjikës*, i 17 janarit 1970, Seria A f. 11-14).

63. Gjykata vëren se arsyeja kryesore për refuzimin e ankesës së parashtrueses nga Gjykata Supreme është se parashtruesja kishte një përfaqësues në Gjykatën Themelore dhe në Gjykatën e Apelit, ndërsa kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme ishte parashtruar nga një tjetër përfaqësues për të cilin, sipas Gjykatës Supreme, nuk kishte autorizim në shkresat e lëndës.

64. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, parimi i gjykimit të drejtë nënkupton të drejtën e palës për t'u mbrojtur personalisht ose nëpërmjet një përfaqësuesi të zgjedhur prej tij dhe se kjo e drejtë është e lidhur ngushtë me të drejtën për një gjykim të drejtë (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 25 prillit 1983, *Pakelli kundër Gjermanisë*, nr. 64, paragrafi 31).

65. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës më 28 dhjetor 2016 ka parashtruar prapë kërkesë në Gjykatën Supreme ku ajo ka paraqitur autorizimin e kontestuar dhe ka deklaruar *"nëse Gjykata Supreme ka ndonjë dyshim ose paqartësi lidhur me statusin e përfaqësuesit të parashtrueses dhe kërkesës së parë për mbrojtjen e ligjshmërisë, ajo duhet të ketë, në pajtim me*

nenin 442 par. 4 të KPPK-së, kërkuar sqarim ose plotësim të kërkesës së parashtrueses brenda afatit të caktuar".

66. Gjykata rikujton se neni 442.4 i KPPK-së, parasheh:

> *[...]*
> *"4. Nëse me këtë Kod nuk është paraparë ndryshe, gjykata thërret paraqitësin e parashtresës së pakuptueshme ose që nuk përmban atë që është e nevojshme që të mund të veprohet në bazë të saj, që ta korrigjojë apo ta plotësojë parashtresën, e nëse ai nuk e bën këtë brenda afatit të caktuar, gjykata e hedh poshtë parashtresën".*

67. Megjithatë, Gjykata vëren se, duke iu përgjigjur kërkesës së parashtrueses së 28 dhjetorit 2016, Gjykata Supreme në Aktvendimin [PN. II. nr. 1/2017] të 31 janarit 2017, deklaroi:

> *"Në dispozitën e nenit 418 të KPPK, në mënyrë decidive janë të përcaktuara rastet se kur mund të ushtrohen mjetet e jashtëzakonshme juridike kundër vendimit të formës së prerë, ndërsa në rastin konkret mbrojtësi i të dënuarës ka parashtruar kërkesë për anulimin e aktvendimit dhe vendosjen meritore për kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë kundër vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, kërkesë e cila nuk mund të konsiderohet si mjet i jashtëzakonshëm, andaj si e tillë kjo Gjykatë konsideron se duhet të hedhet poshtë si e palejuar".*

68. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se në Aktvendimin e saj [PN. II. nr. 1/2017], të 30 janarit 2017, Gjykata Supreme nuk mori parasysh kërkesën e parashtrueses për anulimin e vendimit të Gjykatës Supreme, të 12 dhjetorit 2016, por u mor vetëm me çështjen procedurale, *nëse kërkesa e parashtrueses së 28 dhjetorit 2016 është në pajtim me dispozitat përkatëse ligjore*, përkatësisht nëse parashtruesja kishte të drejtë të shfrytëzojë kërkesën për anulimin e vendimit të Gjykatës Supreme, të 12 dhjetorit 2016, si një mjet i jashtëzakonshëm juridik.

69. Megjithatë, Gjykata vëren se thelbi i kërkesës së parashtrueses për anulimin e Aktvendimit të Gjykatës Supreme, të 12 dhjetorit 2016, ka të bëjë me faktin se Gjykata Supreme e refuzoi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë pa e ftuar paraprakisht parashtruesen për të korrigjuar ose të plotësuar parashtresën siç kërkohet me dispozitën ligjore të nenit 442.4 të KPPK-së, *gjykata thërret paraqitësin e parashtresës që*

ta korrigjojë apo ta plotësojë parashtresën, e nëse ai nuk e bën këtë brenda afatit të caktuar, gjykata e hedh poshtë parashtresën.

70. Gjykata rikujton që parashtruesja e kërkesës në mënyrë eksplicite pretendon se, në bazë të nenit 442.4 të KPPK-së, Gjykata Supreme është dashur të kërkonte plotësimin dhe sqarimin e parashtresave të saj, dhe jo ta refuzonte me procedurë të shkurtër ankesën me Aktvendimin [PML. nr. 300/2016] pa vërtetimin paraprak të kërkesave procedurale që do të lejonin shqyrtimin e thelbit të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë.

71. Në lidhje me këtë, Gjykata konsideron se neni 442.4 i KPPK-së nuk është i pasaktë, dhe as i paqartë sa i përket hapave proceduralë që duhet të ishin ndërmarrë nga Gjykata Supreme. Përkundrazi, neni 442.4 i KPPK-së në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë përcakton se cilat hapa proceduralë që është dashur të ndërmerren nga Gjykata Supreme në lidhje me ankesën e parashtrueses, si dhe cilat veprime duhet të ndërmarrin palët brenda afatit të caktuar.

72. Megjithatë, Gjykata Supreme nxori një vendim, me të cilin e refuzoi me procedurë të shkurtër kërkesën e parashtrueses në baza procedurale, pa i lejuar asaj të sqaronte identitetin e përfaqësuesit të saj ligjor. Në këtë mënyrë, Gjykata Supreme e kufizoi qasjen e parashtrueses së kërkesës në gjykatë.

73. Gjykata konsideron se Gjykata Supreme ka të drejtë të marrë vendim në përputhje me juridiksionin e saj, por vetëm pasi që parashtrueses së kërkesës, në pajtim me dispozitat e aplikueshme të nenit 442.4 të KPPK-së, t'i jepet mundësia që të heqë në kohën e duhur të gjitha dyshimet dhe pasiguritë që kishte Gjykata Supreme në lidhje me statusin e përfaqësuesit të saj ligjor.

74. Përveç kësaj, Gjykata vëren se Gjykata Supreme në vendimin e saj të dytë nuk dha ndonjë shpjegim për arsyet e moszbatimit të nenit 442.4 të KPPK-së, si dhe pse e drejta e saj për qasje në gjykatë ishte e kufizuar deri në atë masë sa të ketë penguar atë krejtësisht që të vazhdojë me mjetin juridik të mbrojtjes së ligjshmërisë.

75. Kufizime të tilla të Gjykatës Supreme nuk mund të çonin në një qëllim legjitim që do të lejonte marrjen e një vendimi për meritat në këtë rast, prej nga rezulton se nuk ka marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura nga Gjykata Supreme dhe qëllimit të ndjekur, që do të çonte në një vendim përfundimtar lidhur me kontestin e rastit.

76. Gjykata konsideron se në rrethana të tilla, parashtruesja e kërkesës është privuar nga e drejta e saj për qasje në gjykatë, si parim i një gjykimi të drejtë dhe të paanshëm në pajtim me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

77. Prandaj, Gjykata konstaton se ka pasur shkelje të nenit 31.1 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 56 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 29 maj 2018, me shumicë

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme për shqyrtim në merita;

II. TË KONSTATOJË se Aktvendimi i Gjykatës Supreme [PML. nr. 300/2016], i 12 dhjetorit 2016, është në kundërshtim me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

III. TA SHPALLË TË PAVLEFSHËM Aktvendimin e Gjykatës Supreme [PML. nr. 300/2016], të 12 dhjetorit 2016, në lidhje me Aktvendimin e Gjykatës Supreme [PN. II. nr. 1/2017], të 30 janarit 2017;

IV. TA KTHEJË rastin në Gjykatën Supreme për rishqyrtim në pajtim me aktgjykimin e kësaj Gjykate;

V. TA URDHËROJË Gjykatën Supreme, që në pajtim me rregullin 63 (5) të Rregullores së punës, ta njoftojë Gjykatën në lidhje me masat e ndërmarra për zbatimin e aktgjykimit të kësaj Gjykate;

VI. TË MBETET fuqimisht e angazhuar në këtë çështje në pritje të pajtueshmërisë me atë urdhër;

VII. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

VIII. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IX. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi	Arta Rama-Hajrizi

KI69/16 Parashtruese e kërkesës: Nora Dukagjini-Salihu, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 295/2015 të 9 dhjetorit 2015

KI69/16, Aktgjykim i 30 majit 2018, publikuar më 13 qershor 2018.

Fjalët kyç*: kërkesë individuale, vlerësim kushtetues i vendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, kërkesë e pranueshme.*

Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121, dhe rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Ky rast ka të bëjë me kontest të punës të filluar para Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës me qëllim të krijimit të marrëdhënies së punës në pozitën e specialistit të ortodoncisë në Shtëpinë e Shëndetit në Prishtinë.

Më pas, procedurat gjyqësore kaluan nëpër të gjitha fazat e procedurës së rregullt.

Ky kontest gjyqësor më në fund u vendos me vendimin e Gjykatës Supreme, me të cilin ishte refuzuar kërkesën e parashtrueses për revizion si e papranueshme.

Parashtruesja e kërkesës pretendon se Gjykata Supreme ia ka mohuar asaj të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës nuk ka demonstruar që procedurat përkatëse kanë qenë, në ndonjë mënyrë, të padrejta ose arbitrare. Në të vërtetë, parashtruesja e kërkesës nuk ka dëshmuar me prova pretendimin se të drejtat dhe liritë e saj të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ janë shkelur me vendimet e kontestuara.

Prandaj, Gjykata më tej konsideron se interpretimi dhe zbatimi i ligjit të dhënë në Gjykatën Supreme ka dështuar të arsyetojë në mënyrë adekuate vendimin e saj lidhur me marrëdhëniet ndërmjet statusit të punësimit të parashtrueses së kërkesës dhe legjislacionit përkatës në fuqi, siç kërkohet me të drejtën për gjykim të drejtë.

Gjykata më tej konsideron se, në këto rrethana, parashtruesja e kërkesës është privuar nga e drejta e saj për gjykim të drejtë dhe të paanshëm sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, dhe të kthehet në pozitën e saj të punës si stomatologe në Shtëpinë e Shëndetit në Prishtinë.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI69/16

Parashtrues

Nora Dukagjini-Salihu

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 295/2015, të 9 dhjetorit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Nora Dukagjini-Salihu nga Prishtina (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e kërkesës), e cila përfaqësohet nga Petrit Prekazi, avokat në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 295/2015, të 9 dhjetorit 2015, i cili i është dorëzuar asaj më 21 janar 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, me të cilin, sipas pretendimeve të parashtrueses, janë shkelur të drejtat e saj të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të

Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe me nenin 6.1 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 20 prill 2016, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 11 maj 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.

7. Më 2 qershor 2016, Gjykata e njoftoi parashtruesen për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Komunës së Prishtinës.

8. Më 30 maj 2018, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës dhe konstatimin e shkeljes së Kushtetutës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 10 korrik 1990, organi menaxhues i Shtëpisë së Shëndetit në Prishtinë (Aktvendimi nr. 160) vendosi se parashtruesja e kërkesës kishte fituar cilësinë e punonjëses me kohë të pacaktuar si stomatologe në Shtëpinë e Shëndetit në Prishtinë (tani Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, në tekstin e mëtejmë: QKMF).

10. Më 1 janar 2000, Departamenti i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale i Strukturës së Përbashkët të Përkohshme Administrative (SPPA-DSHMS) miratoi Udhëzimin Administrativ (Shëndetësi) 17/2000, i cili rregullon formimin e një bordi qendror për trajnimin e specialistëve mjekësorë.

11. Udhëzimi Administrativ (Shëndetësi) 17/2000 përcaktoi në pikën E [Organizimet e Përgjithshme Administrative], ndër të tjera, se:

> "*6. Mjekët që me sukses kanë mbaruar trajnimin e tyre specialistik dhe janë të regjistruar si specialist me leje të punës, duhet të konkurrojnë për vendet e punës në shërbimet publike shëndetësore në Kosovë. Ata nuk mund të mbeten në postet e tyre të trajnimit e as nuk mund t'ju ofrohen automatikisht poste në institucionet e trajnimit.*
>
> *7. […] Kur mjekët pranojnë ofertën për trajnimin specialistik nga Departamenti i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, ata duhet të përfundojnë çdo tentim të punëdhënësit të mëparshëm për punësim dhe nuk duhet lidhur asnjë kontratë që obligon të ardhmen*

12. Më 17 janar 2001, me Vendimin (Ref. nr. 893/2000) SPPA-DSHMS i lejoi parashtrueses së kërkesës specializimin në lëmin e ortopedisë së nofullave financuar nga SPPA-DSHMS, sipas kushteve të Udhëzimit Administrativ (Shëndetësi) 17/2000.

13. Më 2 prill 2001, parashtruesja e kërkesës dhe SPPA-DSHMS nënshkruan "Kontratën e Punës për Specialistë". Kjo kontratë përcaktoi, ndër të tjera, se parashtruesja e kërkesës do të merrte një pozitë për trajnim në Qendrën Klinike Universitare të Prishtinës, se kontrata e punës do të zgjaste nga 10 janari 2001 deri më 10 janar 2005 dhe se asaj do t'i paguhej një pagë mujore prej 360 markave gjermane.

14. Me kontratën e punës gjithashtu parashihej që:

> "*Kërkohet që pas kompletimit të suksesshëm të trajnimit profesional dhe regjistrimit si mjek i licencuar të punoj me orar të plotë për pesë vjet pa ndërprerje për Shërbimin Publik Shëndetësor të Kosovës apo të kthej të gjitha pagat e fituara si specializant".*

15. Pas përfundimit të trajnimit të saj, specializimit, parashtruesja e kërkesës duket se u takua me Drejtorin e Përgjithshëm të Shtëpisë së Shëndetit të Prishtinës, Sekretarin e Përhershëm të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë në Komunën e Prishtinës për të kërkuar një pozitë si specialiste. Pretendohet se parashtruesja e kërkesës u informua nga të gjithë këta zyrtarë se nuk kishte asnjë pozitë në dispozicion.

16. Më 4 maj 2005, së bashku me një numër mjekësh të tjerë që kishin përfunduar specializimin e tyre, parashtruesja e kërkesës iu drejtua me një letër Drejtorit të Përgjithshëm të Shtëpisë së Shëndetit të Prishtinës, duke kërkuar kthimin në vendin e mëparshëm të punës si stomatologe jo specialiste dhe kompensimin për pagat e humbura.

17. Duket se Drejtori i Përgjithshëm i Shtëpisë së Shëndetit të Prishtinës nuk i është përgjigjur kësaj letre.

18. Më 12 maj 2006, Ministri i Shëndetësisë nxori Vendimin (nr. 20-03-2006), me të cilin suspendohet zbatimi i pikave 9 dhe 10 të Kontratës për financimin e studimeve postdiplomike (specializimit), si dhe të detyrimeve të marra përsipër nga specialistë të trajnimit pas përfundimit të specializimit. Me këtë vendim, specializantët janë liruar nga obligimi që të vazhdojnë të punojnë edhe pesë vjet në sektorin e shëndetësisë në Kosovë. Vendimi në fjalë është marrë me arsyetimin se "*shkurtimet buxhetore vështirësojnë zbatimin e pikave 9 dhe 10".*

Kërkesa për pozitë të re si specialiste

19. Në një datë të pacaktuar, parashtruesja e kërkesës parashtroi ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPMK), në të cilën kërkoi themelimin e marrëdhënies së punës në pozitën e specialistit për ortopedinë e nofullave në Shtëpinë e Shëndetit në Prishtinë.

20. Më 13 korrik 2006, KPMK (me Vendimin A. nr. 02/117/2005), e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtrueses për themelimin e marrëdhënies së punës në pozitën e specialistit për ortopedinë e nofullave në Shtëpinë e Shëndetit në Prishtinë.

21. KPMK-ja arsyetoi se kontrata e punës për specializim e nënshkruar ndërmjet parashtrueses së kërkesës dhe Ministrisë së Shëndetësisë e detyronte parashtruesen e kërkesës të vazhdojë të punojë për një periudhë prej pesë vitesh në shërbimin shëndetësor publik, por nuk përmbante asnjë detyrim reciprok ndaj Ministrisë së Shëndetësisë që t'i sigurojë parashtrueses së kërkesës një vend të punës. KPMK-ja konsideroi se mungesa e një detyrimi reciprok që Ministria e Shëndetësisë t'ia sigurojë një vend të punës ishte arsyeja që Ministria e Shëndetësisë ta pezullonte detyrimin që parashtruesja e kërkesës të vazhdonte të punonte për pesë vite në shërbimin shëndetësor publik.

Kërkesa për kthim në vendin e vjetër si stomatologe

22. Parashtruesja e kërkesës paraqiti padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, me të cilën e kontestoi Vendimin A. nr. 02/117/2005 e KPMK-së, të 13 korrikut 2006, dhe njëkohësisht kërkoi që e paditura QKMF të urdhërohet që ta kthejë atë në detyrat e mëparshme të punës si stomatologe, me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës, duke filluar prej 4 janarit 2005.

23. Më 29 gusht 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë (me Aktgjykimin C. nr. 73/10) e aprovoi kërkesëpadinë e parashtrueses si të bazuar, sepse parashtruesja e kërkesës kishte pritje legjitime që asaj do t'i sigurohej një vend pune pas specializimit të saj, për shkak të obligimit kontraktual që të vazhdonte të punonte edhe për 5 (pesë) vjet në shërbimin shëndetësor publik. Gjykata Themelore urdhëroi:

> *"DETYROHET pala e paditur QKMF që bie në menaxhimin e Komunës së Prishtinës - Drejtorisë për Shëndetësi, që paditësen [parashtruesen e kërkesës], ta kthej në punë dhe detyrat e mëparshme të punës [stomatologe] me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës, duke filluar nga data 04.01.2005".*

24. Përveç kësaj, Gjykata Themelore konsideroi se Udhëzimi Administrativ (Shëndetësi) 17/2000 nuk ishte zbatuar në rastin e parashtrueses së kërkesës, sepse punësimi i saj në shërbimin publik të Kosovës nga 10 korriku 1990 nuk ishte ndërprerë në pajtim me ligjin e aplikueshëm, përkatësisht Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Udhëzimin Administrativ të UNMIK-ut nr. 2003/2 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36, neni 35.

25. QKMF dhe Komuna e Prishtinës parashtruan ankesa kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C. nr. 73/2010.

26. Më 7 prill 2015, Gjykata e Apelit e Kosovës, me Aktgjykimin Ac. nr. 4391/2014, i refuzoi ankesat si të pabazuara. Gjykata e Apelit vlerësoi arsyetimin e Gjykatës Themelore si të drejtë dhe të justifikuar në pajtim me dispozitat ligjore përkatëse.

27. Parashtruesja e kërkesës në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 4391/2014, inicioi procedurën përmbarimore në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

28. Më 19 maj 2015, Gjykata Themelore në Prishtinë me Aktvendimin nr 1087/2015, e aprovoi propozimin për përmbarim të parashtrueses dhe urdhëroi që të:

> *"CAKTOHET PËRMBARIMI ndaj debitorit Komuna e Prishtinës - Drejtoria Komunale për Shëndetësi në Prishtinë, ashtu që detyrohet debitori që kreditoren [parashtruesen e kërkesës] ta kthej në punët dhe detyrat e punës Stomatologe në kuadër të QKMF-së dhe t'ia paguaj 478.00 € në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktvendimi".*

29. Komuna e Prishtinës ushtroi prapësim në Gjykatën Themelore në Prishtinë kundër Aktvendimit mbi lejimin e përmbarimit.

30. Më 13 korrik 2015, Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin E. nr. 1087/2015, e refuzoi "*prapësimin e debitorit: Komuna e Prishtinës, Drejtoria Komunale për Shëndetësi në Prishtinë, të ushtruar kundër aktvendimit mbi lejimin e përmbarimit E. n. 1087/2015, të dt. 19.06.2015, si të pabazuar".*

31. Kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore me të cilin është refuzuar prapësimi si i pabazuar, Komuna e Prishtinës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit.

32. Më 10 dhjetor 2015, Gjykata e Apelit, me Aktvendimin Ac. nr. 3084/15, e refuzoi "*si të pabazuar ankesën e përfaqësuesit të debitorit Komuna e Prishtinës, Drejtoria Komunale për Shëndetësi në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, E. nr. 1087/2015, të dt. 13.07.2015 VËRTETOHET".*

33. Njëkohësisht me procedurën e përmbarimit, Komuna e Prishtinës paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës (Ac. nr. 4391/2014), të 7 prillit 2015.

34. Më 9 dhjetor 2015, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Rev. nr. 295/2015, e pranoi si të bazuar kërkesën për revizion dhe e refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtrueses së kërkesës për kthim në vendin e saj të punës.

35. Gjykata Supreme vlerësoi se gjykatat e instancës më të ulët:

> "*[...] në mënyrë të plotë kanë vërtetuar gjendjen faktike por gabimisht kanë zbatuar të drejtën materiale kur kanë gjetur se*

kërkesëpadia e paditëses është e bazuar. Kjo ngase me Urdhëresën administrative 17/2000 të Departamentit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nën pikën D pika 6 është paraparë se mjekët që me sukses kanë mbaruar trajnimin e tyre specialistik dhe janë të regjistruar si specialist me leje të punës, duhet të konkurrojnë për vendet e punës në Shërbimet Publike Shëndetësore në Kosovë. Ata nuk mund të mbeten në postet e tyre të trajnimit e as nuk mund t'iu ofrohen automatikisht poste në institucionet e trajnimit, ndërsa me pikën 7 është përcaktuar se sistemi i sponzorimeve të trajnimeve nga institucionet e ndryshme do të marrë fund kur mjekët pranojnë ofertën për trajnimin specialistik nga Departamenti i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, ata duhet të përfundojnë çdo tentim të punëdhënësit të mëparshëm për punësim dhe nuk duhet lidhur asnjë kontratë që obligon në të ardhmen".

36. Më tej, Gjykata Supreme arsyetoi se:

"*Pretendimin e të padituerës të cekur në revizion se gjykatat e instancës më të ulët në mënyrë të gabuar kanë zbatuar të drejtën materiale, kjo Gjykatë e vlerësoi si të bazuar, ngase sipas Urdhëresës së cekur më lart del se e paditura ka pasur të drejtë të kërkojë nga specializantët të punojnë tek e paditura, por nuk ka qenë e obliguar t'u sigurojë vendin e punës në mënyrë automatike pas përfundimit të specializimit, ndërsa specializantët është dashur të konkurrojnë për vendet e punës sipas specializimit të përfunduar".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

37. Parashtruesja e kërkesës pretendon se ajo duhej të ishte kthyer në punën e saj si stomatologe, sepse Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës dhe Udhëzimin Administrativ nr. 2003/2 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36, duhet të aplikohej në rastin e saj, sepse ajo kishte një kontratë të përhershme të punës si stomatologe. Ajo konsideron se në Udhëzimin Administrativ (Shëndetësi) 17/2000, i cili ka rregulluar financimin e specialistëve për specializim si ortodontiste, nuk duhej të ishte aplikuar.

38. Parashtruesja e kërkesës pretendon se, për shkak se Gjykata Supreme ka zbatuar Udhëzimin Administrativ (Shëndetësi) 17/2000, në vend të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Udhëzimin Administrativ nr. 2003/2 mbi zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36, Gjykata Supreme shkeli të

drejtën e saj për trajtim të barabartë para ligjit siç garantohet me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës. Parashtruesja e kërkesës pretendon se, në këtë mënyrë, Gjykata Supreme i dha përparësi të padrejtë Komunës së Prishtinës, dhe vuri parashtruesen e kërkesës në pozitë të pafavorshme.

39. Përveç kësaj, parashtruesja e kërkesës pretendon se i është mohuar e drejta e saj për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe me nenin 6.1 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, sepse Gjykata Supreme nuk ka dhënë arsyetim të duhur në aktgjykimin e saj.

40. Parashtruesja e kërkesës pretendon se Gjykata Supreme jo vetëm që gabimisht nuk e zbatoi ligjin përkatës për shërbimin civil, por gjithashtu iu referua gabimisht vendimit të Ministrisë së Shëndetësisë (nr. 20-03-2006) të 12 majit 2006, me të cilin ishte pezulluar zbatimi i pikave 9 dhe 10 të Marrëveshjes për financimin e studimeve pasuniversitare (specializimit) dhe detyrimet e marra pas përfundimit të specializimit. Parashtruesja e kërkesës pretendon se ky vendim është marrë më shumë se një vit pasi ka përfunduar studimet e saj për specializim dhe për këtë arsye ky vendim i Ministrisë së Shëndetësisë nuk duhej të ishte aplikuar për kërkesën e saj për kthim në vendin e saj të mëparshëm si stomatologe.

41. Parashtruesja e kërkesës pretendon se Gjykata Supreme nuk ka ofruar arsyetimin e duhur për të justifikuar aktgjykimin e saj, duke shkelur të drejtën e saj për një vendim të arsyetuar. Parashtruesja e kërkesës i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, përkatësisht rasteve KI120/10, të 29 janarit 2013 dhe KI189/13, të 12 marsit 2013, lidhur me dështimin e Gjykatës Supreme për të dhënë arsyetimin e duhur në aktgjykimin e marrë në lidhje në këto raste.

42. Përveç kësaj, parashtruesja e kërkesës pretendon se "*në mënyrë jo të drejtë është privuar nga përfitimi i formës së prerë që është në favor të saj. Andaj, moszbatimi i Aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac. nr. 3084/15 të dt. 10.12.2015 dhe zvarritja e paarsyeshme e zgjidhjes së kësaj çështjeje juridike nga ana e punëdhënësit - Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare nën menaxhimin e Departamentit të Shëndetësisë pranë Komunës së Prishtinës, sipas parashtrueses përmban shkelje të nenit 31 të dispozitave të Kushtetutës, si dhe të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*".

43. Parashtruesja e kërkesës pretendon se, për shkak se Gjykata Supreme ka ndaluar punëdhënësin ta kthejë parashtruesen e kërkesës në vendin e saj të punës, kjo paraqet mohim të së drejtës së saj për të punuar dhe ushtruar profesionin, në kundërshtim me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës.

44. Përveç kësaj, parashtruesja e kërkesës pretendon se duke ia mohuar të drejtën e saj për t'u kthyer në vendin e saj të mëparshëm si stomatologe, Gjykata Supreme ka mohuar të drejtën e saj për mbrojtjen gjyqësore të të drejtave të saj, në kundërshtim me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

45. Parashtruesja e kërkesës propozon që Gjykata Kushtetuese të konstatojë se ka pasur shkelje të të drejtave të saj kushtetuese dhe ta shpallë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 295/2015, të 9 dhjetorit 2015 të pavlefshëm.

Pranueshmëria e kërkesës

46. Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

47. Në lidhje me këtë, Gjykata gjithashtu i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
>
> *[...]*
>
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

48. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 49 [Afatet] të Ligjit, i cili përcakton:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej 4 (katër) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor.*

49. Gjykata konsideron se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar, i ka shteruar mjetet juridike në dispozicion dhe ka parashtruar kërkesën në kohë.

50. Megjithatë, Gjykata i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili përcakton:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

51. Përveç kësaj, Gjykata i referohet paragrafëve (1) (d) dhe (2) (d) të rregullit 36 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, të cilët parashohin:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
> *[...]*
> *(d) kërkesa nuk arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
>
> *(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*
> *[...]*
> *(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".*

52. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton që parashtruesja e kërkesës pretendon se Gjykata Supreme kishte shkelur të drejtën e saj për gjykim të drejtë duke mos zbatuar ligjin e duhur kur e ka arsyetuar vendimin e saj. Parashtruesja e kërkesës pretendon se dështimi i Gjykatës Supreme për të arsyetuar siç duhet vendimin e saj dhe fakti që Gjykata Supreme ka anuluar vendimet e mëparshme të Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit, duke urdhëruar që parashtruesja e kërkesës të kthehet në vendin e saj të mëparshëm si stomatologe, është shkelur e drejta e saj për gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6.1 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

53. Parashtruesja e kërkesës pretendon se Gjykata Supreme *"[...] i referohet ekskluzivisht Urdhëresës Administrative Nr. 17/2000 në bazë të së cilës i ndërpritet marrëdhënia e punës e parashtrueses së kërkesës nga ana e punëdhënësit. Ky akt nënligjor nuk mund të zbatohet në rastin e parashtrueses së kërkesës nga fakti se marrëdhënia e saj e punës në* periudhën *e lidhjes së kontratës për*

specializim, është rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/36 për shërbimin civil ".

54. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës ka sqaruar saktësisht se cilat të drejta pretendohet se janë shkelur me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme.

55. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar, i ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të parashikuara me ligj, ka dorëzuar kërkesën në kohën e duhur dhe ka sqaruar me saktësi shkeljen e pretenduar të të drejtave të saj kushtetuese.

56. Pas shqyrtimit të ankesave dhe vërejtjeve të parashtrueses së kërkesës, Gjykata konsideron se kërkesa ngre çështje serioze të fakteve dhe ligjit të cilat janë të një kompleksiteti të tillë sa që përcaktimi i tyre duhet të varet nga shqyrtimi i meritave. Prandaj, kërkesa nuk mund të konsiderohet si qartazi e pabazuar brenda kuptimit të rregullit 36 (1) (d) të Rregullores së punës dhe nuk është konstatuar asnjë bazë tjetër për ta deklaruar atë të papranueshme (Shih, rasti *A dhe B kundër Norvegjisë*, [DHM], kërkesat nr. 24130/11 dhe nr. 29758/11, Aktgjykimi i 15 nëntorit 2016, paragrafi 55, dhe shih, *mutatis mutandis* rasti nr. KI132/15, *Manastiri i Deçanit*, Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 20 majit 2016).

Meritat e kërkesës

57. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtës së saj për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31.2 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNJ-së.

58. Gjykata i referohet nenit 31.2 të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj".*

59. Gjykata gjithashtu përkujton nenin 6 (1) të KEDNJ-së, i cili në pjesët e tij përkatëse, përcakton:

> *"1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj e cila do të vendosë*

si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij [...]".

60. Gjykata gjithashtu thekson nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës i cili parasheh që: *"Të drejtat e njeriut dhe liritë* themelore *të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut."*

61. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton edhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së e cila, mutatis *mutandis*, thekson se: *"[...] juridiksioni i saj për të verifikuar se ligji i brendshëm është interpretuar dhe zbatuar në mënyrë korrekte është i kufizuar dhe se nuk është funksioni i saj të zërë vendin e gjykatave vendore, roli i saj është të sigurojë që vendimet e këtyre gjykatave nuk janë arbitrare ose qartazi të paarsyeshme".* Shih rastin e GJEDNJ-së *Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë*, kërkesa nr. 73049/01, Aktgjykim i 11 janarit 2007, paragrafi 83.

62. Gjykata gjithashtu rikujton që "*[...] [GJEDNJ] nuk do të ngrejë pyetje të interpretimit të ligjit vendor nga gjykatat vendase, përveç në rast të arbitraritetit të dukshëm (shih, mutatis mutandis, Ādamsons kundër Letonisë, nr. 3669/03, paragrafi 118, 24 qershor 2008), me fjalë të tjera, kur vëren se zbatimi i ligjit nga gjykatat vendase në raste të caktuara, është qartazi i gabuar ose janë marrë konkluzione arbitrare dhe/ose u mohohet drejtësia* (*shih, mutatis mutandis, Farbers dhe Harlanova kundër Lituanisë (vendimi), numër 57313/00, 6 shtator 2001, dhe megjithëse në kontekstin e nenit 1 të Protokollit 1, Beyeler kundër Italisë [DHM], numër 33202/96, paragrafi 108, GJEDNJ 2000-I*)". Shih rastin e GJEDNJ-së *Andjelković kundër Serbisë*, kërkesa nr. 1401/08, Aktgjykimi i 9 prillit 2013, para. 24.

63. Në dritën e sa më sipër, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria). Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. Shih, *mutatis mutandis,* Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës, n*r. 30544/96, para. 28; dhe rasti nr. KI93/16, *Maliq Maliqi dhe Skënder Maliqi*, Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese i 23 nëntorit 2017.

64. Gjykata rikujton që ankesa kryesore e parashtrueses së kërkesës ka të bëjë me zbatimin e një akti nënligjor nga Gjykata Supreme në vendimin e saj për revizion, në vend që të zbatojë legjislacionin primar përkatës, përkatësisht Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës. Parashtruesja e kërkesës pretendon se ajo kishte një kontratë të përhershme si nëpunëse civile dhe se kjo kontratë nuk ishte ndërprerë.

65. Për më tepër, parashtruesja e kërkesës pretendon se në vitin 2001, me nënshkrimin e kontratës së punës për specializim, ajo kishte pranuar një detyrim për të punuar për një periudhë 5 (pesë) vjeçare në shërbimin shëndetësor në Kosovë pas trajnimit të saj si specialiste, ndërsa në vitin 2006, Ministria e Shëndetit kishte përfunduar në mënyrë retroaktive këtë obligim me Vendimin Nr. 20-03-2006.

66. Parashtruesja e kërkesës pretendon se duke mos zbatuar Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe duke mos respektuar faktin se punësimi i parashtrueses së kërkesës si nëpunëse civile asnjëherë nuk ishte ndërprerë në mënyrë të ligjshme, si dhe duke mos marrë parasysh veprimet retroaktive, ndërprerja e detyrimit për të punuar në shërbimin shëndetësor publik për 5 (pesë) vjet të tjera, Gjykata Supreme nuk kishte arsyetuar siç duhet vendimin e saj dhe kishte interpretuar qartazi gabimisht ligjin, me rezultate arbitrare për parashtruesen e kërkesës.

67. Gjykata vëren se Gjykata Themelore konsideroi se Udhëzimi Administrativ (Shëndetësi) 17/2000 nuk zbatohej në rastin e parashtrueses së kërkesës sepse punësimi i saj në Shërbimin Civil të Kosovës që daton nga 10 korriku 1990 nuk ishte ndërprerë në pajtim me ligjin në fuqi, përkatësisht Rregulloren e UNMIK-ut 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Udhëzimin Administrativ të UNMIK-ut nr. 2003/2 për Zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36, neni 35. Gjykata e Apelit mbështeti këtë interpretim.

68. Gjykata vëren se Gjykata Supreme pranoi se gjykatat e ulëta kishin vërtetuar saktë gjendjen faktike, por kishin konstatuar se kishin zbatuar ligjin e gabuar. Gjykata Supreme arsyetoi:

> "*Kjo është për shkak se në pajtim me Udhëzimin Administrativ nr. 17/2000 të Departamentit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ku nën pasusin D pika 6 thuhet: Mjekët që me sukses kanë mbaruar trajnimin e tyre specialistik dhe janë regjistruar si specialist me leje të punës, duhet të konkurrojnë për vendet e punës në shërbimet publike shëndetësore në Kosovë. Ata nuk*

mund të mbeten në postet e tyre të trajnimit e as nuk mund t'ju ofrohen automatikisht poste në institucionet e trajnimit. Ndërsa në piken 7 thuhet:Kur mjekët pranojnë ofertën për trajnim specialistik nga Departamenti i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, ata duhet të përfundojnë çdo tentim të punëdhënësit të mëparshëm për punësim dhe nuk duhet lidhur asnjë kontratë që obligon në të ardhmen".

69. Gjykata vëren se, duke pranuar përcaktimin e gjendjes faktike nga gjykatat e shkallës më të ulët, Gjykata Supreme kishte pranuar se parashtruesja kishte "*fituar statusin e një punonjëse për një periudhë të pacaktuar kohore në Shtëpinë e Shëndetit në Prishtinë si stomatologe*".

70. Megjithatë, duke dhënë arsyetimin e vet, Gjykata Supreme nuk ka adresuar çështjen kryesore të parashtruar nga parashtruesja e kërkesës, që ishte pranuar nga Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit, përkatësisht nëse kontrata e përhershme e parashtrueses së kërkesës si nëpunëse civile, në të vërtetë, ishte ndërprerë ndonjëherë ligjërisht.

71. Gjykata thekson që roli i Gjykatës Kushtetuese është të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat themelore të garantuara me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Akdivar kundër Turqisë,* Nr. 21893/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65, shih po ashtu, Gjykata Kushtetuese rasti KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha,* Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).

72. Me fjalë të tjera, vërtetimi i plotë i gjendjes faktike dhe zbatimi i drejtë i ligjit është brenda juridiksionit të plotë të gjykatave të rregullta (çështje e ligjshmërisë).

73. Gjykata gjithashtu rikujton që, sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), e drejta për një gjykim të drejtë përfshin të drejtën për një vendim të arsyetuar.

74. Sipas praktikës së saj gjyqësore, GJEDNJ konsideron se bazuar në parimet e administrimit të duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave dhe tribunaleve duhet të tregojnë në mënyrë adekuate arsyet mbi të cilat ato bazohen. (Shih *Tatishvili kundër Rusisë*, GJEDNJ, kërkesa nr. 1509/02, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007, paragrafi 58, *Hiro Balani kundër Spanjës*, GJEDNJ, kërkesa nr. 18064/91, Aktgjykimi i 9

dhjetorit 1994, para. 27, *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, GJEDNJ, kërkesa nr. 134/1996/753/952, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998, paragrafi 42).

75. Megjithatë, në kërkesën e tanishme, Gjykata konsideron se arsyetimi i dhënë nga Gjykata Supreme nuk ka sqaruar se pse Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Udhëzimi Administrativ i UNMIK-ut nr. 2003/2 mbi Zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36, nuk janë zbatuar në rastin e parashtruesit të kërkesës.

76. Përveç kësaj, Gjykata konsideron se Gjykata Supreme nuk ka shpjeguar pse ishte aplikuar Udhëzimi Administrativ (Shëndetësi) 17/2000 në vend të Rregullores së UNMIK-ut dhe se si ky Udhëzim Administrativ dhe "Kontrata e Punës të Specialistëve" të nënshkruar nga parashtruesja e kërkesës në mënyrë efektive përbënte një ndërprerje të ligjshme të kontratës së saj të përhershme të shërbimit civil.

77. Gjykata përsërit se e drejta për të marrë një vendim gjyqësor në pajtim me ligjin përfshin detyrimin që gjykatat të japin arsyet për vendimet e tyre me baza të arsyeshme në nivel procedural dhe material. (Shih rastin *IKK Classic*, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 54).

78. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se Gjykata Supreme ka dështuar që në mënyrë adekuate të arsyetojë vendimin e saj sa i përket marrëdhënies ndërmjet statusit të punësimit të parashtrueses dhe legjislacionit përkatës në fuqi, siç kërkohet me të drejtën për gjykim të drejtë.

79. Gjykata më tej konsideron se, në këto rrethana, parashtruesja e kërkesës është privuar nga e drejta e saj për gjykim të drejtë dhe të paanshëm sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, dhe të kthehet në pozitën e saj të punës si stomatologe në Shtëpinë e Shëndetit në Prishtinë.

80. Prandaj, Gjykata konstaton se ka pasur shkelje të nenit 31.2 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së.

81. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës gjithashtu pretendon se, duke përcaktuar se Udhëzimi Administrativ (Shëndetësi) 17/2000 ishte aplikuar në rastin e saj, Gjykata Supreme e favorizoi padrejtësisht palën kundërshtare në dëm të parashtrueses së kërkesës. Parashtruesja e kërkesës pretendoi se kjo përbënte shkelje të së drejtës së saj për barazi para ligjit, të mbrojtur me nenin 24 të Kushtetutës.

82. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës gjithashtu pretendon se duke i refuzuar qasjen parashtrueses së kërkesës në vendin e saj të mëparshëm të punës, gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtën e saj të punës të mbrojtur me nenin 49 të Kushtetutës.

83. Pasi që konstatoi shkelje të së drejtës së parashtrueses së kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm sipas nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme shqyrtimin e pretendimeve të mëtejshme të parashtrueses në lidhje me nenet 24 [Barazia Para Ligjit] dhe 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës.

Përfundim

84. Gjykata konstaton se ka pasur shkelje të nenit 31.2 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së.

85. Pasi që konstatoi shkelje të së drejtës së parashtrueses së kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm sipas nenit 31 të Kushtetutës, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme shqyrtimin e pretendimeve të mëtejshme të parashtrueses së kërkesës në lidhje me nenet 24 dhe 49 të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 56 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 30 maj 2018

VENDOS

I. TA DEKLAROJË me shumicë kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË me shumicë se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në lidhje me nenin 6.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

III. TË KONSTATOJË me shumicë që nuk është e nevojshme të shqyrtojë nëse ka pasur shkelje të neneve 24 dhe 49 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

IV. TA SHPALLË me shumicë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 295/2015, të 9 dhjetorit 2015;

V. TA KTHEJË Aktgjykimin Rev. nr. 295/2015 në Gjykatën Supreme të Kosovës, të 9 dhjetorit 2015 për rishqyrtim në pajtim me këtë Aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese;

VI. TA URDHËROJË Gjykatën Supreme që, në pajtim me rregullin 63 (5) të Rregullores së punës, ta informojë Gjykatën Kushtetuese për masat e ndërmarra për zbatimin e këtij aktgjykimi;

VII. TË MBETET fuqimisht e angazhuar në këtë çështje në pritje të pajtueshmërisë me atë urdhër;

VIII. T'UA KUMTOJË këtë aktgjykim palëve;

IX. TA PUBLIKOJË këtë aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

X. Ky aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Ivan Čukalović	Arta Rama-Hajrizi

KO12/18, Parashtrues: Albulena Haxhiu dhe 30 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 04/20, të 20 dhjetorit 2017

KO12/18, Aktgjykim i miratuar më 29 maj 2018, publikuar më 11 qershor 2018

Fjalët kyç: kontroll abstrakt, kërkesë institucionale, ndarja e pushteteve, kompetencat kushtetuese, implikimet buxhetore, konflikti i interesit, barazia para ligjit

Parashtruesit e kërkesës e kanë dorëzuar kërkesën në Gjykatën Kushtetuese për vlerësim të kushtetutshmërisë së Vendimit të Qeverisë, nr. 04/20. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se vendimi i cekur më lart nuk është në pajtueshmëri me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 7 [Vlerat], 65 [Kompetencat e Kuvendit], 92 [Parimet e Përgjithshme] dhe 93 [Kompetencat e Qeverisë], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës

Gjykata Kushtetuese e deklaroi kërkesën të pranueshme për shqyrtim pasi konstatoi se çështjet e ngritura në kërkesë janë të kompleksitetit të tillë, sa që përcaktimi i tyre duhet të varet nga shqyrtimi i meritave dhe se kërkesa nuk mund të konsiderohet si qartazi e pabazuar brenda kuptimit të rregullit 36 (1) (d) të Rregullores.

Pas shqyrtimit të pretendimeve dhe të argumenteve të parashtruesve të kërkesës, Gjykata Kushtetuese theksoi: (i) nuk është dëshmuar se vendimi për rritjen e pagave përbën çështje të nivelit kushtetues; (ii) bazuar në argumentet e paraqitura, nuk rezulton se Kuvendit i është cenuar apo pamundësuar ushtrimi i kompetencave të tij kushtetuese për miratimin dhe zbatimin e buxhetit shtetëror; (iii) për sa i përket konfliktit të interesit se nuk është brenda funksionit të Gjykatës që të vlerësojë pretendimet për shpërputhjen e vendimit të kontestuar me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, sepse ajo çështje bie nën juridiksionin e organeve të tjera të përcaktuara me Kushtetutë; dhe (iv) për sa i përket shkeljeve të neneve 3 [Barazia para Ligjit] dhe 7 [Vlerat] të Kushtetutës, parashtruesit nuk kanë paraqitur fakte bindëse se pagat e parapara në Vendimin e kontestuar trajtojnë ndryshe pozita ose situata të ngjashme dhe nëse ky ndryshim në trajtim nuk ka ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Gjykata, më tej shtoi se nuk është brenda fushëveprimit të saj që të vlerësojë apo të zëvendësojë politikat publike të përcaktuara nga organi legjislativ apo ekzekutiv. Parimi i ndarjes së pushteteve detyron Gjykatën Kushtetuese që të respektojë përcaktimin e politikave nga organet

gjegjëse kushtetuese. Vendimet themelore të politikëbërjes për qeverisjen e vendit duhet të merren nga organet kushtetuese me legjitimitet demokratik, përkatësisht nga Kuvendi dhe Qeveria. Ato organe – për shkak të natyrës së tyre dhe të legjitimitetit demokratik – janë në pozitë më të mirë se sa Gjykata Kushtetuese për të përcaktuar dhe për të avancuar politikat buxhetore, ekonomike dhe sociale të vendit.

Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese konsideroi se parashtruesit e kërkesës nuk kishin paraqitur prova bindëse për të mbështetur pretendimet e tyre se Vendimi i kontestuar i Qeverisë ka prodhuar efekte kushtetuese, në kuptim të cenimit të kompetencave kushtetuese të Kuvendit, apo shkelje të ndonjë dispozite kushtetuese, ashtu si pretendonin parashtruesit e kërkesës. Megjithatë, Gjykata vuri në dukje se aktet nënligjore të Qeverisë duhet të jenë në pajtueshmëri me Kushtetutën dhe me ligjet. Për më tepër, Gjykata theksoi se, në përputhje me natyrën ekzekutive të kompetencave të saj kushtetuese, Qeveria është e detyruar të implementojë buxhetin shtetëror, të miratuar nga Kuvendi. Andaj, është obligim i Qeverisë që zbatimin e Vendimit të kontestuar ta mbështesë në ndarjet buxhetore të përcaktuara në Buxhetin e vitit 2018 dhe në ligjet përkatëse.

Në fund, Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113. 2 (1) dhe 116. 2 të Kushtetutës, të neneve 27 (1), 29 dhe 30 të Ligjit dhe në mbështetje të rregullave 29, 54, 55 dhe 56 (1) të Rregullores së punës, konstatoi se Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 20/14, i 20 dhjetorit 2017, nuk është në kundërshtim me nenet e pretenduara të Kushtetutës.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KO12/18

Parashtrues

Albulena Haxhiu dhe 30 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 04/20, të 20 dhjetorit 2017

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga: Albulena Haxhiu, Glauk Konjufca, Visar Ymeri, Donika Kadaj-Bujupi, Shqipe Pantina, Albin Kurti, Besa Baftiu, Rexhep Selimi, Ismail Kurteshi, Dardan Sejdiu, Faton Topalli, Driton Çaushi, Arbërie Nagavci, Fatmire Mulhaxha-Kollqaku, Saranda Bogujevci, Sami Kurteshi, Adem Mikullovci, Dukagjin Gorani, Fitore Pacolli-Dalipi, Sali Zyba, Shemsi Syla, Xhelal Sveqla, Liburn Aliu, Drita Millaku, Sali Salihu, Arbër Rexhaj, Valon Ramadani, Ali Lajqi, Korab Sejdiu, Ilir Deda dhe Vjosa Osmani-Sadriu (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës), që të gjithë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kuvendi).

2. Parashtruesit e kërkesës kanë autorizuar znj. Albulena Haxhiu që t'i përfaqësojë ata në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

Akti i kontestuar

3. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Qeveria), nr. 04/20, të 20 dhjetorit 2017.

Objekti i çështjes

4. Objekti i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Qeverisë nr. 04/20, për të cilin parashtruesit e kërkesës pretendojnë se nuk është në pajtueshmëri me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 7 [Vlerat], 65 [Kompetencat e Kuvendit], 92 [Parimet e Përgjithshme] dhe 93 [Kompetencat e Qeverisë], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

5. Parashtruesit e kërkesës, gjithashtu, kërkojnë nga Gjykata caktimin e masës së përkohshme "*me anë të së cilës Vendimi nr. 04/20, i datës*

20 dhjetor 2017 i Qeverisë së Republikës së Kosovës nuk do zbatohej deri në marrjen e një vendimi meritor për këtë çështje".

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenet 113.2 (1) dhe 116.2 të Kushtetutës, në nenet 27, 29 dhe 30 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullat 29, 54 dhe 55 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 29 janar 2018, parashtruesit e kërkesës dorëzuan kërkesën dhe autorizimin për përfaqësim të tyre në Gjykatë nga znj. Albulena Haxhiu.

8. Më 30 janar 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani.

9. Më 30 janar 2018, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.

10. Më 30 janar 2018, kërkesa iu komunikua zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kryeministri) dhe u informuan se mund të paraqesin komentet e tyre në lidhje me kërkesën. Kërkesa iu komunikua edhe Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës me udhëzimin që t'iu ofrohet mundësia të gjithë deputetëve të Kuvendit për të paraqitur komentet e tyre.

11. Më 31 janar 2018, parashtruesit e kërkesës dorëzuan numrat e letërnjoftimeve të tyre dhe një kopje të Vendimit të Agjencisë Kundër Korrupsionit përkitazi me vendimin e kontestuar.

12. Më 6 shkurt 2018, Qeveria njoftoi se kishte nxjerrë vendim për pezullimin e përkohshëm të vendimit të kontestuar të Qeverisë deri në marrjen e vendimit përfundimtar të Gjykatës për këtë çështje.

13. Më 9 shkurt 2018, Zyra e Kryeministrit dorëzoi në Gjykatë komentet përkitazi me pretendimet e ngritura në kërkesë.

14. Më 13 shkurt 2018, komentet e Kryeministrit iu komunikuan parashtruesve të kërkesës dhe Kryetarit të Kuvendit, me udhëzimin që komentet t'u komunikohen të gjithë deputetëve të Kuvendit.

15. Më 15 shkurt 2018, parashtruesit e kërkesës dorëzuan komentet e tyre përkitazi me komentet e Zyrës së Kryeministrit.

16. Më 16 shkurt 2018, Gjykata kërkoi nga Ministria e Financave sqarime shtesë përkitazi me çështje të implikimeve buxhetore të vendimit të kontestuar të Qeverisë, pasqyrimin dhe rishikimin e atyre implikimeve në buxhetin e vitit 2018 dhe nëse ka pasur praktikë të ngjashme në të kaluarën.

17. Më 27 shkurt 2018, Ministria e Financave dorëzoi sqarimet e saj në lidhje me pyetjet e Gjykatës të 16 shkurtit 2018.

18. Më 26 prill 2018, Gjykata ua dërgoi anëtarëve te Forumit të Komisionit të Venecias një kërkesë me disa pyetje, për analizë krahasimtare lidhur me kërkesën nën shqyrtim.

19. Në të njëjtën ditë, sqarimet e Ministrisë së Financave iu komunikuan parashtruesve të kërkesës. Po ashtu, komentet e Qeverisë përkitazi me kërkesën K012/18; përgjigjja e parashtruesve te kërkesës përkitazi me komentet e Qeverisë, dhe sqarimet e Ministrisë së Financave, iu komunikuan këtyre Komisioneve të Kuvendit, për komente eventuale: Komisionit për Buxhet dhe Financa; Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit; dhe Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

20. Komisionet e cekura më lart nuk paraqitën komente në Gjykatë, brenda afatit të përcaktuar.

21. Më 3 maj 2018, parashtruesit e kërkesës dorëzuan komentet e tyre përkitazi me sqarimet e Ministrisë së Financave.

22. Ndërmjet 2 dhe 23 majit 2018, Gjykata pranoi përgjigjet ne pyetjet e parashtruara përmes Forumit të Komisionit të Venecias nga Gjykatat Kushtetuese të: Çekisë, Austrisë, Maqedonisë, Moldavisë, Bosnje dhe Hercegovinës, Suedisë, Letonisë, Sllovakisë, Sllovenisë, Gjermanisë, Kroacisë dhe Luksemburgut.

23. Më 29 maj 2018, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

24. Të njëjtën ditë, gjyqtarët Almiro Rodrigues dhe Gresa Caka-Nimani deklaruan se do të paraqesin mendime mospajtuese në pajtim me rregullin 57 (2) të Rregullores së punës.

Përmbledhje e fakteve

25. Më 20 dhjetor 2017, Qeveria e Republikës së Kosovës mori Vendimin nr. 04/20 për ndryshimin dhe rritjen e pagës bruto të funksionarëve shtetërorë dhe të vartësve të tyre, si në vijim: Kryeministrit dhe Zëvendëskryeministrit, Ministrit dhe Zëvendësministrit, Shefit të Stafit dhe Këshilltarit të Lartë Politik të Kryeministrit, Zëvendëssshefit të Stafit të Kryeministrit, që njëkohësisht është Këshilltar Politik i Kryeministrit, shefit të Kabinetit të Kryeministrit, që njëkohësisht është Këshilltar Politik i Kryeministrit, Këshilltarit Politik të Kryeministrit, Këshilltarit të Lartë Politik të Zëvendëskryeministrit, Këshilltarit të Lartë Politik të Ministrit, Këshilltarit të Ministrit, Shefit të Protokollit të Kryeministrit, Shefit të Njësisë për Siguri të Kryeministrit, Zyrtarit të Lartë të Protokollit, Asistentit të Lartë të Kryeministrit, Zyrtarit, Asistentit, Zyrtarit të Sigurimit, Shoferit, Truprojës së Kryeministrit, Zyrtarit të Lartë dhe Asistentit të Lartë të Zëvendëskryeministrit, Zyrtarit të Lartë dhe Asistentit të Lartë të Ministrit, Zyrtarit, Asistentit, Zyrtarit të Sigurimit, Shoferit, Truprojës së Ministrit, Sekretarit të Përgjithshëm në Zyrën e Kryeministrit, Drejtorit të Zyrës Ligjore dhe Drejtorit të Sekretariatit Koordinues të Qeverisë, koordinatorëve dhe udhëheqësve të divizioneve në Zyrën Ligjore, Sekretariatit Koordinues të Qeverisë, Zyrës për Komunikim Publik, Koordinatorit për Integrim Evropian dhe Shefit të Zyrës së Sekretarit në Zyrën e Kryeministrit, zyrtarëve të lartë në Zyrën Ligjore, Sekretariatit Koordinues të Qeverisë, Zyrës për Komunikim Publik, zyrtarëve, menaxherëve dhe zyrtarëve ekzekutivë në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm, Zyrës Ligjore, Sekretariatit Koordinues të Qeverisë dhe Zyrës për Komunikim Publik.

26. Vendimi i Qeverisë nr. 04/20 hyri në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe ishte nxjerrë me efekt prapaveprues me zbatim nga 1 dhjetori 2017.

27. Më 22 dhjetor 2017, Kuvendi miratoi Ligjin nr. 06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018 (në tekstin e mëtejmë: Ligji i Buxhetit 2018).

28. Më 29 janar 2018, Agjencia Kundër Korrupsionit kishte nxjerrë Opinion përkitazi me Vendimin, duke vlerësuar nëse vendimi i kontestuar i Qeverisë bie ndesh me dispozitat e Ligjit për

Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (Nr. 04/L-051).

29. Opinioni i lartpërmendur i Agjencisë Kundër Korrupsionit, në pjesën kryesore, përcakton:

> *"Vendimi i Qeverisë i datës 20.12.2017 Nr. 04/20, nuk mund të cilësohet si konflikt i interesit për të gjithë ata të cilët janë përfitues nga nxjerrja e këtij vendimi. Konflikti i interesit është paraqitur tek zyrtarët e lartë të cilët me votën e tyre kanë ndikuar që Vendimi të jetë në interes të tyre për përfitime personale.*
>
> *Rrjedhimisht, Agjencia Kundër Korrupsionit, rastin në fjalë nuk e ka trajtuar në aspekt të kompetencës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, të drejtën apo jo për rritje të pagave për atë sektor, mirëpo çështja është trajtuar vetëm në aspekt te procedurës dhe mënyrës se nxjerrjes së Vendimit, duke e vlerësuar kështu me konflikt të interesit vetëm pjesën që kanë votuar, aprovuar dhe nënshkruar [...]".*

Pretendimet e parashtruesve

30. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se vendimi i kontestuar shkel nenet 3 [Barazia para Ligjit], 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 7 [Vlerat], 65 [Kompetencat e Kuvendit], 92 [Parimet e Përgjithshme] dhe 93 [Kompetencat e Qeverisë] të Kushtetutës.

31. Parashtruesit e kërkesës potencojnë se *"[c]aktimi i pagave të funksionarëve shtetëror të cilët paguhen nga Buxheti i Kosovës, në çdo rast ulja dhe rritja e tyre, është kompetencë e Kuvendit të Republikës së Kosovës, e cila ushtrohet prima facie përmes miratimit të ligjit për buxhetin [...]"* duke pretenduar se në bazë të nenit 65 të Kushtetutës *"miratimi i Buxhetit të Republikës së Kosovës është kompetencë ekskluzive e Kuvendit. Një kompetencë e tillë e Kuvendit, nuk mund të ndahet, kufizohet apo tjetërsohet përmes çfarëdo vendimi të Qeverisë".*

32. Parashtruesit pohojnë se *"Kushtetuta e Kosovës, në kapitullin XII, përcakton numerikisht institucionet e pavarura kushtetuese të cilave ju garantohet pavarësia financiare, ku përfshihet edhe përcaktimi i pagave të zyrtarëve të institucionit të pavarur. Qeveria nuk është njëra nga këto institucione të pavarura dhe e njëjta ka karakter dhe funksion specifik i cili mbikëqyret nga Kuvendi dhe nuk ka pavarësi kushtetuese".*

33. Sa më sipër, parashtruesit pretendojnë se *"ndryshimi i pagave të funksionarëve të lartë shtetëror është planifikim i cili duhet të parashihet në planifikimin e Buxhetit për vitin përkatës i cili bëhet nga ana e Qeverisë dhe dërgohet për miratim në Kuvend. Rëndësia e këtij pozicioni interpretues bëhet edhe më e rëndësishme në rastet kur Qeveria vendos për pagat e anëtarëve të saj [...]. Asnjë Qeveri nuk mund të bëhet bartëse e kompetencës për kompensimin e vetes në terma individual të pagës pa kaluar nëpër vendimmarrje parlamentare"*.

34. Parashtruesit po ashtu pohojnë se rritja e pagave *"afekton direkt Buxhetin e Kosovës duke tejkaluar mjetet e ndara buxhetore për pagat e funksionarëve publik të këtyre institucioneve, sipas Ligjit për Buxhetin [për vitin 2018] dhe rrjedhimisht shkel kompetencën e Kuvendit"*. Parashtruesit shtojnë se *"as në Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës 2017, as në atë të vitit 2018, nuk ekziston asnjë normë apo kod buxhetor"* që parashikon një ngritje të tillë të pagave të kabinetit qeveritar.

35. Përkitazi me kompetencat e Qeverisë, parashtruesit pretendojnë se *"Neni 93.5 e Kushtetutës [...] përcakton se Qeveria e Kosovës ka kompetencë të propozojë Buxhetin e Republikës së Kosovës. Kjo nënkupton që Qeveria është kompetente vetëm të propozojë alokimin e Buxhetit të Kosovës dhe ndarjet buxhetore nga Buxheti i Kosovës. [...] Prandaj, duke u bazuar në nenin 65.5 dhe 93.3 të Kushtetutës, Kryeministri Haradinaj me vendimin e kontestuar ka shkelur dispozitat kushtetuese duke vepruar jashtë kompetencave të përshkruara nga Kushtetuta për këtë institucion"*.

36. Për me tepër, parashtruesit pretendojnë se ndryshimi i pagave përbën "*konflikt interesi si standard i ndaluar në funksionimin e qeverisë sipas parimit të integritetit në një shoqëri demokratike"*.

37. Duke iu referuar nenit 92.4 të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës pohojnë se *"në kuptimin e funksionit të saj ekzekutiv, neni 92.4 përsërit rolin e Qeverisë si një organ që vendimet e saj i nxjerr në përputhje me procedurën dhe detyrimet substanciale të vendosura me Kushtetutë dhe ligje përkatëse.*" Parashtruesit pretendojnë se neni 92.4 i Kushtetutës e autorizon Qeverinë që të ndërhyjë në procesin legjislativ me anë të propozimit të projektligjeve për miratim në Kuvend, por *"Kuvendi i Kosovës nuk është i obliguar në asnjë mënyrë në propozimin e Qeverisë dhe është në diskrecionin e këtij organi miratimi ose jo i një projektligji*".

38. Parashtruesit pohojnë se neni 93.4 i Kushtetutës autorizon Qeverinë për të nxjerrë akte nënligjore dhe vendime për të zbatuar ligjet e miratuara nga Kuvendi. Sipas parashtruesve, *"autorizimi për të nxjerrë akte nënligjore, megjithatë, kufizohet me këto kushte: a) që akti nënligjor të rregullojë një fushë juridike që rregullohet përmes ligjit të nxjerrë nga ana e Kuvendit, b) që akti nënligjor të mos shkelë një ndalesë të vënë nga ana e ligjit përkatës; c) që akti nënligjor të ndjek qëllimin dhe objektivat e ligjit dhe që akti nënligjor përkatës të jetë në përputhje të plotë me Kushtetutën; dhe d) që akti nënligjor të ketë karakter konkretizimi të normave abstrakte të ligjit përkatës"*.

39. Sa i përket pretendimit për shkelje të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] të Kushtetutës, parashtruesit citojnë rastin KO98/11 të Gjykatës Kushtetuese, duke sqaruar, ndër të tjera, se *"Republika e Kosovës definohet nga Kushtetuta e vet si Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre. Ndarja e pushteteve është njëra prej bazave që garanton funksionim demokratik të shtetit. Esenca e funksionimit të pavarur dhe efektiv të këtyre degëve është imuniteti që u është dhënë njerëzve që i mishërojnë këto pushtete"*.

40. Në këtë drejtim, parashtruesit pretendojnë se *"duke u bazuar në faktin që Kuvendi i Kosovës është organ i cili ka kompetencë ekskluzive në miratimin e buxhetit dhe për mbikëqyrjen dhe kontrollin e Qeverisë, mund të konkludojmë që Qeveria, me rritjen e pagave në mënyrë të njëanshme dhe në mënyrë sektoriale, ka ndërhyrë në punën e Kuvendit duke shkelur dispozitat kushtetuese dhe ligjore të cilat rrjedhin nga parimet dhe standardet kushtetuese në të cilat është bazuar Republika demokratike e Kosovës. Kjo ngase, një vendimmarrje e tillë, përbën situatë papërshtatshmërie kushtetuese sepse i mundëson anëtarëve të Qeverisë vendimmarrjen me qëllim të vetëm përfitimin personal"*.

41. Sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 3 [Barazia para Ligjit] dhe të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës, parashtruesit pretendojnë se, me anë të vendimit të kontestuar të Qeverisë, "*funksionarëve të lartë të Qeverisë si dhe vartësve të tyre u mundësohet pagë më e favorshme se çdo qytetari tjetër në Kosovë, gjë që nuk do të ishte në përputhje me parimet kushtetuese të vendosura në nenin 3 dhe në nenin 7 të Kushtetutës"*.

42. Parashtruesit po ashtu i referohen Aktgjykimin të Gjykatës KO119/10, i cili kishte specifikuar se *"pasi që pensionet që parashihen të ju paguhen deputetëve të pensionuar janë qartazi jopropocionale me pensionet mesatare në vend dhe të njëjtat duhet të paguhen nga*

buxheti i përgjithshëm i [...] Kosovës pa kontributin e deputetëve, duket që ky legjislacion krijon diskriminim ndaj pjesëtarëve të tjerë të shoqërisë dhe të gjithë pensionistëve të tjerë në Kosovë dhe i shkel parimet e barazisë dhe të drejtësisë sociale të mbrojtura me Kushtetutë [...].”

43. Parashtruesit potencojnë se neni 7 [Vlerat] i Kushtetutës rendit *“parimet e lirisë, demokracisë, barazisë si vlerat më të rëndësishme në të cilat bazohet rendi kushtetues i Republikës së Kosovës.”* Sipas parashtruesve, *“në rastin konkret kemi abuzim të lirisë nga ana e Qeverisë në ushtrimin e autorizimeve publike me anë të së cilave është ndërhyrë në ndarjet buxhetore të garantuara me Ligjin për Buxhetin për vitin 2018, i cili krijohet dhe menaxhohet nga vullneti i qytetarëve të Kosovës përmes përfaqësuesve të zgjedhur në Parlament [...]. Gjithashtu, parimi i demokracisë thekson vendimin e shumicës duke respektuar të drejtat e pakicës. Respektimi i këtij parimi bëhet me miratimin e Ligjit për Buxhetin e Kosovës. Çdo ndërhyrje në këtë proces, i cili nuk bëhet pa miratimin e shumicës dhe duke ndjekur rrugën kushtetuese është shkelje e parimit të demokracisë, parim ky bazë i rendit kushtetues të Kosovës”.*

44. Për sa i përket kërkesës për masë të përkohshme, parashtruesit kërkojnë nga Gjykata caktimin e masës së përkohshme për të suspenduar zbatimin e vendimit të kontestuar të Qeverisë deri në marrjen e një vendimi meritor, sepse, “*nëse zgjatet kjo situatë kundërkushtetuese, buxheti i Republikës së Kosovës do të pësojë humbje të mëdha monetare të paparashikuara”.*

45. Në fund, parashtruesit kërkojnë nga Gjykata që kërkesën ta shpallë të pranueshme, të konstatohet shkelje e neneve 3 [Barazia para Ligjit], 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 7 [Vlerat], 65 [Kompetencat e Kuvendit], 92 [Parimet e Përgjithshme] dhe 93 [Kompetencat e Qeverisë] të Kushtetutës dhe të anulojë vendimin e kontestuar.

Komentet e dorëzuara nga Zyra e Kryeministrit

46. Përgjigjja e Zyrës së Kryeministrit përkitazi me pretendimet e ngritura në kërkesë përmban përgjigje që përshkruajnë natyrën e vendimit të kontestuar të Qeverisë, rezonimin buxhetor të vendimit të kontestuar të Qeverisë dhe mungesën e konfliktit të interesit të Qeverisë përkitazi me vendimin e kontestuar.

47. Për sa i përket natyrës së vendimit të kontestuar të Qeverisë, përgjigjja e Zyrës së Kryeministrit mund të përmblidhet si vijon: (i) bazuar në

nenin 93 (4) [Kompetencat e Qeverisë] të Kushtetutës, Qeveria ka të drejtë, përveç tjerash, të marrë vendime si kompetencë kushtetuese e pakontestueshme, *ex lege*; (ii) bazuar në nenin 92 (2) (3) dhe (4) [Parimet e Përgjithshme], vendimet e Qeverisë kanë titull ekzekutiv sepse natyra kushtetuese e pushtetit të Qeverisë është ekzekutive; (iii) Kosova ende nuk ka ligj për Qeverinë, por bazuar në nenin 99 [Procedurat] të Kushtetutës, Qeveria ka nxjerrë Rregulloren e punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011; (iv) Rregullorja e punës e Qeverisë ka përcaktuar se çështjet që lidhen me punën e Qeverisë që nuk janë rregulluar me atë rregullore, përcaktohen me vendim ose me akt tjetër të Qeverisë; (v) vendimi i kontestuar i Qeverisë është akt juridik kolektiv i miratuar me votë nga tërë kabineti qeveritar pas konstatimit të kuorumit të nevojshëm; dhe (vi) sikur vendimet e Qeverisë të kontestoheshin pafundësisht, do të cenohej siguria e vendimmarrjes qeveritare.

48. Për sa i përket rezonimit buxhetor të vendimit të kontestuar të Qeverisë, përgjigjja e Zyrës së Kryeministrit mund të përmblidhet si vijon: (i) Vendimi i kontestuar i Qeverisë është nxjerrë dy ditë para Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës dhe është paraparë në planifikim buxhetor dhe mund të rishikohet, çka nënkupton se vendimi i kontestuar i Qeverisë bie jashtë juridiksionit *ratione materiae* të Gjykatës, sepse nuk përbën çështje për konflikt kompetencash mes Ekzekutivit dhe Legjislativit; (ii) në rastin nr. KO118/13, Gjykata kishte listuar një sërë argumentesh me ç 'rast, ndër të tjera, kishte konstatuar: "*... Qeveria, dhe vetëm ajo, mund ta përcaktojë buxhetin kombëtar"*; (iii) bazuar në dispozitat përkatëse të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike, buxheti i Republikës së Kosovës mund të rishikohet dhe se buxheti i shtuar për organizatat buxhetore mbulon shtesat në paga deri në rishikim; (iv) Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, në mënyrë specifike parasheh rritje buxheti për kategorinë paga dhe mëditje në organizatat buxhetore të prekura (Zyra e Kryeministrit, ministritë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës, etj.), çka vërteton se vendimi i kontestuar i Qeverisë është paraparë dhe është mbuluar me kategorinë paga dhe mëditje.

49. Për sa i përket mungesës së konfliktit të interesit në nxjerrjen e vendimit të kontestuar të Qeverisë, përgjigjja e Zyrës së Kryeministrit, në pjesën relevante, është kjo: "*Për marrjen e vendimeve të tilla duhet të arrihet kuorumi i nevojshëm i Qeverisë, siç e përcakton neni 15 i Rregullores nr. 09/2011. Për më tepër, në mungesë të Ligjit për Pagat e Funksionarëve të Lartë, si do të duhej të përcaktoheshin pagat e deputetëve, anëtarëve të Qeverisë, Presidentit, bartësve të institucioneve të pavarura etj? Duke tërhequr paralele me*

institucionet e tjera, a do të evitohej situata e konfliktit të interesit sikur Ligji për Paga, duke përfshirë pagat e deputetëve, të miratohej nga Kuvendi, duke qenë se deputetët do të mund të kishin konflikt të interesit pasi që do të votonin për pagën e tyre? Me rastin e shpalljes së ligjit të miratuar nga Kuvendi, ku shpallja do të bëhej nga Presidenti sipas mandatit të tij kushtetues, e në të cilin ligj do të përcaktohej edhe paga e vetë Presidentit, a do të ekzistonte në këtë rast konflikti i interesit? Për më tepër, a janë në konflikt të interesit, vendimet e Qeverisë të cilat janë marrë më herët për rritje të pagave (shih për këtë vendimet e mëhershme të Qeverisë për rritjen e pagave në sektorin publik dhe vendimet për caktimin e pagës minimale në sektorin privat)? Këto pyetje shtrohen për të ardhur te përfundimi ligjor se në asnjë interpretim nuk mund të pretendohet që Qeveria me rastin e një votimi të tillë mund të jetë në një situatë të konfliktit të interesit për arsye kushtetuese dhe ligjore".

Kundërpërgjigjja e parashtruesve të kërkesës

50. Në kundërpërgjigjen e tyre të 15 shkurtit 2018, parashtruesit e kërkesës kryesisht trajtuan këto çështje: (i) juridiksionin *ratione materiae* të Gjykatës në rastin konkret; (ii) mosrespektimin e Ligjit për Buxhetin për vitin 2018 dhe Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike nga Qeveria, gjatë nxjerrjes së vendimit të kontestuar; dhe, (iii) interpretimin e kompetencave të Qeverisë dhe të Kuvendit, siç janë shtjelluar nga Gjykata në rastin nr. KO118/13.

51. Përkitazi me juridiksionin *ratione materiae* të Gjykatës, parashtruesit e kërkesës pohuan se pretendimet e Kryeministrit për papranueshmërinë e kërkesës janë të paqëndrueshme, sepse kanë për qëllim që ta kufizojnë kontrollin kushtetues të Gjykatës ndaj veprimeve të Qeverisë dhe, për më tepër, janë në kundërshtim me 'parimet e vendosura' nga Gjykata në rastin nr. KO73/16, përkitazi me efektet juridike që prodhojnë vendimet e Qeverisë, pavarësisht emërtimit të tyre.

52. Përkitazi me mosrespektimin e Ligjit për Buxhetin për vitin 2018 dhe të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike, parashtruesit e kërkesës pohuan se Qeveria deri më sot nuk ka dorëzuar Projektligj në Kuvend për të reflektuar ndryshimet në Ligjin për Buxhet të vitit 2018. Parashtruesit e kërkesës shtuan se referimi i Qeverisë ndaj Ligjit për Menaxhimin e Financave është i gabuar, për faktin se vendimi i kontestuar i Qeverisë nuk ka qenë vendim i ministrit të Financave dhe se nuk është llogaritur ndikimi i vendimit të kontestuar të Qeverisë, pra nëse ai vendim i tejkalon kufijtë e lejuar me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike.

53. Përkitazi me kompetencat e Qeverisë dhe Kuvendit, siç janë shtjelluar nga Gjykata në rastin nr. KO118/13, parashtruesit e kërkesës pohuan se Gjykata në asnjë rrethanë nuk pretendon që Qeveria e vetme planifikon buxhetin deri në ciklin final të miratimit. Ata shtuan se fjalia 'përcaktim i buxhetit kombëtar' i referohet adresimit të propozimligjit për buxhetin, që më pastaj miratohet në Kuvend në formë të pakufizuar dhe në përputhje me votat e deputetëve që ushtrojnë këtë kompetencë ekskluzive.

Përgjigjet e Ministrisë së Financave në lidhje me pyetjet e Gjykatës

54. Në lidhje me pyetjen e Gjykatës nëse implikimet buxhetore të vendimit të kontestuar janë pasqyruar në draftbuxhetin për vitin 2018, të paraqitur nga Qeveria te Kuvendi [...] më 10 tetor 2018, Ministria e Financave sqaroi se *"Ministria e Financave, duke vepruar në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, ka të përcaktuara afatet ligjore për përgatitjen e Buxhetit për vitin në vijim, andaj në vështrim të nenit 22 të këtij ligji, Qeveria e aprovon Buxhetin dhe e dorëzon në Kuvend [...] më së largu deri më datën 31 tetor dhe mbi bazën e kësaj baze ligjore Qeveria e ka dërguar në Kuvend brenda afat ligjor [në fund të tetorit 2018] duke përfshirë edhe rritjen e faturës së pagave të parapara me nenin 22 c të Ligjit nr. 05/L-063 për ndryshim dhe plotësim të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me ligjet nr. 03/L-221, nr. 04/L-116 dhe nr. 04/L-194*".

55. Në lidhje me pyetjen nëse janë pasqyruar ndikimet buxhetore të vendimit të kontestuar në Buxhetin e vitit 2018, të miratuar në Kuvend, më 22 dhjetor 2017, Ministria e Financave sqaroi: *"Në kohën kur është nxjerrë vendimi i kontestuar, datë 20 dhjetor 2017, Buxheti, si pjesë e Ligjit 06/L-20, ka qenë në procedurën finale të aprovimit në Kuvendin e Republikës se Kosovës në leximin e dytë dhe, rrjedhimisht, vendimi i kontestuar është i natyrës implementuese [...] vendimi i kontestuar prapë inkorporohet brenda buxhetit në faza të mëvonshme"*.

56. Sa i përket pyetjes nëse vendimi i kontestuar cenon buxhetin shtetëror të miratuar nga Kuvendi, Ministria e Financave sqaroi se vendimi i kontestuar *"asnjëherë nuk cenon buxhetin shtetëror për arsye se është shumë e vogël krahasuar me mundësitë buxhetore që i kemi me Buxhetin e vitit 2018. Në këtë pjesë e theksojmë se në kategorinë e pagave dhe mëditjeve kemi rritje të buxhetit për vitin 2018 krahasuar me buxhetin e vitit 2017, kemi rritje të mjaftueshme të mjeteve edhe*

në Kornizën makrofiskale për buxhetin e vitit 2018, e cila në Kuvendin së Republikës së Kosovës prezantohet si pjesë e projektbuxhetit në pjesën tekstuale në kategorinë e pagave dhe mëditjeve është arsyetuar se rritja e shpenzimeve për këtë kategori reflekton rritjen e pagave dhe mbulimin e pozitave të nënbuxhetuara në vitet paraprake".

57. Sa i përket pyetjeve se nëse për mbulimin e shpenzimeve për zbatimin e vendimit të kontestuar është e nevojshme të rishikohet buxheti shtetëror dhe, nëse po, si do të bëhet një gjë e tillë, si dhe si do të zbatohet vendimi në rast të mosmiratimit të rishikimit të buxhetit të propozuar nga Qeveria, Ministria e Financave theksoi se *"[...]nuk ka nevojë dhe nuk do të bëhet rishikimi i buxhetit vetëm për mbulimin e shpenzimeve të vendimit të kontestuar, nëse institucionet e shtetit nuk kanë kërkesa të tjera të reja, për arsye se kjo shumë e shpenzimeve të parapara me vendimin e kontestuar është e mbulueshme [...]. Nëse nuk miratohet rishikimi i buxhetit, vendimi do të mund të aplikohet në vështrim të bazës ligjore të paraparë me nenin 15, paragrafi 3, të Ligjit të buxhetit të shtetit për vitin 2018, me nr. 06/L-20".*

58. Në lidhje me pyetjen e Gjykatës nëse ka pasur praktika të tilla në kaluarën, Ministria e Financave theksoi se *"nga vitit 2004 e tutje ka pasur rritje të pagave me vendime administrative të Qeverisë. Në Republikën e Kosovës nuk kemi Ligj për pagat dhe, si pasojë e kësaj, gjithmonë pagat janë caktuar apo rregulluar përmes vendimeve administrative të Qeverisë [...] shuma e mjeteve të parapara me këto vendime më pas janë rregulluar brenda buxhetit të shtetit në faza të ndryshme duke zbatuar Ligjin apo duke e rishikuar Buxhetin".*

Kundërpërgjigjja e parashtruesve të kërkesës lidhur me sqarimet e Ministrisë së Financave

59. Në lidhje me përgjigjen e Ministrisë së Financave në pyetjet e parashtruara nga Gjykata, parashtruesit e kërkesës potencojnë se çështja e *"parashtruar nga ana e jonë dhe e cila ka përfunduar ne forme te pyetjeve ne Ministrinë e Financave, nuk është çështje e ligjshmërisë. Ajo është në mënyrë absolute çështje e kushtetutshmërisë së vendimit të Qeverisë së Kosovës, sepse prek në thelb kompetencat kushtetuese të Kuvendit të Republikës Kosovës, dhe prandaj ratione materiae rezulton në ushtrimin ultra vires nga ana e Qeverisë të kompetencave të saj në dëm të Kuvendit të Republikës."* Parashtruesit pohojnë se *"përgjigjja e Ministrisë së*

Financave në asnjë rrethanë dhe në asnjë rast nuk ofron asnjë dëshmi shifrore të përputhshmërisë së vendimit me ligjin për buxhetin [...]".

60. Sipas parashtrueseve, *"Ministria vetvetiu e pranon që vendimi i kontestuar nuk është pasqyruar ne Ligjin për Buxhetin, dhe mbi këtë bazë Ministria argumenton që "vendimi i kontestuar është i natyrës implementuese". Është pikërisht kjo bazë që e bën përfundimisht kontraverse pikëpamjen e Ministrisë së Financave dhënë në këto përgjigje. Si mund në të njëjtën kohë vendimi i kontestuar të jetë 'vendim për rritje pagash' kur këto paga, sipas Ministrisë qenkan tashme të rritura sipas Ligjit për Buxhetin?".*

61. Parashtruesit po ashtu shprehen se *"mbështesim rritjen e pagave për sektorin e sundimit të ligjit, ama që kjo të bëhet mbi premisat e pavarësisë gjyqësore dhe rolit thelbësor dhe vendimtar të Kuvendit të Republikës së Kosovës, dhe atë mbi bazën e një skeme plotësisht të arsyetuar dhe të mbështetur në performancë [...]".*

Komentet kryesore, të pranuara nga Forumi i Komisionit të Venecias

62. Gjykata vëren se nga përgjigjet e pranuara të Forumit të Komisionit të Venecias vihet në dukje se në shtetet që kanë dërguar përgjigje ekzistojnë praktika të ndryshme Kushtetuese, sa i përket çështjes së akteve të Qeverisë që mund të paraqitën për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese dhe palëve të autorizuara për të iniciuar shqyrtim të tillë. Gjykata gjithashtu vëren se pagat e shërbyesve publik në ato shtete janë të rregulluara me ligje, përkatësisht akte të veçanta normative.

63. Në lidhje me këtë, Gjykata Kushtetuese e Austrisë u shpreh se në Austri rregulloret administrative janë subjekt i rishikimit nga Gjykata Kushtetuese ndërsa *"termi kushtetuese rregullore administrative gjithashtu përfshin aktet e Qeverisë që janë të natyrës normative dhe të përgjithshme". Aktet normative të Qeverisë që mund të kontestohen [në Gjykatën Kushtetuese] nuk janë të listuara specifikisht; si pasojë kur një akt i Qeverisë sfidohet para Gjykatës Kushtetuese, Gjykata duhet të vlerësoj, si çështje paraprake, nëse akti në fjalë është rregullore administrative për qëllim të nenit 139 të Kushtetutës Federale."* Sa i përket palëve që mund të sfidojnë aktet e Qeverisë, ato përfshijnë: *ex officio* Gjykatën Kushtetuese kur duhet ta aplikoj një rregullore në një rast konkret; me kërkesë të ndonjë gjykate kur duhet të aplikoj rregulloren në një rast të caktuar; individët kur janë direkt të prekur; me kërkesë të Qeverisë Federale (në rast të rregulloreve të "landeve"), me kërkesë të Qeverisë së "landeve" (në rast

të rregulloreve te autoriteteve Federale). Sa i përket pagave të shërbyesve publik, në Austri ato janë të rregulluara me Ligj të nxjerr nga Parlamenti (përkatësisht Ligji Federal për Pagat e Zyrtarëve Federal).

64. Gjykata Kushtetuese e Çekisë u shpreh se ajo ka juridiksion që të anuloj statute apo dispozita të veçanta nëse ato bien ndesh me Kushtetutën. Sipas tyre *"Gjykata Kushtetuese e Çekisë e ka interpretuar këtë dispozitë në atë mënyrë që të ketë mundësi të rishikoj aktet juridike që përmbushin kushtet materiale të "akteve juridike" dhe jo domosdoshmërisht kushtet formale (p.sh. që të emërohen si "akte juridike)"*. Sa i përket palëve të interesuara për të kontestuar aktet e Qeverisë, ato përfshijnë, mes tjerash, një grup prej të paktën 25 deputetësh apo 10 senatorësh. Pagat e shërbyesve publik në Çeki janë të rregulluara me ligje të ndryshme, të posaçme, që përfshijnë Ligjin e Punës për Shërbyesit Civil, Ligjin për Pagat e Zyrtarëve Shtetëror, Ligjin për Pagat e Prokurorëve.

65. Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë u shpreh se Kushtetuta e tyre nuk parasheh ndonjë listë shteruese sa i përket akteve të Qeverisë që mund të parashtrohen për vlerësim kushtetues para Gjykatës Kushtetuese. Kushtetuta përfshin termin "rregullore tjera", që është interpretuar nga Gjykata Kushtetuese se i përfshinë të gjitha aktet nënligjore të nxjerra nga Qeveria që janë më karakter të përgjithshëm normativ, duke përfshirë edhe vendimet e nxjerra nga Qeveria apo ministritë. Sa i përket palëve të autorizuara për të kontestuar aktet e Qeverisë, çdo person fizik apo juridik mund të kërkoj nga Gjykata Kushtetuese të rishikojë ligjet ose aktet nënligjore, pa pasur nevojë të dëshmoj interesin e tij në procedurë. Pagat e shërbyesve publik në Maqedoni po ashtu janë të rregulluara me ligje të posaçme, që përfshijnë Ligjin për Pagat e Zyrtarëve të Zgjedhur dhe të Emëruar, Ligjin për Pagat e Gjyqtarëve dhe Ligjin për Pagat e Zyrtarëve Administrativ, që rregullon pagat e shërbyesve civil.

66. Gjykata Kushtetuese e Bosnjës dhe Hercegovinës sqaroi se Kushtetuta e tyre përveç akteve të cilat janë specifikisht të numëruara në Kushtetutë, kur kontestohet Kushtetutshmëria e akteve tjera të përgjithshme, duke përfshirë edhe vendimet e Qeverisë, vlerëson secilin rast veç e veç nëse ato akte ngrenë çështje kushtetuese apo konflikte në mes të institucioneve kushtetuese , dhe varësisht nga kjo vlerëson kushtetutshmërinë e tyre. Sa i përket palëve të autorizuara për të ngritur konfliktin në mes institucioneve apo etniteteve, para Gjykatës Kushtetuese, ato përfshijnë, anëtarë e Presidencës, Kryetarin e Këshillit të Ministrave, Kryetarit apo Nënkryetarin e secilës Dhomë

të Parlamentit, apo një të katërtën e anëtarëve të secilës Dhomë të Parlamentit.

67. Gjykata Kushtetuese e Kroacisë shpjegoi se aktet e qeverisë lokale apo qendrore, që mund të kontestohen në Gjykatën Kushtetuese të Kroacisë, përcaktohen nga rasti në rast dhe se Kushtetuta e Kroacisë dhe Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Kroacisë nuk parashohin listë shteruese se cilat akte të qeverisë mund të kontestohen. Pagat e shërbyesve civilë, të gjyqtarëve, prokurorëve dhe zyrtarëve të tjerë janë të rregulluara me ligjet përkatëse për kategoritë në fjalë.

68. Gjykata Kushtetuese e Sllovenisë shpjegoi se ka kompetencë për të shqyrtuar të gjitha aktet e qeverisë që janë me karakter të përgjithshëm, pra që prodhojnë efekte juridike për një numër të pacaktuar individësh. Nuk ka listë shteruese, por është e kuptueshme se mund të kontestohen rregulloret dhe aktet e tjera të përgjithshme të nxjerra me qëllim të ushtrimit të autoritetit publik. Kurse, pagat e zyrtarëve publikë janë të rregulluara me ligje përkatëse.

69. Gjykata Kushtetuese Federale e Gjermanisë shpjegoi se, parimisht, të gjitha aktet e Qeverisë Federale mund t'i nënshtrohen kontrollit kushtetues. Nuk ka ndonjë listë shteruese që përcakton shprehimisht se cilat akte të Qeverisë Federale mund t'i nënshtrohen kontrollit kushtetues. Pagat e zyrtarëve shtetërorë në nivel federal dhe të "landeve" individuale rregullohen me ligjet përkatëse. Qeveria Federale dhe qeveritë e "landeve" kanë kompetencë për të nxjerrë rregullore për sa i përket detajeve të sistemit të pagave.

70. Gjykata Kushtetuese e Sllovakisë shpjegoi se ekzistojnë disa ligje që rregullojnë pagat e zyrtarëve shtetërorë dhe të shërbyesve civilë. Ato ligje rregullojnë pagat e deputetëve të Kuvendit, të anëtarëve të Qeverisë, të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të kryetarit të Këshillit Gjyqësor, të kryetarit dhe nënkryetarit të Zyrës së Auditorit Suprem, të Prokurorit të Përgjithshëm dhe të gjyqtarëve të gjykatave të rregullta. Në përgjithësi, pagat e zyrtarëve shtetërorë dhe të shërbyesve civilë janë të rregulluara me ligjet përkatëse të nxjerra nga Parlamenti. Përbrenda kornizës së këtyre ligjeve, autoritetet përkatëse mund të nxjerrin rregulloret e tyre ose mund të konkludojnë marrëveshje kolektive të punës.

71. Gjykata Kushtetuese e Letonisë shpjegoi se Ligji për Gjykatën Kushtetuese përcakton dallimin ndërmjet akteve me zbatim të përgjithshëm dhe të akteve administrative. Këto të fundit janë të zbatueshme në rastet individuale. Parimisht, të gjitha aktet e Qeverisë

mund të kontestohen, mirëpo, nuk ka listë shteruese që përcakton shprehimisht se cilat akte qeveritare mund të kontestohen. Pagat e zyrtarëve shtetërorë janë të rregulluara me ligjet përkatëse, siç janë Ligji për pagat e zyrtarëve dhe punonjësve shtetërorë dhe të autoriteteve të pushtetit lokal, Ligji për pushtetin gjyqësor, Ligji për Zyrën e Prokurorit dhe Ligji për Gjykatën Kushtetuese.

72. Gjykata Supreme Administrative e Suedisë shpjegoi se pagat e deputetëve të parlamentit dhe të ministrave janë të rregulluara me ligjet përkatëse dhe përcaktohen nga autoritete të veçuara në kuadër të Parlamentit. Pagat e gjyqtarëve, të prokurorëve dhe të shërbyesve civilë janë të rregulluara me aranzhim të individualizuar. Prandaj, pagat për këto kategori negociohen me punëdhënësin.

73. Gjykata Kushtetuese e Moldavisë shpjegoi se vendimet, urdhëresat dhe dekretet e Qeverisë mund të kontestohen në Gjykatën Kushtetuese të Moldavisë. Pagat e zyrtarëve shtetërorë, të shërbyesve civilë, të gjyqtarëve e të prokurorëve janë të rregulluara me ligjet përkatëse për ato kategori.

Dispozitat përkatëse kushtetuese

Neni 3 [Barazia para Ligjit]

1. Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera, e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore.

2. Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuara ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.

Neni 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit]

1. Kosova është Republikë demokratike, e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë.
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ.
[...]

3. Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar.
4. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat.
[...]

Neni 7 [Vlerat]

1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes së mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.
[...]

Neni 65 [Kompetencat e Kuvendit]

Kuvendi i Republikës së Kosovës:

(1) miraton ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme;
[...]
(5) miraton Buxhetin e Republikës së Kosovës;
[...]
(8) zgjedh Qeverinë dhe shpreh mosbesimin ndaj saj;
(9) mbikëqyr punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat,
në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit;
[...]

Neni 92 [Parimet e Përgjithshme]

1. Qeverinë e Kosovës e përbëjnë Kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat.
2. Qeveria e Kosovës ushtron pushtetin ekzekutiv në pajtim me Kushtetutën dhe me ligjin.
3. Qeveria zbaton ligjet dhe aktet e tjera të miratuara nga Kuvendi i Kosovës dhe ushtron veprimtari tjera brenda përgjegjësive të përcaktuara me këtë Kushtetutë dhe me ligj.
4. Qeveria merr vendime në pajtim me këtë Kushtetutë dhe me ligje, propozon projektligje dhe amendamentimin e ligjeve ekzistuese e akteve të tjera, si dhe mund të japë mendimin rreth projektligjeve të cilat nuk janë të propozuara nga ajo.

Neni 93 [Kompetencat e Qeverisë]

Qeveria ka këto kompetenca:
[...]
(3) propozon Kuvendit projektligje dhe akte të tjera;
(4) merr vendime dhe nxjerr akte juridike ose rregullore, të nevojshme për zbatimin e ligjeve;
(5) propozon Buxhetin e Republikës së Kosovës;
[...]
(11) ushtron edhe funksione të tjera ekzekutive, të cilat nuk u janë caktuar organeve të tjera qendrore ose vendore.

Pranueshmëria e kërkesës

74. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i përmbush kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të parapara me Ligj dhe të specifikuara më tej në Rregullore të punës.

75. Gjykata i referohet paragrafit 1 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcakton: "Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar".

76. Përveç kësaj, Gjykata i referohet paragrafëve 2(1), 3(1), dhe 5 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë si në vijim:

> *"2. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim:*
>
> *(1) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën;"*
>
> *3. Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Qeveria janë të autorizuar të ngrenë çështjet në vijim:*
> *(1) konflikti në mes të kompetencave kushtetuese të Kuvendit të Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës;"*
> *[...]*
>
> *5. Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose*

vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur".

77. Në këtë drejtim, Gjykata u referohet neneve 29 [Saktësimi i kërkesës] dhe 30 [Afatet] të Ligjit që parashohin:

Neni 29
Saktësimi i kërkesës

1. Kërkesa e ngritura në pajtim me nenin 113 paragrafi 2 të Kushtetutës do të parashtrohen nga një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit të Republikës se Kosovës, nga Presidenti i Republikës se Kosovës , Qeveria ose nga ana e Avokatit të Popullit.

2. Kërkesa e ngritur kundër aktit të kontestuar sipas nenit 113 paragrafi 2 të Kushtetutës duhet të specifikojë, inter alia, nëse i tërë akti i kontestuar apo pjesë të veçanta të këtij akti konsiderohen të jenë në kundërshtim me Kushtetutën.

3. Kërkesa do të specifikoj kundërshtimet e ngritura kundër kushtetutshmërisë së aktit të kontestuar.

Neni 30
Afatet

Kërkesa e ngritur në pajtim me nenin 29 të këtij ligji duhet të parashtrohet brenda afatit prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar.

78. Për më tepër, Gjykata i referohet paragrafit(1) (d) të rregullit 36 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, që specifikojnë:

(1) "Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:
[...]
(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

79. Në lidhje me sa u tha më sipër, paragrafi 2 (1) i nenit 113, është pikë kryesore e referimit për të vlerësuar se cilat akte të Qeverisë mund të kontestohen në Gjykatën Kushtetuese nga deputetët, duke përmendur taksativisht: dekretet e Kryeministrit dhe rregulloret e Qeverisë.

80. Paragrafi 3 (1), i nenit 113, mundëson vlerësimin e kushtetutshmërisë së akteve të tjera të Qeverisë, nëse ato ndërlidhen me pretendime për konflikt të kompetencave ndërmjet Qeverisë dhe Kuvendit.

81. Jashtë sfondit të konfliktit të kompetencave kushtetuese të Kuvendit të Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës, Kushtetuta parashikon mundësinë e ngritjes para Gjykatës Kushtetuese vetëm të kërkesave që kanë të bëjnë me përputhshmërinë e ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën.

82. Gjykata vë në dukje se, për dallim nga ky kufizim që përcakton vetë Kushtetuta për sa i përket mundësisë së kontestimit në Gjykatën Kushtetuese të akteve të Presidentit dhe të Qeverisë, paragrafi 5, i nenit 113, parashikon që 10 apo më tepër deputetë mund të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi.

83. Pra, Kushtetuta bën dallim ndërmjet mundësisë për të kontestuar, në Gjykatën Kushtetuese, kushtetutshmërinë e akteve të Presidentit dhe të Qeverisë, nga njëra anë, dhe akteve të Kuvendit, nga ana tjetër.

84. Megjithatë, Gjykata vë në dukje praktikën e saj kur ka konstatuar se Gjykata Kushtetuese mund të bëjë vlerësimin e kushtetutshmërisë edhe të akteve të tjera të Qeverisë dhe të Kryeministrit, përveç rregulloreve dhe dekreteve, vetëm nëse ato ngrenë çështje të rëndësishme kushtetuese.

85. Kështu, Gjykata i referohet rastit nr. KO73/16 (Parashtrues *Avokati i Popullit*, aktgjykim i 8 dhjetorit 2016, paragrafi 52). Në këtë rast, Gjykata kishte konstatuar se "*në vlerësimin e kërkesës, Gjykata nuk do të marrë qëndrim për natyrën ligjore të kontestuar të Qarkores Administrative. Thelbi i kërkesës është nëse Qarkorja Administrative pretendohet të ketë shkelur dispozitat përkatëse të Kushtetutës […]. Mandati i Gjykatës është që të vlerësojë kushtetutshmërinë e kërkesave që kanë të bëjnë me Qarkoren Administrative dhe jo të vlerësojë ligjshmërinë e saj ose nëse është mbështetur nga politika te mira publike*".

86. Më tutje, Gjykata kishte gjetur se "*Qarkorja Administrative [nr. 01/2016], e nxjerrë nga Ministria e Administratës Publike të Republikës së Kosovës, pavarësisht emrit të saj, është e një natyre të detyrueshme dhe, në fakt, prek statusin kushtetues të institucioneve të pavarura*" (Shih, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës:

rasti nr. KO73/16, parashtrues *Avokati i Popullit*, aktgjykim i 8 dhjetorit 2016, paragrafi 58).

87. Gjykata përsërit se edhe parashtruesit janë referuar në kërkesën e tyre në "*parimet e vendosura nga Gjykata në rastin nr. KO73/16, përkitazi me efektet juridike që prodhojnë vendimet e Qeverisë, pavarësisht emërtimit të tyre*".

88. Së këndejmi, Gjykata nënvizon se vendimet e Qeverisë mund të pranohen për vlerësim kushtetues nga Gjykata Kushtetuese vetëm atëherë kur argumentohet se ato ngrenë çështje të rëndësishme kushtetuese.

89. Në rastin konkret, Gjykata vëren se çështja thelbësore për të cilën parashtruesit dhe Qeveria paraqesin pretendime të kundërta, ka të bëjë me raportin ndërmjet vendimit të Qeverisë për rritje të pagave dhe Ligjit për Buxhetin e vitit 2018. Më fjalë të tjera, a e ka cenuar Qeveria, me vendimin në fjalë, kompetencën kushtetuese të Kuvendit për të miratuar buxhetin shtetëror dhe për të kontrolluar shpenzimin e tij, si dhe a ka tejkaluar Qeveria kompetencat e saj kushtetuese.

90. Në dritën e kësaj, Gjykata konsideron se vendimi në fjalë ngre çështje të rëndësishme kushtetuese, që kanë të bëjnë me ushtrimin e kompetencave kushtetuese nga Kuvendi dhe Qeveria.

91. Prandaj, Gjykata konstaton se çështjet e ngritura në kërkesë janë të kompleksitetit të tillë, sa që përcaktimi i tyre duhet të varet nga shqyrtimi i meritave të kërkesës. Kërkesa, prandaj, nuk mund të konsiderohet si qartazi e pabazuar brenda kuptimit të rregullit 36 (1) (d) të Rregullores, dhe nuk është krijuar asnjë bazë tjetër për ta shpallur atë të papranueshme (shih, për shembull, rasti *A dhe B kundër Norvegjisë* [DHM], ankesat nr. 24130/11 dhe 29758/11, Aktgjykim i 25 nëntorit 2016, paragrafi 55 dhe gjithashtu shih, *mutatis mutandis,* Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës: rasti nr. KO73/16, parashtrues *Avokati i Popullit*, aktgjykim i 8 dhjetorit 2016, paragrafi 49). Rrjedhimisht, Gjykata shpall kërkesën të pranueshme për shqyrtim në merita.

Meritat e kërkesës

92. Gjykata përsëritë se thelbi i kërkesës së parashtruesve ka të bëjë me pretendimin se me vendimin e kontestuar për rritje të pagave, Qeveria ka tejkaluar autorizimet e saj kushtetuese, duke cenuar kështu

kompetencat kushtetuese të Kuvendit lidhur me miratimin e buxhetit shtetëror dhe për të kontrolluar shpenzimin e tij.

93. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Vendimi "*afekton direkt Buxhetin e Kosovës duke tejkaluar mjetet e ndara buxhetore për pagat e funksionarëve publikë të këtyre institucioneve, sipas Ligjit për Buxhetin [për vitin 2018] dhe rrjedhimisht shkel kompetencën e Kuvendit*". Parashtruesit shtojnë se "*as në Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës 2017, as në atë të vitit 2018, nuk ekziston asnjë normë apo kod buxhetor*" që parashikon një ngritje të tillë të pagave të Kabinetit qeveritar. Duke qenë se "*Neni 93.5 i Kushtetutës përcakton se Qeveria e Kosovës ka kompetencë të propozojë Buxhetin e Republikës së Kosovës. Kjo nënkupton që Qeveria është kompetente vetëm të propozojë alokimin e Buxhetit të Kosovës dhe ndarjet buxhetore nga Buxheti i Kosovës"*. Rrjedhimisht, sipas parashtruesve, nëpërmjet vendimit të kontestuar, Qeveria ka tejkaluar autorizimet e saj kushtetuese, duke cenuar kompetencën ekskluzive të Kuvendit për miratimin e buxhetit dhe për mbikëqyrjen dhe kontrollin e Qeverisë.

94. Qeveria, në komentet e saj, argumenton se *"Vendimi i kontestuar i Qeverisë është nxjerrë dy ditë para Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës dhe është paraparë në planifikim buxhetor dhe mund të rishikohet* [...]". Në këtë linjë argumentimi, Qeveria pretendon se "*Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, në mënyrë specifike parasheh rritje buxheti për kategorinë paga dhe mëditje në organizatat buxhetore të prekura (Zyra e Kryeministrit, ministritë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës, etj.), çka vërteton se vendimi i kontestuar i Qeverisë është paraparë dhe është mbuluar me kategorinë paga dhe mëditje*". Qeveria po ashtu argumenton se "*bazuar në dispozitat përkatëse të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike, buxheti i Republikës së Kosovës mund të rishikohet dhe se buxheti i shtuar për organizatat buxhetore mbulon shtesat në paga deri në rishikim*".

95. Gjykata po ashtu vë në dukje përgjigjet e Ministrisë së Financave, e cila argumenton se, në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, "*Qeveria e aprovon Buxhetin dhe e dorëzon ne Kuvend [...] më së largu deri më datën 31 tetor dhe, mbi bazën e kësaj baze ligjore, Qeveria e ka dërguar në Kuvend brenda afat ligjor [në fund të tetorit 2017], duke përfshirë edhe rritjen e faturës se pagave [...]"*. Më tutje, Ministria e Financave thekson se *"vendimi i kontestuar është i natyrës implementuese [...] dhe ai prapë inkorporohet brenda buxhetit në faza të mëvonshme"*. Për më tepër, Ministria e Financave potencon se vendimi i kontestuar "*asnjëherë nuk cenon buxhetin shtetëror [...]"* dhe se *"nga vitit 2004 e tutje ka*

pasur rritje të pagave me vendime administrative të Qeverisë. Në Republikën e Kosovës nuk kemi Ligj për pagat dhe si pasojë e kësaj gjithmonë pagat janë caktuar apo rregulluar përmes vendimeve administrative të Qeverisë [...] shuma e mjeteve të parapara me këto vendime më pas janë rregulluar brenda buxhetit të shtetit në faza të ndryshme, duke zbatuar Ligjin apo duke e rishikuar Buxhetin".

96. Gjykata vëren se argumentet kundërthënëse të palëve, në thelb, kanë të bëjnë me aspekte procedurale të miratimit dhe implementimit të buxhetit shtetëror, në ndërlidhje me kompetencën dhe procedurën për rritjen e pagave në sektorin publik.

97. Në lidhje me kompetencat e Qeverisë dhe Kuvendit, Gjykata fillimisht vë në dukje se asnjëra palë nuk e vë në pikëpyetje kompetencën e garantuar me Kushtetutë të Kuvendit për të miratuar buxhetin shtetëror dhe për të ushtruar funksionin e tij mbikëqyrës ndaj Qeverisë.

98. Më tutje, Gjykata thekson faktin qenësor se Republika e Kosovës ende nuk ka ligj, apo akt tjerë të veçantë, që rregullon në mënyrë gjithëpërfshirëse çështjen e pagave në sektorin publik.

99. Gjykata sjellë në vëmendje përgjigjet e pranuara nga vendet anëtare të Forumit të Komisionit të Venecias, ku bëhet e qartë se në këto vende çështja e pagave në sektorin publik rregullohet me ligje, përkatësisht akte të veçanta normative.

100. Gjykata vëren se, siç sqarohet edhe në përgjigjet e Ministrisë së Financave, si rezultat i vakumit ligjor për shkak të mungesës së Ligjit për pagat, praktika e krijuar në Republikën e Kosovës, që nga viti 2004, është rritja e pagave me vendime administrative të Qeverisë; vendime këto të cilat janë përfshirë në buxhet, me vendim të Kuvendit, në faza të ndryshme.

101. Gjykata dëshiron të theksojë se për të shmangur situata të tilla ku Qeveria merr vendime në vakum ligjor, është e domosdoshme që çështja e pagave në sektorin publik të rregullohet në mënyrë gjithëpërfshirëse, përmes një akti, gjegjësisht ligji te veçantë (ashtu siç është praktika e vendeve të Forumit të Komisionit të Venecias).

102. Për më tepër, Gjykata konsideron se, në përputhje me natyrën ekzekutive të kompetencave të saj, funksionimi i Qeverisë ndërlidhet ngushtë me procesin e nxjerrjes dhe implementimit të buxhetit shtetëror.

103. Në ndërlidhje me këtë, Gjykata thekson se një nga funksionet kryesore kushtetuese të Qeverisë, i përcaktuar në nenin 92.3, është zbatimi i ligjeve dhe i akteve të tjera të miratuara nga Kuvendi i Kosovës.

104. Gjykata qartëson se institucionet shtetërore duhet të ushtrojnë autorizimet e tyre në bazë të Kushtetutës dhe të Ligjit. Kuvendi është institucioni që ka përgjegjësinë e ushtrimit të pushtetit legjislativ, ndërsa Qeveria ushtron pushtetin e ekzekutiv në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve të miratuara në Kuvend (Shih, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës: rasti nr. KO73/16, parashtrues *Avokati i Popullit*, aktgjykim i 8 dhjetorit 2016, paragrafi 61).

105. Për sa i përket pretendimit kryesor të parashtruesve të kërkesës, se Qeveria përmes vendimit të kontestuar ka cenuar kompetencat e Kuvendit, Gjykata sjell në vëmendje se me 22 dhjetor 2017 Kuvendi ka miratuar Ligjin për Buxhetin e vitit 2018, duke ushtruar kështu funksionin e tij kushtetues për sa i përket miratimit të buxhetit shtetëror.

106. Për më tepër, Gjykata vëren argumentin e Ministrisë së Financave se, në kuadër të kompetencave të saj, Qeveria ka qenë propozues i Projektbuxhetit për vitin 2018, i cili është miratuar nga Kuvendi.

107. Gjykata po ashtu vë në pah se komisionet përkatëse të Kuvendit, përkatësisht Komisioni për Buxhet dhe Financa; Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit dhe Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, nuk paraqitën ndonjë koment në Gjykatë, në lidhje me pretendimet dhe argumentet e ndryshme, të ngritura në këtë kërkesë.

108. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është roli i saj të bëjë vlerësime hipotetike lidhur me mënyrën e implementimit të buxhetit shtetëror nga ana e Qeverisë, duke përfshirë edhe zbatimin e vendimit të kontestuar.

109. Gjykata, po ashtu, dëshiron të potencojë se, në përputhje me qëndrimin e saj të mëparshëm (shih rastin KO73/16), pretendimet e paraqitura në Gjykatë për shpërputhjen e akteve të ndryshme të Qeverisë me ligje përkatëse, duhet të argumentohen në nivel kushtetuese.

110. Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk kanë dëshmuar se si Qeveria ka cenuar kompetencat kushtetuese të Kuvendit, që kanë të

bëjnë me miratimin e buxhetit shtetëror, apo ndonjë kompetencë tjetër kushtetuese. Rrjedhimisht, në rastin konkret, Gjykata nuk është e bindur se vendimi për rritjen e pagave përbën çështje të nivelit kushtetues.

111. Në dritën e pretendimeve dhe argumenteve të paraqitura më lartë, Gjykata
konsideron se Kuvendit nuk i është cenuar apo pamundësuar ushtrimi i kompetencave të tij kushtetuese që kanë të bëjnë me miratimin dhe zbatimin e buxhetit shtetëror.

112. Megjithatë, Gjykata vë në dukje po ashtu se aktet nënligjore të Qeverisë duhet të jenë në pajtueshmëri me Kushtetutën dhe me ligjet. Për më tepër, Gjykata thekson se, në përputhje me natyrën ekzekutive të kompetencave të saj kushtetuese, Qeveria është e detyruar të implementojë buxhetin shtetëror, të miratuar nga Kuvendi. Andaj, është obligim i Qeverisë që zbatimin e Vendimit të kontestuar ta mbështesë në ndarjet buxhetore të përcaktuara në Buxhetin e vitit 2018 dhe në ligjet përkatëse.

113. Për sa i përket pretendimeve të parashtruesve të kërkesës që kanë të bëjnë me konfliktin e interesit, Gjykata vë re se, në analogji me vendimin e saj në rastin nr. KO73/16, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të vlerësojë aspektet ligjore të akteve të Qeverisë, ose nëse ato janë të mbështetura nga politika të mira publike. Pra, Gjykata thekson se nuk është brenda funksionit të saj të vlerësojë pretendimet për shpërputhjen e vendimit të kontestuar me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (për të cilin Agjencia Kundër Korrupsionit ka dhënë vlerësimin e saj).

114. Sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 3 [Barazia para Ligjit] dhe të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës, sepse me anë të vendimit të kontestuar të Qeverisë, *"funksionarëve të lartë të Qeverisë si dhe vartësve të tyre u mundësohet pagë më e favorshme se çdo qytetari tjetër në Kosovë",* Gjykata konsideron se ky pretendim është i pa mbështetur në argumente bindëse. Për më tepër, Gjykata konsideron se nuk qëndron analogjia e këtij vendimi me rastin Nr. KO119/10[Aktgjykim i datës 8 dhjetor 2011, Vlerësim i kushtetutshmërisë se nenit 14 paragrafit 1.6, nenit 22, nenit 24, nenit 25 dhe nenit 27 te Ligjit për te Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, Nr. 03/L111, të 4 qershorit 2010]. Kjo për faktin se në rastin KO119/10, Gjykata nuk ka vlerësuar pagat e deputetëve por pensionet shtesë të tyre, për të cilat Gjykata ka konsideruar se krijon diskriminim ndaj pjesëtarëve të tjerë të shoqërisë dhe pensionistëve në Kosovë, pasi deputetët do të përfitonin pensione substanciale, nga buxheti i shtetit

pa kontributin e tyre, që nuk ishte rasti me pjesëtarët e tjerë të shoqërisë.

115. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se trajtimi është diskriminues nëse një individ trajtohet ndryshe nga të tjerët në pozita ose situata të ngjashme dhe nëse ky ndryshim në trajtim nuk ka ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Gjykata përsërit se trajtimi i ndryshëm duhet të ndjekë një qëllim legjitim për të qenë i justifikuar dhe duhet të ketë një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet. (Shih rastin e GJEDNJ-së *Marckx kundër Belgjikës,* Kërkesa nr. 6833/74, Aktgjykimi i 13 qershorit 1979, paragrafi 33).

116. Në lidhje me këtë, Gjykata konsideron se dallimi në paga në vetvete nuk krijon trajtim të pabarabartë për qëllime te nenit 3 dhe 7 të Kushtetutës. Rrjedhimisht, parashtruesit nuk kanë paraqitur fakte bindëse se pagat e parapara në vendimin e kontestuar trajtojnë ndryshe pozita ose situata të ngjashme dhe nëse ky ndryshim në trajtim nuk ka ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm.

Përfundim

117. Gjykata dëshiron të theksojë se nuk është brenda fushëveprimit të saj që të vlerësojë apo të zëvendësojë politikat publike të përcaktuara nga organi legjislativ apo ekzekutiv. Parimi i ndarjes së pushteteve detyron Gjykatën që të respektojë përcaktimin e politikave nga organet gjegjëse kushtetuese. Vendimet themelore të politik-bërjes për qeverisjen e vendit duhet të merren nga organet kushtetuese me legjitimitet demokratik, përkatësisht nga Kuvendi dhe Qeveria. Ato organe – për shkak të natyrës së tyre dhe legjitimitetit demokratik – janë të thirrura për të përcaktuar dhe avancuar politikat buxhetore, ekonomike dhe sociale të vendit (shih, GJEDNJ *mutatis mutandis, Dubska dhe Krejzova kundër Republikës Çeke* [DHM], § 175).

118. Gjykata konsideron se organet kushtetuese janë të obliguara të përfillin kompetencat e njëri-tjetrit gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre kushtetuese. Situatat e paqarta për sa i përket ushtrimit të kompetencave, sikurse rasti nën shqyrtim, në të ardhmen mund të shmangen me nxjerrje të ligjeve përkatëse për Qeverinë dhe për pagat e funksionarëve shtetëror.

119. Si përfundim, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk kanë paraqitur prova bindëse për të mbështetur pretendimet e tyre se vendimi i kontestuar i Qeverisë ka prodhuar efekte kushtetuese, në

kuptim të cenimit të kompetencave kushtetuese të Kuvendit, apo shkelje të ndonjë dispozite kushtetuese.

Kërkesa për masë të përkohshme

120. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës gjithashtu kërkojnë nga Gjykata që të nxjerrë vendim për caktimin e masës së përkohshme, përkatësisht ndalimin e ekzekutimit të vendimit të kontestuar deri në vendosjen e rastit nga Gjykata, sepse *"nëse zgjatet kjo situatë kundër kushtetuese buxheti i Republikës së Kosovës do të pësojë humbje të mëdha monetare të paparashikuara"*.

121. Gjykata rikujton se, më 6 shkurt 2018, Qeveria njoftoi se kishte nxjerrë vendim për pezullimin e përkohshëm të vendimit të kontestuar të Qeverisë deri në marrjen e vendimit përfundimtar të Gjykatës për këtë çështje.

122. Duke qenë se Vendimi i kontestuar ishte pezulluar nga Qeveria, Gjykata konsideron se nuk ka nevojë të shqyrtojë kërkesën për masë të përkohshme.

123. Prandaj, në pajtim me nenin 27 (1) të Ligjit dhe me rregullin 55 (4) të Rregullores së punës, kërkesa e parashtruesit për masë të përkohshme refuzohet si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 113. 2 (1) dhe 116. 2 të Kushtetutës, neneve 27 (1), 29 dhe 30 të Ligjit dhe në mbështetje të rregullave 29, 54, 55 dhe 56 (1) të Rregullores së punës, më 29 maj 2018

VENDOS

I. TA DEKLAROJË njëzëri kërkesën të pranueshme për shqyrtim në merita;

II. TË KONSTATOJË me shumicë votash se Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 20/14, i 20 dhjetorit 2017, nuk është në kundërshtim me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 7 [Vlerat], 65 [Kompetencat e Kuvendit], 92 [Parimet e Përgjithshme] dhe 93 [Kompetencat e Qeverisë] të Kushtetutës;

III. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;

IV. T'UA KUMTOJË këtë aktgjykim palëve;

V. TA PUBLIKOJË këtë aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe

VI. TË SHPALLË që ky aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Bekim Sejdiu	Arta Rama-Hajrizi

MENDIM I PËRBASHKËT MOSPAJTUES
i gjyqtarëve Almiro Rodrigues dhe Gresa Caka-Nimani

në

rastin nr. KO12/18

Parashtrues

Albulena Haxhiu dhe 30 deputetë të tjerë
të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së
Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 04/20,
të 20 dhjetorit 2017

E respektojmë vendimin e Shumicës së Gjyqtarëve (në tekstin e mëtejmë: Shumica) të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata). Megjithatë, gjithnjë me respekt, ne nuk mund të pajtohemi me të, për arsyet që do të elaborohen në vijim.

Fushëveprimi i kërkesës

1. Parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se Vendimi nr. 04/20 i 20 dhjetorit 2017 (në tekstin e mëtejmë: Vendimi i kontestuar) i Qeverisë së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Qeveria) nuk është në përputhje me nenet: 3 [Barazia para Ligjit]; 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit]; 7 [Vlerat]; 65 [Kompetencat e Kuvendit]; 92 [Parimet e Përgjithshme]; dhe 93 [Kompetencat e Qeverisë] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

2. Kërkesa e parashtruesve në radhë të parë ka të bëjë me pretendimin se, përmes nxjerrjes së Vendimit të kontestuar, Qeveria ka tejkaluar kompetencat e saj të përcaktuara me nenet 92 dhe 93 të Kushtetutës, duke cenuar kështu edhe kompetencat e Kuvendit të përcaktuara me nenin 65 të Kushtetutës. Në këtë drejtim, parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretendojnë që është shkelur neni 4 i Kushtetutës.

3. Shumica vendosi ta deklarojë këtë Kërkesë të pranueshme dhe të konstatojë që Vendimi i kontestuar nuk është në kundërshtim me nenet 3 [Barazia para Ligjit]; 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit]; 7 [Vlerat]; 65 [Kompetencat e Kuvendit]; 92 [Parimet e Përgjithshme] dhe 93 [Kompetencat e Qeverisë] të Kushtetutës.

Faktet e rastit

4. Qeveria nxorri Vendimin e kontestuar më 20 dhjetor 2017. Vendimi hyri në fuqi në ditën e nënshkrimit, për t'u zbatuar në mënyrë retroaktive që nga 1 dhjetori 2017.[1]

5. Vendimi i kontestuar rriti pagat e një liste specifike të pozitave të Qeverisë, duke përfshirë: a) Kryeministrin, Zëvendës Kryeministrat, Ministrat dhe zëvendësit e tyre; b) një numër të emëruarish politik lidhur me pozitat e lartshënuara; c) një numër të nëpunësve civilë të punësuar në Zyrën e Kryeministrit. Ndonëse të pa përmendur në mënyrë specifike, Vendimi i kontestuar prodhon të njëjtat efekte për të gjithë prokurorët dhe gjyqtarët, duke përfshirë edhe gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, sipas proporcioneve të përcaktuara në Ligjin për Gjykatat, Ligjin për Prokurorin e Shtetit dhe Ligjin për Gjykatën Kushtetuese.[2]

6. Dy ditë më vonë, më 22 dhjetor 2017, Kuvendi i Republikës se Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kuvendi) miratoi Ligjin nr. 06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018 (në tekstin e mëtejmë: Ligji për Buxhetin 2018).

7. Më 29 janar 2018, 31 deputetë të Kuvendit parashtruan një kërkesë në Gjykatë, duke kontestuar përputhshmërinë e Vendimit të kontestuar me Kushtetutën.

Vërejtje preliminare

8. Shumica, duke konstatuar se Vendimi i kontestuar nuk është në kundërshtim me nenet e lartshënuara të Kushtetutës, konstatoi se "*Gjykata nuk është e bindur se vendimi për rritjen e pagave përbën çështje të nivelit kushtetues*" (paragrafi 110 i Aktgjykimit) dhe se "*parashtruesit e kërkesës nuk kanë paraqitur prova bindëse për të mbështetur pretendimet e tyre se Vendimi i kontestuar i Qeverisë ka prodhuar efekte kushtetuese, në kuptim të cenimit të kompetencave kushtetuese të Kuvendit, apo shkelje të ndonjë dispozite kushtetuese*" (paragrafi 119 i Aktgjykimit). Ne nuk pajtohemi.

9. Thelbi i çështjes së ngritur para Gjykatës nuk është nëse një vendim i Qeverisë "*për rritje pagash*" është në përputhje më Kushtetutën; por

[1] Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 04/20 i 20 dhjetorit 2017.
[2] Ligji nr. 03/L-199 për Gjykatat; Ligji nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit dhe Ligji nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese.

nëse një vendim i Qeverisë pa "autorizim në ligj" ose që nuk "zbaton një ligj", sikur është rasti në rrethanat e rastit konkret, është në përputhje me kompetencat e Qeverisë për të marrë vendime, siç janë të përcaktuara me nenet 92 dhe 93 të Kushtetutës. Ne mendojmë që kjo është çështje kushtetutshmërie.

10. Për më tepër, ne mendojmë që me nxerrjen e Vendimit të kontestuar, në rrethanat e rastit konkret, Qeveria ka tejkaluar kufijtë e kompetencave të saj për ushtrimin e funksionit ekzekutiv siç është përcaktuar me nenet 92 dhe 93 të Kushtetutës. Ky konstatim bazohet mbi dy argumentet thelbësore në vijim. Vendimi i kontestuar a) as nuk "zbaton ligj" siç kërkohet me nenet 92.3, 92.4 dhe 93.4 të Kushtetutës; dhe b) as nuk është "propozim" siç kërkohet me nenet 92.4 dhe 93.5 të Kushtetutës. Rrjedhimisht, Vendimi i kontestuar rezulton në cenimin e kompetencave të Kuvendit për të miratuar buxhetin siç është përcaktuar me nenin 65.5 të Kushtetutës. Përfundimisht, ne konsiderojmë që neni 4 i Kushtetutës mbi Formën e Qeverisjes dhe Ndarjen e Pushtetit është afektuar gjithashtu sepse a) tejkalimi i kompetencave të Qeverisë dhe cenimi respektiv i kompetencave të pushtetit legjislativ, kanë afektuar balancimin në mes ekzekutivit dhe legjislativit siç është përcaktuar me këtë nen; dhe b) Vendimi i kontestuar prodhon efekte për një degë të pavarur të pushtetit, pushtetin gjyqësor, duke e anashkaluar kontrollin parlamentar.

11. Këto janë pretendimet më të rëndësishme që kanë të bëjnë me rrethanat e rastit konkret. Prandaj, ne do të përmbahemi nga analiza e përputhshmërisë së Vendimit të kontestuar me nenet 3 dhe 7 të Kushtetutës.

Përputhshmëria me nenet 92 dhe 93 të Kushtetutës

12. Neni 4 i Kushtetutës përcakton formën e qeverisjes, ndarjen e pushtetit në mes tri pushteteve të qeverisjes dhe kontrollin e balancimin përkatës në mes tyre. Në këtë aspekt, dhe për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, Kushtetuta përcakton që Kuvendi ushtron pushtetin legjislativ (neni 4.2), ndërsa Qeveria është përgjegjëse për "zbatimin e ligjeve" e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar (neni 4.4).

13. Në përcaktimin e mëtejmë të kompetencave të Qeverisë dhe kufizimeve përkatëse, neni 92 i Kushtetutës e autorizon Qeverinë me ushtrimin e pushtetit ekzekutiv; megjithatë, duke e kufizuar këtë

funksion brenda kufijve të "pajtueshmërisë me Kushtetutën dhe ligjin" (neni 92.2).[3]

14. Neni 92.3 më tej plotëson nenin 4 të Kushtetutës në definimin e përgjegjësisë së Qeverisë për "zbatimin e ligjit" dhe akteve të tjera të miratuara nga Kuvendi dhe ushtrimin e veprimtarive të tjera brenda fushëveprimit të përgjegjësive të përcaktuara me "Kushtetutë dhe ligj". Për më tepër, në ushtrimin e pushtetit ekzekutiv, kompetenca e Qeverisë për të "marrë vendime" është e përcaktuar me Kushtetutë, megjithatë e njëjta kufizohet me "pajtueshmërinë me Kushtetutën dhe ligjet" (neni 92.4).

15. Në anën tjetër, neni 93.4 i Kushtetutës specifikon më tutje se kompetenca e Qeverisë për "marrjen e vendimeve dhe nxjerrjen e akteve juridike ose rregulloreve" është e kufizuar në "nevojën për zbatimin e ligjeve".

16. Prandaj, sipas Kushtetutës, në ushtrimin e funksioneve të saj, Qeveria është e autorizuar të marrë vendime dhe të nxjerrë akte juridike ose rregullore, për sa kohë që ato janë: a) "në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin"; dhe b) "të nevojshme për zbatimin e ligjeve". Në të kundërtën, Kushtetuta e autorizon Qeverinë që të propozojë projektligje, të propozojë amendamentimin e ligjeve ekzistuese ose akteve të tjera dhe të japë mendimin e saj rreth projektligjeve që nuk janë propozuar prej saj (nenet 92.4 dhe 92.3). Në dritën e këtyre kompetencave, neni 93.5 i Kushtetutës në mënyrë specifike e autorizon Qeverinë që t'i propozojë Kuvendit Buxhetin e Republikës së Kosovës.

17. Parimet e përgjithshme të përshkruara më lart, sa i përket kufizimeve të kompetencave të Qeverisë në ushtrimin e funksioneve të saj ekzekutive në "pajtueshmëri me Kushtetutën dhe ligjin", në vijim do të aplikohen në rrethanat e rastit konkret, dhe për këtë arsye do të përqendrohen në kompetencën e Qeverisë për të nxjerrë "vendime dhe akte juridike".

18. Siç është arsyetuar më lart, kompetenca për "marrjen e vendimeve" kufizohet në kushtet kushtetuese si në vijim: a) "pajtueshmërinë me Kushtetutën dhe ligjet" (neni 92.4); dhe b) "të nevojshme për zbatimin e ligjeve" (neni 93.4). Në të kundërtën, Qeverisë i është dhënë kompetenca që t'i "propozojë" Kuvendit, projektligje, duke përfshirë

[3] Në analizën e kompetencave kushtetuese të Qeverisë, autorizimeve të saj dhe kufizimeve përkatëse, si dhe kontrollin dhe balancimin me degët e tjera të qeverisjes, ky Mendim do të kufizohet në masën e nevojshme dhe për aq sa është relevante për rrethanat e çështjeve të ngritura në këtë Kërkesë.

projektligjin për buxhetin dhe amendamentime të ligjeve ekzistuese (nenet 92.3, 92.4 dhe 93.5).

19. Prandaj, në vlerësimin e përputhshmërisë të Vendimit të kontestuar me Kushtetutën, dy çështje parësore dhe thelbësore kushtetuese duhet të shqyrtohen: a) A është Vendimi i kontestuar "i nevojshëm për zbatimin e ligjit" siç kërkohet me nenin 93.4 të Kushtetutës?; dhe b) Nëse jo, a është "propozim" për Kuvendin, në formë të një projektligji apo amendamentimi të ligjit siç kërkohet me nenet 92.4 dhe 93.3 të Kushtetutës?

A zbaton Vendimi i kontestuar "një ligj"?

20. Vendimi i kontestuar është nxjerrë më 20 dhjetor 2017 dhe përcakton që ka efekt retroaktiv nga 1 dhjetori 2017. Ligji për Buxhetin 2018 u miratua nga Kuvendi dy ditë më vonë, më 22 dhjetor 2017, respektivisht. Prandaj, Vendimi i kontestuar, në rrethanat e rastit konkret, mund të ketë qenë i nevojshëm vetëm për një nga dy qëllimet në vijim: a) të mbështesë zbatimin e Ligjit për Buxhetin 2017; ose b) të mbështesë zbatimin e Ligjit për Buxhetin 2018. Siç do të argumentohet në vijim, ky rast nuk është rasti.

21. Qeveria nuk argumenton të ketë nxjerrë Vendimin e kontestuar si një akt të nevojshëm për zbatimin e Ligjit për Buxhetin e vitit 2017, në fuqi në kohën kur është nxjerrë Vendimi i kontestuar. Qeveria, megjithëse me argumente kontradiktore, pohon se Vendimi i kontestuar është një akt që mbështet zbatimin e Ligjit për Buxhetin e vitit 2018, që nuk ishte në fuqi kur është nxjerrë Vendimi i kontestuar.[4]

22. Në fakt, vet Vendimi i kontestuar nuk i referohet fare asnjë ligji. Ai është nxjerrë duke iu referuar neneve 92.4 dhe 93.4 të Kushtetutës, të cilat kufizojnë kompetencën e Qeverisë për të vepruar në "pajtueshmëri" dhe në funksion të "zbatimit të një ligji".

23. Vendimi i kontestuar gjithashtu i referohet Rregullores 09/2011[5] dhe nenit 4 të Rregullores 02/2011.[6] Në këtë aspekt, Qeveria argumenton

---

[4] Komente të Qeverisë së Republikës së Kosovës sipas kërkesës të Gjykatës lidhur me Kërkesën e parashtruar në rastin KO12/18 të 9 shkurtit 2018; dhe Përgjigje e Ministrisë së Financave ndaj kërkesës së Gjykatës për komentet në lidhje me rastin KO12/18 me numër reference 01 353 të 27 shkurtit 2018.

[5] Rregullorja nr. 09/2011 për Rregulloren e punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.

[6] Rregullorja nr.02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive.

se, në bazë të nenit 99 [Procedurat] të Kushtetutës, vendimmarrja e saj, përpos ligjit, rregullohet edhe me rregullore dhe se, në mungesë të Ligjit për Qeverinë, Qeveria është e autorizuar të veprojë në bazë të Rregullores së referuar të Qeverisë. Kjo qëndron; megjithatë, Qeveria duke iu referuar rregulloreve të saj, nuk mund të tejkalojë kompetencat e saj siç janë përcaktuar e kufizuar përmes Kushtetutës dhe ligjit. Për më tepër që, Rregulloret të cilave Qeveria u referohet vet, gjithashtu kufizojnë fushëveprimin e vendimmarrjes së Qeverisë në "pajtueshmëri me Kushtetutën dhe ligjin" dhe për qëllim të "zbatimit të ligjeve".[7]

24. Në të vërtetë, në përgjigjen e saj ndaj Gjykatës, Qeveria pranon se Vendimi i saj i kontestuar nuk zbaton asnjë ligj,[8] por arsyeton nxjerrjen e Vendimit të kontestuar për shkak të "*mungesës së ligjit për pagat për zyrtarët qeveritarë*" dhe bazuar në "*praktikën e deritanishme*".[9] Asnjë nga këto argumente nuk qëndrojnë dhe as nuk justifikojnë një veprim të Qeverisë jashtë kufizimeve të përcaktuara me nenet 92 dhe 93 të Kushtetutës.

25. "*Mungesa e një ligji*" ose një situatë e "*vakumit ligjor*", siç i referohet Shumica (paragrafët 100 dhe 101 të Aktgjykimit), nuk e autorizojnë Qeverinë për të nxjerrë një vendim të tillë, sepse siç është elaboruar më lart, vendimet e Qeverisë janë të kufizuara të jenë në "pajtueshmëri me Kushtetutën dhe ligjin" dhe duhet të nxirren për qëllim të "zbatimit të një ligji". Në "*mungesë të ligjit*", Qeveria ka autorizimin për të vepruar në bazë të kompetencave të përcaktuara me Kushtetutë për të "*propozuar një ligj apo një amendamentim të një ligji*" në Kuvend. Qeveria nuk mund të marrë vendime ose të nxjerrë akte që nuk "zbatojnë një ligj". Në të kundërtën, Qeveria do të tejkalojë kufizimet e kompetencave të saj dhe do të cenoj ato që i janë përcaktuar me Kushtetutë një pushteti tjetër të qeverisjes, atij legjislativ.

26. Për më tepër, fakti që nuk ekziston një "*ligj për pagat e zyrtarëve qeveritarë*" nuk do të thotë se nuk ekziston kornizë ligjore në Kosovë që rregullon "pagat dhe mëditjet" dhe as që Qeveria është e autorizuar të veprojë në kundërshtim me ligjin ekzistues të aplikueshëm. Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe amendamentet përkatëse , ligjet për Buxhetin, si dhe Ligji për Pagat e

[7] Rregullorja nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave, Neni 4 për Qeverinë.
[8] Komente të Qeverisë së Republikës së Kosovës sipas kërkesës së Gjykatës lidhur me Kërkesën e parashtruar në rastin KO12/18 të 9 shkurtit 2018.
[9] Komente të Qeverisë së Republikës së Kosovës sipas kërkesës së Gjykatës lidhur me Kërkesën e parashtruar në rastin KO12/18 të 9 shkurtit 2018.

Nëpunësve Civilë, i afektuar nga Vendimi i kontestuar, ndër të tjera, rregullojnë çështjet që kanë të bëjnë me "pagat dhe mëditjet" e që mbulohen përmes buxhetit të shtetit, duke përfshirë këtu edhe mundësitë për rregullimin/ndryshimin e ndarjeve buxhetore dhe kufizimet përkatëse brenda vitit fiskal.[10]

27. Në fund, "*praktika e deritanishme*" nuk është argument. Së pari, siç u shtjellua më lart, thelbi i çështjes së ngritur para Gjykatës nuk është detyrimisht nëse Qeveria mund të marrë "vendime që rrisin pagat", por nëse Qeveria mund të marrë vendime të cilat nuk "zbatojnë një ligj" ose të cilat nuk kanë "autorizim në ligj". Së dyti, fakti që mund të ketë pasur praktikë në bazë të së cilës pagat e zyrtarëve qeveritarë mund të jenë rritur përmes vendimeve ose akteve të Qeverisë, e të cilat mund të kenë "zbatuar" ose jo ligjet në fuqi, nuk do të thotë domosdoshmërisht se janë ose jo në "përputhje me Kushtetutën dhe ligjin". Gjykata nuk ka vlerësuar përputhshmërinë e vendimeve të tilla me Kushtetutën.

28. Në këtë aspekt, dhe për arsyet e lartcekura, shprehim mospajtimin tonë me arsyetimin e Shumicës (paragrafët 98 dhe 100 të Aktgjykimit), e të cilët mbështesin "*mungesën e ligjit*" dhe "*praktikën e deritanishme*" si argumente për të justifikuar përputhshmërinë e Vendimit të kontestuar me Kushtetutën.

29. Për më tepër, në shqyrtimin e kushtetutshmërisë së vendimeve të ngjashme qeveritare, Gjykata tjera Kushtetuese kanë arritur përfundime esencialisht të ngjashme.[11] Ndër të tjera, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Lituanisë argumentoi se Qeveria është e detyruar *"të veprojë në përputhje me ligjet e miratuara nga Kuvendi"*.

---

[10] Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë i 3 qershorit 2008 (Neni 30 për Rregullimin e ndarjeve buxhetore të organizatës buxhetore); Ligji Nr. 05/L-063 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjet Nr. 03/L-221, Nr. 04/L-116 dhe Nr. 04/L-194 (Neni 22/C për Kufizimin e rritjes së buxhetit për paga dhe mëditje); Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Shërbyesve Civil i 25 Qershorit 2010 (Neni 8 për Llogaritjen e pagës bazë).

[11] Ndër të tjera: Gjykata Kushtetuese e Moldavisë (Vendimi 21/2004) theksoi se, në bazë të Kushtetutës së saj, Qeveria nxjerr akte për "zbatimin e ligjeve". Sipas këtij Vendimi, Dekreti nr. 782-37, i cili nuk përmbajti asnjë bazë ligjore dhe nuk i referohej ligjit apo dispozitave ligjore që zbaton, u deklarua jokushtetues, pasi Qeveria tejkaloi kufijtë e saj kushtetues. Në mënyrë të ngjashme, Gjykata Kushtetuese e Estonisë (Vendimi 3-4-1-5-2000), lidhur me shqyrtimin e kushtetutshmërisë së një rregulloreje të Qeverisë, theksoi se Qeveria është e autorizuar të nxjerrë rregullore për sa kohë që ligji i jep kompetencën për ta bërë këtë.

Ajo specifikisht theksoi se: *"Qeveria, ..., përderisa kalon rezoluta, nuk mund të veprojë ultra vires; ajo duhet të respektojë Kushtetutën dhe ligjet. Nëse Qeveria nuk respekton ligjet, parimi kushtetues i një shteti bazuar në sundimin e ligjit, që nënkupton hierarkinë e akteve ligjore, si dhe pikës 2 të nenit 94 të Kushtetutës, ku Qeveria, ndër të tjera, zbaton ligje, do të mohoheshin"*. Përveç kësaj*: "Kjo është gjithashtu e zbatueshme për Qeverinë e cila nuk gëzon asnjë diskrecion për të vendosur për moszbatimin e dispozitave të një ligji të caktuar, i cili rregullon marrëdhëniet përkatëse, përveç nëse moszbatimi i një dispozite të caktuar të ligjit është paraparë në ligje expressis verbis*".[12]

30. Si përfundim, dhe në përmbledhje, konkludojmë se Vendimi i kontestuar nuk është nxjerrë për "zbatimin e ndonjë ligji" siç kërkohet me nenet 92.3 dhe 93.4 të Kushtetutës. Argumenti i parashtruar nga Qeveria dhe i pranuar nga Shumica, se Vendimi i kontestuar është nxjerrë në "*mungesë të ligjit*" dhe duke u bazuar në "*praktikën e deritanishme*", vet rezulton në përfundimin se në nxjerrjen e Vendimit të kontestuar, Qeveria ka vepruar jashtë kufizimeve të përcaktuara në nenet përkatëse të Kushtetutës.

31. Në vijim, paragrafët e mëposhtëm do të analizojnë nëse Qeveria, duke nxjerrë Vendimin e kontestuar, ka vepruar në pajtim me alternativën, gjegjësisht kompetencën e saj për të "propozuar" një ligj, një amendament të ligjit ose për të "propozuar" buxhetin për miratim në Kuvend, të përcaktuara me nenet 92.4, 93.3 dhe 93.5 të Kushtetutës, respektivisht.

A mund të cilësohet Vendimi i kontestuar si "propozim"?

32. Vendimi i kontestuar nuk hyn në kategorinë e "propozimit të projektligjit ose amendamentit të ligjit", siç përcaktohet me nenet 92.4 dhe 93.3 të Kushtetutës. Ky nuk është rasti, dhe as parashtruesit e kërkesës ose Qeveria nuk e pohojnë këtë. Prandaj, duhet të analizohet nëse Vendimi i kontestuar është "propozim" në kuptimin e nenit 93.3 të Kushtetutës, i cili autorizon Qeverinë që t'ia "propozojë" buxhetin Kuvendit.

33. Ne konsiderojmë që ky nuk është rasti. Në këtë aspekt, do të fokusohemi në tri çështjet esenciale në vijim: a) retroaktiviteti i Vendimit të kontestuar; b) koha e nxjerrjes së tij; dhe c) qëllimi i tij.

[12] Gjykata Kushtetuese e Republikës së Lituanisë, Vendimi nr. 70/06 i 23 majit 2007, paragrafi 16.

34. Së pari, vet fakti që Vendimi i kontestuar ka efekt retroaktiv, është kundër çdo argumenti të mundshëm që Vendimi i kontestuar mund të cilësohet si "propozim" për qëllimet e Ligjit për Buxhetin për 2018.

35. Së dyti, Qeveria kishte miratuar dhe dorëzuar për miratim në Kuvend buxhetin e propozuar për vitin 2018 deri më 31 tetor 2017, siç është e kërkuar mbi bazën e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.[13] Përgjigja e Ministrisë së Financave e dorëzuar në Gjykatë pohon të njejtën: "*Qeveria e aprovon Buxhetin dhe e dorëzon në Kuvendin e Republikës së Kosovës më së largu deri më datën 31 tetor dhe mbi bazën e kësaj baze ligjore Qeveria e ka dërguar [projektligjin] në Kuvend brenda afat ligjor fundi i tetorit.*".[14] Vendimi i kontestuar është nxjerrë pas këtij afati.

36. Së treti, Qeveria konsideron se Vendimi i kontestuar, së paku pjesërisht, është përfshirë në propozimin e Qeverisë për Buxhetin 2018 qoftë "*në formën e përgatitjes buxhetore*" apo "*në procesin e rishikimit të buxhetit*" dhe se "*prapë inkorporohet brenda buxhetit në faza të mëvonshme*".[15] Parashtruesit e kërkesës pohojnë se ky nuk është rasti, pasi "*Ministria e Financave në asnjë rrethanë dhe në asnjë rast nuk ofron asnjë dëshmi të përputhshmërisë së vendimit [të kontestuar] me ligjin për buxhetin*". [16]

37. Në këtë aspekt, ne vërejmë se deklaratat e Qeverisë bien në dy kategori të ndryshme. E para, "*qoftë në formën e përgatitjes buxhetore*", ka të bëjë fazën përgatitore para dorëzimit të buxhetit të propozuar në Kuvend; ndërsa e dyta, "*në procesin e rishikimit të buxhetit*" dhe që "*inkorporohet brenda buxhetit në faza të mëvonshme*", ka të bëjë me fazën pas miratimit të buxhetit të propozuar në Kuvend. Rrjedhimisht, vetëm kategoria e parë është relevante për të konkluduar nëse Vendimi i kontestuar mund të cilësohet si "propozim" në rrethanat e rastit konkret.

---

[13] Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Neni 22 për Dorëzimin në Kuvend të Propozim Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe Propozim Ligjit për Ndarje Buxhetore.

[14] Përgjigje e Ministrisë së Financave ndaj kërkesës së Gjykatës për komentet në lidhje me rastin KO12/18 me numër reference 01 353 të 27 shkurtit 2018.

[15] Komente të Qeverisë së Republikës së Kosovës sipas kërkesës së Gjykatës lidhur me Kërkesën e parashtruar në rastin KO12/18 të 9 shkurtit 2018; dhe Përgjigje e Ministrisë së Financave ndaj kërkesës së Gjykatës për komentet në lidhje me rastin KO12/18 me numër reference 01 353 të 27 shkurtit 2018.

[16] Përgjigje e parashtruesve në kërkesën e Gjykatës të 26 prillit 2018 për komentet lidhur me përgjigjen e Ministrisë së Financave të 27 shkurtit 2018.

38. Kategoria e dytë është relevante sa i përket zbatimit të Ligjit pas miratimit në Kuvend dhe rrjedhimisht reflekton mekanizma që mund të realizohen ose përmes "propozimit" të amendamenteve për Ligjin, ose përmes vendimeve që "zbatojnë" të njejtin. Rrjedhimisht, argumentet që kanë të bëjnë me zgjidhje sa i përket mekanizmave të "*inkorporimit të buxhetit në procesin e rishikimit të buxhetit 2018*" ose *"inkorporimit në faza të mëvonshme*", duke përfshirë edhe referencat e Ministrisë së Financave për mekanizmat e përcaktuara në nenin 15 të Ligjit për Buxhetin për vitin 2018, ose të referencave të Qeverisë në përgjigjën e saj për Gjykatën të përcaktuara me nenin 25 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nuk janë relevante. Siç theksohet në këtë Mendim, Vendimi i kontestuar nuk është një akt "që zbaton Ligjin për Buxhetin për 2018".

39. Ndërsa, sa i përket kategorisë së parë, përkatësisht pohimit që Vendimi i kontestuar është i inkorporuar në buxhetin e propozuar për vitin 2018, në vërejmë që Qeveria nuk argumenton në asnjë mënyrë që "rritja" e propozuar nga Qeveria dhe e miratuar nga Kuvendi është në përputhje me "rritjen" e përcaktuar përmes Vendimit të kontestuar.[17] Për më tepër, këto argumente nuk sqarojnë e as nuk arsyetojnë qëllimin apo nevojën për nxjerrjen e Vendimit të kontestuar.

40. Në fund, kompetenca e Qeverisë, sipas nenit 93 të Kushtetutës për të "propozuar" buxhetin, nuk përfshin vetëm aktin e "propozimit", por përfshin një proces. Ky proces është përcaktuar qartë përmes Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.[18] Ky i fundit përcakton që Qeveria përgatit dhe miraton buxhetin e propozuar dhe e dorëzon ne Kuvend deri me 31 tetor. Kur Qeveria dorëzon "propozimin" për buxhet, një proces tjetër fillon – ai i shqyrtimit në Kuvend, dhe më pas i "miratimit" të buxhetit të propozuar nga Qeveria.

41. Vendimi i kontestuar është nxjerrë pasi Qeveria ka miratuar dhe dorëzuar buxhetin e propozuar për vitin 2018 për miratim në Kuvend dhe para se Kuvendi e ketë miratuar atë. Në këtë aspekt, Vendimi i

[17] Përgjigje e Ministrisë së Financave ndaj kërkesës së Gjykatës për komentet në lidhje me rastin KO12/18 me numër reference 01 353 të 27 shkurtit 2018, pohon se Buxheti për vitin 2018 rrit faturën e pagave siç është përcaktuar me Nenin 22c (Kufizimi i rritjes së buxhetit për paga dhe mëditje) të Ligjit Nr. 05/L-063 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjet Nr. 03/L-221, Nr. 04/L-116 dhe Nr. 04/L-194.

[18] Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Pjesa IV mbi Përgatitjen dhe Përmbajtjen e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës të Propozuar.

kontestuar as nuk mund të cilësohet si "propozim" për qëllime të buxhetit për vitin 2018, sepse i njejti tashmë ishte dorëzuar, dhe as si "propozim" për amendamentim të buxhetit për vitin 2018 e as si vendim që "zbaton" të njejtin, sepse ai nuk ishte miratuar ende nga Kuvendi.[19]

42. Si përmbledhje, dhe për arsyet e lartpërmendura, ne konkludojmë se Vendimi i kontestuar nuk mund të cilësohet si "propozim" brenda kuptimit të neneve 92.4, 93.3 dhe 93.5 të Kushtetutës, respektivisht.

43. Rrjedhimisht, duhet të konkludohet se Vendimi i kontestuar as nuk cilësohet si "propozim" për Ligjin për Buxhetin 2018, e as si vendim apo akt që "zbaton" Ligjin për Buxhetin 2018. Kështu, me nxjerrjen e Vendimit të kontestuar, Qeveria i ka tejkaluar kufizimet e kompetencës së saj dhe ka vepruar në kundërshtim me nenin 92.4 dhe 93.4 të Kushtetutës. Me të arritur në këtë konkludim, ne nuk do të analizojmë aspekte të tjera të "pajtueshmërisë me Kushtetutën dhe ligjin" të Vendimit të kontestuar.

44. Është e rëndësishme të theksohet, se Shumica (paragrafi 110 i Aktgjykimit) ka konstatuar se një "*vendim për rritjen e pagave*" nuk përbën çështje të nivelit kushtetues. Ne, me respekt, nuk pajtohemi.

45. Siç është theksuar më lart, thelbi i çështjes para Gjykatës nuk është nëse një vendim Qeverisë për "*rritje pagash*" është në përputhshmëri me Kushtetutën; por nëse një vendim i Qeverisë pa "autorizim në ligj" ose që nuk "zbaton një ligj", si në rrethanat e rastit konkret, është në përputhshmëri me Kushtetutën.

46. Për më tepër, siç është elaboruar më lart, nenet 4.4, 92 dhe 93 të Kushtetutës e kufizojnë kompetencën e Qeverisë në ushtrimin e pushtetit ekzekutiv në "pajtueshmërinë me Kushtetutën dhe ligjin"; në "zbatim të ligjit"; dhe në marrjen e vendimeve "të nevojshme për zbatimin e ligjeve".

47. Gjithashtu, detyrimi për të zbatuar "Kushtetutën dhe ligjin" është premisa më thelbësore e parimit të sundimit të ligjit të mishëruar në nenet 3 [Barazia para Ligjit] dhe 7 [Vlerat] të Kushtetutës.

---

[19] Ligji për Buxhetin 2018 (Neni 15) dhe Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe amendamentimet përkatëse, përcaktojnë proceset për implementimin e buxhetit, duke përcaktuar qartë autorizimet por edhe kufizimet e Qeverisë në rregullimin e ndarjeve buxhetore të organizatës buxhetore dhe rrethanat në kuadër të të cilave kërkohet autorizimi/miratimi i Kuvendit (Neni 30).

48. Në këtë drejtim, Komisioni i Venecias në Listën e Kontrollit të Sundimit të Ligjit për vitin 2016[20] numëron "Pajtueshmërinë me Ligjin" dhe "Detyrimin për Zbatimin e Ligjit" si dy parime themelore të sundimit të ligjit. Sa i përket të parit, Komisioni i Venecias pohon se: "*Një kërkesë themelore e sundimit të ligjit është që kompetencat e autoriteteve publike të jenë të përcaktuara me ligj. Përderisa ligjshmëria adreson veprimet e zyrtarëve publikë, gjithashtu kërkon që ata të kenë autorizim për të vepruar dhe që më pas të veprojnë brenda kufijve të kompetencave që u janë dhënë atyre dhe si rrjedhojë të respektojnë të drejtën procedurale dhe materiale.*"[21] Ndërsa sa i përket të dytit, Komisioni i Venecias vlerëson se: "*Esenca e sundimit të ligjit do të vihet në pikëpyetje nëse ligji ishte shfaqur vetëm në letër, por nuk ishte aplikuar dhe zbatuar siç duhet. Detyra për të zbatuar ligjin është e trefishtë, pasi ajo nënkupton bindjen ndaj ligjit nga individët, detyrën për të zbatuar ligjin në mënyrë të arsyeshme nga Shteti dhe detyrën e zyrtarëve publikë për të vepruar brenda kufijve të kompetencave të tyre të dhëna*".[22]

Përputhshmëria me nenet 65 dhe 4 të Kushtetutës

49. Pasi konstatuam se Vendimi i kontestuar nuk është në përputhje me nenet 92 dhe 93 të Kushtetutës, ne konsiderojmë se Vendimi i kontestuar gjithashtu cenon kompetencat e Kuvendit për "miratim" të buxhetit, siç është përcaktuar në nenin 65.5 të Kushtetutës.

50. Neni 93.5 i Kushtetutës e autorizon Qeverinë t'ia propozojë buxhetin Kuvendit. Nga ana tjetër, neni 65.5 i Kushtetutës i jep Kuvendit kompetencën për ta miratuar atë. Në lidhje me këtë, ne pajtohemi me arsyetimin e Shumicës (paragrafët 105 dhe 106), ku pohohet se "*Më 22 dhjetor 2017, Kuvendi miratoi Ligjin nr. 06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, duke ushtruar kështu funksionin e tij kushtetues për sa i përket miratimit të buxhetit shtetëror*" dhe "*Qeveria ka qenë propozues i Projektbuxhetit për vitin 2018, i cili është miratuar nga Kuvendi*". Kjo qëndron. Megjithatë, këto konkluzione i përkasin përputhshmërisë me Kushtetutën të Ligjit të Buxhetit 2018, i cili nuk kontestohet para Gjykatës. Çështja është nëse, me nxjerrjen e Vendimit të kontestuar, Qeveria cenoi kompetencën e Kuvendit për ta "miratuar" buxhetin e propozuar për vitin 2018.

---

[20] Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias), Lista e Kontrollit të Sundimit të Ligjit, Miratuar nga Komisioni i Venecias në Sesionin e 106-të Plenar (Venecia, 11-12 Mars 2016).

[21] Lista e Kontrollit të Sundimit të Ligjit të Komisionit të Venecias, paragrafi 45.

[22] Lista e Kontrollit të Sundimit të Ligjit të Komisionit të Venecias, paragrafi 53.

51. Në këtë drejtim, duhet të theksohet se kompetenca e Kuvendit për të "miratuar", nuk përfshin vetëm aktin e "miratimit", por edhe procesin. Procesi i miratimit të buxhetit të propozuar të Qeverisë fillon me dorëzimin e buxhetit të propozuar të Qeverisë në Kuvend. Kuvendi shqyrtoi dhe miratoi buxhetin e 31 tetorit 2017 të propozuar nga Qeveria. Implikimet financiare të Vendimit të kontestuar, të nxjerrë dy ditë para miratimit të Ligjit për Buxhetin e vitit 2018 nga Kuvendi, nuk i janë nënshtruar as shqyrtimit dhe as miratimit parlamentar. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në lidhje me efektet që Vendimi i kontestuar ka në pushtetin e gjyqësorit.

52. Siç është cekur më lart, përderisa Vendimi i kontestuar në mënyrë specifike ka numëruar zyrtarët qeveritarë të cilët përfitojnë nga "rritja" e pagave, i njejti Vendim gjithashtu "rritë" pagat e të gjithë gjyqtarëve, prokurorëve dhe gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, sipas proporcioneve të përcaktuara në nenin 29 të Ligjit për Gjykatat, nenin 21 të Ligjit për Prokurorin e Shtetit dhe nenin 15 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese. Prandaj, pagat e një pushteti të veçantë dhe të pavarur të qeverisjes, janë prekur ndjeshëm nëpërmjet një vendimi të pushtetit ekzekutivit, pa pjesëmarrjen e pushtetit legjislativ.

53. Një vendim i njëanshëm i Qeverisë, që nuk i nënshtrohet kontrollit parlamentar e që ka ndikim në një degë të tërë të pavarur të qeverisjes, ndikon në parimin e ndarjes së pushteteve si dhe kontrollit e balancimit në mes tyre.

54. Në këtë drejtim, rikujtojmë se neni 4 i Kushtetutës përcakton: *"Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë."* Parimi i ndarjes së pushteteve është parimi më thelbësor në përcaktimin e formës së qeverisjes dhe marrëdhënieve midis tri pushteteve të saj të qeverisjes. Ai nënkupton që të tri pushtetet e qeverisjes duhet të jenë të pavarura në ushtrimin e funksioneve të tyre kushtetuese dhe gjithashtu duhet të kufizojnë dhe balancojnë pushtetet dhe kompetencat e njëra tjetrës.

55. Në definimin e ndarjes së pushteteve, Kushtetuta në mënyrë specifike i jep Kuvendit autoritetin për të ushtruar pushtetin legjislativ (neni 4.2); Qeverisë përgjegjësinë për "zbatimin e ligjeve" dhe politikave shtetërore (neni 4.4); dhe në mënyrë specifike i referohet pavarësisë së degës së gjyqësorit si dhe pavarësisë së Gjykatës Kushtetuese (nenet 4.5 dhe 4.6, respektivisht). Në definimin e kontrollit dhe balancimeve, ky nen i Kushtetutës, në mënyrë specifike e vendos ushtrimin e

funksionit ekzekutiv nga ana e Qeverisë nën kontrollin parlamentar (neni 4.4).

56. Duhet gjithashtu të theksohet se përderisa parimi i ndarjes së pushtetit përcakton pavarësinë e tri pushteteve të qeverisjes, parimi i kontrolleve dhe balancimeve përcakton ndërvarësinë e tyre. Të tri pushtetet e qeverisjes nuk mund të veprojnë në izolim prej njëra-tjetrës. Ndërvarësia e tyre, përpos dispozitave kushtetuese, gjithashtu definohet nëpërmjet parimeve të bashkëpunimit, bashkërendimit, kontrollimit dhe balancimit. Të tri pushtetet e qeverisjes mbështeten në njëra tjetrën për të siguruar totalin e shërbimeve publike të nevojshme në një shoqëri demokratike.[23]

57. Në këtë drejtim, rikujtojmë një interpretim të Gjykatës Kushtetuese të Sllovenisë, ku theksohet se: "*Ndarja e pushtetit shtetëror në degët e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor nuk nënkupton një lidhje superioriteti ose nënshtrimi, por një lidhje e kufizimit dhe bashkëpunimit të degëve të barabarta të pushtetit, ashtu që secila funksionon brenda kornizave të pozitës së vet dhe kompetencës së vet. Një pikënisje e rregullimit të mekanizmave të kontrollit dhe balancimit midis degëve të pushtetit duhet të jetë barazia kushtetuese e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Marrëdhëniet mes tyre duhet të vendosen në një mënyrë të tillë që të mos rrezikohet pavarësia relative dhe integriteti i një dege individuale të pushtetit në kryerjen e funksionit të saj*".[24] Gjykata Kushtetuese e Sllovenisë shkon më tutje: "*Kuptimi bashkëkohor i parimit të ndarjes së pushtetit nënkupton që autoritetet që kryejnë funksione themelore të pushtetit shtetëror janë relativisht të pavarura dhe autonome në funksionimin e tyre në raport me autoritetet e tjera ashtu që asnjëri prej tyre nuk mbizotëron. Ekziston një sistem i sofistikuar i mbikëqyrjes së ndërsjellë, kufizimeve, kontrollit, varësisë së ndërthurur dhe balancit*".[25]

58. Ne vërejmë që aspektet e kompensimit financiar[26] që afektojnë pushtetin e gjyqësorit, në mes tjerash, kryesojnë në listën e masave

[23] Shih, në mes tjerash, Këshilli i Evropës, Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve të Evropës (CCJE) Opinioni Nr. 18 (2015), "Pozita e gjyqësorit dhe marrëdhënia e tij me pushtetet e tjera të shtetit në një demokraci moderne", i datës 16 tetor 2015.

[24] Gjykata Kushtetuese e Republikës së Sllovenisë, Vendimi U-I-159/08, i 11 dhjetorit 2009, paragrafi 24.

[25] Gjykata Kushtetuese e Republikës së Sllovenisë, Vendimi U-I-159/08 i 11 dhjetorit 2009, paragrafi 23.

[26] Cështjet që ndërlidhen me kompenzimin finaciar mund të përfshiejnë rritje, zbritje, apo aspekte tjera që kanë të bëjnë me kompenzimin financiar të pushtetit gjyqësor.

mbrojtëse që sigurojnë pavarësinë dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.[27] Duke marrë parasysh që pavarësia e pushtetit gjyqësor është e mishëruar në Kushtetutë, një diskutim lidhur me kompensimin financiar për degën e gjyqësorit, nuk mund të anashkalojë parimin e ndarjes së pushteteve. Gjykatat e tjera Kushtetuese kanë vlerësuar kushtetutshmërinë e vendimeve dhe rregulloreve të qeverisë, madje edhe ligjeve të Kuvendit, që kanë pasur ndikim në aspektet e kompensimit në pushtetin e gjyqësorit dhe kanë arritur në përfundime esencialisht të ngjashme.[28]

59. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kroacisë shpalli jokushtetuese një dispozitë të një ligji të miratuar nga Kuvendi, që autorizonte në mënyrë specifike Qeverinë të marrë vendime për llogaritjen e pagave të gjyqtarëve.[29] Gjykata Kushtetuese e Kroacisë theksoi se: "*duket se ligjvënësi, në pjesën që ka të bëjë me përcaktimin e bazës për llogaritjen e pagave të gjyqësorit, ka lënë pas dore postulatet themelore që rrjedhin nga parimi i ndarjes së pushtetit, veç e veç dhe së bashku me kërkesën kushtetuese të pavarësisë së gjyqësorit në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet gjyqësorit dhe ekzekutivit politik*". Gjykata Kroate shkoi më tutje*: "Për t'i dhënë ekzekutivit politik (Qeverisë) kompetencën për të ndikuar drejtpërdrejt në përcaktimin e pagave të gjyqësorit nënkupton a priori se marrëdhëniet ndërmjet këtyre dy degëve të pushtetit shtetëror (pushtetit ekzekutiv, që është ekzekutivi politik dhe pushtetit gjyqësor) bazohen në themele të cilat janë objektivisht të papranueshme në një shoqëri demokratike të bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe sundimit të ligjit, të gjitha në dritën e kërkesës kushtetuese që gjyqësori duhet të jetë i pavarur*". Gjykata Kushtetuese Kroate arriti në përfundimin se: "*Rrjedhimisht, një kusht rrjedh nga Kushtetuta që të gjitha elementet e pagave të gjyqësorit duhet të rregullohen nga ligjvënësi në ligjin e saj të miratuar në një procedurë parlamentare demokratike në një mënyrë që respekton thelbin e garancisë për stabilitetin e zyrës*

[27] Këshilli i Evropës, Karta Europiane për Statutin e Gjyqtarëve dhe Memorandumi Shpjegues, Strasburg, 8-10 korrik 1998.

[28] Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kroacisë, me Vendimin Nr. U-I-4039/2009; U-I-25427/2009; U-I-195/2010 të 18 korrikut 2014; Gjykata Kushtetuese e Lituanisë, rasti nr. 3/95, i 6 dhjetorit 1995, pohon se një Rezolutë e Qeverisë që ndikon në pagat e një numri të zyrtarëve të lartë gjyqësor ishte në kundërshtim me Kushtetutën e Lituanisë. Një qëndrim i ngjashëm u mbajt nga Gjykata Kushtetuese e Letonisë, përmes Vendimit nr. 2016-31-01 të 26 tetorit 2017; Gjykata Kushtetuese e Sllovenisë me Vendimet U-I-159/08 të 11 dhjetorit 2009 dhe Vendimit U-I-15/14 të 26 marsit 2015; dhe Gjykata Kushtetuese e Moldavisë përmes Aktgjykimit nr. 15/2017.

[29] Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kroacisë, përmes Vendimit nr.U-I-4039/2009; U-I-25427/2009; U-I-195/2010 të 18 korrikut 2014, 9.1, paragrafi 5.

gjyqësore, që është e duhur, e kualifikuar dhe e paanshme në administrimin e drejtësisë, ku të gjitha elementet e pagave të gjyqësorit duhet të jenë në përpjesëtim me dinjitetin e profesionit të gjyqtarit dhe me barrën e përgjegjësisë së tij apo saj".

60. Për më tepër, komentet kryesore të pranuara nga Forumi i Komisionit të Venecias (paragrafët 62 deri 73 të Aktgjykimit) shkojnë në drejtim të theksimit që "*çështja e pagave në sektorin publik rregullohet me ligje"* (paragrafi 99 i Aktgjykimit). Ligjet përkatëse nënkupton të miratuara nga Kuvendet; jo nga Qeveritë. Eshtë detyrim i Qeverisë të zbatoj këto ligje. Më tutje, kompensimi financiar për pushtetin e gjyqësorit, si një aspekt esencial i pavarësisë së gjyqësorit, duhet të rregullohet nga ana e pushtetit legjislativ përmes një procedure demokratike parlamentare. Në kundërshtim me këto parime, Vendimi i kontestuar afekton pushtetin gjyqësorit, duke anashkaluar kontrollin parlamentar.

61. Prandaj, dhe pa trajtuar pretendimet e tjera dhe/ose aspektet e tjera të ngritura në Kërkesë, në rrethanat e rastit konkret, Vendimi i kontestuar nuk është nxjerrë në pajtim me nenet 92 dhe 93 të Kushtetutës, duke cenuar kështu kompetencat e Kuvendit të përcaktuara në nenin 65.5 të Kushtetutës, dhe si rezultat duke ndikuar në ekuilibrin dhe ndarjen e pushteteve të përcaktuar me nenin 4 të Kushtetutës.

62. Në fund, pa adresuar secilin paragraf në arsyetimin e Shumicës, ne do të theksojmë në mënyrë specifike mospajtimin me përfundimet e Aktgjykimit.

63. Ne nuk pajtohemi me përfundimin e Shumicës (paragrafi 117 i Aktgjykimit), që konstaton se "*nuk është brenda fushëveprimit të saj që të vlerësojë apo të zëvendësojë politikat publike të përcaktuara nga organi legjislativ apo ekzekutiv*", sepse kjo nuk është çështja para Gjykatës.

64. Ne gjithashtu nuk pajtohemi me përfundimin e Shumicës (paragrafi 118 i Aktgjykimit) që konstaton se rrethanat e rastit paraqesin "*situata të paqarta për sa i përket ushtrimit të kompetencave*" dhe se situatat e tilla "*në të ardhmen mund të shmangen me nxjerrje të ligjeve përkatëse për Qeverinë dhe për pagat e funksionarëve shtetëror*". Ne kemi pohuar se, në rrethanat e rastit konkret, situata nuk është e paqartë dhe se Kushtetuta nuk autorizon Qeverinë të veprojë jashtë kompetencave të saj për të vepruar në "pajtim me Kushtetutën dhe ligjin"; për të "zbatuar ligjet"; ose për të "propozuar ligjet".

65. Në fund dhe prandaj, për arsyet e shprehura në këtë Mendim, ne nuk pajtohemi me përfundimin e Shumicës (paragrafi 119 i Aktgjykimit), i cili pohon se "*nuk është vërtetuar se Vendimi i kontestuar ka prodhuar efekte kushtetuese, në kuptim të cenimit të kompetencave kushtetuese të Kuvendit, apo shkelje të ndonjë dispozite kushtetuese*".

Përfundime

66. Ne konkludojmë se Vendimi nr. 04/20 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, i 20 dhjetorit 2017, nuk është në përputhje me nenet 92 dhe 93 të Kushtetutës, sepse as nuk "zbaton një ligj" dhe as nuk është një "propozim".

67. Më tutje ne konkludojmë se rrjedhimisht Vendimi nr. 04/20 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, i 20 dhjetorit 2017, cenon kompetencat e Kuvendit të përcaktuara në nenin 65.5 të Kushtetutës, duke afektuar kështu balancimin dhe ndarjen e pushteteve të përcaktuar me nenin 4 të Kushtetutës.

Dorëzuan me respekt,

Gjyqtari Almiro Rodrigues **Gjyqtarja Gresa Caka-Nimani**

Rastet nr. KI146/17, KI147/17, KI148/17, KI149/17 dhe KI150/17, Parashtrues: Isni Thaçi, Zeqir Demaku, Fadil Demaku, Nexhat Demaku, dhe Jahir Demaku, vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës PML. KZZ. nr. 322/2016 të 19 korrikut 2017

KI146/17, KI147/17, KI148/17, KI149/17 dhe KI150/17, Aktgjykim i 30 majit 2018, publikuar më 8 qershor 2018

Fjalët kyç: *kërkesë individuale, akuzë penale, përbërja e trupit gjykues, e drejta për gjykim të drejtë - e drejta për vendim të arsyetuar*

Parashtruesit e kërkesës u shpallën fajtorë nga Gjykata Themelore në Mitrovicë (Aktgjykimi P58/14) për kryerjen e veprave penale të sanksionuara me nenin 152 [Krimet e Luftës në shkelje të rëndë të nenit 3 të Përbashkët me Konventat e Gjenevës] në lidhje me nenin 31 [Bashkëkryerja] të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK). Parashtruesit parashtruan ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore duke kontestuar, ndër të tjera, përbërjen e trupit gjykues të Gjykatës Themelore dhe dëshmitë e dëshmitarëve ekspertë. Gjykata e Apelit, (Aktgjykimi PAKR nr. 456/15), i refuzoi ankesat e palëve dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Parashtruesit e kërkesës parashtruan kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë - kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit - në Gjykatën Supreme të Kosovës, duke pretenduar, ndër të tjera, se trupi gjykues i Gjykatës Themelore ishte përbërë në kundërshtim me rregullat e aplikueshme për caktimin e gjyqtarëve në trupat gjykues.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë u refuzua nga Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit Pml. KZZ. nr. 322/2016, si e pabazuar. Gjykata Supreme arsyetoi vendimin e saj lidhur me pretendimet e parashtruesve për shkelje të rregullave për caktimin e gjyqtarëve në trupat gjykues, duke theksuar se, bazuar në Udhëzimin e EULEX-it, kryetari i gjyqtarëve të EULEX-it ka liri të plotë për t'i caktuar gjyqtarët në kolegje, pavarësisht ndonjë rregulli të veçantë të përmbajtur në Udhëzim. Gjykata Supreme, vlerësoi se edhe nëse ka pasur shkelje të rregullores së brendshme të EULEX-it atëherë do të ishte çështje e diskrecionit brenda autoriteteve administrative/disiplinore të EULEX-it.

Parashtruesit e kërkesës pretenduan në Gjykatën Kushtetuese, se duke refuzuar kërkesën e tyre për mbrojtjen e ligjshmërisë si të pabazuar, Gjykata Supreme kishte shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në këtë drejtim, ata pretenduan se Gjykata Supreme nuk e trajtoi siç duhet

çështjen e caktimit të gjyqtarëve në trupin gjykues të Gjykatës Themelore, sepse ai ishte bërë në kundërshtim me rregullat për caktimin e gjyqtarëve në trupat gjykues.

Në trajtimin e pretendimeve të parashtruesve të kërkesës në lidhje me përbërjen e trupit gjykues të Gjykatës Themelore, Gjykata Kushtetuese vërejti se sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut, e drejta për një gjykim të drejtë përfshin të drejtën për një vendim të arsyetuar. Lidhur me këtë, Gjykata Kushtetuese vlerësoi se arsyetimi i Gjykatës Supreme, gjatë shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesve në lidhje me caktimin e gjyqtarëve në trupin gjykues të Gjykatës Themelore, kryesisht ishte i kufizuar në shkelje të mundshme të KPP-së dhe nuk ka marrë parasysh normat e tjera relevante të aplikueshme për caktimin e gjyqtarëve në trupat gjykues, përkatësisht parimet e parapara me Ligjin nr. 03/l-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë dhe të legjislacionit që rrjedh prej tij. Gjykata Kushtetuese gjithashtu vlerësoi se, sipas praktikës së saj gjyqësore, të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë edhe gjyqtarët e EULEX-it, kanë obligim të zbatojnë ligjet e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe rrjedhimisht, legjislacionin që rrjedh prej tij.

Prandaj, Gjykata Kushtetuese konstatoi se duke mos dhënë një vlerësim dhe justifikim të plotë lidhur me atë se a është zbatuar e tërë korniza e dispozitave të zbatueshme ligjore, duke përfshi edhe parimin e kritereve objektive të paracaktuara dhe të masave siguruese procedurale, në lidhje me caktimin e gjyqtarëve në trupin gjykues në rastin e parashtruesve të kërkesës në Gjykatën Themelore, Gjykata Supreme (Aktgjykimi PML. KZZ. nr. 322/2016 i 19 korrikut 2017), kishte shkelur të drejtën e parashtruesve të kërkesës për një vendim të arsyetuar, dhe me këtë kishte shkelur të drejtën e parashtruesve të kërkesës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

Prandaj, në pajtim me rregullin 74 (1) të Rregullores së punës, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme PML. KZZ. nr. 322/2016 i 19 korrikut 2017, shpallet i pavlefshëm dhe çështja i kthehet Gjykatës Supreme për rishqyrtim.

Aktgjykim

në

rastet nr. KI146/17, KI147/17, KI148/17, KI149/17 dhe KI150/17

Parashtrues

Isni Thaçi, Zeqir Demaku, Fadil Demaku, Nexhat Demaku, dhe Jahir Demaku

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. KZZ. nr. 322/2016, të 19 korrikut 2017

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa KI146/17 është dorëzuar nga Isni Thaçi nga Prishtina, i përfaqësuar nga Artan Qerkini, Shoqëria e Avokatëve "Sejdiu & Qerkini" Sh.p.k; Kërkesa KI147/17 është dorëzuar nga Zeqir Demaku nga Gllogoci, i përfaqësuar nga Bajram Tmava, avokat nga Prishtina; Kërkesa KI148/17 është dorëzuar nga Fadil Demaku nga Gllogoci; Kërkesa KI149/17 është dorëzuar nga Nexhat Demaku nga Gllogoci; dhe Kërkesa KI150/17 është dorëzuar nga Jahir Demaku nga Gllogoci, i përfaqësuar nga Mexhid Syla, avokat nga Prishtina (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. KZZ. nr. 322/2016 (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme) të 19 korrikut 2017.

3. Parashtruesit Isni Thaçi (KI146/17), Zeqir Demaku (KI147/17) dhe Jahir Demaku (KI150/17), aktgjykimin e kontestuar e kishin pranuar më 22 gusht 2017, ndërsa parashtruesit Fadil Demaku (KI148/17) dhe Nexhat Demaku (KI149/17), aktgjykimin e kontestuar e kishin pranuar më 19 gusht 2017.

Objekti i çështjes

4. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat e parashtruesve të kërkesës të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

5. Parashtruesi i kërkesës Jahir Demaku (KI150/17), gjithashtu kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) që të vendosë masë të përkohshme, përkatësisht *"të pezulloj ekzekutimin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme"* Pml. KZZ. nr. 322/2016, të 19 korrikut 2017.

Baza juridike

6. Kërkesat bazohen në paragrafin 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] 27 [Masat e Përkohshme] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 29 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 8 dhjetor 2017, parashtruesi i kërkesës Isni Thaçi e dorëzoi kërkesën (KI146/17) në Gjykatë.

8. Më 11 dhjetor 2017, parashtruesit e kërkesës Zeqir Demaku (KI147/17), Fadil Demaku (KI148/17), dhe Nexhat Demaku (KI149/17) dorëzuan kërkesat në Gjykatë.

9. Më 12 dhjetor 2017, parashtruesi i kërkesës Jahir Demaku (KI150/17) dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

10. Më 15 dhjetor 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese në lidhje me kërkesën KI146/17 dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Bekim Sejdiu dhe Gresa Caka-Nimani.

11. Të njëjtën ditë, në pajtim me rregullin 37 (1) të Rregullores së punës, Kryetarja e Gjykatës urdhëroi bashkimin e kërkesave KI147/17, KI148/17, KI149/17 dhe KI150/17, me kërkesën KI146/17. Me këtë urdhër, u vendos që gjyqtarja raportuese dhe përbërja e Kolegjit shqyrtues të jetë e njëjtë me atë që ishte vendosur nga Kryetarja për caktimin e gjyqtarit raportues dhe Kolegjit shqyrtues në rastin KI146/17.

12. Më 19 dhjetor 2017, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin dhe bashkimin e kërkesave dhe kërkoi nga përfaqësuesit e parashtruesve Zeqir Demaku (KI147/17) dhe Jahir Demaku (KI150/17), që të dorëzojnë në Gjykatë autorizimet për përfaqësimin e parashtruesve të cekur më lart para Gjykatës.

13. Më 20 dhjetor 2017, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesave Gjykatës Supreme dhe dërgoi kërkesë në Gjykatën Themelore në Mitrovicë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore), për të dorëzuar fletëkthesat të cilat dëshmojnë datën kur parashtruesit kishin pranuar vendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme.

14. Më 22 dhjetor 2017, përfaqësuesit e parashtruesve Zeqir Demaku (KI147/17) dhe Jahir Demaku (KI150/17) dorëzuan në Gjykatë autorizimet e kërkuara më 19 dhjetor 2017.

15. Më 5 janar 2018, Gjykata Themelore dorëzoi në Gjykatë fletëkthesat që tregojnë datën kur parashtruesit e kërkesës kishin pranuar vendimin e kontestuar, siç ishte kërkuar nga Gjykata, më 20 dhjetor 2017.

16. Më 22 shkurt 2018, Gjykata kërkoi nga parashtruesit e kërkesës që ta informojnë Gjykatën nëse kanë shfrytëzuar ndonjë mjet tjetër juridik për të kontestuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pml. KZZ. nr. 322/2016.

17. Më 26 shkurt 2018, parashtruesit e kërkesës Isni Thaçi, Fadil Demaku dhe Nexhat Demaku e njoftuan Gjykatën se ata kanë parashtruar kërkesa për rishikimin e procedurës penale në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, P. nr. 58/14 dhe i kanë bashkëngjitur kërkesat e mësipërme.

18. Më 28 shkurt 2018, parashtruesi i kërkesës Jahir Demaku njoftoi Gjykatën se përveç kërkesës në Gjykatë, asnjë mjet tjetër juridik nuk është shfrytëzuar për të kontestuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pml. KZZ. nr. 322/2016.

19. Më 6 mars 2018, Gjykata kërkoi nga EULEX-i që të paraqesë në Gjykatë modalitetet/rregullat/udhëzimet për ndarjen e lëndëve gjyqtarëve të EULEX-it (në tekstin e mëtejmë, Udhëzimin e EULEX-it për Ndarjen e Lëndëve) të nxjerra në pajtim me Ligjin nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, të 3 qershorit 2008.

20. Më 14 mars 2018, parashtruesit e kërkesës Isni Thaçi, Fadil Demaku dhe Nexhat Demaku, njoftuan Gjykatën se kërkesat për Rishqyrtimin e Procedurës Penale në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, P. nr. 58/14 u refuzuan nga Gjykata Themelore. Ata gjithashtu e informuan Gjykatën se nuk kanë për qëllim që të ankohen ndaj këtij vendimi.

21. Më 26 mars 2018, EULEX-i dërgoi në Gjykatë Udhëzimin e EULEX-it për Caktimin e Lëndëve.

22. Më 30 maj 2018, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues me shumicë i propozoi Gjykatës në përbërje të plotë pranueshmërinë e kërkesës dhe vlerësimin e substancës së kërkesës.

23. Të njëjtën ditë, Gjykata aprovoi me shumicë pranueshmërinë e kërkesës. Gjyqtarët Almiro Rodrigues dhe Snezhana Botusharova votuan kundër pranueshmërisë.

24. Në të njëjtën ditë, Gjykata votoi me shumicë për të gjetur shkelje. Gjyqtarja Gresa Caka-Nimani ka mendim konkurrues. Gjyqtarët Almiro Rodrigues dhe Snezhana Botusharova votuan kundër gjetjes së shkeljes

25. Aktgjykimi mund të plotësohet me mendime mospajtuese dhe konkurruese.

Përmbledhja e fakteve

26. Më 8 nëntor 2013, Prokurori i EULEX-it nga Zyra e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (Prokurori i PSRK-së) ngriti

Aktakuzën (Nr. PPS88/11) kundër parashtruesve të kërkesës dhe disa personave të tjerë me dyshimin e bazuar se parashtruesit gjatë vitit 1998 kishin kryer veprën penale të sanksionuar me nenin 152 [Krimet e luftës në shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët të konventave të Gjenevës] në lidhje me nenin 31 [Bashkëkryerja] të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

27. Më 27 maj 2015, Gjykata Themelore nxori Aktgjykimin (P58/14), me të cilin shpalli fajtor parashtruesit e kërkesës për veprat penale të cekura më lart dhe i dënoi ata si në vijim: Isni Thaçin, Zeqir Demakun dhe Jahir Demakun, secilin me nga 7 (shtatë) vjet burgim, ndërsa Fadil Demakun dhe Nexhat Demakun me nga 3 (tre) vjet burgim secilin.

28. Parashtruesit e kërkesës parashtruan ankesë ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Themelore (P58/14) të 27 majit 2015, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, konstatimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe vendimit mbi sanksionin penal. Parashtruesit kontestuan, ndër të tjera, përbërjen e trupit gjykues të Gjykatës Themelore dhe dëshmitë e dëshmitarëve ekspertë C. B. dhe M. G., konkretisht mosparaqitjen për të dëshmuar në Gjykatë të ekspertit M. G.

29. Ankesë parashtroi edhe Prokurori i PSRK-së, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, duke kërkuar që të rritet dënimi në mënyrë adekuate për të gjithë parashtruesit e kërkesës.

30. Më 14 shtator 2016, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit (PAKR. nr. 456/15), refuzoi ankesat e Prokurorit të PSRK-së dhe parashtruesve të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore (P58/14). Gjykata e Apelit *ex-officio* ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore sa i përket parashtruesve të kërkesës Isni Thaçi, Zeqir Demaku dhe Jahir Demaku, duke konsideruar veprën penale për të cilën ishin dënuar si vepër penale në vazhdim. Gjithashtu, Gjykata e Apelit ndryshoi dënimet e caktuara nga Gjykata Themelore në lidhje me Isni Thaçin nga 7 (shtatë) vjet, në 6 (gjashtë) vjet e 6 (gjashtë) muaj, ndërsa për parashtruesit e kërkesës Zeqir Demaku dhe Jahir Demaku nga 7 (shtatë) vjet në 6 (gjashtë) vjet secilit.

31. Lidhur me dëshminë e ekspertëve, Gjykata e Apelit arsyetoi, *inter alia*, se dëshmia e ekspertit C. B. në Gjykatën Themelore është në tërësi e besueshme në lidhje me lëndimet e dëshmitarit A. Sa i përket pretendimeve se eksperti M. G. nuk ka dhënë dëshmi pranë Gjykatës Themelore, Gjykata e Apelit vërejti se ai ishte i përfshirë si ekspert vetëm për të kryer ekzaminimin e pjesëve intime të dëshmitarit nga një person i gjinisë së njëjtë, dhe se pas ekzaminimit ai i përshkroi

observimet e tij përfshirë edhe fotografitë, ndërkaq vlerësimin e tyre e ka bërë ekspertja C. B.

32. Po ashtu në lidhje me pretendimin se gjykatat e rregullta kishin pranuar dëshmitë e dëshmitarëve A. dhe K. në kundërshtim me parimin *in dubio pro reo*, Gjykata e Apelit kishte arsyetuar se tek dëshmitari A. nuk ishin vërejtur simptome të ndonjë sëmundje mentale dhe rrjedhimisht nuk kishte dyshime mbi dëshminë e tij. Sipas Gjykatës së Apelit, paraqitja unike e psikozës akute nuk e ulë besueshmërinë e përgjithshme të dëshmitarit A. Për më tepër, Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se deklarata e dëshmitarit A. është përkrahur plotësisht nga ajo e dëshmitarit K. si dhe dëshmia e ekspertit C. B.

33. Parashtruesit e kërkesës parashtruan kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore (P58/14) dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit (PAKR nr. 456/15), për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve të ligjit penal. Parashtruesit pretenduan, ndër të tjera, se përbërja e trupit gjykues të Gjykatës Themelore ishte në kundërshtim me rregullat e EULEX-it; dy anëtarë të trupit gjykues kishin konflikt të interesit, rrjedhimisht nga kjo parashtruesit propozuan që të merren prova të reja - dëshmia nga dëshmitari M. S.; dëshmitë e dëshmitarëve ekspertë C. B. dhe M. G., nuk u morën në mënyrën e duhur, konkretisht duke theksuar mosparaqitjen në Gjykatë të ekspertit M. G.; dhe, shpallja e dëshmitarit B. si "dëshmitar armiqësor" ishte në kundërshtim me Kodin e Procedurës Penale (në tekstin e mëtejmë: KPP).

34. Më 19 korrik 2017, Gjykata Supreme nëpërmjet Aktgjykimit (Pml. KZZ. nr. 322/2016) refuzoi si të pabazuara kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtrueseve të kërkesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit.

35. Nën një, lidhur me kundërshtimet e parashtruesve për zbatimin e rregullave për përzgjedhjen e trupit gjykues në Gjykatën Themelore, Gjykata Supreme arsyetoi si më poshtë:

> *"[...]*
> *Kolegji pajtohet me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit se nuk ka pasur ndonjë skemë për caktimin e gjyqtarëve të EULEX-it në kohën relevante. Sipas udhëzimit për caktimin e rasteve tek gjyqtarët e EULEX-it në rastet penale nëpër gjykatat e qarqeve, e cila ka qenë e zbatueshme në kohën kur gjyqtarja [A. A. G], u*

caktua në rast, nuk është mbështetur ndonjë orar specifik. Udhëzimi thjesht shpjegon strukturën e gjyqtarëve të EULEX-it në gjykata të qarqeve dhe i përshkruan parimet e përgjithshme të cilat zbatohen lidhur me caktimin e rastit. Po ashtu, gjyqtarja [A. A. G] u caktua në rast sipas vendimit të 29 majit 2014 të ushtruesit të detyrës së kryetarit të gjyqtarëve të EULEX-it, i cili aso kohe ka qenë i autorizuar për ta marrë këtë vendim. Përveç kësaj , gjyqtarja e EULEX-it [A. A. G] në atë kohë ka qenë e caktuar ligjërisht në nivelin e shkallës së parë.
[...]
Prandaj, Kolegji është i mendimit se caktimi i gjyqtares [A. A. G] nuk mund të cilësohet si shkelje e nenit 384 (1.1) ose e nenit 384 (1.2) e KPP-së. Kolegji vëren se edhe sikur të ketë pasur shkelje të rregullores së brendshme të EULEX-it (përderisa shkeljet e pretenduara nuk përbëjnë shkelje të ligjit përkatës - sikurse është kërkesa në fjalë se KPP-ja është shkelur), atëherë ajo do ishte një çështje e diskrecionit përbrenda autoriteteve disiplinore/administrative të EULEX-it [...]".

36. Nën dy, Gjykata Supreme arsyetoi vendimin e saj në lidhje me kërkesën për prova të reja për të dëshmuar konfliktin e interesit ndërmjet gjyqtarëve të Gjykatës Themelore dhe për çështjen e dëshmisë së ekspertit M. G., ndër të tjera, se "*asnjë prej [...] dispozitave të [Kodit të Procedurës Penale të Kosovës] nuk përfshin ndonjë mundësi procedurale sipas së cilës Gjykata Supreme mund të mbaj një shqyrtim të hapur me palët e pranishme apo të mbaj ndonjë seancë dëgjimore me qëllim të mbledhjes së provave të reja*".

37. Nën tre, sa i përket shpalljes së dëshmitarit B. "dëshmitar armiqësor", Gjykata Supreme vlerësoi se: *[...] Edhe pse KPP nuk njeh si të tillë termin "dëshmitar armiqësor", KPP në nenin 123 (2) parasheh mundësinë e marrjes në pyetje të dëshmitarëve nëse dëshmitari ka dhënë dëshmi që dallon nga dëshmia e dhënë gjatë intervistës në procedurën paraprake, që në esencë paraqet përafrim me konceptin e "dëshmitarit armiqësor".*

38. Më 18 tetor 2017, parashtruesit e kërkesës Fadil Demaku dhe Nexhat Demaku parashtruan kërkesë për rishqyrtimin e procedurës penale në Gjykatën Themelore në Mitrovicë.

39. Më 21 nëntor 2017, parashtruesi i kërkesës Isni Thaçi parashtroi kërkesë për shqyrtimin e procedurës penale në Gjykatën Themelore në Mitrovicë.

40. Parashtruesit e kërkesës Fadil Demaku, Nexhat Demaku dhe Isni Thaçi, në kërkesat e tyre për rishqyrtimin e procedurës penale, kërkuan nga Gjykata Themelore që në pajtim me nenin 423 (1.13) të KPP-së, ndër të tjera, të lejojë marrjen e provave të reja, përkatësisht dëshminë e M. S. dhe korrespondencat me email ndërmjet gjyqtarëve dhe personelit të EULEX-it që do të zbulonte se përbërja e trupit gjykues të Gjykatës Themelore nuk ishte e rregullt dhe që do të dëshmonte se trupi gjykues ishte i njëanshëm.

41. Më 12 shkurt 2018, Gjykata Themelore hodhi poshtë si të pabazuar kërkesën për shqyrtimin e procedurës penale në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, P. nr. 58/14 të parashtruar nga parashtruesit Isni Thaçi, Fadil Demaku dhe Nexhat Demaku. Sa i përket pretendimeve të parashtruesve në lidhje me përbërjen e trupit gjykues, Gjykata Themelore gjeti se ato pretendime *"ishin ngritur edhe në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Supreme"*. Rrjedhimisht, Gjykata Themelore erdhi në përfundim se ato pretendime nuk përbëjnë elemente të reja për qëllime të nenit 423 të KPP për të lejuar rishikimin e procedurës penale.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

42. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkelje të të drejtave individuale të tyre, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

Pretendimet e parashtruesit Isni Thaçi (KI146/17)

43. Parashtruesi Isni Thaçi ankohet fillimisht se *"[Caktimi i [A. A. G.] në trupin gjykues të këtij rasti është bërë në kundërshtim me procedurat, politikat dhe rregullat e përzgjedhjes së trupave gjykues. [...] Sipas listës së aplikueshme, ajo nuk ka qenë gjyqtarja e radhës së EULEX-it e cila është dashur të caktohej për këtë rast. Në kundërshtim me këtë listë, ajo është zgjedhur nga [Kryetari i trupit gjykues D. S.] si anëtare e trupit gjykues, sepse ka qenë e dashura e tij dhe, sepse ai ka dashur që ajo të avanconte në karrierën e saj, duke ia mundësuar që të gjykonte një rast të krimeve të luftës. [A. A. G.] pastaj është ngritur në një gjykatë më të lartë në Kosovë"*.

44. Parashtruesi Isni Thaçi, pretendon se *"Marrëdhënia e këtyre dy gjyqtarëve [D. S.] dhe [A. A. G.] përbënë konflikt interesi për të cilin mbrojtja nuk ka qenë në dijeni"*. Parashtruesi ka kuptuar për këtë konflikt interesi vetëm *"në nëntor të vitit 2016 [kur] mbrojta [e parashtruesit] ka marrë një numër emailash nga punonjësit e*

EULEX-it që pasqyrojnë parregullsitë në formimin e trupit gjykues [dhe] pasqyrojnë njëanshmërinë e këtij trupi. Për këtë arsye […] është kërkuar përmes kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë që kryetari i asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it [M. S.] të dëgjohet në cilësinë e dëshmitarit", por kjo, sipas parashtruesit të kërkesës, nuk është lejuar nga Gjykata.

45. Parashtruesi Isni Thaçi, gjithashtu, potencon se *"[edhe pse pretendimet për parregullsi në formimin e trupit gjykues dhe njëanshmërinë e tij ishin mjaft serioze dhe të dokumentuara me prova materiale, Gjykata Supreme refuzoi të merret me këtë problem sepse sipas saj kjo Gjykatë [Supreme] nuk e ka për detyrë që të mbledh prova në procedurën sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë",* duke shtuar se në bazë të të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, *"si emërimi i gjyqtarëve ashtu dhe formimi i trupave gjykues duhet të bëhen ashtu që të garantojnë pavarësinë e sistemit gjyqësor".*

46. Parashtruesi Isni Thaçi po ashtu pretendon se në rastin e tij është shkelur edhe parimi i barazisë së armëve sepse *"Ekspertët e Forenzikës Mjekësore [C. B.] dhe [M. G.] bashkërisht kishin ekzaminuar dëshmitarin A. në lidhje me lëndimet e pretenduara prej tij. Në [gjykatat e rregullta] ishte dëgjuar vetëm ekspertja [C. B.]. Edhe pse mbrojtja kishte insistuar që të thirret edhe eksperti [M. G.] i cili e kishte përpiluar ekspertizën së bashku me eksperten [C. B.], kërkesa e mbrojtjes kishte hasur në vesh të shurdhër*".

47. Në lidhje me këtë pretendim, parashtruesi i kërkesës Isni Thaçi sqaron se *"deklarata e ekspertit [M. G.] është konsideruar e lexuar në shqyrtimin gjyqësorë pa u plotësuar kushtet ligjore […]. Po ashtu, me këtë veprim është cenuar rëndë edhe neni 341.3 i KPP-së, sepse palës që nuk e ka propozuar ekspertin nuk i është dhënë mundësia që ta bëjë ekzaminimin e tërthortë të ekspertit lidhur me raportin, analizat, arsimimin, përvojën, ose bazën e ekspertizës së tij".*

48. Parashtruesi Isni Thaqi (KI146/17), po ashtu, pretendon se dëshmitari B. është deklaruar "dëshmitar armiqësor" pa bazë ligjore, pasi KPP nuk e njeh institutin e "dëshmitarit armiqësor". Neni 2 i KPP-së përcakton se "*Vetëm gjykata kompetente, e pavarur dhe e paanshme, mund të shqiptojë sanksionin penal kryerësit të veprës penale në procedurë të filluar dhe të zbatuar sipas [KPP]*", ndërsa, *"[nuk është i qëndrueshëm konstatimi i Gjykatës [Supreme] se duhet të lejohet që dëshmitari B. të konsiderohet "dëshmitar armiqësor", duke u mbështetur në nenin 6 të [KEDNJ], sepse [KEDNJ] nuk mbron të*

drejtat e organeve shtetërore, siç është në fakt Prokuroria e Shtetit, por mbron të drejtat e njeriut në raport me organet shtetërore".

Pretendimet e parashtrueseve Zeqir Demaku (KI147/17), Fadil Demaku (148/17) dhe Nexhat Demaku (KI149/17)

49. Parashtruesit e kërkesës Zeqir Demaku, Fadil Demaku dhe Nexhat Demaku pretendojnë se *"Gjykata Supreme fare nuk ka marrë parasysh kërkesën e avokatëve mbrojtës për të marrë në pyetje si dëshmitar gjyqtarin [M. S.] në kuptim të paragrafit 4, të nenit 31 të Kushtetutës lidhur me nenin 6 të KEDNJ-së. [...] GJEDNj përcakton se e drejta për një proces të rregullt ligjor që i garantohet individit përmes nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së përfshinë edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar".* Sipas parashtruesve Zeqir Demaku, Fadil Demaku dhe Nexhat Demaku, arsyetimi kërkon *"shpjegime me arsyetime bindëse dhe të ndërtuara mirë për vendimin e marrë në çdo rast individual i cili duhet të përfshijë që të dyja: kriteret ligjore dhe elementet faktike në mbështetje të vendimit. Gjykata Supreme nuk e ka arsyetuar vendimin e saj dhe kjo përbën një vendim arbitrar që cenon të drejtën e palës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm".*

50. Parashtruesit e kërkesës Zeqir Demaku, Fadil Demaku dhe Nexhat Demaku pretendojnë se Gjykata Supreme, gjithashtu "*ka abuzuar me imunitetin e dëshmitarit duke mos nisur asnjë procedurë për heqjen e imunitetit, sipas kërkesës se vetë [M. S.] për t'u trajtuar si dëshmitar, me të vetmin qëllim të ndriçimit të së vërtetës. Kjo përbën cenim të barazisë së armëve sepse, siç është konstatuar edhe nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavi, imuniteti funksional i një zyrtari shtetëror nuk përfshin edhe imunitet kundër detyrimit për të dëshmuar atë që zyrtari ka parë ose dëgjuar gjatë ushtrimit të funksioneve të tij zyrtare".*

51. Parashtruesit Zeqir Demaku, Fadil Demaku dhe Nexhat Demaku po ashtu potencojnë se *"[...] parimi i paanësisë është cenuar edhe për faktin se përbërja e trupit gjykues ka qenë e atillë që [...] ka pasur dy anëtarë që kanë pasur konflikt të pastër interesi",* duke potencuar më tej se *"Paanësia e një tribunali sipas nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së duhet të përcaktohet sipas një testi subjektiv, pra në bazë të bindjes dhe sjelljes personale të një gjyqtari në një rast të caktuar dhe gjithashtu sipas testit objektiv, pra konstatimit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për ta përjashtuar çdo dyshim legjitim në këtë drejtim".*

52. Ata po ashtu pretendojnë se shkelja e rregullave të brendshme të EULEX-it me rastin e caktimit të gjyqtarëve në trupa gjykuese pa pasur një orar të paracaktuar ndikon drejtpërdrejtë në të drejtat kushtetuese të parashtruesve, konkretisht në të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Ata theksojnë se *"asnjë gjykatë në Evropë, përfshirë GJEDNJ-në, nuk do të lejonte një arbitraritet të tillë – caktimin e gjyqtarëve në kolegje pa pasur një orar për caktime të tilla"*.

53. Parashtruesit Zeqir Demaku, Fadil Demaku dhe Nexhat Demaku në vijim pretendojnë se, "*për shkak të natyrës së shkruar të procedurës, as parashtruesi as avokati nuk kanë mundur të jenë në dijeni rreth konfliktit të interesit, derisa nuk e kanë marrë vendimin e Gjykatës Supreme. Prandaj, nuk mund të konkludohet që është hequr dorë nga e drejta për përcaktimin e të drejtave nga një "tribunal i paanshëm"*.

54. Parashtruesit Zeqir Demaku, Fadil Demaku dhe Nexhat Demaku pretendojnë se, "[...] *korrespondenca që është zbuluar në mes të zyrtarëve të EULEX-it, e transmetuar edhe në RTK në disa emisione, shihet se qoftë [KPP], qoftë [KPRK] është shkelë në dëm të [parashtruesve të kërkesës]. Kjo korrespondencë përfshinë edhe fjalë ofenduese si "shqiptarët janë kafshë-albanians are animals". Përveç kësaj përmbajtja e postës elektronike nxjerr edhe dy [thënie të kryetarit të trupit gjykues]: "Poqëse do ta gjykoj rastin Drenica edhe të njëjtit do t'i shpalli fajtor dhe do ta kem mundësinë që në Organet e Bashkimit Evropian të gjejë punë të mirë",* apo edhe thënia *"Nëse gjykohet rasti Drenica II atëherë bisedimet me Serbinë do të vazhdojnë pa problem"*.

Pretendimet e parashtruesit Jahir Demaku (KI150/17)

55. Parashtruesi i kërkesës Jahir Demaku, duke pretenduar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ-së, potencon se *"kërkesa e kryetarit të trupit gjykues për caktimin e [A. A. G.] si anëtare e trupit gjykues ka pasur për qëllim që kryetarit të trupit gjykues t'i mundësojë që t'i realizojë qëllimet e tij ashtu si ka deklaruar jashtë shqyrtimit gjyqësor, [...] se "nëse i dënon këta të akuzuar mund të gjejë punë ku të dojë në Evropë", dhe thënie tjera që japin për të kuptuar se i njëjti çështjen e ka paragjykuar dhe paraprakisht ka qenë i përcaktuar që të akuzuarit në këtë rast penal t'i shpalli fajtorë me çdo kusht pavarësisht asaj se a ka prova apo nuk ka"*.

56. Parashtruesi i kërkesës Jahir Demaku, po ashtu, pretendon se *"qëllimet e kryetarit të trupit gjykues, gjyqtarit [D. S.] janë vërtetuar*

me veprimet e tij gjatë mbajtjes së gjykimit, duke i shpallur si dëshmitar armiqësor në kundërshtim me ligjin të gjithë dëshmitarët që nuk kanë dëshmuar në favor të akuzës, duke i vlerësuar provat në mënyrë të njëanshme dhe në dëm të [parashtruesve], duke anashkaluar në tërësi parimin in dubio pro reo, apo në rast dyshimi në favor të të akuzuarit ashtu që ua falë besimin dëshmitarëve A. dhe K, përkundër konstatimit ku thuhet "ishte e qartë se ata dëshmitarët A. dhe K. nuk kishin përvojë në dhënien e një versioni të saktë dhe mirë të strukturuar të ngjarjeve, prandaj deklaratat e tyre përmbanin ngecje dhe zbrazëtira të cilat trupi gjykues ua atribuon aftësive të kufizuara raportuese të dëshmitarëve".

57. Parashtruesi Jahir Demaku pretendon se Gjykata Supreme *"ka refuzuar, pa dhënë arsye, për të marrë në pyetje [...] [M. S.] i cili pretendim ishte primar dhe i potencuar gjatë procedurës pranë gjykatës së rregullt kosovare, ka abuzuar me imunitetin e dëshmitarit duke mos nisur asnjë procedurë për heqjen e imunitetit, sipas kërkesës së vet [M. S.] për t'u trajtuar si dëshmitar, e me të vetmin qëllim për ndriçimin e të vërtetës".*

58. Parashtruesi Jahir Demaku po ashtu, potencon se *"parimi i paanësisë është cenuar edhe për faktin se përbërja e trupit gjykues ka qenë e atillë që në përbërjen e vet ka pasur dy anëtarë që kanë pasur konflikt të pastër interesi".* Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës Jahir Demaku gjithashtu pretendon se "*... shkelja e rregullave të brendshme të EULEX-it [gjatë caktimit të gjyqtarëve në trupa gjykues] ka pasur ndikim direkt në të drejtat kushtetuese për gjykim të drejtë dhe të paanshëm*" të parashtruesve të kërkesës.

59. Parashtruesi Jahir Demaku në lidhje me kërkesën për vënien e masës së përkohshme potencon se *"[privimi nga liria si është rasti me z. Jahir Demaku mund të rezultojë me shkaktimin e pasojave të përhershme dhe të pandreqshme të paraqitësit të kësaj kërkese sepse gjatë mbajtjes së tij në paraburgim dhe tani gjatë vuajtjes së dënimit është duke përjetuar një gjendje të rëndë shpirtërore dhe psikike posaçërisht pasi është informuar për parregullsitë që janë manifestuar në procesin gjyqësor kundër tij."* Sipas tij, *'Fjalët e thëna nga kryetari i trupit gjykues për rastin Drenica II, ku parashtruesi i kësaj kërkese është njeri ndër të gjykuarit, paraqet cenim të nenit 23 (Dinjiteti i njeriut) të Kushtetutës së Kosovës, sipas këtij neni "dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut".*

60. Në fund, të gjithë parashtruesit e kërkesave kërkojnë nga Gjykata që kërkesat e tyre të deklarohen të pranueshme, të konstatohet që atyre

u është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, dhe të shfuqizohet Aktgjykimi i Gjykatës Supreme.

Pranueshmëria e kërkesës

61. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesat i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

62. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili parasheh:

> "*1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

63. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 49 [Afatet] të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej 4 (katër) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. [...]".*

64. Lidhur me si më sipër, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës i kanë parashtruar kërkesat si palë të autorizuara, kërkesat i kanë parashtruar brenda afateve të përcaktuara me nenin 49 të Ligjit dhe pas shterjes së të gjitha mjeteve juridike të parapara me ligj.

65. Gjykata, më tej, i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".*

66. Gjithashtu, Gjykata i referohet paragrafit (1) (d) të rregullit 36 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, që përcaktojnë:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*

d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar".

67. Lidhur me përmbushjen e kësaj kërkese, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës kanë qartësuar saktësisht, se cilat të drejta të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ, janë shkelur në dëm të tyre, nga jokushtetutshmëria e pretenduar e procedurave gjyqësore.

68. Përveç kësaj, pas shqyrtimit të ankesave dhe vërejtjeve të parashtruesve të kërkesës, Gjykata konsideron se kërkesat ngrenë çështje serioze të fakteve dhe ligjit të cilat janë të një kompleksiteti të tillë sa që përcaktimi i tyre duhet të varet nga shqyrtimi i meritave. Prandaj, kërkesa nuk mund të konsiderohet si qartazi e pabazuar brenda kuptimit të rregullit 36 (1) (d) të Rregullores së punës dhe nuk është krijuar asnjë bazë tjetër për ta deklaruar atë të papranueshme (Shih, për shembull, rasti *A. dhe B. kundër Norvegjisë*, [DHM], kërkesat nr. 24130/11 dhe nr. 29758/11, Aktgjykimi i 15 nëntorit 2016, paragrafi 55, dhe gjithashtu shih, *mutatis mutandis* rasti nr. KI132/15, *Manastiri i Deçanit*, Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 20 majit 2016).

Meritat e kërkesës

69. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se me vendimin e kontestuar është shkelur e drejta e tyre për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, veçanërisht sa i përket caktimit të gjyqtarëve në trupin gjykues të Gjykatës Themelore dhe arsyetimit të vendimeve.

Të gjithë parashtruesit e kërkesave pretendojnë se:

i) Gjykata Supreme nuk e ka trajtuar si duhet çështjen e përbërjes së trupit gjykues në Gjykatën Themelore pasi që kjo përbërje ishte caktuar në kundërshtim me rregullat për caktimin e gjyqtarëve të EULEX-it në trupat gjykues, me ç'rast u është cenuar e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm;

ii) Gjykata Supreme ka refuzuar të marrë dëshminë e [M. S.] lidhur me parregullsitë në përbërjen e trupit gjykues të Gjykatës Themelore dhe nuk e ka arsyetuar vendimin e saj në lidhje me këtë, si dhe nuk e ka adresuar çështjen e konfliktit të interesit ndërmjet anëtarëve të trupit gjykues të Gjykatës Themelore.

Parashtruesit e kërkesës Isni Thaçi dhe Jahir Demaku pretendojnë:

iii) Gjykatat e rregullta e shpallën dëshmitarin B. "dëshmitar armiqësor" në kundërshtim me ligjin dhe ua falën besimin dëshmitarëve A. dhe K., në kundërshtim me parimin *in dubio pro reo*, edhe pse gjykata gjeti se dëshmitarët A. dhe K. nuk kishin përvojë në dhënien e një versioni të saktë dhe të mirë strukturuar të ngjarjeve.

Parashtruesi i kërkesës Isni Thaçi pretendon:

iv) Eksperti i forenzikës mjekësore M. G. nuk është marrë në pyetje gjatë procedurës gjyqësore, duke shkelur kështu parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit të procedurës.

70. Në lidhje me këtë, Gjykata u referohet dispozitave të nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ-së, që përcaktojnë:

"Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
[...]"

Neni 6 (E drejta për një proces të rregullt)

1. *"Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze të natyrës penale që i është drejtuar.*
[...]"

71. Gjykata gjithashtu i referohet dispozitave të legjislacionit përkatës:

Kodi i Procedurës Penale

Neni 384 [Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale]

1. Shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale konsiderohet nëse:

1.1. përbërja e gjykatës nuk ka qenë në pajtim me ligjin ose […];

Neni 432 Arsyet për paraqitje të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë

1. Kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë ose kundër procedurës gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të tillë, pas përfundimit të procedurës penale në formë të prerë mund të paraqitet kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në rastet vijuese:

[…]

1.2. në rast të shkeljes esenciale të ligjit të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1. i këtij Kodi; ose

1.3. në rast të shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor.

2. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, as kundër vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës me të cilën është vendosur mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.

[…]

Ligji nr. 03/l-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë

Neni 2 [Kompetencat e përgjithshme të gjyqtarëve të EULEX-it]

[…]

2.6. Pas konsultimit me Shefin e Komponentit të Drejtësisë, Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it dhe Kryeprokurori i EULEX-it, do t'ia propozojnë Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it përkatësisht Asamblesë se Prokurorëve të EULEX-it, modalitetet për përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve në bazë të kritereve objektive dhe masat siguruese procedurale të cilat do të jenë në përputhje me ligjin në fuqi. Këto modalitete që do të miratohen nga Asambleja e gjyqtarëve të EULEX-it dhe Asambleja se Prokurorëve të EULEX-it, do të sigurojnë respektimin e pavarësisë dhe paanësisë së gjyqtarëve të EULEX-it si dhe të autonomisë së prokurorëve të EULEX-it në ushtrimin e funksioneve të tyre.

Neni 3 [Juridiksioni dhe kompetencat e gjyqtarëve të EULEX-it në procedurë penale]

[...]
3.2 Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it do ta caktojë cilindo gjyqtar të EULEX-it në fazën përkatëse të procedurës penale të lëndës së hetuar a ndjekur penalisht nga PSRK-ja në përputhje me modalitetet për përzgjedhjen dhe caktimin e lëndëve të përcaktuara nga Asambleja e gjyqtarëve të EULEX-it dhe në pajtim me këtë ligji.

Udhëzimi për caktimin e lëndëve për gjyqtarët e EULEX-it në rastet penale në gjykatat e qarkut

[...]
II. 1. Historiku juridik
Caktimi i lëndëve të gjyqtarëve të EULEX-it do të bëhet në përputhje me Ligjin mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (Ligji nr. 03/L-053), më poshtë LL.

Ky udhëzim duhet të shtjellojë përshkrimet për shpërndarjen e lëndëve të parashikuara nga ligji i lartpërmendur.

II. 2. Parimet
• Transparenca
Caktimi i rasteve duhet të jetë transparent për aktorët dhe jo-aktorët në sistemin e drejtësisë.
• Objektiviteti
Gjithkush duhet të dijë paraprakisht se ku dhe nga cili gjyqtar do të gjykohet (Gjyqtarët nuk përzgjedhin lëndët).
• Fleksibiliteti
Kushtet specifike të formulimit dhe numri i gjyqtarëve të EULEX-it dhe përjashtimet ligjore në bazë të KPPPK duhet të merren parasysh.
• Qëndrueshmëria
Sistemi i caktimit të rasteve duhet të jetë një shembull i një administrate të mirë të drejtësisë, për të cilën gjyqtarët vendorë munden (duhet) t'i përmbahen në mënyrë që të arrijnë qëllimet e një administrate të pavarur, transparente dhe efikase të drejtësisë.
• Barazia në ngarkesën e punës së gjyqtarëve".
[...]

III.3. Sistemi i caktimit të rasteve
[...]

3.1. Brenda seksionit rastet do t'u ndahen gjyqtarëve sipas sistemit numerik ku çdo rast i tretë që vjen në seksion do të ndahet për gjyqtarin A, secili rast i tretë për gjyqtarin B. dhe çdo rast i tretë për gjyqtarin C. (nr. 1. për gjyqtarin A., nr. 2. për gjyqtarin B., nr. 3. për gjyqtarin C., nr 4. për gjyqtarin A. dhe kështu me radhë). Për arsye të jashtëzakonshme (për shembull cilësinë dhe kompleksitetin e rastit dhe numrin e rasteve të besuara për secilin gjyqtar), gjyqtari caktues mund të ndajë rastet e zgjedhura në një mënyrë tjetër nga sa është përmendur më parë.
[...]
5.3. Gjyqtarët e EULEX-it vendosen në Gjykatën Supreme ose në një ose më shumë Gjykata të Qarkut. Vendosja e gjyqtarëve të EULEX-it në më shumë se një Gjykatë të Qarkut do t'i përgjigjet nevojës për zëvendësim në raste të jashtëzakonshme. Në këto raste, gjyqtari i EULEX-it do të ketë vendin kryesor të tij në një gjykatë të qarkut dhe do të veprojë si zëvendësues i natyrshëm i një gjyqtari tjetër të EULEX-it në një Gjykatë tjetër të Qarkut.

[...]
5.5. Një sistem i kujdestarisë/detyrës do të vendoset për situata emergjente në mes të gjykatave të lidhura më lart në mënyrë që të sigurohet që një gjyqtar është në dispozicion për situata urgjente. Afati i caktimit në sistemin e kujdestarisë/ detyrës caktohet për një javë duke përfshirë edhe fundjavat. Propozimi i sistemit të rotacionit dërgohet nga Kryetarët e Seksioneve të Krimeve të Luftës të Gjykatave përkatëse të Qarkut tek Kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it jo më pak se një muaj më parë.
[...] "

i) Përbërja e Trupit Gjykues të Gjykatës Themelore

72. Gjykata fillimisht do ta adresojë pretendimin se *i)* Gjykata Supreme nuk e ka adresuar si duhet çështjen e caktimit të gjyqtarëve në trupin gjykues të Gjykatës Themelore, sepse kjo është bërë në kundërshtim me rregullat për caktimin e gjyqtarëve të EULEX-it në trupat gjykuese.

73. Gjykata thekson se në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, *"[të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut"*.

E drejta për vendim të arsyetuar

74. Gjykata rikujton që, sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), e drejta për një gjykim të drejtë përfshin të drejtën për një vendim të arsyetuar.

75. Sipas praktikës së saj të konsoliduar gjyqësore, GJEDNJ konsideron se, bazuar në parimet e administrimit të duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave dhe tribunaleve duhet t'i theksojnë në mënyrë adekuate arsyet në të cilat ato bazohen. (Shih *Tatishvili kundër Rusisë*, nr. 1509/02, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 22 shkurtit 2007, paragrafi 58; *Hiro Balani kundër Spanjës*, GJEDNJ, kërkesa nr. 18064/91, Aktgjykimi i 9 dhjetorit 1994, para. 27; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, GJEDNJ, kërkesa nr. 134/1996/753/952, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998, paragrafi 42; *Papon kundër Francës*, GJEDNJ, kërkesa nr. 54210/00, Aktgjykimi i 7 qershorit 2001).

76. Përveç kësaj, GJEDNJ-ja ka konstatuar se autoritetet gëzojnë liri të konsiderueshme në zgjedhjen e mjeteve të përshtatshme për të siguruar se sistemet e tyre gjyqësore janë në përputhje me kërkesat e nenit 6 (1) të KEDNJ-së, por gjykatat duhet *"t'i tregojnë me qartësi të mjaftueshme bazat që kanë shërbyer për nxjerrjen e vendimeve të tyre"*. (Shih, *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, Aktgjykim i GJEDNJ-së, i 16 dhjetorit 1992, paragrafi 33).

77. Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, funksioni esencial i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar. Për më tepër, një vendim i arsyetuar i jep një pale mundësinë për t'u ankuar kundër tij, si dhe mundësinë e shqyrtimit të vendimit nga një organ i apelit. Vetëm duke dhënë një vendim të arsyetuar mund të ketë shqyrtim publik të administrimit të drejtësisë. (Shih *mutatis mutandis, Hirvisaari kundër Finlandës*, nr. 49684/99, para. 30, 27 shtator 2001; shih gjithashtu *Tatishvili kundër Rusisë*, GJEDNJ, kërkesa nr. 1509/02, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007, paragrafi 58).

78. Megjithëse gjykatat nuk janë të detyruara të adresojnë të gjitha pretendimet e parashtruara nga parashtruesit - ato megjithatë duhet të adresojnë pretendimet që janë qendrore për rastet e tyre dhe të cilat ngritën në të gjitha fazat e procedurës (Shih rastin *IKK Classic*, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 53).

79. Gjykata përsërit se e drejta për të marrë një vendim gjyqësor në pajtim me ligjin përfshin detyrimin që gjykatat të japin arsyet për vendimet e tyre me baza të arsyeshme si në nivelin procedural ashtu edhe në atë

material. (Shih rastin *IKK Classic*, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 54).

80. Shkalla në të cilën zbatohet obligimi për të dhënë arsye, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet duke pasur parasysh rrethanat të rastit. (*Garcia Ruiz kundër Spanjës*, [GC], kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999. para. 29, *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 9 dhjetorit 1994, para. 27, *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, GJEDNJ, kërkesa nr. 134/1996/753/952, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998, paragrafi 42).

81. Gjykata thekson se, arsyetimi i vendimit duhet të sqarojë raportin ndërmjet gjetjeve në merita dhe vlerësimeve lidhur me provat e propozuara nga njëra anë, dhe konkluzioneve ligjore të gjykatës nga ana tjetër. Aktgjykimi i gjykatës do të shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk përmban fakte të vërtetuara, dispozitat ligjore përkatëse dhe marrëdhënien logjike midis tyre. (Rasti i Gjykatës Kushtetuese nr. KI72/12, *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012, paragrafi 61, shih gjithashtu rastin KI135/14, *IKK Classic*, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 58).

Zbatimi i standardeve të lartpërmendura në rastin e parashtruesve të kërkesës

82. Gjykata rikujton që në bazë të nenit 384, paragrafi 1.1 të KPP-së, ekziston shkelje substanciale e dispozitave të procedurës penale, nëse, ndër të tjera, gjykata nuk është themeluar në pajtim me ligjin.

83. Gjykata gjithashtu rikujton se sipas nenit 2.6 të Ligjit nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, të 3 qershorit 2008 (e aplikueshme në kohën kur ishte themeluar trupi gjykues), Asambleja e Gjyqtarëve të EULEX-it dhe e Prokurorëve të EULEX-it do të miratojë modalitetet për përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve në bazë të kritereve objektive të paracaktuara dhe masave siguruese procedurale të cilat do të jenë në përputhje me ligjin në fuqi dhe të cilat do të sigurojnë respektimin e pavarësisë dhe paanësisë së gjyqtarëve të EULEX-it, si dhe të autonomisë së prokurorëve të EULEX-it në ushtrimin e funksioneve të tyre.

84. Në lidhje me këtë, Udhëzimi për caktimin e lëndëve penale gjyqtarëve të EULEX-it në Gjykata të Qarkut (në tekstin e mëtejmë: Udhëzimi), i nxjerrë në bazë të Ligjit nr. 03/L-053, shtjellon parimet që do të

udhëheqin caktimin e gjyqtarëve të EULEX-it në rastet penale, duke përfshirë parimet e transparencës, objektivitetit, fleksibilitetit, qëndrueshmërisë dhe barazisë së ngarkesës së punës së gjyqtarëve.

85. Përveç kësaj, Gjykata vëren se Udhëzimi i nxjerrë në bazë të Ligjit nr. 03/L-053, në nënrregullin 3.1, parasheh rregulla specifike se si do të ndahen rastet brenda seksioneve - duke ndjekur sistemin numerik ku çdo rast i tretë që vjen në seksion do të ndahet për gjyqtarin A., B. përkatësisht C.

86. Gjykata gjithashtu rikujton se Udhëzimi lejon që për arsye të jashtëzakonshme, gjyqtari kompetent, për ndarjen e rasteve mund t'i ndajë rastet specifike në mënyrë të ndryshme nga sistemi numerik i përmendur më lart, megjithatë, kjo krijon obligim për të justifikuar arsyet e jashtëzakonshme, siç është kompleksiteti i rastit dhe numri i rasteve që i janë besuar secilit gjyqtar. Udhëzimi gjithashtu parasheh se si gjyqtarët e caktuar në një gjykatë të qarkut mund të zëvendësojnë në një gjykatë tjetër të qarkut në rast se është e nevojshme në bazë të listës së prioriteteve të gjykatave, si dhe sistemin e kujdestarisë/detyrës për situatë emergjente bazuar në një sistem rotacioni që duhet të caktohet jo më pak se një muaj më parë.

87. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton që Gjykata Supreme, duke adresuar çështjen e ngritur nga parashtruesit e kërkesave, në lidhje me zbatimin e rregullave të brendshme dhe orarin e EULEX-it për caktimin e gjyqtarëve në rastet e caktuara, arsyetoi se "*nuk ka pasur ndonjë skemë për caktimin e gjyqtarëve të EULEX-it në kohën relevante. Sipas udhëzimit për caktimin e rasteve tek gjyqtarët e EULEX-it në rastet penale nëpër gjykatat e qarqeve", e cila ka qenë e zbatueshme në kohën kur gjyqtarja [A. A. G], u caktua në rast, nuk është mbështetur ndonjë orar specifik. Udhëzimi thjesht shpjegon strukturën e gjyqtarëve të EULEX-it në gjykata të qarqeve dhe i përshkruan parimet e përgjithshme të cilat zbatohen lidhur me caktimin e rastit. Po ashtu, gjyqtarja [A. A. G] u caktua në rast sipas vendimit të 29 majit 2014 të ushtruesit të detyrës së kryetarit të gjyqtarëve të EULEX-it, i cili aso kohe ka qenë i autorizuar për ta marrë këtë vendim. Përveç kësaj, gjyqtarja e EULEX-it [A. A. G] aso kohe ka qenë e caktuar ligjërisht në nivelin e shkallës së parë*". "*Prandaj, Kolegji është i mendimit se as caktimi i gjyqtares [A. A. G.] nuk mund të cilësohet si shkelje e nenit 384 (1.1) ose e nenit 384 (1.2) e KPP-së. Kolegji vëren se edhe sikur të ketë pasur shkelje të rregullores së brendshme të EULEX-it (përderisa shkeljet e pretenduara nuk përbëjnë shkelje të ligjit përkatës-sikurse është kërkesa në fjalë se KPP-ja është shkelur), atëherë ajo do ishte një*

çështje e diskrecionit përbrenda autoriteteve disiplinore/administrative të EULEX-it".

88. Në këtë drejtim, Gjykata përsërit se nuk është detyrë e saj të shqyrtojë nëse Gjykata Supreme ka interpretuar në mënyrë të drejtë ligjin e aplikueshëm (ligjshmërinë), por të vlerësojë nëse Gjykata Supreme ka shkelur të drejtat dhe liritë individuale të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë) (shih, për shembull, rasti nr. KI72/14, Parashtruese *Besa Qirezi*, Aktgjykimi i 4 shkurtit 2015, para. 65).

89. Për më tepër, në këtë pikë, si rregull i përgjithshëm, vërtetimi i fakteve të rastit dhe interpretimi i ligjit janë ekskluzivisht çështje për gjykatat e rregullta, gjetjet dhe konkluzionet e të cilëve në këtë drejtim janë të detyrueshme për Gjykatën. Megjithatë, kur një vendim i një gjykate të rregullt është qartazi arbitrar, Gjykata mund dhe duhet ta vë atë në dyshim.(Shih *Sisojeva dhe të tjerët kundër Letonisë*, [GC], kërkesa nr, 60654/00, Aktgjykimi i 15 janarit 2007, para 89. Shih gjithashtu rastin *IKK Classic*, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 47).

90. Gjykata vëren se Gjykata Supreme i hodhi poshtë argumentet e parashtruesve të kërkesës për shkelje të rregullave për caktimin e gjyqtarëve në trupa gjykues, duke deklaruar se Kryetari i gjyqtarëve të EULEX-it është i autorizuar me ligj që t'i caktojë gjyqtarët në raste të tilla. Gjykata Supreme në arsyetimin e vet gjithashtu theksoi se edhe nëse ka pasur shkelje të rregullave të EULEX-it për caktimin e gjyqtarëve në raste penale, përderisa nuk ka shkelje të dispozitave të KPP-së lidhur me përbërjen e trupave gjykues, nuk ka shkelje të të drejtave të parashtruesve të kërkesës.

91. Prandaj, Gjykata vëren se arsyetimi i Gjykatës Supreme kryesisht u kufizua në shkeljen e mundshme të KPP-së dhe nuk i mori parasysh normat tjera të aplikueshme, relevante për caktimin e gjyqtarëve në trupat gjykues, siç kërkohet nga parashtruesit e kërkesës. Për më tepër, Gjykata vëren se në arsyetimin e saj Gjykata Supreme nuk ka sqaruar pse KPP-ja nuk është shkelur.

92. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se Gjykata Supreme arsyetoi se mosrespektimi i Udhëzimit për caktimin e lëndëve gjyqtarëve të EULEX-it nuk shkel të drejtat e parashtruesve të kërkesës, përderisa shkeljet e pretenduara nuk përbëjnë shkelje të vetë KPP-së .

93. Gjykata vëren se Gjykata Supreme e bazoi këtë konkluzion në vlerësimin se *"edhe sikur të ketë pasur shkelje të rregullores së brendshme të EULEX-it [...], atëherë ajo do ishte një çështje e*

diskrecionit përbrenda autoriteteve disiplinore/administrative të EULEX-it […]".

94. Kësisoj, Gjykata e kupton se, përfundimisht, Gjykata Supreme konsideroi se Udhëzimet e EULEX-it ishin një çështje e brendshme e EULEX-it dhe, për këtë arsye, nuk ishin pjesë e kornizës legjislative të Kosovës. Megjithatë, sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës, të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e EULEX-it, kanë obligim të zbatojnë ligjet e miratuara siç duhet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe rrjedhimisht, legjislacioni që rrjedh prej tij (shih, *mutatis mutandis*, rasti nr. KI25/10, Parashtrues: *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktgjykimi i 31 marsit 2011, paragrafi 61 dhe 62).

95. Për më tepër, Gjykata vëren se Gjykata Supreme ka arsyetuar që, bazuar në Udhëzimin e EULEX-it, Kryetari i gjyqtarëve të EULEX-it ka liri të plotë për t'i caktuar gjyqtarët në kolegje, pavarësisht nga rregullat specifike që gjenden në Udhëzim.

96. Prandaj, Gjykata kupton se Gjykata Supreme konsideroi se Udhëzimi përmban vetëm parime të përgjithshme të cilat nuk kufizojnë autoritetin diskrecional të Kryetarit të gjyqtarëve të EULEX-it në caktimin e gjyqtarëve në trupa të veçantë gjykues.

97. Megjithatë, Gjykata rikujton që Ligji nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë specifikon se ndarja e lëndëve dhe emërimi i gjyqtarëve bazohen në "*kritere objektive të paracaktuara dhe garanci procedurale*".

98. Në këto rrethana, Gjykata konstaton se, duke mos marrë parasysh të gjitha rregullat e zbatueshme për emërimin e gjyqtarëve në trupat gjykues, Gjykata Supreme nuk ka arsyetuar vendimin e saj lidhur me emërimin e gjyqtarëve në trupa gjykues bazuar në "*kriteret objektive të paracaktuara dhe garancitë procedurale*", siç parashihet me Ligjin nr. 03/l-053.

99. Në veçanti, Gjykata konstaton se Gjykata Supreme ka dështuar në detyrën e saj për të lidhur në mënyrë të mjaftueshme rregullat e zbatueshme me faktet e rastit, siç kërkohet me të drejtën për një vendim të arsyetuar sipas të drejtës për një gjykim të drejtë.

100. Gjykata konsideron se nëse Gjykata Supreme do të kishte adresuar pretendimet e parashtruesve lidhur me përbërjen e trupit gjykues, bazuar në legjislacionin relevant që ka të bëjë me caktimin e gjyqtarëve në trupa gjykues dhe në dritën e "*kritereve objektive të paracaktuara dhe garancive procedurale*" siç kërkohet me Ligjin nr. 03/L-053 dhe

me normat tjera relevante, atëherë kjo do të ishte në pajtueshmëri me administrimin e duhur të drejtësisë.

101. Nuk është roli i Gjykatës të shqyrtojë se deri në çfarë mase janë të arsyeshme pretendimet e parashtruesve në procedurat në gjykatat e rregullta. Megjithatë, drejtësia procedurale kërkon që pretendimet esenciale që palët ngrenë duhet të përgjigjen në mënyrë të duhur nga gjykatat e rregullta në pajtueshmëri me kërkesat e të drejtës për gjykim të drejtë (shih, *mutatis mutandis*, Gjykata Kushtetuese nr. KI22/16, *Naser Husaj*, Aktgjykimi i 9 qershorit 2017, paragrafi 47). Ajo që është në pyetje është besimi që gjykatat në një shoqëri demokratike duhet të frymëzojnë në publik (shih, *Volkov kundër Ukrainës*, paragrafi 106, Aktgjykim i GJEDNJ-së i 2013 dhe shih *De Cubber kundër Belgjikës*, 26 tetor 1984, paragrafi 26 , Seria A. nr. 86).

102. Prandaj, Gjykata konstaton se Gjykata Supreme ka shkelur të drejtën e parashtruesve për një vendim të arsyetuar, për shkak të dështimit për të bërë një vlerësim dhe arsyetim të plotë, nëse është respektuar ose jo tërësia e dispozitave ligjore të aplikueshme, kur janë caktuar gjyqtarët në trupin gjykues në rastin e parashtruesve të kërkesës.

103. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se ka pasur shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

104. Gjykata thekson se ky konkludim i referohet shkeljes së pretenduar kushtetuese. Kësisoj, Gjykata konfirmon se gjetjet që i përmban ky aktgjykim nuk paragjykojnë rezultatin e procedurës në lidhje me rastin e parashtruesve të kërkesës ose në lidhje me fajësinë apo pafajësinë e tyre.

105. Sa i përket pretendimeve të tjera të parashtruesve, Gjykata konsideron se ato kryesisht ngrenë çështje të ligjshmërisë dhe jo të kushtetutshmërisë dhe se Gjykata Supreme ka dhënë arsyetime të hollësishme për të gjitha këto çështje në aktgjykimin e saj.

Kërkesa për masë të përkohshme

106. Gjykata rikujton se parashtruesi Jahir Demaku (KI150/17) gjithashtu kërkon nga Gjykata që të nxjerrë vendim për vendosjen e masës së përkohshme, përkatësisht ndalimin e ekzekutimit të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme.

107. Duke pasur parasysh se Gjykata ka gjetur shkelje të të drejtave të parashtruesit të mbrojtura me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, nuk e konsideron të nevojshme që ta shqyrtojë kërkesën e parashtruesit për miratimin e masës së përkohshme.

Përfundim

108. Në përfundim, Gjykata konstaton se duke dështuar të japë një vlerësim dhe arsyetim të plotë lidhur me atë se a ka qenë caktimi i gjyqtarëve në trupin gjykues në rastin e parashtruesve në Gjykatën Themelore në pajtim me tërësinë e dispozitave ligjore të zbatueshme, me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pml. KZZ. 322/2016, të 19 korrikut 2017, është shkelur e drejta e parashtruesve për një vendim të arsyetuar dhe me këtë ka shkelur të drejtën e parashtruesve për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

109. Në pajtim me rregullin 74 (1) të Rregullores së punës, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. KZZ. nr. 322/2016 i 19 korrikut 2017, shpallet i pavlefshëm dhe rasti i kthehet Gjykatës Supreme për rishqyrtim.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullin 56 (1 të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 30 maj 2018, me shumicë

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme për shqyrtim në merita;

II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe paragrafit 1, të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

III. TA SHPALLË TË PAVLEFSHËM Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. KZZ. nr. 322/2016 të 19 korrikut 2017;.

IV. TA KTHEJË Aktgjykimin e Gjykatës Supreme për rishqyrtim në pajtim me aktgjykimin e kësaj Gjykate;

V. TA URDHËROJË Gjykatën Supreme, që në pajtim me rregullin 63 (5) të Rregullores së punës, ta njoftojë Gjykatën, brenda 6 (gjashtë) muajve nga publikimi i këtij aktgjykimi, në lidhje me masat e ndërmarra për zbatimin e aktgjykimit të kësaj Gjykate;

VI. TË MBETET fuqimisht e angazhuar në këtë çështje në pritje të pajtueshmërisë me këtë urdhër;

VII. TË URDHËROJË që ky aktgjykim t'u kumtohet palëve, dhe në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, të publikohet në Gazetën Zyrtare;

VIII. TË DEKLAROJË se ky aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi	Arta Rama-Hajrizi

Mendim i përbashkët mospajtues
i
gjyqtarëve Almiro Rodrigues dhe Snezhana Botusharova

rastet nr. KI146/17, KI147/17, KI148/17, KI149/17 dhe KI150/17

Parashtrues

Isni Thaçi, Zeqir Demaku, Fadil Demaku, Nexhat Demaku, dhe Jahir Demaku

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. KZZ. nr. 322/2016, të 19 korrikut 2017

1. E respektojmë vendimin e Shumicës së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Shumica). Megjithatë, nuk mund të pajtohemi me të për arsyet në vijim.

2. Së pari, Shumica nuk ka paraqitur dhe vlerësuar si duhet fushëveprimin e kërkesës.

3. Së dyti, Shumica ka konstatuar se Gjykata Supreme dështoi *"për shkak të mosparaqitjes së një vlerësimi të plotë dhe arsyetimit, nëse është respektuar ose jo tërësia e dispozitave ligjore te aplikueshme, kur caktoi gjyqtarët në trupin gjykues në rastin e parashtruesve të kërkesës"* (para 102 i Aktgjykimit). Ky përfundim bazohet në mungesën e një leximi të plotë dhe shqyrtimin e të gjitha vendimeve të gjykatave të rregullta dhe arsyetimit të tyre, që kanë të bëjnë me rastin e parashtruesve të kërkesës, përkatësisht, Aktgjykimi PML. KZZ. nr. 322/2016 i Gjykatës Supreme të Kosovës i 19 korrikut 2017, Aktgjykimi PAKP nr. 456/15 i Gjykatës së Apelit i 14 shtatorit 2016 dhe Aktgjykimi P58/14 i Gjykatës Themelore.

4. Së treti, Shumica nuk ka marrë parasysh tërë procesin penal *vis-à-vis* parashtruesve të kërkesës dhe nuk ka ndjekur në mënyrë të duhur arsyetimin e të tri instancave gjyqësore, në lidhje me përbërjen e gjykatës së shkallës së parë, përkatësisht Gjykatës Themelore.

5. Së katërti, nëse faktet dhe arsyetimi ligjor në aktgjykimet e tri instancave merren si të paraqitura dhe të dëshmuara, Gjykata Kushtetuese do të kishte arritur në përfundimin se kërkesa është e

papranueshme. Për më tepër, konkludimi se është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, veçanërisht për shkak të një vendimi të paarsyetuar nga Gjykata Supreme, nuk është dëshmuar nga Shumica. Leximi i kujdesshëm i Aktgjykimeve të tri instancave, dhe veçanërisht të Gjykatës Supreme, dëshmon se janë shqyrtuar dhe respektuar të gjitha bazat ligjore për përcaktimin e përbërjes së Gjykatës Themelore. Në veçanti, Gjykata Supreme mori parasysh *"Udhëzimin për caktimin e lëndëve për gjyqtarët e EULEX-it në rastet penale në gjykatat e qarkut"* të EULEX-it në fuqi në kohën e formimit të përbërjes së Gjykatës Themelore, Ligjin nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve të EULEX-it dhe Kodin e Procedurës Penale (në tekstin e mëtejmë: KPP).

6. Bazuar në shqyrtimet e mësipërme, argumentet dhe arsyetimet e hollësishme pasojnë si më poshtë.

Fushëveprimi i kërkesës

7. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme ka shkelur nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

8. Konkretisht, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se trupi gjykues i Gjykatës Themelore (Nr. P58/14 i 27 majit 2015) nuk ishte i përbërë në pajtim me ligjin, sepse një nga gjyqtarët në përbërjen e trupit gjykues nuk ishte caktuar në pajtim me rregullat e zbatueshme.

9. Shumica konstatoi se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme nuk ka arsyetuar mjaftueshëm pretendimet e parashtruesve të kërkesës në lidhje me përbërjen e trupit gjykues në Gjykatën Themelore dhe caktimin e gjyqtarit të kontestuar.

10. Megjithatë, Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme kanë arsyetuar gjerësisht dhe në mënyrë të kuptueshme vendimet e tyre mbi pretendimet lidhur me përbërjen e trupit gjykues të Gjykatës Themelore dhe caktimin e gjyqtarëve në këtë trup gjykues.

Vërejtjet paraprake

11. Në fillim, Gjykata Themelore vërejti se *"nuk ishte ngritur asnjë çështje nga palët lidhur me përbërjen e trupit gjykues"*. Prandaj, ajo konkludoi se *"sipas nenit 382 paragrafi 4 i KPPRK-së, ata hoqën dorë nga e drejta për të kontestuar përbërjen"*. Gjykata e Apelit gjithashtu vuri në dukje se "*kundërshtimi nuk ishte ngritur gjatë procedurës së shkallës së parë, edhe pse nuk kishte pengesa për ta bërë këtë. Prandaj, në pajtim me nenin 382 paragrafi 6 të KPP-së ai ishte i vonuar"*. Gjykata Supreme më tej vlerësoi se "*të gjitha kundërshtimet në lidhje me caktimin e gjyqtares së EULEX-it [A.A.G.] në kolegjin e Gjykatës Themelore janë bërë pas shqyrtimit gjyqësor. Sipas afateve të përcaktuara në nenin 41 (2) të KPP-së, pretendimet janë të vonuara"*.

12. Pavarësisht nga fakti se kundërshtimet për përbërjen e trupit gjykues u konsideruan "*të vonuara*", instancat kanë vazhduar më tutje duke sqaruar plotësisht pse ato konsideruan se përbërja e trupit gjykues ka qenë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

13. Prandaj, instancat shkuan më tej me shpjegime të panevojshme, pasi kundërshtimi i "vonuar" nuk do të kishte nevojë për arsyetime të mëtejshme. Kështu që çështja nuk mund të jetë mungesa e arsyetimit. Në fund, Shumica i bazon të gjitha analizat dhe vendimin e saj në *obiter dictum*.

Arsyetimi i Gjykatës Themelore

14. Gjykata Themelore në Mitrovicë (Aktgjykimi P58/14, i 27 majit 2015) i adresoi pretendimet lidhur me përbërjen e trupit gjykues.

15. Në të vërtetë, Gjykata Themelore, në pikën *"III. Kompetenca e gjykatës dhe përbërja e dhe kolegjit"* të Aktgjykimit të saj, thekson si në vijim:

> *"14. Asnjë çështje nuk u ngrit nga palët lidhur me përbërjen e trupit gjykues. Prandaj, supozohet se sipas nenit 382 paragrafi 4 i KPPRK-së ata kanë hequr dorë nga e drejta për të kontestuar përbërjen"*.

Arsyetimi i Gjykatës së Apelit

16. Gjykata e Apelit (Aktgjykimi PAKR nr. 456/15) e adresoi pretendimin lidhur me përbërjen e trupit gjykues në Gjykatën Themelore.

17. Në të vërtetë, Gjykata e Apelit, nën pikën "2. *Përbërja e trupit gjykues*" të Aktgjykimit të saj, arsyetoi si më poshtë:

> *"Kolegji thekson që çështja nuk ishte përmendur asnjëherë para se ankesat të parashtroheshin. Shpërndarja e gjyqtarëve në gjykata nuk është fshehtësi, si dhe baza ligjore për caktimin e tyre në rastet. Kundërshtimi nuk ishte ngritur gjatë procedurës së shkallës së parë, edhe pse nuk kishte pengesa për ta bërë këtë. Prandaj, në pajtim me nenin 382 paragrafi 6 të KPP-së, ai është i vonuar.*
>
> *[...]*
>
> *Në kontrast me pretendimet, asnjë regjistër për caktimin e gjyqtarëve të EULEX-it nuk është mbajtur në vitin 2013. Gjithashtu, caktimi i anëtarit të trupit gjykues në rastin në fjalë u krye në mënyrë zyrtare nga kryesi i detyrës së Kryetarit të Gjyqtarëve të EULEX-it, i cili ishte i autorizuar për një vendim të tillë. Ankuesit kanë theksuar thirrjen telefonike ndërmjet gjyqtarit kryesues të shkallës së parë dhe Kryetarit të Gjyqtarëve të EULEX-it disa minuta para se të nënshkruhet vendimi për emërim. Përmbajtja e një thirrjeje të tillë telefonike nuk dihet dhe nuk mund të dihet, prandaj nuk mund të arrihet përfundimi i qartë se është kërkuar gjyqtari i caktuar - si anëtar i kolegjit. Shkëmbimi në emal siç është përmendur në ankesa nuk përfshin një kërkesë të tillë. Si rrjedhojë, nuk ka arsye për të konkluduar se caktimi i kolegjit ka shkelur rregullat dhe mund të ketë dëmtuar paanësinë e trupit gjykues. Përveç kësaj, Kolegji nuk vëren ndonjë parregullsi në punën e Trupit Gjykues të pasqyruar në procesverbalin e seancave gjyqësore".*

Arsyetimi i Gjykatës Supreme

18. Parashtruesit e kërkesës parashtruan në Gjykatën Supreme kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë. Ata përsëritën pretendimet e tyre lidhur me përbërjen e papërshtatshme të trupit gjykues në Gjykatën Themelore dhe gjithashtu pretenduan që Gjykata e Apelit nuk kishte trajtuar siç duhet ankesat e tyre lidhur me përbërjen e trupit gjykues në Gjykatën Themelore.

19. Në të vërtetë, Gjykata Supreme (Aktgjykimi PML. KZZ, nr. 322/2016 i 19 korrikut 2017) i adresoi dhe arsyetoi pretendimet e parashtruesve të kërkesës lidhur me përbërjen e trupit gjykues në Gjykatën Themelore si më poshtë:

"137. Krejt në fillim Kolegji vëren se kundërshtimet lidhur me caktimin e gjyqtares së EULEX-it [A.A.G.] në Kolegjin e Gjykatës Themelore janë bërë pas shqyrtimit kryesor. Bazuar ne afatet kohore të cekura ne nenin 41 (2) të KPP-së, këto pretendime janë të pas-afatshme.

138. Po ashtu këto pretendime bazohen në një raportim televiziv të Koha Vision dhe emaile anonime, të cilat gjoja se janë dërguar nga punëtorë të EULEX-it. Sikurse u shpjegua nen titullin "kërkesat procedurale", [Gjykata Supreme] ka vendosur se në shkallën e tretë të procedurës nuk mund të pranohen prova të reja. Si obiter dictum, [Gjykata Supreme] vëren se dokumentet e bashkëlidhura duhet të konsiderohen si thelbësisht të pambështetshme (emaile të dërguara nga autorë të panjohur). Si rezultat i vetëm këtyre të gjeturave, Kolegji nuk mund ti pranoj pretendimet sipas të cilave është ardhur deri caktimi i gjyqtares së EULEX-it [A.A.G.] në këtë rast apo përmbajtjes së bisedave para Gjykatës së Apelit. Vetëm për këtë arsye, pretendimet janë të pabazuara.

139. Duke dashur të qartësoj disa prej çështjeve ligjore të ngritura në kërkesa, atëherë Kolegji do të bej disa vërejtje të përgjithshme lidhur me caktimin e gjyqtares së EULEX-it [A.A.G.] në Kolegjin e Gjykatës Themelore. Argumenti kryesor i ngritur nga Mbrojtja është se nuk është ndjekur orari i brendshëm i EULEX-it dhe se për këtë arsye Kolegji i Gjykatës Themelore nuk ishte në përbërjen e paraparë me Nenin 384 (1. 1) të KPP-së […].

*140. [Gjykata Supreme] pajtohet me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit se nuk ka pasur ndonjë skemë për caktimin e gjyqtarëve të EULEX-it në kohën relevante. Sipas "*Udhëzimit për caktimin e rasteve tek gjyqtarët e EULEX-it në rastet penale nëpër gjykatat e qarqeve*", e cila ka qenë e zbatueshme në kohën kur Gjyqtarja [A.A.G.] u caktua në rast, nuk është mbështetur ndonjë orar specifik. Udhëzimi thjesht shpjegon strukturën e gjyqtarëve të EULEX-it ne gjykata të qarqeve dhe i përshkruan parimet e përgjithshme të cilat zbatohen lidhur me caktimin e rastit. Po ashtu, Gjyqtarja [A.A.G.] u caktua në rast sipas vendimit të datës 29 Maj 2014 të ushtruesit të detyrës së kryetarit të gjyqtarëve të EULEX-it, i cili aso kohë ka qenë i autorizuar për ta marr këtë vendim. Përveç kësaj, gjyqtarja e EULEX-it [A.A.G.] aso kohe ka qenë e caktuar ligjërisht në nivelin e shkallës së parë.*

[…]

142. Prandaj, [Gjykata Supreme] është i mendimit se as caktimi i Gjyqtares [A.A.G.]nuk mund të cilësohet si shkelje e Nenit 384 (1.1) ose e Nenit 384 (1.2) e KPP-së. [Gjykata Supreme] vëren se edhe sikur të ketë pasur shkelje të rregullores së brendshme të EULEX-it (përderisa shkeljet e pretenduara nuk përbejnë shkelje të ligjit përkatës -sikurse është kërkesa në fjalë se KPP-ja është shkelur), atëherë ajo do ishte një çështje e diskrecionit përbrenda autoriteteve disiplinore/administrative të EULEX-it, sikurse veç është cekur sipër në paragrafin 121".

Vlerësimi i arsyetimit të gjykatave të rregullta

20. Të tri nivelet e gjykatave të rregullta arsyetuan çështjen e përbërjes së trupit gjykues të Gjykatës Themelore.

21. Pretendimet lidhur me caktimin e gjyqtares [A.A.G.] u ngritën së pari në Gjykatën e Apelit. Pavarësisht nga fakti se Gjykata e Apelit konsideroi se këto pretendime ishin paraqitur jashtë afatit, Gjykata e Apelit megjithatë arsyetoi se pse përbërja ishte në pajtim me ligjin.

22. Gjykata e Apelit e bazoi arsyetimin e saj në faktin se në atë kohë nuk kishte asnjë skemë të gjyqtarëve të EULEX-it, që ushtruesi i detyrës së Kryetarit të Gjyqtarëve të EULEX-it ishte i autorizuar të caktojë gjyqtarë në trupin gjykues dhe se pretendimet që gjyqtarja [A.A.G.] është kërkuar në mënyrë specifike për t'u caktuar jashtë fushëveprimit të Rregullores së aplikueshme nuk mund të konfirmoheshin. Gjykata e Apelit konsideroi se *"[...] nuk ka arsye për të arritur në përfundimin se caktimi i kolegjit ka shkelur rregullat dhe mund të ketë dëmtuar paanshmërinë e trupit gjykues".*

23. Në kërkesën e tyre për mbrojtjen e ligjshmërisë, parashtruesit e kërkesës përsëritën pretendimet e tyre lidhur me përbërjen e trupit gjykues dhe caktimin jo të duhur të gjyqtares [A.A.G.].

24. Përkundër faktit se Gjykata Supreme gjithashtu konsideroi se këto pretendime ishin paraqitur jashtë afatit, Gjykata Supreme megjithatë arsyetoi se pse përbërja ishte në pajtim me ligjin.

25. Lidhur me pretendimet lidhur me përbërjen e trupit gjykues dhe caktimin e gjyqtares [A.A.G.], Gjykata Supreme konfirmoi arsyetimin e dhënë nga Gjykata e Apelit, duke i ndarë pretendimet në dy çështje.

26. Lidhur me çështjen e parë, përkatësisht pretendimin se gjyqtarja [A.A.G.] është kërkuar në mënyrë specifike për t'u caktuar jashtë fushëveprimit të rregullave të aplikueshme, Gjykata Supreme vërtetoi

arsyetimin e Gjykatës së Apelit se (a) nuk kishte asnjë regjistër të gjyqtarëve të EULEX-it në atë kohë, (b) se një regjistër i tillë nuk ishte kërkuar me *"Udhëzimin për caktimin e lëndëve për gjyqtarët e EULEX-it në çështjet penale në gjykatat e qarkut"* të zbatueshme në atë kohë, (c) se caktimi ishte bërë nga Ushtruesi i detyrës së Kryetarit të Gjyqtarëve të EULEX-it në kuadër të fushëveprimit të autorizimit të tij, dhe përveç kësaj, Gjykata Supreme arsyetoi (d) se *"Gjyqtarja e EULEX-it [A.A.G.] ishte gjyqtare e EULEX-it e caktuar në mënyrë legjitime në nivelin e shkallës së parë në atë kohë".*

27. Përkitazi me çështjen e dytë, lidhur me caktimin e gjyqtares [A.A.G.], përkatësisht që gjyqtarja [A.A.G.]nuk mund të riemërohej nga njësia e lëvizshme në Mitrovicë në trupin gjykues në Mitrovicë, Gjykata Supreme arsyetoi që riemërimet e tilla ndërmjet departamenteve të juridiksionit të njëjtë ishin të autorizuara sipas Ligjit nr. 03/L-199 për Gjykatat, si dhe në bazë të "*Udhëzimit për caktimin e lëndëve për gjyqtarët e EULEX-it në rastet penale në gjykatat e qarkut*" të EULEX-it dhe kompetenca për të bërë riemërime të tilla në rastin e EULEX-it kishte rënë tek Ushtruesi i detyrës së Kryetarit të Gjyqtarëve të EULEX-it.

28. Arsyetimi i tri instancave të gjykatave të rregullta janë në pajtim me njëri-tjetrën dhe adresuan pretendimet e parashtruesve në detaje të bollshme dhe në rritje në çdo nivel të ri të njëpasnjëshëm të gjykatave.

29. Përveç kësaj, fakti se edhe Gjykata e Apelit, po ashtu edhe Gjykata Supreme kanë adresuar pretendimet e parashtruesve lidhur me caktimin e gjyqtares së EULEX-it [A.A.G.] në trupin gjykues edhe përkundër faktit që të dy gjykatat konsideruan se këto pretendime ishin paraqitur jashtë afateve ligjore.

30. Parashtruesit e kërkesës në mënyrë specifike pretenduan se caktimi i gjyqtares [A.A.G.] ishte në kundërshtim me nenet 384 (1.1) dhe 384 (1.2) të Kodit të Procedurës Penale (KPP); por Gjykata Supreme ka vlerësuar më tej rrethanat e rastit dhe ka konstatuar se përbërja e trupit gjykues ishte në pajtim me ato dispozita të KPP-së.

31. Për më tepër, Gjykata Supreme ka konstatuar gjithashtu se procedura e ndjekur për caktimin e gjyqtares [A.A.G.] në trupin gjykues ishte në pajtim me Ligjin nr. 03/L-199 për Gjykatat, si dhe me "*Udhëzimin e EULEX-it për caktimin e lëndëve për gjyqtarët e EULEX-it në çështjet penale në gjykatat e qarkut*" të aplikueshme në kohën përkatëse.

32. Pavarësisht nga kjo, si *obiter dictum,* Gjykata Supreme Court vlerësoi se *"se edhe sikur të ketë pasur shkelje të rregullores së brendshme të*

EULEX-it (përderisa shkeljet e pretenduara nuk përbejnë shkelje të ligjit përkatës -sikurse është kërkesa në fjalë se KPP-ja është shkelur), atëherë ajo do ishte një çështje e diskrecionit përbrenda autoriteteve disiplinore/administrative të EULEX-it".

33. Gjykata Supreme mori parasysh se situata mund të shihej në dy aspekte: procedura penale (*përderisa shkeljet e pretenduara (...)përbejnë shkelje të ligjit përkatës)* dhe procedura disiplinore *(përderisa shkeljet e pretenduara nuk përbejnë shkelje të ligjit përkatës)*. Në lidhje me procedurën penale, Gjykata Supreme arriti në përfundimin se nuk kishte shkelje; sa i përket procedurës disiplinore, "*ajo do ishte një çështje e diskrecionit përbrenda autoriteteve disiplinore/administrative të EULEX-it".*

34. Gjykata Supreme ka arsyetuar pretendimin për përbërjen e trupit gjykues duke marrë parasysh Kodin e Procedurës Penale, Ligjin nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, dhe Udhëzimin për caktimin e lëndëve për gjyqtarët e EULEX-it në rastet penale në gjykatat e qarkut.

35. Do të thotë se është gabim kur Shumica thotë se Gjykata Supreme dështoi *"duke mos marrë parasysh të gjitha rregullat e zbatueshme për emërimin e gjyqtarëve në trupat gjykues"* (para. 98).

36. Përveç kësaj, kjo gjithashtu do të thotë se Gjykata Supreme*, "nëse ka pasur shkelje të rregullores së brendshme të EULEX-it (...)",* e shpalli veten jokompetente për t'i vlerësuar ato për aq sa *"përderisa shkeljet e pretenduara nuk përbejnë shkelje të ligjit përkatës". "Nëse ka ndonjë", ato do të binin "atëherë ajo do ishte një çështje e diskrecionit përbrenda autoriteteve disiplinore/administrative të EULEX-it".*

37. Për më tepër, as Gjykata Supreme, dhe as Gjykata Kushtetuese nuk kanë kompetencë juridiksionale për të vendosur lidhur me rregulloret e brendshme të EULEX-it, të cilat nuk përbëjnë shkelje të një ligji që ka të bëjë me rastin në fjalë dhe i cili mbetet vetëm në fushën administrative/disiplinore.

38. Prandaj, nuk ishte e mundur të konkludohej, siç bëri Shumica (nën para. 94), se *"Gjykata Supreme konsideroi se Udhëzimi i EULEX-it ishte një çështje e brendshme e EULEX-it dhe, për këtë arsye, nuk ishte pjesë e kornizës legjislative të Kosovës".*

39. Përkundrazi, Gjykata Supreme shqyrtoi Udhëzimin e EULEX-it për aq sa mund të "*përbënte shkelje të një ligji relevant për rastin*"; por jo aq

sa ato mund të përbënin shkelje të vetëm një rregulloreje të brendshme *"brenda diskrecionit të autoriteteve përkatëse administrative/disiplinore të EULEX-it"*.

40. Si përmbledhje, siç shpjegohet në arsyetimin e lartpërmendur të Gjykatës Supreme, caktimi i gjyqtares [A.A.G.] në trupin gjykues të Gjykatës Themelore në Mitrovicë në atë kohë u bazua në shqyrtimet vijuese:

(a) nuk kishte asnjë regjistër të gjyqtarëve të EULEX-it në atë kohë;
(b) se një regjistër i tillë nuk ishte kërkuar nga *"Udhëzimi për caktimin e lëndëve për gjyqtarët e EULEX-it në çështjet penale në gjykatat e qarkut"* të zbatueshëm në atë kohë;
(c) se caktimi ishte bërë nga Ushtruesi i detyrës së Kryetarit të Gjyqtarëve të EULEX-it në kuadër të fushëveprimit të të autorizimit tij, dhe
(d) Gjyqtarja e EULEX-it [A.A.G.] ishte gjyqtare e EULEX-it e caktuar në mënyrë legjitime në nivelin e shkallës së parë në atë kohë.

41. Në këto rrethana, gjykatat e rregullta respektuan dhe zbatuan të gjitha normat dhe rregullat në dispozicion të zbatueshme për përbërjen e trupit gjykues dhe caktimin e gjyqtarëve në trupin gjykues në këtë rast.

42. Për më tepër, Gjykata Supreme, në bazë të Kodit të Procedurës Penale, nuk gjeti shkelje të të drejtave të parashtruesve të kërkesës ose të dispozitave në të cilat ata thirreshin të Kodit të Procedurës Penale, as sa i përket përbërjes së trupit gjykues dhe as caktimit të gjyqtarëve në këtë trup gjykues.

Përfundim

43. Në përfundim, Shumica nuk mori parasysh arsyetimin e dhënë nga Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit, dhe më tej e zhvilluar dhe e detajuar nga Gjykata Supreme, gjatë vlerësimit të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës lidhur me përbërjen e trupit gjykues dhe caktimin e gjyqtares së EULEX-it [A.A.G.] në këtë trup gjykues.

44. Prandaj, Shumica nuk i ka interpretuar saktë faktet e kësaj kërkese dhe nuk ka marrë parasysh arsyetimin e qëndrueshëm dhe koherent të Gjykatës Themelore, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme.

45. Arsyetimi i Gjykatës Supreme shpjegohet dhe justifikohet plotësisht. Ai nuk është qartazi arbitrar, siç thekson Shumica, në mënyrë që

Gjykatës Kushtetuese t'i lejohet të vë në dyshim kushtetutshmërinë e tij.

46. Prandaj, nuk ka pasur shkelje të së drejtës së parashtruesve për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm sipas nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si pasojë e mungesës së një vendimi të arsyetuar.

47. Si përmbledhje, kërkesa duhej të ishte deklaruar e papranueshme si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese sipas nenit 48 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) (d) dhe 36 (2) (b) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

48. Për më tepër, çështjet e ngritura dhe të diskutuara nga Shumica në Aktgjykim bien brenda fushëveprimit të ligjshmërisë dhe nuk ngrihen në nivelin e një çështjeje të kushtetutshmërisë.

Dorëzuan me respekt,

Almiro Rodrigues	Snezhana Botusharova
Gjyqtar	Gjyqtare

KO45/18, Parashtrues: Glauk Konjufca dhe 11 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-060 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi

KO45/18, Aktgjykim i 18 prillit 2018, publikuar më 30 prill 2018

Fjalët kyç: kontroll abstrakt, kërkesë institucionale, marrëveshje ndërkombëtare, ratifikim, demarkacion, e pranueshme, ratione materiae.

Parashtruesit e kërkesës e kanë dorëzuar kërkesën në Gjykatë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-060 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi. Ata pretendojnë se procedura e ndjekur për miratim si dhe përmbajtja e Ligjit për Ratifikimin e Demarkacionit, janë në kundërshtim me nenet 1 [Përkufizimi i Shtetit], 2 [Sovraniteti], 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare], 125 [Parimet e Përgjithshme], 126 [Forca e Sigurisë e Kosovës], 127 [Këshilli i Sigurisë i Kosovës], 128 [Policia e Kosovës] dhe 129 [Agjencia e Kosovës për Inteligjencë] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Gjykata e ka deklaruar kërkesën të pranueshme për shkak se parashtruesit ishin palë të autorizuara sipas nenit 113.5 të Kushtetutës, e kishin dorëzuar kërkesën brenda afatit prej 8 (tetë) ditësh siç kërkohet me nenin 113.5 të Kushtetutës, dhe kishin respektuar kriteret e parapara me nenin 42 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

Pas shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, bazuar në praktikën e saj të themeluar gjyqësore, Gjykata rikujtoi se Ligji për Ratifikimin e Demarkacionit dhe Marrëveshja Ndërkombëtare për Demarkacionin janë dy akte të veçanta ligjore. Gjykata rikujtoi se është kompetente në bazë të Kushtetutës që ta vlerësojë "Ligjin" për pajtueshmërinë me Kushtetutën, si në substancën e tij, po ashtu edhe në procedurën e ndjekur për miratimin e tij. Megjithatë, Gjykata rikujtoi se nuk është kompetente që ta vlerësojë substancën e "Marrëveshjes Ndërkombëtare" për pajtueshmërinë me Kushtetutën.

Gjykata konstatoi njëzëri se Ligji nr. 06/L-060 për Ratifikimin e Marrëveshjes dhe procedura për miratimin e tij nuk ishin në kundërshtim me Kushtetutën. Gjykata gjithashtu njëzëri refuzoi kërkesën e parashtruesve për të vlerësuar Marrëveshjen Ndërkombëtare për Demarkacionin e Kufirit Shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi pasi që nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën dhe kështu jashtë fushëveprimit të juridiksionit të Gjykatës.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KO45/18

Parashtrues

Glauk Konjufca dhe
11 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-060 për Ratifikimin e
Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesit e kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Glauk Konjufca, Albin Kurti, Rexhep Selimi, Liburn Aliu, Albulena Haxhiu, Xhelal Sveçla, Arbërie Nagavci, Fitore Pacolli, Shemsi Syla, Ismajl Kurteshi, Valon Ramadani, Salih Zyba (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës), të gjithë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kuvendi).

2. Parashtruesit e kërkesës kanë autorizuar Glauk Konjufcën t'i përfaqësojë ata në procedurën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

Vendimi i kontestuar

3. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e Ligjit nr. 06/L -060 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi (në tekstin e mëtejmë: Ligji për Ratifikimin e Demarkacionit), të miratuar nga Kuvendi më 21 mars 2018.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar për Ratifikimin e Demarkacionit, i cili pretendohet se është në kundërshtim me nenet 1 [Përkufizimi i Shtetit], 2 [Sovraniteti], 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare], 125 [Parimet e Përgjithshme], 126 [Forca e Sigurisë e Kosovës], 127 [Këshilli i Sigurisë së Kosovës], 128 [Policia e Kosovës] dhe 129 [Agjencia e Kosovës për Inteligjencë] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 5 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 42 [Saktësimi i kërkesës] dhe 43 [Afati] i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 36 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 29 mars 2018, parashtruesit parashtruan kërkesën me dokumente të shumta të bashkëngjitura në Gjykatë.

7. Më 29 mars 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani.

8. Më 29 mars 2018, kërkesa u ishte komunikuar: parashtruesve të kërkesës; Presidentit të Republikës së Kosovës; Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kryetari i Kuvendit); Kryeministrit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kryeministri); dhe Sekretariatit të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Sekretariati).

9. Në Letrën drejtuar Presidentit të Republikës së Kosovës është vërejtur se neni 45 paragrafi 2 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese përcakton që Ligji i kontestuar nuk mund të shpallet deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese për çështjen e ngritur. Kryetarit të Kuvendit iu kërkua që ta mundësonte shpërndarjen e kërkesës të gjithë deputetëve të Kuvendit dhe nëse dikush kishte komente që t'i dorëzonte ato deri më 6 prill 2018. Kryeministrit gjithashtu iu dha mundësia që të parashtronte komente deri më 6 prill 2018. Sekretariatit të Kuvendit iu kërkua në mënyrë të veçantë që të dorëzojë në Gjykatë të gjitha dokumentet që mund të jenë relevante për rastin.

10. Më 3 prill 2018, Sekretariati i paraqiti Gjykatës dokumentet si në vijim:

    a. Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi nr. 06/L-060 të 20 shkurtit 2018;

    b. Kërkesën e Kryeministrit (22 shkurt 2018) në Kuvend për të mbajtur seancë të jashtëzakonshme për shqyrtimin e Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi të 20 shkurtit 2018;

    c. Raportin e Komisionit Funksional për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike të 21 shkurtit 2018;

    d. Ftesën dhe rendin e ditës për seancën e jashtëzakonshme plenare të Kuvendit të 22 shkurtit 2018;

    e. Raporti me amendamente i Komisionit Funksional për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investimeve Strategjike të 21 marsit 2018;

    f. Rezolutën e Kuvendit nr. 06-V-090, të 21 marsit 2018 për miratimin e Ligjit nr. 06/L-060 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi;

    g. Ligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi nr. 06/L-060.

11. Sekretariati nuk ka komentuar lidhur me pretendimet e ngritura në kërkesë, por shtoi se nëse ka pasur ndonjë koment nga ana e deputetëve, Gjykata do të informohej në kohën e duhur.

12. Më 6 prill 2018, parashtruesit e kërkesës e dorëzuan një dokument me sqarime shtesë sipas pretendimeve materiale dhe procedurale të ngritura në kërkesën e tyre.

13. Kryeministri ose deputetët e Kuvendit nuk kanë dorëzuar asnjë koment brenda afatit të paraparë.

14. Më 18 prill 2018, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues njëzëri i rekomandoi Gjykatës ta deklarojë kërkesën të pranueshme dhe të vlerësojë meritat e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

15. Më 21 mars 2012, Qeveria miratoi Vendimin për Emërimin e Anëtarëve të Komisionit Shtetëror për Demarkacion dhe Mirëmbajtje të Kufirit Shtetëror nr. 12/67 (në tekstin e mëtejmë: Komisioni për Demarkacion).

16. Më 26 mars 2013, Komisioni për Demarkacionin e Kosovës dhe Komisioni për Demarkacion i Malit të Zi miratuan një Rregullore të Punës së Përbashkët, lidhur me demarkacionin e kufirit shtetëror në mes të Kosovës dhe Malit të Zi.

17. Më 17 korrik 2013, Qeveria miratoi Vendimin nr. 03/14, me të cilin aprovoi Rregulloren e punës së Komisionit për Demarkacion.

18. Më 8 maj 2015, Qeveria miratoi Vendimin nr. 05/28 për vazhdimin e mandatit të anëtarëve të Komisionit për Demarkacion.

19. Më 25 qershor 2015, Kuvendi miratoi Rezolutën nr. 05-R-03 për Demarkacionin e Kufirit në mes të Kosovës dhe Malit të Zi. Me Rezolutë, ndër të tjera, kërkohej që kufiri me Malin e Zi të përcaktohej bazuar në *"linjat administrative të parapara me legjislacionin në fuqi për kufijtë administrativë të RSFJ-së, kufijtë administrativë të territorit të Kosovës të vitit 1974 dhe Kushtetuta aktuale."* Përveç kësaj, ai kërkoi nga Kryeministri i Republikës së Kosovës që të ndërmarrë veprime që sigurojnë që Komisioni për Demarkacion të vë në dispozicion të gjitha diskutimet dhe propozimet e Komisionit për Demarkacion të Malit të Zi dhe se Qeveria *"t' i raportojë Kuvendit para miratimit [Marrëveshjes] ndërkufitare ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi"*.

20. Më 5 gusht 2015, Qeveria miratoi Vendimin nr. 01/43, me të cilin aprovoi në parim iniciativën për Marrëveshje për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi. Me vendim detyrohej

Ministria e Punëve të Jashtme të ndërmarrë veprime për të nënshkruar marrëveshjen në pajtim me Ligjin nr. 04/L-052 për Marrëveshje Ndërkombëtare.

21. Më 20 gusht 2015, Presidenti i Republikës së Kosovës, me kërkesë të Qeverisë, autorizoi Ministrin e Punëve të Jashtme dhe Ministrin e Punëve të Brendshme të ndërmarrin veprime për nënshkrimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi.

22. Më 26 gusht 2015, ministrat përkatës të Punëve të Jashtme dhe ministrat e Punëve të Brendshme të të dy vendeve nënshkruan Marrëveshjen për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi. Kjo marrëveshje u hartua në bazë të punës së përbashkët të Komisionit të Demarkacionit të Republikës së Kosovës dhe Komisionit të Demarkacionit të Malit të Zi.

23. Më 22 shtator 2017, pas zgjedhjeve parlamentare të 11 qershorit 2017, Qeveria e re vendosi (Vendimi nr. 01/04) të emërojë anëtarët e rinj të Komisionit të Demarkacionit dhe kështu shkarkoi anëtarët e Komisionit të mëparshëm të Demarkacionit.

24. Më 3 tetor 2017, Qeveria vendosi (Vendimi nr. 01/06), të autorizojë Komisionin e ri të Demarkacionit për të vlerësuar punën e atij të mëparshëm.

25. Më 4 dhjetor 2017, Komisioni i Demarkacionit i paraqiti Qeverisë Raportin për Vlerësimin e Punës së Komisionit të mëparshëm të Demarkacionit, duke vënë në dukje gabimet që pretendohet se janë kryer prej tij.

26. Më 4 dhjetor 2017, Qeveria miratoi (Vendimi nr. 02/17) Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi (në tekstin e mëtejmë: Projektligji për Ratifikimin e Demarkacionit), si dhe Raportin e Komisionit të Demarkacionit të përmendur më lart. Në pajtim me këtë vendim, Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit e procedoi Projektligjin për Ratifikimin e Demarkacionit për shqyrtim dhe miratim nga Kuvendi.

27. Më 5 dhjetor 2017, Projektligji për Ratifikimin e Demarkacionit u dorëzua nga Kryetari i Kuvendit tek deputetët e Kuvendit. Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike (në tekstin e mëtejmë: Komisioni i Punëve të Jashtme) ishte i ngarkuar për

shqyrtimin e Projektligjit për Ratifikimin e Demarkacionit dhe për të paraqitur Raportin me Rekomandime.

28. Më 16 shkurt 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Presidenti i Malit të Zi nënshkruan një Deklaratë të përbashkët. Ajo parashihte që Republika e Kosovës dhe Mali i Zi të krijojnë një Grup të përbashkët punues për përcaktimin e kufirit në pajtim me Projektligjin për Ratifikimin e Demarkacionit, për ta vlerësuar atë dhe për të korrigjuar gabimet e mundshme në disa pjesë të kufirit shtetëror në mes të Kosovës dhe Malit të Zi.

29. Më 20 shkurt 2018, Kryeministri kërkoi që seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të mbahej më 22 shkurt 2018, në orën 11:00 në lidhje me draftin e Ligjit për Ratifikimin e Demarkacionit.

30. Më 21 shkurt 2018, në bazë të kërkesës së Kryeministrit, Kryesia e Kuvendit vendosi që seanca e jashtëzakonshme do të mbahet më 22 shkurt 2018, në orën 11:00. Megjithatë, për shkak të mungesës së kuorumit, seanca ishte shtyrë.

31. Më 27 shkurt 2018, Kryesia e Kuvendit vendosi që vazhdimi i seancës së shtyrë të jashtëzakonshme do të mbahet më 28 shkurt 2018, në orën 10:00. Megjithatë, për shkak të mungesës së kuorumit, seanca ishte shtyrë përsëri.

32. Më 15 mars 2018, Kryesia e Kuvendit vendosi që vazhdimi i seancës së jashtëzakonshme mbi draftin e Ligjit për Ratifikimin e Demarkacionit do të mbahej më 20 mars 2018. Rrjedhimisht, diskutimi filloi në orën 16:00 dhe vazhdoi deri në orën 01:00 të 21 marsit 2018, kur Kuvendi votoi për shtyrjen e votimit mbi Projektligjin për Ratifikimin e Demarkacionit dhe për të vazhduar seancën më 21 mars 2018, në orën 11:00.

33. Më 21 mars 2018, Komisioni i Punëve të Jashtme i rekomandoi Kuvendit ta miratojë draftin e Ligjit për Ratifikimin e Demarkacionit dhe propozoi një Amendament:

"Neni 3 i Projektligjit ndryshohet si në vijim:

Neni 3

1. *Pjesë përbërëse e këtij ligji janë:*

1.1. Marrëveshja për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, e nënshkruar në Vjenë me datë 26 gusht 2015;

1.2. Deklarata e përbashkët e Presidentit të Republikës së Kosovës Hashim Thaçi dhe Presidentit të Malit të Zi Filip Vujanoviç nënshkruar më 16.02.2018.

1.3. Të dhënat zyrtare të Komisionit Shtetëror për demarkacionin e Kufirit Shtetëror - për orientim".

34. Më 21 mars 2018, në orën 11:00, Kuvendi vazhdoi me votimin e draftit të Ligjit për Ratifikimin e Demarkacionit. Megjithatë, ai u ndërpre për shkak të përdorimit të gazit lotsjellës nga një numër i deputetëve të Kuvendit. Më pas, Kryesia e Kuvendit (Vendimet 06/V-112 dhe 06/V-112), largoi nga pjesëmarrja në seancë të jashtëzakonshme një numër të deputetëve të Kuvendit *"për shkak të hedhjes së gazit lotsjellës në seancën e 21 marsit 2018",* dhe një deputet i Kuvendit *"për shkak të shkatërrimit të pajisjeve të dhomës së seancës plenare".*

35. Më 21 mars 2018, pas disa ndërprerjeve dhe pas ricaktimit pasues të seancës së jashtëzakonshme nga Kryesia e Kuvendit, Kryetari i Kuvendit vazhdoi me miratimin e amendamenteve të propozuara nga Komisioni i Punëve të Jashtme dhe më pas për miratimin e draftit të Ligji për Ratifikimin e Demarkacionit në tërësi. Sipas transkriptove të seancave (22, 23 dhe 28 shkurt 2018 dhe më 20 dhe 21 mars 2018), ishin të pranishëm dhe votuan nëntëdhjetë e një (91) deputetë, tetëdhjetë (80) deputetë votuan për, njëmbëdhjetë (11) deputetë votuan kundër dhe nuk kishte abstenime. Ndryshimi i projektligjit për Ratifikimin e Demarkacionit u miratua në tërësinë e tij.

36. Prandaj, më 21 mars 2018, Kuvendi miratoi Ligjin Nr. 06/L-060 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi (Ligji për Ratifikimin e Demarkacionit).

37. Ligji për Ratifikimin e Demarkacionit e përcakton:

"Neni 1
Ratifikohet Marrëveshja për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, e nënshkruar në Vjenë me datë 26 gusht 2015.

Neni 2
Dispozitat e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, e nënshkruar në Vjenë me datë 26 gusht 2015, nëse ka fakte të reja ligjore, mund të

ndryshohen dhe plotësohen me pëlqimin e palëve. Dispozitat e kësaj marrëveshje mund të ndryshohen sipas procedurës së njëjtë të paraparë për miratim. Me pajtimin e palëve, për ndryshimin e dispozitave të marrëveshjes mund të kërkohet edhe Arbitrazh ndërkombëtar.

Neni 3

2. Pjesë përbërëse të këtij ligji janë:

1.1. Marrëveshja për Kufirin Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, e nënshkruar në Vjenë me datë 26 gusht 2015;

1.2. Deklarata e përbashkët e Presidentit të Republikës së Kosovës Hashim Thaçi dhe Presidentit të Malit të Filip Vujanoviç të nënshkruar më 16.02.2018.

1.3. Të dhënat zyrtare të Komisionit Shtetëror për demarkacionin e Kufirit Shtetëror - për orientim.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës".

Argumentet e paraqitura nga parashtruesit e kërkesës

38. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se procedura e ndjekur për miratim si dhe përmbajtja e Ligjit për Ratifikimin e Demarkacionit, janë në kundërshtim me nenet 1 [Përkufizimi i Shtetit], 2 [Sovraniteti], 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare], 125 [Parimet e Përgjithshme], 126 [Forca e Sigurisë e Kosovës], 127 [Këshilli i Sigurisë i Kosovës], 128 [Policia e Kosovës] dhe 129 [Agjencia e Kosovës për Inteligjencë] të Kushtetutës.

Sa i përket procedurës së ndjekur

39. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se *"[K]ërkesa e dorëzuar në Kuvend [nga Kryeministri] për thirrjen e seancës së jashtëzakonshme nuk përmbush kriterin e përcaktuar në nenin 38 par 3 të Rregullores së Punës se Kuvendit",* sipas të cilit parashihet që kërkesa për seancë të jashtëzakonshme duhet të japë arsyetimin se pse një çështje e caktuar konsiderohet "urgjente". Ata konsiderojnë se dështimi për të dhënë një arsyetim për kërkesën për një seancë të

jashtëzakonshme siç kërkohet me nenin 38 (3) i Rregullores së punës së Kuvendit, gjithashtu çon në shkelje të nenit 69 (4) të Kushtetutës, i cili parasheh se Kuvendi mblidhet në seancë të jashtëzakonshme sipas kërkesës, në mes tjerash, të Kryeministrit.

40. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se që nga koha kur është kërkuar dhe caktuar seanca e jashtëzakonshme, deri në miratimin e Ligjit për Ratifikimin e Demarkacionit, ka kaluar më shumë se një (1) muaj. Kështu, çështja që fillimisht konsiderohej urgjente, por nuk u vendos për më shumë se një (1) muaj, nuk korrespondon me natyrën e 'çështjes urgjente' siç parashihet në nenin 69 (4) të Kushtetutës, në lidhje me nenin 38 (3) të Rregullores së punës së Kuvendit.

41. Parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se Ligji nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare nuk specifikon në asnjë nga dispozitat e tij se "*një marrëveshje ndërkombëtare duhet të ratifikohet (në seancë të jashtëzakonshme) si urgjente*". Kështu, ata konsiderojnë se ratifikimi i një marrëveshjeje ndërkombëtare në seancë të jashtëzakonshme është në kundërshtim me nenin 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] të Kushtetutës, i cili rregullon ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare.

42. Parashtruesit e kërkesës specifikojnë se gjatë diskutimit të Ligjit për Ratifikimin e Demarkacionit që filloi me 20 mars 2018 në orën 16:00, dhe vazhdoi deri më 21 mars në orën 01:00, ishte propozuar që të vazhdojë më 21 mars në orën 11:00. Ky propozim u vu në votim nga Kryetari i Kuvendit dhe "*69 deputetë ishin të pranishëm, 46 votuan* "*Për*" 1 ishte "*Kundër*" dhe "*Abstenimet*" *nuk u numëruan*". Në këtë drejtim, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se duke mos verifikuar nëse të gjithë deputetët që përbënin kuorumin votuan "Për", "Kundër" ose "Abstenim", çoi në shkelje të nenit 69 (3) [Orari i Seancave dhe Kuorumi] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 51 (3) të Rregullores së punës së Kuvendit, që kërkon që ligjet, vendimet dhe aktet e tjera të Kuvendit konsiderohen si të miratuara nëse votohen nga shumica e deputetëve të pranishëm dhe që votojnë.

43. Parashtruesit e kërkesës konsiderojnë më tej se Vendimi 06/V-114 i Kryesisë së Kuvendit për përjashtimin e një numri të deputetëve nga seanca e jashtëzakonshme e 21 marsit 2018, "*për shkak të hedhjes së gazit lotsjellës*", nuk ishte i saktë, sepse shumica e deputetëve të përjashtuar nuk hodhën gaz lotsjellës në seancë. Prandaj, largimi i tyre nga seanca përbën shkelje të *"neneve 18 dhe 80 të Kushtetutës në lidhje me nenin 21 të Rregullores së punës së Kuvendit, për shkak se u është mohuar e drejta për ta shprehur vullnetin e tyre të lirë*" për çështjen që u diskutua dhe u vendos në seancën e 21 marsit 2018.

Në lidhje me substancën e Ligjit për Ratifikimin e Demarkacionit

44. Parashtruesit e kërkesës specifikojnë se Ligji nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror kërkon që Qeveria të emërojë anëtarë të Komisionit të Demarkacionit dhe Mirëmbajtjes së Kufijve Shtetëror, në bazë të "marrëveshjeve ndërkombëtare". Sipas parashtruesve, "marrëveshja ndërkombëtare" e përmendur në nenin 40 të këtij Ligji nënkupton "Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës" (në tekstin e mëtejmë: Pakoja e Ahtisarit). Kështu, ata pretendojnë se i gjithë procesi i demarkacionit të kufirit shtetëror midis Kosovës dhe Malit të Zi duhej të ishte bërë në përputhje me Pakon e Ahtisaarit, i cili kërkonte që vijat kufitare të shënoheshin në përputhje me ato të 31 dhjetorit 1988.

45. Parashtruesit e kërkesës ankohen se Komisioni i Demarkacionit nuk ka ndjekur historinë kushtetuese dhe ligjore të integritetit territorial të Kosovës dhe ka pranuar propozimin e Komisionit të Demarkacionit të Malit të Zi për të përcaktuar vijën kufitare ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi bazuar në kriterin kadastral. Ky kriter është në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare e cila nuk i njeh 'kriteret kadastrale' si kritere të vetme për demarkacionin e kufirit. Kështu, duke injoruar kriteret e '*uti possidetis*' dhe *'kriteret efektive të kontrollit'*, kufiri i përcaktuar është pesë (5) deri në gjashtë (6) kilometra brenda territorit të Kosovës.

46. Lidhur me këtë, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Komisioni i ka tejkaluar kompetencat e veta duke kryer caktimin e një kufiri të ri në vend të kryerjes së demarkacionit të vijës kufitare siç ishte mandatuar me Ligjin për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror. Kështu, Komisioni ka shkelur sovranitetin dhe integritetin territorial të Kosovës, të garantuar me nenin 2, paragrafi 2 [Sovraniteti] i Kushtetutës si dhe nenet 125 [Parimet e Përgjithshme] deri 129 [Agjencia e Kosovës për Inteligjencë] të Kushtetutës, të cilat specifikojnë institucionet kushtetuese të cilat kanë obligime kushtetuese për të mbrojtur kufijtë territorialë të Kosovës.

47. Parashtruesit e kërkesës rikujtojnë Rezolutën e Kuvendit të 25 qershorit 2015 me të cilën kërkohej nga ish-Kryeministri Isa Mustafa që të ndërmarrë masa për të siguruar që Komisioni i Demarkacionit të zbulojë të gjitha diskutimet dhe çështjet e ngritura nga Komisioni i Demarkacionit të Malit të Zi dhe të raportojë para lidhjes së marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi. Ata pretendojnë se Qeveria e Kosovës nuk e respektoi Rezolutën e Kuvendit dhe gjithashtu nuk arriti ta shkarkojë Komisionin e Demarkacionit, edhe

pse Qeveria u informua se Komisioni kishte tejkaluar kompetencat e veta.

48. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Raporti i Komisionit të Demarkacionit i 4 dhjetorit 2017, i cili është pjesë e Ligjit për Ratifikimin e Demarkacionit, argumenton se Marrëveshja për Demarkacionin e Kufirit të 26 gushtit 2015 shkel dispozitën kushtetuese të neneve 1 [Përkufizimi i Shtetit], 2 [Sovraniteti], 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], 125 [Parimet e Përgjithshme] dhe 129 [Agjencia e Kosovës për Inteligjencë] të Kushtetutës, sepse, në vend të demarkacionit të kufijve ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi, ajo përcaktoi kufij të rinj (caktimi i kufijve)).

49. Kështu, deputetët e Kuvendit të cilët votuan për miratimin e Ligjit për Ratifikimin e Demarkacionit, shkelin sovranitetin dhe integritetin territorial të Kosovës, sepse Ligji që ratifikon Marrëveshjen dhe vetë Marrëveshja duhet të jenë në përputhje me elementët përbërës të sovranitetit shtetëror dhe integritetit territorial. Prandaj, çdo ligj, akt nënligjor ose marrëveshje që shkel sovranitetin dhe integritetin territorial të shtetit duhet të shfuqizohet nga një perspektivë kushtetuese dhe ndërkombëtare.

50. Përveç kësaj, në sqarimin e tyre të 6 prillit 2018, parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretendojnë se neni 3 (1 dhe 2) i Ligjit për Ratifikimin e Demarkacionit është kontradiktor, i pakuptueshëm dhe krijon konfuzion. Në lidhje me këtë, parashtruesit specifikojnë se Qeveria *"krijoi qëllimisht konfuzionin, mashtrimin dhe çorientimin e publikut dhe sidomos të deputetëve të Kuvendit, me qëllim që t'i tërheq ata me qëllimin përfundimtar që ata të votojnë"*.

Pranueshmëria e kërkesës

51. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i përmbush kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe siç parashihet më tej me Ligj dhe të përcaktuara në Rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

52. Gjykata i referohet nenit 113 (1) [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton se *"Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar"*.

53. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 113 (5) të Kushtetutës, i cili përcakton se, *"Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit,*

kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur."

54. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se parashtruesit e kontestojnë kushtetutshmërinë e Ligjit për Ratifikimin e Demarkacionit në lidhje me substancën e tij dhe procedurën e ndjekur për miratimin e tij.

55. Gjykata më tej rikujton se kërkesa është dorëzuar nga 12 deputetë të Kuvendit, në pajtim me nenin 113 (5) të Kushtetutës. Prandaj, parashtruesit e kërkesës janë palë e autorizuar.

56. Gjykata merr parasysh nenin 42 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili parasheh:

> *"1. Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 6 të Kushtetutës, ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme:*
>
> > *1.1. emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetushmërin e ligjit apo vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit te Republikës se Kosovës;*
> > *1.2. dispozitat e Kushtetutës apo të ndonjë akti apo ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe*
> > *1.3. paraqitjen e provave mbi të cila mbështetet kontesti."*

57. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës treguan emrat me nënshkrimet e deputetëve, specifikuan ligjin që ata kontestuan, iu referuan dispozitave përkatëse kushtetuese që pretendojnë se janë shkelur dhe kanë paraqitur prova që mbështetin pretendimet e tyre. Prandaj, Gjykata konsideron se janë përmbushur kërkesat e nenit 42 të Ligjit.

58. Lidhur me afatin e përcaktuar prej *"tetë (8) ditëve nga data e miratimit"*, Gjykata vëren se Ligji për Ratifikimin e Demarkacionit është miratuar më 21 mars 2018, ndërsa kërkesa është parashtruar në Gjykatë më 29 mars 2018.

59. Gjykata rikujton që në pajtim me rregullin 27 të Rregullores së punës, afati i fundit për dorëzimin e kërkesës, "*kur periudha shprehet me ditë, ajo duhet të llogaritet duke filluar nga dita pasi kishte ndodhur një ngjarje"*. Në këtë rast, kjo është dita e nesërme pas miratimit të Ligjit për Ratifikimin e Demarkacionit. Prandaj, kërkesa është dorëzuar në afatin e duhur.

60. Gjykata konsideron se nuk ka arsye për ta deklaruar këtë kërkesë të papranueshme. Prandaj, kërkesa është e pranueshme.

Analiza krahasimtare

61. Para se të vlerësojë nëse Ligji i kontestuar për Ratifikimin e Demarkacionit është në përputhje me Kushtetutën, Gjykata rikujton se tashmë ka përdorur analiza krahasuese të hollësishme në rastin e saj nr. KO95/13, *Visar Ymeri dhe 11 deputetë të tjerë*, Aktgjykim i 9 shtatorit 2013.

62. Gjykata thekson se Kushtetutat e vendeve të ndryshme evropiane i qasen çështjes së vlerësimit të kushtetutshmërisë së ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare në mënyra të ndryshme. Këto dallime janë rezultat i mënyrave të ndryshme me të cilat definohet marrëdhënia midis një marrëveshjeje ndërkombëtare dhe rendit juridik të vendit. Ky mund të kuptohet se shtrihet përgjatë një spektri të qasjeve kushtetuese.

63. Në njërën anë qëndron qasja e marrë nga Mbretëria e Bashkuar ku marrëveshjet ndërkombëtare lidhen nga Mbretëresha nëpërmjet Ministrit të saj për Punët e Jashtme dhe Komonveltit (*Commonwealth*) dhe nuk është e domosdoshme që të ratifikohen nga Parlamenti Britanik para se të bëhen të obligueshme për shtetin. Pasi njëherë të lidhen, ato e detyrojnë shtetin vetëm sa i përket marrëdhënieve me shtetet e tjera, dhe nuk kanë fuqi në rendin e brendshëm juridik të Mbretërisë së Bashkuar. Në mënyrë që dispozitat e një marrëveshjeje ndërkombëtare të hyjnë në fuqi brenda rendit juridik vendës, duhet të miratohet legjislacion i veçantë që përmban ato dispozita dhe që përcakton veprimin e tyre brenda rendit juridik vendës. Sapo të inkorporohen nëpërmjet legjislacionit të veçantë, këto dispozita qëndrojnë në një rend juridik më të ulët se Kushtetuta e shtetit.

64. Në anën e kundërt të spektrit, është qasja që ka përqafuar Holanda. Atje, pas ratifikimit nga Parlamenti, marrëveshja ndërkombëtare bëhet e obligueshme për shtetin në marrëdhëniet e tij me vendet e tjera dhe çdo dispozitë e vet-ekzekutueshme e marrëveshjes bëhet e detyrueshme brenda rendit të brendshëm juridik. Për më tepër, dispozitat e marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare janë të një rendi më të lartë juridik, madje, edhe se Kushtetuta e shtetit dhe legjislacioni vendës mund të shqyrtohet nga të gjitha gjykatat përkitazi me pajtueshmërinë e tij me obligimet që dalin nga marrëveshje të tilla ndërkombëtare.

65. Sistemi kushtetues i Kosovës ka specifikat e veta bie në mes të këtyre dy shembujve. Pas ratifikimit nga ana e Kuvendit, një marrëveshje ndërkombëtare bëhet e obligueshme për shtetin në marrëdhëniet e tij me shtetet e tjera dhe marrëveshjet e tilla bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik. Megjithatë, dispozitat e një marrëveshjeje ndërkombëtare, që janë të vet-ekzekutueshme, janë të një rendi më të lartë juridik se legjislacioni i Kosovës, porse qëndrojnë në një rend juridik me të ulët se Kushtetuta e Kosovës, siç përcaktohet me nenin 19 të Kushtetutës. Dispozitat e vet-ekzekutueshme të marrëveshjeve ndërkombëtare mund të zbatohen drejtpërdrejt brenda rendit të brendshëm juridik të Kosovës, por zbatimi i tyre i nënshtrohet Kushtetutës (Shih rastin nr. KO95/13, *Visar Ymeri dhe 11 deputetë të tjerë*, Aktgjykimi i 9 shtatorit 2013, paragrafët 53-69).

Meritat

66. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Ligji për Ratifikimin e Demarkacionit të Kufijve Shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi është në kundërshtim me Kushtetutën, si për nga procedura e ndjekur ashtu edhe për nga substanca e tij.

Sa i përket procedurës së ndjekur për miratimin e ligjit të kontestuar

67. Parashtruesit e kërkesës ankohen se procedura për miratimin e ligjit të kontestuar është në kundërshtim me:

a. Nenin 69 (4) [Orari i Seancave dhe Kuorumi] i Kushtetutës në lidhje me nenin 38 (3) të Rregullores së punës *"... sipas të cilëve kërkesa për seancë të jashtëzakonshme duhet të japë arsyetimin përse çështja e caktuar konsiderohet urgjente"*.

b. Nenin 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] të Kushtetutës, i cili rregullon çështjen e ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare, sepse *"Ligji nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare nuk specifikon në asnjë prej dispozitave të tij se një marrëveshje ndërkombëtare duhet të ratifikohet (në seancë të jashtëzakonshme) si urgjente"*.

c. Nenin 69 (3) [Orari dhe Seancat dhe Kuorumi] i Kushtetutës në lidhje me nenin 51 (3) të Rregullores së punës së Kuvendit, i cili përcakton: "*Kuvendi ka kuorum kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e të gjithë deputetëve të Kuvendit*". Këto nene ishin shkelur sepse nuk u verifikua nëse të gjithë deputetët që përbënin kuorumin votuan "Për", "Kundër" ose "Abstenuan". Përveç kësaj, parashtruesit pretendojnë se

propozimi i ligjit të kontestuar ishte vënë në votim nga Kryetari i Kuvendit dhe *"69 deputetë ishin të pranishëm, 46 votuan "Për", 1 ishte "Kundër" dhe "Abstenimet" nuk u numëruan"*.

d. Nenet 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] dhe 80 [Miratimi i Ligjeve] të Kushtetutës në lidhje me nenin 21 të Rregullores së punës së Kuvendit, sepse: "*atyre (deputetëve) iu mohua e drejta për të shprehur vullnetin e tyre të lirë*". Lidhur me këtë, parashtruesit konsiderojnë më tej se Vendimi 06/V-114 i Kryesisë së Kuvendit për përjashtimin e një numri të deputetëve nga seanca e jashtëzakonshme e 21 marsit 2018, "*për shkak të hedhjes së gazit lotsjellës*" nuk ishte i saktë, sepse shumica e deputetëve të përjashtuar nuk hodhën gaz lotsjellës në seancën e Kuvendit.

68. Megjithatë, Gjykata përsërit se mund të analizojë vetëm hapat e ndërmarrë nga Qeveria dhe Kuvendi për miratimin e ligjit të kontestuar, në bazë të dispozitave përkatëse kushtetuese, përkatësisht procedurës legjislative dhe procesit të duhur.

69. Përkitazi me këtë, Gjykata vëren se kompetencat e Kuvendit janë të përcaktuara në nenin 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës, nga të cilët, për rastin aktual, janë relevantë vetëm paragrafët e tyre 1 dhe 4. Ata parashohin si më poshtë:

> *"Kuvendi i Republikës së Kosovës:*
> *(1) miraton ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme;*
> *[...]*
> *(4) ratifikon traktatet ndërkombëtare;"*

70. Kuvendi, në bazë të kompetencës së tij sipas nenit 65 (1) të Kushtetutës, votoi dhe miratoi Ligjin për Ratifikimin e Demarkacionit, në përputhje me kërkesat për miratimin e një ligji të parapara në paragrafin 1 të nenit 80 [Miratimi i Ligjeve] që përcakton: *"Ligjet, vendimet dhe aktet tjera miratohen nga Kuvendi me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, përveç në rastet kur është ndryshe e përcaktuar me këtë Kushtetutë"*.

71. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu i referohet nenit 18 (1) të Kushtetutës dhe nenit 10 (2) të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, i cili përcakton procedurën për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare. Paragrafi 1 i nenit 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] parasheh si në vijim:

"Kuvendi i Republikës së Kosovës me votat e dy të tretave (2/3) e të gjithë deputetëve ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare për këto çështje:
(1) territorin, paqen, aleancat, çështjet politike dhe ushtarake;
(2) të drejtat dhe liritë themelore;
(3) anëtarësimin e Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare;
(4) marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga ana e Republikës së Kosovës;"

72. Prandaj, ratifikimi i një marrëveshjeje ndërkombëtare për demarkacionin e kufijve të shtetit lidhet me lëndën e territorit të shtetit dhe për këtë arsye del në kuadër të nenit 18 (1) të Kushtetutës. Si e tillë, Marrëveshja për Demarkacion kërkon një shumicë prej dy të tretash në Kuvend për ratifikimin e saj.

73. Sa i përket asaj se cili autoritet i një Shteti ka kompetencë për të lidhur traktatet ndërkombëtare, Gjykata i referohet nenit 2 (c) të Konventës së Vjenës për Ligjin e Traktateve të vitit 1969, i cili përcakton "kompetenca të plota" që nënkupton *"[...] një dokument që del nga autoritetet kompetente të një Shteti ose nga organi kompetent i një organizate ndërkombëtare që përcakton një person apo disa persona për të përfaqësuar shtetin apo organizatën për të negociuar, miratuar apo vërtetuar autenticitetin e tekstit të një marrëveshjeje, për të shprehur pëlqimin e Shtetit apo organizatës për të qenë i detyruar nga dispozitat e një traktati, apo për të përmbushur çdo akt tjetër në lidhje me një traktat"*.

74. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se referencën tek 'autoriteti kompetent' për të lidhur marrëveshje ndërkombëtare, ia lë ligjit të brendshëm të secilit shtet për të përcaktuar autoritetin që mban kompetencat e plota. Zakonisht, këto dokumente dalin nga Kreu i Shtetit (ose dikush tek i cili ka deleguar kompetencat e nevojshme), kreu i qeverisë ose ministri i jashtëm dhe mbajnë simbolin zyrtar dhe, në disa raste, vulën e një vendi.

75. Përveç kësaj, ligji i brendshëm i Kosovës i cili rregullon se cilat institucione janë të autorizuara për të lidhur marrëveshje ndërkombëtare është përcaktuar në nenin 6 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare që deklaron si në vijim:

"[...]
1. Presidenti, Kryeministri dhe Ministri i Punëve të Jashtme kanë të drejtën e kryerjes së të gjitha veprimeve të ndërlidhura me lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës,

në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Konventën e Vjenës për të Drejtën e Traktateve.
2. Shefi i misionit diplomatik të Republikës së Kosovës ose përfaqësuesi i autorizuar i Republikës së Kosovës në një konferencë ndërkombëtare, organizatë ndërkombëtare ose një prej organeve të tyre ka të drejtën e negociimit të lidhjes së marrëveshjes ndërkombëtare të Republikës së Kosovës ose të miratojë tekstin me shtetin në të cilin është akredituar ose në konferencën ndërkombëtare, organizatën ndërkombëtare ose një prej organeve të tyre.
3. Personat tjerë, mund të kryejnë veprime drejt lidhjes së marrëveshjeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës vetëm me kusht që kanë fuqi të deleguara në bazë të ligjit në fuqi dhe procedurës së përcaktuar në nenin 6 të këtij ligji.
[...]"

76. Gjykata vëren se më 25 qershor 2015, Kuvendi miratoi Rezolutën nr. 05-R-03 për Demarkacionin e Kufirit Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi. Përveç kësaj, ai kërkoi nga Kryeministri të ndërmarrë veprime për të siguruar që Komisioni i Demarkacionit t'i vë në dispozicion të gjitha diskutimet dhe propozimet e Komisionit të Demarkacionit të Malit të Zi . Ai gjithashtu kërkoi që Qeveria të raportojë në Kuvend para miratimit të marrëveshjes në mes të Kosovës dhe Malit të Zi.

77. Kështu, filloi një seri veprimesh që përfshinë Kryeministrin, Presidentët përkatës të Kosovës dhe Malit të Zi, ministrat e Punëve të Jashtme dhe të Punëve të Brendshme para se Ligji i kontestuar për Ratifikimin e Demarkacionit, iu paraqit deputetëve të Kuvendit. Më pas, më 21 mars 2018, Kuvendi votoi dhe miratoi Ligjin e kontestuar për Ratifikimin e Demarkacionit.

78. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 10 të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, i cili, përveç që përsërit dispozitën e nenit 18 të Kushtetutës, parasheh:

"
2. Marrëveshjet ndërkombëtare të referuara në paragrafin 1. të këtij neni [10 të Ligjit nr. 04/L-052] *ratifikohen me ligj të votuar nga dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.*
[...]"

79. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se për qëllimet e inkorporimit të Marrëveshjes në rendin juridik të Kosovës, Qeveria është përgjegjëse

të dorëzojë në Kuvend, sipas procedurës së përcaktuar, një projekt të ligjit përkatës, në pajtim me nenin 15 (3) të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare.

80. Neni 15 (3) i Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare thotë si në vijim*:*

> *"Nëse një ligj ose ndonjë akt tjetër ligjor miratohet me qëllim të zbatimit të një marrëveshjeje ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, Qeveria dorëzon në Kuvend, në bazë të procedurës së paraparë, një projekt të ligjit adekuat ose duhet të miratojë një vendim të Qeverisë ose siguron miratimin e ndonjë akti tjetër ligjor në bazë të kompetencave përkatëse".*

81. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se më 4 dhjetor 2017, Qeveria, në bazë të kompetencave të saj sipas nenit 92 (4) [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës dhe në bazë të Vendimit nr. 02/17 propozoi për miratim në Kuvend Projektligjin për Ratifikimin e Demarkacionit.

82. Gjykata i referohet nenit 60 të Rregullores së punës së Kuvendit i cili rregullon miratimin e këtij lloji të ligjeve, i cili është i ndryshëm nga ligjet e tjera dhe përcakton si vijon:

> *"[...]*
> *1. Kuvendi i Republikës së Kosovës, i ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare me ligj, në bazë të nenit 18 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës.*
> *2. Projektligji për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare i përmban tekstin e marrëveshjes ndërkombëtare, arsyet e ratifikimit dhe deklaratën financiare, në rastet kur ka implikime buxhetore.*
> *3. Procedimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare është i veçantë dhe i nënshtrohet vetëm një shqyrtimi.*
> *[...]"*

83. Në këtë drejtim, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet formulimit të nenit 60 (3) i Rregullores, i cili parasheh që *"Procedimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare është i veçantë dhe i nënshtrohet vetëm një shqyrtimi."* Ligjet e tjera të miratuara nga Kuvendi kërkojnë më shumë se një shqyrtim.

Pretendimi për shkelje të nenit 69 (4) të Kushtetutës

84. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkelje te nenit 69 (4) të Kushtetutës, në lidhje me nenin 38 (3) te Rregullores së punës, sepse seanca e jashtëzakonshme ka nevojë për arsyetim se pse një çështje e caktuar është urgjente.

85. Gjykata vëren se neni 69 (4) i Kushtetutës nuk kërkon shprehimisht e as në mënyrë implicite nga aktorët politikë që të ofrojnë justifikim të plotë për të thirrur një mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit. Gjykata është e detyruar të vlerësojë respektimin e procedurës kushtetuese dhe në rastin konkret, Kuvendi ka respektuar dispozitat kushtetuese për miratimin e Ligjit për Ratifikimin e Demarkacionit.

86. Rrjedhimisht, pretendimi për shkeljen e nenit 69 (4) të Kushtetutës është qartazi i pabazuar në bazë kushtetuese.

Pretendimi për shkelje të nenit 18 të Kushtetutës në lidhje me Ligjin për Marrëveshjet Ndërkombëtare nr. 04/L-052

87. Gjykata gjithashtu rikujton që parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkelje të nenit 18 të Kushtetutës, sepse Ligji për Marrëveshjet Ndërkombëtare nr. 04/L-052 nuk parasheh që një marrëveshje ndërkombëtare duhet të ratifikohet (në seancë të jashtëzakonshme) si urgjente.

88. Gjykata vëren se neni 18 i Kushtetutës nuk rregullon ritmin e një çështjeje për t'u shqyrtuar dhe votuar nga deputetët e Kuvendit. Nëse një çështje konsiderohet 'urgjente' apo jo, lihet në diskrecionin e aktorëve politikë. (Shih, *mutatis mutandis*, rasti nr. KO118/16, *Slavko Simiq dhe 10 deputetë të tjerë*, Aktvendim për papranueshmëri, i 31 tetorit 2016 dhe rasti nr. KO120/16, *Slavko Simiq dhe 10 deputetë të tjerë*, Aktvendim për papranueshmëri 1 shkurtit 2017).

89. Gjykata vëren se Ligji për Ratifikimin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare nuk rregullon procedurën për miratimin e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe në veçanti nuk përmend "urgjencën" e miratimit ose "seancën e jashtëzakonshme" nuk është relevant. Kjo është një çështje e prioriteteve legjislative dhe menaxhim i punës së Kuvendit. Kushtetuta rregullon procesin dhe procedurën legjislative.

90. Gjykata konsideron se pretendimi i ngritur nga parashtruesit e kërkesës nuk bie brenda fushëveprimit të procedurave të rregulluara me Kushtetutë. Nuk mund të pritet që secili ligj që merret me çështje

legjislative specifike të parasheh procedurë të veçantë për miratimin e tij. Në fund të fundit, është organi legjislativ ai që vendosë.

88. Prandaj, Gjykata konkludon se procedura dhe miratimi i Ligjit për Ratifikimin e Demarkacionit është në pajtim me Kushtetutën. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson, në përputhje me parimin e hierarkisë së normave, se ligjet i nënshtrohen Kushtetutës dhe jo anasjelltas.

91. Rezulton se pretendimi i parashtruesve për shkelje të nenit 18 të Kushtetutës është qartazi i pabazuar në bazë kushtetuese.

Pretendimi për shkelje të nenit 69 (3) të Kushtetutës

92. Gjykata më tej rikujton se parashtruesit e kërkesës ankohen se është shkelur neni 69 (3) i Kushtetutës, në lidhje me nenin 51 (3) të Rregullores së punës së Kuvendit, sepse nuk është verifikuar nëse kanë votuar të gjithë deputetët që kanë përbërë kuorumin "Për", "Kundër" ose "Abstenim".

93. Gjykata vlerëson se sipas transkriptit të seancës së jashtëzakonshme plenare të Kuvendit, nëntëdhjetë e një deputetë ishin të pranishëm dhe votuan. Tetëdhjetë (80) deputetë votuan për, njëmbëdhjetë (11) deputetë votuan kundër, pa asnjë abstenim. Ligji për Ratifikimin e Demarkacionit u miratua në tërësi. Kështu, procedura legjislative u zhvillua në pajtim me nenin 18 (1) të Kushtetutës, i cili trajton ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare.

94. Rrjedh se pretendimi për shkelje të nenit 69 (3) të Kushtetutës është qartazi i pabazuar në bazë kushtetuese.

Pretendimi për shkelje të nenit 18 të Kushtetutës në lidhje me nenin 21 të Rregullores së punës së Kuvendit

94. Gjykata në fund rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkelje të neneve 18 dhe 80 të Kushtetutës në lidhje me nenin 21 të Rregullores së punës së Kuvendit, sepse deputetëve të larguar u është mohuar e drejta për të shprehur vullnetin e tyre të lirë.

97. Gjykata vëren se ata deputetë u përjashtuan nga seanca e Kuvendit 'për shkak të hedhjes së gazit lotsjellës'. Gjykata konsideron se "hedhja e gazit" nuk hyn në kuadër të kushtetutshmërisë dhe sundimit të ligjit. Sa i përket pohimit se deputetët e larguar faktikisht nuk kishin hedhur ose nuk janë fajtorë për hedhjen e gazit lotsjellës, autoritetet përkatëse duhet që të bëjnë hetimet dhe përfundimet e nevojshme për këtë bazuar në Rregulloren e punës së Kuvendit dhe në legjislacionin tjetër

në fuqi. Prandaj, Gjykata shqyrton kushtetutshmërinë e një procedure legjislative dhe përputhjen e saj me dispozitat përkatëse të Kushtetutës.

98. Në dritën e shqyrtimeve të mësipërme, Gjykata vëren se Kuvendi ka ndjekur procedurat e parapara në paragrafin 1 dhe 4 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] dhe paragrafin 1 të nenit 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] të Kushtetutës, nenin 10 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare] të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe rregullin 60 të Rregullores së punës së Kuvendit.

99. Rezulton se ky pretendim për shkelje të nenit 18 të Kushtetutës është qartazi i pabazuar në bazë kushtetuese.

Përfundim lidhur me procedurën e ndjekur

100. Prandaj, sa i përket pjesës së kërkesës në lidhje me ankesën procedurale për miratimin e Ligjit për Ratifikimin e Demarkacionit, Gjykata konkludon se procedura e ndjekur për miratimin e Ligjit të kontestuar është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Sa i përket substancës së Ligjit të kontestuar

101. Parashtruesit ankohen në lidhje me standardet e përdorura nga Komisioni për Demarkacion dhe tejkalimin e pretenduar të mandatit të dhënë kushtetues që rezulton në shkelje të Kushtetutës.

102. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se "*marrëveshjet ndërkombëtare shërbejnë për plotësimin e një nevoje themelore të shteteve për të rregulluar, me pëlqim, çështjet e shqetësimit të përbashkët, dhe kësisoj të sjellin stabilitet në marrëdhëniet e tyre reciproke. Pra, marrëveshjet ndërkombëtare janë instrument për të siguruar stabilitet, besueshmëri dhe rend në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe, rrjedhimisht, marrëveshjet gjithmonë kanë qenë burim kryesor i marrëdhënieve juridike ndërmjet shteteve"* (Gjykata Kushtetuese, rasti nr. KO95/13, *Visar Ymeri dhe 11 deputetë të tjerë*, Aktgjykim i 9 shtatorit 2013, paragrafi 94).

103. Në lidhje me këtë, Gjykata shqyrton nëse është kompetente në bazë të Kushtetutës për të trajtuar këto ankesa. Siç u përmend më lart në analizën krahasimtare, janë disa kushtetuta që i japin kompetenca Gjykatës Kushtetuese për të bërë vlerësimin e pajtueshmërisë së marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën. Për shembull, Shqipëria dhe Bullgaria u japin gjykatave të tyre kushtetuese

kompetencë për të bërë vlerësimin e kushtetutshmërisë së një marrëveshjeje ndërkombëtare para ratifikimit të saj, ndërsa Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia dhe Maqedonia janë përcaktuar të mos u japin gjykatave të tyre kushtetuese juridiksion për të vlerësuar marrëveshjet ndërkombëtare. Përveç këtyre, Sllovenia ka përqafuar një sistem të përzier ku, gjatë procedurës së ratifikimit, Gjykata Kushtetuese vlerëson kushtetutshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare nëse shprehimisht kërkohet nga Presidenti, nga Qeveria, apo nga një e treta e deputetëve të Parlamentit (Gjykata Kushtetuese, rasti nr. KO95/13, *Ibidem*, paragrafët 93-101).

104. Kësisoj, analiza krahasimtare zbulon se gjykatat kushtetuese të vendeve të hulumtuara përgjithësisht nuk kanë juridiksion për të vlerësuar kushtetutshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare pas miratimit të ligjit për ratifikim nga Parlamenti. Disa gjykata kushtetuese mund të vlerësojnë kushtetutshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare para ratifikimit të tyre bazuar në një fuqizim të qartë me Kushtetutë.

105. Gjykata konsideron se Ligji për Ratifikimin e Demarkacionit dhe Marrëveshja Ndërkombëtare për Demarkacionin janë dy akte të veçanta ligjore. Secili prej këtyre akteve ndjek një procedurë tjetër ligjore. Sa i përket miratimit të Ligjit për Ratifikimin e Demarkacionit nga ana e Kuvendit, Gjykata vëren se ky Ligj është miratuar me shumicë të kërkuar prej dy të tretave (2/3) dhe vetëm me një lexim, siç kërkohet me Kushtetutë. Prandaj, Gjykata konsideron se miratimi i Ligjit për Ratifikimin e Demarkacionit nga Kuvendi është bërë në përputhje me dispozitat procedurale të Kushtetutës.

106. Përveç kësaj, Gjykata konsideron se qëllimi i ligjit të kontestuar është të përcaktojë karakterin ndërkombëtar të Marrëveshjes për Demarkacionin e Kufijve Shtetëror dhe të inkorporojë Marrëveshjen në sistemin juridik të Republikës së Kosovës dhe ta forcojë shtetësinë e saj.

107. Sa i përket substancës së Marrëveshjes Ndërkombëtare për Demarkacionin e Kufijve Shtetëror, Gjykata vëren se asnjë nen i Kushtetutës nuk parasheh vlerësimin e kushtetutshmërisë së substancës së marrëveshjeve ndërkombëtare nga Gjykata.

108. Në këto rrethana rezulton që, në bazë të Kushtetutës, Gjykata ka juridiksion për të shqyrtuar Ligjin për Ratifikimin e Demarkacionit, por nuk është e autorizuar për të vlerësuar se a është marrëveshja ndërkombëtare, si e tillë, në përputhje me Kushtetutën (Gjykata Kushtetuese, rasti nr. KO95/13, *Ibidem*, paragrafi 100).

109. Prandaj, Gjykata konkludon se nuk është brenda juridiksionit të saj *ratione materiae* të vlerësojë kushtetutshmërinë e Marrëveshjes Ndërkombëtare për Demarkacionin e Kufijve Shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi.

110. Si përmbledhje, Gjykata e refuzon kërkesën e parashtruesve për të vlerësuar kushtetutshmërinë e Marrëveshjes Ndërkombëtare për Demarkacionin e Kufijve Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, pasi kjo nuk përbën substancën e Ligjit të kontestuar për Ratifikimin e Demarkacionit. Ligji për Ratifikimin e Demarkacionit është në substancë një mjet për ratifikimin e një marrëveshjeje ndërkombëtare, por substanca e vetë marrëveshjes ndërkombëtare nuk bie në kuadër të vlerësimit të kushtetutshmërisë nga Gjykata.

111. Sa i përket substancës përkatëse të Ligjit për Ratifikimin e Demarkacionit, parashtruesit e kërkesës nuk e shtjellojnë veçmas substancën e tij nga objekti i ratifikimit në fjalë, d.m.th. Marrëveshja Ndërkombëtare e Ratifikimit të Kufijve Shtetëror. Gjykata vëren se substanca e Ligjit të kontestuar është përmbajtja e Ligjit si të tillë dhe përsërit se Marrëveshja Ndërkombëtare nuk përbën substancën e tij. Në bazë të këtij arsyetimi, Gjykata konkludon se substanca e Ligjit për Ratifikimin e Demarkacionit nuk bie në kundërshtim me dispozitat kushtetuese, dhe, prandaj është në përputhje me Kushtetutën.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.5 të Kushtetutës, nenet 20, 42 dhe 43 të Ligjit dhe rregullin 36 të Rregullores së punës, më 18 prill 2018,

VENDOS

I. TA DEKLAROJË njëzëri kërkesën të pranueshme;

II. TË DEKLAROJË njëzëri se procedura e ndjekur për miratimin e Ligjit nr. 06/L-060 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Demarkacionin e Kufirit Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi është në pajtim me Kushtetutën;

III. TË DEKLAROJË njëzëri se Ligji nr. 06/L-060 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Demarkacionin e Kufirit Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi nuk është në kundërshtim me Kushtetutën;

IV. TA REFUZOJË njëzëri kërkesën e parashtruesve për të shqyrtuar Marrëveshjen Ndërkombëtare për Demarkacionin e Kufirit Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi pasi që kërkesa nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën dhe kështu jashtë fushëveprimit të juridiksionit të Gjykatës;

V. TË DEKLAROJË se në pajtim me nenin 43 të Ligjit për Gjykatën, Ligji për Ratifikimin e Marrëveshjes për Demarkacionin e Kufirit Shtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, do t'i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje;

VI. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim parashtruesve të kërkesës, Presidentit të Republikës së Kosovës, Kryetarit të Kuvendit të Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës;

VI. TA PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;

VII. TË DEKLAROJË se ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Snezhana Botusharova	Arta Rama-Hajrizi

KI122/17, Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktvendimit Ae. nr. 185/2017 të Gjykatës së Apelit, të 11 gushtit 2017, dhe Aktvendimit IV. EK. C. nr. 273/2016 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të 14 qershorit 2017

KI122/17, parashtrues i kërkesës: Česká Exportní Banka A.S.

Aktgjykim i datës 18 prill 2018

Fjalët kyçe: *res judicata, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siguria juridike, masë e sigurisë, aplikueshmëria e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së në procedura paraprake.*

Parashtruesi i kërkesës ishte një shoqëri e huaj, Česká Exportní Banka A.S., me seli në Republikën Çeke e cila kishte lidhur kontratë pune me një shoqëri vendore, Compact Group Sh.P.K., me seli në Republikën e Kosovës. Palët kontraktuale ishin pajtuar që mosmarrëveshjet e tyre do t'i zgjidhnin përmes arbitrazhit dhe atë në Gjykatën e Arbitrazhit pranë Odës Ekonomike të Republikës Çeke. Kjo e fundit, pas kërkesës së parashtruesit, nxori një Vendim të Arbitrazhit përmes së cilit e detyroi Compact Group Sh.P.K. që t'i paguaj parashtruesit të kërkesës shumën prej 1,364,527.00 € plus kamatëvonesë. Vendimi i Arbitrazhit u vërtetua nga gjykatat e rregullta dhe u shpall si vendim i ekzekutueshëm në Republikën e Kosovës. Për më tepër, u vërtetua edhe Urdhëri Përmbarimor i lëshuar nga Përmbaruesi Privat që kërkonte përmbarimin e Vendimit të Arbitrazhit.

Një ditë pasi që Vendimi i Arbitrazhit u vërtetua si vendim përfundimtar, i detyrueshëm dhe i zbatueshëm në Republikën e Kosovës, Compact Group Sh.P.K. morri Vendim për shpërbërje vullnetare të shoqërisë së tyre. Nëpërmjet këtij vendimi, Compact Group Sh.P.K. deklaroi se nuk kishte asnjë detyrim të papaguar ndaj personave të tretë. Parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, anulimin e Vendimit për shpërbërje vullnetare si të paligjshëm. Përveç kërkesave në padinë e tij kryesore, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata Themelore që të vendosë masë të sigurisë që kishte për qëllim ruajtjen e aseteve dhe mjeteve të nevojshme për ekzekutimin e Vendimit të Arbitrazhit.

Sa i përket kërkesës së parashtruesit për masë të sigurisë, gjykatat e rregullta morën gjithsej tetë vendime. U morën katër grupe të vendimeve në nivel të shkallës së parë dhe të apelit, përkatësisht katër vendime të Gjykatës Themelore dhe katër vendime të Gjykatës së Apelit. Në Gjykatën Kushtetuese u kontestua grupi i katërt i vendimeve. Parashtruesi i kërkesës pretendoi se grupi i katërt i vendimeve i ka cenuar të drejtën për gjykim të drejtë dhe të

paanshëm sepse ato vendime anuluan vendimet e mëhershme për të cilat parashtruesi i kërkesës konsideroi se ishin përfundimtare dhe detyruese, dhe si të tilla, *res judicata*.

Parashtruesi i kërkesës, përveç që kërkoi që vendimet e kontestuara të shpallen të pavlefshme, ai po ashtu kërkoi që vendimet që kishin arritë formën e prerë dhe detyruese, të shpalleshin si vendime *res judicata*. Argumenti kryesor i parashtruesit të kërkesës ishte që Gjykata e Apelit kishte rihapur me vetë-iniciativë dhe përtej kërkesave të palëve ndërgjyqëse, çështje të cilat veçse i kishte konfirmuar vetë përmes një vendimi të saj të mëhershme.

Gjykata Kushtetuese e shpalli kërkesën të pranueshme dhe gjeti shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së sepse konsideroi që, Gjykata e Apelit nuk kishte respektuar parimin e sigurisë juridike si dhe nuk kishte respektuar një vendimi të formës së prerë. Më tutje, Gjykata po ashtu gjeti se Gjykata e Apelit kishte injoruar në tërësi të gjitha pretendimet e parashtruesit në lidhje me çështjet *res judicata* dhe nuk iu ishte përgjigjur argumenteve të parashtruesit lidhur me këtë çështje. Si rezultat i këtyre shkeljeve, Gjykata konstatoi se parashtruesi i kërkesës është privuar nga përfitimi që sjell një vendim përfundimtar dhe i detyrueshëm i gjykatës.

Sa i përket procedurës në tërësi, Gjykata po ashtu shprehu shqetësimin e saj që parashtruesi është i detyruar të ndërmarrë këto procedura shtesë kundër shpërbërjes vullnetare të shoqërisë së padituritë në mënyrë që të realizojë ekzekutimin e një vendimi gjyqësor përfundimtar dhe të detyrueshëm lidhur me Vendimin e saj të Arbitrazhit.

Një pikë tjetër e rëndësishme e këtij Aktgjykimi është që, për herë të parë, Gjykata ka bërë interpretimin e zbatueshmërisë së nenit 31 të Kushtetutës (dhe nenit 6 KEDNJ) në procedurat paraprake. Bazuar në praktikën e GJEDNJ-së (*Micallef kundër Maltës*, kërkesa nr. 17056/06, Aktgjykim, [DHM], 15 tetor 2009), Gjykata vendosi testin dy-hapësh në bazë të të cilit duhet të shqyrtohet zbatueshmëria e këtyre garancive, rast-për-rast.

Përfundimisht, Gjykata e deklaroi kërkesën të pranueshme; konstatoi se ka pasë shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së; konstatoi se grupi i katërt i vendimeve (të kontestuara) janë të pavlefshme dhe nule; konstatoi se Aktvendimi i Gjykatës së Apelit [Ae. nr. 185/2017, i datës 16 dhjetor 2017] është përfundimtar dhe i detyrueshëm, dhe si i tillë *res judicata* lidhur me tri pika specifike, të cilat duhet të ekzekutohen.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI122/17

Parashtrues

Česká Exportní Banka A.S.

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit Ae. nr. 185/2017 të Gjykatës së Apelit, të 11 gushtit 2017, dhe Aktvendimit IV. EK. C. nr. 273/2016 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të 14 qershorit 2017

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Česka Exportní Banka A.S, me seli në Pragë, Republika Çeke (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), e përfaqësuar nga Dastid Pallaska, avokat nga Prishtina.

Vendimet e kontestuara

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, Ae. nr. 185/2017, të 11 gushtit 2017, dhe Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, IV. EK. C. nr. 273/2016, të 14 qershorit 2017.

3. Aktvendimet e kontestuara kanë të bëjnë me kërkesën e parashtruesit për vendosje të masës së sigurisë kundër Compact Group Sh.P.K., në pritje të rezultatit përfundimtar të padisë së tij kryesore në procedurë kontestimore.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara, me të cilat pretendohet se janë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 13 (E drejta për ankim efektiv) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 47 [Kërkesa individuale] dhe 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe paragrafin (1) të rregullit 29 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 11 tetor 2017, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 12 tetor 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Gresa Caka-Nimani.

8. Më 13 tetor 2017, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës si dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore.

9. Më 18 tetor 2017, parashtruesi dorëzoi një përkthim të kërkesës së tij në gjuhën angleze dhe në gjuhën serbe.

10. Më 2 nëntor 2017, Gjykata ia dërgoi një kopje të kërkesës Compact Group Sh.P.K., në cilësinë e palës së interesuar dhe e ftoi atë të paraqesë komente, nëse ka, jo më vonë se më 13 nëntor 2017. Brenda afatit të caktuar, Compact Group Sh.P.K. parashtroi komentet e saj.

11. Më 15 nëntor 2017, Gjykata i dërgoi parashtruesit të kërkesës një kopje të komenteve të parashtruara nga Compact Group Sh.P.K.

12. Më 12 mars 2018, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

13. Më 18 prill 2018, Gjykata, me shumicë votash, e deklaroi kërkesën të pranueshme, dhe me shumicë votash konstatoi se ka pasur shkelje.

Përmbledhja e fakteve

14. Në vitin 2010, parashtruesi i kërkesës arriti një marrëveshje kontraktuale me Compact Group Sh.P.K., shoqëri me seli në Kosovë. Objekti i "Kontratës për punë" kishte të bënte me *"prodhimin, furnizimin, montimin dhe vënien në përdorim të teknologjisë për zgjerimin e impiantit për prodhimin dhe mbushjen e ujit mineral, të tavolinës dhe aromatizues […]."*

15. Palët kontraktuese të sipërpërmendura u pajtuan që çdo mosmarrëveshje që shfaqet midis tyre, nëse nuk zgjidhet në mënyrë miqësore brenda 30 ditëve, mund të paraqitet në arbitrazh në Gjykatën e Arbitrazhit pranë Odës Ekonomike të Republikës Çeke (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Arbitrazhit).

A. Procedurat e arbitrazhit

16. Më 12 qershor 2012, në pajtim me rregullat kontraktuale mbi mosmarrëveshjet, parashtruesi parashtroi padi kundër Compact Group Sh.P.K. para Gjykatës së Arbitrazhit.

17. Më 30 janar 2013, Gjykata e Arbitrazhit nxori Vendim të Arbitrazhit në favor të parashtruesit, ku theksohet si në vijim:

> *I. I padituri* [Compact Group Sh.P.K.] *është detyruar që Paditësit* [Parashtruesit të Kërkesës] *të ia paguaj një shumë prej 1,364,527.00 euro (një milion e treqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e pesëqind e njëzet e shtatë euro) dhe kamatëvonesën […].*
> *II. I padituri është i detyruar të paguajë një gjobë kontraktuale në shumën prej […] brenda 3 (tre) ditëve nga fuqia ligjore e këtij vendimi të arbitrazhit.*
> *III. I padituri është i detyruar të paguajë shpenzimet procedurale që përbëhen nga tarifa e arbitrazhit në shumën prej […]."*

18. Më 13 mars 2014, Gjykata e Arbitrazhit korrigjoi Vendimin e saj të Arbitrazhit, por vetëm sa i përket disa gabimeve teknike dhe numerike

të cilat konsideroheshin se ishin vënë në pah me të drejtë nga Compact Group Sh.P.K..

B. Procedurat për njohjen e Vendimit të Arbitrazhit në Kosovë

19. Më 18 qershor 2014, parashtruesi paraqiti kërkesë për njohjen e Vendimit të Arbitrazhit të lartpërmendur pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore).

20. Më 5 dhjetor 2014, Gjykata Themelore [Aktvendimi I.C. nr. 355/2014] e njohu Vendimin e Arbitrazhit dhe e shpalli atë si një dokument të ekzekutueshëm që mund të zbatohet në Republikën e Kosovës.

21. Më 15 dhjetor 2014, Compact Group Sh.P.K. parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit të sipërpërmendur të Gjykatës Themelore.

22. Më 9 shkurt 2015, Gjykata e Apelit [Aktvendimi Ae. nr. 13/2015] refuzoi ankesën e Compact Group Sh.P.K. dhe vërtetoi Aktvendimin [I.C. nr. 355/2014] e Gjykatës Themelore.

23. Më 20 mars 2015, Aktvendimi për njohjen e Vendimit të Arbitrazhit u vërtetua si vendim përfundimtar, i detyrueshëm dhe i zbatueshëm në Republikën e Kosovës.

C. Procedura pas njohjes së Vendimit të Arbitrazhit

Vendimi për shpërbërjen vullnetare të Compact Group Sh.P.K.

24. Më 21 mars 2015, pas njohjes së Vendimit të Arbitrazhit, aksionarët e Compact Group Sh.P.K., morën Vendim për shpërbërjen vullnetare të shoqërisë së tyre, në të cilin thuhet si më poshtë:

> *"Nga data e miratimit të këtij vendimi, Korporata* [Compact Group Sh.P.K.] *nuk mund të ndërmarrë ndonjë veprim pune përveç veprimeve që lidhen me zbatimin e procedurës vullnetare të shpërbërjes [...].*
>
> *Korporata nuk ka detyrime të papaguara ndaj personave të tretë; megjithatë, të gjithë personat fizikë dhe juridikë, të cilët kanë kërkesa kreditore ndaj Korporatës, njoftohen se do t'i drejtohen likuidatorit në zyrën kryesore të Korporatës [...]*

brenda një afati prej 30 ditësh nga data kur është shpallur njoftimi [...].”

Urdhri për përmbarim të Vendimit të Arbitrazhit

25. Më 26 mars 2015, parashtruesi i kërkesës paraqiti propozim për përmbarimin e Vendimit të vërtetuar të Arbitrazhit te përmbaruesi privat.

26. Të njëjtën ditë, përmbaruesi privat [Urdhri nr. 246/15] miratoi propozimin për përmbarim të parashtruesit të kërkesës kundër Compact Group Sh.P.K. (në tekstin e mëtejmë: Urdhri për përmbarim).

27. Më 7 prill 2015, Compact Group Sh.P.K. paraqiti prapësim kundër Urdhrit për përmbarim pranë Gjykatës Themelore.

28. Më 7 korrik 2015, Gjykata Themelore [Aktvendimi CPK. nr. 40/15] aprovoi prapësimin e paraqitur nga Compact Group Sh.P.K. duke shfuqizuar Urdhrin për përmbarim.

29. Më 24 korrik 2015, parashtruesi i kërkesës, përmes Gjykatës Themelore, parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit të sipërpërmendur të Gjykatës Themelore.

30. Më 13 tetor 2015, duke pasur parasysh se ankesa e parashtruesit nuk ishte dërguar në Gjykatën e Apelit për tre muaj, parashtruesi paraqiti kërkesë urgjente në Gjykatën Themelore për të dërguar ankesën e saj në Gjykatën e Apelit në mënyrë që kjo e fundit të mund të vendoste për këtë çështje.

31. Më 1 mars 2016, Gjykata e Apelit [Aktvendimi Ac. nr. 3865/15] e aprovoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të bazuar dhe ndryshoi Aktvendimin [CPK. nr. 40/15, e 7 korrikut 2015] e Gjykatës Themelore. Përmes këtij vendimi, Gjykata e Apelit e refuzoi prapësimin e parashtruar nga Compact Group Sh.P.K. si të pabazuar.

32. Rrjedhimisht, Urdhri për përmbarim i lëshuar nga përmbaruesi privat u bë i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm (në tekstin e mëtejmë: Urdhri përmbarimor përfundimtar).

Procedura kontestimore kundër Vendimit për shpërbërje vullnetare të Compact Group Sh.P.K.

33. Më 30 maj 2016, parashtruesi kërkoi nga Gjykata Themelore anulimin e Vendimit për shpërbërjen vullnetare të Compact Group Sh.P.K. dhe kompensim për dëmin material.

34. Parashtruesi i kërkesës pretendoi se vendimi për shpërbërjen vullnetare ishte i paligjshëm duke pasur parasysh se: i) ishte lëshuar në bazë të një deklarate të rrejshme të Compact Group Sh.P.K. se nuk kishte ndonjë detyrim financiar ndaj palëve të treta; ii) procedura e shpërbërjes vullnetare nuk ishte kryer në pajtim me ligjin në fuqi; iii) aksionarët e Compact Group Sh.P.K. kanë marrë Vendimin për shpërbërje vullnetare një ditë pasi që vendimi i arbitrazhit ishte vërtetuar si vendim gjyqësor i formës së prerë me qëllim të vetëm për të penguar dhe shmangur përmbarimin e ligjshëm të Vendimit të Arbitrazhit; dhe iv) aksionarët e Compact Group Sh.P.K. kërkuan që të pengojnë ekzekutimin e Vendimi të Arbitrazhit duke transferuar të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të Compact Group Sh.P.K. në një Shoqëri tjetër, respektivisht Adea Group Sh.P.K..

35. Bazuar në këto pretendime, parashtruesi i kërkesës, përmes padisë së tij, kërkoi nga Gjykata Themelore si në vijim:

    i) të anulojë Vendimin për shpërbërje vullnetare si të paligjshëm dhe të pavlefshëm;

    ii) të anulojë të gjitha vendimet dhe njoftimet e Compact Group Sh.P.K. të marra pas Vendimit për shpërbërje vullnetare;

    iii) ta detyrojë, në baza solidare, Compact Group Sh.P.K. dhe aksionarët e tij si dhe Adea Group Sh.P.K. të paguajnë borxhin dhe dëmin material në shumën prej 1,364,527.00 euro si dhe shpenzimet procedurale.

36. Së bashku me kërkesën e tij për anulimin e Vendimit për shpërbërje vullnetare, parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkoi nga gjykatat që t'i ofrojnë atij masë të sigurisë (shih më poshtë në pikën D).

37. Deri më sot, gjykatat e rregullta nuk kanë vendosur për padinë e parashtruesit për anulimin e Vendimit për shpërbërje vullnetare. Të gjitha procedurat në gjykatat e rregullta kanë të bëjnë me masën e sigurisë.

D. Procedura në gjykatat e rregullta lidhur me kërkesën e parashtruesit për masë të sigurisë të parashtruar kundër Compact Group Sh.P.K., aksionarëve të Compact Group Sh.P.K., dhe Adea Group Sh.P.K.

38. Siç u tha më lart, së bashku me padinë e tij për anulimin e Vendimit për shpërbërje vullnetare, parashtruesi gjithashtu parashtroi kërkesë për masë të sigurisë kundër Compact Group Sh.P.K., kundër aksionarëve të Compact Group Sh.P.K. dhe kundër të sapo themeluarës Adea Group Sh.P.K..

39. Përmes kërkesës për masë të sigurisë, parashtruesi kërkoi nga Gjykata Themelore:

a. bllokimin/ngrirjen e llogarive bankare të Compact Group Sh.P.K.;

b. bllokimin/ngrirjen e llogarive bankare të aksionarëve të Compact Group Sh.P.K;

c. ndalimin e tjetërsimit, fshehjes, ngarkimit dhe/ose disponimit të pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme të Compact Group Sh.P.K. dhe aksionarëve të saj;

d. ndalimin e çdo ndryshimi statusor të bërë nga aksionarët e Compact Group Sh.P.K.; dhe

e. bllokimin/ngrirjen e llogarive bankare të të sapo themeluarës Adea Group Sh.P.K.; ndalimin e tjetërsimit, fshehjes, ngarkimit dhe/ose disponimit të pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme të Adea Sh.P.K.; dhe ndalimin e çdo ndryshimi statusor të bërë nga Adea Group Sh.P.K.

40. Sa i përket kërkesës së parashtruesit për masë të sigurisë, gjykatat e rregullta morën gjithsej tetë vendime. U morën katër grupe të vendimeve në nivel të shkallës së parë dhe të apelit, përkatësisht katër vendime të Gjykatës Themelore dhe katër vendime të Gjykatës së Apelit. Në Gjykatën Kushtetuese po kontestohet grupi i katërt i vendimeve. Parashtruesi i kërkesës pretendon se grupi i katërt i vendimeve i ka cenuar të drejtën për gjykim të drejtë sepse ato vendime anuluan vendimet e mëhershme për të cilat parashtruesi i kërkesës konsideroi se ishin përfundimtare dhe detyruese, dhe si të tilla, *res judicata*. Hollësitë e secilit grup të vendimeve do të pasojnë më poshtë.

Grupi i parë i vendimeve për masën e sigurisë

41. Më 30 qershor 2016, Gjykata Themelore nxori Aktvendimin e saj të Parë për masën e sigurisë [I.C. nr. 273/2016], përmes së cilit ajo e

aprovoi pjesërisht kërkesën e parashtruesit për masë të sigurisë dhe shpalli të pavlefshme tërë procedurat lidhur me shpërbërjen vullnetare të Compact Group Sh.P.K..

42. Më konkretisht, Gjykata Themelore e aprovoi kërkesën e parashtruesit për:

a. bllokimin/ngrirjen e llogarive bankare të Compact Group Sh.P.K.;
b. bllokimin/ngrirjen e llogarive bankare e aksionarëve të Compact Group Sh.P.K.;
c. ndalimin e tjetërsimit, fshehjes, ngarkimit dhe/ose disponimit të pronës së paluajtshme dhe të luajtshme të Compact Group Sh.P.K. dhe të aksionarëve të saj;
d. ndalimin e çdo ndryshimi statusor të bërë nga aksionarët e Compact Group Sh.P.K. Për shkak të miratimit të pjesshëm të kërkesës së parashtruesit, Gjykata Themelore i refuzoi të gjitha kërkesat e parashtruesit që lidheshin me Adea Group Sh.P.K..

43. Kundër Aktvendimit të Parë për masën e sigurisë të Gjykatës Themelore, si parashtruesi i kërkesës, ashtu dhe Compact Group Sh.P.K. parashtruan ankesa në Gjykatën e Apelit. Compact Group Sh.P.K. kërkoi kthimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë për shkak të shkeljeve esenciale të ligjit të procedurës kontestimore. Parashtruesi kërkoi që, përveç miratimit nga ana e Gjykatës Themelore të katër nga pesë kërkesat e tij, që kërkesa e tij e pestë e cila lidhej me Adea Group Sh.P.K të rishqyrtohet dhe të aprovohet nga Gjykata e Apelit.

44. Më 16 gusht 2016, Gjykata e Apelit nxori Aktvendimin e saj Ae. nr. 167/2016 (në tekstin e mëtejmë, Aktvendimi i Parë i Gjykatës së Apelit për masë të sigurisë), duke shfuqizuar në tërësi Aktvendimin e Parë për masë të sigurisë të Gjykatës Themelore dhe duke e kthyer çështjen për rigjykim.

45. Kësisoj, Gjykata e Apelit e refuzoi tërësisht ankesën e parashtruesit, ndërsa e aprovoi ankesën e Compact Group Sh.P.K. si të bazuar. Me vendimin e saj, Gjykata e Apelit e ktheu çështjen për rigjykim në Gjykatën Themelore për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore.

46. Gjykata e Apelit konsideroi se Gjykata Themelore nuk arriti të: i) qartësojë çështjen e juridiksionit lëndor lidhur me anulimin e Vendimit për shpërbërje vullnetare të Compact Group Sh.P.K.; ii)

sqarojë legjitimitetin e aksionarëve të Compact Group Sh.P.K., si palë në procedurë; iii) të vlerësojë pranueshmërinë e padisë së parashtruesit. Sipas Gjykatës së Apelit, Gjykata Themelore mund të vendosë për kërkesën e parashtruesit për masë të sigurisë vetëm pasi të jetë përgjigjur dhe të ketë sqaruar pikat e kërkuara nga Gjykata e Apelit.

47. Rrjedhimisht, Gjykata e Apelit e urdhëroi Gjykatën Themelore të ndërmarrë veprimet e mëposhtme në rigjykim:

a) të vlerësojë kompetencën lëndore të gjykatës;
b) të vlerësojë pranueshmërinë e padisë së parashtruesit; dhe
c) të vlerësojë legjitimitetin e aksionarëve të Compact Group Sh.P.K., si palë në procedurë.

Grupi i dytë i vendimeve për masë të sigurisë

48. Më 29 shtator 2016, Gjykata Themelore nxori Aktvendimin e Dytë për masë të sigurisë [I.C. nr. 273/2016], pas kërkesës së Gjykatës së Apelit për rigjykim. Kërkesa e parashtruesit për masë të sigurisë përsëri u aprovua pjesërisht.

49. Në mënyrë identike me Aktvendimin e saj të Parë për masë të sigurisë, Gjykata Themelore miratoi kërkesën e parashtruesit për:

a. bllokimin/ngrirjen e llogarive bankare të Compact Group Sh.P.K.;
b. bllokimin/ngrirjen e llogarive bankare të aksionarëve të Compact Group Sh.P.K.;
c. ndalimin e tjetërsimit, fshehjes, ngarkimit dhe/ose disponimit të pronës së paluajtshme dhe të luajtshme të Compact Group Sh.P.K. dhe të aksionarëve të saj;
d. ndalimin e çdo ndryshimi statusor të bërë nga aksionarët e Compact Group Sh.P.K.

50. Gjykata Themelore, me Aktvendimin e saj të Dytë për masën e sigurisë, edhe një herë, i refuzoi kërkesat e parashtruesit në lidhje me Adea Group Sh.P.K..

51. Gjykata Themelore vlerësoi të trija çështjet për të cilat rasti ishte kthyer në rigjykim nga Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit të saj të Parë për masën e sigurisë.

52. Së pari, lidhur me pikën (a) kompetenca lëndore e gjykatës, Gjykata Themelore shqyrtoi argumentet e parashtruara nga parashtruesi i

kërkesës dhe nga Compact Group Sh.P.K. në seancën e 16 shtatorit 2016 dhe vendosi që "*kompetenca për të vendosur lidhur me padinë e parashtruesit të kërkesës i takon pikërisht* [Gjykatës Themelore] *Departamentit për Çështje Ekonomike*".

53. Së dyti, lidhur me pikën (b) pranueshmëria e padisë së parashtruesit të kërkesës, Gjykata Themelore vlerësoi pranueshmërinë dhe konkludoi se parashtruesi i kërkesës e kishte bërë padinë e tij të besueshme dhe ishin plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 297.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore për vendosjen e masës së sigurisë. Më konkretisht, Gjykata Themelore arsyetoi si në vijim:

> "[Parashtruesi i kërkesës] *e ka bërë të besueshme rrethanën se "Compact Group", ka ngelur në borxh tek* [Parashtruesi i kërkesës] *në shumën prej 1,364,527.00 €, të përcaktuar me vendim të arbitrazhit të huaj, i cili ka kaluar procedurën gjyqësore të njohjes dhe të shpalljes i ekzekutueshëm, dhe ka fituar titullin e dokumentit ekzekutiv në procedurë përmbarimore. Pastaj, parashtruesi i kërkesës e ka bërë të besueshme rrethanën se kundërshtari i sigurimit, "Compact Group", i është shmangur vazhdimisht ekzekutimit vullnetar të vendimit të arbitrazhit, madje ka bërë transaksione me qëllim që të mos arrihet ekzekutimi* [i Vendimit të Arbitrazhit] *në procedurë përmbarimore [...]."*

54. Së treti, lidhur me pikën (c) legjitimiteti i aksionarëve të Compact Group Sh.P.K., si palë në procedurë, Gjykata Themelore arsyetoi si në vijim:

> *"Pra, ekziston rreziku se pa caktimin e masave të tilla, mund të vështirësohet apo të pamundësohet dukshëm realizimi i kërkesës së* [Parashtruesit të kërkesës]. *Kjo nga fakti se provat e lëndës dëshmojnë se të gjitha veprimet e gjertanishme të kundërshtarit të sigurimit, "Compact Group" dhe aksionarëve të tij kanë qenë të atilla që të krijohet gjendje e insolvencës tek kundërshtaret e sigurimit dhe të shmanget ekzekutimi i vendimit të arbitrazhit. Andaj, nëse nuk ndërmerren në këtë fazë të procedurës masa kufizuese ndaj kundërshtarëve të sigurimit, do të shtohet edhe me tutje rreziku i realizimit të kërkesës së propozuesit të sigurimit, natyrisht, nëse rezulton se është e bazuar. [...]* [Parashtruesi i kërkesës] *ka bërë të besueshme edhe rrethanën se nëse nuk caktohen masat e sigurimit, "Compact Group" dhe aksionarët e saj mund të vazhdojnë me veprime dhe transaksione të ngjashme me qëllim të shmangies së detyrimeve ndaj* [Parashtruesit të kërkesës]*, madje edhe të krijojnë situatën përfundimtare ku nuk*

do të ketë fare mundësi të ekzekutimit të borxhit. Andaj, gjykata ka ardhur në përfundimin se ne këtë situatë është e domosdoshme që të caktohen masat e sigurimit, ashtu siç janë specifikuar në dispozitiv të këtij aktvendimi".

55. Kundër Aktvendimit të Dytë për masë të sigurisë të Gjykatës Themelore, Compact Group Sh.P.K. parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit duke propozuar që Gjykata e Apelit të refuzojë kërkesën e parashtruesit për masë të sigurisë si të palejueshme ose si të pabazuar. Parashtruesi i kërkesës dorëzoi përgjigje në ankesën e Compact Group Sh.P.K. duke kërkuar vërtetimin e Aktvendimit të Dytë për masë të sigurisë të Gjykatës Themelore.

56. Më 16 dhjetor 2016, Gjykata e Apelit nxori Aktvendimin e saj Ae. nr. 241/2016 (në tekstin e mëtejmë: Aktvendimi i Dytë i Gjykatës së Apelit për masë të sigurisë).

57. Gjykata e Apelit pjesërisht aprovoi ankesën e Compact Group Sh.P.K.. Gjykata e Apelit e ktheu çështjen në rigjykim në Gjykatën Themelore vetëm lidhur me një pikë, më konkretisht me pikën (ii) bllokimin/ngrirjen e llogarive bankare të aksionarëve të Compact Group Sh.P.K., pasi që Gjykata e Apelit konsideroi se Gjykata Themelore nuk kishte arsyetuar mjaftueshëm se përse aksionarët e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar duhej mbajtur personalisht përgjegjës në këtë rast.

58. Gjykata e Apelit e refuzoi ankesën e Compact Group Sh.P.K. lidhur me pikat e tjera që ishin miratuar nga Gjykata Themelore dhe vërtetoi pikat si në vijim:

i) bllokimin/ngrirjen e llogarive bankare të Compact Group Sh.P.K.;
iii) ndalimin e tjetërsimit, fshehjes, ngarkimit dhe/ose disponimit të pronës së paluajtshme dhe të luajtshme të Compact Group Sh.P.K. dhe të aksionarëve të saj;
iv) ndalimin e çdo ndryshimi statusor të bërë nga aksionarët e Compact Group Sh.P.K..

59. Gjykata e Apelit e arsyetoi vendimin e saj si në vijim:

"Gjykata e Apelit e pranon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se Aktvendimi i atakuar [I.C. nr. 273/2016 të 29 shtatorit 2016 gjegj. Aktvendimi i Dytë për masë të sigurisë i Gjykatës Themelore] *nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës*

kontestimore [...] e po ashtu drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore i vështron gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK [Ligji për Procedurën Kontestimore]*, përveç në pikën I parag.2.*

Gjykata e Apelit mori këtë vlerësim ligjor sepse neni 297.1 pika a) dhe b) të LPK-së përcakton se: Masa e sigurimit mund të caktohet: a) në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij, dhe b) në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit.

Bazuar në dispozitat e sipërcituara për caktimin e masës së sigurimit duhet të plotësohen kushtet ligjore sipas të cilave propozuesi duhet ta bëjë të besueshme ekzistimin e kërkesës respektivisht të dëshmojë se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë dhe me këtë do të pamundësohej realizimi i kërkesës së tij. Në rastin konkret, propozuesi i sigurimit e ka bërë të besueshëm kërkesën e tij për faktin se "Compact Group" sh.p.k., ka mbetur borxh tek propozuesi i sigurimit në shumë prej 1,364,527.00 E, të përcaktuar me vendim të arbitrazhit të huaj, i cili ka kaluar procedurën gjyqësore të njohjes dhe të shpalljes i ekzekutueshëm dhe ka fituar titullin e dokumentit ekzekutiv në procedurë përmbarimore. Po ashtu paditësi-propozuesi e ka bërë të besueshëm ekzistimin e kërkesës si dhe rrezikun se pa caktimin e masës së sigurimit do të vështirësohej apo pamundësohej realizimi i kërkesës së tij, sepse "Compact Group" i është shmangur vazhdimisht ekzekutimit vullnetar të vendimit të arbitrazhit, madje ka herë transaksione me qëllim që të mos arrihet ekzekutimi as në procedurë përmbarimore, mund të vazhdojnë me veprime dhe transaksione të ngjashme në qëllim që shmangies së detyrimeve ndaj propozuesit të sigurimit, madje edhe të krijojnë situatën përfundimtare ku nuk do të ketë fare mundësi të ekzekutimit të borxhit.

Prandaj gjykata e apelit konsideron se janë plotësuar kushtet e përcaktuara me nenin 297. 1 nën pikën a) dhe b) të LPK-së, që të caktohet masa e sigurimit e, sepse në rastin konkret propozuesi e ka bërë të besueshëm ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij dhe ekziston rreziku se pa caktimin e masës së tillë

[parashtruesit të kërkesës] *do t'i shkaktohej dëm i konsiderueshëm i cili vështirë do të mund të riparohej".*

Grupi i tretë i vendimeve për masë të sigurisë

60. Më 24 shkurt 2017, Gjykata Themelore nxori Aktvendimin e Tretë për masë të sigurisë [I.C. nr. 273/2016], pas kërkesës së Gjykatës së Apelit për rigjykim të një pike specifike. Gjykata Themelore sqaroi se vendimi i saj i mëparshëm është anuluar vetëm në lidhje me (ii) ngrirjen/bllokimin e llogarive bankare të aksionarëve të Compact Group të Sh.P.K..

61. Gjykata Themelore konfirmoi se masat tjera lidhur me masën e sigurisë të aprovuara nga Gjykata Themelore në Aktvendimin e saj të dytë për Masë të sigurisë [I.C. Nr. 273/2016] janë vërtetuar nga Gjykata e Apelit dhe se pjesa tjetër e vendimit mbeti e pashqyrtuar.

62. Gjykata Themelore deklaroi se si rrjedhojë, objekti i çështjes së kësaj procedure të rigjykimit ishte vetëm kërkesa e parashtruesit (ii) për bllokimin/ngrirjen e llogarive bankare të aksionarëve të Compact Group Sh.P.K. Më tutje, ajo përcaktoi që ekzistojnë të gjitha kushtet ligjore për të vendosur këtë masë shtesë të sigurisë dhe se si rezultat kërkesa e parashtruesit duhet të miratohet.

63. Me fjalë të tjera, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit të saj të Tretë për masë të sigurisë, përveç vërtetimit të gjetjeve të Aktvendimit të Dytë për masë të sigurisë të Gjykatës Themelore dhe ato të Aktvendimit të Dytë për masë të sigurisë të Gjykatës së Apelit, gjithashtu miratoi kërkesën e parashtruesit për (ii) bllokimin/ngrirjen e llogarive bankare të aksionarëve të Compact Group të Sh.P.K..

64. Kundër Aktvendimit të Tretë për masë të sigurisë të Gjykatës Themelore, Compact Group Sh.P.K. parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, duke propozuar që Gjykata e Apelit ta refuzojë kërkesën e parashtruesit për masë të sigurisë.

65. Më saktësisht, Compact Group Sh.P.K. paraqiti dy baza të ankesës, konkretisht që:

(1) Gjykata Themelore nuk kishte konstatuar drejt nëse aksionarët e Compact Group Sh.P.K. mund të mbahen personalisht përgjegjës në bazë të ligjit;

(2) padia e parashtruesit të kërkesës në procedurë kontestimore nuk ishte e pranueshme sepse, para ngritjes së padisë në

procedurë kontestimore, parashtruesi i kërkesës është dashur të kontestonte ligjshmërinë e Vendimit për shpërbërje vullnetare pranë Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: ARBK), gjë për të cilën parashtruesi i kërkesës e kishte humbur afatin.

66. Parashtruesi i kërkesës dorëzoi përgjigje në ankesën e Compact Group Sh.P.K. duke kërkuar vërtetimin e Aktvendimit të Tretë për masë të sigurisë të Gjykatës Themelore.

67. Më 30 mars 2017, Gjykata e Apelit [Aktvendimi Ae. nr. 91/2017] aprovoi ankesën e Compact Group Sh.P.K. (në tekstin e mëtejmë: Aktvendimi i Tretë i Gjykatës së Apelit për masë të sigurisë) dhe e ktheu tërë çështjen për rigjykim në Gjykatën Themelore. Sipas fjalëve të Gjykatës së Apelit *"rasti i kthehet gjykatës së shkallës së parë për shqyrtim dhe rivendosje"*.

68. Gjykata e Apelit urdhëroi që gjykimi në Gjykatën Themelore të kryhet nga një gjyqtar tjetër duke pasur parasysh se "*pavarësisht udhëzimeve të dhëna në Gjykatën Themelore*", kjo e fundit ka vazhduar përsëri me të njëjtin qëndrim duke vendosur masë të sigurisë ndaj aksionarëve të Compact Group Sh.P.K.. Gjykata e Apelit konsideroi se Aktvendimi i Tretë për masë të sigurisë i Gjykatës Themelore përmbante shkelje të konsiderueshme të dispozitave të procedurës kontestimore dhe si rrjedhojë e detyroi Gjykatën Themelore të eliminojë mangësitë, respektivisht: të vlerësojë faktet; të vlerësojë kompetencën e saj për të vendosur për çështjen dhe legjitimitetin e të gjitha palëve të përfshira; të vlerësojë pranueshmërinë e kërkesës; dhe të vendosë në mënyrë të drejtë dhe në pajtim me ligjin.

***Grupi i katërt i vendimeve për masë të sigurisë* [Vendimet e kontestuara]**

69. Më 11 maj 2017, Gjykata Themelore mbajti seancë dëgjimore publike, në të cilën ishin të përfaqësuar parashtruesi i kërkesës dhe Compact Group Sh.P.K..

70. Parashtruesi i kërkesës parashtroi që Gjykata e Apelit kishte shkelur nenin 2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, që parasheh se gjykata duhet të vendos brenda kufijve të kërkesave të palëve në procedurë. Gjykata e Apelit po ashtu kishte tejkaluar fushëveprimin e kompetencës së saj, sepse kishte gjetur shkelje të ligjit për çështje për të cilat tashmë kishte vendosur si instancë e fundit. Më konkretisht, parashtruesi i kërkesës theksoi se Gjykata e Apelit në Aktvendimin e saj të Dytë për masë të sigurisë e kishte vërtetuar pranueshmërinë e

padisë së parashtruesit të kërkesës dhe kishte vërtetuar çështjen e kompetencës lëndore. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës ritheksoi se Gjykata e Apelit kishte vërtetuar masën e sigurisë lidhur me tri pika, të cilat rrjedhimisht morën formë të prerë dhe detyruese dhe nuk i nënshtrohen më ankesës.

71. Sipas parashtruesit të kërkesës, ishin vërtetuar këto pika:

> i) bllokimi/ngrirja e llogarive bankare të Compact Group Sh.P.K.;
> iii) ndalimi i tjetërsimit, fshehjes, ngarkimit dhe/ose disponimit të pronës së paluajtshme dhe të luajtshme të Compact Group Sh.P.K. dhe të aksionarëve të saj;
> iv) ndalimi i çdo ndryshimi statusor të bërë nga aksionarët e Compact Group Sh.P.K..

72. Compact Group Sh.P.K. parashtroi se Gjykata e Apelit ka trajtuar ankesën e saj *"brenda pretendimeve të përmbajtura në ankesë dhe se kjo çështje* [siç është ngritur nga parashtruesi i kërkesës] *nuk është objekt i kësaj seance publike."* Më konkretisht, Compact Group Sh.P.K. parashtroi se gjykata e shkallës së parë nuk i kishte respektuar udhëzimet e gjykatës së shkallës së dytë sipas së cilave aksionarët e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar nuk mund të mbahen personalisht përgjegjës për shpërbërjen e një shoqërie. Në rast se konsideronte se shpërbërja nuk ishte bërë në pajtueshmëri me ligjin, parashtruesi i kërkesës është dashur t'ia drejtojë kërkesat e saj ARBK-së në pajtim me nenin 17 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare. Nëse parashtruesi i kërkesës nuk do të ishte i kënaqur me vendimet e ARBK-së, atëherë do të mund të ndiqte procedurat gjyqësore.

73. Parashtruesi i kërkesës u përgjigj duke theksuar se neni 17 i Ligjit për Shoqëritë Tregtare nuk parashihte ndonjë mjet kundër Vendimit për shpërbërje vullnetare, por vetëm lejonte ankesë kundër "*regjistrimit*" të Vendimit për shpërbërje vullnetare, por jo edhe ankesë kundër Vendimit si të tillë.

74. Më 14 qershor 2017, pas përfundimit të seancës dëgjimore publike, Gjykata Themelore nxori Aktvendimin e saj të Katërt për masë të sigurisë [IV. EK. C. nr. 273/2016]. Përmes këtij Aktvendimi, Gjykata Themelore e hodhi poshtë si të parakohshme kërkesën e parashtruesit për masë të sigurisë me arsyetimin se parashtruesi i kërkesës është dashur që së pari të ushtrojë mjetet administrative pranë ARBK-së duke kontestuar veprimet e kësaj Agjencie.

75. Gjykata Themelore dha këtë arsyetim:

"[...] Gjykata duke vepruar sipas udhëzimeve të Gjykatës së Apelit, mori Aktvendim si në dispozitiv [...], dhe atë nga shkaku se:

- [...] [Parashtruesi i kërkesës] *i masës së sigurisë nuk i ka shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike administrative, nga momenti kur ka marr vesh mbi shpërbërjen e Personit Juridik "Compact Group" Sh.P.K., gjegjësisht nuk ka vepruar komfor nenit 17 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, me nr. 02/L123 [...]. Bazuar në dispozitat e nenit 17 të LSHT,* [Parashtruesi i kërkesës] *ka qen dashur që së pari ti shfrytëzoj mjetet juridike- administrative, ta atakoj vendimin mbi shpërbërjen e personit juridik në organet administrative, për anulimin e vendimit mbi shpërbërjen e personit juridik [...] që në momentin kur kanë vërejtur se shpërbërja e tij është bërë në mënyrë të kundërligjshme, apo siç thyhet duke i fshehur obligimet që ka pasur ndaj kreditoreve* [Compact Group sh.p.k] *[...]. Propozuesi* [Parashtruesi i kërkesës], *pasi ti ketë shterrur të gjitha rrugët administrative të ankesës para organeve administrative, tek në fund ka qenë dashur t'i drejtohet Gjykatës, për ta vlerësuar kundërligjshmërinë e Vendimit mbi shpërbërjen vullnetare të personit juridik të lëshuar nga ARBK-ja. Sikur të ishte respektuar një procedure e tillë, Gjykata ka mundur ta merr një vendim që ta zhvleftësoj, ose vërtetoj në tërsi, apo pjesërisht, vendimin e Zyrës se Regjistrimit, po meqë paditësi* [Parashtruesi i kërkesës] *nuk ka vepruar ashtu siç e autorizon neni 17 i LSHT-së, Gjykata konsideron se tash për tash, nuk janë pjekur kushtet që të vendos komfor nenit 17.5 të LSHT-së, andaj edhe në bazë të këtij neni padia na del se është e parakohshme. [...]*

Duke i analizuar te gjitha këto qe u cekën më lartë Gjykata konstaton se:

- Propozuesi i sigurimit [Parashtruesi i kërkesës*] nuk e ka përmbushur kushtin themelor për caktimin e masës së sigurimit, e që është besueshmëria e kërkesëpadisë. [...] Gjykata gjithashtu konsideron se nuk ekzistojnë kushtet ligjore për Caktimin e masës së sigurimit, bllokim i llogarive bankare, aksionarëve vendosja e një mase të tille do të ishte në kundërshtim të plotë me dispozitën e nenit 80 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare. [...]."*

76. Kundër Aktvendimit të Katërt për masë të sigurisë të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit [Ankesa e katërt dhe ankesa e fundit] duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimin jo të plotë dhe të gabueshëm të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Më konkretisht, parashtruesi pretendoi se

Gjykata Themelore përmes Aktvendimit të saj të Katërt për masë të sigurisë *"anuloi në mënyrë të paprecedent një vendim gjyqësor të formës së prerë*" [Aktvendimi i Dytë për masë të sigurisë të Gjykatës Themelore (I.C. nr. 273/2016, të 26 shtatorit 2016)] dhe vendosi përtej "*kërkesave të parashtruara nga palët ndërgjyqëse".*

77. Më saktësisht, parashtruesi i kërkesës pretendoi se Gjykata Themelore i kishte kërkuar të ushtronte një mjet inekzistent, pasi që vetë ARBK nuk merr vendime, por thjesht regjistron vendimet e marra nga shoqëritë. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendoi se, me Aktvendimin e saj të Katërt për masën e sigurisë, Gjykata Themelore e paragjykoi rezultatin përfundimtar të padisë kryesore të parashtruesit duke vendosur se ai "*nuk e ka përmbushur kushtin themelor për caktimin e masës së sigurimit, e që është besueshmëria e kërkesë padisë*."

78. Compact Group SH.P.K. parashtroi përgjigje ndaj ankesës së parashtruesit në lidhje me Aktvendimin e Katërt për masë të sigurisë të Gjykatës Themelore duke kërkuar nga Gjykata e Apelit të refuzojë ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe të konfirmojë Aktvendimin e Katërt për masë të sigurisë të Gjykatës Themelore.

79. Më 11 gusht 2017, Gjykata e Apelit [Aktvendimi Ae. nr. 185/2017] e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar (në tekstin e mëtejmë: Aktvendimi i Katërt i Gjykatës së Apelit për masë të sigurisë) dhe vërtetoi Aktvendimin e Katërt për masë të sigurisë të Gjykatës Themelore.

80. Gjykata e Apelit arsyetoi se parashtruesi i kërkesës po kërkonte të paragjykohej rezultati përfundimtar i padisë së tij kryesore përmes masës së sigurisë. Gjykata e Apelit konsideroi se parashtruesi i kërkesës kishte dështuar të dëshmonte kërkesën e tij për masë së sigurisë sepse nuk kishte prova se Compact Group Sh.P.K. ose aksionarët e saj do të "*ta pamundësonin apo vështirësonin dukshëm realizimin e kërkesës së tij, respektivisht se të njëjtit janë duke ndërmarrë veprime me të cilat do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese e gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat*".

81. Më tutje, Gjykata e Apelit arsyetoi se "*në këtë fazë të procedurës nuk ka asnjë epilog përfundimtar lidhur me realizimin e kërkesës ndaj debitorit "Compact Group" sh.p.k. andaj caktimi i çdo mase të sigurimit ndaj aksionarëve do të paragjykonte çështjen kryesore dhe do të ishte në kundërshtim me nenin 80 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare*".

82. Në fund, Gjykata e Apelit konsideroi pretendimet tjera ankimore të parashtruesit të kërkesës, *"por gjeti se të njëjtat ndërlidhen me çështjen kryesore e jo me besueshmërinë e kërkesës për masë sigurimi, e cila është objekt shqyrtimi në këtë fazë të procedurës. Edhe pse* [parashtruesi i kërkesës] *gjatë procedurës në shkallë të parë dhe në tërë referatin e ankesës, përtej kompetencave të tij, merret me vlerësimin e vendimeve të mëparshme të Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit, në disa raste duke përdorur shprehje që tejkalojnë gjuhën profesionale dhe atakojnë autoritetin e gjykatës, megjithatë pretendimet ankimore i referohen çështjes kryesore e jo kushteve ligjore për caktimin e masës së sigurimit. […]."*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

83. Parashtruesi i kërkesës kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së dy vendimeve, konkretisht Aktvendimit të Katërt për masë të sigurisë të Gjykatës Themelore [IV. EK. C. nr. 273/2016, i 14 qershorit 2017] dhe Aktvendimit të Katërt për masën e sigurisë të Gjykatës së Apelit [Ae. nr. 185/2017, i 11 gushtit 2017].

84. Parashtruesi gjithashtu kërkon që Aktvendimi i Dytë për masë të sigurisë i Gjykatës Themelore [I.C. nr. 273/2016, i 29 shtatorit 2016] dhe Aktvendimi i Dytë për masë të sigurisë i Gjykatës së Apelit [Ae. nr. 241/2016, i 16 dhjetorit 2016] të vërtetohen si vendime të formës së prerë dhe detyruese dhe si të tilla, *res judicata*.

85. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata e Apelit ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, si dhe nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 (E drejta për proces efektiv) të KEDNJ-së.

86. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se Gjykata e Apelit *"shfuqizoi në mënyrë të paprecedent Vendimin I.C. Nr. 273/2016 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështjet Ekonomike, të datës 29 shtator 2016* [Aktvendimin e Dytë për masë të sigurisë të Gjykatës Themelore], *e cila, inter alia, në lidhje me të drejtën e parashtruesit të kërkesës për të paraqitur kërkesë para Gjykatës Themelore […] është konfirmuar me Vendimin Ae. nr. 241/2016 të Gjykatës së Apelit, Departamenti për Çështje Ekonomike, i datës 16 dhjetor 2016 dhe si i tillë paraqet vendimin përfundimtar të gjykatës."*

87. Sa i përket pranueshmërisë së kërkesës, parashtruesi thekson se kërkesa e tij përmbush të gjitha kriteret e pranueshmërisë dhe se Gjykata duhet ta pranojë këtë rast për shqyrtim të meritave në bazë të kritereve të përcaktuara me Aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut [në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ] në rastin *Micallef kundër Maltës* (kërkesa nr. 17056/06). Parashtruesi i kërkesës argumenton se vendimet e kontestuara prekin të drejtat e tij civile dhe, duke pasur parasysh se kjo është kështu, në këtë rast zbatohen garancitë e nenit 6 të KEDNJ-së dhe nenit 31 të Kushtetutës.

88. Më konkretisht në lidhje me meritat e kërkesës, parashtruesi pretendon shkelje të të drejtave:

i) për siguri juridike dhe respektim të një vendim gjyqësor të formës së prerë;
ii) për t'u dëgjuar dhe për një vendim gjyqësor të arsyetuar;
iii) për qasje në gjykatë;
iv) për një gjykatë të paanshme; dhe
v) për një mjet juridik.

i) E drejta për siguri juridike dhe respektim të vendimit gjyqësor të formës së prerë

89. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata e Apelit ka përmbysur një vendim gjyqësor të formës së prerë me vetëiniciativë.

90. Në këtë drejtim, parashtruesi argumenton se Aktvendimi i Dytë për masë të sigurisë së Gjykatës Themelore u vërtetua me Aktvendimin e Dytë për masë të sigurisë së Gjykatës së Apelit.

91. Me Aktvendimin e Dytë për masë të sigurisë, Gjykata e Apelit e njohu juridiksionin ekskluziv dhe kompetencën lëndore të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike për shqyrtimin e padisë dhe vendosjen lidhur me të njëjtën.

92. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi i Dytë për masë të sigurisë i Gjykatës së Apelit vërtetoi këto veprime:

i) bllokimin/ngrirjen e llogarive bankare të Compact Group Sh.P.K.
iii) ndalimin e tjetërsimit, fshehjes, ngarkimit dhe/ose disponimit të pronës së paluajtshme dhe të luajtshme të Compact Group Sh.P.K. dhe të aksionarëve të saj;
iv) ndalimi i çdo ndryshimi statusor të bërë nga aksionarët e Compact Group Sh.P.K..

93. Parashtruesi pretendon se çështjet e lartpërmendura u vendosën me Aktvendimin e Dytë për masën e sigurisë, i cili, pas konfirmimit të këtyre pikave specifike me Aktvendimin e Dytë të Gjykatës së Apelit për masë të sigurisë, mori "*titullin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë.*"

94. Lidhur me këtë, parashtruesi i kërkesës deklaron se *"hedhja poshtë e një vendimi të formës së prerë të gjykatës në këtë rast ka ndodhur pavarësisht faktit se të paditurit* [Compact Group Sh.P.K.] *në ankesën e tyre kundër Vendimit të Tretë për masë të sigurisë nuk ngritën fare shqyrtimin e çështjeve të sipërpërmendura të cilat u vendosën me Vendimin e Dytë për masë të sigurisë dhe të vërtetuara me Vendimin e Dytë të Gjykatës së Apelit për masë të sigurisë".*

95. Në lidhje me të drejtën për siguri juridike dhe respektimin për vendime të formës së prerë të gjykatës, parashtruesi u referohet rasteve të mëposhtme të GJEDNJ-së: rasti i *Brumărescu kundër Rumanisë* (kërkesa nr. 28342/95) duke argumentuar se *"vendimi përfundimtar i gjykatës nuk mund të rihapet dhe/ ose të rishqyrtohet përsëri;"* rastet e *Okyay dhe të tjerët kundër Turqisë* (kërkesa nr. 36220/97), *Agrokompleks kundër Ukrainës* (kërkesa nr. 23465/03) *dhe Tregubenko kundër Ukrainës* (kërkesa nr. 61333/00) duke argumentuar se *"parimi i sigurisë juridike përfaqëson një nga aspektet më të rëndësishme të sundimit të ligjit"* dhe se *"ndalimi për të rihapur vendimin përfundimtar të gjykatës shtrihet te gjykatat dhe/ose gjyqtarët".*

ii) E drejta për t'u dëgjuar dhe e drejta për një vendim të arsyetuar

96. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të së drejtës për t'u dëgjuar dhe për një vendim të arsyetuar bazuar në faktin se *"Vendimet e kontestuara nuk përmendin - e aq më pak adresojnë - pretendimin kryesor të parashtruesit të kërkesës se Vendimi i Dytë për masë të sigurisë, pasi u konfirmua me Vendimin e Dytë të Gjykatës së Apelit për masë të sigurisë, përfaqësonte një* vendim *gjyqësor të formës së prerë"* në lidhje me pikat që tashmë ishin vendosur.

97. Parashtruesi i kërkesës pretendon se kjo pikë esenciale e ankesës ishte e përcaktuar qartë në ankesën që parashtruesi kishte parashtruar dhe që ishte e pranishme në procesverbalin e procedurës së rregullt gjyqësore. Pavarësisht ankesës së tij konkrete për shkeljen e parimit *res judicata* duke hedhur poshtë një vendim përfundimtar, parashtruesi i kërkesës pretendon që Gjykata e Apelit tërësisht e

shpërfilli këtë argument dhe nuk e adresoi fare në asnjë pjesë të arsyetimit të saj.

98. Parashtruesi më tej pretendon se Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit të saj të Katërt për masë të sigurisë, në vend që të japë arsyet për ankesën e saj, *"e ka qortuar parashtruesin për ngritjen e këtij pretendimi, duke deklaruar se parashtruesi nuk ka "kompetencë" për të ngritur padi në lidhje me vendimet gjyqësore dhe duke deklaruar se pretendimet e tilla sulmojnë "autoritetin e gjykatës"".*

99. Në këtë aspekt, parashtruesi pretendon se "*e drejta kushtetuese për një vendim që arsyetohet në mënyrë koherente përfaqëson garancinë kryesore procedurale që mbron individët kundër arbitraritetit të autoriteteve publike, duke përfshirë gjykatat"*. Për të mbështetur pretendimin se është shkelur e drejta e tij për t'u dëgjuar dhe e drejta e tij për një vendim të arsyetuar, parashtruesi i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, konkretisht rasteve *Garcia Ruiz kundër Spanjës* (kërkesa nr. 30544/96); *Pronina v. Ukrainë*s (kërkesa nr. 63566/00); *Nechiporuk dhe Yonkalo v. Ukrainë*s (kërkesa nr. 42310/04); *Mala v. Ukrainës* (kërkesa nr. 4436/07); *Hirvisaari kundër Finlandës* (kërkesa nr. 49684/99); *Hadjianastassiou kundër Greqi*së (kërkesa nr. 12945/87), si dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, përkatësisht rasteve KI72/12 dhe KI132/10.

100. Bazuar në këtë praktikë gjyqësore, parashtruesi pretendon, *inter alia, se "parimi i drejtësisë i mishëruar në nenin 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së gjithashtu preket në qoftë se gjykatat vendase injorojnë një pikë specifike dhe të rëndësishme të bërë nga një palë në rastin";* që gjykatat janë thirrur të japin arsye të hollësishme dhe bindëse *"për refuzimin e tyre për të marrë dëshmi që janë propozuar nga një parashtrues";* se një tjetër funksion i së drejtës për një vendim të arsyetuar është t'u tregojë palëve se janë dëgjuar; dhe se gjykatat *"duhet të japin arsye të tilla që t'u mundësojnë palëve të përdorin në mënyrë efektive çdo të drejtë ekzistuese të ankesës"*.

iii) E drejta e qasjes në gjykatë

101. Parashtruesi pretendon se, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, të vendosur në rastin *Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere kundër Belgjikës* (kërkesat nr. 6878/75 dhe 7238/75), e drejta e qasjes në gjykatë nënkupton edhe të drejtën për të parashtruar padi në gjykatën kompetente, si dhe për marrjen e vendimit për meritat e kërkesës.

102. Lidhur me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes vendimeve të kontestuara, e drejta e tij për të marrë një vendim gjyqësor për meritat e kërkesës ishte mohuar në mënyrë efektive duke deklaruar kërkesën e parashtruesit për masë të sigurisë si të parakohshme dhe duke i kërkuar parashtruesit të kërkesës "*të ndjekë procedura administrative të paidentifikuara"* pranë ARBK-së.

103. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se udhëzimi i gjykatave të rregullta në vendimet e kontestuara se ai duhet të paraqesë kërkesë kundër vendimeve të ARBK-së është i pakuptueshëm duke pasur parasysh se një Agjenci e tillë nuk ka autoritet ligjor për të nxjerrë një vendim për shpërbërjen vullnetare të Compact Group Sh.P.K..

104. Në fund, sa i përket kësaj çështjeje, parashtruesi pretendon se *"mohimi i së drejtës për qasje në gjykatë me vendimet e kontestuara jo vetëm që nuk ka mbështetje ligjore, por - edhe më keq - është në kundërshtim të plotë me një vendim gjyqësor të formës së prerë me të cilin ishin refuzuar si të pabazuara kërkesat/pretendimet e palës kundërshtare* [Compact Group Sh.P.K.] *lidhur me mungesën e juridiksionit ekskluziv lëndor të Gjykatës Themelore në Prishtinë […]."*

iv) E drejta në një gjykatë të paanshme

105. Në lidhje me të drejtën për një gjykatë të paanshme, parashtruesi ngre dy pretendime.

106. Së pari, parashtruesi pretendon se Gjykata Themelore nuk kishte garancitë e nevojshme procedurale për ruajtjen e paanësisë së saj për shkak të presionit të Gjykatës së Apelit për të vendosur çështjen, faktikisht, ashtu siç Gjykata e Apelit e konsideronte atë të përshtatshme dhe të drejtë. Parashtruesi i kërkesës konsideron se *"pikërisht për këtë arsye"* Gjykata Themelore *"iu nënshtrua presionit të lartpërmendur dhe nxori Aktvendimin e Katërt për masa të sigurisë, i cili ishte identik me Aktvendimin e Tretë të Gjykatës së Apelit për masa të sigurisë dhe i cili - nën iluzionin optik të dyshkallshmërisë - u vërtetua me Aktvendimin e Katërt të Gjykatës së Apelit për masa të sigurisë".*

107. Për të mbështetur këtë argument, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata e Apelit, me Aktvendimin e saj të Tretë për masë të sigurisë, i dha udhëzime specifike për vendimmarrje Gjykatës Themelore që çoi në ushtrimin efektiv të funksionit të Gjykatës Themelore. Më tutje, në lidhje me këtë, parashtruesi argumenton se *"përderisa Gjykata e*

Apelit ka një epërsi hierarkike ndaj gjykatave më të ulëta dhe mbi këtë bazë mund edhe të ndryshojë vendimet e gjykatave më të ulëta - Gjykata e Apelit e Kosovës nuk ka të drejtë që nga gjykatat më të ulëta të kërkoj të vendosin në lidhje me vlerësimin e fakteve dhe/ose zbatimin e ligjit material sipas bindjeve të Gjykatës së Apelit të Kosovës".

108. Pretendimi i dytë i parashtruesit ka të bëjë me gjuhën e pretenduar qortuese që Gjykata e Apelit kishte përdorur për të përshkruar pikën specifike të ankesës të parashtruesit, se Gjykata e Apelit kishte përmbysur një vendim gjyqësor të formës së prerë.

109. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi i Katërt për masë të sigurisë i Gjykatës së Apelit shprehu *"indinjatë të qartë"* ndaj parashtruesit të kërkesës vetëm për shkak se parashtruesi i kërkesës *"kishte shpalosur shkeljen e paprecedentë"* të Aktvendimit të Tretë të Gjykatës së Apelit për masë të sigurisë *"me të cilin ishte përmbysur një vendim gjyqësor i formës së prerë".*

110. Parashtruesi i kërkesës pretendon se sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, gjegjësisht *Kyprianou kundër Qipros* (kërkesa nr. 73797/02) GJEDNJ *"ka gjetur se gjykatat e shkelin parimin e paanshmërisë sa herë që në vendimet gjyqësore shprehin ndjenjat personale në lidhje me veprimet e palëve ndërgjyqëse"* sepse reflektimi i ndjenjave të indinjatës është kundër natyrës neutrale dhe të paanshme me të cilin duhet të karakterizohet një vendim i gjykatës.

v) E drejta për mjet juridik

111. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e së drejtës së tij për mjet efektiv juridik, duke konsideruar se mungesa e arsyetimit në Aktvendimin e Katërt për masë të sigurisë së Gjykatës Themelore e ka penguar parashtruesin e kërkesës që të ushtrojë në mënyrë efektive të drejtën e tij për mjet juridik.

Kërkesa e parashtruesit për Gjykatën

112. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata si në vijim:

> *"I. E shpall të pranueshme kërkesën për vlerësim të kushtetutshmërisë të Aktvendimit IV. EK. C Nr. 273/2016 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, të datës 14 qershor 2017 dhe Aktvendimit Ae. Nr. 185/2017 të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Departamenti për Çështje Ekonomike, të datës 11 gusht 2017.*

II. Konstaton se ka pasur shkelje te Nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në lidhje me Nenin 6, paragrafi 1, [E Drejta për një Proces te Rregullt) të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, dhe të Nenit 32 [E Drejta për Mjet Juridik) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
III. I shpall të pavlefshëm Aktvendimin IV. EK. C Nr. 273/2016 të Gjykatës Themelore në Prishtine, Departamenti për Çështje Ekonomike, të datës 14 qershor 2017 dhe Aktvendimin Ae. Nr. 185/2017 të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Departamenti për Çështje Ekonomike, të datës 11 gusht 2017, dhe çështjen ia kthen në rishqyrtim Gjykatës Themelore në Prishtine, Departamentit për Çështje Ekonomike, në pajtim me këtë Aktgjykim.
IV. E vërteton si vendim gjyqësor të formës së prerë Aktvendimin 1. C. Nr. 273/2016 i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, të datës 29 shtator 2016, për çështjet/ pikat që janë vërtetuar me Aktvendimin Ae. Nr. 241/2016 të Gjykatës së Apelit të Kosovës, të datës 16 dhjetor 2016 […]".

Komentet e paraqitura nga Compact Group SH.P.K.

113. Pala e interesuar, respektivisht Compact Group SH.P.K. i rekomandon Gjykatës ta deklarojë kërkesën të papranueshme, sepse: i) argumentet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës kanë të bëjnë me fushën e ligjshmërisë dhe të njëjtat nuk bien nën juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese; dhe ii) Vendimet e kontestuara nuk përbëjnë një vendim përfundimtar në lidhje me meritat e rastit.

114. Sa i përket zbatueshmërisë së garancive të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së në këtë kërkesë, Compact Group SH.P.K. thekson se zbatueshmëria e tillë është *"e padiskutueshme"* siç konfirmohet nga referenca e parashtruesit të kërkesës në rastin e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së *Micallef kundër Maltës* (kërkesa nr. 17056/06). Megjithatë, Compact Group SH.P.K. konsideron se përmbajtja e praktikës gjyqësore së lartpërmendur nuk është ashtu siç është paraqitur nga parashtruesi. Më konkretisht, Compact Group SH.P.K. argumenton se rasti *Micallef kundër Maltës "zbaton parimin se një palë mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese në rast të mohimit të së drejtës së tij për të kërkuar masë të sigurisë me qëllim të sigurimit të kërkesës, por nuk ofron mundësinë për të paraqitur rastin në Gjykatën Kushtetuese vetëm për shkak se gjykata* [gjykatat e rregullta] *nuk vendosin në favor të palës që ka propozuar një masë të sigurisë."*

115. Compact Group Sh.P.K. konsideron se argumentet e parashtruesit të kërkesës se: *"[...] Gjykata e Apelit me Vendimin e Tretë për masa të sigurisë rihapi një rast i cili ishte bërë i formës së prerë dhe kur Gjykata e Apelit duke e kthyer Vendimin e Dytë për masa të sigurisë të Gjykatës Themelore [...] kishte zbatuar gabimisht dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore [...] janë çështje të ligjshmërisë dhe në bazë të funksionit dhe të praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese ato nuk janë objekt i shqyrtimit të Gjykatës Kushtetuese [...]."*

116. Në lidhje me vlerësimin e Compact Group Sh.P.K se vendimet e kontestuara nuk përbëjnë një vendim përfundimtar në lidhje me meritat e rastit, Compact Group Sh.P.K. deklaron: *"Vendimet në fjalë, për shkak të natyrës së tyre që merren me drejtimin e procedurës kontestimore nuk mund të bëhen përfundimtare në aspektin material, meqë subjekti i vendimit nuk do të thotë res judicata, dhe për këtë arsye, gjykata nuk kufizohet në këto vendime. Kjo do të thotë që gjykata mund të ndryshojë këto vendime në çdo kohë kur të plotësohen kushtet ligjore dhe vendosja ndryshe nuk do të thotë të vendoset në kundërshtim me parimin "ne bis in idem", sepse rasti i cili ndryshohet nuk është një çështje e gjykuar."*

Pranueshmëria e kërkesës

117. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

118. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar. [...]*
>
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

119. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton: *"Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme"*.

120. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqes ankesë kushtetuese, duke u thirrur në të drejtat themelore, që vlejnë si për individët ashtu edhe për personat juridikë (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI41/09, parashtruesi i kërkesës *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendimi për papranueshmëri i 27 janarit 2010, paragrafi 14).

121. Gjykata po ashtu i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët parashohin:

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. [...]."

122. Sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret e përcaktuara me nenin 113 (7) të Kushtetutës, pasi është palë e autorizuar, konteston akte të autoriteteve publike, gjegjësisht Aktvendimin e Gjykatës së Apelit [Ae. nr. 185/2017, të 11 gushtit 2017] dhe Aktvendimin e Gjykatës Themelore [IV. EK. C. nr. 273/2016, të 14 qershorit 2017] dhe i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj.

123. Gjykata më tej vëren se parashtruesi i kërkesës në pajtim me nenin 48 të Ligjit ka qartësuar saktësisht të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ, që pretendohet se i janë shkelur, dhe i ka mbështetur pretendimet e tij me referencë specifike në praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ-së. Gjithashtu, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit prej katër (4) muajve të paraparë me nenin 49 të Ligjit.

124. Për sa i përket zbatueshmërisë së nenit 6 të Konventës dhe nenit 31 të Kushtetutës në procedurat paraprake – si ato me të cilat vendoset për kërkesën e parashtruesit për masa të sigurisë, Gjykata vëren se një zbatim i tillë është interpretuar nga GJEDNJ përmes praktikës së saj

gjyqësore. Gjykata, në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejta të Njeriut] të Kushtetutës, është e obliguar të interpretojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë në harmoni me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. Rrjedhimisht, Gjykata do të përcaktojë zbatueshmërinë e nenit 6 të Konventës në lidhje me nenin 31 të Kushtetutës në faktet e kësaj kërkese duke u mbështetur në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së.

(i) Parime të përgjithshme mbi zbatueshmërinë e nenit 6 të KEDNJ-së për procedurat paraprake

125. Gjykata së pari vëren se neni 6 i KEDNJ-së, në pjesën civile, zbatohet në procedurat që përcaktojnë të drejtat ose detyrimet civile (Shih rastin e GJEDNJ-së: *Ringeisen kundër Austrisë*, kërkesa nr. 2614/65, Aktgjykim i 22 qershorit 1972).

126. Gjykata më tutje thekson se procedurat paraprake, si ato që kanë të bëjnë me dhënien e një mase të përkohshme/mase të sigurisë - zakonisht nuk konsiderohen që përcaktojnë të drejta dhe detyrime civile dhe për këtë arsye zakonisht nuk hynë në kuadër të fushëveprimit të mbrojtjes së tillë (shih rastet e GJEDNJ-së: *Wiot v. Francës*, kërkesa nr. 43722/98, Aktgjykimi i 7 janarit 2003; *APIS a.s. kundër Sllovakisë*, kërkesa nr. 39754/98, Vendimi i 13 janarit 2000; *Verlagsgruppe NEWS GmbH kundër Austrisë*, kërkesa nr. 62763/00, Vendimi i 23 tetorit 2003; *Libert kundër Belgjikës*, kërkesa nr. 44734/98, Vendimi i 8 korrikut 2004).

127. Megjithatë, në raste të caktuara, GJEDNJ ka aplikuar nenin 6 të KEDNJ-së në këto procedura paraprake kur konsideroi se masat e sigurisë ishin vendimtare për të drejtat civile të parashtruesit të kërkesës (Shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së: *Aerts kundër Belgjikës*, 25357/94, Aktgjykimi i 30 korrikut 1998; *Boca kundër Belgjikës*, kërkesa nr. 50615/99, Aktgjykimi i 15 nëntorit 2012).

128. Në vitin 2009, GJEDNJ qëllimisht ndryshoi qëndrimin e saj të mëparshëm ndaj procedurave paraprake duke dhënë deklaratën e mëposhtme në përgjigje të pyetjes se a ekziston nevoja për një zhvillim të praktikës gjyqësore:

> *"79. Përjashtimi i masave* të përkohshme *nga fushëveprimi i Nenit 6 deri tani është justifikuar me faktin që ato, në parim, nuk përcaktojnë detyrime dhe të drejta civile. Megjithatë, në kushtet kur shumë Shteteve Kontraktuese u duhet të përballen me një akumulim të konsiderueshëm çështjesh për shkak të mbingarkesës së sistemeve të tyre të drejtësisë, gjë që çon në*

procese të tejzgjatura, vendimi i një gjyqtari për një urdhër ndalues shpesh ndodh që është i barazvlershëm me një vendim për themelin e çështjes për një kohë të konsiderueshme, nganjëherë edhe përgjithmonë. Rrjedhimisht, shumë herë ndodh që procedurat për masa provizore dhe ato në lidhje me veprimin ligjor kryesor vendosin për të njëjtat "detyrime dhe të drejta civile" dhe japin të njëjtat efekte afat-gjata apo edhe të përhershme. (Shih rastin e GJEDNJ-së: *Micallef kundër Maltës*, kërkesa. nr. 17056/06, Aktgjykim, [DHM], 15 tetor 2009, para 79).

129. Bazuar në këtë Aktgjykim, Gjykata vëren se jo të gjitha masat e sigurisë/masat e përkohshme përcaktojnë të drejtat ose detyrimet civile dhe zbatueshmëria e nenit 6 të KEDNJ-së për procedurat paraprake varet nga fakti nëse janë përmbushur disa kushte.

130. Së pari, e drejta në fjalë duhet të jetë "civile", si në shqyrtimin gjyqësor ashtu edhe në procedurat lidhur me masën e sigurisë, brenda kuptimit autonom të këtij nocioni sipas nenit 6 të KEDNJ-së (Shih*, inter alia*, rastet e GJEDNJ-së: *Rafineritë Greke dhe Stratis Andreadis kundër Greqisë*, nr. 13427/87, Aktgjykimi i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 39, *König kundër Gjermanisë*, kërkesa nr. 6232/73, Aktgjykimi i 28 qershorit 1978, paragrafët 89-90, *Ferrazzini kundër Italisë*, kërkesa nr. 44759/98, Aktgjykimi i 15 korrikut 1999, paragrafët 24-31, *Roche v. Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 32555/96, Aktgjykimi i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 119, *Micallef kundër Maltës*, kërkesa nr. 17056/06, Aktgjykim, [DHM], 15 tetor 2009, paragrafi 84).

131. Së dyti, GJEDNJ-ja thekson se duhet të vëzhgohet natyra e masës së përkohshme/masës së sigurisë, meqenëse sa herë që një masë e tillë konsiderohet që përcakton në mënyrë efektive të drejtën civile ose detyrimin në fjalë - neni 6 do të jetë i zbatueshëm (Shih rastin e GJEDNJ-së *Micallef kundër Maltës*, Ibidem, paragrafi 85).

(ii) Zbatimi i parimeve të përmendura më lart në rastin e tanishëm

132. Gjykata vëren se përmbajtja e të drejtës në fjalë, në procedurën kryesore, ka të bëjë me anulimin e Vendimit për shpërbërje vullnetare, e cila është një e drejtë e karakterit civil sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.

133. Qëllimi i masës së sigurisë ishte sigurimi i pretendimit kryesor të parashtruesit, të cilin ky i fundit e konsideronte të domosdoshëm për përmbarimin e Vendimit përfundimtar të Arbitrazhit. Kësisoj, Gjykata vëren se ekzekutimi i Vendimit përfundimtar të Arbitrazhit varet

drejtpërdrejt nga rezultatet e kërkesës për masë të sigurisë në procedurë e tanishme kontestimore.

134. Nga kjo rrjedh që procedurat e masës së sigurisë në rastin konkret i përmbushin kriteret për zbatimin e nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, dhe nuk janë dhënë arsye bindëse nga Compact Group Sh.P.K. për të kufizuar fushëveprimin e një zbatimi të tillë në ndonjë aspekt.

135. Prandaj, Gjykata konkludon që, në dritë të fakteve të kërkesës së tanishme, masa e sigurisë e kërkuar nga parashtruesi i kërkesës mund të konsiderohet që efektivisht përcakton të drejtat e tij civile, dhe në këtë drejtim garancitë e përfshira në nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, zbatohen në këto procedura paraprake.

136. Pas shqyrtimit të ankesave dhe vërejtjeve të parashtruesit, si dhe vërejtjeve të paraqitura nga Compact Group Sh.P.K. si palë e interesuar në këto procedura, Gjykata konsideron se kërkesa ngre çështje serioze të faktit dhe të ligjit të cilat janë të një kompleksiteti të tillë sa që determinimi i tyre varet nga një shqyrtim i meritave të rastit. Prandaj, kërkesa nuk mund të konsiderohet si qartazi e pabazuar në kuptim të rregullit 36 (1) (d) të Rregullores së punës dhe nuk është krijuar asnjë bazë tjetër për ta deklaruar kërkesën të papranueshme. (Shih, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, rasti *A dhe B kundër Norvegjisë*, [DHM], kërkesat nr. 24130/11 dhe nr. 29758/11, Aktgjykimi i 15 nëntorit 2016, paragrafi 55, shih, *mutatis mutandis* rasti i Gjykatës Kushtetuese nr. KI132/15, *Manastiri i Deçanit*, Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 20 majit 2016).

137. Si përmbledhje, Gjykata konstaton se kërkesa është e pranueshme.

Meritat e kërkesës

138. Para se të hyjë në merita të kërkesës, Gjykata vëren se çështjet e mëposhtme nuk janë të kontestueshme para kësaj Gjykate:

a) Parashtruesi i kërkesës ka pasur një kontratë të vlefshme me Compact Group Sh.P.K. që parashihte se kontestet do të trajtoheshin nga Gjykata e Arbitrazhit në Republikën Çeke;
b) Parashtruesi i kërkesës e paraqiti kontestin me Compact Group Sh.P.K. në Gjykatën e Arbitrazhit dhe fitoi Vendimin e Arbitrazhit në shumë prej 1,364,527.00 plus kamatëvonesën;
c) Ky Vendim i Arbitrazhit është i formës së prerë dhe detyrues;

d) Ky Vendim i Arbitrazhit u njoh si i ekzekutueshëm në Kosovë nga gjykatat e rregullta në Kosovë, si në shkallë të parë ashtu edhe në apel;
e) Një Urdhër i vlefshëm për përmbarim u nxor nga Përmbaruesi privat;
f) Ky Urdhër për përmbarim u vërtetua nga gjykatat e rregullta, në shkallë të parë dhe në apel, dhe mori formë të prerë dhe u bë i ekzekutueshëm;
g) Aksionarët e Compact Group Sh.P.K. morën Vendim për shpërbërje vullnetare të Compact Group Sh.P.K.;
h) Parashtruesi i kërkesës inicioi procedurë kontestimore kundër Vendimit për shpërbërje vullnetare;
i) Parashtruesi i kërkesës kërkoi vendosjen e masës së sigurisë deri në përfundim të procedurës kontestimore.

139. Gjykata vëren se ajo çfarë është në rrezik për parashtruesin e kërkesës është disponueshmëria e mjeteve dhe aseteve të mjaftueshme për ekzekutimin e Vendimit të Arbitrazhit.

140. Pas potencimit të këtyre pikave, Gjykata rikujton që parashtruesi pretendon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ; dhe nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 13 (E drejta për ankim efektiv) te KEDNJ-së.

141. Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës thelbësisht pohon se parimi i sigurisë juridike dhe respektimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës është shkelur nga Gjykata e Apelit duke mos respektuar formën e prerë të vendimeve të mëparshme të Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit.

142. Gjithashtu, parashtruesi pohon se Gjykata e Apelit i ka shkelur të drejtën e tij për një vendim të arsyetuar, duke pasur parasysh se argumenti thelbësor i parashtruesit të kërkesës se një vendim *res judicata* është shfuqizuar, është shpërfillur tërësisht nga Gjykata e Apelit.

143. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon shkelje të së drejtës së tij për qasje në gjykatë; të drejtës për një gjykatë të paanshme; dhe të drejtës për mjet juridik.

144. Në rastin në fjalë, Gjykata do të shqyrtojë meritat e kërkesës, në pajtim me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të

Kushtetutës, në lidhje me Nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

145. Gjykata rikujton nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, që përcakton:

> *"1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
>
> *2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj."*

146. Përveç kësaj, neni 6.1 [E drejta për një proces të rregullt] i KEDNJ-së, parasheh:

> *"1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. […]"*

147. Gjykata rithekson se e drejta për siguri juridike dhe respektim të vendimit të formës së prerë, si dhe e drejta për një vendim të arsyetuar, garantohen me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe se zbatueshmëria e tillë është interpretuar, në hollësi, nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së. Kjo Gjykatë, në përputhje me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejta të Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë në harmoni me vendimet e GJEDNJ-së. Rrjedhimisht, Gjykata do të vlerësojë meritat e kërkesës duke u mbështetur në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së.

148. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se ekziston një çështje thelbësore së cilës kjo Gjykatë duhet t'i japë përgjigje, konkretisht nëse Gjykata e Apelit ka shkelur të drejtën e parashtruesit të kërkesës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm në lidhje me sigurinë juridike dhe respektimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë duke shfuqizuar një vendim përfundimtar dhe të detyrueshëm, i cili ishte bërë *res judicata* në lidhje me disa pika specifike.

(i) Parimet e përgjithshme lidhur me të drejtën e sigurisë juridike dhe respektimin e një vendimi gjyqësor të formës

së prerë, siç është zhvilluar nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së

149. Gjykata rikujton që e drejta për gjykim të drejtë kërkon që një çështje që është bërë *res judicata* të konsiderohet e pakthyeshme, në pajtim me parimin e sigurisë juridike. (Shih rastin e GJEDNJ-së: *Brumărescu kundër Rumanisë*, kërkesa nr. 28342/95, Aktgjykimi i 28 tetorit 1999).

150. Gjykata rikujton se GJEDNJ ka dhënë përkufizimin e konceptit *res judicata* (shih rastin *Nikitin kundër Rusisë*, kërkesa nr. 50178/99, GJEDNJ, Aktgjykim i 15 dhjetorit 2004, paragrafi 37) si në vijim:

> *"37. Sipas raportit shpjegues për Protokollin nr. 7, i cili i referohet Konventës Evropiane për Vlefshmërinë Ndërkombëtare të Gjykimeve Penale, "një vendim është final, 'nëse, sipas shprehjes tradicionale, ka fituar fuqinë e res judicata. Ky është rasti kur vendimi është i parevokueshëm, që do të thotë kur nuk ka mjete të mëtejshme të zakonshme në dispozicion ose kur palët i kanë shteruar këto mjete ose kanë lejuar që afati të mbarojë pa i shfrytëzuar ato'".*

151. GJEDNJ ka theksuar se parimi i sigurisë juridike presupozon respektimin e parimit *res judicata* (shih rastin e GJEDNJ *Ponomaryov kundër Ukrainës*, kërkesa nr. 3236/03, Aktgjykimi i 3 prillit 2008, paragrafi 40). Më konkretisht, GJEDNJ-ja pohoi se:

> *"[...] e drejta për një gjykim të drejtë para një tribunali siç garantohet me nenin 6 § 1 të Konventës duhet të interpretohet në dritën e preambulës së Konventës, e cila deklaron, në pjesën e saj përkatëse, që sundimi i ligjit të jetë pjesë e trashëgimisë së përbashkët të Shteteve Kontraktuese. Një nga aspektet themelore të sundimit të ligjit është parimi i sigurisë juridike, i cili presupozon respektimin e parimit res judicata, që është parimi i formës së prerë të vendimeve gjyqësore. Ky parim thekson se asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rishikimin e një vendimi të formës së prerë dhe të plotfuqishëm thjesht për qëllimin e fitimit të rishikimit dhe rishqyrtimit të freskët të rastit. [...] Një shmangie nga ky parim justifikohet vetëm kur bëhet e nevojshme nga rrethanat e një karakteri substancial ose bindës."*

152. GJEDNJ ka shtjelluar parimin e sigurisë juridike në lidhje me të drejtën për gjykim të drejtë edhe në raste të tjera (Shih, për shembull, rastin e GJEDNJ *Ryabykh kundër Rusisë*, kërkesa nr. 52854/99, Aktgjykimi i 24 korrikut 2003, paragrafët 52 dhe 56).

153. Në këtë Aktgjykim, GJEDNJ-ja theksoi sa më poshtë:

> *"52. Siguria juridike presupozon respektimin e parimit të res judicata (ibid., § 62), që është parimi i formës së prerë të aktgjykimeve. Ky parim thekson se asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rishikimin e një aktgjykimi përfundimtar dhe të detyrueshëm vetëm për qëllim të fitimit të një rishqyrtimi dhe një dhe rishqyrtimit të freskët të rastit. Duhet të ushtrohet kompetenca e gjykatave më të larta për të korrigjuar gabimet gjyqësore dhe gabimet e drejtësisë, por jo për të kryer një shqyrtim të ri. Rishikimi nuk duhet të trajtohet si një ankesë e maskuar dhe mundësia e thjeshtë për të pasur dy pikëpamje mbi këtë temë nuk është një bazë për rishqyrtim. Largimi nga parimi justifikohet vetëm nëse një gjë e tillë bëhet e nevojshme nga rrethanat dhe nga karakteri substancial bindës dhe detyrues. [...]*
>
> *56. Gjykata konsideron se e drejta e palës ndërgjyqëse në një gjykatë do të ishte po aq iluzore nëse sistemi ligjor i një Shteti Kontraktues lejon një vendim gjyqësor, i cili ishte bërë i formës së prerë dhe i detyrueshëm për t'u anuluar nga një gjykatë më e lartë sipas një kërkese të bërë nga një zyrtar shtetëror".*

154. Për më tepër, Gjykata rikujton se GJEDNJ ka përcaktuar që, përveç aktgjykimeve përfundimtare për meritat, edhe vendimet paraprake mund të bëhen *res judicata*. Në rastin *Okyay dhe të tjerë kundër Turqisë* (Aktgjykim i 12 korrikut 2005, kërkesa nr. 36220/97, paragrafët 72-75), GJEDNJ theksoi se:

> *"72. Gjykata rikujton se ekzekutimi i një aktgjykimi të nxjerrë nga një gjykatë duhet të konsiderohet si pjesë integrale e "gjykimit" për qëllime të nenit 6 të Konventës (shih Hornsby kundër Greqisë, aktgjykim i 19 marsit 1997, Raportet 1997-II, faqe 511-12, § 40). E drejta e qasjes në gjykatë e garantuar sipas atij neni do të ishte iluzore nëse sistemi ligjor i një Shteti kontraktues do të lejonte që një vendim gjyqësor përfundimtar dhe i ekzekutueshëm ose një urdhër i përkohshëm i nxjerrë në pritje të rezultatit të vendimit përfundimtar të mbetej i paefektshëm në dëm të njërës palë. [...]*
> *73. Gjykata vëren se autoritetet administrative dështuan të respektojnë urdhrin e përkohshëm të Gjykatës Administrative të Aydinit të 20 qershorit 1996 me të cilin pezulloheshin aktivitetet e tri termocentraleve (shih paragrafin 17 më lart). Për më tepër, vendimet e Gjykatës Administrative Supreme me të cilat u vërtetuan aktgjykimet e Gjykatës Administrative të Aydinit të 30 dhjetorit 1996 nuk u zbatuan brenda afatit të përcaktuar.*

Përkundrazi, me një vendim të 3 shtatorit 1996, Këshilli i Ministrave vendosi që tri termocentralet duhet të vazhdojnë punën pavarësisht aktgjykimeve të gjykatave administrative. Ky vendim i fundit nuk kishte bazë ligjore dhe ishte qartazi i paligjshëm në bazë të ligjit vendës (shih paragrafin 57 më lart). Kjo ishte e barazvlershme me anashkalimin e vendimeve gjyqësore. Sipas mendimit të Gjykatës, një situatë e tillë ndikon negativisht në parimin e shtetit të bazuar në ligj, të themeluar mbi sundimin e së drejtës dhe mbi parimin e sigurisë juridike (shih Taşkın dhe të tjerë, të cituar më lart, § 136).
74. Nga sa u tha më lart, Gjykata konsideron se autoritetet nacionale dështuan të respektojnë në praktikë dhe brenda afatit të arsyeshëm aktgjykimet e nxjerra nga Gjykata Administrative e Aydinit më 30 dhjetor 1996 dhe të vërtetuara më pas nga Gjykata Administrative Supreme më 3 dhe 6 qershor 1998, duke i hequr nenit 6 § 1 çdo efekt të dobishëm.
75. Rrjedhimisht ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës."

155. Gjykata Kushtetuese, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, gjithashtu ka shtjelluar çështjen e *res judicata*. Në Aktgjykimin e 17 dhjetorit 2010 në rastin nr. KI08/09, Sindikata e Pavarur e Punëtorëve të Fabrikës së Çelikut IMK Ferizaj, Gjykata theksoi në paragrafët 61 dhe 62:

"61. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson që e drejta e inicimit të procedurës
gjyqësore në raste civile, siç parashihet me nenin 31 të Kushtetutës së Kosovës, si dhe Nenin 6 në lidhje me Nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), do të ishte iluzore, nëse sistemi ligjor i Kosovës do të lejonte një vendim gjyqësor përfundimtar dhe të plotfuqishëm që të mbetej i paefektshëm në dëm të një pale. Do të ishte e pakuptueshme që këto nene t'i përshkruajnë në hollësi garancitë procedurale që i ofrohen palëve në procedurë – procedura që janë të drejta, publike dhe ekspeditive – pa mbrojtjen e zbatimit të vendimeve gjyqësore. Interpretimi i neneve të lartpërmendura si ekskluzivisht të lidhura me qasjen ndaj gjykatës dhe administrimi dhe efektshmëria e procedurave do të kishte mundësi të çonte në situata që nuk janë në përputhje me parimin e sundimit të ligjit, të cilin autoritetet e Kosovës janë të obliguara ta respektojnë (shih, mutatis mutandis, aktgjykimin e ECRtHR-së në rastin Romashov kundër Ukrainës, Parashtresa nr. 67534/01, aktgjykimi i 25 korrikut 2004).

62. Sundimi i ligjit është një prej parimeve themelore të një shoqërie demokratike, presupozon respektimin e parimit të sigurisë juridike, sidomos në lidhje me vendimet gjyqësore që kanë marrë formën res judicata. Asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rishikimin e një aktgjykimi përfundimtar dhe të plotfuqishëm thjesht për qëllimin e fitimit të rishikimit dhe rishqyrtimit të freskët të rastit (shih, për shembull Sovtransavto Holding kundër Ukrainës, nr. 48553/99, § 72,ECHR 2002 VII). Po të mos ishte kështu, kthimi prapa i vendimeve përfundimtare do të çonte në një klimë të përgjithshme të pasigurisë juridike, duke zvogëluar kështu besimin publik në sistemin gjyqësor, si dhe rrjedhimisht edhe në sundimin e ligjit. […].”

156. Për më tepër, në Aktgjykimin e 12 shkurtit 2016 në rastin nr. KI132/15, parashtrues Manastiri i Deçanit, Gjykata theksoi në paragrafët 95-97:

“95. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës ka pasur pritje legjitime që rasti i tij të ishte vendosur në instancën e fundit nga Paneli i pronësisë dhe se ajo nuk ka mundur të rihapet para Kolegjit të Apelit. Si i tillë, parashtruesi duhet të ketë pare aktgjykimet e Kolegjit të Pronësisë të ekzekutuara.

96. Duke u bazuar në këto konsiderata dhe në praktikën e vet gjyqësore, si dhe në atë të GJEDNJ-së, Gjykata konkludon se aktgjykimet e Kolegjit të Apelit, të 27 dhjetorit 2012 (nr. SCC-08-0226 dhe nr. SCC-08-0227), ishin bërë res judicata në bazë të vendimit të mëparshëm të formës së prere dhe të detyrueshëm të Kolegjit të Apelit, të 24 korrikut 2010, në lidhje me palët e autorizuara

97. Duke përdorur procedurën e ankesës për të anuluar këto aktgjykime të Panelit të Pronësisë dhe për të referuar kontestin origjinal të pronësisë përsëri në gjykatat e rregullta, Gjykata konstaton se, me vendimet e tij të 12 qershorit 2015 (nr. AC-I-13-0008 dhe nr. AC-1-13-0009), Kolegji i Ankesave ka cenuar parimin e sigurisë juridike dhe i ka mohuar parashtruesit një gjykim të drejte dhe të paanshëm për të drejtat dhe detyrimet e tij brenda kuptimit të nenit 31, paragrafi 2, të Kushtetutës dhe të nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së”.

157. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se praktika e saj gjyqësore si dhe praktika gjyqësore e GJEDNJ-së e përmendur më sipër, qartë dhe në mënyrë eksplicite, theksojnë se e drejta për gjykim të drejtë sipas nenit 6 të KEDNJ-së dhe nenit 31 të Kushtetutës përfshin parimin e sigurisë

juridike, i cili përfshin parimin që vendimet gjyqësore përfundimtare të cilat janë bërë *res judicata* duhet të respektohen dhe nuk mund të rihapen ose të bëhen objekt i ankesave.

158. Përveç kësaj, Gjykata vëren se parimi *res judicata* aplikohet jo vetëm për vendimet gjyqësore përfundimtare, por edhe për vendimet paraprake që nxirren në pritje të rezultatit të një vendimi përfundimtar.

(ii) Zbatimi i parimeve të lartpërmendura në rastin e tanishëm

159. Në këtë kërkesë çështja kryesore është nëse Gjykata e Apelit ka rrëzuar një nga vendimet e saj të mëparshme për të njëjtën çështje.

160. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton që Gjykata Themelore, me Aktvendimin e saj të Dytë për masa të sigurisë [I. C. nr. 273/2016, të 29 shtatorit 2016] e aprovoi kërkesën e parashtruesit për masa të sigurisë në pikat vijuese:

i.bllokimin/ngrirjen e llogarive bankare të Compact Group Sh.P.K.;
ii. bllokimin/ngrirjen e llogarive bankare të aksionarëve të Compact Group Sh.P.K.;
iii. ndalimin e tjetërsimit, fshehjes, ngarkimit dhe/ose disponimit të pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme të Compact Group Sh.P.K. dhe aksionarëve të saj; dhe
iv. ndalimin e çdo ndryshimi statusor të bërë nga aksionarët e Compact Group Sh.P.K..

161. Gjykata pastaj rikujton se Gjykata e Apelit, me Aktvendimin e saj të Dytë për masë të sigurisë [Ae. nr. 241/2016, të 16 dhjetorit 2016], e ktheu çështjen për rigjykim vetëm në lidhje me pikën (ii) bllokimin/ngrirjen e llogarive bankare të aksionarëve të Compact Group Sh.P.K.. Në lidhje me këtë pikë, Gjykata e Apelit e udhëzoi Gjykatën Themelore që të sqaronte se si dhe pse aksionarët e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar janë prapëseprapë personalisht përgjegjës në këtë rast konkret. Gjykata e Apelit e refuzoi ankesën e Compact Group Sh.P.K. lidhur me të gjitha pikat tjera.

162. Rrjedhimisht, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit i vërtetoi tri pikat tjera që i përmbante Aktvendimi i Dytë për masë të sigurisë [Ae. nr. 241/2016, i 16 dhjetorit 2016] i Gjykatës Themelore, gjegjësisht:

i. bllokimin/ngrirjen e llogarive bankare të Compact Group Sh.P.K.;

iii. ndalimin e tjetërsimit, fshehjes, ngarkimit dhe/ose disponimit të pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme të Compact Group Sh.P.K. dhe aksionarëve të saj; dhe
iv. ndalimin e çdo ndryshimi statusor të bërë nga aksionarët e Compact Group Sh.P.K..

163. Gjykata po ashtu rikujton arsyetimin e dhënë nga Gjykata e Apelit në Aktvendimin e saj të Dytë, ku thuhet:

> *"Gjykata e Apelit e pranon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar* [I. C. nr. 273/2016 i 29 shtatorit 2016, përkatësisht Aktvendimi i dytë për masë të sigurisë i Gjykatës Themelore] *nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore [...] e po ashtu drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore i vështron gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK, perveç në piken I parg.2.*
> [...]
> *Prandaj gjykata e apelit konsideron se janë plotësuar kushtet e përcaktuara me nenin 297. 1 nën piken a) dhe b) të LPK-së, që të caktohet masa e sigurimit e, sepse në rastin konkret* [Parashtruesi i kërkesës] *e ka bërë të besueshëm ekzistimin e kërkesës apo te së drejtës subjektive të tij dhe ekziston rreziku se pa caktimin e masës së tillë propozuesit do t'i shkaktohej dëm i konsiderueshëm i cili vështirë do të mund të riparohej.*
> *Aktvendimi i atakuar [pika] është dashur të prishet në dispozitiv ku janë detyruar Bankat Komerciale në Kosovë, që të bëjnë bllokimin e llogarive bankare të kundërshtarit të sigurimit "Compact Group" sh.p.k. dhe pronarëve të saj S.SH, F.SH dhe F.SH, deri në shumën prej 1,364,527.00 E sepse ky paragraf është i pakuptueshëm dhe i paekzekutueshëm sepse nuk janë dhëne arsye se pronarët a duhet të përgjigjen për borxhet ose detyrimet e shoqërisë vetëm për arsye se janë pronar [...].*"

164. Me fjalë të tjera, Gjykata e Apelit konstatoi se Gjykata Themelore e kishte zbatuar drejt ligjin relevant, se padia kryesore e parashtruesit të kërkesës nuk ishte e papranueshme dhe se vendosja e masës së sigurisë ishte e justifikuar me dëmin potencial që do t'i shkaktohej parashtruesit të kërkesës.

165. Për më tepër, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit e ktheu në rigjykim vetëm një pikë, konkretisht pikën lidhur me (ii) bllokimin/ngrirjen e llogarive bankare të aksionarëve të Compact Group Sh.P.K..

166. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës kishte pritje legjitime që rasti i tij, në lidhje me masat specifike të sigurisë të vërtetuara nga Gjykata e Apelit si të pajtueshme me ligjin, ishte vendosur përfundimisht nga Gjykata e Apelit dhe se nuk mund të rihapej nga vetë Gjykata e Apelit. Kësisoj, parashtruesi është dashur të jetë në gjendje të përfitojë nga këto vendime dhe t'i shihte ato të ekzekutuara.

167. Përveç kësaj, Gjykata vëren se në Aktvendimin e saj të Tretë për masë të sigurisë, Gjykata e Apelit vendosi që Gjykata Themelore në Aktvendimin e saj të Tretë për masë të sigurisë kishte bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe e refuzoi rastin në tërësi, përkundër që në Aktvendimin e saj të Dytë për masë të sigurisë kishte theksuar në mënyrë eksplicite se *"[...] e pranon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm,* [dhe] *nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore [...] e po ashtu drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale."*

168. Gjykata gjithashtu vëren se në parashtresat e tij drejtuar Gjykatës së Apelit si në ankesën e tretë ashtu edhe në të katërtën lidhur me masën e sigurisë, parashtruesi i kërkesës në mënyrë eksplicite kishte ngritur çështjen e plotfuqishmërisë së pikave të vërtetuara nga Gjykata e Apelit në Aktvendimin e saj të Dytë për masë të sigurisë, gjegjësisht që Gjykata Themelore në Aktvendimin e saj të Dytë për masë të sigurisë kishte vendosur për kërkesën e parashtruesit për vendosje të masës së sigurisë në pajtueshmëri të plotë me ligjin dhe se masat vijuese duhet të zbatohen:

> i. bllokimi/ngrirja e llogarive bankare të Compact Group Sh.P.K.;
> iii. ndalimi i tjetërsimit, fshehjes, ngarkimit dhe/ose disponimit të pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme të Compact Group Sh.P.K. dhe aksionarëve të saj; dhe
> iv. ndalimi i çdo ndryshimi statusor të bërë nga aksionarët e Compact Group Sh.P.K..

169. Gjykata vëren se, në Aktvendimin e Tretë dhe në të Katërtin për masën e sigurisë, Gjykata e Apelit nuk i adresoi argumentet e parashtruesit të kërkesës lidhur me plotfuqishmërinë e Aktvendimit të Dytë të Gjykatës së Apelit për masë të sigurisë. Në vend se të adresonte argumentet e parashtruesit të kërkesës, Gjykata e Apelit nxori Aktvendimin e saj të Tretë dhe të Katërt për masën e sigurisë në bazë të argumenteve krejtësisht të reja që nuk kishin ndërlidhshmëri as me

argumentet e parashtruesit të kërkesës e as me argumentet e Compact Group Sh.P.K..

170. Në fakt, Compact Group Sh.P.K. nuk kontestoi plotfuqishmërinë e masave të vërtetuara nga Gjykata e Apelit në Aktvendimit e saj të Dytë për masë të sigurisë, por vetëm kontestoi çështjen e detyrimit dhe përgjegjësisë së aksionarëve të Compact Group Sh.P.K. Ishte pikërisht çështja e përgjegjësisë së aksionarëve e vetmja pikë që ishte kthyer nga Gjykata e Apelit në Aktvendimin e saj të Dytë të për masë të sigurisë.

171. Bazuar në këto shqyrtime dhe në praktikën e mëparshme gjyqësore të saj, si dhe në atë të GJEDNJ-së, Gjykata konkludon se Aktvendimi i Dytë për masa të sigurisë [I.C. nr. 273/2016, i 29 shtatorit 2016] i Gjykatës Themelore dhe Aktvendimi i Dytë për masa të sigurisë [Ae. Nr. 241/2016, i 16 dhjetorit 2016] i Gjykatës së Apelit ishin bërë *res judicata* për pikat që u vërtetuan dhe u aprovuan nga vetë Gjykata e Apelit.

172. Duke përdorur procedurën e ankesës për të përmbysur këto vendime me vetë-iniciativë, pa iu kërkuar nga Compact Group Sh.P.K., Gjykata e Apelit kishte shkelur parimin e sigurisë juridike dhe i kishte mohuar parashtruesit të kërkesës një gjykim të drejtë dhe të paanshëm lidhur me të drejtat dhe detyrimet e tij brenda kuptimit të nenit 31, paragrafi 2 të Kushtetutës dhe nenit 6, paragrafi 1 i KEDNJ-së.

173. Gjykata konkludon se ka pasur shkelje të së drejtës së parashtruesit të kërkesës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm të mbrojtur me nenin 31 paragrafi 2 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 paragrafi 1 të KEDNJ-së.

174. Për më tepër, Gjykata shpreh shqetësimin e saj se parashtruesi i kërkesës është i detyruar të ndërmarrë këto procedura shtesë kundër shpërbërjes vullnetare të shoqërisë së paditur në mënyrë që të realizojë ekzekutimin e një vendimi gjyqësor përfundimtar dhe të detyrueshëm lidhur me Vendimin e Arbitrazhit. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore përfundimtare dhe të detyrueshme është pjesë përbërëse e garancisë për një gjykim të drejtë, të mbrojtur me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNJ-së, siç është përsëritur nga kjo Gjykatë në praktikën e saj gjyqësore (shih gjithashtu, *inter alia*, rasti i GJEDNJ-së: *Hornsby kundër Greqisë*, kërkesa nr. 18357/91, Aktgjykim i 19 marsit 1997). Zhvillimi ekonomik i Kosovës varet nga mbrojtja efektive e sundimit të ligjit dhe nga zbatimi i vendimeve gjyqësore, siç është rasti i parashtruesit të paraqitur këtu.

Përfundime

175. Si përfundim, Gjykata konstaton se, duke mos respektuar parimin e sigurisë juridike dhe respektimin e një vendimi të formës së prerë të gjykatës, si dhe duke mos trajtuar pretendimet e parashtruesit në lidhje me çështjet *res judicata*, Gjykata e Apelit ka shkelur të drejtën e parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së. Si rezultat i këtyre shkeljeve, parashtruesi i kërkesës është privuar nga përfitimi që sjell një vendim përfundimtar dhe i detyrueshëm i gjykatës.

176. Sa i përket procedurës në tërësi, Gjykata shpreh shqetësimin e saj që parashtruesi është i detyruar të ndërmarrë këto procedura shtesë kundër shpërbërjes vullnetare të shoqërisë së padituri në mënyrë që të realizojë ekzekutimin e një vendimi gjyqësor përfundimtar dhe të detyrueshëm lidhur me Vendimin e saj të Arbitrazhit.

177. Në pajtim me rregullin 74 (1) të Rregullores së punës, shpallen të pavlefshme këto vendime:

i) Aktvendimi i Gjykatës së Apelit Ae. nr. 185/2017, i 11 gushtit 2017;
ii)Aktvendimi i Gjykatës Themelore IV. EK. C. nr. 273/2016, i 14 qershorit 2017;

178. Në pajtim me rregullin 74 (1) të Rregullores së punës, Aktvendimi i Gjykatës së Apelit Ae. nr. 241/2016, i 16 dhjetorit 2016 shpallet përfundimtar dhe i detyrueshëm lidhur me pikat në vijim, të cilat duhet të ekzekutohen:

i) bllokimi/ngrirja e llogarive bankare të Compact Group Sh.P.K.;
ii) ndalimi i tjetërsimit, fshehjes, ngarkimit dhe/ose disponimit të pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme të Compact Group Sh.P.K. dhe aksionarëve të saj; dhe
iii) ndalimi i çdo ndryshimi statusor të bërë nga aksionarët e Compact Group Sh.P.K..

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113 (7) të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 56 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 18 prill 2018, me shumicë votash

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

III. TË KONSTATOJË se nuk është e nevojshme të shqyrtohet nëse ka pasur shkelje të nenit 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

IV. TË KONSTATOJË se Vendimet në vijim janë të pavlefshme, dhe si të tilla nule:

a. Aktvendimi i Gjykatës së Apelit Ae. nr. 185/2017, i 11 gushtit 2017;
b. Aktvendimi i Gjykatës Themelore IV. EK. C. nr. 273/2016, i 14 qershorit 2017;

V. TË KONSTATOJË se Aktvendimi i Gjykatës së Apelit Ae. nr. 241/2016, i 16 dhjetorit 2016, është përfundimtar dhe i detyrueshëm, dhe si i tillë *res judicata* lidhur me pikat në vijim, të cilat duhet të ekzekutohen:

a. bllokimi/ngrirja e llogarive bankare të Compact Group Sh.P.K.;
b. ndalimi i tjetërsimit, fshehjes, ngarkimit dhe/ose disponimit të pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme të Compact Group Sh.P.K. dhe aksionarëve të saj; dhe
c. ndalimi i çdo ndryshimi statusor të bërë nga aksionarët e Compact Group Sh.P.K.;

VI. TË URDHËROJË Gjykatën e Apelit që ta informojë Gjykatën Kushtetuese sa më shpejt që është e mundur, por jo më larg se 6 (gjashtë) muaj, lidhur me masat e ndërmarra për

zbatimin e Aktgjykimit të kësaj Gjykate, në pajtim me rregullin 63 të Rregullores së punës;

VII. TË MBETET e përkushtuar në këtë çështje në pritje të respektimit të këtij urdhri;

VIII. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

IX. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit;

X. TË DEKLAROJË se ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Snezhana Botusharova	Arta Rama-Hajrizi

Në pajtim me nenin 112 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me nenin 11.1.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe me rregullin 61 [Përmirësimi i aktgjykimeve dhe vendimeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës nxjerr Urdhrin për korrigjim në vijim, me qëllim të korrigjimit të një gabimi teknik në Aktgjykimin e publikuar në rastin KI122/17, të 18 prillit 2018.

URDHËR PËR KORRIGJIM

të një gabimi teknik në Aktgjykimin në rastin KI122/17, të 18 prillit 2018

1. Më 18 prill 2018, Gjykata, me shumicë votash, e deklaroi kërkesën të pranueshme dhe me shumicë votash konstatoi se ka pasur shkelje.

2. Më 2 maj 2018, Aktgjykimi KI122/17 iu dorëzua palës së interesuar, "Compact Group" sh.p.k., nëpërmjet shërbimeve postare.

3. Më 8 maj 2018, pala e interesuar, "Compact Group" sh.p.k., e përfaqësuar nga "Sejdiu & Qerkini" me seli në Prishtinë, parashtroi kërkesë për korrigjim të një gabimi teknik në Aktgjykimin KI122/17, të 18 prillit 2018.

4. Pala e interesuar paraqiti kërkesën e saj për korrigjim të një gabimi teknik brenda 2 (dy) javësh nga pranimi i Aktgjykimit KI122/17, siç parashihet me rregullin 61 (1) të Rregullores së punës.

5. Pala e interesuar pretendon se dispozitivi i Aktgjykimit të Gjykatës përmban gabim teknik në pikën V, nën (b). Konkretisht, pala e interesuar pretendon që ekziston një mospërputhje ndërmjet Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese si dhe dispozitivit të Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike (I. C. nr. 273/2016, i 29 shtatorit 2016), siç është mbështetur nga Gjykata e Apelit (Aktvendimi Ae. nr. 241/2016, i 16 dhjetorit 2016), të cilin Gjykata e ka deklaruar përfundimtar dhe të detyrueshëm.

6. Pala e interesuar i ka kërkuar Gjykatës që të korrigjojë nënpikën b., të pikës V të dispozitivit, të Aktgjykimit KI122/17, në atë mënyrë që ky dispozitiv të jetë identik me dispozitivin e mbështetur të Aktvendimit të Gjykatës Themelore.

7. Në dispozitiv të Aktvendimit të Gjykatës së Apelit (Ae nr. 241/2016, të 16 dhjetorit 2016), theksohet:

"I. Me aprovimin e pjesshëm të ankesës, PRISHET Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, I. C. nr. 273/2016, i datës 29.09.2016, në pikën I, par. 2, të dispozitivit dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rishqyrtim dhe për rivendosje lidhur me këtë pikë.

II. REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kundërshtarit të propozimit të masës së sigurimit lidhur me pjesën tjetër të dispozitivit, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, Ek. nr. I. C. nr. 273/2016, i datës 29.09.2016, në pikën 1, par. 1, 3 dhe 4 të dispozitivit VËRTETOHET.

III. Pjesa tjetër e aktvendimit të atakuar mbetet e pashqyrtuar".

8. Në dispozitiv të Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike (I. C. nr. 273/2016, i 29 shtatorit 2016), siç u referua nga dispozitivi i Gjykatës së Apelit, i cituar më lart, theksohet:

"I. Miratohet pjesërisht si i bazuar propozimi i propozuesit të sigurimit, 'Çeska Exportni Bank, A.S.', me numër të regjistrimit të biznesit 63078333, me seli në Pragë, 'Vodoçikova' 34/701, Republika Çeke, përkitazi me kundërshtarët e sigurimit: "Compact Group" sh.p.k, dhe pronarët e tij S. Sh., F.Sh. dhe F.Sh., ashtu që vendoset si në vijim:

- *Detyrohen bankat komerciale në Kosovë: ProCredit Bank; Raiffeisen Bank; Banka Ekonomike; TEB Banka; Banka Kombëtare Tregtare; NLB Prishtina dhe Banka për Biznes; që të bëjnë bllokimin e llogarive bankare të kundërshtarit të sigurimit "Compact Group" sh.p.k. dhe pronarëve të tij S. Sh., F. Sh. dhe F. Sh., deri në shumën prej 1,364,527.00€;*

- *I ndalohet kundërshtarit të sigurimit "Compact Group" sh.p.k; organeve menaxhuese të tij dhe pronarëve të tij, që të bëjnë tjetërsimin, fshehjen, ngarkimin dhe disponimin me pasuritë e Shoqërisë Tregtare "Compact Group" sh.p.k; dhe*

- *Ndalohen të gjitha veprimet që mund të rezultojnë me ndryshime statusore te kundërshtari i sigurimit, "Compact Group" sh.p.k.*

II. REFUZOHET propozimi për caktimin e masës së sigurimit në pjesën me të cilën është kërkuar të shpallet nule procedura e

shpërbërjes vullnetare të Shoqërisë Tregtare "Compact Group" sh.p.k.; të anulohen vendimet, veprimet dhe punët e tjera juridike të "Compact Group" sh.p.k. dhe të aksionarëve të saj, në veçanti punët juridike që i janë referuar tjetërsimit, shitjes, transferimit, ngarkimit dhe dhënies në shfrytëzim të pasurisë së saj dhe të bëhet bllokimi i llogarive bankare të Shoqërisë Tregtare "Adea Group" sh.p.k, ndalimi i tjetërsimit të pasurisë së saj dhe ndalimi i ndryshimit statusor të saj.

III. Vërtetohet se sipas aktvendimit të kësaj gjykate, të datës 20.09.2016, propozuesi i sigurimit me datën 29.06.2016, ka deponuar në llogarinë bankare të kësaj gjykate shumën prej 50.000.00 €, e cila shumë mund të shërbejë si mbulesë për dëmin eventual që mund t'u shkaktohet kundërshtarëve të sigurimit për shkak të caktimit dhe zbatimit të masave të sigurimit, të caktuara me këtë aktvendim.

IV. Nga një kopje e këtij aktvendimi i dërgohet: ARBK-së dhe Odës së Noterëve të Republikës së Kosovës.

V. Ky aktvendim mbi caktimin e masave të sigurimit mbetet në fuqi deri në vendimin e ardhshëm gjyqësor me të cilin do të ndryshohen apo do të hiqen këto masa siguruese".

9. Rrjedhimisht, Gjykata gjen se ka pasur gabim teknik në Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KI122/17 të 18 prillit 2018, dhe lëshon këtë:

URDHËR

I. Dispozitivi i Aktgjykimit KI122/17, i 18 prillit 2018, ndryshohet ashtu që pika V. do të lexojë:

> V. TË KONSTATOJË se Aktvendimi i Gjykatës së Apelit Ae. nr. 241/2016, i 16 dhjetorit 2016, është përfundimtar dhe i detyrueshëm, dhe si i tillë *res judicata* lidhur me pikat në vijim, të cilat duhet të ekzekutohen:
>
> a. Bankat Komerciale në Kosovë: ProCredit Bank; Raiffeisen Bank; Banka Ekonomike; TEB Banka; Banka Kombëtare Tregtare; NLB Prishtina dhe Banka për Biznes, të bëjnë bllokimin e llogarive bankare të kundërshtarit të sigurimit "Compact Group" sh.p.k. [...] deri në shumën prej 1,364,527.00€;
> b. I ndalohet kundërshtarit të sigurimit "Compact Group" sh.p.k; organeve menaxhuese të tij dhe pronarëve të tij, që

të bëjnë tjetërsimin, fshehjen, ngarkimin dhe disponimin me pasuritë e Shoqërisë Tregtare “Compact Group” sh.p.k; dhe

c. Ndalohen të gjitha veprimet që mund të rezultojnë me ndryshime statusore te kundërshtari i sigurimit, “Compact Group” sh.p.k.

II. Paragrafët 39, 42, 49, 58, 71, 92, 160, 162, 168 dhe 178 të Aktgjykimit KI122/17, të 18 prillit 2018, nën pikat përkatëse (iii), ndryshohen ashtu që fraza “[...] dhe aksionarëve të saj” zëvendësohet me frazën “nga organet e saj menaxhuese ose nga aksionarët e saj”;

III. Ky urdhër do t’i bashkëngjitet Aktgjykimit fillestar të Gjykatës, në pajtim me rregullin 61 (2) të Rregullores së punës;

IV. Ky urdhër do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;

V. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

KI97/16, Parashtrues "IKK Classic", Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, E. Rev. 15/2016, të 16 marsit 2016

KI97/16, Aktgjykim i miratuar më 4 dhjetor 2017 dhe i publikuar më 11 janar 2018

Fjalët kyç*: Kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, ne lidhje me paragrafin 1, të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut*

Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [E. Rev. 15/2016] e Gjykatës Supreme të Kosovës, të 16 marsit 2016.
Më 16 mars 2016, pas Aktgjykimit të Gjykatës në rastin nr. KI135/14, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin e ri, respektivisht, të dytë për rastin [Aktgjykimi E. Rev. nr. 15/2016], të 16 marsit 2016, nëpërmjet të të cilit konstatoi gjetjet e Aktgjykimit të parë [E. Rev. nr. 21/2014], të 8 prillit 2014, duke vendosur se kërkesa për revizion e SIGMA-s është e bazuar dhe se vendimet e gjykatave të shkallës më të ulët, me të cilat ishte konstatuar se SIGMA është e detyruar t'i kompensojë parashtruesit të kërkesës shumën prej 18.985,36 euro, duhet të refuzohet si e pabazuar.
Parashtruesi i kërkesës pretendoi shkelje të neneve 24 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
Parashtruesi i kërkesës pretendoi se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme [E. Rev. 15/2016], i 16 marsit 2016, vazhdon të karakterizohet nga mungesa e arsyetimit në lidhje me pretendimet e tij thelbësore dhe se Gjykata Supreme nuk arriti të japë arsyetimin për konstatimet kryesore dhe për çështjet e ngritura nga Aktgjykimi i parë i Gjykatës në rastin nr. KI134/15, posaçërisht se si përmbushja e detyrimeve nga SIGMA ndaj të siguruarit D.H., përmes marrëveshjes jashtëgjyqësore, i pamundëson parashtruesit të kërkesës realizimin e së drejtës së tij për kompensim. Prandaj, parashtruesi i kërkesës pretendoi se pretendimet thelbësore të tij nuk janë adresuar nga Gjykata Supreme dhe as nuk janë arsyetuar me aktgjykimin e lartcekur.
Gjykata konstatoi që Aktgjykimi i dytë i Gjykatës Supreme, përkatësisht [E. Rev. 15/2016], i 16 marsit 2016, nuk ka korrigjuar shkeljet e konstatuara me Aktgjykimin parë të Gjykatës në rastin nr. KI135/14 dhe nuk i ka dhënë arsye të mjaftueshme parashtruesit të kërkesës se përse i mohohen të drejtat e tij për kompensim në rrethanat e këtij rasti specifik. Gjykata konsideron se dështimi i Gjykatës Supreme për të dhënë përgjigje të qarta dhe të plota përbën shkelje kushtetuese.

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI97/16

Parashtrues

"IKK Classic"

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, E. Rev. 15/2016, të 16 marsit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga kompania e sigurimit IKK Classic (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), të cilën e përfaqësojnë avokatët Besnik Nikqi dhe Visar Morina nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [E. Rev. 15/2016] e Gjykatës Supreme të Kosovës të 16 marsit 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë:

Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 47 [Kërkesa individuale] dhe 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 9 shkurt 2016, Gjykata Kushtetuese nxori Aktgjykimin në rastin KI135/14, parashtrues *IKK Classic*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit E. Rev. nr. 21/2014 të Gjykatës Supreme të Kosovës të 8 prillit 2014 (në tekstin e mëtejmë: Aktgjykimi i Gjykatës në rastin nr. KI135/14). Gjykata e shpalli të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [E. Rev. nr. 21/2014] të 8 prillit 2014 për shkak se kishte konstatuar se ky Aktgjykim ishte nxjerrë në kundërshtim me të drejtën për një vendim të arsyetuar siç garantohet me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E Drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

6. Më 7 prill 2016, Gjykata Supreme njoftoi Gjykatën për Aktgjykimin e saj të ri, respektivisht të dytë [E. Rev. 15/2016] të 16 marsit 2016, të nxjerrë në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës në rastin nr. KI135/14.

7. Më 25 prill 2016, parashtruesi i kërkesës gjithashtu e informoi Gjykatën për Aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Supreme, duke pretenduar se ai: a) përsëri përbën shkelje të së drejtës së tij për një vendim të arsyetuar dhe b) nuk ka zbatuar Aktgjykimin e Gjykatës në rastin nr. KI135/14.

8. Më 29 prill 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës se në bazë të Kushtetutës, ajo vendos vetëm çështjet e ngritura në mënyrë ligjore nga palët e autorizuara dhe se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqesë një kërkesë të re në Gjykatë.
9. Më 22 qershor 2016, parashtruesi e dorëzoi kërkesën e re në Gjykatë, të regjistruar si kërkesa nr. KI97/16 duke pretenduar se Aktgjykimi i ri, respektivisht, i dytë i Gjykatës Supreme [E. Rev. 15/2016] i 16

marsit 2016, i nxjerrë në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës në rastin nr. KI135/14, vazhdon ta shkelë të drejtën e tij në vendim të arsyetuar.

10. Më 12 korrik 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Bekim Sejdiu.

11. Më 29 gusht 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme të Kosovës.

12. Më 2 nëntor 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani gjyqtare raportuese në vend të gjyqtarit Robert Carolan, i cili dha dorëheqje nga pozita e gjyqtarit të Gjykatës më 9 shtator 2016. Përbërja e Kolegjit shqyrtues mbeti e pandryshuar.

13. Më 4 dhjetor 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Më 24 nëntor 2008, D.H., i siguruari i parashtruesit të kërkesës, ka pësuar lëndime të rënda në një aksident trafiku të shkaktuar nga B.L., shfrytëzues i sigurimit në kompaninë e sigurimeve "SIGMA" në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: SIGMA). D.H., ka marrë trajtim mjekësor në Republikën Federale të Gjermanisë në shumë prej 18.985,36 Euro, e cila ishte paguar nga parashtruesi i kërkesës.

15. Më 3 shkurt 2009, SIGMA dhe D.H. arritën një marrëveshje jashtëgjyqësore, ku ky i fundit u kompensua nga SIGMA në shumën prej 2,729 Euro. Bazuar në këtë marrëveshje, SIGMA konsideroi se i kishte përmbushur të gjitha detyrimet e saj në lidhje me kompensimin e dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të 24 nëntorit 2008, duke përfshirë shumën prej 18.985,36 Euro të paguar nga parashtruesi i kërkesës si kompani e sigurimit të D.H.

16. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga SIGMA që të kompensohet me shumën e lartpërmendur. Parashtruesi i kërkesës kërkoi që SIGMA t'i kompensojë shpenzimet mjekësore për trajtimin e D.H., në bazë të Rregullës 3 të Rregullit për Sigurimin e Detyrueshëm të Autopërgjegjësisë së Palës së Tretë të Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës.

17. Parashtruesi i kërkesës dhe SIGMA nuk arritën marrëveshje sa i përket çështjes së kompensimit, prandaj, i adresuan paditë e tyre përkatëse në gjykatat e rregullta.

18. Gjykata e atëhershme Ekonomike e Qarkut në Prishtinë, aprovoi padinë e parashtruesit të kërkesës si të bazuar dhe urdhëroi që SIGMA t'ia kompensojë parashtruesit të kërkesës shumën prej 18.985,36 Euro. Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit konfirmoi vendimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut, duke arsyetuar se pala e paditur (SIGMA) duhet t'ia kompensojë parashtruesit të kërkesës shumën prej 18.985,36 Euro.

19. Më 4 mars 2014, SIGMA parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, duke pretenduar se ka përmbushur detyrimet e saj me pagesën e dëmit material dhe jomaterial ndaj të siguruarit D.H., dhe se, parashtruesi i kërkesës, si një kompani e huaj e sigurimeve do të kishte të drejtë të kompensimit *vis-a-vis* kompanive të sigurimeve të Kosovës vetëm përmes marrëveshjes dypalëshe midis Republikës së Kosovës dhe shtetit të kompanisë së huaj të sigurimit.

20. Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [E. Rev. nr. 21/2014 i 8 prillit 2014], aprovoi si të bazuar kërkesën për revizion të SIGMA dhe konstatoi se gjykatat e shkallës më të ulët kishin zbatuar gabimisht të drejtën materiale dhe, se SIGMA është liruar nga kompensimi i shumës që parashtruesi i kërkesës pretendonte.

21. Më 3 shtator 2014, parashtruesi i kërkesës parashtroi në Gjykatë kërkesë, duke kontestuar Aktgjykimin e lartpërmendur të Gjykatës Supreme. Kjo kërkesë ishte regjistruar si rasti nr. KI135/14 (shih Aktgjykimin në rastin KI135/14, parashtruesi i kërkesës *IKK Classic*, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, E. Rev. nr. 21/2014 të 8 prillit 2014).

22. Parashtruesi i kërkesës pretendoi se ky Aktgjykim i Gjykatës Supreme ishte nxjerrë në shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit], nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së dhe nenin 46 [Mbrojta e Pronës] të Kushtetutës. Parashtruesi i kërkesës pretendoi, ndër të tjera, se Aktgjykimi i kontestuar Gjykatës Supreme karakterizohet me mungesën e arsyetimit përkitazi me pretendimet e tij thelbësore.

23. Më 9 shkurt 2016, Gjykata përmes Aktgjykimit në rastin KI135/14, konstatoi shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta

për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, për shkak se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme nuk ishte i arsyetuar.

24. Aktgjykimi i Gjykatës në rastin nr. KI135/14 kishte konstatuar se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme [E. Rev. nr. 121/2014] i 8 prillit 2014, nuk i kishte përmbushur standardet e një vendimi të arsyetuar, dhe përmes Aktgjykimit të saj [KI135/14], Gjykata kishte përmbledhur pretendimet e parashtruesit të kërkesës të cilat i përcaktoi si thelbësore dhe të cilat rrjedhimisht, kërkojnë përgjigje nga Gjykata Supreme, me qëllim që të respektohen të drejtat e parashtruesit të kërkesës dhe të përmbushen standardet e së drejtës për një vendim të arsyetuar.

25. Në të vërtetë, me Aktgjykimin e Gjykatës në rastin nr. KI135/14, ishte konstatuar që Aktgjykimi i Gjykatës Supreme [E. Rev. nr. 121/2014] i 8 prillit 2014, nuk kishte adresuar pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës si në vijim: "*(i) nëse marrëveshja jashtëgjyqësore e lidhur në mes të SIGMA dhe të siguruarit D. H. ia ka mohuar të drejtën parashtruesit për kompensim, (ii) se si kompensimi i paguar nga SIGMA ndaj të siguruarit D. H. e liroi atë t'ia paguajë kompensimin parashtruesit të kërkesës, si dhe, (iii) se si marrëveshja jashtëgjyqësore në mes të SIGMA-s dhe D. H., mund të prekë të drejtat e parashtruesit të kërkesës, ku është e qartë, se ky i fundit nuk ishte palë në këtë marrëveshje".* (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI135/14, parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykim i 9 shkurtit 2016, para. 51).

26. Më 16 mars 2016, pas Aktgjykimit të Gjykatës në rastin nr. KI135/14 , Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin e ri, respektivisht, të dytë për rastin, [Aktgjykimi E. Rev. nr. 15/2016] të 16 marsit 2016, përmes të cilit përsëriti gjetjet e Aktgjykimit të parë [E. Rev. nr. 21/2014] të 8 prillit 2014, duke vendosur se kërkesa për revizion e SIGMA është e bazuar; dhe se, vendimet e gjykatave të shkallës më të ulët, me të cilat ishte konstatuar se SIGMA është e detyruar t'i kompensojë parashtruesit të kërkesës shumën prej 18.985,36 Euro, duhet të refuzohen si të pabazuara.

27. Duke iu përgjigjur pretendimeve thelbësore të parashtruesit të kërkesës, siç ishin përmbledhur edhe me Aktgjykimin e Gjykatës në rastin nr. KI135/14, Gjykata Supreme me Aktgjykimin e saj të dytë [E. Rev. nr. 15/2016] i 16 marsit 2016] u përgjigj përmes dy paragrafëve në vijim:

> *" [...] marrëveshja jashtëgjyqësore e lartpërmendur e lidhur në mes të KS "Sigma" dhe të siguruarit të paditësit, ia ka mohuar të*

drejtën e paditësit për regresim të shpërblimit të dëmit, të cilin ia ka paguar të siguruarit të saj D. H., nga se i siguruari i paditësit drejtëpërdrejtë nga e paditura ka realizuar shpërblimin e dëmit sipas kësaj marrëveshjeje, sipas të cilës ai ka hequr dorë nga të gjitha kërkesat për këtë dëm, të tanishëm dhe të ardhshëm. Kështu që raporti juridik në mes të paditësit dhe të siguruarit të saj D.H. mbetet raport juridik vetëm në mes tyre, në bazën e të cilit edhe paditësi ka paguar dëmshpërblim, pa e ditur se i siguruari i saj ka realizuar nga KS "Sigma" dëmshpërblimin. Kjo i bie që i siguruari i paditësit, është kompensuar dy herë, në çka nuk ka të drejtë.

Nëse i siguruari i paditësit të mos kishte realizuar direkt dëmshpërblimin nga e paditura, ndaj të padituës, paditësi përkitazi me regresimin e borxhit për aq sa i ka paguar të siguruarit të saj, padyshim do të kishte të drejtë, sepse mundësia e regresivit është e paraparë me nenin 939 par.,1 të Ligjit të lartpërmendur".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

28. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të neneve 24 [Barazia para Ligjit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

29. Sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës konsideron se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme [E. Rev. 15/2016] i 16 marsit 2016 vazhdon të karakterizohet nga mungesa e arsyetimit në lidhje me pretendimet e tij thelbësore; dhe se Gjykata Supreme nuk arriti të japë arsyetimin për konstatimet kryesore dhe çështjet e ngritura nga Aktgjykimi i Gjykatës në rastin nr. KI134/15, posaçërisht, se si përmbushja e detyrimeve nga SIGMA ndaj të siguruarit D.H., përmes marrëveshjes jashtëgjyqësore, i pamundëson parashtruesit të kërkesës realizimin e së drejtës së tij për kompensim.

30. Sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës konsideron se në rastin e tij, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme është në kundërshtim me praktikën e vet gjyqësore në situata të ngjashme. Parashtruesi i kërkesës argumenton se praktika gjyqësore e Gjykatës Supreme në situata të ngjashme tregon që marrëveshjet e dëmshpërblimit prodhojnë efekte juridike '*inter-partes*' dhe jo '*erga omnes*', rrjedhimisht, të drejtat dhe interesat e palëve të treta nuk mund të preken me këto marrëveshje. Në

mbështetje të këtyre pretendimeve, parashtruesi i kërkesës i referohet tri vendimeve të Gjykatës Supreme [E. Rev. nr. 62/2014; E. Rev. nr. 48/2014; dhe E. Rev. nr. 14/2015].

Pranueshmëria e kërkesës

31. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

32. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar".*
>
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

33. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme".*

34. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se, në pajtim me nenin 21.4 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqes ankesë kushtetuese, duke u referuar në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejnë për individët dhe personat juridikë (shih Gjykata Kushtetuese rasti nr. KI41/09, parashtruesi i kërkesës *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendimi për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, në paragrafin 14).

35. Rrjedhimisht, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e përcaktuara me nenin 113.7 të Kushtetutës, pasi që është palë e autorizuar, që e konteston aktin e një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [E. Rev. 15/2016] të 16 marsit 2016, dhe i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj.

36. Në vazhdim, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët parashohin:

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

Neni 49
[Afatet]

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht…".

37. Sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka specifikuar qartë të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ, të cilat pretendohet se janë shkelur, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe e ka parashtruar kërkesën brenda afatit prej katër (4) muajsh të paraparë me nenin 49 të Ligjit.

38. Gjykata në fund vlerëson se kjo kërkesë nuk është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (1) (d) të Rregullores së punës. Gjykata më tej thekson se nuk është e papranueshme në asnjë bazë tjetër. Prandaj ajo duhet deklaruar e pranueshme (shih gjithashtu rastin e GJEDNJ-së *Alimuçaj kundër Shqipërisë*, kërkesa nr. 20134/05, Aktgjykimi i 9 korrikut 2012, § 144).

Meritat e kërkesës

39. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së. Parashtruesi i kërkesës kryesisht pretendon se me Aktgjykimin e dytë, respektivisht Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme, janë shkelur të drejtat e tij për një vendim të arsyetuar, sepse nuk i ka adresuar argumentet e tij thelbësore, duke përfshirë edhe ato

që janë kërkuar me Aktgjykimin e Gjykatës në rastin nr. KI135/14, për më tepër që është një Aktgjykim i cili bie në kundërshtim me praktikën gjyqësore të vet Gjykatës Supreme.

40. Gjykata fillimisht do të shqyrton meritat e kërkesës sa i përket nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

41. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, që përcakton:

> *"1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
>
> *2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj".*

42. Përveç kësaj, Gjykata i referohet nenit 6.1 (E drejta për një proces të rregullt), të KEDNJ-së, që përcakton:

> *"Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij."*

43. Gjykata thekson se e drejta për një vendim të arsyetuar garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe zbatimi i saj, është interpretuar nga Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ) përmes praktikës së saj gjyqësore. Gjykata bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, në pajtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. Rrjedhimisht, sa i përket interpretimit të pretendimeve për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata do t'i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së.

(i) Parimet e përgjithshme mbi të drejtën për një vendim të arsyetuar siç është zhvilluar me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së

44. Gjykata rikujton që e drejta për një gjykim të drejtë përfshin të drejtën për një vendim të arsyetuar. GJEDNJ ka konstatuar se, sipas praktikës së saj të vendosur gjyqësore, e cila pasqyron parimet të lidhur me administrimin e duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave dhe tribunaleve duhet t'i theksojnë në mënyrë adekuate arsyet në të cilat ato bazohen. (Shih rastet e GJEDNJ-së *Tatishvili kundër Rusisë*, nr. 1509/02, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007, § 58; *Hiro Balani kundër Spanjës*, GJEDNJ, kërkesa nr. 18064/91, Aktgjykimi i 9 dhjetorit 1994, § 27; dhe *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, kërkesa nr. 134/1996/753/952, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998, § 42).

45. Përveç kësaj, përderisa GJEDNJ-ja gjithashtu ka konstatuar se autoritetet gëzojnë liri të konsiderueshme në zgjedhjen e mjeteve të përshtatshme për të siguruar se sistemet e tyre gjyqësore janë në përputhje me kërkesat e nenit 6 (1) të KEDNJ-së, gjykatat e tyre duhet "t'i tregojnë me qartësi të mjaftueshme bazat që kanë shërbyer për nxjerrjen e vendimeve të tyre". (Shih rasti i GJEDNJ-së, *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, Aktgjykim, i 16 dhjetorit 1992, § 33).

46. Në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së theksohet se funksioni thelbësor i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se janë dëgjuar. Për më tepër, një vendim i arsyetuar i jep një pale mundësinë për t'u ankuar kundër tij, si dhe mundësinë e shqyrtimit të vendimit nga një organ i apelit. Vetëm duke dhënë një vendim të arsyetuar mund të ketë shqyrtim publik të administrimit të drejtësisë. (shih *mutatis mutandis,* rastet e GJEDNJ-së *Hirvisaari kundër Finlandës*, kërkesa nr. 49684/99, 27 shtator 2001 § 30; *Tatishvili kundër Rusisë*, kërkesa nr. 1509/02, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007, § 58; dhe *Suominen kundër Finlandës*, kërkesa nr. 37801/97, Aktgjykimi i 1 korrikut 2003, § 37).

47. Megjithatë, edhe pse GJEDNJ pohon se neni 6, paragrafi 1, obligon gjykatat të japin arsyet për vendimet e tyre, ajo gjithashtu ka konstatuar se kjo nuk mund të kuptohet si kërkesë për një përgjigje të hollësishme në çdo argument. (Shih rastet e GJEDNJ-së *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994, § 61; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, kërkesa nr. 134/1996/753/952, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998, § 42).

48. Shkalla në të cilën zbatohet obligimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit. (rastet e GJEDNJ-së *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999. § 29, *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 9 dhjetorit 1994, § 27, dhe *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, *Ibidem* § 42).

49. Për shembull, në hedhjen poshtë të një ankese, një gjykatë apeli mundet në parim, thjesht të miratojë arsyet për nxjerrjen e vendimit të gjykatës më të ulët. (Shih rastet e GEJDNJ-së *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, § 26 dhe *Helle kundër Finlandës*, Aktgjykimi i 19 dhjetorit 1997, §§ 59, 60). Autoriteti ose gjykata më e ulët duhet të japin arsye të tilla që t'u mundësojnë palëve që të shfrytëzojnë në mënyrë efektive çdo të drejtë ekzistuese të ankesës. (Rasti i GJEDNJ-së *Hirvisaari kundër Finlandës*, kërkesa 49684/99, Aktgjykimi i 27 shtatorit 2001, § 30).

50. Megjithatë, GJEDNJ ka gjithashtu ka vërejtur se, edhe pse gjykatat kanë liri të caktuar të vlerësimit në zgjedhjen e argumenteve në një rast të veçantë dhe në pranimin e provave në mbështetje të parashtresave të palëve, një gjykatë vendore është e detyruar të justifikojë aktivitetet duke dhënë arsyet për vendimet e saj. (Rasti i GJEDNJ-së shih *Suominen kundër Finlandës*, kërkesa nr. 37007/97, 1 korrik 2003 § 36).

51. Prandaj, përderisa nuk është e nevojshme që gjykata të merret me çdo pikë të ngritur në argument (shih gjithashtu *Van de Hurk kundër Holandës*, *Ibidem*, § 61), argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës duhet të adresohen. (Rastet e GJEDNJ-së *Buzescu kundër Rumanisë*, kërkesa nr. 61302/00, Aktgjykimi i 24 majit 2005, § 63; *Pronina kundër Ukrainës*, kërkesa nr. 63566/00, Aktgjykim i 18 korrikut 2006, § 25). Po ashtu, dhënia e një arsyeje për një vendim që nuk është mirë e bazuar në ligj, nuk do të përmbushë kriteret e nenit 6.

52. Në fund, Gjykata gjithashtu i referohet praktikës së saj gjyqësore ku ajo konsideron që arsyetimi i vendimit duhet të theksojë raportin ndërmjet konstatimeve të meritës dhe reflektimeve kur të merren parasysh provat e propozuara nga njëra anë, dhe konkluzionet ligjore të gjykatës nga ana tjetër. Aktgjykimi i Gjykatës do të shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk përmban fakte të vërtetuara, dispozitat ligjore përkatëse dhe marrëdhënien logjike midis tyre. (Gjykata Kushtetuese: rasti nr. KI72/12, *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykimi i 17

dhjetorit 2012, § 61, dhe nr. KI135/14, *IKK Classic*, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, § 58).

(ii)Zbatimi i parimeve të përmendura më lart në rastin e tanishëm

53. Parashtruesi i kërkesës pretendon se edhe me Aktgjykimin e dytë të Gjykatës Supreme [E. Rev. 15/2016 të 16 marsit 2016], nuk arrin të kuptojë pse i mohohen të drejtat e tij për kompensim, duke marrë parasysh që pretendimet thelbësore të tij nuk janë adresuar dhe as nuk janë arsyetuar me Aktgjykimin e lartcekur.

54. Përgjatë tërë sistemit të rregullt gjyqësor, parashtruesi i kërkesës ka pretenduar se duke plotësuar detyrimet ndaj të siguruarit D. H., ai ka fituar të drejtën e subrogimit nga SIGMA (kalimi i të drejtave të siguruarit ndaj personit përgjegjës në siguruesin), siç përcaktohet me Ligjin për Marrëdhëniet Detyrimore (Ligji nr. 04/L-77 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, publikuar në Gazetën Zyrtare më 19 qershor 2012). Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka pretenduar përgjatë tërë sistemit të rregullt gjyqësor se marrëveshja jashtëgjyqësore e arritur mes SIGMA dhe D. H., nuk i përjashton të drejtat e parashtruesit të kërkesës për subrogim dhe se kjo marrëveshje jashtëgjyqësore nuk mund të cenojë të drejtat e parashtruesit të kërkesës, pasi që ka efekt ligjor '*inter-partes*' dhe jo '*erga-omnes*'.

55. Gjykata përmes Aktgjykimit të saj në rastin KI135/14, i ka pranuar këto pretendime të parashtruesit si thelbësore dhe që kërkojnë të adresohen dhe arsyetohen. Gjykata vuri në dukje në mënyrë specifike se në bazë të natyrës dhe rrethanave specifike të rastit, çështjet e mëposhtme thelbësore do të duhej të adresoheshin, për të pasur një vendim që përmbush standardet e të drejtës për një vendim të arsyetuar, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së: "*(i) nëse marrëveshja jashtëgjyqësore e lidhur në mes të SIGMA dhe të siguruarit D. H, ia ka mohuar të drejtën parashtruesit për kompensim, (ii) se si kompensimi i paguar nga SIGMA ndaj të siguruarit D. H. e liroi atë t'ia paguajë kompensimin parashtruesit të kërkesës, si dhe, (iii) se si marrëveshja jashtëgjyqësore në mes të SIGMA-s dhe D. H. mund të prekë të drejtat e parashtruesit të kërkesës, ku është e qartë, se ky i fundit nuk ishte palë në këtë marrëveshje*". (Shih Aktgjykimin e Gjykatës KI135/14, § 51).

56. Gjykata vëren se Gjykata Supreme, në Aktgjykimin e saj të dytë [E. Rev. 15/2016] të 16 marsit 2016, konstatoi që "*Gjykata Kushtetuese,*

(...) ka kthyer në rishqyrtim aktgjykimin e lartpërmendur në Gjykatën Supreme të Kosovës, (...) me arsyetim që Gjykata nuk ka arritur të shpjegojë qartë disa çështje të rëndësishme", të cilat, Aktgjykimi i kontestuar i numëron një nga një, por në të cilat nuk përgjigjet.

57. Në të vërtetë, në përpjekje për të adresuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe Aktgjykimin e Gjykatës në rastin nr. KI135/14, Gjykata Supreme vëren se: *"i siguruari D. H. është kompensuar dy herë nga parashtruesi dhe nga "SIGMA" dhe se: "paditësi ka paguar dëmshpërblim, pa e ditur se i siguruari i saj ka realizuar dëmshpërblimin nga KS "Sigma"*. Prandaj, në Aktgjykimin e kontestuar konsiderohet që *"i siguruari i paditësit, është kompensuar dy herë, në çka nuk ka të drejtë"*. Gjykata Supreme pastaj thekson që*: "Nëse i siguruari i paditësit të mos kishte realizuar direkt dëmshpërblimin nga e paditura, ndaj të padituërës, paditësi përkitazi me regresimin e borxhit për aq sa i ka paguar të siguruarit të saj pa dyshim do të kishte të drejtë".*

58. Prandaj, duket se Gjykata Supreme konsideron se është e padrejtë që i siguruari D. H., është kompensuar dy herë dhe se, nëse D.H. nuk do të ishte kompensuar nga SIGMA, atëherë parashtruesi i kërkesës do të kishte të drejtën e kompensimit. Megjithatë, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme nuk i adreson pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës dhe nuk jep arsyetim adekuat pse janë mohuar të drejtat e tij për kompensim.

59. Më konkretisht, përderisa Aktgjykimi i Gjykatës Supreme pohon se parashtruesi i kërkesës nuk ka të drejtën e kompensimit, pavarësisht faktit se e ka kompensuar të siguruarin D.H., gjë që vetë Gjykata Supreme pohon se nuk është e drejtë, prapëseprapë nuk i jep parashtruesit të kërkesës përgjigje ndaj pretendimeve të tij thelbësore dhe nuk bën arsyetimin e mjaftueshëm vendimit, në veçanti duke pasur parasysh praktikën e saj gjyqësore.

60. Në të vërtetë, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme nuk ka shpjeguar pse parashtruesi i kërkesës nuk ka fituar të drejtën e subrogimit dhe as nuk i është përgjigjur pretendimeve që me Aktgjykimin e Gjykatës në rastin nr. KI135/14 janë përcaktuar si thelbësore, përkatësisht, se si kompensimi i paguar nga SIGMA tek i siguruari D. H., e liroi të parin nga kompensimi i parashtruesit të kërkesës; dhe se si marrëveshja jashtëgjyqësore e arritur ndërmjet SIGMA dhe D.H., mund të ndikojë në të drejtat e parashtruesit të kërkesës, kur është e qartë se ky i fundit nuk ishte palë në atë marrëveshje.

61. Gjykata përsërit, siç ka bërë në Aktgjykimin e saj në rastin nr. KI135/14, (paragrafi 47), se nuk është detyrë e saj që të shqyrtojë nëse Gjykata Supreme e ka interpretuar drejt ligjin e aplikueshëm (ligjshmëria), por të shqyrtojë nëse Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme ka shkelur të drejtat dhe liritë individuale të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). (Shih, gjithashtu Gjykata Kushtetuese rasti nr. KI72/14, parashtruesja e kërkesës *Besa Qirezi*, Aktgjykim i 4 shkurtit 2015, § 65; dhe rasti i GJEDNJ-së *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, § 28).

62. Për më tepër në këtë pikë, Gjykata përsërit që (shih gjithashtu Aktgjykimin e Gjykatës në rastin nr. KI135/14, paragrafi 48), si rregull i përgjithshëm, vërtetimi i fakteve të rastit dhe interpretimi i ligjit janë ekskluzivisht çështje për gjykatat e rregullta, konstatimet dhe konkluzionet e të cilave në këtë drejtim janë detyruese për Gjykatën. Megjithatë, kur vendimi i gjykatës së rregullt është qartazi arbitrar, Gjykata mund dhe duhet ta shqyrtojë atë. (shih GJEDNJ *Sisojeva dhe të tjerët kundër Letonisë*, kërkesa nr. 60654/00, Aktgjykimi i 15 janarit 2007, § 89).

63. Për më tepër, nuk është detyrë e Gjykatës të vendosë se cila do të ishte mënyra më e përshtatshme për gjykatat e rregullta që të merren me argumentet e ngritura. Megjithatë, Gjykata konsideron që Gjykata Supreme, duke injoruar krejtësisht çështjen, edhe pse ishte specifike, relevante dhe e rëndësishme, nuk i kishte plotësuar detyrimet e saj sipas nenit 6, para. 1 të KEDNJ-së. (Shih rasti i GJEDNJ-së *Pronina kundër Ukrainës*, , kërkesa nr. 63566/00, Aktgjykimi i 18 korrikut 2006, § 25).

64. Prandaj, duke marrë parasysh vërejtjet e mësipërme dhe procedurën në tërësi, Gjykata konsideron që Aktgjykimi i dytë i Gjykatës Supreme, përkatësisht [E. Rev.15/2016] i 16 marsit 2016, nuk ka korrigjuar shkeljet e konstatuara me Aktgjykimin e Gjykatës në rastin nr. KI135/14 dhe nuk i ka dhënë arsye të mjaftueshme parashtruesit të kërkesës se përse mohohen të drejtat e tij për kompensim në rrethanat e këtij rasti specifik. Rrjedhimisht, ai nuk i ka plotësuar kriteret e drejtësisë siç kërkohet me nenin 6 të KEDNJ-së. (Shih rasti i GJEDNJ-së *Grădinar kundër Moldavisë*, kërkesa nr. 7170/02, Aktgjykimi i 8 prillit 2008, § 115).

65. Gjykata konsideron se dështimi i Gjykatës Supreme për të dhënë përgjigje të qarta dhe të plota që kanë të bëjnë me të drejtën e parashtruesit të kërkesës për kompensim, siç është përcaktuar gjithashtu nga gjykatat e instancës më të ulët, paraqet shkelje të së drejtës së parashtruesit të kërkesës për t'u dëgjuar dhe të drejtës për

një vendim të arsyetuar, si pjesë përbërëse e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. (Shih Aktgjykimi i Gjykatës, § 59).

66. Gjykata vëren se GJEDNJ gjithashtu kishte konstatuar shkelje të nenit 6.1 të KEDNJ-së (në *Hiro Balani kundër Spanjës*), ku parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar një kërkesë, duke kërkuar përgjigje konkrete dhe të shpejtë. Gjykata nuk arriti të japë një përgjigje, duke e bërë kështu të pamundur për të verifikuar nëse thjesht e kishte neglizhuar këtë çështje, ose kishte për qëllim ta hidhte poshtë atë parashtresë dhe nëse po, cilat ishin arsyet për ta hedhur poshtë atë. (Shih gjithashtu Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KI135/14, § 56).

67. Në pajtim me këtë, duhet të konstatohet se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme [E. Rev. 15/2016] të 16 marsit 2016, nuk ka plotësuar kriteret e një "gjykimi të drejtë" sipas nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6, paragrafi 1 të KEDNJ-së, për shkak të mungesës së vendimit të arsyetuar.

68. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se ky përfundim ekskluzivisht ka të bëjë me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme nga këndvështrimi i mjaftueshmërisë së arsyetimit që ndërlidhet me pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës, dhe në asnjë mënyrë nuk paragjykon rezultatin e meritave të rastit.

69. Në fund, Gjykata konsideron se nuk është e nevojshme të shqyrtohen pretendimet e parashtruesit të kërkesës sa i përket nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, posaçërisht pasi që ka konstatuar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1, të nenit 6 të KEDNJ-së.

Përfundim

70. Në përfundim, Gjykata konstaton se duke mos marrë parasysh dhe duke mos e arsyetuar të drejtën e pretenduar të parashtruesit të kërkesës për kompensim, për më tepër që nuk i ka adresuar konstatimet e Aktgjykimit të Gjykatës në rastin nr. KI135/14, me Aktgjykimin e dytë të Gjykatës Supreme [E. Rev. nr. 15/2016] të 16 marsit 2016, është shkelur e drejta e parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6, paragrafin 1 të KEDNJ-së. Si rezultat i kësaj shkeljeje, parashtruesi i kërkesës u privua nga e drejta e tij për vendim të arsyetuar.

71. Si përmbledhje, në pajtim me rregullin 74 (1) të Rregullores së punës, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme [E. Rev. nr. 15/2016] i 16 marsit 2016

shpallet i pavlefshëm dhe çështja i kthehet Gjykatës Supreme për rishqyrtim.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 113 (7) dhe 116 (1) të Kushtetutës, nenet 47 dhe 48 të Ligjit dhe rregullat 56 (1), 63 (1) (5) dhe 74 (1) të Rregullores së punës, më 4 dhjetor 2017, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1, të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut;

III. TA SHPALLË të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [E. Rev. nr. 15/2016] të 16 marsit 2016;

IV. TA KTHEJË Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [E. Rev. nr. 15/2016] të 16 marsit 2016 për rishqyrtim në pajtim me këtë Aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese;

V. TË MBETET fuqimisht e angazhuar në këtë çështje në pritje të pajtimit me këtë urdhër;

VI. TA URDHËROJË Gjykatën Supreme që ta njoftojë Gjykatën, në pajtim me rregullin 63 (5) të Rregullores së punës, për masat e ndërmarra për ta zbatuar Aktgjykimin e Gjykatës;

VII. TË NJOFTOJË që ky Aktgjykim t'u komunikohet palëve;

VIII. TA PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IX. TË DEKLAROJË se ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Gresa Caka-Nimani	Arta Rama-Hajrizi

KO79/18, Parashtrues: Presidenti i Republikës së Kosovës, Kërkesë për interpretim të nenit 139, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës

KO79/18, Aktvendim i miratuar më 21 nëntor 2018, publikuar më 03.12.2018

Fjalët kyç: kërkesë institucionale, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, grupet parlamentare, çështje kushtetuese, juridiksioni i Gjykatës

Parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata Kushtetuese interpretimin e nenit 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve], paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke shtruar pyetjet në vijim: nga cilat grupet parlamentare duhet të emërohen anëtarët e KQZ-së: *a)* nga grupet parlamentare që kanë dalë nga subjektet politike që i kanë fituar zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës?; apo *b)* nga grupet parlamentare që krijohen pas konstituimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës?".

Gjykata fillimisht vlerësoi nëse kërkesa e parashtruar i plotëson kushtet e pranueshmërisë, sikurse që janë përcaktuar me Kushtetutë dhe që janë saktësuar më tej në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në Rregulloren e punës së Gjykatës.

Parashtruesi, kërkesën e tij për interpretim të nenit 139 (4) të Kushtetutës, e kishte mbështetur në nenin 84 (9), si dhe në nenin 112, paragrafi 1, të Kushtetutës. Në lidhje me këtë, Gjykata sqaroi se Gjykata Kushtetuese, sipas nenit 113, paragrafi 1, të Kushtetutës ka juridiksion të vendosë vetëm për rastet e ngritura para saj në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar. Në këtë kuptim, Gjykata është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës, sipas nenit 112, paragrafi 1, të Kushtetutës, në lidhje me rastet e ngritura para saj sikurse përcaktohet me nenin 113. Gjykata theksoi se ajo nuk merret me interpretime për çështje që lidhen me veprime ose me mosveprime juridike të institucioneve kushtetuese për të cilat nuk është e autorizuar sipas nenit 113 të Kushtetutës. Prandaj, neni 112, paragrafi 1, i Kushtetutës nuk mund të interpretohet jashtë kontekstit të nenit 113 të Kushtetutës. Në lidhje me kuptimin dhe me kufijtë e nenit 84 (9) të Kushtetutës, Gjykata theksoi se kërkesat e parashtruara mbi këtë bazë mund të jenë të pranueshme vetëm brenda juridiksionit të rregullt të Gjykatës, të përcaktuar shprehimisht dhe qartë në nenin 113, paragrafët 2 dhe 3.

Gjykata më tej sqaroi se në praktikën e saj të mëparshme gjyqësore, duke aplikuar kuptimin e zgjeruar të nocionit "çështje kushtetuese", kishte shqyrtuar kërkesa që nuk përfshiheshin shprehimisht në kufijtë e juridiksionit të saj të përcaktuar me nenin 113, paragrafët 2 dhe 3, të

Kushtetutës. Për më tepër, në praktikën e saj, Gjykata kishte theksuar se është në diskrecionin e saj të vendosë nëse çështja e ngritur është një "çështje kushtetuese" dhe për këtë të vendosë nga rasti në rast. Gjykata, në fakt, kishte vlerësuar se jo çdo çështje që parashtruesi i kërkesës pretendon të ngrejë çështje kushtetuese mund të jetë *per se* çështje e tillë.

Gjykata sqaroi më tej se, praktika e mëhershme e Gjykatës në lidhje me trajtimin e kërkesave të parashtruara në kuptimin e gjerë të nocionit "çështje kushtetuese", duhet kuptuar në frymën e procesit të vendosjes së themeleve të gjyqësisë kushtetuese, si dhe të nevojës shoqërore që Gjykata në fillesat e saj të përfshihet në interpretime të neneve specifike të Kushtetutës, sidomos kur çështjet e parashtruara janë ndërlidhur me ushtrimin e kompetencave të Presidentit të përcaktuara me Kushtetutë; kur çështjet e ngritura kanë ndikuar në ndarjen e pushteteve, në ruajtjen e rendit kushtetues, si dhe kur çështjet e ngritura kishin implikime thelbësore në funksionimin e sistemit kushtetues të vendit.

Megjithatë, Gjykata ritheksoi se përmbajtja e dispozitës së nenit 113 të Kushtetutës, marrë në tërësinë e saj, është e qartë dhe konkrete për sa u përket kompetencave të Presidentit që dalin nga konteksti i palës së autorizuar para Gjykatës Kushtetuese. Rrjedhimisht, rezulton që neni 113 paraqet bazën themelore juridiksionale të Gjykatës në lidhje me autorizimet e Presidentit si palë e autorizuar para Gjykatës Kushtetuese.

Andaj, Gjykata gjeti se çështjet e ngritura nga parashtruesi para Gjykatës nuk hyjnë në fushëveprimin e juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese, siç përcaktohet me nenin 113. Rrjedhimisht, në pajtim me nenin 113, paragrafi 1, të Kushtetutës, Gjykata përfundoi se kërkesa është e papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KO79/18

Parashtrues

Presidenti i Republikës së Kosovës

Kërkesë për interpretim të nenit 139, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLLKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Shkëlqesia e Tij, Hashim Thaçi (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Objekti i çështjes

2. Parashtruesi i kërkesës kërkon interpretimin e nenit 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve] paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

3. Parashtruesi i kërkesës i parashtroi Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) pyetjen si në vijim:

> *"Nga cilat grupet parlamentare duhet të emërohen anëtaret e KQZ-së:*

1.1. nga grupet parlamentare që kanë dalë nga subjektet politike që i kanë fituar zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës?; apo

1.2. nga grupet parlamentare që krijohen pas konstituimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës?"

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 84 (9) në lidhje me nenin 113 të Kushtetutës.

5. Më 31 maj 2018, Gjykata miratoi në seancën administrative plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës të Gjykatës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës), e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata i referohet dispozitave juridike të Rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatë

6. Më 7 qershor 2018, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

7. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.

8. Më 17 gusht 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu – Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban.

9. Më 24 gusht 2018 , Gjykata e njoftoi për regjistrimin e kërkesës parashtruesin e kërkesës, Kryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kryetari i Kuvendit) dhe Kryeministrin e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kryeministri).

10. Kryetarit të Kuvendit iu kërkua që një kopje e kërkesës t'i dorëzohet të gjithë deputetëve të Kuvendit dhe i ftoi deputetët që të dorëzojnë komentet e tyre lidhur me kërkesën, nëse kanë, deri më 20 shtator 2018.

11. Më 11 shtator 2018, Gjykata i kërkoi Zyrës së Presidentit dorëzimin e kopjeve të dekreteve të Presidentit të Republikës së Kosovës për

emërimin e anëtarëve të përbërjes së fundit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

12. Më 13 shtator 2018, Zyra e Presidentit dorëzoi në Gjykatë kopjet e dekreteve të kërkuara.

13. Më 19 shtator dhe 20 shtator 2018, Ismet Beqiri, deputet i Kuvendit, Albulena Haxhiu, në emër të grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Visar Ymeri, në emër të grupit parlamentar të Partisë Socialdemokrate dhe Bilall Sherifi, në emër të grupit parlamentar Nisma Socialdemokrate dorëzuan komentet e tyre përkitazi me kërkesën.

14. Më 24 shtator 2018, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës përkitazi me komentet dhe e ftoi që të dorëzojë komentet e tij, nëse ka, deri më 28 shtator 2018. Parashtruesi i kërkesës nuk dorëzoi përgjigje përkitazi me komentet e lartcekura të deputetit dhe grupeve parlamentare.

15. Të njëjtën ditë, Gjykata po ashtu njoftoi Kryetarin e Kuvendit dhe Kryeministrin përkitazi me komentet. Kryetarit të Kuvendit iu kërkua që kopjet e të gjitha komenteve t'u dorëzohen të gjithë deputetëve të Kuvendit.

16. Më 25 shtator 2018, Gjykata i parashtroi pyetje Forumit të Komisionit të Venecias.

17. Më 26 shtator deri më 29 tetor 2018, Gjykata pranoi përgjigjet nga Gjykatat Kushtetuese/Supreme të Austrisë, Holandës, Sllovakisë, Kroacisë, Luksemburgut, Irlandës, Lituanisë, Bullgarisë, Afrikës së Jugut, Norvegjisë, Çekisë, Gjermanisë dhe Letonisë.

18. Më 21 nëntor 2018, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe, me shumicë, i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

19. Të njëjtën ditë, Gjykata votoi, me shumicë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

20. Më 16 dhjetor 2014, Presidentja e Republikës së Kosovës në bazë të nominimit nga grupet parlamentare dhe partitë politike të komuniteteve jo - shumicë të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kuvendi) emëroi anëtarët e Komisionit Qendror për Zgjedhje (në tekstin e mëtejmë: KQZ).

21. Më 11 qershor 2017, u mbajtën zgjedhjet e parakohshme për Kuvend.

22. Më 21 qershor 2017, Presidenti shpalli zgjedhjet për kuvende komunale dhe kryetarë të komunave në Republikën e Kosovës.

23. Më 8 korrik 2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (në tekstin e mëtejmë: KQZ) certifikoi rezultatet e zgjedhjeve për Kuvend.

24. Me 3 gusht 2017, Kuvendi mbajti seancën konstituive dhe mes tjerash formoi Komisionin *ad hoc* për verifikimin e kuorumit dhe mandateve (në tekstin e mëtejmë: Komisioni *ad hoc*)

25. Të njëjtën ditë, Komisioni *ad hoc* paraqiti raportin, bazuar ne listën e rezultateve te certifikuara te zgjedhjeve dhe konstatoi mandatet si në vijim:

    a. Partia Demokratike e Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Nisma për Kosovën, Partia e Drejtësisë, Lëvizja për Bashkim, Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës, Partia Konservatore e Kosovës, Alternativa Demokratike e Kosovës, Republikanët e Kosovës, Partia e Ballit, Partia Socialdemokrate, Balli Kombëtar i Kosovës (në tekstin e mëtejmë: PDK, AAK dhe Nisma), 39 deputetë;

    b. Lëvizja "Vetëvendosje!" (në tekstin e mëtejmë: LVV), 32 deputetë;

    c. Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Aleanca Kosova e Re (në tekstin e mëtejmë: LDK dhe AKR), 29 deputetë;

    d. Građanska Iniciativa Srpska lista, 9 deputetë;

    e. Kosova Demokratik Tyrk Partisi, 2 deputetë;

    f. Koalicija "Vakat", 2 deputetë;

    g. Nova Demokratska Stranka, 1 deputet;

    h. Samostalna Liberalna Stranka, 1 deputet;

    i. Partia Demokratike e Ashkalinjëve të Kosovës, 1 deputet;

    j. Partia Liberale Egjyptiane, 1 deputet;

    k. Jedinstvena Goranska Partija, 1 deputet;

    l. Partia e Ashkalinjëve për Integrim, 1 deputet; dhe

    m. Partia Rome e Bashkuar e Kosovës, 1 deputet.

26. Më 7 shtator 2017, me zgjedhjen e Kryetarit dhe Nënkryetarëve u konstituua Kuvendi.

27. Në shtator të vitit 2017, një numër deputetësh, njoftuan Kryetarin e Kuvendit për themelimin e Grupit të ri Parlamentar, Nisma Socialdemokrate.

28. Në shtator të vitit 2017, një numër deputetësh, njoftuan Kryetarin e Kuvendit për themelimin e Grupit të ri Parlamentar, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (në tekstin e mëtejmë: AAK).

29. Më 22 tetor 2017, u mbajtën zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës.

30. Më 27 dhjetor 2017, KQZ certifikoi rezultatin e zgjedhjeve lokale.

31. Më 14 mars 2018, dymbëdhjetë (12) deputetë, njoftuan Kryetarin e Kuvendit për themelimin e Grupit të ri Parlamentar, Grupi i Deputetëve të Pavarur.

32. Më 27 prill 2018, Presidenti i Republikës, emëroi znj. Valdete Daka, Kryesuese të KQZ-së.

Kërkesa e parashtruesit

33. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës kërkon interpretimin e nenit 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve] paragrafi 4, të Kushtetutës.

34. Në dritën e kërkesës së tij, parashtruesi kërkon nga Gjykata që të përgjigjet në pyetjet vijuese:

> *"Nga cilat grupet parlamentare duhet të emërohen anëtaret e KQZ-së:*
>
> *1.3. nga grupet parlamentare që kanë dalë nga subjektet politike që i kanë fituar zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës?; apo*
>
> *1.4. nga grupet parlamentare që krijohen pas konstituimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës?"*

35. Në lidhje me pyetjen e lartcekur, parashtruesi e sqaron kërkesën e tij si në vijim:

"Në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (GZ, Nr. 31, 15 qershor 2008), Presidenti është në fazën e emërimit të anëtarëve të KQZ-së me mandat të ri.

Për të shmangur çdo dilemë në emërimin e anëtarëve të KQZ-së, kërkoj nga Gjykata Kushtetuese që në frymën e Kushtetutës, të interpretojë nenin 139, paragrafi 4, të Kushtetutës […]."

36. Në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, parashtruesi argumenton:

"Kërkesa parashtrohet në pajtim me nenin 84 (9) të Kushtetutës, ngase kjo dispozitë i jep Presidentit kompetencë të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese, kur ka të paqartë çështje kushtetuese, të cilat i has gjatë ushtrimit të kompetencave të garantuara me Kushtetutë dhe me qëllim të realizmit të rolit primar të Presidentit, si përfaqësues i unitetit juridik kushtetues të popullit të Kosovës dhe si garantues i funksionimit demokratik të institucioneve dhe të sistemit kushtetuese të Republikës së Kosovës."

37. Sipas parashtruesit të kërkesës: *"Kompetenca e Gjykatës Kushtetuese për interpretimin e Kushtetutës, është përcaktuar me nenin 112.1 të Kushtetutës:*

"Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.

Neni 84 (9), i Kushtetutës shprehimisht i jep Presidentit kompetencë për të referuar çështje në Gjykatën Kushtetuese. Kjo kompetencë sipas kësaj dispozite kushtetuese është një kompetencë e gjerë dhe nuk i nënshtrohet asnjë kufizimi, përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet specifike të renditura në nenin 113 të Kushtetutës.

Presidenti bart përgjegjësinë e zbatimit të Kushtetutës dhe garantimin e funksionimit demokratik dhe kushtetues të institucioneve të Republikës së Kosovës. Në zbatimin e një përgjegjësie të tillë kushtetuese, Presidenti mund të dërgojë çështje në Gjykatën Kushtetuese, në raste kur nevojitet qartësim në lidhje me një situatë kur dispozita kushtetuese është e paqartë, dhe kërkohet të merret Vendim që prodhon efekte juridike.

Në këtë kontekst, paraqiten paqartësi se cilat janë grupet parlamentare që kanë të drejtën e nominimit/propozimit të anëtarit/ve për t'u emëruar anëtar/e të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (Në tekstin në vijim: KQZ), nga ana e Presidentit. Në këtë drejtim, Presidenti shfrytëzon kompetencën e tij kushtetuese për referim të kësaj çështje kushtetuese, për të sqaruar se nga cilat grupe parlamentare duhet të emërohen anëtarët e KQZ-së."

38. Parashtruesi i kërkesës, më tej, arsyeton se: *"Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 112 të Kushtetutës, është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën dhe në pajtim me nenin 113 të Kushtetutës ka jurisdiksion të vendosë vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar. Pa dyshim, në këtë rast, këto dy kushte plotësohen dhe rrjedhimisht Gjykata Kushtetuese duhet të bëjë interpretimin e dispozitave kushtetuese kurdo që një çështje i adresohet asaj nga institucione të mandatuara për referim. Në rastin konkret, kërkohet interpretimi i nenit 139, paragrafi 4 i Kushtetutës, në atë mënyrë që të qartësohet kjo dispozitë kushtetuese dhe t'i mundësohet Presidentit të konsolidojë KQZ-në, duke i emëruar anëtarët e saj."*

39. Parashtruesi i kërkesës në fund thekson se*: "[n]ë rrjedhë të asaj që u theksua më lartë, pranueshmëria e kësaj kërkese nga Gjykata Kushtetuese është e vetëkuptueshme."*

Pyetjet e parashtruara Forumit të Komisionit të Venecias dhe përmbledhja e përgjigjeve

Pyetjet

1. A ekziston ndonjë përkufizim kushtetues për grupin parlamentar (grupet parlamentare)?
2. A ka ndonjë afat kushtetues (ligjor) prej kur themelohet zyrtarisht një grup parlamentar? Në cilën fazë autorizohen (kanë të drejtë) grupet parlamentare të propozojnë ose të nominojnë kandidatë për emërim në organe të ndryshme (p.sh., në komisione parlamentare, në komisione parlamentare ad hoc, në institucione të pavarura)?
3. Nëse është e zbatueshme në vendin tuaj, cila është praktika relevante për emërimin e anëtarëve të KQZ-së, më konkretisht, a zgjidhen anëtarët e KQZ-së:

(a) nga radhët e grupeve parlamentare që dalin nga subjektet politike që kanë dalë drejtpërsëdrejti nga zgjedhjet, dhe si të tilla kanë fituar ulëse në Kuvend/Parlament; ose

(b) *nga radhët e grupeve parlamentare që janë krijuar pas konstituimit të Kuvendit/Parlamentit (dhe të cilat mund të korrespondojnë, ose jo, me grupet parlamentare që kanë dalë automatikisht nga subjektet (koalicionet) politike që kanë marrë pjesë në procesin zgjedhor?*

A ka ndonjë praktikë gjyqësore relevante në lidhje me objektin e çështjes që mbulohet nga pyetjet paraprake ose ndonjë situatë tjetër që mund të jetë relevante për qëllimet e këtij objekti të çështjes?

Përgjigjet e Gjykatave Kushtetuese/Supreme, të dorëzuara përmes Forumit të Komisionit të Venecias

40. Bazuar në përgjigjet e Gjykatave Kushtetuese/Supreme, të dorëzuara përmes Forumit të Komisionit të Venecias, vërehet se dispozitat e kushtetutave të këtyre shteteve nuk parashohin një përkufizim për grupet parlamentare.

41. Po ashtu, bazuar në përgjigjet e Gjykatave Kushtetuese/Supreme, të dorëzuara përmes Forumit të Komisionit të Venecias, rezulton që në shumicën e këtyre shteteve, Komisionet Qendrore Zgjedhore janë Komisione të përhershme dhe profesionale që përbëhen nga përfaqësues të institucioneve të ndryshme, atyre qeveritare dhe të gjyqësorit. Ndërkaq, në disa raste janë të përbëra nga anëtarë që propozohen qoftë drejtpërsëdrejti nga partitë politike, apo nga grupet parlamentare të përfaqësuara në Parlament.

Komentet e paraqitura nga deputeti Ismet Beqiri dhe nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare

Komentet e deputetit Ismet Beqiri

42. Deputeti Ismet Beqiri në komentet e paraqitura më 19 shtator 2018, ndër të tjera, argumentoi se *"[...] kjo dispozitë, është e qartë edhe për faktin se implementimi i saj në praktikë nuk është duke ndodhur për herë të parë në shtetin tonë. Të gjitha përbërjet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që nga hyrja në fuqi e kësaj Kushtetute dhe themelimi i KQZ-së, janë ndërtuar duke e marrë për baze numrin e grupeve parlamentare ashtu siç kanë dalë nga procesi zgjedhor, duke u*

bazuar në rezultatet e tyre dhe në procesin e verifikimit të grupeve dhe të mandateve të secilit deputet veç e veç në seancat konstituive të të gjitha legjislaturave të mëhershme. Si e tillë, kjo formulë e ndarjes së vendeve ka qene gjithmonë e pranueshme nga të gjithë akterët dhe si rrjedhoje nuk kemi pasur asnjëherë ndonjë kontestim dhe as me të voglën dilemë në frymën e pyetjes së shtruar për institucionin Tuaj nga ana e Presidentit të Kosovës."

43. Z. Beqiri, më tej, arsyeton se *"[...] në dispozitën për të cilën është kërkuar interpretim behët fjale vetëm për grupet parlamentare të cilat si të tilla dalin nga procesi zgjedhor, dhe jo për grupet të cilat mund të krijohen, shuhen, krijohen e shuhen... në pa kufi raste gjatë një legjislature [...]."*

44. Sipas z. Beqiri *"[...] në pajtim me nenin 61, paragrafi 4 të Ligjit 03/L-073 Për Zgjedhjet e Përgjithshme limiti i epërm kohor është gjashtëdhjetë (60) ditë dhe se procesi i emërimit të anëtareve të KQZ së mund të zhvillohet menjëherë pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve, madje edhe para konstituimit të Kuvendit (sepse sipas nenit 66.1 të Kushtetutës, seanca konstituive e Kuvendit të Kosovës duhet të mbahet brenda 30 ditësh nga shpallja e rezultateve të zgjedhjeve)."*

45. Z. Beqiri përfundon: *"Prandaj interpretimi ndryshe, nga ai që e gjejmë të qartë në përmbajtjen e nenit 139.4 të Kushtetutës dhe të praktikuar në vazhdimësi deri më sot, se vendet në KQZ ndahen nga grupet të cilat si të tilla kanë dalë nga zgjedhjet, nuk ka asnjë logjikë juridike e as institucionale dhe do ta dëmtonte jashtëzakonisht shumë KQZ-në dhe punën e këtij institucioni kaq të ndjeshëm."*

Komentet e Grupit parlamentar Lëvizja Vetëvendosje

46. Në komentet e paraqitura nga znj. Albulena Haxhiu në emër të Grupit parlamentar të Vetëvendosjes më 20 shtator 2018, ndër të tjera u theksua: "*Paragrafi 4, i nenit 61 te Ligjit për Zgjedhje te Përgjithshme e përcakton se "Mandati i anëtareve të KQZ-se fillon jo me vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve për Kuvend ". Ky paragraf, përtej afatit se kur duhet të filloje më së voni mandati i anëtareve të KQZ-së, e qartëson gjithashtu edhe kriterin ligjor mbi subjektet legjitime për të bërë nominime për anëtarë të KQZ-se, sikurse qe e garanton mekanizmin e domosdoshëm për vazhdimësi institucionale të një institucioni të përhershëm kushtetues. Po e theksojmë, ky afat lidhet me ditën e certifikimit te rezultateve të zgjedhjeve dhe jo me ditën apo datën e konstituimit të Kuvendit. Nga kjo shihet se funksionalizimi i KQZ-së nuk ka kurrfarë ndërlidhje me konstiuimin e Kuvendit. Madje konstituimi i Kuvendit*

mund të shkojë përtej kësaj periudhe prej 60 ditësh nga certifikimi i rezultateve të zgjedhjeve, sikurse që dështimi i Kuvendit pas konstituimit për të zgjedhur Kryeministrin do ta qonte vendin në zgjedhje të parakohshme, për të cilat KQZ do të duhej të ishte tashmë funksionale."

47. Në vijim, Znj. Haxhiu arsyeton se *"Nisur nga fryma e Kushtetutës së Republikës, në përputhje me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese Nr.KO119/14, mbështetur në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe në bazë të vendimit të KQZ-së për certifikimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të përgjithshme të 11 qershorit 2017, Komisioni Qendror Zgjedhor duhet të përbehet nga anëtarët që përfaqësojnë grupet parlamentare që kane dalë si subjekte politike nga rezultati i zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës dhe që kanë kaluar pragun parlamentar.[...]."*

Komentet e Grupit parlamentar Partia Socialdemokrate

48. Në komentet e paraqitura nga z. Visar Imeri, në emër të Grupit parlamentar të PSD më 20 shtator 2018 u theksua si në vijim:

> *"Teksti kushtetues në këtë dispozitë ka përdorur termin "të përfaqësuara". Termi i tillë që është përdorur në këtë dispozitë ka karakter post festum. Kjo nënkupton se jo domosdoshmërisht subjekti politik që ka fituar mandate të caktuara në Kuvend do të jetë përfaqësuar në nivel të grupit parlamentar me poaq deputetë të mandatuar. Dhe meqenëse baza e fitimit të së drejtës për të nominuar përfaqësuesin për emërim në cilësi të anëtarit të KQZ-së ndërlidhet ngushtë me autorizimet kushtetuese lidhur me morfologjinë e mandatit kushtetues të deputeteve, si anëtarë të organit me te lartë kushtetues me karakter ligjvënës. Është dispozita e nenit 70, paragrafit 1 e cila i jep lirinë e ushtrimit te funksionit te deputetit brenda mandatit të tij duke mos iu nënshtruar asnjë mandati tjetër të detyrueshëm. Përforcimi i lirisë së përcaktimit politik brenda strukturës politike të deputeteve si anëtarë te Kuvendit, ndërlidhet me vetë natyrën e përfaqësimit. Përfaqësimi është nocion dinamik. Pra është i lëvizshëm. Dinamizmi i tij shprehet edhe me përkufizimin e mandatit në kuptim kohor. Këto janë madje ndër prerogativat themelore të demokracisë përfaqësuese, meqë përmes kufizimit kohor të mandateve stimulohet dinamizmi i përfaqësimit."*

49. Në fund z. Imeri vlerësoi: *"Të gjitha këto pyetje eliminohen me interpretimin e tillë që "Presidenti do të emëroje anëtarët e KQZ-së*

nga radhët e grupeve parlamentare -ato që janë krijuar dhe funksionojnë në kuadrin e strukturës së brendshme politike të Kuvendit. […] Andaj, sipas të thënave si më lartë, konsiderojmë se në pyetjet alternative që janë përfshire në Kërkesën KO79/18 nga Presidenti i Kosovës, përgjigja për interpretim të dispozitës se nenit 139 paragrafit 4 të Kushtetutës së Kosovës duhet gjetur në modalitetin e pyetjes së dytë, respektivisht se: " Anëtaret e KQZ-së duhet zgjedhur nga radhët e grupeve parlamentare me të drejtë të nominimit të përfaqësuesve në KQZ, që janë krijuar pas konstituimit të Kuvendit të Kosovës, respektivisht sipas gjendjes në të cilën reflekton përbërja e grupeve parlamentare kur duhet bërë nominimi i përfaqësuesve për emërim në KQZ."

Komentet e Grupit parlamentar Nisma Socialdemokrate

50. Më 20 shtator 2018, z. Bilall Sherifi, në emër të Grupit parlamentar Nisma Socialdemokrate në thelb theksoi si në vijim:

> *"Pyetja e Presidentit të Republikës së Kosovës për Gjykatën Kushtetuese nuk ka relevancë juridike kushtetuese për emërimin e anëtarëve të KQZ-së për sa i takon kohës së themelimit të Grupeve Parlamentare pasi që ekziston sipas interpretimit të gjykatës KO119/14 vetëm një kohë dhe ajo është pas Konstituimit të Kuvendit.*
> *1. Nuk ekzistojnë grupet parlamentare të dala nga zgjedhjet dhe pas konstituimit të Kuvendit siç Presidenti e ka parashtruar pyetjen, por ekzistojnë grupet parlamentare vetëm pas Konstituimit të Kuvendit.*
>
> *2. Nuk ekziston asnjë dilemë juridike që Grupet Parlamentare të themeluara pas Konstituimit të Kuvendit duhet të përfaqësohen me anëtar sipas fuqisë së votës në KQZ shih nenin 139 të Kushtetutës se Republikës së Kosovës dhe nenit 61 të Ligjit Nr.03/L-073/2008.*
>
> *Grupi Parlamentar i Nismasocialdemokrate bazuar nga argumentet e parashtruara në këto komente është e bindur se Gjykata Kushtetuese do të ruaj kontinuitetin e interpretimit të saj në aktgjykimin KO119/14, përkitazi me relevancë kohore të themelimit të grupeve parlamentare siç është përshkruar me lartë ashtu që Grupi Parlamentar i Nisma që tash ka 8 deputet të ketë të drejtën e përfaqësimit me anëtar në Komisionin Qendror Zgjedhor konform nenit 139 të Kushtetutës së Republikës se Kosovës dhe nenit 61 të Ligjit Për Zgjedhjet Qendrore në Republikën e Kosovës."*

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 84
[Kompetencat e Presidentit]

[...]

(26) emëron Kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;

[...]

Neni 112
[Parimet e Përgjithshme]

1. Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.

[...]

Neni 139
[Komisioni Qendror i Zgjedhjeve]

[...]

3. Kryesuesin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, e emëron Presidenti i Republikës së Kosovës nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe të Gjykatave me jurisdiksion apeli.

4. Gjashtë (6) anëtarë emërohen nga pjesëtarët e gjashtë grupeve më të mëdha parlamentare të përfaqësuara në Kuvend, të cilët nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e vendeve të rezervuara. Nëse në Kuvend janë të përfaqësuara më pak grupe, grupi a grupet më të mëdha mund të emërojnë anëtarë shtesë. Një (1) anëtarë emërohet nga deputetët e Kuvendit të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetin Serb të Kosovës dhe tre (3) anëtarë nga deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetet e tjera që nuk janë shumicë në Kosovë.

Ligji Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (publikuar në Gazetën Zyrtarë më 15 qershor 2008)

Neni 61

Mandati dhe Emërimi i Anëtarëve të KQZ-së

61.1 Kryesuesi i KQZ-së emërohet në pajtueshmëri me nenin 139.3 të Kushtetutës së Kosovës.

61.2 Mandati i Kryetarit të KQZ-së është shtatë (7) vjet duke filluar nga data e caktuar për njoftim të emërimit nga Presidenti i Kosovës.

61.3 Neni 139.4 i Kushtetutës së Kosovës parasheh se caktimi i anëtarëve të KQZ-së duhet të bëhet sipas procedurave në vijim:

a) Brenda dhjetë (10) ditëve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, grupet parlamentare me të drejtë të caktimit të anëtarit(ve) në KQZ e njoftojnë Presidentin e Kosovës për nominimin e tyre. Pas sigurimit se individi i caktuar nga grupi parlamentar i përshtatet kërkesave të këtij ligji, Presidenti i Kosovës, brenda pesë (5) ditëve e konfirmon me shkrim emërimin. Emërimi hyn në fuqi në ditën e shënuar në Emërimin zyrtar nga Presidenti i Kosovës;
b) Kryesuesi i KQZ-së nuk shërben në më shumë se dy (2) mandate të njëpasnjëshme;
c) Anëtarët e KQZ-së nuk shërbejnë në më shumë se tri (3) mandate të njëpasnjëshme;
d) Përfundimi i mandatit bëhet në ditën e fundit të muajit kalendarik, në të njëjtin muaj në të cilin ka filluar mandati;

e) Pavarësisht nga pika (d) e këtij paragrafi mandati që përfundon nëntëdhjetë (90) ditë ose më pak para zgjedhjeve ose deri 90 ditë pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve, automatikisht zgjatet për 90 ditë pas certifikimit të rezultateve zgjedhore.

61.4 Mandati i anëtarëve të KQZ-së fillon jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve për Kuvend.

Pranueshmëria e kërkesës

51. Gjykata fillimisht vlerëson nëse kërkesa e parashtruar i plotëson kushtet e pranueshmërisë, sikurse që janë përcaktuar me Kushtetutë

dhe saktësuar më tej në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në Rregulloren e Punës.

52. Neni 113, paragrafi 1, i Kushtetutës përcakton që *"Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar"*.

53. Gjykata thekson që Presidenti i Republikës së Kosovës është palë e autorizuar sipas nenit 113 [*Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara*], paragrafët 2 dhe 3, të Kushtetutës.

54. Në bazë të nenit 113, paragrafi 2, të Kushtetutës, *"[...] Presidenti i Republikës së Kosovës [...][është i] autorizuar të ngrejë rastet në vijim*:

> *(1) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të [...] Kryeministrit, dhe të rregulloreve të qeverisë, me Kushtetutën;*
>
> *(2) përputhshmëria e Statutit të Komunës më Kushtetutën.*

55. Më tej, neni 113, paragrafi 3, i Kushtetutës, përcakton që *[...], Presidenti i Republikës së Kosovës [...][është i] autorizuar të ngrejë çështjet në vijim:*

> *(1) konflikti në mes të kompetencave kushtetuese të Kuvendit të Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës;*
> *(2) përputhshmëria e referendumit të propozuar me Kushtetutën;*
> *(3) përputhshmëria e shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme dhe veprimeve të ndërmarra gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme me Kushtetutën;*
> *(4) përputhshmëria e një amendamenti të propozuar kushtetues me marrëveshjet e detyrueshme ndërkombëtare, të ratifikuara sipas kësaj Kushtetute dhe rishikimi i kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur;*
> *(5) nëse është shkelur Kushtetuta gjatë zgjedhjes së Kuvendit.*

56. Në këtë drejtim, neni 113, paragrafët 2 dhe 3 të Kushtetutës, shprehimisht parasheh rastet që Presidenti i Republikës mund t'ia referojë Gjykatës Kushtetuese.

57. Rrjedhimisht, Gjykata thekson që e drejta e palëve të autorizuara sipas Kushtetutës, për të parashtruar kërkesa në Gjykatë, buron nga neni 113 i Kushtetutës. Përjashtim nga kjo përbën situata që ndërlidhet me nenin 62 [Përfaqësimi në Organet e Pushtetit Lokal], paragrafi 4, të Kushtetutës, si dhe rastet që mund të burojnë nga juridiksioni shtesë

që mund të rregullohet me ligj, siç parashihet në nenin 113, paragrafi 10, të Kushtetutës.

58. Neni 62, paragrafi 4 i Kushtetutës përcakton:

> *"Në rast se kuvendi i komunës vendos që të mos rishqyrtojë aktin a vendimin e vet, ose nëse zëvendëskryetari vlerëson se, edhe pas rishqyrtimit rezultati përbën shkelje të të drejtave të garantuar me Kushtetutë, ai/ajo mund të parashtrojë çështjen drejtpërdrejt në Gjykatën Kushtetuese, e cila mund të vendosë nëse do ta paranojë ta shqyrtojë rastin përkatës."*

59. Megjithatë, edhe në lidhje më këtë përjashtim, kur rasti mbi këtë bazë parashtrohet drejtpërsëdrejti në Gjykatën Kushtetuese, është në diskrecionin e Gjykatës që të vendosë nëse do të pranojë ta shqyrtojë rastin përkatës (Shih Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në rastin KO01/09, *Parashtrues: Qemajl Kurtishi,* zëvendës Kryetar i Komunës së Prizrenit, të 18 marsit 2010).

60. Gjykata rikujton se parashtruesi kërkon interpretimin e nenit 139 [Komisioni Qendror për Zgjedhje], paragrafit 4, të Kushtetutës, dhe kërkesën e tij për interpretim e ka mbështetur në nenin 84 (9), si dhe në nenin 112, paragrafi 1, të Kushtetutës.

61. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren që çështja që ngrit parashtruesi i kërkesës para Gjykatës nuk hyn në fushëveprimin e juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese siç parashihet me paragrafët 2 dhe 3 të nenit 113 të Kushtetutës. Për më tepër, një gjë e tillë as nuk është kërkuar apo saktësuar nga parashtruesi në kërkesën e tij.

62. Në vijim, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës thekson: "*Neni 84 (9), i Kushtetutës shprehimisht i jep Presidentit kompetencë për të referuar çështje në Gjykatën Kushtetuese. Kjo kompetencë sipas kësaj dispozite kushtetuese është një kompetencë e gjerë dhe nuk i nënshtrohet asnjë kufizimi, përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet specifike të renditura në nenin 113 të Kushtetutës.*"

63. Parashtruesi i kërkesës deklaron tutje se, sipas nenit 84 (9) të Kushtetutës, Presidenti ka kompetencë të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese "*[...] ngase kjo dispozitë i jep Presidentit kompetencë të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese, kur ka të paqartë çështje kushtetuese, të cilat i has gjatë ushtrimit të kompetencave të garantuara me Kushtetutë dhe me qëllim të realizmit të rolit primar të Presidentit, si përfaqësues i unitetit juridik kushtetues të popullit të Kosovës dhe si garantues i funksionimit*

demokratik të institucioneve dhe të sistemit kushtetues të Republikës së Kosovës... Presidenti mund të dërgojë çështje në Gjykatën Kushtetuese, në raste kur nevojitet qartësim në lidhje me një situatë kur dispozita kushtetuese është e paqartë, dhe kërkohet të merret Vendim që prodhon efekte juridike."

64. Po ashtu, parashtruesi deklaron se "*Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 112 të Kushtetutës, është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën dhe në pajtim me nenin 113 të Kushtetutës ka juridiksion të vendosë vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar...*" duke shtuar se *"[...] pranueshmëria e kësaj kërkese nga Gjykata Kushtetuese është e vetëkuptueshme."*

65. Në lidhje me këtë, Gjykata rithekson se neni 112 i Kushtetutës përcakton që Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe të përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.

66. Andaj, ashtu siç me të drejtë specifikohet në përmbajtjen e kërkesës së parashtruesit, Gjykata Kushtetuese, sipas nenit 113, paragrafit 1 të Kushtetutës ka juridiksion të vendosë vetëm për rastet e ngritura para saj në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

67. Në këtë kuptim, Gjykata është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës, sipas nenit 112, paragrafit 1 të Kushtetues, në lidhje me rastet e ngritura para saj sikurse përcaktohet me nenin 113. Gjykata nuk merret me interpretime për çështje që lidhen me veprime ose mosveprime juridike të institucioneve kushtetuese për të cilat nuk është e autorizuar sipas nenit 113 të Kushtetutës. Prandaj, neni 112, paragrafi 1, i Kushtetutës nuk mund të interpretohet jashtë kontekstit të nenit 113 të Kushtetutës.

68. Në lidhje me kuptimin dhe me kufijtë e nenit 84 (9) të Kushtetutës, Gjykata thekson se kërkesat e parashtruara mbi këtë bazë mund të jenë të pranueshme vetëm brenda juridiksionit të rregullt të Gjykatës, të përcaktuar shprehimisht dhe qartë në nenin 113, paragrafët 2 dhe 3.

69. Gjykata, në praktikën e saj të mëparshme gjyqësore, duke aplikuar kuptimin e zgjeruar të nocionit "çështje kushtetuese", kishte shqyrtuar kërkesa që nuk përfshihen shprehimisht në kufijtë e juridiksionit të saj të përcaktuar me nenin 113, paragrafët 2 dhe 3, të Kushtetutës. Gjykatës i ishte kërkuar nga Presidenti/ja e Republikës që të interpretojë kuptimin e dispozitave specifike të Kushtetutës (shih, p. sh., rastin nr. KO80/10, *Presidenti i Republikës së Kosovës;* Aktgjykim i 7 tetorit 2010; rasti nr. KO97/10, *Ushtruesi i detyrës së*

Presidentit të Republikës së Kosovës, Aktgjykim i 28 dhjetorit 2010; rasti nr. KO57/12, *Presidentja* e *Republikës së Kosovës,* Aktgjykim i 22 tetor 2012; rasti nr. KO103/14, *Presidentja* e *Republikës së Kosovës,* Aktgjykim i 1 korrikut 2014)·

70. Gjithashtu, në praktikën e saj, Gjykata kishte theksuar se është në diskrecionin e saj të vendosë nëse çështja e ngritur është një *"çështje kushtetuese"* dhe për këtë të vendosë nga rasti në rast. Gjykata, në fakt, kishte vlerësuar se *"jo çdo çështje që [parashtruesi i kërkesës] pretendon të ngrejë çështje kushtetuese mund të jetë per se çështje e tillë"* (Shih Aktgjykimin në rastin KO130/15, Presidentja e Republikës së Kosovës, në *lidhje me përputhshmërinë e parimeve që përmban dokumenti i titulluar "Asociacioni/Bashkësia i komunave me shumicë serbe në Kosovë - Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore" me frymën e Kushtetutës, me nenin 3 [Barazia para Ligjit], paragrafi 1, me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] dhe me Kapitullin III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës i cekur më lart,* Aktgjykim i 23 dhjetorit 2015, paragrafi 101).

71. Praktika e mëhershme e Gjykatës në lidhje me trajtimin e kërkesave të parashtruara në kuptimin e gjerë të nocionit "çështje kushtetuese", duhet kuptuar në frymën e procesit të vendosjes së themeleve të gjyqësisë kushtetuese, si dhe të nevojës shoqërore që Gjykata në fillesat e saj të përfshihet në interpretime të neneve specifike të Kushtetutës, sidomos kur çështjet e parashtruara janë ndërlidhur me ushtrimin e kompetencave të Presidentit të përcaktuara me Kushtetutë; kur çështjet e ngritura kanë ndikuar në ndarjen e pushteteve; në ruajtjen e rendit kushtetues; si dhe kur çështjet e ngritura kishin implikime thelbësore në funksionimin e sistemit kushtetues të vendit (Shih Aktgjykimin në rastin KO130/15, *Presidentja e Republikës së Kosovës*, të cekur më lart, paragrafët 104, 107 dhe 109. Shih, po ashtu, rastin nr. KO103/14, *Presidentja* e *Republikës së Kosovës*, të cekur më lart, Aktgjykim i 1 korrikut 2014, paragrafët 27, 57 dhe 61).

72. Megjithatë, Gjykata në përbërjen e saj aktuale, vlerëson se në përputhje të plotë me gjuhën e qartë, shteruese dhe kufizuese të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të gjitha referencat tjera në Kushtetutë që ndërlidhen me ngritjen e çështjeve kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese, burojnë nga neni 113.

73. Mbi këtë bazë, Gjykata gjen se kërkesa e parashtruar nuk bie në kufij të nenit 113, për shkak se në bazë të nenit 113, paragrafi 2, Presidenti mund të ngrejë çështje që ndërlidhen me përputhshmërinë me

Kushtetutën të ligjeve, të akteve të Qeverisë dhe të Kryeministrit, të përcaktuara në 113.2 (1), si dhe të Statutit të Komunës, të përcaktuar në 113.2 (2) të Kushtetutës.

74. Ndërsa, në bazë të nenit 113, paragrafi 3, Presidenti është i autorizuar të ngrejë çështje që ndërlidhen me situata të konfliktit të kompetencave kushtetuese të Kuvendit, Presidentit dhe të Qeverisë; përputhshmërinë e referendumit me Kushtetutën; përputhshmërinë e shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme dhe veprimeve të ndërmarra gjatë kësaj gjendjeje, me Kushtetutën; përputhshmërinë e amendamenteve të propozuara kushtetuese me marrëveshjet ndërkombëtare dhe rishikimin e kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur; si dhe kushtetutshmërinë e procesit të zgjedhjes së Kuvendit.

75. Rrjedhimisht, edhe kompetenca e parashtruesit të kërkesës, sipas nenit 84 (9) të Kushtetutës, duhet të ndërlidhet me juridiksionin e Gjykatës të përcaktuar me nenin 113, paragrafët 2 dhe 3 të Kushtetutës, e cila përcakton shprehimisht dhe në mënyrë shteruese çështjet që Presidenti i Republikës mund t'ia referojë Gjykatës Kushtetuese.

76. Duke u nisur nga fakti që Kushtetuta ka përcaktuar shprehimisht juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, përfshirë edhe palët e autorizuara për aktivizimin e juridiksionit të saj, Gjykatës i është kufizuar mundësia që të marrë rol konsultativ apo këshillëdhënës, ngase ky rol do të binte ndesh me rolin e saj themelor për vendosjen e rasteve të ngritura para saj. Praktika e vendeve të tjera njeh raste kur gjykatat kushtetuese kanë ushtruar juridiksion këshillëdhënës, por më vonë një praktikë e tillë e juridiksionit të natyrës konsultative është hequr për shkak të inkompatibilitetit të saj me natyrën vendimmarrëse të gjykatave kushtetuese. Konkretisht, në rastin e Gjykatës Kushtetuese të Gjermanisë, Ligji për Gjykatën Federale Kushtetuese, në fillet e ekzistimit të saj kishte paraparë mundësinë e dhënies së mendimeve këshillëdhënëse nga kjo gjykatë (Ligji për Gjykatën Federale Kushtetuese të Gjermanisë, *BVerfGG*, i 12 marsit 1951). Megjithatë, vetëm disa vite më vonë, për shkak të natyrës detyruese të "mendimeve këshilluese", dispozita e ligjit të lartcekur, që lejonte një juridiksion të tillë, ishte shfuqizuar (më 21 korrik 1956).

77. Gjykata rithekson se përmbajtja e dispozitës së nenit 113 të Kushtetutës, marrë në tërësinë e saj, është e qartë dhe konkrete për sa u përket kompetencave të Presidentit që dalin nga konteksti i palës së autorizuar para Gjykatës Kushtetuese.

78. Rrjedhimisht, rezulton që neni 113 paraqet bazën themelore dhe të vetme juridiksionale të Gjykatës në lidhje me autorizimet e Presidentit si palë e autorizuar para Gjykatës Kushtetuese.

79. Gjykata, për më tepër, rikujton se parashtruesi në kërkesën tij kërkon interpretimin e nenit 139, paragrafi 4, të Kushtetutës, i cili përcakton që:

> *"Gjashtë (6) anëtarë emërohen nga pjesëtarët e gjashtë grupeve më të mëdha parlamentare të përfaqësuara në Kuvend, të cilët nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e vendeve të rezervuara. Nëse në Kuvend janë të përfaqësuara më pak grupe, grupi a grupet më të mëdha mund të emërojnë anëtarë shtesë. Një (1) anëtar emërohet nga deputetë të Kuvendit të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetin Serb të Kosovës dhe tre (3) anëtarë nga deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetet e tjera që nuk janë shumicë në Kosovë".*

80. Prandaj, kërkesa e parashtruar nuk ka të bëjë me çështje që shprehimisht ndërlidhen me ushtrimin e përgjegjësive kushtetuese të Presidentit, për arsye se as në nenin 84 [Kompetencat e Presidentit] dhe as në nenin 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve], të Kushtetutës, nuk është përcaktuar kompetenca e Presidentit për emërimin e anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, respektivisht:

Neni 84
[Kompetencat e Presidentit]
[...]
(26) emëron Kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
[...]

Neni 139

[...]

[Komisioni Qendror i Zgjedhjeve]
[...]

3. Kryesuesin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, e emëron Presidenti i Republikës së Kosovës nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe të Gjykatave me juridiksion apeli.
[...]

81. Për dallim nga nenet 84 (26) dhe 139 (3) të Kushtetutës, që përcaktojnë shprehimisht kompetencën e Presidentit për emërimin e Kryesuesit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kompetenca e

Presidentit për emërimin e anëtarëve të KQZ-së është përcaktuar shprehimisht vetëm me dispozitat e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht nenin 61, paragrafi 3 (a).

82. Në fund, Gjykata konstaton se në mënyrë që Gjykata të vlerësoj kërkesën e parashtruesit , kërkesa duhet të mbështetet në nenin 113 të Kushtetutës.

83. Prandaj, bazuar në atë që u tha më lart, Gjykata gjen se çështjet e ngritura nga parashtruesi para Gjykatës nuk hyjnë në fushëveprimin e juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese, siç përcaktohet me nenin 113. Rrjedhimisht, në pajtim me nenin 113, paragrafi 1, të Kushtetutës, Gjykata përfundon se kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, ne pajtim me nenin 113, paragrafi 1, të Kushtetutës, me rregullin 59 (2) të Rregullores së punës, më 21 nëntor 2018, me shumicë

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 te Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatën Kushtetuese**
Nexhmi Rexhepi	Arta Rama-Hajrizi

KI102/17, Parashtrues Meleq Ymeri, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Udhëzimit Administrativ nr. 09/2015 për kategorizimin e shfrytëzuesve të pensionit kontribut pagues sipas strukturës kualifikuese dhe kohëzgjatjes së pagesës së kontributeve-stazhit pensional të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale

KI102/17, Aktvendim i miratuar më 10 janar 2018 dhe i publikuar më 22 shkurt 2018

Fjalët kyç: *Neni 47 [E Drejta për Arsimin] dhe 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit te Profesionit] të Kushtetutës, person i paautorizuar, pension, kërkesë e papranueshme*

Parashtruesi i kërkesës konteston Udhëzimin Administrativ nr. 09/2015 për kategorizonin e shfrytëzuesve të pensionit kontribut pagues sipas strukturës kualifikuese dhe kohëzgjatjes së pagesës së kontributeve-stazhit pensional të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese që të vlerësoje ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë e Udhëzimit Administrativ, respektivisht dispozitën e fundit të nenit 5, e cila sipas tij është diskriminuese.

Gjykata konstatoi se parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk ka dëshmuar se si akti i kontestuar ka cenuar të drejtat dhe liritë e tij themelore. Gjykata ritheksoi se teksti kushtetues dhe jurisprudenca e kësaj Gjykate nuk ua njohin të drejtën individëve që të kontestojnë *in abstrakto* akte të karakterit të përgjithshëm. Rrjedhimisht, kërkesa u shpall e papranueshme nga Gjykata Kushtetuese sepse nuk ishte dorëzuar në mënyrë ligjore nga personi i autorizuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI102/17

Parashtrues

Meleq Ymeri

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Udhëzimit Administrativ nr. 09/2015 për kategorizimin e shfrytëzuesve të pensionit

kontributpagues sipas strukturës kualifikuese dhe kohëzgjatjes së pagesës së kontributeve-stazhit pensional të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Meleq Ymeri (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), jurist i diplomuar nga fshati Kuk, komuna e Dragashit.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Udhëzimin Administrativ nr. 09/2015 për kategorizimin e shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues sipas strukturës kualifikuese dhe kohëzgjatjes së pagesës së kontributeve-stazhit pensional (në tekstin e mëtejmë: Udhëzimit Administrativ nr. 09/2015), të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejmë: MPMS).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Udhëzimit Administrativ nr. 09/2015, të MPMS-së.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113 (1) (7) të Kushtetutës, në nenet 47 dhe 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 21 gusht 2017, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 22 gusht 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani.

7. Më 12 tetor 2017, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 16 tetor 2017, Gjykata e dërgoi një kopje të kërkesës në MPMS.

9. Më 10 janar 2018, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 31 dhjetor 2015, MPMS-ja publikoi Udhëzimin Administrativ nr. 09/2015, në Gazetën Zyrtare.

11. Më 21 gusht 2017, parashtruesi i kërkesës kontestoi kushtetutshmërinë e Udhëzimit Administrativ nr. 09/2015.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

12. Parashtruesi pretendon se dispozita e nenit 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 09/2015 është *"diskriminuese meqë nuk ka mbështetje juridike, pa arsyetim, pa fakte, dhe argumente ... kufizon të drejtat me një datë të supozuar 01.01.1991..."*.

13. Parashtruesi më tej pretendon shkelje të neneve 47 [E Drejta për Arsimin] dhe 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës.

14. Për sa i përket obligimit për shterimin e mjeteve juridike, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës u shpreh: *"ky është një akt i një autoriteti publik, dhe se e vetmja Gjykata Kushtetuese ka tagër për ta bërë vlerësimin e ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë"*.

15. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese që të konsiderojë: *"... se kërkesa ime është e drejtë dhe e ligjshme, duke kërkuar nga Gjykata Kushtetuese që ta vlerësojë ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë e Udhëzimit Administrativ nr. 09/2015 respektivisht dispozitën e fundit të nenit 5 e cila është super diskriminuese"*.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

16. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

17. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar;*
>
> *[...]*
>
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj"*.

18. Gjykata merr parasysh rregullin 36 (1) (a) të Rregullores së punës, që specifikon:

> *"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
>
> *(a) Kërkesa shtrohet nga një palë e autorizuar"*.

19. Për sa i përket kërkesës për vlerësim të kushtetutshmërisë së Udhëzimit Administrativ nr. 09/2015, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk ka dëshmuar se si akti i kontestuar ka cenuar të drejtat dhe liritë e tij themelore. Gjykata rithekson se teksti kushtetues dhe jurisprudenca e kësaj Gjykate nuk ua njohin të drejtën individëve që të kontestojnë *in abstracto* akte të karakterit të përgjithshëm. (Shih për këtë qëllim, mes shumë referencave, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës: aktvendimet për papranueshmëri në rastet nr. KI92/12 *parashtrues Sali Hajdari;* KI62/12 *parashtrues Liridon Aliu;* KI40/11 *parashtrues Zef Prenaj;* KI51/10 *parashtrues Ljubiša Živić*).

20. Gjykata përsërit se Kushtetuta e Kosovës nuk parasheh *actio popularis,* që do të thotë se individët nuk mund të ankohen në abstrakt ose t'i sfidojnë drejtpërsëdrejti veprimet ose mosveprimet e autoriteteve publike. Kushtetuta e Kosovës ofron mbështetje për individët sa i përket veprimeve ose mosveprimeve të autoriteteve publike vetëm përbrenda fushëveprimit të përcaktuar me nenet 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, që kërkon nga parashtruesit të tregojnë se janë: (1) palë të autorizuara, (2) të prekur drejtpërsëdrejti nga akti konkret ose mosveprimi i autoriteteve publike, dhe (3) se kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës: rasti nr. KI39/11, parashtrues *Tomë Krasniqi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Njoftimit nr. 311/07, të 13 prillit 2007, dhe Vërtetimit nr. 322/07, të 30 prillit 2007, të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale,* Aktvendim për papranueshmëri, i 30 janarit 2013, paragrafi 40 dhe referencat e përmendura aty).

21. Në këtë drejtim, Gjykata nënvizon se juridiksioni i saj procedural dhe material për vlerësimin e akteve me karakter të përgjithshëm vihet në lëvizje vetëm nga institucionet kushtetuese, sipas procedurës së përcaktuar me nenin 113 të Kushtetutës; kurse individët, kanë të drejtë të kontestojnë vetëm aktet individuale të autoriteteve publike-që cenojnë të drejtat e tyre individuale- dhe vetëm pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike, të përcaktuar me paragrafin 7, të nenit 113 të Kushtetutës.

22. Rrjedhimisht, kërkesa në baza kushtetuese, duhet të shpallet e papranueshme sepse nuk është dorëzuar në mënyrë ligjore nga personi i autorizuar siç përcaktohet me paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 (1) dhe (7) të Kushtetutës, nenet 47 dhe 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (a) të Rregullores së punës, më 10 janar 2018, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Ivan Čukalović	Arta Rama-Hajrizi

KI152/17, Parashtrues, Shaqir Totaj, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, A. A. U. ZH. nr. 63/2017, të 7 dhjetorit 2017

Aktvendim për papranueshmëri miratuar më 17 janar 2018, publikuar më 8 shkurt 2018

Fjalët kyç: *kontest zgjedhor, zgjedhje lokale, kryetar komune, të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes*

Kërkesa KI152/17 u parashtrua nga z. Shaqir Totaj, i cili ishte kandidat i Partisë Demokratike të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: PDK) për Kryetar të Komunës së Prizrenit në zgjedhjet lokale të vitit 2017.
Pretendimi kryesor i parashtruesit të kërkesës ishte se Gjykata Supreme nuk kishte arritur *"të provojë dhe të verifikojë faktet dhe provat e ankuesit"* dhe si rrjedhojë ishin shkelur të drejtat e tij e garantuar me nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës. Parashtruesi i kërkesës po ashtu kërkoi nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme ashtu që të pezullohet puna e Kryetarit të zgjedhur të Komunës së Prizrenit derisa Gjykata Kushtetuese të vendos për rastin e ngritur nga ai.
Gjykata vërejti se kërkesa e z. Shaqir Totaj ishte parashtruar si kërkesë individuale, në cilësinë e tij si person fizik, përmes së cilës kërkohej vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Supreme; ndërkaq që aktgjykimi në fjalë ishte nxjerrë nga Gjykata Supreme pas ankesës që PDK, në cilësinë e subjektit politik dhe rrjedhimisht në cilësinë e personit juridik, kishte parashtruar kundër një vendimi të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP).
Pas sqarimeve të dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës në Gjykatë, kjo e fundit konstatoi se parashtruesi i kërkesës nuk kishte shteruar ndonjë mjet juridik në emrin e tij personal, pra si person fizik apo si *"person i cili ka interes ligjor"*, pranë PZAP-it apo pranë Gjykatës Supreme, para se të dorëzonte kërkesën në Gjykatën Kushtetuese. Për më tepër, Gjykata vërejti se parashtruesi i kërkesës nuk përmendej asnjëherë në vendimet të cilat ishin objekt i vlerësimit kushtetues.
Në lidhje me këtë, Gjykata vlerësoi parashtruesi i kërkesës kishte pasur mundësi ligjore që si person fizik, apo si *"person i cili ka interes ligjor",* të paraqiste ankesat dhe apelet përkatëse për sa i përket pretendimeve të tij për *"shkelje të të drejtës pasive zgjedhore (e drejta për të qenë i zgjedhur)"*. Ai ka mundur që pretendimet për shkelje të të drejtave të tij kushtetuese t'i paraqesë pranë PZAP-it dhe Gjykatës Supreme, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Vetëm pasi që të kishte shteruar mjetet e tilla juridike, ai do të mund të paraqiste, në Gjykatën Kushtetuese, një kërkesë individuale për vlerësim të kushtetutshmërisë së vendimeve në fjalë, të PZAP-it dhe të

Gjykatës Supreme, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47 të Ligjit.
Në dritën e fakteve të mësipërme, Gjykata arriti në përfundimin se parashtruesi i kërkesës nuk i kishte shteruar mjetet juridike që i kishte në dispozicion, të parapara me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës. Si rrjedhojë, kërkesa e parashtruesit u shpall e papranueshme për shkak të mosshterimit të të gjitha mjeteve juridike në dispozicion; ndërkaq që, si rezultat i papranueshmërisë, edhe kërkesa për masë të përkohshme u refuzua si e pabazuar.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI152/17

Parashtrues

Shaqir Totaj

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, A. A. U. ZH. nr. 63/2017, i 7 dhjetorit 2017

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Shaqir Totaj nga Prizreni (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, A. A. U. ZH. nr. 63/2017, të 7 dhjetorit 2017.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të lartpërmendur, i cili pretendohet të ketë shkelur të drejtën e parashtruesit të kërkesës të garantuar me nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe nenin 3 [Parimet themelore] të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji për Zgjedhjet Lokale).

4. Parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) *"të vendosë si masë të përkohshme pezullimin e punës së Kryetarit të zgjedhur të Komunës së Prizrenit, në pritje të vendimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese."*

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), si dhe në rregullat 29 dhe 56 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 15 dhjetor 2017, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

7. Në të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.

8. Më 19 dhjetor 2017, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës si dhe kërkoi nga ai që, në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të shkresës, të qartësojë nëse kërkesën e ka dorëzuar si kërkesë individuale në emrin e tij. Po ashtu, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

9. Në po të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi Partinë Demokratike të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: PDK), si dhe z. Mytaher Haskuka, kandidat i

Lëvizjes VETËVENDOSJE! për Kryetar të Komunës së Prizrenit në zgjedhjet lokale të vitit 2017 (në cilësinë e palëve të interesuara), për regjistrimin e kërkesës. Gjykata iu dërgoi atyre nga një kopje të kërkesës si dhe i ftoj që, në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të shkresës, të dorëzojnë komentet e tyre eventuale përkitazi me kërkesën.

10. Më 26 dhjetor 2017, brenda afatit të përcaktuar, parashtruesi i kërkesës dorëzoi sqarimin e kërkuar në Gjykatë.

11. Në po të njëjtën ditë, z. Mytaher Haskuka dorëzoi komentet e tij përmes postës elektronike. Brenda afatit të përcaktuar, PDK nuk dorëzoi ndonjë koment.

12. Më 29 dhjetor 2017, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës, z. Mytaher Haskuka dhe PDK-në, për pranimin e sqarimit dhe komenteve përkatëse (si dhe iu dërgoi atyre nga një kopje të sqarimit dhe komenteve).

13. Më 17 janar 2018, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Më 22 tetor 2017, u mbajt raundi i parë i zgjedhjeve lokale në Republikën e Kosovës. Parashtruesi i kërkesës ishte kandidat i PDK-së për Kryetar të Komunës së Prizrenit.

15. Rezultatet përfundimtare të raundit të parë zgjedhor përcaktuan se gara për Kryetar të Komunës së Prizrenit do të vendosej nga rezultati i raundit të dytë zgjedhor (balotazhit), që do të zhvillohej në mes të dy kandidatëve me më së shumti vota në raundin e parë, përkatësisht në mes të parashtruesit të kërkesës, z. Shaqir Totaj nga PDK dhe z. Mytaher Haskuka nga Lëvizja VETËVENDOSJE!.

16. Më 19 nëntor 2017, u mbajt raundi i dytë i zgjedhjeve lokale, ku për Kryetar të Komunës së Prizrenit garuan dy kandidatët e lartpërmendur.

17. Më 29 nëntor 2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shpalli rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të raundit të dytë për Kryetar të Komunës së Prizrenit. Sipas këtyre rezultateve, parashtruesi i kërkesës, z. Shaqir Totaj, kishte marrë 49.64% të votave; ndërsa, z. Mytaher Haskuka kishte marrë 50.36% të votave.

18. Më 30 nëntor 2017, PDK, përmes përfaqësuesit të saj z. Gani Koci, u ankua në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (në tekstin e mëtejmë: PZAP), duke kërkuar *"që të hetohen, numërohen, fletëvotimet dhe materialet e tjera zgjedhore, dhe pas vërtetimit të fakteve për cenim të procesit zgjedhor në ditën e votimit, të anulohet rezultati zgjedhor dhe të urdhërohet Komisioni Qendror Zgjedhor për ta përsëritur votimin në Komunën e Prizrenit"*.

19. Më 1 dhjetor 2017, PZAP, me Vendimin ZL. Anr. 1124/2017, hodhi poshtë ankesën e PDK-së si të palejuar, me arsyetimin si në vijim:

> *"Apelin e parashtruar nga Partia Demokratike e Kosovës […] paneli e ka trajtuar dhe proceduar në këtë fazë të procesit zgjedhor si apel, në kuptim të dispozitës ligjore të nenit 3 par. 8 Rregullës nr.02/2015, të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it[…].*
> *PZAP-i, pas shqyrtimit të lejueshmërisë së apelit, në kuptim të nenit 117 të LZP-së* [Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme]*, gjeti se pretendimet e parashtruesit të apelit në këtë fazë të procesit zgjedhor janë të palejueshme, për këto arsye:*
> *Siç është përcaktuar me LZP dhe me Rregulla Zgjedhore, secila fazë e procesit zgjedhor, i ka afatet e caktuara ligjore, për të parashtruar ankesa dhe apele në PZAP, që ndërlidhen me fazën e procesit zgjedhor, që është duke u zhvilluar. Në këtë rast konkret, tani jemi në fazën e procesit zgjedhor, pas publikimit të rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve lokale për raundin e dytë, të mbajtura më datë 19.11.2017, për kryetarë të komunave.*
> *Paneli vlerëson se kjo fazë e procesit zgjedhor, është e ankimueshme vetëm sa i përket vendimit të KQZ-së* [Komisionit Qendror Zgjedhor] *pas shpalljes së rezultatit përfundimtar, për kryetarë të komunave dhe atë për parregullsitë e shkaktuara gjatë administrimit të të dhënave në QNR, mospërputhjet e FRP-ve, FRK-ve, dhe provave që eventualisht i sjell pala që ka interes ligjor, e të cilat prova nuk përputhen me rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve, apo parregullsitë të cilat kanë qenë të ditura publikisht dhe që janë konsideruar nga paneli se mund të kenë ndikim drejtpërdrejt në rezultat final dhe që minojnë procesin zgjedhor, por nuk janë përmirësuar respektivisht nuk janë eliminuar nga KQZ-ja […].*
> *Pretendimet ankimore të parashtrueses së apelit […] për raundin e dytë të zgjedhjeve lokale të mbajtura me datë 19.11.2017 […] në këtë fazë të procesit zgjedhor janë të palejueshme, sepse për të gjitha parregullsitë që ndërlidhen me ditën e votimit, afati për të parashtruar ankesë në PZAP, ka qenë 24 orë nga mbyllja e*

qendrave të votimit, në këtë rast afati për të parashtruar ankesë në PZAP ka qenë me datë 20.11.2017, në ora 19:00."

20. Më 5 dhjetor 2017, PDK parashtroi ankesë në Gjykatën Supreme përmes së cilës kontestoi ligjshmërinë e Vendimit të lartpërmendur të PZAP-it, me propozimin që: ankesa të pranohet; të anulohet Vendimi i PZAP-it; të kërkohet nga PZAP-i që të rishqyrtojë Vendimin ose të anulohen rezultatet zgjedhore dhe të urdhërohet KQZ-ja që të përsërisë votimin në Komunën e Prizrenit.

21. Më 7 dhjetor 2017, Gjykata Supreme, me Aktgjykimin A. A. U. ZH. nr. 63/2017, e refuzoi si të pabazuar ankesën e paraqitur nga PDK, me arsyetimin si në vijim:

"Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prizren […].
Gjykata vlerësoi se janë të pabazuara pretendimet e subjektit politik PDK, paraqitur në ankesën ndaj vendimit të kontestuar të PZAP-it […]. Parashtruesi i ankesës [PDK] *nuk i ka argumentuar me asnjë provë pretendimet e veta, kurse ato prova, të cilave u referohet, nuk janë me ndikim në marrjen e një vendimi tjetër në këtë çështje juridike* […].
Kjo Gjykatë, po ashtu, vlerëson se të gjitha parregullsitë që ndërlidhen me ditën e votimit, pra prej datës 19.11.2017, afati për të parashtruar ankesë në PZAP ka qenë 24 orë nga mbyllja e qendrave të votimit, e në këtë kuptim, sipas nenit 119.1 LZP nr.03/L-073 i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr.03/L-256 parashihet se personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP, ose të drejtat e të cilat janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të paraqes ankesë PZAP-it brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit, dhe PZAP do të vendos ankesën brenda 72 orëve nga koha kur është pranuar ankesa.
PZAP ka vërtetuar drejt se parregullsitë gjatë procesit zgjedhor, në ditën e votimit, për raundin e dytë të zgjedhjeve lokale të datës 19.11.2017 drejtpërdrejt të ndërlidhura me ditën e votimit, e që afati për të parashtruar ankesë ishte 24 orë nga mbyllja e qendrave të votimit, në këtë rast afati ka qenë deri në 20.11.2017, në ora 19:00.
Prandaj, kjo Gjykatë vlerëson se PZAP-i ka vendos drejt me rastin e hedhjes së ankesës së subjektit politik PDK – si të palejuar, pasi afati i ankimit ishte 20.11.2017, deri në ora 19:00, kurse ankesa është parashtruar me datën 30.11.2017.

Sipas vlerësimit të Gjykatës, vendimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë, e cila konstatoi se edhe e drejta materiale, po ashtu, është zbatuar drejt. Nisur nga kjo gjendje faktike e vërtetuar, kjo Gjykatë konstatoi se në këtë çështje juridike gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe nuk është shkelur ligji në dëm të parashtruesit të ankesës, prandaj nuk i pranoi pretendimet ankimore të tij, ngaqë janë pa ndikim në konstatimin e një gjendjeje tjetër faktike nga ajo që ka vërtetuar PZAP".

22. Më 11 dhjetor 2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve certifikoi rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve për raundin e dytë për Kryetar të Komunës së Prizrenit, si dhe disa komunave të tjera.

Sqarimi i dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës

23. Me rastin e njoftimit të parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës, Gjykata kishte kërkuar nga ai që të bëjë një qartësim me sa vijon:

"Nëpërmjet kërkesës tuaj, ju kontestoni Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, A.A. U.ZH. nr. 63/2017, të 7 dhjetorit 2017, që është nxjerrë pas ankesës së parashtruar nga Partia Demokratike e Kosovës [...]. Ju lutemi që të qartësoni nëse kërkesën e keni dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese si kërkesë individuale në emrin tuaj [...]".

24. Në përgjigjen e tij drejtuar Gjykatës, parashtruesi i kërkesës sqaroi si në vijim:

"Pas njoftimit tuaj për regjistrimin e kërkesës KI152/17 dhe kërkesës për qartësim, në vijim qartësoj se kërkesa ime duhet të trajtohet nga Gjykata Kushtetuese si kërkesë individuale në emrin tim".

Komentet e dorëzuara nga pala e interesuar, z. Mytaher Haskuka

25. Në cilësi të palës së interesuar, z. Mytaher Haskuka ka dorëzuar komente lidhur me pranueshmërinë e kërkesës; pranueshmërinë e kërkesës për masë të përkohshme; si dhe për meritat e kërkesës.

26. Lidhur me pranueshmërinë e kërkesës, në aspektin procedural, z. Mytaher Haskuka, pohon se *"parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Kushtetuese nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike për shkak se*

'PDK' më cilësinë e personit juridik ka shfrytëzuar apelet në PZAP dhe në Gjykatën Supreme". Më tutje, z. Mytaher Haskuka thekson se *"PDK në cilësinë e personit juridik, i përfaqësuar nga personi i caktuar, nuk ka dorëzuar apo firmosur ankesë, apo parashtresë në emër të parashtruesit, (Shaqir Totaj) në apelet e përcaktuara me nenin 118.4 dhe 119.1 të LZP-së* [Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme] *dhe as në Gjykatën Kushtetuese".*

27. Lidhur me pranueshmërinë e kërkesës për masë të përkohshme, z. Mytaher Haskuka deklaron se: *"Parashtruesi, nuk ka mundur në asnjë çast të vetëm të mbështesë kërkesën për masë të përkohshme me prova apo të paraqesë fakte të cilat do të krijonin besim dhe bindje në Gjykatën Kushtetuese për ndërmarrjen e një mase të tillë ".*

28. Përkitazi me meritat e kërkesës, z. Mytaher Haskuka deklaron se: *"[...] PZAP dhe* Gjykata *Supreme kanë vendosur drejt në rastin e hedhjes së ankesës së subjektit politik PDK, si të palejuar dhe të pabazuar".* Më tutje, ai thekson se: *"[...] mosrespektimi i afatit dhe mosmbështetja e pretendimeve me prova të caktuara, nuk reflekton cenim të nenit 45 të Kushtetutës, konkretisht të drejtës pasive zgjedhore".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

29. Parashtruesi i kërkesës pretendon se është shkelur neni 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] i Kushtetutës si dhe neni 3 [Parimet themelore] i Ligjit për Zgjedhjet Lokale.

30. Në këtë drejtim, parashtruesi pretendon se Gjykata Supreme nuk ka arritur *"të provojë dhe të verifikojë faktet dhe provat e ankuesit, e të cilat ndërlidhen dhe implikojnë drejtpërsëdrejti me interesin ligjor të parashtruesit të saj, dhe janë po ashtu vendimtare në cilësimin ose jo të shkeljes së të drejtës kushtetuese, të drejtës pasive zgjedhore (e drejta për të qenë i zgjedhur) [...]."*

31. Më tej, parashtruesi thekson se, duke mos shqyrtuar ankesën, PZAP-i *"[...] ka anashkaluar fakte dhe prova vendimtare".* Sipas parashtruesit, *"përkundër që PDK kishte ushtruar ankesë, bazuar në fakte dhe prova që ndërlidheshin me procesin zgjedhor dhe numërimin [...] PZAP me vendimin për hedhje poshtë si të palejuar të ankesës së PDK-së e kishte bazuar në faktin e mosparaqitjes së ankesës brenda 24 orëve nga mbyllja e qendrave të numërimit, duke mos shqyrtuar në mënyrë meritore këtë ankesë, edhe pse një pjesë e konsiderueshme e provave dhe fakteve të saj, ndërlidheshin ekskluzivisht, me procesin e numërimit të votave me kusht, votave me*

postë dhe votave të personave me nevoja të veçanta, i cili proces ka ndodhur pas shpalljes se rezultateve preliminare nga KQZ".

32. Për më tepër, parashtruesi pretendon se PZAP-i ka *"zbatuar gabimisht nenin 119.1 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës i ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-256"* meqë e kishte *"konsideruar të paefektshëm dhe jorelevant cilindo fakt ose provë që vërteton shkelje sipas ligjit, edhe pas ditës së votimit […]."* Sipas parashtruesit, shkeljet e tilla "*rezultojnë ose mund të rezultojnë me cenimin e parimeve themelore si dhe të drejtës kushtetuese dhe ligjore, të drejtës pasive zgjedhore (e drejta për të qenë i zgjedhur)".*

33. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të bëhet: *"Vlerësimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së Aktgjykimit A. A. U. ZH. nr. 63/2017 të datës 07.12.2017 të Gjykatës Supreme të Kosovës për refuzimin si të pabazuar të ankesës A.ZL.NR.1124/2017 të datës 01.12.2017, të parashtruar nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës "PDK" kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa "PZAP" për shkak të keqpërdorimeve gjatë procesit zgjedhor, në ditën e votimit, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale […]".*

34. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu, kërkon nga Gjykata *"të vendosë si masë të përkohshme pezullimin e punës së Kryetarit të zgjedhur të Komunës së Prizrenit, në pritje të vendimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese".*

Dispozitat relevante ligjore të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës të ndryshuar sipas Ligjit nr. 03/L-256 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës

Neni 118 [Vendimet]

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet. […]
118.4 Mund të apelohet vendimi i PZAP-it, sikurse që PZAP-i mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar. Ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda 24 (njëzetekatër) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5.000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore. Gjykata Supreme

vendos në afatin prej 72 (shtatëdhjetedy) orëve pas paraqitjes së apelit.

Neni 119 [Ankesat]

119.1 Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të paraqesë ankesë PZAP-it brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit, dhe PZAP-i do të vendos për ankesën brenda 72 orëve nga koha kur është pranuar ankesa […].

Pranueshmëria e kërkesës

35. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore.

36. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
(…)
7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

37. Më tej, Gjykata i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit, i cili përcakton:

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

38. Përveç kësaj, Gjykata i referohet paragrafit (1) (b) të rregullit 36 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, i cili parasheh:

"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

(b) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kontestuar, [...]

39. Gjykata rikujton se kërkesa është parashtruar, si kërkesë individuale, nga z. Shaqir Totaj, i cili kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, A.A. U.ZH. nr. 63/2017, të 7 dhjetorit 2017. Ky aktgjykim është nxjerrë nga Gjykata Supreme pas ankesës që PDK, në cilësinë e subjektit politik dhe rrjedhimisht në cilësinë e personit juridik, ka parashtruar kundër Vendimit Anr. 1124/2017 të PZAP-it, të 1 dhjetorit 2017.

40. Fakti që parashtruesi e ka dorëzuar kërkesën e tij kushtetuese në cilësinë e personit fizik dhe në emrin e tij personal, vërtetohet edhe nga vetë sqarimi i tij dorëzuar në Gjykatë. Këtë sqarim, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi pas kërkesës së Gjykatës drejtuar atij. Në përgjigjen e tij, parashtruesi i kërkesës thekson se "*kërkesa ime duhet të trajtohet nga Gjykata Kushtetuese si kërkesë individuale në emrin tim*".

41. Gjykata, po ashtu, vë në pah se në kërkesën e dorëzuar në Gjykatë, parashtruesi shprehet se "*nuk ka pasur mjete tjera të rregullta juridike që nuk i kemi shfrytëzuar*", duke aluduar në mjetet juridike të shteruara nga PDK, si palë e vetme procedurale pranë PZAP-it dhe Gjykatës Supreme.

42. Megjithatë, nga shkresat e lëndës, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk ka shteruar asnjë mjet juridik në emrin e tij personal, pra si person fizik apo si *"person i cili ka interes ligjor"*, pranë PZAP-it apo pranë Gjykatës Supreme, para se të dorëzonte kërkesën e tanishme në Gjykatën Kushtetuese. Për më tepër, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk përmendet asnjëherë në aktgjykimin e kontestuar e as në vendimin e lartpërmendur të PZAP-it.

43. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës ka pasur mundësi ligjore që si person fizik, apo si *"person i cili ka interes ligjor",* të paraqiste ankesat dhe apelet përkatëse për sa i përket pretendimeve të tij për *"shkelje të të drejtës pasive zgjedhore (e drejta për të qenë i zgjedhur)"*. Ai ka mundur që pretendimet për shkelje të të drejtave të tij kushtetuese t'i paraqes pranë PZAP-it dhe Gjykatës Supreme, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Vetëm pasi që të kishte shteruar mjetet e tilla juridike ai do të mund të paraqiste, në Gjykatën Kushtetuese, një kërkesë individuale për vlerësim të kushtetutshmërisë së vendimeve në fjalë, të PZAP-it dhe Gjykatës

Supreme, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47 të Ligjit.

44. Në dritën e fakteve të mësipërme, Gjykata arrin në përfundimin se parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar mjetet juridike që i ka pasur në dispozicion, të parapara me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese, nr. KI73/09, *Mimoza Kusari-Lila kundër Komisionit Qendror i Zgjedhjeve*, Aktvendim për papranueshmëri i 24 marsit 2010, paragrafët 28-36).

45. Gjykata rikujton se rregulli i shterimit të mjeteve juridike është pasqyrim i parimit të subsidiaritetit, si parim themelor në gjyqësinë kushtetuese, i cili ka për qëllim që t'i ofrojë gjykatave të rregullta, apo autoriteteve publike përkatëse, mundësinë për të parandaluar ose korrigjuar shkeljen e pretenduar kushtetuese (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese rasti KI41/09, *Universiteti AAB-RIINVEST SH.P.K., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës,* Aktvendim për papranueshmëri i 21 janarit 2010*,* shih gjithashtu rastin e GJEDNJ-së *Selmouni kundër Francës, Ibidem*, paragrafi 74).

46. Si përfundim, Gjykata konstaton që kërkesa është parashtruar para se parashtruesi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike dhe, si e tillë, duhet të deklarohet e papranueshme në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) (b) të Rregullores së punës.

Kërkesa për masë të përkohshme

47. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkoi nga Gjykata *"të vendosë si masë të përkohshme pezullimin e punës së Kryetarit të zgjedhur të Komunës së Prizrenit, në pritje të vendimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese."*

48. Për të mbështetur këtë kërkesë, parashtruesi thekson se *"masa e përkohshme është në interes të publikut, sepse mungesa e saj mund të shkaktojë një dëm të pakthyeshëm në funksionimin e institucionit – Komunës së Prizrenit, si dhe demokracisë në Republikën e Kosovës."*

49. Gjykata përsëritë konstatimin se kërkesa e parashtruesit të kërkesës u deklarua e papranueshme për shkak se ai nuk ka shteruar të gjitha mjetet juridike.

50. Prandaj, në pajtim me konstatimet e mësipërme si dhe në pajtim me nenin 116 (2) të Kushtetutës, nenin 27 (1) të Ligjit dhe rregullin 55 (4)

të Rregullores së punës, kërkesa për masë të përkohshme refuzohet si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës, më 17 janar 2018njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;

III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin
20.4 të Ligjit; dhe

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Bekim Sejdiu	Arta Rama-Hajrizi

KI53/18, Parashtrues Hajri Ramadani, Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. nr. 181/2016, të 13 shkurtit 2017

KI53/18, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 nëntorit 2018, publikuar më 06 dhjetor 2018

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, barazia para ligjit, e paafatshme*

Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin e saj refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës, kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës.

Parashtruesi në Gjykatën Kushtetuese në thelb pretendoi se gjykatat e instancave më të ulëta që kanë vepruar në këtë çështje kanë qenë të njëanshme, të ndikuara politikisht dhe nuk kanë vendosur mbi bazën e fakteve të vërtetuara po mbi bazën e supozimeve. Parashtruesi i kërkesës pretendoi se vendimin e kontestuar e kishte pranuar më 8 dhjetor 2017, por nuk e mbështeti këtë pretendim me ndonjë dëshmi, fletëkthesë ose me ndonjë dokument me shkrim.

Gjykata Themelore njoftoi Gjykatën Kushtetuese se, pas dy përpjekjeve të pasuksesshme për ta dorëzuar me postë Aktgjykimin PML. nr. 181/2016, të 13 shkurtit 2017, e ka shpallur në tabelën për shpallje të Gjykatës Themelore dhe të njëjtën e ka mbajtur të shpallur në tabelën për shpallje të Gjykatës Themelore deri më 19 mars 2017.

Gjykata konsideroi se parashtruesi i kërkesës vendimin e kontestuar e ka pranuar më 19 mars 2017.

Gjykata konstatoi se kërkesa është e papranueshme, për shkak se nuk janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës. Kërkesa u shpall e papranueshme si e paafatshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI53/18

Parashtrues

Hajri Ramadani

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. nr. 181/2016, të 13 shkurtit 2017

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Hajri Ramadani, me vendbanim në fshatin Brodesan, komuna e Dragashit (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, PML. nr. 181/2016, të 13 shkurtit 2017 (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme). Parashtruesi i kërkesës vendimin e kontestuar e ka pranuar më 19 mars 2017.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin

31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 49 [E drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon shkelje të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 47 [Kërkesa Individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

5. Më 31 maj 2018, Gjykata miratoi, në seancë administrative, plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata i referohet dispozitave juridike të rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 5 prill 2018, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 11 prill 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.

8. Më 18 prill 2018, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

9. Më 16 qershor 2018, u përfundoi mandati i gjyqtarëve: Snezhana Botusharova dhe Almiro Rodrigues. Më 26 qershor 2018, u përfundoi mandati i gjyqtarëve: Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.

10. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës dekretoi gjyqtarët: Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.

11. Më 22 gusht 2018, Kryetarja e Gjykatës nxori vendim për zëvendësimin e gjyqtarit raportues, ku në vend të gjyqtarit Ivan Čukalović u caktua gjyqtari Radomir Laban.

12. Më 25 shtator 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi Kolegjin e ri shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Bajram Ljatifi.

13. Më 28 shtator 2018, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Prizren, që të dorëzonte në Gjykatë fletëkthesën që dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, PML. nr. 181/2016, të 13 shkurtit 2017.

14. Më 4 tetor 2018, Gjykata Themelore në Prizren e njoftoi Gjykatën se ka provuar dy herë t'ia dorëzojë parashtruesit të kërkesës Aktgjykimin PML. nr. 181/2016, të 13 shkurtit 2017, përkatësisht dërgesa është provuar të bëhet më 25 shkurt 2017 dhe më 2 mars 2017, por nuk ka mundur t'ia dorëzojë sepse parashtruesi i kërkesës nuk ka qenë në adresën e paraqitur në Gjykatë. Gjykata Themelore shpjegon më tej se pas dy përpjekjeve për ta dorëzuar vendimin e lartcekur, e publikoi të njëjtin në tabelën e shpalljeve deri më 19 mars 2017.

15. Më 5 nëntor 2018, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

16. Më 1 dhjetor 2014, Prokuroria Themelore në Prizren-Departamenti për Krime të Rënda, kishte ngritur aktakuzë me numër PP. nr. 244/2014, kundër parashtruesit të kërkesës nën dyshimin e bazuar, se ka kryer vepër penale "*Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar*" sipas nenit 422 paragrafi 1 dhe 2, nënparagrafi 2.1 dhe 2.2, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPRK).

17. Parashtruesi i kërkesës, ndër të tjera, akuzohej se kishte shkelur Ligjin e Institucionit të Arsimit duke mos zbatuar Vendimin ref. 10/14, prot. 96, të 28 prillit 2014, të Inspektoratit të Arsimit në Prizren, duke mos vepruar sipas udhëzimeve të nxjerra nga ky udhëzim.

18. Më 24 dhjetor 2015, Gjykata Themelore në Prizren-Departamenti për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore), nëpërmjet Aktgjykimit P. nr. 275/14, shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës duke e dënuar me burgim prej 1 (një) viti, dënim ky i cili nuk do të ekzekutohet nëse parashtruesi i kërkesës nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale brenda 2 (dy) viteve. Ndaj parashtruesit të kërkesës, gjithashtu, u shqiptua edhe ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve.

19. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, P. nr. 275/14, të 24 dhjetorit 2015, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe shkelje të ligjit penal. Në anën tjetër, Prokuroria Themelore në Prizren paraqiti ankesë duke kërkuar burgim efektiv për parashtruesin e kërkesës.

20. Më 3 maj 2016, Gjykata e Apelit e Kosovës, nëpërmjet Aktgjykimit PAKR. nr. 184/2016, e refuzon si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërteton aktgjykimin e Gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e Apelit e Kosovës në aktgjykimin e saj kishte vlerësuar se i njëjti është i qartë, konkret dhe i kuptueshëm dhe në arsyetimin e tij janë dhënë arsyet e duhura mbi faktet vendimtare duke dhënë përgjigje të detajuar në të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës.

21. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës ushtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Kosovës, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, P. nr 275/14, të 24 dhjetorit 2015, dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, PAKR. nr. 184/2016, të 19 majit 2016, duke pretenduar se këto aktgjykime ishin nxjerrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal.

22. Më 13 shkurt 2017, Gjykata Supreme e Kosovës, nëpërmjet Aktgjykimit PML. nr. 181/2016, refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon që Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, PML. nr. 181/2016, i 13 shkurtit 2017, shkel të drejtën e tij të garantuar me nenin 24 [Barazia para Ligjit] nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 49 [E drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], nenin 53 [Interpretimi i

Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

24. Parashtruesi i kërkesës pohon se vendimin e kontestuar e ka pranuar më 8 dhjetor 2017, dhe më tej pretendon se: *"Gjykata Supreme dhe gjykatat e instancave më të ulëta me rastin e vendosjes për shpalljen fajtor të parashtruesit të kërkesës, kanë aplikuar standard të dyfishtë me rastin kur nuk kanë pranuar si të drejtë kërkesën e parashtruesit që të vërtetohet se ai nuk ka pasur kompetencë ta zbatoj vendimin e dhënë nga Inspektorati i Arsimit, për anulimin e vendimit të cilin e ka nxjerrë Kryetari i Komunës. Gjithashtu barazia para ligjit është cenuar me vetë faktin se është shpallë fajtor mbi bazën e veprimeve të akuzuarit tjetër Sh. N. Kjo për faktin se nuk ekziston vepra penale nëse nuk është vërtetuar falsifikimi..."*.

25. Më tutje, parashtruesi i kërkesës pretendon se "*Gjykatat e tri instancave që kanë vepruar në këtë çështje kanë qenë të njëanshme, të ndikuara politikisht dhe nuk kanë vendosur mbi bazën e fakteve të vërtetuara po mbi bazën e supozimeve, edhe kur objekti i akuzës nuk ka ekzistuar [...] parashtruesit nuk i është mundësuar gjykim i drejtë edhe për faktin se pavarësisht provave që kanë në favor të tij, të gjitha këto janë interpretuar në dëm të parashtruesit të kërkesës"*. Parashtruesi i kërkesës pretendon se si rezultat i vendimeve të gjykatave të rregullta i është ndërprerë marrëdhënia e punës.

26. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të deklarojë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. nr. 181/16, të 13 shkurtit 2017 dhe ta kthejë aktgjykimin për rivendosje në Gjykatën Supreme.

Pranueshmëria e kërkesës

27. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

28. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
>
> *[...]*

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

29. Në lidhje me këtë, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar dhe i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion.

30. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 49 [Afatet] të Ligjit, i cili parasheh:

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht…".

31. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] (1) (c) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

"1) Gjykata mund të konsideroj një kërkesë të pranueshme nëse:
(…)
(c) kërkesa parashtrohet brenda 4 (katër) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit[…]".

32. Në fillim, Gjykata i referohet datës së dorëzimit të vendimit përfundimtar dhe datës së parashtrimit të kërkesës në Gjykatë për të vlerësuar nëse parashtruesi e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të caktuar prej 4 (katër) muajve.

33. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton që vendimi i fundit në rastin e parashtruesit të kërkesës është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, PML. nr. 181/2016, i 13 shkurtit 2017.

34. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimin e kontestuar e ka pranuar më 8 dhjetor 2017, por se parashtruesi i kërkesës nuk e mbështeti këtë pretendim me ndonjë dëshmi, fletëkthesë ose një dokument me shkrim.

35. Megjithatë, Gjykata me shikimin e dokumenteve shtesë të dorëzuar nga Gjykata Themelore në Prizren, lidhur me datën e pranimit të vendimit të kontestuar, vërtetoi se Gjykata Themelore në Prizren dy

herë u përpoq t'ia dorëzojë parashtruesit të kërkesës aktgjykimin e kontestuar me postë.

36. Së pari, më 25 shkurt 2017, Gjykata Themelore në Prizren u përpoq t'ia dërgojë aktgjykimin e kontestuar në adresën e parashtruesit të kërkesës me postë, fletëkthesa u kthye në Gjykatën Themelore në Prizren, me arsyetimin se parashtruesi i kërkesës ishte zhvendosur së bashku me familjen e tij në Prizren.

37. Pastaj, më 2 mars 2017, Gjykata Themelore në Prizren u përpoq për herë të dytë ta dërgonte vendimin e kontestuar në adresën e parashtruesit të kërkesës me postë, fletëkthesa ishte kthyer në Gjykatën Themelore në Prizren me sqarimin se parashtruesi i kërkesës ishte zhvendosur së bashku me familjen e tij në Prishtinë.

38. Nga shkresat e rastit vërehet qartë se nuk ka qenë e mundur që parashtruesi i kërkesës të gjendet në adresën e dërguar të cilën vetë parashtruesi i kërkesës e ka dorëzuar në Gjykatë.

39. Në përputhje me dispozitat ligjore, Gjykata Themelore, pas dy përpjekjeve të pasuksesshme për ta dorëzuar me postë Aktgjykimin PML. nr. 181/2016, të 13 shkurtit 2017 e ka shpallur në tabelën për shpallje të Gjykatës Themelore dhe të njëjtën e ka mbajtur të shpallur në tabelën për shpallje të Gjykatës Themelore deri më 19 mars 2017.

40. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet dispozitave të paragrafit 4, të nenit 478 [Shkresat që duhet dorëzuar personalisht] të Kodit për Procedurën Penale, nr. 04/L-123, i cili parasheh:

Neni 478

"4.. Kur të pandehurit nuk mund t'i dorëzohet vendimi apo ankesa për shkak të mosdhënies së adresës, ato vihen në stendën e gjykatës dhe pas tetë (8) ditëve nga dita e vënies në stendë dërgesa konsiderohet valide".

41. Në bazë të gjithë kësaj që u tha më lart, Gjykata vlerëson se Gjykata Themelore ka vepruar në përputhje me dispozitat relevante ligjore.

42. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës vendimin e kontestuar e ka pranuar më 19 mars 2017, ndërsa kërkesën në Gjykatë e ka dorëzuar më 5 prill 2018, që do të thotë se kërkesa e parashtruesit është dorëzuar jashtë afatit të përcaktuar ligjor.

43. Gjykata përsërit se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri juridike, duke siguruar që rastet që ngrenë çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe për të parandaluar autoritetet dhe palët e tjera të interesuara që të mbahen në gjendje të pasigurisë për një periudhë më të gjatë kohore (Shih: vendimin e GJEDNJ-së, *P. M. kundër Mbretërisë së Bashkuar* nr. 6638/03, 24 gusht 2004, shih Vendimin e GJEDNJ-së *Olivier Gaillard kundër Francës*, nr. 47337/99, të 11 korrikut 2000, shih Vendimin e GJEDNJ-së *Franz Hofstädter kundër Austrisë* nr. 25407/94, 12 shtator 2000).

44. Ky afat gjithashtu i mundëson parashtruesit potencial që të shqyrtojë nëse dëshiron të paraqesë kërkesë dhe, nëse dëshiron, të vendosë për ankesat dhe argumentet konkrete që duhet ngritur (shih: vendimi i GJEDNJ-së *O'Loughlin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, parashtresa nr. 23274/04), dhe të njëjtën kohë lehtëson vërtetimin e fakteve në këtë rast, meqë me kalimin e kohës, çdo shqyrtim i drejtë i çështjeve të ngritura bëhet problematik (Shih: vendimi i GJEDNJ-së, *Nee kundër Irlandës*, nr. 52787/99, i 30 janarit 2003).

45. Ky rregull specifikon afatin kohor për kontrollin e ushtruar nga Gjykata dhe paralajmëron individët dhe autoritetet shtetërore për afatin pas të cilit kontrolli i tillë nuk është më i mundur (shih vendimi i GJEDNJ-së *Walker kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 34979/97, i 25 janarit 2000, shih aktgjykimin e GJEDNJ-së *Sabri Güneş kundër Turqisë*, i 29 qershorit 2012, paragrafi 40)..

46. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit nuk është parashtruar brenda afatit ligjor të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit është e papranueshme, sepse kërkesa e parashtruesit është parashtruar jashtë afatit të paraparë ligjor.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 49 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, më 5 nëntor 2018, njëzëri

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

Radomir Laban Arta Rama-Hajrizi

KI112/17, Parashtrues: Deno Denović, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ. nr. 7/2017, të 16 majit 2017.

KI112/17, Aktvendim për papranueshmëri i 26 shtatorit 2018, publikuar më 22 tetor 2018

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, seancë dëgjimore, procedura administrative, kërkesë qartazi e pabazuar*

Drejtoria Rajonale e Doganës së Kosovë në Mitrovicë, nëpërmjet Aktvendimit [08.05.2/394], e shpalli parashtruesin e kërkesës përgjegjës për kundërvajtjen doganore dhe e dënoi me gjobë, pasi ai ishte kapur nga Policia e Kosovës duke transportuar 4 (katër) bidonë naftë, me arsyetimin se fatura me të cilën parashtruesi i kërkesës arsyetonte mallin, nuk ishte vërtetuar të jetë valide. Pas ankesës së parashtruesit të kërkesës, Dogana e Kosovës nëpërmjet Aktvendimit [07.03/497] e refuzoi si të pabazuar kërkesën për rishqyrtimin e Aktvendimit të Drejtorisë Rajonale dhe la në fuqi Aktvendimin e Drejtorisë Rajonale.

Parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje administrative kundër Doganave të Kosovës, duke kërkuar anulimin e Aktvendimit [07.03/497] ose kthimin e çështjes së tij në rishqyrtim në Doganën e Kosovës. Gjykata Themelore, nëpërmjet Aktgjykimit [A. nr. 1247/14], e refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore u konfirmua edhe nga Gjykata e Apelit dhe nga Gjykata Supreme.

Parashtruesi i kërkesës pretendoi para Gjykatës Kushtetuese shkelje të të drejtave të tij në gjykim të drejtë dhe të paanshëm sipas nenit 31 të Kushtetutë, nëpërmjet dy argumenteve në vijim: a) refuzimit të kërkesës për mbajtjen e seancës dëgjimore nga sektori për rishqyrtim i Doganës së Kosovës; dhe b) që aktvendimet e Doganës së Kosovës dhe aktgjykimet e gjykatave të rregullta janë arbitrare, sepse të njëjtat konsiderojnë që fatura mbi bazën e së cilës ai arsyetonte mallin e kontestuar nuk është valide dhe se asnjëra nga instancat administrative e gjyqësore nuk ka vërtetuar elementet e veprës për të cilën ai është shpallur përgjegjës dhe është dënuar.

Gjykata vëren që argumentet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, si rezultat i mosmbajtjes së një seance dëgjimore në nivelin e organeve administrative, nuk mbështesin në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij për shkelje kushtetuese, sepse vendimet përkatëse të organeve administrative iu nënshtruan kontrollit të mëvonshëm nga një *"organ gjyqësor që ka juridiksion të plotë",* me kompetencë për të anuluar

vendimet e tilla edhe sa i përket çështjeve të faktit e po ashtu edhe të ligjit. Ndërsa, sa i përket pretendimeve të tij ndaj organeve gjyqësore, Gjykata konsideroi se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se procedurat në Gjykatën Supreme kanë qenë të padrejta apo arbitrare, apo që të drejtat dhe liritë themelore të tij të mbrojtura me Kushtetutë janë shkelur si rrjedhojë e interpretimit të gabuar të ligjit dhe vlerësimit të provave dhe fakteve në rastin e tij.

Rrjedhimisht, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, kërkesa ishte qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhej të deklarohej e papranueshme.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI112/17

Parashtrues

Deno Denović

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ. nr. 7/2017, të 16 majit 2017

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Deno Denović, me vendbanim në Mitrovicë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson Zyhdi Axhemi, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi [ARJ. nr. 7/2017] i 16 majit 2017 i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, të cilin parashtruesi i kërkesës e kishte pranuar më 5 qershor 2017.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 47 [Kërkesa Individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

5. Më 31 maj 2018, Gjykata miratoi, në seancë administrative, plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës Gjykata i referohet dispozitave juridike të Rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 18 shtator 2017, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 19 shtator 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.

8. Më 23 tetor 2017, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.

9. Më 14 shkurt 2018, Gjykata kërkoi nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës që të dorëzonte autorizimin që dëshmon se ai është i autorizuar që të përfaqësojë parashtruesin e kërkesës para Gjykatës. Gjykata po ashtu kërkoi nga parashtruesi i kërkesës dhe Gjykata Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore), që të dorëzojnë fletëkthesën që dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e kishte pranuar vendimin e kontestuar.

10. Më 22 shkurt 2018, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës dorëzoi autorizimin e kërkuar nga Gjykata.

11. Më 24 prill 2018, Gjykata Themelore dorëzoi fletëkthesën e cila dëshmon që parashtruesi i kërkesës vendimin e kontestuar e kishte pranuar më 5 qershor 2017.

12. Më 2 korrik 2018, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata që rasti i tij të zgjidhej me urgjencë.

13. Më 16 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Snezhana Botusharova dhe Almiro Rodrigues. Më 26 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.

14. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.

15. Më 12 shtator 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi Kolegjin e ri shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.

16. Më 26 shtator 2018, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

17. Më 25 shkurt 2014, parashtruesi i kërkesës ishte ndalur nga Policia e Kosovës në fshatin Krajkovë, Komuna e Leposaviqit, duke transportuar 4 (katër) bidonë naftë në vlerë prej 3999.00 euro (në tekstin e mëtejmë: malli i kontestuar). Në lidhje me këtë, Policia e Kosovës inicioi rastin për dyshim për tregti të palejuar kundër parashtruesit të kërkesës dhe udhëzoi që malli i kontestuar të dërgohet në Terminalin Doganor të Mitrovicës për ruajtje.

18. Më 15 prill 2014, Drejtoria Rajonale në Mitrovicë (në tekstin e mëtejmë: Drejtoria Rajonale) e Doganës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Dogana e Kosovës) përmes Aktvendimit [08.05.2/394] e shpalli parashtruesin e kërkesës përgjegjës për kundërvajtjen doganore të përcaktuar me nenin 8 të Ligjit nr. 04/L-099 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit nr. 03/L-109 Doganor dhe të Akcizave të Kosovës; e dënoi me gjobë prej 3822.00 euro dhe e urdhëroi konfiskimin e mallit të kontestuar. Drejtoria Rajonale e arsyetoi Aktvendimin në fjalë, ndër të tjera, me faktin se fatura përmes të cilës parashtruesi i kërkesës arsyetonte mallin, nuk ishte vërtetuar të jetë valide.

19. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Dogana e Kosovës rishqyrtimin e Aktvendimit [08.05.2/394] të Drejtorisë Rajonale, duke pretenduar "*shkelje esenciale të dispozitave të Kodit Doganor, cenimit të dispozitave materiale dhe të drejtave themelore të garantuara me Kushtetutë*".

20. Më 19 qershor 2014, Dogana e Kosovës, përmes Aktvendimit [07.03/497], e refuzoi si të pabazuar kërkesën për rishqyrtimin e Aktvendimit [08.05.2/394] të Drejtorisë Rajonale.

21. Më 22 korrik 2014, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje administrative (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore) kundër Doganave të Kosovës, duke kërkuar anulimin e Aktvendimit [07.03/497] ose kthimin e çështjes së tij në rishqyrtim në Doganën e Kosovës. Në ankesën e tij, parashtruesi i kërkesës pretendon që Dogana e Kosovës nuk i ka vërtetuar faktet, në veçanti, sa i përket validitetit të fakturës përmes të cilës pretendohet të jetë bërë blerja e mallit dhe konteston cilësimin e kundërvajtjes duke e pretenduar se e njëjta nuk mund të cilësohet si "kontrabandë me mallra".

22. Më 13 prill 2016, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit [A. nr. 1247/14], e refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe la në fuqi Aktvendimin [07.03/497] e Doganës së Kosovës.

23. Në një datë të paspecifikuar, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar "*shkelje të parimit të barazisë së palëve në procedurë*" dhe "*shqyrtimit jo objektiv të provave*". Parashtruesi i kërkesës kërkoi anulimin e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore ose kthimin e çështjes së tij në rigjykim si dhe kthimin e mallit të kontestuar.

24. Më 14 tetor 2016, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [AA. nr. 226/2016], duke i adresuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës e refuzoi si të pabazuar ankesën e tij dhe e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore.

25. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, në Gjykatën Supreme, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, për shkak të vërtetimit të gabuar të fakteve si dhe shkeljen e dispozitave materiale dhe procedurale, duke pretenduar sërish se nuk janë vërtetuar faktet në lidhje me validitetin e faturës për mallin e kontestuar dhe duke kërkuar që Aktgjykimet përkatëse të Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit të anulohen dhe që çështja e tij të kthehet në rigjykim.

26. Më 16 maj 2017, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit [ARJ.nr.7/2017], e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

27. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi [ARJ. nr. 7/2017] i 16 majit 2017 i Gjykatës Supreme shkel të drejtat e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.

28. Pretendimet për shkelje të të drejtave të tij në gjykim të drejtë dhe të paanshëm parashtruesi i kërkesës i ndërton përmes dy argumenteve në vijim: a) refuzimit të kërkesës për mbajtjen e seancës dëgjimore nga sektori për rishqyrtim i Doganës së Kosovës; dhe b) që Aktvendimet e Doganës së Kosovës dhe Aktgjykimet e gjykatave të rregullta janë arbitrare, sepse të njëjtat konsiderojnë që fatura mbi bazën e të cilës ai arsyetonte mallin e kontestuar nuk është valide dhe se asnjëra nga instancat administrative e gjyqësore nuk ka vërtetuar elementet e veprës për të cilën ai është shpallur përgjegjës dhe është dënuar.

29. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që ta deklarojë kërkesën e tij të pranueshme; të konstatojë shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe të shpallë Aktgjykimin [ARJ. nr. 7/2017] e 16 majit 2017 të Gjykatës Supreme në lidhje me Aktgjykimin [AA. nr. 226/2016] e 14 tetorit 2016 të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [A. nr. 1247/14] e 13 prillit

2016 të Gjykatës Themelore, të pavlefshëm duke e kthyer çështjen e tij në rishqyrtim.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

30. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
>
> *[...]*
>
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

32. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

> Neni 48
> [Saktësimi i kërkesës]
>
> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."*
>
> Neni 49
> [Afatet]
>
> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...".*

33. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [ARJ.nr.7/2017] e 16

majit 2017 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

34. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

> *"(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".*

35. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht rikujton që përmes Aktvendimit [08.05.2/394] të Drejtorisë Rajonale, parashtruesi i kërkesës është shpallur përgjegjës për kryerjen e kundërvajtjes doganore dhe i është shqiptuar dënimi përkatës. Ky Aktvendim ishte konfirmuar nga Dogana e Kosovës përmes Aktvendimit [07. 3/497] dhe nga Aktgjykimet e tri instancave gjyqësore në Republikën e Kosovës. Parashtruesi i kërkesës pretendon që vendimet në procedurë administrative e gjyqësore kanë shkelur të drejtat tij në gjykim të drejtë dhe të paanshëm sepse nuk i kishin mundësuar mbajtjen e një seance dëgjimore para organeve administrative dhe se nuk kishin vërtetuar faktet, posaçërisht sa i përket validitetit të faturës, e që ndërlidhen me veprën për të cilën ai është shpallur përgjegjës.

36. Gjykata fillimisht thekson që pretendimet thelbësore të parashtruesve të kërkesës, që kanë të bëjnë me shkeljet e pretenduara të garancive procedurale të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, janë interpretuar detajisht përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, Gjykata në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë. Rrjedhimisht, në interpretimin e pretendimeve për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata do t'i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së.

37. Gjykata gjithashtu vëren se praktika e GJEDNJ-së thekson se drejtësia e një procedure vlerësohet në bazë të procedurës si tërësi. (Shih

Aktgjykimin e GJEDNJ-së, të 6 dhjetorit 1988, *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës,* nr. 10590/83, paragrafi 68). Rrjedhimisht, gjatë vlerësimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata gjithashtu do t'i përmbahet këtij parimi. (Shih gjithashtu, rastin e Gjykatës KI104/16, parashtrues *Miodrag Pavić*, Aktgjykim i 4 gushtit 2017, paragrafi 38; dhe rastin KI143/16, parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmërisë i 13 qershorit 2018, paragrafi 31).

38. Në këtë aspekt, Gjykata së pari do t'i shqyrtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës sa i përket shkeljes së pretenduar të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, lidhur me shkeljen e pretenduar të garancive procedurale për seancë dëgjimore para organeve administrative bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së.

Për sa i përket pretendimit për shkelje të së drejtës për seancë dëgjimore para organeve administrative

39. Fillimisht, Gjykata duke u referuar në praktikën e GJEDNJ-së dhe në praktikën e saj gjyqësore, thekson se e drejta në proces të rregullt, në parim, nënkupton të drejtën e palëve për të qenë personalisht të pranishëm në gjykim dhe se kjo e drejtë është e lidhur ngushtë me të drejtën për seancë dëgjimore dhe me të drejtën e përcjelljes së procedurës personalisht. (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, të 23 shkurtit 1994, *Fredin kundër Suedisë*, Aplikacioni nr. 18928/91, faqe 10 e 11; *Ekbatani kundër Suedisë*, nr. 10563/83, GJEDNJ, Aktgjykim i 26 majit 1988, paragrafi 25; dhe rastin e Gjykatës KI104/16, parashtrues *Miodrag Pavić,* Aktgjykim i 4 gushtit 2017, paragrafi 40; dhe KI143/16, parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 qershorit 2018, paragrafi 37).

40. Gjykata rithekson se edhe pse nuk përmendet shprehimisht në tekstin e nenit 6 të KEDNJ-së, një seancë dëgjimore përbën një ndër parimet themelore të përcaktuara përmes këtij neni. (Shih *Jussila kundër Finlandës*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 23 nëntorit 2006 dhe rastin e Gjykatës KI104/16, parashtrues *Miodrag Pavić,* Aktgjykim i 4 gushtit 2017, paragrafi 42).

41. Megjithatë, GJEDNJ-ja përmes praktikës së saj gjyqësore përcakton edhe kufijtë e aplikimit të këtij rregulli dhe përjashtimet përkatëse. Të njëjtën e ka vendosur edhe praktika gjyqësore e Gjykatës, ndër të tjera, përmes rasteve KI104/16, parashtrues *Miodrag Pavić,* Aktgjykim i 4 gushtit 2017 dhe KI143/16, parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 13 qershorit 2018.

42. Për më tepër, në aplikimin e këtyre parimeve dhe kufizimeve përkatëse në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren që parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës si rezultat i refuzimit të mbajtjes së një seance dëgjimore para organeve administrative, përkatësisht Doganës së Kosovës dhe jo organeve gjyqësore. Kufijtë e aplikimit të garancive procedurale të mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së para organeve administrative janë po ashtu mirë të përcaktuara në praktikën e GJEDNJ-së dhe të Gjykatës. (shih, KO12/17, parashtrues *Avokati i Popullit*, Aktgjykim i 30 majit 2017).

43. Në Aktgjykimin e saj KO12/17, Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, kishte konstatuar se vendimet e marra nga autoritetet administrative duhet t'i nënshtrohen kontrollit pasues nga një *"organ gjyqësor që ka juridiksion të plotë"*, duke përfshirë edhe kompetencën e këtyre të fundit për të anuluar në të gjitha aspektet, në çështjet e faktit dhe ligjit, vendimet e autoriteteve administrative. (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese, KO12/17, *Avokati i Popullit*, Aktgjykim i 30 majit 2017, paragrafi 77 dhe 101. Shih gjithashtu, *mutatis mutandis*, vendimet e mëposhtme të GJEDNJ-së: *Albert dhe Le Compte kundër Belgjikës*, kërkesat nr. 7299/75, 7496/76, paragrafi 29, dhe Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 26 prillit 1995, *Fischer kundër Austrisë*, kërkesa nr. 16922/90, paragrafi 28).

44. Rrjedhimisht, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe Gjykatës përcakton që për drejtësinë e një procedure në tërësi, vendimet e organeve administrative do t'i përmbushin garancitë procedurale të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, për sa kohë që vendimet e autoriteteve të tilla administrative i nënshtrohen kontrollit të mëvonshëm nga një *"organ gjyqësor që ka juridiksion të plotë",* duke përfshirë edhe kompetencën për të anuluar vendimet e tilla në të gjitha aspektet – edhe sa i përket çështjeve të faktit po ashtu edhe të ligjit. (Shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, të 10 shkurtit 1983, *Albert dhe Le Compte kundër Belgjikës*, kërkesat nr. 7299/75, 7496/76, paragrafi 29, dhe Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 23 tetorit 1995, *Gradinger kundër Austrisë*, kërkesa nr. 15963/90, paragrafi 42; shih gjithashtu rastin e Gjykatës, KO12/17, parashtrues *Avokati i Popullit*, Aktgjykim i 30 majit 2017).

45. Rrjedhimisht, Kushtetuta dhe KEDNJ, bazuar në praktikat përkatëse gjyqësore, ngërthejnë në vetvete alternativat vijuese: ose që vet organet administrative t'i përmbushin kriteret e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, ose në rast se ato vet nuk i plotësojnë këto kritere, të jenë subjekt i kontrollit gjyqësor që ka

juridiksion të plotë dhe që i përmban garancitë e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. (Shih, *mutatis mutandis*, rasti *Albert dhe Le Compte kundër Belgjikës*, të cekur më lart, paragrafi 29).

46. Në aplikimin e këtyre parimeve në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren që argumentet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës si rezultat i mosmbajtjes të një seance dëgjimore në nivelin e organeve administrative nuk mbështesin në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij për shkelje kushtetuese, sepse vendimet përkatëse të organeve administrative iu nënshtruan kontrollit të mëvonshëm nga një *"organ gjyqësor që ka juridiksion të plotë"* me kompetencë për të anuluar vendimet e tilla edhe sa i përket çështjeve të faktit po ashtu edhe të ligjit. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton që të dy Aktvendimet e Doganave të Kosovës ishin vërtetuar nga tri instanca gjyqësore, Gjykata Themelore, e Apelit dhe Supreme, respektivisht. Në tri instancat gjyqësore ishin shqyrtuar faktet dhe provat dhe një shqyrtim kryesor publik ishte mbajtur në Gjykatën Themelore.

47. Rrjedhimisht dhe duke marrë parasysh karakteristikat e veçanta të rastit, pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, Gjykata mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, nuk gjen të jetë cenuar e drejta në seancë dëgjimore si element përbërës i së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

48. Gjykata në vijim do të shqyrtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës për mos vërtetim të drejtë të fakteve nga organet administrative dhe gjyqësore, dhe posaçërisht sa i përket validitetit të faturës për mallin e kontestuar.

Për sa i përket pretendimit për mos vërtetim të drejtë të fakteve

49. Parashtruesi i kërkesës pretendon se organet administrative dhe gjykatat e rregullta, kanë shpallur përgjegjës parashtruesin e kërkesës pa i vërtetuar provat dhe faktet relevante, respektivisht duke mos e vlerësuar si duhet validitetin e faktuarës në lidhje me mallin e kontestuar si dhe duke i ngarkuar atij barrën e provës për të dëshmuar se malli i kontestuar ka kaluar në procedurat e rregullta të zhdoganimit.

50. Gjykata konsideron se ky pretendim i parashtruesit të kërkesës ngrit çështje të ligjshmërisë që kanë të bëjnë me zbatimin e dispozitave ligjore dhe me vlerësimin e provave në bazë të të cilave parashtruesi i kërkesës është shpallur përgjegjës për kundërvajtjen doganore në lidhje me mallin e kontestuar. Gjykata rikujton se këto pretendime kanë të bëjnë me fushën e ligjshmërisë dhe si të tilla nuk bien nën juridiksionin e Gjykatës, dhe si rrjedhojë, në parim, nuk mund të shqyrtohen nga Gjykata.

51. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "*shkallës së katërt*", që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih, rasti *García Ruiz kundër Spanjës*, GJEDNJ nr. 30544/96, i 21 janarit 1999, par. 28 dhe shih, gjithashtu rastin: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima,* Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

52. Për më tepër, Gjykata vëren se pas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, Gjykata Supreme ka hedhur poshtë pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të dispozitave materiale dhe procedurale nga Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit. Gjykata Supreme i është përgjigjur të gjitha pretendimeve për shkelje ligjore të ngritura nga parashtruesi i kërkesës.

53. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se në adresimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme kishte arsyetuar se fatura e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës nuk mund të pranohet si valide për shkak se valuta monetare e shprehur në faturë nuk është në përdorim në territorin e Kosovës dhe nuk mund të kryhen transaksionet ekonomike. Ndërsa, në anën tjetër, parashtruesi i kërkesës nuk kishte ofruar prova që dëshmojnë se malli i kontestuar i ishte nënshtruar procedurave doganore të zhdoganimit ashtu siç kërkohet me nenin 81. F të Ligjit nr. 03/l-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjit 04/L-102.

54. Në këtë aspekt, Gjykata Supreme, ndër të tjera, arsyetoi:

> *"[Fatura e paraqitur nga [parashtruesi i kërkesës] nr. 107/014 dt.25.02.2014 edhe sipas vlerësimit të këtij kolegji nuk mund të pranohet si valide për shkak se valuta monetare e shprehur në faturë (në dinar) nuk është në përdorim në territorin e Kosovës dhe nuk mund të kryhen transaksionet ekonomike, ndërsa në anën tjetër paditësi nuk ka ofruar prova që dëshmojnë se malli lëndor i është nënshtruar procedurave doganore të zhdoganimit. Bazuar në dispozitën e nenit 81.F të Ligjit 04/L-102 parashihet që tatimpaguesi do të bartë detyrimin mbi vërtetimin e fakteve që mbështesin kërkesën e tij, kësisoj për të trajtuar mallin kontestues si mall vendor siç pretendon paditësi në kërkesë duhet të posedoj dokumentacion përkatës të rregullt që do të harmonizohej fatura e mallit me nr. e regjistrimit të biznesit - shitësit në këtë rast që ka lëshuar faturën, pastaj kuponin fiskal apo pagesën që do ta vërtetonte, shitblerjen e brendshme të mallit.*
>
> *Nga të cekurat më lart, Gjykata Supreme gjeti se gjykata e shkallës së parë dhe e dytë në këtë çështje administrativo-juridike drejt kanë aplikuar dispozitat e të drejtës materiale, njashtu që thëniet e paditësit në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor janë të pabazuara ngase nuk janë me ndikim në vërtetim tjetër të gjendjes faktike nga ajo të cilën e kanë vërtetuar gjykatat e shkallës më të ulët".*

55. Gjykata më tej konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se procedurat në Gjykatën Supreme kanë qenë të padrejta apo arbitrare, apo që të drejtat dhe liritë themelore të tij të mbrojtura me Kushtetutë janë shkelur si rrjedhojë e interpretimit të gabuar të ligjit dhe vlerësimit të provave dhe fakteve në rastin e tij. Gjykata rithekson se interpretimi i ligjit është detyrë e gjykatave të rregullta dhe është çështje e ligjshmërisë. Asnjë çështje kushtetuese nuk është dëshmuar nga parashtruesi i kërkesës. (Shih, rasti KI63/16, parashtrues i kërkesës *Astrit Pira*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 gushtit 2016, paragrafi 44 dhe shih, gjithashtu rastin KI150/15; KI161/15; KI162/15; KI14/16; KI19/16; KI60/16 dhe KI64/16, parashtrues të kërkesës *Arben Gjukaj, Hysni Hoxha, Driton Pruthi, Milazim Lushtaku, Esat Tahiri, Azem Duraku dhe Sami Lushtaku*, Aktvendim për papranueshmëri, i 15 nëntorit 2016, paragrafi 62).

56. Gjykata më tej vëren se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e procedurës para gjykatave të rregullta. Megjithatë, pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të

argumentueshëm për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. (shih, *mutatis mutandis,* rastin *Mezotur - Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21,; dhe shih, gjithashtu rastin KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 42).

57. Si rezultat, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet se procedurat përkatëse në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare dhe se me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ. (shih, *mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë,* nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

58. Si përfundim, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe, rrjedhimisht, e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, me 26 shtator 2018, njëzëri

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim ne Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Gresa Caka-Nimani	Arta Rama-Hajrizi

Rasti nr. KI34/18, Parashtrues i kërkesës: Albert Berisha, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, PML. nr. 225/2017, të 18 dhjetorit 2017

KI34/18, Aktvendim për papranueshmëri, i 23 majit 2018, i publikuar më 18 qershor 2018

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, procedurë penale, drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, "gjykatë e shkallës së katërt"

Gjykata Themelore në Prishtinë e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për veprën penale *"Organizimi dhe pjesëmarrja në grupe terroriste"*. Parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore. Në ankesën e tij para Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës pretendoi se atij i ishte mohuar e drejta për gjykim të drejtë sepse dënimi ishte bazuar në vlerësim të gabuar të fakteve. Gjykata e Apelit refuzoi pretendimet ankimore të parashtruesit të kërkesës. Parashtruesi paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, duke pretenduar shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë për shkak të shkeljes së parimit të barazisë së armëve.

Gjykata Supreme e refuzoi kërkesën e parashtruesit për mbrojtjen e ligjshmërisë si të pabazuar, veçanërisht sepse dëshmitarët që parashtruesi kishte kërkuar që të ftoheshin ishin persona zyrtar, dëshmia e të cilëve ishte e përfshirë në dosje të rastit.

Në kërkesën e tij para Gjykatës Kushtetuese, parashtruesi i kërkesës pretendoi se atij i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë. Parashtruesi pretendoi se e drejta e tij për të heshtur është shkelur sepse dëshmitë e tij të dhëna gjatë fazës hetimore janë përdorur kundër tij. Për më tepër, ai ankohet se e drejta e tij për barazi të armëve është shkelur pasi ai nuk u lejua që të ftoj disa dëshmitar specifik. Ai gjithashtu pretendon se vendimet e gjykatave të rregullta nuk janë arsyetuar, dhe në rastin e tij nuk janë respektuar parimet e të drejtës në gjykim i drejtë, dhe rrjedhimisht mbajtja e tij nuk është e bazuar ligjërisht në një vendim të gjykatës kompetente.

Gjykata vlerësoi se aktgjykimet e gjykatave e rregullta janë të arsyetuara si duhet, se deklarata e parashtruesit e dhënë në procedurën paraprake është marrë në mënyrë të ligjshme dhe është provë valide, dhe se parashtruesi i kërkesës ka përfituar nga prezenca e avokatit gjatë intervistës para zyrtarëve policor.

Sa u përket pretendimeve të parashtruesit lidhur me shkeljen e nenit 5 (E drejta për liri dhe siguri) të KEDNJ-së, Gjykata konstatoi se parashtruesi i

kërkesës është dënuar nga një *"gjykatë kompetente",* e cila ka kryer një *„procedurë gjithëpërfshirëse"*, e cila ka rezultuar me vërtetimin e përgjegjësisë penale.

Rrjedhimisht, Gjykata konkludoi se asgjë në rastin e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës nuk tregon që procedurat në gjykatat e rregullta ishin të padrejta apo arbitrare në mënyrë që Gjykata Kushtetuese të bindet se thelbi i së drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm është shkelur ose që parashtruesi është privuar nga çdo lloj garancie procedurale, gjë që do të çonte në shkelje të së drejtës sipas nenit 31 të Kushtetutës paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së. Për më tepër, Gjykata më tej konsideron se nuk mund të veprojë si „gjykatë e shkallës së katërt" për të rishikuar provat dhe deklarohet në lidhje me fajësinë apo pafajësinë e parashtruesit.

Lidhur me këtë, Gjykata e shpalli kërkesën e parashtruesit qartazi të pabazuar në baza kushtetuese dhe e deklaroi të papranueshme në pajtim me rregullin 36 (1) d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI34/18

Parashtrues

Albert Berisha

Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, PML. nr. 225/2017, të 18 dhjetorit 2017

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Albert Berisha nga Prishtina (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, PML. nr. 225/2017, të 18 dhjetorit 2017, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, PAKR. nr. 518/2016, të 4 majit 2017, dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, PKR. nr. 263/15, të 29 prillit 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve gjyqësore të lartpërmendura, me të cilat pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 5 (E drejta për liri dhe siguri) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

4. Parashtruesi gjithashtu kërkon nga Gjykata Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), "*të vendosë masë të përkohshme, sepse konsideron se po privohet padrejtësisht nga liria, si rezultat i nxjerrjes së vendimeve gjyqësore kundërkushtetuese*".

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenin 27 [Masat e përkohshme], nenin 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullat 29 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] dhe 54 [Kërkesa për masa të përkohshme] të Rregullores së punës së Gjykatës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 8 mars 2018, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

7. Më 9 mars 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të

përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Gresa Caka-Nimani.

8. Më 13 mars 2018, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe ia dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

9. Më 13 mars 2018, në pajtim me rregullin 37 (1) të Rregullores së punës, Kryetarja urdhëroi bashkimin e kërkesës së regjistruar me numër KI37/18, me kërkesën e parashtruesit të regjistruar me numër KI34/18.

10. Më 19 mars 2018, parashtruesi parashtroi një letër në Gjykatë duke kërkuar që mos ta bashkojë kërkesën e tij me kërkesën e regjistruar me numër KI37/18.

11. Më 22 mars 2018, në pajtim me rregullin 37 (3) të Rregullores së punës, Kryetarja urdhëroi ndarjen e kërkesës së parashtruesit të regjistruar me numër KI34/18 nga kërkesa e regjistruar me numrin KI37/18.

12. Më 17 maj 2018, parashtruesi parashtroi në Gjykatë argumente shtesë në mbështetje të kërkesës së tij.

13. Gjykata, në pajtim me rregullin 30 (3) (Regjistrimi i kërkesës dhe afati i dorëzimit) të Rregullores së punës, nuk mori parasysh argumentet shtesë të paraqitura nga parashtruesi më 17 maj 2018.

14. Më 23 maj 2018, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

15. Më 11 gusht 2014, Policia e Kosovës (në tekstin e mëtejmë: PK), e privoi parashtruesin e kërkesës nga liria për shkak të dyshimit të bazuar se kishte kryer veprën penale *"Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist"* , nga neni 143, paragrafi 2, të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPK).

16. Më 26 gusht 2014, parashtruesi i kërkesës, në prani të mbrojtësit i cili i është caktuar sipas detyrës zyrtare, u mur në pyetje në polici. Parashtruesi i kërkesës dha deklaratën si në vijim: "*më 6 tetor 2013, jam nisur nga Prishtina në drejtim të Stambollit, e prej aty kam shkuar në Hataj, ku kam qëndruar një ditë e pastaj kam udhëtuar në qytetin Kilis, afër kufirit Turqi - Siri. Ndërsa, ditën e nesërme me ndihmën e një shtetasi turk, kam kaluar kufirin në mënyrë ilegale dhe*

kam shkuar në Siri, saktësisht në qytetin Tal Rivat, me ç' rast jam vendosur në një bazë në afërsi të Alepos, e pastaj më pyetën për arsyen e shkuarjes sime atje të cilëve iu kam thënë se kam ardhur për ta ndihmuar popullin sirian dhe nuk dua që të jem pjesë e Al Kaidës …".

17. Më 7 maj 2015, Prokurori Special i Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Prokurori) paraqiti në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore), aktakuzën PPS. nr. 26/2015, kundër parashtruesit e kërkesës për kryerjen e veprës penale "Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist", nga neni 143, paragrafi 2, të KPK-së.

18. Gjatë shqyrtimit në Gjykatën Themelore, parashtruesi i kërkesës pohoi pafajësinë tij, duke deklaruar se: "*[...] qëllimi i shkuarjes se tij në Siri ka qenë për t'i ndihmuar popullit sirian kundër regjimit të Asadit dhe se nuk ka pasur qëllim që t'i bashkohet grupeve terroriste, më vetëdije të plotë ka marrë pjesë në grupin Ahra al Sham, i cili ishte një grup opozitar që nuk bënte pjesë në organizata terroriste, nuk ishte as në listën e zezë të Departamentit Amerikan të Shtetit".*

19. Në fjalën përfundimtare në Gjykatën Themelore, mbrojtësi i parashtruesit deklaroi se: "*Prokurori special nuk arriti që të vërtetoj pretendimet e veta se i akuzuari Albert Berisha ka kryer veprën penale Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist nga neni 143 par.2 të KPK-së".*

20. Prokuroi në fjalën përfundimtare në Gjykatën Themelore tha *"[...] se disa nga të akuzuarit kanë pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat janë akuzuar, andaj për këta të akuzuar nuk është lëshuar në vlerësimin e provave por ka bërë vlerësimin e provave vetëm për të akuzuarit që nuk kanë pranuar fajësinë".*

21. Më 29 prill 2015, Gjykata Themelore nxori Aktgjykimin PKR. nr. 263/15, me të cilin parashtruesin e kërkesës e shpalli fajtor për kryerjen e veprës penale dhe ia shqiptoi dënimin me 3 (tre) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim.

22. Në arsyetimin e Aktgjykimit PKR. nr. 263/5 të Gjykatës Themelore theksohet se *"Gjykata nuk i fali besimin të akuzuarit Albert Berisha e as tezës mbrojtëse të avokates së tij, se kinse i akuzuari Albert nuk kishte qenë në dijeni për situatën në Siri, se ai atje kishte shkuar për t'ju ndihmuar popullsisë civile. [...] "Qëndrimi i të akuzuarit Albert Berisha, për një kohë të shkurtë në Siri nuk e liron nga përgjegjësia*

penale, deklarimet e tij në hetuesi dhe në shqyrtim kryesor janë kontradiktore.
[...]
Gjatë matjes së dënimit për të akuzuarit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit konform nenit 73 të KPRK-së".

23. Parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, PKR. nr. 263/15, duke deklaruar:

a) "ashtu që aktgjykimi është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sepse dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm, kundërthënës, dhe se është dënuar në bazë të deklaratës së tij.

b) Se në aktgjykime gjendja faktike është vërtetuar gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë,

c) Se dënimi është i padrejtë, sepse ai është dënuar në mënyrë të padrejtë në bazë të fakteve që nuk janë vërtetuar".

24. Më 4 maj 2016, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin PAKR. nr. 518/2016, me të cilin i refuzoi, si të pabazuara, pretendimet ankimore të parashtruesit të kërkesës.

25. Në Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, PAKR. nr. 518/2016, theksohet:

a) "Sa i përket pretendimeve ankimore të parashtruesit për shkelje të dispozitave të procedurës penale se gjykata e shkallës së parë e ka shpall fajtor të akuzuarin (parashtruesin) në bazë të deklaratës së tij të dhënë në polici, Gjykata thekson më tej se sipas dispozitave ligjore është përcaktuar se mbrojtja e të pandehurit mund të përdoret si provë (neni 125, paragrafi 2 KPPK-së) në procedurën penale".

b) "I akuzuari (parashtruesi i kërkesës) si në polici ashtu edhe në shqyrtimin gjyqësor ka pohuar faktin se ka qenë në Siri por kategorikisht ka mohuar se kishte pasur për qëllim që t'ju bashkohet organizatave terroriste. Në fakt ky i akuzuar në shqyrtimin gjyqësor thekson ka dëgjuar nga portalet e ndryshme dhe rrjetet sociale për paraqitjen e Lavdrim Muhaxherit dhe e ka ditur se ai ka qenë pjesë e organizatës së Shtetit Islamik të organizatës së "ISIS-it" dhe për këtë arsye ka vendosur për t'iu bashkuar grupit "Ahra Al Sham".

c) "Gjykata vlerëson se matja e dënimeve të shqiptuara ndaj të akuzuarve është bërë në pajtim me rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit konform nenit 73 të KPRK, kështu që dënimet e shqiptuara ndaj tyre janë në përpjesëtim me rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale të kryer".

26. Parashtruesi paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, PAKR. nr. 518/2016, "*për shkelje të parimit të barazisë midis palëve në procedurë "equality of the arms", sepse gjykata nuk e miratoi propozimin e tij për dëgjimin e dëshmitarëve, duke e shkelur kështu parimin e gjykimit të drejtë dhe të paanshëm të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".*

27. Më 18 dhjetor 2017, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin, PML. nr. 225/2017, me të cilin e refuzoi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë së parashtruesit si të pabazuar. Në arsyetimin e aktgjykimit theksohet:

"Gjykata vlerëson se dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë në raport me të akuzuarin është i qartë dhe përmban të gjitha të dhënat për kohën, vendin, mënyrën e kryerjes së veprës penale dhe të dhëna të tjera që paraqesin elementet qenësore të veprave të kryera penale. Në këtë çështje penale nuk ka qenë kontestuese se në kohën kritike, siç është përshkruar në dispoztivin e shkallës së parë, parashtruesi i kërkesës ka qenë në Siri, sikurse edhe fakti se ishte atje për t'u bashkangjitur formacionit terrorist".

28. Sa i përket pretendimit për shkelje të parimit "*barazia e armëve",* për shkak se Gjykata Themelore nuk e ka aprovuar propozimin e parashtruesit të kërkesës për t'i dëgjuar zyrtarët e policisë të cilët kishin kryer pyetjen e tij fillestare, Gjykata Supreme theksoi: *"Kjo gjykatë vlerëson, siç ka konkluduar drejt gjykata e shkallës së parë, se nuk është i nevojshëm dëgjimi i tyre meqë dëshmitarët e propozuar, si personat zyrtar (policë) kanë intervistuar të dënuarin në rrethanat e veprës penale, kurse sa i përket pohimit të tij se të njëjtit i është premtuar se ai nuk do të përfshihet në aktakuzë del si i pabazuar sepse siç rezulton nga shkresat e çështjes, ky i dënuar në këtë çështje penale, nuk është shpallur dëshmitar bashkëpunues siç kërkohet me dispozitën e nenit 236 të KPPK, prandaj nuk është shkelur parimi i barazisë së palëve në procedurë".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

29. Parashtruesi i kërkesës pretendon se procedura në tërësi në gjykatat e rregullta, duke përfshirë edhe fazën e marrjes në pyetje në polici, kishte shkelur të drejtat e tij kushtetuese, përkatësisht të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, "*sepse edhe me ligj nacional (KPPK) - por edhe me KEDNJ, nxitja e të dyshuarit për të dhënë ndonjë deklaratë "duke i premtuar" apo "duke ushtruar çfarëdo forme të presionit" konsiderohet e pavlefshme*".

30. Parashtruesi i kërkesës konsideron se gjykatat ia shkelën parimet e prezumimit të pafajësisë dhe barazisë së armëve, pasi që në të gjitha fazat e procedurës ata paragjykuan fajin e tij për veprën e pretenduar penale. Gjykatat përjashtuan parimet kushtetuese se aktakuza duhet të bazohet në dëshmi të arsyeshme dhe të mjaftueshme dhe se barra e të provuarit bie mbi prokurorinë. Rrjedhimisht, ata e privuan parashtruesin nga e drejta e tij për t'u prezumuar i pafajshëm derisa të mos vërtetohet se është fajtor, ndërsa duke refuzuar t'i dëgjonin të vetmit dëshmitarë që ai propozoi, e vendosën atë në një pozitë të pabarabartë në raport me organet që e akuzojnë atë.

31. Parashtruesi i kërkesës konsideron se i është shkelur e drejta në vendim gjyqësor të arsyetuar, sepse vendimet e gjykatave nuk janë logjike, nuk janë në formën e rregullt, nuk janë të qarta në përmbajtje dhe përmbajnë kontradikta.

32. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se ndalimi i tij nuk bazohet në një dënim nga një gjykatë kompetente, në shkelje të nenit 5 (E drejta për liri dhe siguri) të KEDNJ-së si rezultat i shkeljes së të drejtës së tij për gjykim të drejtë siç mbrohet me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

33. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata ta deklarojë kërkesën të pranueshme, të vendosë masë të përkohshme, të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së dhe si rezultat i këtyre shkeljeve erdhi deri te shkelja e nenit 5 (E drejta për liri dhe siguri) të KEDNJ-së.

Pranueshmëria e kërkesës

34. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i plotëson kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

35. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë se:

> *1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

36. Gjykata i referohet nenit 49 [Afatet] të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej 4 (katër) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor".*

37. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i ka shteruar të gjitha mjetet juridike dhe ka parashtruar kërkesë brenda afatit të caktuar.

38. Megjithatë, Gjykata më tej i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili përcakton:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*

39. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 36 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, i cili parasheh:

> *(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
>
> > *(d) kërkesa nuk arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

40. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës së pari pretendon se me aktgjykimet e kontestuara i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së dhe si rezultat i këtyre shkeljeve, erdhi deri te shkelja e nenit 5 (E drejta për liri dhe siguri) të KEDNJ-së.

41. Gjykata së pari rikujton që, në pajtim me nenin 53. [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës "*Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*".

42. Në këtë kuptim, Gjykata i referohet nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, i cili përcakton:

"1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
[...]".

43. Gjithashtu, edhe neni 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, përcakton:

"Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij.
[...]"

44. Gjykata verën se çështja kryesore ka të bëjë me vërtetimin e bazueshmërisë së akuzës penale kundër parashtruesit të kërkesës, prandaj, parashtruesi në procedurën lëndore gëzon garancinë e së drejtës për gjykim të drejtë sipas nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

45. Parashtruesi i kërkesës në thelb pretendon se i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë. Ai i bazon pretendimet e tij në *i)* faktin se aktgjykimet e kontestuara bazohen në deklaratën e tij të dhënë në procedurën paraprake penale, e cila është shfrytëzuar si dëshmi gjatë gjykimit. Në këtë drejtim, *ii)* parashtruesi i kërkesës pretendon se ishin shkelur të drejtat për mbrojtje sepse e drejta e tij për të heshtur dhe për të mos kontribuar në inkriminimin e tij ishte shkelur, *iii)* për shkak se gjykatat nuk e lejuan atë që në gjykim të thirrë dëshmitarët në mbrojtje të tij, dhe *iv)* sepse aktgjykimet e kontestuara nuk përmbajnë arsye të mjaftueshme dhe shpjegime për faktet vendimtare. Të gjitha të lartcekurat, sipas mendimit të parashtruesit të kërkesës, qojnë në përfundimin se nuk i janë siguruar garancitë për gjykim të drejtë. Për më tepër, *v)* parashtruesi i kërkesës pretendon se vuajtja e dënimit në bazë të këtyre aktgjykimeve gjyqësore, nuk është e ligjshme, sepse gjykatat kanë shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë, dhe rrjedhimisht vuajtja e dënimit nuk është duke u bërë në bazë të dënimeve të gjykatave kompetente, ashtu si kërkohet me nenin 5(1) të KEDNJ.

46. Gjykata, e udhëhequr nga pretendimet e bëra nga parashtruesi i kërkesës, duke marrë parasysh se ai konsideron se procedura si tërësi nuk ishte e drejtë, rikujton, së pari, në praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), sipas të cilës, "*çështja nëse i akuzuari kishte procedurë të drejtë duhet të shikohet në bazë të procedurës në tërësi"* (shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Monnel dhe Morris kundër Mbretërisë së Bashkuar,* Kërkesa nr. 9562/81; 9818/82, të 2 marsit 1987, Seria A, nr. 115, faqe 21, paragrafi 54).

i) **Shfrytëzimi i deklaratave të parashtruesit si dëshmi**

47. Në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës, *"[...] që aktgjykimet e kontestuara bazohen në prova, përkatësisht në deklaratën e tij [në polici], dhe se ka munguar vlerësimi i kujdesshëm dhe gjithëpërfshirës të provave të tjera"*, Gjykata së pari rikujton praktikën e vet dhe atë të GJEDNJ-së, sipas së cilës nuk është detyrë e saj të shqyrtojë se si gjykatat e rregullta e kanë vërtetuar gjendjen faktike apo zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, përveç dhe nëse nuk i vë në pikëpyetje të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNJ. Prandaj, ajo nuk mund të veprojë si "*gjykatë e shkallës së katërt*" (shih: *Akdivar kundër Turqisë*, nr. 21893/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, paragrafi 65. Shih, gjithashtu: *mutatis mutandis* rastin KI86/11, parashtrues: *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, të 5 prillit 2012).

48. Gjykata vëren se neni 6 i KEDNJ-së garanton të drejtën për një gjykim të drejtë, por nuk vendos rregulla për shfrytëzimin e provave, kjo është kryesisht çështje që rregullohet nga legjislacioni vendor (shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Schenk kundër Zvicrës*, Seria A. nr. 140, të 12 korrikut 1988, paragrafët 45-46 dhe Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Teixeira de Castroprotiv kundër Portugalisë,* Raporti 1998-IV, paragrafi 34, të 9 qershorit 1998).

49. Prandaj, si çështje e parimit, Gjykata konsideron se roli i saj nuk është të vërtetojë nëse një lloj i caktuar i provave në gjykatë mund të jetë i pranueshëm ose jo, përkatësisht nëse parashtruesi i kërkesës është fajtor apo jo. Në këtë drejtim, pyetja në të cilën duhet përgjigjur është nëse procedura si tërësi, duke përfshirë edhe mënyrën se si janë marrë provat, ishte e drejtë. Kjo përfshin edhe shqyrtimin e "joligjshmërisë" në fjalë, edhe atje ku është në pyetje shkelja e të drejtave të tjera nga KEDNJ (shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-s. *Bykov kundër Rusisë*, Kërkesa nr. 4378/02, paragrafi 89, të 10 marsit 2009, dhe Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Lee Davies kundër Belgjikës*, Kërkesa nr. 18704/05, paragrafi 41, të 28 qershorit 2009).

50. Për më tepër, Gjykata rikujton se nuk do të ndërhyjë në atë se cilat prova të palëve në procedurë gjykatat i dhanë më shumë besim në bazë të shqyrtimit të lirë gjyqësor (shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Doorson kundër Hollandës*, Kërkesa 1996/II, paragrafi 78, të 6 marsit 1996).

51. Gjithashtu, GJEDNJ-ja në praktikën e saj tregoi se gjykatat vendore kanë vlerësim të caktuar diskrecional në lidhje me atë se cilat argumente dhe prova do t'i pranojnë në rastin e caktuar, por njëkohësisht kanë obligim ta arsyetojnë vendimin e tyre, duke ofruar arsye të qarta dhe të kuptueshme mbi të cilat e kanë bazuar vendimin (shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Suominen kundër Finlandës*, Kërkesa nr. 37801/97, paragrafi 36, të 1 korrikut 2003.).

52. Gjykata vëren se në arsyetimin e aktgjykimit të shkallës së parë, ndër të tjera, thuhet se njëra nga provat kryesore mbi të cilat u bazua konkludimi për ekzistimin e veprës penale dhe përgjegjësisë penale të parashtruesit është pikërisht dëshmia që ai e ka dhënë në polici. Në atë deklaratë, parashtruesi ka përshkruar me hollësi veprimet që i ka ndërmarrë në Siri, të cilat gjykatat e rregullta i kanë vlerësuar si elemente qenësorë që padyshim tregojnë ekzistimin e figurës së veprës penale dhe përgjegjësinë e tij penale.

53. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës deklaratën e tij të dhënë në polici e dha në praninë e mbrojtësit të tij të caktuar

sipas detyrës zyrtare. Kjo çon në përfundimin se ai gjatë tërë procedurës kishte qasje në asistencë ligjore nga e cila ka mund të përfitoj, si dhe ka mundur të jetë i njoftuar për pasojat që dalin ose mund të dalin nga deklarata e tij në rrjedhën e mëtejshme të procedurës penale.

54. Gjykata më tej vëren se neni 261 i KPP-së përcakton mundësinë që deklaratat e bëra në procedurën e mëparshme mund të përdoren si dëshmi gjatë shqyrtimit gjyqësor.

55. Neni 261 Përdorimi i deklaratave të mëparshme në shqyrtim gjyqësor të KPP-së, thekson:

> *"[...]*
>
> *2. Marrja në pyetje në procedurë paraprake mund të përdoret si provë në pajtim me nenin 123 paragrafi 2. të këtij Kodi.*
> *3. Deklarata në procedurë paraprake mund të përdoret si provë në pajtim me nenin 123, paragrafi 3. të këtij Kodi".*

56. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta kanë dhënë konkludime të gjëra, duke dhënë arsyet, dhe duke treguar dispozitat relevante ligjore se pse deklarata e parashtruesit të kërkesës në procedurën paraprake është shfrytëzuar si provë. Gjykata nuk konsideron se arsyetimi i dhënë nga gjykatat e rregullta ishte arbitrar.

ii) **Lidhur me ndalimin e vetëinkriminimit**

57. Parashtruesi i kërkesës pretendon se është shkelur e drejta e tij për t'u liruar nga vetëfajësimi, sepse deklarata e tij në polici gjatë hetimit ishte shfrytëzuar kundër tij në gjykatë gjatë gjykimit penal.

58. Gjykata rikujton nenin 10 [Njoftimi për shkaqet e akuzës, mosdetyrimi për vetëfajësim dhe ndalesa kundër imponimit për pranim të fajit] të KPP-së, i cili thotë:

> *"1. Gjatë arrestimit të tij dhe marrjes në pyetje për herë të parë, i pandehuri menjëherë njoftohet në hollësi për llojin dhe shkaqet e akuzës kundër tij në gjuhën që ai e kupton.*
>
> *2. I pandehuri nuk ka detyrim të paraqesë mbrojtjen e vet ose të përgjigjet në ndonjë pyetje, dhe nëse mbrohet, nuk është i detyruar të akuzojë vetveten ose të afërmit e tij e as të pranojë fajësinë. Kjo e drejtë nuk përfshin rastin kur i pandehuri hyn*

vullnetarisht në marrëveshje për të bashkëpunuar me Prokurorin e Shtetit.

3. Nga i pandehuri ose personi tjetër që merr pjesë në procedurë ndalohet dhe dënohet që të imponohet pranimi i fajësisë ose ndonjë deklarim tjetër me anë të torturës, forcës, kanosjes apo nën ndikimin e drogës ose të masave të tjera të ngjashme".

59. Gjykata gjithashtu rikujton se e drejta për një gjykim të drejtë, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, siguron disa garanci minimale për çdo person të akuzuar për një vepër penale, e cila përfshin të drejtën e lirisë nga vetëfajësimi, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së (shih Aktgjykimi i GJEDNJ-së, *Saunders kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 19187/91, paragrafët 68 dhe 69, të 17 dhjetorit 1996, si dhe GJEDNJ *John Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa 18731/91, paragrafi 45, i 8 shkurtit 1996).

60. Në këtë drejtim, e drejta e personit për të mos fajësuar veten, nënkupton që në procedurën penale kërkohet nga prokurori të provojë çështjen e tij kundër të akuzuarit pa përdorur dëshmi të fituara nëpërmjet metodës së dhunës dhe represionit në kundërshtim me vullnetin e të akuzuarit. E drejta për mos ta inkriminuar veten është kryesisht e lidhur me vullnetin e palës së akuzuar për t'u mos deklaruar, përkatësisht të drejtën në heshtje që zbatohet edhe në rastin e marrjes në pyetje të të dyshuarit (shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Saunders kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa 19187/91, paragrafët 68 dhe 69, të 17 dhjetorit 1996, si dhe Aktgjykimi i GJEDNJ-së, *John Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa 18731/91, paragrafi 45, të 8 shkurtit 1996).

61. Përfundimisht, e drejta në heshtje nuk është absolute, dhe në vlerësimin nëse procedura ka shkele vetë thelbin e garancive kundër vetëfajësimit, GJEDNJ-ja i vlerëson në bazë të: a) *natyrës dhe shkallës së dhunës*, b) *ekzistimit të ndonjë mase mbrojtëse relevante*, dhe c) *përdorimin e provës të fituar në këtë mënyrë. (*shih GJEDNJ, *John Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa 18731/91, paragrafi 45, i 8 shkurtit 1996).

62. Më tej, Gjykata do ta elaboroj pretendimin e parashtruesit të kërkesës, se i është "*shkelur e drejta për mbrojtje dhe garancitë në lidhje me mbrojtjen nga vetë inkriminimi, për shkak se deklarata e tij është përdorur si dëshmi".*

63. Lidhur me këtë, Gjykata së pari thekson se gjatë vlerësimit nëse procedura ishte e drejtë në tërësi, duhet pasur parasysh nëse janë respektuar të drejtat e mbrojtjes. Në lidhje me këtë, Gjykata do të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës kishte mundësi ta kontestoj ligjshmërinë e provave dhe të kundërshtoj përdorimin e tyre (shih, Aktgjykimin e GEDNJ-së, *Szilagyi kundër Rumanisë*, Kërkesa 30164/04, të 17 dhjetorit 2013).

64. Përveç kësaj, duhet të merret parasysh edhe cilësia e provës, duke përfshirë nëse rrethanat në të cilat është marrë tregojnë dyshimin për besueshmërinë ose saktësinë e saj (shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Lisica kundër Kroacisë*, Kërkesa 20100/06, paragrafi 49, të 25 shkurtit 2010).

65. Për më tepër, problemi i drejtësisë nuk do të paraqitet domosdoshmërisht kur dëshmia e marrë nuk mbështetet nga materiale të tjera. Rrjedhimisht duhet pasur parasysh se kur prova është shumë e fortë dhe është e pranueshme pa ndonjë dyshim, nevoja për prova të tjera të cilat e mbështesin atë zvoglohet (shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Davies kundër Belgjikës*, Kërkesa 18704/05 paragrafi 42, të 28 qershorit 2009, si dhe Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Bykov kundër Rusisë*, Kërkesa nr. 4378/02, paragrafi 90, të 10 marsit 2009).

66. Në rastin konkret, Gjykata vëren se në rastin e parashtruesit të kërkesës, gjykatat e rregullta kanë konkluduar, duke dhënë arsye të mjaftueshme dhe arsyetimet që edhe kjo Gjykatë nuk i konsideron arbitrare, që deklarata e parashtruesit e dhënë në polici është marrë në mënyrë ligjore. Gjithashtu, parashtruesi i kërkesës para se të jepte dëshminë në mënyrë vullnetare dhe me vetëdije në praninë e mbrojtësit të tij, hoqi dorë nga e drejta për të mos iu përgjigjur pyetjeve të zyrtarëve kompetentë përgjegjës për hetimin dhe të mos ta shfrytëzoj të drejtën e tij të qëndrojë i heshtur.

67. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës në asnjë fazë të procedurës në Gjykatën Themelore, Gjykatën e Apelit apo Gjykatën Supreme, nuk dëshmonte se ai në polici ishte i ekspozuar ndonjë lloji të presionit për faktin se ishte në paraburgim policor. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu nuk kishte vërejtje ndaj emërimit të mbrojtësit të caktuar sipas detyrës zyrtare, dhe në këtë kuptim "*kishte masa mbrojtëse*" në kuptimin e parimeve të mësipërme.

68. Gjithashtu, nga faktet e rastit rrjedh se parashtruesi i kërkesës para deklaratës të dhënë në polici, ishte konsultuar me mbrojtësin e tij pa praninë e personave të tjerë, për më tepër, parashtruesi gjithashtu

gjatë dhënies së dëshmisë në Gjykatën Themelore kishte kohë të mjaftueshme që në konsultim me mbrojtësin e tij ta përgatit mbrojtjen e tij me të cilën do ta kontestonte deklaratën e dhënë më herët në polici, prej nga rrjedh konkludimi se parashtruesit nuk i është mohuar mundësia për të kundërshtuar përdorimin e deklaratës së tij si provë.

69. Së fundi, siç vuri në dukje Gjykata Themelore, me analizën e kujdesshme të deklaratës së bërë nga parashtruesi i kërkesës në polici dhe deklaratës që ai dha në mbrojtjen e tij në Gjykatën Themelore, u konstatua se ato ndryshonin mjaftueshëm që gjykata të vërteton se ato ndryshonin në masën e mjaftueshme që të vërtetojnë faktin se parashtruesi është i vetëdijshëm për veprën penale dhe se ka vendosur të mbrohet, por që "*[...] Gjykata nuk i fali besimin të akuzuarit Albert Berisha e as tezës mbrojtëse të avokates se tij, të paraqitur në Gjykatën Themelore...*".

70. Në bazë të të gjithave që u thanë më sipër, Gjykata konstaton si të pabazuara pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljet e pretenduara të drejtës për mbrojtje dhe garancitë në lidhje me mbrojtjen kundër vetëinkriminimit.

iii) **Lidhur me mohimin për të dëgjuar dëshmitarët e mbrojtjes**

71. Më tej, në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës "*se i është shkelur parimi i barazisë së palëve në procedurën gjyqësore, sepse gjykatat nuk donin të pranonin dëshmitarët që ai i rekomandoi[...]*", Gjykata i konstaton si të pabazuara, pasi që parashtruesi i kërkesës të njëjtat argumente i bëri në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Supreme, në të cilat mori përgjigje të hollësishme ndaj pretendimeve të tij, për të cilat gjykatat siguruan bazë ligjore.

72. Gjykata nuk mund të mos vërejë se Gjykata Supreme në Aktgjykimin PML. nr. 225/2017, në mënyrë konkrete iu përgjigj parashtruesit dhe pse Gjykata Themelore në Aktgjykimin PKR. nr. 263/15, refuzoi kërkesën për të dëgjuar dy zyrtarë të PK-së, të cilët gjatë procedurës hetimore kishin marrë në pyetje parashtruesin në praninë e mbrojtësit, duke theksuar "*[...] se nuk është i nevojshëm dëgjimi i tyre meqë dëshmitarët e propozuar, si personat zyrtar (policë) kanë intervistuar të dënuarin në rrethanat e veprës penale, kurse sa i përket pohimit të tij se të njëjtit i është premtuar se ai nuk do të përfshihet në aktakuzë del si i pabazuar...*".

iv) **Lidhur me vendimin e arsyetuar**

73. Sa i përket pretendimit të parashtruesit për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë *"[...] sepse aktgjykimet e gjykatave nuk janë logjike, në formën e rregullt, nuk janë të qarta në përmbajtje dhe kanë kontradikta dhe kundërthënie",* Gjykata thekson se, sipas praktikës së përcaktuar të GJEDNJ-së, neni 6 paragrafi 1 i KEDNJ-së i obligon gjykatat të, *intera alia,* arsyetojnë aktgjykimet e tyre. Ky detyrim, megjithatë, nuk mund të kuptohet si detyrim që në aktgjykim të paraqiten të gjitha detajet dhe të jepen përgjigje të gjitha pyetjeve dhe argumenteve të paraqitura (shih: Aktgjykimi i GJEDNJ-së, *Ruiz Torio kundër Spanjës*, të 9 dhjetorit 1994, Seria A, nr. 303-A, paragrafi 29, shih, Vendimin e GJEDNJ-së, *Harutyunyan kundër Armenisë*, të 5 korrikut 2005, Kërkesa nr. 36549/03).

74. Gjykata vëren se, qëndrimi i marrë nga Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut, *vendimet përfundimtare të gjykatave të apelit nuk duhet të kenë arsyetime të hollësishme, por ato që gjykata i konsideron relevante dhe të bazuara* (shih: Vendimin e Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, 8769/07, të 16 korrikut 1981, OI 25).

75. Në thelb, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës përpiqet të justifikojë shkeljen e supozuar, me qëndrimin se *" [...] Gjykata nuk bën një lidhje logjike mes kornizës ligjore dhe gjendjes faktike. Gjykatat në vend që të arsyetojnë substancën e vendimit të tyre, ato parashtrojnë pyetje hipotetike - të cilat janë jorelevante për një vendim gjyqësor".*

76. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesi i kërkesës edhe në Gjykatën Supreme, kryesisht i përsëriti të njëjtat pretendime ankimore, për të cilat gjykata në Aktgjykimin PML. nr. 225/2017, u përgjigj, duke theksuar "*Gjykata vlerëson se dispozitivat e aktgjykimit të shkallës së parë në raport me të akuzuarin janë të qarta dhe përmbajnë të gjitha të dhënat për kohën, vendin, mënyrën e kryerjes së veprës penale dhe të dhëna të tjera që paraqesin elementet qenësore të veprave të kryera penale. Në arsyetimin e të dy aktgjykimeve janë dhëne arsye ligjore për të gjitha pikat e aktgjykimit".*

77. Gjykata këto pretendime të parashtruesit të kërkesës i gjen si të pabazuara dhe ligjërisht të pajustifikuara. Kjo, sepse Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit në aktgjykimet kanë dhënë arsyetime të qarta për vendimet e tyre, si në lidhje me gjendjen e vërtetuar faktike ashtu edhe për zbatimin e të drejtës materiale, dhe të cilat kjo Gjykatë nuk i konsideron arbitrare.

78. Për arsyet e parashtruara më lart, Gjykata konkludon se pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë,

të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese.

v) **Lidhur me të drejtën për liri dhe siguri**

79. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës lidhur me shkeljen e nenit 5 (E drejta për liri dhe siguri) të GJEDNJ-së, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se, për shkak se atij nuk i është siguruar një gjykim i drejtë, paraburgimi i tij nuk bazohet në "dënim nga një gjykatë kompetente" siç kërkohet me nenin 5 të KEDNJ-së. Parashtruesi pretendoi se ai është dënuar me aktgjykimet të cilat janë jokushtetuese, që është arsyeja pse dënimi i tij me burgim është gjithashtu jokushtetues.

80. Së pari, Gjykata rikujton që GJEDNJ thotë se neni 5 paragrafi (1) pika (a) e KEDNJ-së lejon heqjen e lirisë "*pas dënimit nga një gjykatë kompetente*". GJEDNJ thotë se fjala "pas" nuk do të thotë thjesht se 'burgimi' duhet të ndjekë "dënimin" në të njëjtin kohë: përveç kësaj, 'burgimi' duhet të rezultojë nga, 'të ndjekë dhe të varet' ose të ndodhë në bazë të 'dënimit'. " (shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *B. kundër Austrisë*, Kërkesa 11968/86, të 28 marsit 1990, paragrafi 38).

81. Gjykata konstaton se, sipas kornizës legjislative të Kosovës, procedurat që çuan në një dënim penal ndaj parashtruesit të kërkesës janë zhvilluar nga gjykatat e themeluara në mënyrë të rregullt dhe të ligjshme në Kosovë. Për më tepër, nuk ka asgjë në procedurat e aplikuara nga gjykatat e rregullta për të vënë në dyshim "kompetencën" e tyre sipas ligjit ose Kushtetutës.

82. Prandaj, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është dënuar nga një "*gjykatë* kompetente" e cila ka kryer një procedurë gjithëpërfshirëse që ka rezultuar në përcaktimin e përgjegjësisë penale dhe "*nxjerrjen e një aktgjykimi të formës së prerë*", që e ka dënuar parashtruesin e kërkesës me burgim (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *B. kundër Austrisë*, kërkesa nr. 11968/86 e 28 marsit 1990).

83. Gjykata konkludon se dënimi i parashtruesit nga një gjykatë kompetente ishte krejtësisht i mjaftueshëm për të justifikuar ndalimin e tij në përputhje me kërkesat e nenit 5 të KEDNJ-së dhe pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 5 të KEDNJ-së duhet të refuzohen si qartazi të pabazuara në baza kushtetuese.

Përfundim

84. Duke pasur parasysh të gjitha që u thanë më sipër, duke përfshirë rrethanat e rastit, dhe arsyetimin e dhënë në vendimet e kontestuara, Gjykata nuk sheh asnjë arbitraritet në zbatimin e të drejtës materiale në gjykimin penal të parashtruesit të kërkesës. Gjykata gjithashtu, nuk gjen asnjë element që do të tregonte parregullsi ose arbitraritet në marrjen e vendimeve të kontestuara në dëm të parashtruesit.

85. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se asgjë në rastin e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës nuk tregon që procedurat në gjykatat e rregullta ishin të padrejta ose arbitrare në mënyrë që Gjykata Kushtetuese të bindet se thelbi i së drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm është shkelur ose që parashtruesi është privuar nga çdo lloj garancie procedurale, gjë që do të çonte në shkelje së drejtës për gjykim të drejtë sipas nenit 31 të Kushtetutës ose paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së.

86. Gjykata konsideron se është obligim i parashtruesit të kërkesës që t'i mbështesë pretendimet e tij kushtetuese dhe t'i paraqesë provat *prima facie* që tregojnë shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ. Ky vlerësim është në pajtim me juridiksionin e Gjykatës (shih, rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtruesit e kërkesës: *Tafil Qorri dhe Mehdi Syla*, të 5 dhjetorit 2013).

87. Megjithatë, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur pretendimin e tij dhe nuk ka treguar se të drejtat e tij ishin shkelur.

88. Gjykata më tej konsideron se nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt".

89. Në përfundim, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe të drejtën për liri dhe siguri të garantuar me nenin 5 të KEDNJ-së, janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese.

90. Prandaj, kërkesa e parashtruesit, në tërësi, është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) d) të Rregullores së punës.

Kërkesë për masë të përkohshme

91. Gjykata rikujton që parashtruesi gjithashtu kërkoi nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme "*sepse konsideron se po privohet padrejtësisht nga liria, si rezultat i nxjerrjes së vendimeve gjyqësore kundërkushtetuese*".

92. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 27 [Masat e përkohshme] të Ligjit, i cili përcakton:

> *1."Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës mund të vendos përkohësisht masa të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik".*

93. Gjykata i referohet rregullit 55 (4) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

> *"Para se Kolegji shqyrtues të mund të rekomandojë pranimin e kërkesës për masë të përkohshme, ai duhet të konstatojë që:*
>
> *"(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;*
> *(...)*
> *Nëse pala që kërkon masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës".*

94. Gjykata përsërit konkludimin se kërkesa e parashtruesit është shpallur e papranueshme, si qartazi e pabazuar, pasi që parashtruesi nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* për pranueshmërinë e kërkesës.

95. Prandaj, në pajtim me nenin 116.2 të Kushtetutës, nenit 27.1 të Ligjit dhe rregullit 55 (4) të Rregullores së punës, kërkesa për masë të përkohshme refuzohet si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113 (1 dhe 7) të Kushtetutës, nenet 27.1 dhe 47.2 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2) (d), 55 (4) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 23 maj 2018,

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;

III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi	Arta Rama-Hajrizi

KI143/16, Parashtrues: Muharrem Blaku dhe të tjerët, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ASC -11-0012, të 22 shtatorit 2016

KI143/16, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 majit 2018, publikuar më 13 qershor 2018

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, procedurë civile, gjykim i drejtë dhe i paanshëm, qartazi e pabazuar*

Parashtruesit e kërkesës kishin kërkuar nga Gjykata vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështjet që lidhen me AKP-në, me të cilin është vërtetuar aktvendimi i Kolegjit të Specializuar të po asaj gjykate dhe i Gjykatës Komunale në Podujevë, me të cilat ishte vendosur lidhur me kompensimin për një sipërfaqe toke të nacionalizuar në vitin 1960.

Parashtruesit kishin pretenduar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, respektivisht të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm në disa nga elementet kyçe të kësaj të drejte si: barazia e armëve, e drejta për pjesëmarrje në gjykim dhe e drejta në vendim të arsyetuar gjyqësor.

Gjykata shqyrtoi pretendimet e parashtruesit dhe elaboroi gjerësisht parimet e përgjithshme të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm se në rrethanat e rastit konkret, një seancë dëgjimore ishte mbajtur në gjykatën e shkallës e parë. Gjykata Komunale në Podujevë kishte mbajtur seancë të shqyrtimit kryesor ku ishin shqyrtuar faktet e rastit, me pjesëmarrjen e të gjitha palëve të cilat ishin pjesë e kontestit. Parashtruesit e kërkesës kishin mundësinë që në seancën e shqyrtimit kryesor të paraqesin argumentet e tyre dhe provat të cilat gjykata përkatëse i ka çmuar si të pamjaftueshme për t'ua aprovuar padinë. Nga aktgjykimi, gjithashtu shihet se në seancën e shqyrtimit kryesor janë shqyrtuar edhe ekspertizat e ekspertëve të pavarur.
Gjykata i dha përgjigjeje edhe dy pretendimeve tjera lidhur me shkeljen e kësaj të drejte, duke cituar gjerësisht rastet paraprake të kësaj gjykate e të aplikueshme në këtë rast si dhe raste nga GJEDNJ.
Si përfundim, Gjykata konstatoi se parashtruesit nuk kishin arritur të mbështesim mjaftueshëm me prova bindëse pretendimet e tyre, andaj gjeti se kërkesa e tyre duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI143/16

Parashtrues

Muharrem Blaku dhe të tjerët

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ASC -11-0012, të 22 shtatorit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare.

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues të kërkesës janë Muharrem Blaku, Imer Blaku, Murat Blaku dhe Rifat Blaku nga Podujeva (në tekstin e mëtejmë: parashtruesit e kërkesës), të përfaqësuar në Gjykatë nga Muhamet Shala, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Aktgjykimin [ASC-11-0012] e 22 shtatorit 2016 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Apelit i DHPGJS), të cilin parashtruesit e kërkesës e kanë pranuar më 7 tetor 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin parashtruesit e kërkesës pretendojnë se i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ) dhe nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 9 dhjetor 2016, parashtruesit e kërkesës e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 16 janar 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Ivan Čukalović.

7. Më 27 janar 2017, Gjykata i njoftoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës i dërgoi Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së.

8. Më 17 maj 2018, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe me shumicë i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 6 janar 1960, Këshilli Popullor i Komunës së Podujevës, bazuar në Ligjin e asaj kohe për nacionalizimin (në fuqi që nga 26 dhjetori 1958),

përmes Aktvendimit [nr. 7732/59], nacionalizoi, sipas parashtruesve të kërkesës, një pjesë të patundshmërisë së paraardhësit të tyre dhe të njëjtën e regjistroi si pronë shoqërore.

10. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesit e kërkesës kishin paraqitur kërkesë për kthimin e pronave kontestuese në vitin 1993, në Komisionin për Kthimin e Tokave në Komunën e Podujevës dhe në vitin 2002, në Drejtoratin për Çështje Ligjore dhe të Pronave në Komunën e Podujevës.

11. Më 30 mars 2006, parashtruesit e kërkesës parashtruan padi, duke përfshirë një kërkesë për masë të përkohshme, në Kolegjin e Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së) kundër të paditurave Komuna e Podujevës dhe Kooperativa Bujqësore "Përparimi" në Podujevë, duke kërkuar vërtetimin e të drejtave pronësore mbi ngastrat e caktuara kadastrale, me pretendimin se këto prona iu ishin marrë nga pushteti në vitin 1960, përmes një vendimi politik dhe pa kompensim përkatës.

12. Më 18 maj 2006, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së, përmes Aktvendimit [SCC-06-0139], ia referoi lëndën Gjykatës Komunale në Podujevë për të vendosur lidhur me padinë e parashtrueseve të kërkesës. Në Aktvendimin e cekur më lart, theksohej se palët e pakënaqura me vendimin e Gjykatës Komunale, ankesë mund të parashtrojnë në DHPGJS.

13. Më 18 qershor 2008, Gjykata Komunale në Podujevë, përmes Aktgjykimit C. nr. 214/2006, e refuzoi kërkesëpadinë si të pabazuar. Gjykata Komunale, përmes Aktgjykimit e saj, kërkesëpadinë në fjalë, ndër të tjera, e kishte refuzuar duke u bazuar në faktin që paditësit, përkatësisht, parashtruesit e kërkesës, nuk kishin arritur të vërtetojnë që patundshmëria kontestuese ishte në pronësi të paraardhësve të tyre apo që kishte kaluar në pronësi shoqërore pa bazë ligjore, dhe se në fakt, sipas aktgjykimit, kjo patundshmëri ishte regjistruar në pronësi të padituës, përkatësisht, Kooperativës Bujqësore "Përparimi", që nga viti 1952. Për më tepër, Gjykata Komunale kishte arsyetuar që në kontestin konkret, nuk ishin plotësuar kushtet ligjore për fitimin e të drejtës së pronësisë të përcaktuara me nenin 20 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Pronësore.

14. Më 15 shtator 2008, parashtruesit e kërkesës paraqitën ankesë në Kolegjin e Specializuar të DHPGJS-së, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës

materiale, duke kërkuar që Aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe që lënda të kthehet në rigjykim. Paditësit, përkatësisht parashtruesit e kërkesës, kryesisht kishin kontestuar profesionalizimin dhe saktësinë e raportit të ekspertit sa i përket sqarimit të gjendjes para vitit 1952.

15. Më 2 qershor 2009, DHPGJS përfshiu në procedurë Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (në tekstin e mëtejmë: AKM) dhe Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP), si të paditura. Kjo e fundit, më 8 nëntor 2011, paraqiti përgjigjen në ankesën e paditësve, përkatësisht parashtruesve të kërkesës, duke argumentuar se ata nuk kishin asnjë fakt apo dëshmi që kishin në posedim patundshmëritë kontestuese të paktën që nga viti 1952.

16. Më 13 janar 2011, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së nxori Aktgjykimin [SCA-08-0085], përmes të cilit ankesa e parashtruesve të kërkesës hedhet poshtë si e papranueshme, ndërsa vërtetohet Aktgjykimi [C. nr. 214/2006] i 18 qershorit 2008 i Gjykatës Komunale në Podujevë.

17. Më 21 shkurt 2011, parashtruesit e kërkesës paraqitën ankesë në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, duke kërkuar që Aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim.

18. Më 8 prill 2014, parashtruesit e kërkesës gjithashtu parashtruan kërkesë për masë të përkohshme në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së në mënyrë që t'i ndalohet AKP-së tenderimi i patundshmërisë së kontestuar deri në gjykimin përfundimtar të çështjes.

19. Më 22 shtator 2016, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, përmes Aktgjykimit [ASC-11-0012] vendosi që ankesa dhe kërkesa për masë të përkohshme të parashtruara nga parashtruesit e kërkesës të refuzohen si të pabazuara dhe të vërtetohet Aktgjykimi [SCA-08-0085] i 13 janarit 2011 i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, me arsyetim të detajuar.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë që Aktgjykimi i kontestuar, i cili konfirmon Aktgjykimet e DHPGJS-së dhe Gjykatës Komunale në Podujevë, respektivisht, në lidhje me pretendimet pronësore të parashtruesve të kërkesës rreth patundshmërisë të cilën ata pretendojnë se është nacionalizuar përmes vendimit politik dhe pa

kompensim në vitin 1960, është nxjerrë në shkelje të të drejtave të tyre kushtetuese, të garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së dhe nenin 53 të Kushtetutës.

21. Parashtruesit e kërkesës ndërtojnë rastin e tyre mbi pretendimet për shkelje të garancive procedurale të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, duke pretenduar shkelje të parimit të barazisë së armëve sepse ata nuk ishin njoftuar për seancën gjyqësore të mbajtur në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së dhe shkelje të së drejtës në vendim të arsyetuar, sepse Aktgjykimi i kontestuar ka dështuar të arsyetojë pretendimet thelbësore rreth pronësisë dhe mungesës së kompensimit të pronës kontestuese.

22. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu theksojnë se garancitë e KEDNJ-së dhe praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ) janë direkt të aplikueshme në rendin juridik të Republikës së Kosovës, mbi bazën e neneve 22 dhe 53 të Kushtetutës. Në këtë aspekt, në mbështetje të pretendimeve për shkelje të parimit të barazisë së armëve, parashtruesit e kërkesës mbështeten në të gjeturat e rasteve *Grozdanoski kundër IRJ të Maqedonisë* (Aktgjykimin e i GJEDNJ-së i 31 majit 2007) dhe *Gusak kundër Rusisë* (Aktgjykim i GJEDNJ-së i 7 qershorit 2011) dhe rastin e Gjykatës nr. KI108/10 (Parashtrues *Fadil Selmanaj*, Aktgjykim i Gjykatës i 5 dhjetorit 2011), ndërsa në mbështetje të pretendimeve për shkelje të së drejtës për vendim të arsyetuar, mbështeten në të gjeturat e rasteve *Garcia Ruiz kundër Spanjës* (Aktgjykim i GJEDNJ-së i 21 janarit 1999), *Pronina kundër Ukrainës* (Aktgjykim i GJEDNJ-së i 18 korrikut 2006), *Nechiporuk dhe Tonkalo kundër Ukrainës* (Aktgjykim i GJEDNJ-së i 21 korrikut 2011), *Mala kundër Ukrainës* (Aktgjykim i GJEDNJ-së i 7 korrikut 2014), *Hirvisaari kundër Finlandës* (Aktgjykim i GJEDNJ-së i 25 dhjetorit 2001) dhe *Hadjianastassiu kundër Greqisë* (Aktgjykim i GJEDNJ-së i 16 dhjetorit 1992) si dhe rastin e Gjykatës KI22/16 (Parashtrues *Naser Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017).

23. Në fund, parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata që kërkesa e tyre të shpallet e pranueshme; të shpallet i pavlefshëm Aktgjykimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit të DHPGJS; dhe të urdhërohet që çështja e tyre të kthehet në rigjykim.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

24. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i përmbush kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

25. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
>
> *[...]*
>
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

26. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] e Ligjit, të cilët përcaktojnë:

> Neni 47
> [Kërkesa individuale]
>
> *"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik."*
>
> *2. Individi mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*
>
> Neni 48
> [Saktësimi i kërkesës]
>
> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë."*

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej 4 (katër) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...".

27. Lidhur me përmbushjen e këtyre kërkesave, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës janë palë e autorizuar, që kontestojnë një akt të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin [ASC-11-0012] e 22 shtatorit 2016 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, pas shterjes së të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj. Në këtë aspekt, kërkesa e parashtruesve të kërkesës është në përputhje me kriteret e përcaktuara me paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe ato të nenit 47 të Ligjit. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu kanë specifikuar me saktësi të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ, që pretendohet se janë shkelur në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe kanë parashtruar kërkesën brenda afatit prej 4 (katër) muajsh të paraparë në nenin 49 të Ligjit.

28. Përveç kësaj, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara në rregullin 36 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 36 (1) i Rregullores së punës specifikon kushtet sipas të cilave Gjykata mund të shqyrtojë një kërkesë, duke përfshirë kushtin që kërkesa e tillë të mos jetë qartazi e pabazuar. Sipas rregullit 36 (2), një kërkesë është qartazi e pabazuar nëse Gjykata bindet se:

"(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(d) kërkesa nuk arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese.

[...]

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij."

29. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton që parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Aktgjykimi [ASC -11-0012] i 22 shtatorit 2016 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së është nxjerrë në shkelje të të drejtave të tyre të garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së dhe nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, sepse, sipas pretendimit, Aktgjykimi i kontestuar është nxjerrë në a) shkelje të së drejtës së tyre në barazi të armëve, sepse ata nuk ishin njoftuar për seancën gjyqësore të mbajtur në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së dhe b) shkelje të së drejtës së tyre në vendim të arsyetuar gjyqësor.

30. Gjykata fillimisht thekson që pretendimet thelbësore të parashtruesve të kërkesës, që kanë të bëjnë më shkeljet e pretenduara të garancive procedurale të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, barazia e armëve dhe e drejta në vendim të arsyetuar, respektivisht, janë interpretuar detajisht përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, Gjykata në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë. Rrjedhimisht, në interpretimin e pretendimeve për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata do t'i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së.

31. Gjykata gjithashtu vëren se praktika e qëndrueshme e GJEDNJ-së thekson se drejtësia e një procedure vlerësohet në bazë të procedurës si tërësi. (Shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 6 dhjetorit 1988, *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës,* nr. 10590/83, paragrafi 68). Rrjedhimisht, gjatë vlerësimit të meritave të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata do t'i përmbahet këtij parimi. (Shih gjithashtu, rastin e Gjykatës KI104/16, parashtrues *Miodrag Pavić*, Aktgjykim i 4 gushtit 2017, paragrafi 38).

32. Në këtë aspekt, Gjykata se pari do t'i shqyrtojë pretendimet e parashtruesve të kërkesës sa i përket shkeljes së pretenduar të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenit 6 të KEDNJ-së, dhe fillimisht sa i përket pretendimeve lidhur me shkeljen e parimit të barazisë së armëve, për të vazhduar me pretendimet rreth shkeljes të së drejtës për vendim të arsyetuar gjyqësor.

Parimet themelore mbi barazinë e armëve dhe të drejtën në dëgjim publik sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së

33. Në praktikën e saj gjyqësore, GJEDNJ ka përcaktuar se parimi i "*barazisë së armëve*" është një nga elementet kyçe të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor dhe sipas të cilës "*secilës palë në proces t'i ofrohet mundësia e arsyeshme të parashtrojë çështjen e tij – duke përfshirë provat - nën kushtet të cilat në mënyrë të ndjeshme nuk do ta venin në pozitë të pabarabartë në raport me palën kundërshtare*". (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Nideröst-Huber kundër Zvicrës,* të 18 shkurtit 1997, paragrafi 23*;* Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Kress kundër Francës,* të 7 qershorit 2001, paragrafi 72; Aktgjykimin e GJEDNJ-së për rastin *Yvon kundër Francës,* të 24 prillit 2003; dhe Aktgjykimin e GJEDNJ-së në rastin *Gorraiz Lizarraga e të tjerët kundër Spanjës,* të 27 prillit 2004, paragrafi 56).

34. Parimi i barazisë së armëve më tej nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se duhet të përcaktohet një "*ekuilibër i drejtë*" mes palëve. (Shih *Dombo Beheer B. kundër Holandës*, GJEDNJ, Aktgjykim i 27 tetorit 1993, Seria A. nr. 274, paragrafi 33).

35. Në këtë drejtim, e drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t'u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit civil, përkundrazi, duhet që legjislacioni procedural në radhë të parë, dhe më pas gjyqtari gjatë gjykimit, t'u japin mundësi të barabarta palëve, për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre.

36. Mosrespektimi i këtij parimi nuk varet nga të vërtetuarit e padrejtësisë në vlerësimin e fakteve. Shkelja procedurale në vetvete rezulton në shkelje të së drejtës në gjykim të drejtë. (shih, ndër të tjera, *Bulut kundër Austrisë,* GJEDNJ, 22 shkurt 1996, paragrafi 84). Për shembull, sa i përket rasteve që kanë të bëjnë me "*të drejtat dhe detyrimet civile*", do të ketë shkelje të parimit të barazisë së armëve nëse njëra palë mund të merr pjesë në seancë ndërsa tjera jo. (shih *Komanicky kundër Sllovakisë*, GjEDNJ, 4 qershor 2002, paragrafi 45).

37. Në këtë aspekt, Gjykata përkujton se e drejta në proces të rregullt në parim nënkupton të drejtën e palëve për të qenë personalisht të pranishëm në gjykim dhe se kjo e drejtë është e lidhur ngushtë me të drejtën për seancë dëgjimore dhe me të drejtën e përcjelljes së procedurës personalisht. (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, të 23 shkurtit 1994, *Fredin kundër Suedisë*, Aplikacioni nr. 18928/91, faqe

10 e 11; *Ekbatani kundër Suedisë*, nr. 10563/83, GJEDNJ, Aktgjykim i 26 majit 1988, paragrafi 25; dhe rastin e Gjykatës KI104/16, parashtrues *Miodrag Pavić,* Aktgjykim i 4 gushtit 2017, paragrafi 40).

38. Gjykata rithekson se edhe pse nuk përmendet shprehimisht në tekstin e nenit 6 të KEDNJ-së, një seancë dëgjimore përbën një ndër parimet themelore të përcaktuara në nenin 6 (1). (Shih *Jussila kundër Finlandës*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 23 nëntorit 2006 dhe rastin e Gjykatës KI104/16, parashtrues *Miodrag Pavić,* Aktgjykim i 4 gushtit 2017, paragrafi 42).

39. Megjithatë, GJEDNJ-ja përmes praktikës së saj gjyqësore përcakton edhe kufijtë e aplikimit të këtij rregulli dhe përjashtimet përkatëse. Ajo mbanë, që e drejta në seancë dëgjimore, nuk është absolute në procesin e apelimit. Në këtë aspekt, GJEDNJ, pohon se *"në rastet në të cilat ka pasur një seancë dëgjimore në shkallë të parë, ose për të cilën është hequr dorë në atë nivel, nuk ka të drejtë absolute për një seancë dëgjimore në çdo procedurë ankimore që jepet"*. (Shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 12 nëntorit 2002, *Döry kundër Suedisë*, nr. 28394/95, paragrafi 37 dhe rastin e Gjykatës KI104/16, parashtrues *Miodrag Pavić,* Aktgjykim i 4 gushtit 2017, paragrafi 43).

40. Për më tepër, GJEDNJ më tej mbanë që, kur procedura përfshin një ankesë vetëm për çështje të ligjit, përgjithësisht një seancë dëgjimore nuk është e detyrueshme. (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, të 8 dhjetorit 1983, *Axen kundër Gjermanisë*, kërkesa nr. 8273/78, paragrafi 28 dhe rastin e Gjykatës KI104/16, parashtrues *Miodrag Pavić*, Aktgjykim i 4 gushtit 2017, paragrafi 44). Ndërsa, nëse një Gjykate Apeli i kërkohet të vendosë edhe për çështje të faktit, një seancë dëgjimore mund të kërkohet ose jo, në varësi të asaj se a është e nevojshme që të sigurohet një gjykim i drejtë. (Shih rastin e Gjykatës KI104/16, parashtrues *Miodrag Pavić*, Aktgjykim i 4 gushtit 2017, paragrafi 45).

41. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se nëse është e nevojshme një seancë dëgjimore në nivelin e apelit, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së "*varet nga karakteristikat e veçanta të procedimeve përkatëse, duhet të merren parasysh tërësia e procedimeve në rendin e brendshëm juridik dhe e rolit të Gjykatës së Apelit në të"*. (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 26 majit 1988, *Ekbatani kundër Suedisë*, nr. 10563/83, paragrafi 27; Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 2 marsit 1987, *Monnell dhe Morris kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 9562/81; 9818/82, faqe 56; shih gjithashtu rastin e Gjykatës KI104/16, parashtrues *Miodrag Pavić,* Aktgjykim i 4 gushtit 2017, paragrafi 46).

42. Rrjedhimisht, Gjykata përmbledh se e drejta për një seancë dëgjimore në procedurën ankimore nuk është absolute sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së. Në përgjithësi, ajo nuk kërkohet kur procedurat ankimore përfshijnë shqyrtim vetëm të çështjeve të ligjit. Nëse është seanca e nevojshme kur procedurat përfshijnë të dy çështjet, ato të ligjit dhe të fakteve, varet nëse një e tillë është e nevojshme për të siguruar gjykim të drejtë. (Shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës KI104/16, parashtrues *Miodrag Pavić,* Aktgjykim i 4 gushtit 2017, paragrafi 49).

Aplikimi i parimeve të referuara më lart në rrethanat e rastit konkret

43. Gjykata rikujton se në rastin konkret, parashtruesit e kërkesës ishin palë në një rast civil dhe pretenduan se nuk morën pjesë në seancën pranë Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së ku u shqyrtua ankesa e tyre.

44. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se seanca dëgjimore nuk ishte mbajtur pranë Kolegjit të Apelit, sepse Kolegji përkatës kishte vendosur mbi bazën e autorizimeve të dala nga Ligji për DHPGJS që të mos mbaj seancë dëgjimore. Ky Kolegj kishte vendosur mbi bazën e ankesës dhe përgjegjës në ankesë, që të vërtetohet Aktgjykimi [SCA-08-0085] i 13 janarit 2011 i DHPGJS-së.

45. Përpos pohimit se nuk morën pjesë në seancën e Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, parashtruesit e kërkesës nuk paraqitën asnjë argument tjetër shtesë i cili dallon nga ato që i kishin paraqitur në instancat tjera gjyqësore dhe nuk paraqitën fakte që në shqyrtimin e bërë nga Kolegj i Apelit ishte trajtuar ndonjë provë apo fakt të cilin ata nuk e posedonin apo i cili i vinte në pozitë "*ndjeshëm të pabarabartë*" me palët tjera në procedurë.

46. Rrjedhimisht, në kuptimin e parimit të barazisë së armëve që parashtruesit e kërkesës pretendojnë të jetë shkelur, Gjykata vëren, që parashtruesit e kërkesës nuk paraqesin asnjë fakt, që ata do të mund të ishin vënë në pozitë më pak të favorshme në raport me palën kundërshtare. Asnjëra palë nuk kishte marrë pjesë në seancën e shqyrtimit të Kolegjit të Apelit, sepse një seancë dëgjimore nuk ishte mbajtur fare. Në këtë aspekt, Gjykata vëren, që rasti i parashtruesve të kërkesës, dallon nga rasti KI108/10, të cilit ata i referohen. Kjo, sepse në këtë të fundit, parashtruesi i kërkesës nuk kishte qenë fare në dijeni për procedurën në Gjykatën Supreme, nuk kishte pasur qasje në padinë e komunës përkatëse drejtuar Gjykatës Supreme, nuk kishte pasur asnjë mundësi të përgjigjet në padi, dhe për më tepër, nuk ishte njoftuar për Aktgjykimin e Gjykatës Supreme.

47. Prandaj, rasti KI108/10 dallon përmbajtësisht nga rrethanat e rastit konkret, sepse, përpos që nuk ishte mbajtur seancë dëgjimore, që është pretendimi kryesor i parashtruesve të kërkesës, këta të fundit nuk argumentojnë në asnjë mënyrë që ishin vendosur në pozitë më pak të favorshme në raport me palën kundërshtare sa i përket shkresave të lëndës mbi bazën e të cilave Kolegji i Apelit kishte vendosur.

48. Më tej, Gjykata do të shqyrtojë nëse mungesa e seancës dëgjimore në rrethanat e rastit konkret rezulton në shkelje të së drejtave të parashtruesve të kërkesës të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

49. Në këtë aspekt, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së të referuar më lart, për të theksuar edhe një herë, që e drejta në seancë dëgjimore në procedurën ankimore nuk është absolute. Në parim, në rast se një e tillë është mbajtur në gjykatën e shkallës së parë, në procedurën e apelimit, një e tillë nuk kërkohet detyrimisht.

50. Gjykata vëren, se në rrethanat e rastit konkret, një seancë dëgjimore ishte mbajtur në gjykatën e shkallës e parë. Gjykata Komunale në Podujevë kishte mbajtur seancë të shqyrtimit kryesor ku ishin shqyrtuar faktet e rastit me pjesëmarrjen e të gjitha palëve të cilat ishin pjesë e kontestit. Parashtruesit e kërkesës kishin mundësinë që në seancën e shqyrtimit kryesor të paraqesin argumentet e tyre dhe provat të cilat gjykata përkatëse i çmoj si të pamjaftueshme për t'ua aprovuar padinë. Nga Aktgjykimi gjithashtu shihet se në seancën e shqyrtimit kryesor janë shqyrtuar edhe ekspertizat e ekspertëve të pavarur.

51. Për më tepër që rrethanat e rastit konkret gjithashtu dallojnë në mënyrë përmbajtjësore nga rrethanat e rasteve *Grozdanoski kundër IRJ të Maqedonisë dhe Gusak kundër Rusisë* të GJEDNJ-së, të cilëve parashtruesit e kërkesës iu referohen. Në rastin e parë, kërkesën për revizion e kishte paraqitur pala kundërshtare, ndërsa kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë prokurori i shtetit, ndërkaq që Gjykata Supreme përkatëse për asnjërën nuk e kishte njoftuar parashtruesin duke mos i dhënë asnjë mundësi as t'i komentojë e kundërshtojë faktet dhe argumentet e paraqitura. Kjo për dallim me rastin e parashtruesve të kërkesës, ku ata vet paraqitën ankesë në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së dhe vendimi i këtij Kolegji u nxor mbi bazën e ankimit të tyre dhe provave të ofruara në dosjen e lëndës. Ndërsa, në rastin e dytë, GJEDNJ konstatoi shkelje duke e arsyetuar me faktin që

parashtruesit përkatës gjykata nuk i kishte lënë kohë të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e tij.

52. Bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh karakteristikat e veçanta të rastit, pretendimet e ngritura nga parashtruesit e kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ata, Gjykata mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, nuk gjen të jetë cenuar parimi i barazisë së armëve apo e drejta në seancë dëgjimore si elemente përbërëse të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

Parimet themelore mbi të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së

53. Gjykata thekson se e drejta për një proces të rregullt gjyqësor përfshin të drejtën për një vendim të arsyetuar. GJEDNJ ka përsëritur se, sipas jurisprudencës së saj, e cila pasqyron një parim të lidhur me administrimin e duhur të drejtësisë, gjykimet e gjykatave dhe tribunalet duhet të tregojnë në mënyrë adekuate arsyet në të cilat ato janë bazuar. (Shih *Tatishvili kundër Rusisë*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 22 shkurtit 2007, paragrafi 58).

54. GJEDNJ gjithashtu ka theksuar se, edhe pse autoritetet gëzojnë liri të konsiderueshme në zgjedhjen e mjeteve të përshtatshme për të siguruar që sistemet e tyre gjyqësore të jenë në përputhje me kërkesat e nenit 6 (1) të Konventës, gjykatat e tyre duhet "*të tregojnë me qartësi të mjaftueshme arsyet në të cilat ata bazuan vendimin e tyre"*. (Shih *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 16 dhjetorit 1992, paragrafi 33; shih gjithashtu rastin e Gjykatës KI97/16, parashtrues "*IKK Classic",* Aktgjykim i 9 janarit 2018, paragrafi 45).

55. Funksioni i një vendimi të arsyetuar, sipas GJEDNJ-së, është t'u tregojë palëve se janë dëgjuar. Për më tepër, një vendim i arsyetuar i jep një pale mundësinë për të apeluar kundër saj, si dhe mundësinë e shqyrtimit të vendimit nga një organ i apelit. Vetëm duke dhënë një vendim të arsyetuar se mund të ketë shqyrtim publik të administrimit të drejtësisë. (Shih *Hirvisaari kundër Finlandës*, nr 49684/99, 27 shtator 2001, paragrafi 30;*Tatishvili kundër Rusisë*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 22 shkurtit 2007, paragrafi 58; rastin e Gjykatës KI97/16, parashtrues "*IKK Classic",* Aktgjykim i 9 janarit 2018, paragrafi 46; dhe KI22/16, parashtrues *Naser Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017, paragrafi 40).

56. Megjithatë, edhe pse GJEDNJ pohon se neni 6 i KEDNJ-së obligon gjykatat të japin arsyet për vendimet e tyre, ajo gjithashtu ka konstatuar se kjo nuk mund të kuptohet si kërkesë për një përgjigje të hollësishme në çdo argument. (Shih rastet e GJEDNJ-së *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994, paragrafi 61;*Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, nr. 134/1996/753/952, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998, paragrafi 42; dhe rastin e Gjykatës KI97/16, parashtrues "*IKK Classic",* Aktgjykim i 9 janarit 2018, paragrafi 47).

57. Shkalla në të cilën zbatohet obligimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit. (Shih rastet e GJEDNJ-së *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 29;*Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, *Ibidem,* paragrafi 42; gjithashtu, rastin e Gjykatës KI97/16, parashtrues "*IKK Classic"*, Aktgjykim i 9 janarit 2018, paragrafi 48; dhe KI22/16, parashtrues *Naser Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017, paragrafi 44).

58. Për shembull, në hedhjen poshtë të një ankese, një gjykatë apeli mundet në parim, thjesht të miratojë arsyet për nxjerrjen e vendimit të gjykatës më të ulët. (Shih rastet e GEJDNJ-së *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 26 dhe *Helle kundër Finlandës*, Aktgjykimi i 19 dhjetorit 1997, paragrafët 59 e 60). Autoriteti ose gjykata më e ulët duhet të japin arsye të tilla që t'u mundësojnë palëve që të shfrytëzojnë në mënyrë efektive çdo të drejtë ekzistuese të ankesës. (Shih rastin e GJEDNJ-së *Hirvisaari kundër Finlandës*, kërkesa 49684/99, Aktgjykimi i 27 shtatorit 2001, paragrafi 30; dhe rastin e Gjykatës KI97/16, parashtrues "*IKK Classic",* Aktgjykim i 9 janarit 2018, paragrafi 49).

59. Megjithatë, GJEDNJ gjithashtu ka vërejtur se, edhe pse gjykatat kanë liri të caktuar të vlerësimit në zgjedhjen e argumenteve në një rast të veçantë dhe në pranimin e provave në mbështetje të parashtresave të palëve, një gjykatë vendore është e detyruar të justifikojë aktivitetet duke dhënë arsyet për vendimet e saj. (Rasti i GJEDNJ-së shih *Suominen kundër Finlandës*, kërkesa nr. 37007/97, i 1 korrikut 2003, paragrafi 36; dhe rastin e Gjykatës KI97/16, parashtrues "*IKK Classic",* Aktgjykim i 9 janarit 2018, paragrafi 50).

60. Prandaj, përderisa nuk është e nevojshme që gjykata të merret me çdo pikë të ngritur në argument (shih gjithashtu *Van de Hurk kundër Holandës*, *Ibidem*, paragrafi 61), argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës duhet të adresohen. (Shih rastet e GJEDNJ-së *Buzescu kundër Rumanisë,* kërkesa nr. 61302/00, Aktgjykimi i 24

majit 2005, paragrafi 63; *Pronina kundër Ukrainës,* Aktgjykim i 18 korrikut 2006, paragrafi 25). Po ashtu, dhënia e një arsyeje për një vendim që nuk është mirë e bazuar në ligj, nuk do të përmbushë kriteret e nenit 6 të Konventës. (Shih rastin e Gjykatës KI97/16, parashtrues "*IKK Classic",* Aktgjykim i 9 janarit 2018, paragrafi 51).

61. Në fund, Gjykata gjithashtu i referohet praktikës së saj gjyqësore ku ajo konsideron që arsyetimi i vendimit duhet të theksojë raportin ndërmjet konstatimeve të meritës dhe reflektimeve kur të merren parasysh provat e propozuara nga njëra anë, dhe konkluzionet ligjore të gjykatës nga ana tjetër. Aktgjykimi i Gjykatës do të shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk përmban fakte të vërtetuara, dispozitat ligjore përkatëse dhe marrëdhënien logjike midis tyre. (Shih rastet KI72/12, *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri,* Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012, paragrafi 61, dhe KI97/16, parashtrues *"IKK Classic",* Aktgjykim i 9 janarit 2018, paragrafi 52).

Aplikimi i parimeve të referuara më lart në rrethanat e rastit konkret

62. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Aktgjykimi [ASC -11-0012] i 22 shtatorit 2016 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS nuk ishte i arsyetuar sepse kishte dështuar të vërtetojë faktet kyçe rreth pronësisë së parashtruesve të kërkesës mbi patundshmëritë kontestuese dhe mungesën e kompensimit të së njëjtës në përputhje me çmimin e tregut apo kundërvlerës përkatëse.

63. Në këtë aspekt, Gjykata së pari vëren, që vendimet e gjykatave të rregullta në fakt, refuzojnë pretendimet e parashtruesit të kërkesës, mbi mungesën e fakteve për të vërtetuar pronësinë fillimisht, mbi vërtetimin e të cilës do të varej çështja e shqyrtimit të fakteve rreth mungesës apo kompensimit përkatës.

64. Në adresimin e pretendimeve rreth vërtetimit të pronësisë, Kolegji i Apelit, në Aktgjykimin përkatës, ndër të tjera, kishte arsyetuar:

> *"Se i vetmi dokument të cilit ankuesit i referohen në ankesën e tyre është i ashtuquajturi "posedovna prijave" (raporti/ aplikacioni i posedimit), i cili emërton Bajramoviq Sherif Latifa si posedues i disa ngastrave kadastrale. Ky dokument i është dorëzuar gjykatës bashkë me padi. Megjithatë, ngastra e kontestuar nuk është cekur në këtë dokument dhe ankuesit nuk e kanë specifikuar ndonjërën prej ngastrave nga ai raport aplikacion që do të përputhej me ngastrën e kontestuar".*

65. Kolegji i Apelit, më tej, ka arsyetuar:

> *"Duke u bazuar vetëm në këtë dokument, paditësit nuk kanë qenë në gjendje që të dëshmojnë të drejtën pronësore të paraardhësit të tyre dhe shpronësimin e kundërligjshëm, ashtu siç është cekur nga Gjykata Komunale në Podujevë dhe vërtetuar nga trupi gjykues i DHPGJS-së. Dokumenti të cilin e kanë dorëzuar më 8 prill 2014 bashkë me kërkesën për masë të përkohshme (vendimin e komisionit popullor të Komunës së Podujevës, numër 7322/59 të 25 janarit 1960 nuk ndërlidhet me palët dhe paluajtshmërinë e kontestuar për rastin në fjalë. Prandaj nuk është me vend që të mbështetet padia."*

66. Për më tepër, Gjykata vëren se përtej pretendimeve për vlerësim të gabuar të fakteve, parashtruesit e kërkesës në rastin konkret, nuk specifikojnë më tej në kërkesën e tyre se cilat argumente kyçe i kishin ngritur në ankesën e tyre, dhe cilat prej tyre nuk ishin adresuar nga Kolegji i Apelit përmes Aktgjykimit të kontestuar.

67. Gjykata rithekson, duke iu referuar parimeve të GJEDNJ-së mbi të drejtën për një vendim të arsyetuar, siç janë elaboruar më lart, se në parim, shkalla në të cilën zbatohet obligimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit. Prandaj, përderisa nuk është e nevojshme që gjykata të merret me çdo pikë të ngritur në argument, ato thelbësore të parashtruesve të kërkesës duhet të adresohen.

68. Megjithatë, Gjykata në rastin konkret, konsideron se argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës ishin adresuar dhe arsyetuar nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së. Aktgjykimi përkatës kishte sqaruar në mënyrë të detajuar se pse ankesa është e pabazuar dhe se cilat fakte ishin të rëndësishme e cilat jo për të arritur deri tek përfundimi sikur në Aktgjykimin e kontestuar, duke përcaktuar qartazi bazën juridike dhe ligjin në fuqi mbi të cilën e mbështetë konkluzionin përfundimtar.

69. Për më tepër që, sa i përket pretendimeve për vlerësim të gabuar të fakteve, Gjykata rithekson se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta me rastin e vlerësimit të provave ose aplikimit të ligjit (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "shkallës së katërt", që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në

të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih, rasti *García Ruiz kundër Spanjës,* GJEDNJ nr. 30544/96, i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe shih, gjithashtu rastet: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011; dhe KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 41).

70. Në fund, parashtruesit e kërkesës i referohen një numër rastesh të praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe GJEDNJ-së, në ndërtimin e argumenteve që mbështesin pretendimet për shkelje të së drejtës në vendim të arsyetuar. Ndër të tjera, parashtruesit e kërkesës i referohen rastit KI22/16, i cili në fakt nuk është i aplikueshëm në këtë rast sepse dallimet edhe në pretendimet e ngritura edhe në vlerësimin e gjykatave të rregullta në të dyja rastet janë të ndryshme, dhe kjo sepse argumenti thelbësor në rastin e referuar i ngritur nga parashtruesi i kërkesës nuk ishte adresuar fare nga Gjykata Supreme.

71. Për më tepër, Gjykata vëren së të gjitha pretendimet e parashtruesve të kërkesës për aplikim të rasteve specifike të GJEDNJ-së, përfshirë *Garcia Ruiz kundër Spanjës, Pronina kundër Ukrainës, Nechiporuk dhe Tonkalo kundër Ukrainës, Mala kundër Ukrainës, Hirvisaari kundër Finlandës dhe Hadjianastassiu kundër Greqisë*, janë të përfshira në referencat që shpjegojnë parimet themelore të GJEDNJ-së sa i përket të drejtës në vendim të arsyetuar, por se asnjëri nga rastet e referuara nuk përkojnë me rrethanat e rastit konkret, dhe se vetëm përmendja e tyre nga ana e parashtruesve të kërkesës, pa specifikuar elementet qenësore të ngjashme me rastin e tyre, nuk i bënë ato automatikisht e të aplikueshme në këtë rast.

72. Bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh karakteristikat e veçanta të rastit, pretendimet e ngritura nga parashtruesit e kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ata, Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së nuk gjen të jetë shkelur e drejta në vendim të arsyetuar gjyqësor si një nga elementet përbërëse të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

73. Për më tepër, gjatë shqyrtimit të pretendimeve për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Gjykata vlerëson se procesi gjyqësor në tërësinë e tij ka qenë i drejtë dhe i paanshëm, ashtu sikur

edhe kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

74. Në fund, parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretendojnë shkelje të paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës.

75. Sa i përket pretendimit të parë, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës nenin 21.4 të Kushtetutës vetëm e kanë përmendur dhe cituar përmbajtjen e tij pa dhënë shpjegime se si dhe në cilat rrethana të rastit kjo dispozitë është cenuar. Për më tepër, kjo dispozitë kushtetuese në substancën e saj në mënyrë specifike iu referohet "personave juridikë", duke përcaktuar se të drejtat themelore vlejnë edhe për ata për aq sa janë të zbatueshme, duke nënkuptuar mundësinë që edhe personave juridikë mund t'u cenohen të drejtat dhe liritë themelore kur ato gjejnë zbatim në atë rast konkret. Në rastin konkret, parashtruesit e kërkesës kanë paraqitur një kërkesë individuale dhe në këtë kontekst, Gjykata nuk gjen se ka ndonjë lidhshmëri në mes të kërkesës së tyre dhe dispozitës përkatëse kushtetuese.

76. Sa i përket pretendimit të dytë, Gjykata vëren se neni 53 i Kushtetutës përcakton shprehimisht se të drejtat dhe liritë themelore që garantohen me Kushtetutë duhet të interpretohen në harmoni me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. Ky obligim kushtetues para së gjithash i adresohet institucioneve që vendosin lidhur me të drejtat dhe liritë themelore, duke përfshirë këtu edhe Gjykatën e cila këtë obligim e përmbushë tërësisht në secilin rast kur vendos për kërkesa individuale që kanë objekt shqyrtimi shkeljen eventuale të të drejtave themelore. (Shih rastin 74/17, parashtrues *Lorenc Kolgjeraj,* Aktvendim për papranueshmëri i 5 dhjetorit 2017, paragrafi 28). Ndërsa, rastet e cituara nga GJEDNJ për të cilat parashtruesit e kërkesës kanë pretenduar se janë të aplikueshme me rastin e tyre, Gjykata i ka trajtuar specifikisht në raport me pretendimet e tyre për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në tërësinë e këtij vendimi.

77. Si rezultat, dhe duke u bazuar në elaborimin e mësipërm, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk i kanë mbështetur pretendimet se procedurat përkatëse të ndjekura nga gjykatat e rregullta në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare, dhe se me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ. (Shih*, mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë,* nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

78. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesve nuk i përmbushë kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Rregulloren e punës, sepse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, duke marrë parasysh që faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese dhe që parashtruesi i kërkesës nuk dëshmon mjaftueshëm pretendimin e tij për shkelje kushtetuese.

79. Si përfundim, Gjykata konkludon se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe, në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës, ajo duhet të deklarohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (d) dhe 2(d)të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 17 maj 2018, me shumicë

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Gresa Caka- Nimani	Arta Rama-Hajrizi

KI76/18, Parashtrues: Pjetër Boçi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. nr. 279/2017, të 26 marsit 2018, dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN. nr. 462/2018, të 28 majit 2018

KI76/18, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 nëntorit 2018, publikuar më 19 dhjetor 2018

Fjalët kyç: *Kërkesë individuale, person zyrtar, mosshterje e mjeteve juridike, kërkesë qartazi e pabazuar, ratione materiae*

Gjykata Themelore Prizren, nëpërmjet Aktgjykimit P. nr. 206/2015, shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për kryerjen e veprës penale sipas nenit 343 [Marrja e ryshfetit] të Kodit Penal, dhe e dënoi me dënim me burg prej 7 (shtatë) muajsh, ndërsa e liroi nga akuza për veprën penale të paraparë në nenin 345 [Ushtrimi i Ndikimit] të Kodit Penal të Kosovë. Parashtruesi kishte paraqitur ankesë ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, e cila ishte refuzuar si e pabazuar nga Gjykata e Apelit. Parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit. Gjykata Supreme, nëpërmjet Aktgjykimit (P. nr. 279/2015), refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruesit të kërkesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore (PKR. nr. 540/2011) dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit (PAKR. nr. 70/17).

Parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur kërkesë për rishikimin e procedurës penale në Gjykatën Themelore në lidhje me rastin e tij, duke prezantuar prova shtesë.# Gjykata Themelore, nëpërmjet Aktvendimit PKRS. nr. 157/2017 refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për rishikimin e procedurës penale. Ky aktvendim u konfirmua edhe nga Gjykata e Apelit.

Parashtruesi i kërkesës para Gjykatës Kushtetuese pretendon shkelje të drejtave të tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

Gjykata sqaroi se pretendimet e parashtruesit ndërlidheshin me tri procedura të ndryshme që ishin zhvilluar në lidhje me rastin e tij: a) procedura për hedhjen e aktakuzës; b) procedura penale me të cilën parashtruesi i kërkesës është shpallur fajtor për veprën penale marrje ryshfeti, dhe c) procedura për rishikimin e procedurës penale.
Pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruesit, Gjykata, në pajtim me nenin 48 të Ligjit të Gjykatës Kushtetuese dhe me rregullin 39 (1) (b), (2) dhe (3) (b) të Rregullores së Punës konstatoi se kërkesa e parashtruesit:

(i) në lidhje me pretendimin se në rastin e tij janë pushuar hetimet dhe rrjedhimisht është ngritur aktakuzë pa bazë ligjore, nuk janë shterur mjetet juridike të parapara me ligj;

(ii) në lidhje me pretendimin e parashtruesit se në procedurë penale nuk janë aplikuar drejt dispozitat në lidhje me definicionin e "personin zyrtar", parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë; dhe,

(iii) sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës lidhur me rishikimin e procedurës penale kërkesa nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën.

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI76/18

Parashtrues

Pjetër Boçi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. nr. 279/2017, të 26 marsit 2018, dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN. nr. 462/2018, të 28 majit 2018

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Pjetër Boçi nga Shëngjini, Republika e Shqipërisë, me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston:

   a) Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme), PML. nr. 279/2017, të 26 marsit 2018, me të cilin i ishte refuzuar si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR. nr. 70/17 (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, P. nr. 206/2015 (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore); dhe

   b) Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, PN. nr. 462/2018, të 28 majit 2018 me të cilin i ishte refuzuar ankesa ndaj Aktvendimit të Gjykatës Themelore PKRS. nr. 157/2017, për refuzimin e kërkesës për rishikimin e procedurës penale.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara, me të cilat parashtruesi i kërkesës pretendon që i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ), si dhe nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

5. Më 31 maj 2018, Gjykata Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), miratoi në seancën administrative plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave juridike të rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatë

6. Më 4 qershor 2018, Gjykata pranoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës.

7. Më 8 qershor 2018, parashtruesi i kërkesës plotësoi kërkesën me dokumente shtesë.

8. Më 16 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Snezhana Botusharova dhe Almiro Rodrigues. Më 26 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.

9. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.

10. Më 10 gusht 2018, parashtruesi i kërkesës plotësoi kërkesën me dokumente shtesë.

11. Më 16 gusht 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.

12. Më 14 shtator 2018, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoi që të dorëzojë në Gjykatë, autorizimin që dëshmon se përfaqësuesi i cekur në kërkesë është i autorizuar që të përfaqësojë parashtruesin para Gjykatës, dhe vendimet gjyqësore përkitazi me kërkesën e tij për hedhje të aktakuzës të paraqitur në Gjykatën Themelore.

13. Në të njëjtën ditë, Gjykata njoftoi Gjykatën Supreme dhe Gjykatën e Apelit për regjistrimin e kërkesës.

14. Më 20 shtator 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë dokumentet e kërkuara nga Gjykata dhe e njoftoi Gjykatën se *"tani në*

këtë proces nuk kam avokat". Parashtruesi gjithashtu e njoftoi Gjykatën për adresën e tij të re.

15. Më 22 nëntor 2018, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

16. Në të njëjtën ditë, parashtruesi i kërkesës e njoftoi Gjykatën se nuk gjendet më në adresën e mëparshme dhe për këtë paraqiti një adresë të re.

Përmbledhja e fakteve

17. Më 21 maj 2011, Prokuroria e Qarkut në Prizren (në tekstin e mëtejmë: Prokuroria e Qarkut), me Aktvendimin HP. nr. 119/2011, kishte filluar hetimet kundër parashtruesit të kërkesës dhe disa personave të tjerë, nën dyshimin e arsyeshëm se parashtruesi gjatë kohës sa ai ishte duke punuar si instruktor në autoshkollën "Geni" në Prizren, kishte kryer veprën penale nga nenet 343 [Marrja e Ryshfetit], 332 [Falsifikimi i Dokumenteve], 274 [Krimi i Organizuar] dhe 23 [Bashkëkryerja] të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPK).

18. Më 12 shtator 2011, Prokurori i Qarkut, me Aktvendim HP. nr. 119/2011, pushoi hetimet ndaj parashtruesit në lidhje me veprat penale, sipas nenit 274 [Krimi i Organizuar] dhe 23 [Bashkëkryerja], me arsyetimin se nuk ekziston dyshimi i arsyeshëm që parashtruesi i kërkesës ka kryer veprat e tilla penale.

19. Më 17 mars 2014, Prokuroria Themelore në Prizren-Departamenti për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejmë: Prokuroria Themelore), me Aktakuzën PP. nr. 3409/11-II, akuzoi parashtruesin e kërkesës, nën dyshimin e bazuar, se ai kishte kryer veprën penale nga nenet 343 [Marrja e Ryshfetit] dhe 345 [Ushtrimi i Ndikimit] të KPK-së. Përkatësisht, Prokuroria Themelore akuzoi parashtruesin se në cilësinë e tij si instruktor në autoshkollën "Geni" kishte pranuar të holla nga kandidatët për patentë shofer, duke ju premtuar kalimin e testeve përmes ekzaminuesit të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit.

20. Më 27 maj 2014, parashtruesi i kërkesës paraqiti në Gjykatën Themelore kërkesë për hedhjen e Aktakuzës së Prokurorisë Themelore, PP. nr. 3409/11-II, ndër të tjera, duke arsyetuar se, në lidhje me të njëjtat vepra penale më 12 shtator 2011, ishin pushuar

hetimet kundër parashtruesit të kërkesës me Aktvendimin HP. nr. 119/2011. Andaj, sipas tij këto hetime nuk mund të rihapeshin.

21. Më 16 korrik 2014, Gjykata Themelore në Prizren (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore), me Aktvendimin P. nr. 66/2014, refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për hedhje të aktakuzës, duke konstatuar se nuk bëhet fjalë për çështje të gjykuar ndaj parashtruesit sepse hetimet ishin mbyllur vetëm për veprën penale krim i organizuar të kryer në bashkëkryerje dhe jo për veprat penale marrje e ryshfetit dhe ushtrim i ndikimit.

22. Më 7 dhjetor 2016, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit P. nr. 206/2015, shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për kryerjen e veprës penale, sipas nenit 343 [Marrja e Ryshfetit] të KPK-së, dhe e dënoi me dënim me burg prej 7 (shtatë) muajve, ndërsa e liroi nga akuza për veprën penale të paraparë në nenin 345 [Ushtrimi i Ndikimit] të KPK-së.

23. Parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore (P. nr. 206/2015), për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, konstatimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe vendimit mbi sanksionin penal.

24. Ankesë parashtroi edhe Prokuroria Themelore, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe në lidhje me sanksionin penal për veprën penale për të cilën parashtruesi ishte gjetur fajtor.

25. Më 15 shtator 2017, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit (PAKR. nr. 70/17), refuzoi ankesat e Prokurorisë Themelore dhe të parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Themelore (P. nr. 206/2015).

26. Ndërsa, Gjykata e Apelit, sipas detyrës zyrtare ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, përkitazi me veprën penale - ushtrimi i ndikimit, ashtu që refuzoi akuzën pasi kishte arritur parashkrimi absolut.

27. Parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore (P. nr. 206/2015) dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit (PAKR. nr. 70/17), për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, duke pretenduar, ndër

të tjera, se në bazë të dispozitave të Kodit penal ai nuk e kishte statusin e "personit zyrtar" ashtu si kishin vendosur Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit. Prokuroi i Shtetit me parashtresën KMLP. II. nr. 194/2017, paraqiti përgjigje në kërkesën e parashtruesit duke propozuar që ajo të refuzohet si e pabazuar.

28. Më 26 mars 2018, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit (P. nr. 279/2015), refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruesit të kërkesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore (PKR. nr. 540/2011) dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit (PAKR. nr. 70/17).

29. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës kishe paraqitur kërkesë për rishikimin e procedurës penale në Gjykatën Themelore në lidhje me rastin e tij, duke prezantuar prova shtesë.

30. Më 10 maj 2018, Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit PKRS. nr. 157/2017, refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për rishikimin e procedurës penale.

31. Parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë ndaj Aktvendimit të Gjykatës Themelore (PKRS. nr. 157/2017), për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe dispozitave të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

32. Më 28 maj 2018, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit (PN. nr. 462/2018), refuzoi ankesën e parashtruesit kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore (PKRS. nr. 157/2017), si të pabazuar, pasi konsideroi se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për rishikimin e procedurës penale.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

33. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së si dhe shkelje të dispozitave të KPK-së.

34. Parashtruesi i kërkesës thekson se, Prokuroria pasi i pushon hetimet me aktvendim të formës së prerë (PP. nr. 119/2011 të 12 shtatorit 2011), më 17 mars 2014, ngriti aktakuzë *"për të njëjtat vepra, për të njëjtat fakte pa asnjë fakt a provë të re, pra pa asnjë bazë ligjore"*.

35. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Themelore *"në procedurën [ndaj tij] shkel nenin 102 të Kushtetutës",* duke cituar këtë nen të Kushtetutës në kërkesën e tij.

36. Parashtruesi me tej pretendon se gjykatat e rregullta pa bazë ligjore e kanë cilësuar si "person zyrtar", duke shtuar se *"Gjykata Supreme është gjykata që ka pasur edhe një dokument zyrtar të lëshuar [...] me të cilin vërtetohet pastër se vendimi i formës së prerë [në lidhje me dënimin e tij] është i kundërligjshëm dhe se Gjykata Supreme ka për obligim që të komentojë dhe interpretojë institutet ligjore, mbi bazën e të cilave pa të drejtë jam trajtuar si person zyrtar".*

37. Në lidhje me procedurën për rishikimin e procedurës penale, parashtruesi pretendon se *"Gjykata Themelore nuk ka shqyrtuar dokumentin e lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës me kërkesën time, dhe nuk i qaset realisht bazës dhe të drejtës për lejimin e rishikimit të procedurës për t'i dhënë rast vërtetimit të drejtë e të ligjshëm të kësaj çështje".*

38. Ai po ashtu pohon se njëra nga gjyqtaret që ka marrë pjesë në Kolegjin e Gjykatës së Apelit në lidhje me kërkesën për rishikimin e procedurës, po ashtu ka marrë pjesë në Kolegjin e Gjykatës së Apelit gjatë procedurës për shpalljen fajtor të parashtruesit të kërkesës, andaj ai shtron pyetjen se *"se si mund të pres unë që kjo gjyqtare të pranoj provën e re?".*

39. Parashtruesi në fund kërkon nga Gjykata, që të konstatojë se gjykatat e rregullta kanë shkelur ligjin penal dhe atë të procedurës penale dhe të drejtat e tij të parashikuara me Kushtetutë, dhe kërkon që lënda e tij të kthehet në rigjykim.

Pranueshmëria e kërkesës

40. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

41. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili parasheh që:

> "*1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

42. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 49 [Afatet] të Ligjit, i cili parasheh:

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej 4 (katër) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. [...]"

43. Gjykata i referohet edhe nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili parasheh:

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".

44. Gjykata po ashtu i referohet paragrafëve (1) (b), (2) dhe 3 (b) të rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, që parashohin:

"(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:
[...]
(b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar,
[...]

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

(3) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse ndonjë nga kushtet në vijim është i pranishëm:
[...]
(b) kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën;
[...]".

45. Gjykata rikujton se në lidhje me rastin e parashtruesit të kërkesës janë zhvilluar tri procedura:

a) procedura për hedhjen e aktakuzës;

b) procedura penale me të cilën parashtruesi i kërkesës është shpallur fajtor për veprën penale marrje ryshfeti, dhe

c) procedurën për rishikimin e procedurës penale.

46. Prandaj, Gjykata gjatë vlerësimit të pranueshmërisë, këto tri procedurat do t'i trajtojë ndaras.

a) Procedura për hedhjen e aktakuzës

47. Në lidhje me këtë procedurë, parashtruesi i kërkesës pretendon se atij i është ngritur aktakuzë për të njëjtat vepra penale për të cilën janë pushuar hetimet me aktvendim të formës së prerë të Prokurorisë, PP. nr. 119/2011, të 12 shtatorit 2011.

48. Gjykata vëren se ky pretendim i parashtruesit ka qenë objekt shqyrtimi nga Gjykata Themelore pas kërkesës së parashtruesit për hedhjen e aktakuzës. Kjo kërkesë ishte refuzuar nga Gjykata Themelore, me Aktvendimin P. nr. 66/2014, me arsyetimin se aktakuza nuk ishte ngritur në lidhje me veprat penale për të cilat ishin pushuar hetimet, por për vepra të tjera penale.

49. Në lidhje me këtë, pas kërkesës së Gjykatës për të dorëzuar vendimet e gjykatave të rregullta në lidhje me hedhjen e aktakuzës, nuk ka ofruar fakte dhe dëshmi se ai kishte paraqitur ankesë ndaj Aktvendimit P. nr. 66/2014, në Gjykatën e Apelit ashtu si ishte udhëzuar me Aktvendimin e Gjykatës Themelore, P. nr. 66/2014. Gjykata konsideron se parashtruesi nuk i ka ushtruar mjetet efektive juridike të vëna në dispozicion me ligjet në fuqi, në këtë rast ankesën, në mënyrë që Gjykata e Apelit të vlerësojë pretendimet e tij për shkelje ligjore me rastin e ngritjes së aktakuzës.

50. Rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese, në pajtim me parimin e subsidiaritetit, nuk mund ta vlerësojë këtë çështje pa pasur dëshmi se ka qenë më parë e ngritur dhe vlerësuar në procedurë të rregullt.

51. Parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi të shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt, në mënyrë që të parandalohet shkelja e Kushtetutës apo, nëse ka shkelje, të korrigjohet shkelja e tillë e të drejtave themelore. Përndryshe, parashtruesi i kërkesës është përgjegjës kur rasti i tij shpallet i papranueshëm nga Gjykata Kushtetuese nëse dështon të shfrytëzojë procedurat e

rregullta, apo dështon të raportojë shkeljen e Kushtetutës në procedurë të rregullt. Mosshfrytëzimi i kësaj mundësie do të kuptohet si heqje dorë nga e drejta për të kundërshtuar më tej shkeljen dhe për t'u ankuar. (Shih, Aktvendimin në rastin KI139/12, *Besnik Asllani*, Vlerësim i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, PKL. nr. 111/2012, i 30 nëntorit 2012, paragrafi 45; dhe *shih Selmouni kundër Francës, [DHM] § 74; Kudla kundër Polonisë [DHM] § 152; Andrashik dhe të tjerët kundër Sllovakisë [aktvendim]).*

b) Procedura penale për shpalljen fajtor të parashtruesit të kërkesës

52. Në lidhje me këtë procedurë, Gjykata konstaton se parashtruesi ka parashtruar kërkesën si palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. nr. 279/2017, të 26 marsit 2018, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit

53. Megjithatë, Gjykata vëren se pretendimet e parashtruesit për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë kanë të bëjnë me mënyrën se si gjykatat e rregullta kanë aplikuar KPK-në dhe KPPK-në, në mënyrë specifike se si gjykatat e rregullta e kanë trajtuar parashtruesin e kërkesës si "person zyrtar" në kundërshtim me dispozitat ligjore.

54. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se Gjykata Supreme, me Aktgjykimin PML. nr. 279/2017, kishte arsyetuar vendimin e saj, duke konstatuar se parashtruesi i kërkesës: *"përveç që ka qenë i punësuar në autoshkollën "Geni" si person zyrtar-instruktor-i autorizuar për përgatitjen e kandidatëve për provim, dhe atë për pjesën praktike dhe teorike, ka qenë i autorizuar edhe për mbajtjen e ligjëratave si atë teorike dhe praktike. Sipas dispozitës së nenit 120, par 2 të KPRK-së personi zyrtar nënkupton:*
[...] 2.2 personi i autorizuar në një organ shtetëror; organizatë biznesi ose ndonjë person tjetër juridik i cili sipas ligjit ose ndonjë dispozite tjetër të nxjerrë në pajtim me ligj ushtron detyra të posaçme;
Nga kjo dispozitë mund të kuptohet se [parashtruesi i kërkesës] ka pasur cilësinë e personit zyrtar, prandaj edhe në këtë drejtim plotësohen të gjitha elementet e veprës penale që kërkohet me dispozitat e nenit 343, par 1, të KPK-së".

55. Prandaj, Gjykata vëren se pas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, Gjykata Supreme kishte hedhur poshtë pretendimet e tij për shkelje të KPK-së dhe KPPK-së duke mbështetur plotësisht Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, respektivisht të Gjykatës së Apelit. Gjykata Supreme i ishte përgjigjur pretendimeve për shkelje të KPK-së dhe KPPK-së, të ngritura nga parashtruesi i kërkesës.

56. Gjykata rikujton se Gjykata Kushtetuese nuk ka juridiksion për të vendosur nëse një parashtrues ka qenë fajtor për kryerjen e veprës penale apo jo. Ajo nuk ka as juridiksion për të vlerësuar nëse gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë apo për të vlerësuar nëse gjyqtarët e gjykatave të rregullta kanë pasur dëshmi të mjaftueshme për të përcaktuar fajësinë e një parashtruesi të kërkesës. (Shih rastin KI68/17, parashtrues: *Fadil Rashiti*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri, i 2 qershorit 2017, para 50).

57. Lidhur me këtë, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve apo të ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të jenë kryer nga Gjykata Supreme apo ndonjë gjykatë tjetër e instancës më të ulët, përveç; nëse dhe për aq sa ajo mund të ketë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Gjykata rithekson më tej se nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e "shkallës së katërt" në lidhje me vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Roli i gjykatave të rregullta është të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih *mutatis mutandis*, rastin, *Akdivar kundër Turqisë,* nr. 21893/93, Aktgjykim i GJEDNJ-së i 16 shtatorit 1996 para. 65, rastin *Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar* nr. 35394/97, GJEDNJ, Aktgjykim i 4 tetorit 2000, paragrafi 34; shih gjithashtu rastin KI70/11, parashtrues: *Faik Hima, Magbule Hima* dhe *Besart Hima*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

58. Gjykata vëren se arsyetimi nga Gjykata Supreme, duke iu referuar pretendimit të parashtruesit të kërkesës për shkelje të ligjit penal dhe të procedurës penale, është i qartë dhe, pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu konstaton se procedurat në gjykatat e rregullta nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis*, rastin *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).

59. Gjykata rikujton se fakti i thjeshtë që parashtruesi i kërkesës nuk është e kënaqur me rezultatin e vendimeve të gjykatave të rregullta apo përmendja e neneve të Kushtetutës nuk është e mjaftueshme për të

ndërtuar një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesja e kërkesës duhet të sigurojë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, Aktvendimin për papranueshmëri i 10 shkurtit 2015, *Abdullah Bajqinca*, KI136/14, paragrafi 33).

60. Lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 102 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, Gjykata rikujton se është parim i përgjithshëm se nenet e Kushtetutës të cilat drejtpërdrejtë nuk rregullojnë të drejtat e njeriut nuk kanë efekt të pavarur, pasi efekti i tyre vlen vetëm për *"gëzimin e të drejtave dhe lirive"* që garantohen me dispozitat e Kapitullit II dhe III të Kushtetutës. Prandaj, ky nen në mënyrë të pavarur nuk mund të zbatohet nëse faktet e çështjes nuk bien në fushën e veprimit të paktën të njërës ose më shumë dispozitave të Kushtetutës që kanë të bëjnë me *"gëzimin e të drejtave dhe lirive të njeriut"* (shih, *inter alia*, *E.B. kundër Francës [GC],* par. 47*,* Aktgjykimi i 22 janarit 2008; *Vallianatos dhe të tjerët kundër Greqisë,* par. 72, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 7 shtatorit 2013; gjithashtu rastin KI67/16, parashtrues i kërkesës *Lumturije Voca,* Aktvendimi për papranueshmëri*,* i 23 janarit 2017, par. 128).

61. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk ka mbështetur pretendimin e tij për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës lidhur me nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe nenin 102 të Kushtetutës gjatë procedurës me të cilën ai është shpallur fajtor për veprën penale – marrje ryshfeti.

c) Kërkesa për rishikimin e procedurës penale

62. Sa i përket kërkesës për rishikimin e procedurës penale, parashtruesi ka parashtruar kërkesën si palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN. nr. 462/2018, të 28 majit 2018, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

63. Në lidhje me këtë procedurë, parashtruesi pretendon se gjykatat e rregullta nuk kanë shqyrtuar dokumentin e lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe nuk kanë lejuar rishikim të procedurës në rastin e parashtruesit edhe pse ishin plotësuar kushtet ligjore për një gjë të tillë. Gjithashtu, ai konteston edhe përbërjen e Kolegjit të Gjykatës së

Apelit që ka vendosur për rishikimin e procedurës penale ndaj parashtruesit pasi sipas tij, njëra nga gjyqtaret që ka marrë pjesë në Kolegjin e Gjykatës së Apelit gjatë procedurës penale ishte gjithashtu anëtare e Kolegjit të Gjykatës së Apelit në lidhje me kërkesën për rishikimin e procedurës.

64. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se vendimi i fundit lidhur me kërkesën e parashtruesit për rishikimin e procedurës penale është Aktvendimi i Gjykatës së Apelit, PN. nr. 462/2018, i 28 majit 2018, me të cilin ishte refuzuar kërkesa e parashtruesit për rishikimin e procedurës penale kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore, PKR. nr. 157/2017, i 10 majit 2018.

65. Gjykata vëren se në këtë procedurë, gjykatat e rregullta vendosin vetëm lidhur me përmbushjen e kërkesave procedurale për rishikimin e procedurës penale dhe jo për meritat e rastit.

66. Gjykata gjithashtu përsëritë se në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës *"Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut"*.

67. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Gjykata, duke iu referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe praktikës gjyqësore të saj, përsëritë se neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së nuk zbatohen në kërkesat për rishikimin ose përsëritjen e procedurës. (Shih, në mënyrë analoge rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI07/17/15, *Pashk Mirashi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 qershorit 2017, paragrafi 64; KI80/15, 81/15 dhe 82/15, *Rrahim Hoxha,* Aktvendim për papranueshmëri, i 27 dhjetorit 2016, paragrafi 31, shih gjithashtu rastet e GJEDNJ-se, *inter alia, Dowsett kundër Mbretërisë* se *Bashkuar,* nr. 8559/08, Aktvendim për papranueshmëri i 4 janarit 2011, *Sablon kundër Belgjikës,* nr. 36445/97, Aktgjykim i 10 prillit 2001, paragrafi 86).

68. Për më tepër, Gjykata rikujton praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së e cila konstaton se neni 6 nuk zbatohet në procedurat për rishikimin e ndonjë rasti sepse një person dënimi i të cilit është bërë i plotfuqishëm dhe i cili bën kërkesë për rishikimin e rastit të tij nuk është "akuzuar për vepër penale" brenda kuptimit të atij neni (shih rastet e GJEDNJ *Franz Fischer kundër Austrisë,* nr. 27569/02, Aktvendim për papranueshmëri, i 6 majit 2003).

69. Gjykata thekson se pajtueshmëria *ratione materiae* e kërkesës me Kushtetutën rrjedh nga juridiksioni material i Gjykatës. E drejta në të cilën thirret parashtruesi i kërkesës duhet të mbrohet me Kushtetutë, në mënyrë që një ankesë kushtetuese të jetë në pajtim *ratione materiae* me Kushtetutën. Megjithatë, Kushtetuta nuk i garanton parashtruesit të kërkesës të drejtën për rishikim dhe përsëritje të procedurës (shih në mënyrë analoge rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI07/17/15, *Pashk Mirashi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 qershorit 2017, paragrafi 66; KI80/15, 81/15 dhe 82/15, *Rrahim Hoxha,* Aktvendim për papranueshmëri, i 27 dhjetorit 2016, paragrafi 33).

70. Prandaj, Gjykata konsideron se ankesat e parashtruesit lidhur me refuzimin nga gjykatat e rregullta për të rishikuar procedurën penale nuk janë *ratione materiae* ne pajtim me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

Përfundim

71. Gjykata në pajtim me nenin 47 dhe 48 të Ligjit dhe me rregullin 39 (1) (b), (2) dhe (3) (b) të Rregullores së punës, konstaton se kërkesa e parashtruesit:

(i) në lidhje me pretendimin se në rastin e tij janë pushuar hetimet dhe rrjedhimisht është ngritur aktakuzë pa bazë ligjore, nuk janë shterur mjetet juridike të parapara me ligj;

(ii) në lidhje me pretendimin e parashtruesit se në procedurë penale nuk janë aplikuar drejtë dispozitat në lidhje me definicionin e *"personin zyrtar"*, parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë; *dhe,*

(iii) sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës lidhur me rishikimin e procedurës penale kërkesa nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 dhe 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 39 (1) (b), (2) dhe (3) (b) të Rregullores së punës, me 22 nëntor 2018, njëzëri

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Safet Hoxha	Arta Rama-Hajrizi

KI 110/17 Parashtrues i kërkesës: Sekule Stanković, i cili kërkon tërheqjen e kërkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 233/2014, të 3 shtatorit 2014

KI 110/17, Aktvendim për papranueshmëri, i 24 majit 2018, i publikuar më 13 qershor 2018

Fjalët kyçe: kërkesë individuale, tërheqja e kërkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme, aprovimi i kërkesës së parashtruesit për tërheqjen e kërkesës

Parashtruesi e parashtroi kërkesën në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, neneve 22 dhe 23 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 dhe rregullave 32 dhe 56 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Parashtruesi e parashtroi kërkesën në Gjykatë duke kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme.

Pas kësaj, parashtruesi parashtroi kërkesën për tërheqjen e kërkesës së tij për vlerësimin e kushtetutshmërisë, si dhe për tërheqjen e kërkesës për vendosjen e masës së përkohshme dhe tërheqjen e kërkesës për mbajtjen e seancës dëgjimore publike.

Prandaj, Gjykata vendosi të aprovojë kërkesën e parashtruesit për tërheqjen e kërkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme, duke përfshirë edhe tërheqjen e kërkesës për vendosjen e masës së përkohshme dhe tërheqjen e kërkesës për seancën dëgjimore publike.

VENDIM PËR TËRHEQJE TË KËRKESËS

në

rastin nr. KI110/17

Parashtrues

Sekule Stanković

Vlerësim i kërkesës së parashtruesit për tërheqjen e kërkesës për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 233/2014, të 3 shtatorit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Sekule Stanković nga Medvegja, Republika e Serbisë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson Žarko Gajić, avokat nga Graçanica.

Objekti i çështjes

2. Objekti i çështjes është vlerësimi i kërkesës së parashtruesit për tërheqjen e kërkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë, si dhe tërheqja e kërkesës për vendosjen e masës së përkohshme dhe tërheqja e kërkesës për mbajtjen e seancës dëgjimore.

Baza juridike

3. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në nenet 22 dhe 23 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullat 32 dhe 56 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

4. Më 13 shtator 2017, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

5. Më 18 shtator 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përberë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Ivan Čukalović dhe Arta Rama-Hajrizi.

6. Më 17 tetor 2017, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme të Kosovës për regjistrimin e kërkesës. Me këtë njoftim, Gjykata kërkoi që parashtruesi të paraqiste kopjen e fletëdërgesës me datën e pranimit të vendimit të kontestuar.

7. Më 7 nëntor 2017, parashtruesi i kërkesës paraqiti kopjen e fletëdërgesës me datën e pranimit të vendimit të kontestuar të 17 majit 2017. Me këtë shkresë, parashtruesi gjithashtu dorëzoi kërkesë në Gjykatë për vendosjen e masës së përkohshme.

8. Më 4 dhjetor 2017, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumente shtesë. Me këtë shkresë, parashtruesi gjithashtu kërkoi nga Gjykata që të mbajë seancë dëgjimore me rastin e vendosjes për këtë lëndë.

9. Më 23 prill 2018, parashtruesi i kërkesës, përkatësisht përfaqësuesi i tij i autorizuar ligjor (Žarko Gajić) iu drejtua Gjykatës me kërkesë për të tërhequr kërkesën.

10. Më 24 maj 2018, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës ta aprovon kërkesën e parashtruesit për tërheqjen e kërkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë, si dhe tërheqjen e kërkesës për vendosjen e masës së përkohshme dhe tërheqjen e kërkesës për mbajtjen e seancës dëgjimore.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 13 shtator 2017, parashtruesi dorëzoi kërkesë në Gjykatë, duke kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit (Rev. nr. 233/2014) të Gjykatës Supreme, të 3 shtatorit 2014.

12. Më 24 prill 2018, parashtruesi dorëzoi kërkesë për tërheqjen e kërkesës së tij për vlerësimin e kushtetutshmërisë, si dhe tërheqjen e kërkesës për vendosjen e masës së përkohshme dhe tërheqjen e kërkesës për mbajtjen e seancës dëgjimore. Parashtruesi i kërkesës në shkresën e tij, ndër të tjera, theksoi:

> *"[...] Pas parashtrimit të kërkesës, me shikimin në ueb faqen e Gjykatës Kushtetuese në Prishtinë, u konstatua se në këtë çështje juridike tani më është vendosur me vendimin e Gjykatës Kushtetuese në rastin KI176/14.*
>
> *Në këtë mënyrë, përfaqësuesi, avokati Žarko Gajić e informon Gjykatën për tërheqjen e kërkesës së dorëzuar për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit gjyqësor sipas revizionit dhe i*

propozon Gjykatës që ta njoftoj për pezullimin e procedurën në adresën e zyrës në Graçanicë".

Vlerësimi i kërkesës për tërheqjen e kërkesës

13. Për të vendosur lidhur me kërkesën e parashtruesit për tërheqjen e kërkesës, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret e përcaktuara me Ligj dhe me Rregulloren e punës.

14. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pas pranimit të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 233/2014, paraqiti në Gjykatë kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktgjykimit të lartcekur.

15. Më 24 prill 2018, parashtruesi e dorëzoi kërkesën për tërheqjen e kërkesës së tij për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 233/2014, të 3 shtatorit 2014.

16. Gjykata i referohet nenit 23 [Tërheqja e palës] të Ligjit, i cili parasheh:

> *"Gjykata Kushtetuese do të vendosë për çështjet që iu janë referuar në mënyrë ligjore nga ana e palëve të autorizuara pavarësisht tërheqjes së palës nga procedura".*

17. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 32 [Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës] të Rregullores së punës, i cili përcakton:

> *"(1) Pala mund të tërheqë kërkesën ose përgjigjen e parashtruar për atë kërkesë në çdo kohë para fillimit të seancës dëgjimore, ose në çdo kohë para marrjes së vendimit nga Gjykata, nëse vendimi merret pa seancë dëgjimore.*
>
> *(2) Pavarësisht tërheqjes së kërkesës, Gjykata mund të përcaktojë të vendosë përkitazi me të. […]".*

18. Duke marrë parasysh kërkesën e parashtruesit dhe rrethanat e rastit, Gjykata vlerëson se nuk ka arsye për të vazhduar shqyrtimin e kërkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Supreme, si dhe kërkesës për vendosjen e masës së përkohshme dhe kërkesës për mbajtjen e seancës dëgjimore.

19. Rrjedhimisht, Gjykata në bazë të rregullit 32 (1) vendos ta aprovon kërkesën e parashtruesit për tërheqjen e kërkesës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit dhe rregullit 32 (1) të Rregullores së punës, më 24 maj 2018,

VENDOS

I. TA MIRATOJË kërkesën për tërheqjen e kërkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë, duke përfshirë edhe tërheqjen e kërkesës për vendosjen e masës së përkohshme dhe tërheqjen e kërkesës për seancën dëgjimore;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Bekim Sejdiu	Arta Rama-Hajrizi

KI74/18, Parashtrues: Gëzim Murati, Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimeve ose akteve të paspecifikuara të autoriteteve publike

KI74/18, Vendim i 05 nëntorit 2018, publikuar më 06 dhjetor 2018

Fjalët kyç: Kërkesë individuale, vendim për refuzim

Parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, duke pretenduar se autoritete të ndryshme publike kishin shkelur shumë të drejta të tij të garantuara me Kushtetutë. Lidhur me shkeljen e këtyre të drejtave dhe si dëmshpërblim, parashtruesi kishte kërkuar në kërkesën e parashtruar shumën prej 100.000 eurosh.

Marrë parasysh faktin se parashtruesi i kërkesës nuk kishte dorëzuar dokumentet përkatëse, Gjykata i kërkoi atij të sqaronte se vendimin e cilit autoritet publik po e kontestonte pranë Gjykatës, si dhe t'i bashkëngjiste dokumentet përkatëse.

Parashtruesi i kërkesës, si rrjedhojë, kishte dërguar vetëm një shkresë me email, duke mos bashkangjitur dokumente relevante dhe duke mos qartësuar kërkesën e tij.

Si përfundim, Gjykata refuzoi kërkesën e tij me procedurë të shkurtër, sepse ai nuk kishte plotësuar kushtet e parapara me dispozitat e Kushtetutës, të Ligjit dhe të Rregullores së punës.

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

rastin nr. KI74/18

Parashtrues

Gëzim Murati

Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimeve ose akteve të paspecifikuara të autoriteteve publike

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Gëzim Murati, me vendbanim në Mitrovicë (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës nuk e konteston ndonjë vendim apo akt të veçantë të një autoriteti publik.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve ose akteve të paspecifikuara të autoriteteve publike, me anë të të cilave pretendohet se parashtruesit të kërkesës i është shkelur e drejta e tij e garantuar me nenet 23 [Dinjiteti i Njeriut], 25 [E drejta për Jetën], 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 44 [Liria e Asociimit], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] si dhe 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenin 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i Kërkesave dhe Përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

5. Më 31 maj 2018, Gjykata Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Gjykata) miratoi, në seancë administrative, plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së

Kosovës më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata i referohet dispozitave juridike të rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 29 maj 2018, Gjykata pranoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës të cilën ai e kishte dorëzuar në Postën e Kosovës më 24 maj 2018.

7. Më 16 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Almiro Rodrigues dhe Snezhana Botusharova. Më 26 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.

8. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Ljatifi, Radomir Laban, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.

9. Më 16 gusht 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.

10. Më 3 shtator 2018, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës si dhe kërkoi nga ai që të specifikojë dhe qartësojë se aktin e cilit autoritet publik po e konteston pranë Gjykatës, si dhe ta bashkëngjisë atë.

11. Më 6 shtator 2018, parashtruesi i kërkesës dërgoi një shkresë me titull *"Njoftim për nenet, rregullat ligjore për kompensimin material"* në adresën elektronike të Gjykatës.

12. Më 5 nëntor 2018, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që ta refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtër.

Përmbledhja e fakteve

13. Parashtruesi i kërkesës nuk ka dorëzuar në Gjykatë asnjë vendim të autoritetit publik, përveç disa certifikatave të trajnimeve, diplomën e shkollës së mesme si dhe diplomën e fakultetit.

14. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka bashkëngjitur disa raporte mjekësore.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me veprimet e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale përkatësisht Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, Komunës së Mitrovicës si dhe Ministrisë së Shëndetësisë, atij i është shkelur e drejta e garantuar me nenet 23 [Dinjiteti i Njeriut], 25 [E Drejta për Jetën], 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 44 [Liria e Asociimit], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] si dhe 51[Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale] të Kushtetutës.

16. Parashtruesi i kërkesës pohon se "*kam përfunduar [...] fakultetin ekonomik [...] drejtimi menaxhment si dhe 11 trajnime trajnime [...] dhe 13 certifikata [...]*".

17. Parashtruesi i kërkesës fillimisht pohon se është i paraqitur në Agjencinë e Punësimit të Kosovës nga viti 2009. Ai tutje, ankohet se Komuna e Mitrovicës asnjëherë nuk ishte marrë me problemin e tij për punësim për 10 (dhjetë) vite, dhe këtë veprim e quan *"neglizhencë institucionale"*.

18. Sipas parashtruesit të kërkesës, këto veprime të institucioneve të lartpërmendura, i kanë shkaktuar probleme shëndetësore. Si rrjedhojë, parashtruesi i kërkesës, thekson *"[...] kërkoj dëmshpërblim deri 100.000 Euro"*.

19. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu në shkresën e tij të 6 shtatorit 2018, thekson: "*[...] ju lutem që Gjykata Kushtetuese të mbrojë të drejtën time të garantuar me ligj*".

Pranueshmëria e kërkesës

20. Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

21. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
> *[...]*
> *7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara*

me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

22. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4, të nenit 22 [Procedimi i kërkesës] të Ligjit, i cili përcakton:

"Nëse kërkesa […] nuk është e […] kompletuar, gjyqtari raportues njofton palët apo pjesëmarrësit përkatës për këtë dhe ia cakton një afat prej jo më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve për të […] plotësuar kërkesën […]".

23. Më tej, Gjykata i referohet dhe rregullit 32 (2) (h) [Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve] dhe rregullit 35 (5) [Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës], të Rregullores së punës, që përcakton:

"32 (2) Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe:

[…]
(h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës.
[…]

[…]

35 (5) Gjykata mund të vendosë të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se kërkesa është e paplotë ose e paqartë përkundër kërkesave të Gjykatës ndaj palës që të plotësojnë apo qartësojnë kërkesën, nëse kërkesa është përsëritje e një kërkese të mëparshme të vendosur nga Gjykata, ose në qoftë se kërkesa është joserioze".

24. Gjykata rikujton se më 3 shtator 2018, në pajtim me nenin 22.4 të Ligjit, kërkoi që parashtruesi i kërkesës ta qartësonte kërkesën e tij duke ia bashkëngjitur asaj aktet ose vendimet e kontestuara të autoriteteve publike.

25. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk dorëzoi asnjë akt apo vendim të autoriteteve publike, kushtetutshmëria e të cilëve do të mund t'i nënshtrohej vlerësimit kushtetues nga Gjykata, ashtu si i ishte kërkuar nga Gjykata me shkresën e 3 shtatorit 2018.

26. Andaj, Gjykata nuk mund t'i marrë për bazë pretendimet e parashtruesit të kërkesës, për shkak se kërkesa është jo e plotë, pasi nuk janë specifikuar dhe bashkëngjitur vendimet e autoriteteve publike të kontestuara (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës

Kushtetuese, KI03/15, parashtrues: *Hasan Beqiri*, të 13 majit 2015, paragrafi 19, si dhe rastin e Gjykatës Kushtetuese KI07/16, parashtrues: *Rifat Abdullahi*, të 14 korrikut 2016, paragrafi 22).

27. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë dhe përgjegjësi e saj të hulumtojë dhe të ndërtojë rastin e parashtruesit të kërkesës. Përgjegjësia për përmbushjen e kritereve formale-procedurale, ashtu siç kërkohet me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës, bie mbi parashtruesin e kërkesave (shih, rastin e Gjykatës Kushtetuese, në rastin KI130/17, parashtrues: *Ndue dhe Simon Palushaj*, Vendimi për refuzim i kërkesës, i 14 marsit 2018*,* paragrafi 26*).*

28. Rrjedhimisht, Gjykata përfundon se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbush kriteret siç përcaktohet me Rregulloren e punës, për shkak të arsyeve të sipërcekura.

29. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbush kriteret procedurale për shqyrtim të mëtejmë, për shkak të moskompletimit të saj me dokumentacion përkatës, ashtu siç kërkohet me nenin 22.4 të Ligjit dhe me rregullat 32 (2) (h) dhe 35 (5) të Rregullores së punës.

30. Prandaj, Gjykata përfundon se kërkesa duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 22.4 të Ligjit dhe rregullin 35 (5) të Regullores së punës, më 5 nëntor 2018, njëzëri

VENDOS

I. TË REFUZOJË kërkesën;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues	**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**
Nexhmi Rexhepi	Arta Rama-Hajrizi

INDEKSI I SHPREHJEVE LIGJORE

TERMAT	NUMRI I FAQEVE
A	
Agjencioni Kosovar i Privatizimit (AKP)	122, 123, 124, 127, 128, 130, 131, 146, 432, 436.
Aktgjykim	23, 24, 25, 26, 32, 33, 34, 44, 45, 46, 50, 53, 56, 64, 65, 67, 94, 97, 102, 107, 110, 111, 115, 117, 119, 126, 128, 129, 130, 132, 133, 135, 136, 153, 154, 170, 171, 192, 193, 196, 197, 200, 218, 220, 238, 243, 245, 255, 256, 257, 269, 321, 329, 330, 331, 333, 334, 338, 339, 340, 341, 343, 345, 364, 384, 405, 406, 427, 437, 440, 441, 442, 443, 445, 446, 447, 463, 465.
Aktvendim për Papranueshmëri	21, 32, 42, 43, 109, 110, 111, 124, 167, 275, 348, 368, 374, 375, 385, 387, 388, 397, 398, 405, 408, 409, 411, 412, 421, 432, 433, 449, 450, 452, 453, 463, 465, 466, 468
Aksident	432
Amendament	208, 266
Ankesë kushtetuese	308, 336, 466,
Avokat	12, 46, 48, 49, 59, 104, 119, 136, 139, 144, 145, 154, 190, 191, 192, 193, 196, 200, 220, 229, 283, 330, 390, 406, 411, 415, 246, 433, 456, 469, 470.

Avokati i Popullit 190, 192, 193, 196, 406.

B

Barazia para Ligjit 120, 122, 137, 154, 161, 169, 171, 173, 177, 179, 180, 188, 197, 199, 201, 211, 239, 331, 333, 335, 337, 364, 387, 388, 392, 392.

Baza Juridike 13, 47, 68, 99, 120, 137, 155, 174, 221, 258, 283, 331, 349, 369, 376, 389, 399, 413, 434, 454, 469, 474.

D

Deputetët 9, 66, 69, 76, 78, 80, 81, 83, 93, 94, 182, 191, 197, 260, 265, 267, 270, 275, 276, 349, 359, 365.

Dëshmitar 225, 226, 228, 229, 231, 234, 411, 417.

DH

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme 118, 121, 122, 124, 126, 128, 133, 433, 434, 435, 436, 437, 439, 440, 443, 444, 447, 448.

E

E Drejta

e pronës 13, 20, 31, 81, 89, 118, 120, 121, 123, 124, 127, 128, 132, 189, 290, 291, 293, 297, 301, 317, 333, 435, 436, 437, 447, 448.

për pension 129, 180, 197, 368, 369.

për gjykim të drejtë dhe të paanshëm 9, 11, 12, 13, 15, 20, 21, 31, 32, 44, 45, 47, 51, 56, 60, 63, 97, 98, 105, 112, 116, 117, 119, 120, 123, 132, 33, 137, 143, 151, 153, 154, 161, 163, 164, 168, 169, 221, 227, 228, 229, 231, 232, 233, 314, 244, 247, 255, 281, 282, 300, 306, 312, 313, 322, 329, 333, 334, 335, 338, 344, 345, 387, 389, 391, 399, 402, 407, 410, 411, 413, 418, 420, 432, 434, 440, 445, 449, 452, 454, 458, 464, 465.

për proces të rregullt 15, 20, 31, 44, 45, 47, 49, 57, 58, 60, 63, 98, 117, 128, 133, 137, 143, 144, 151, 155, 161, 163, 218, 221, 227, 229, 234, 244, 247, 255, 284, 300, 312, 313, 329, 331, 333, 334, 335, 338, 345, 405, 413, 418, 420, 434, 437, 440, 441, 445.

e punës dhe ushtrimit të profesionit 98, 105, 154, 162, 169, 370, 389, 391, 474, 476.

zgjedhore dhe e pjesëmarrjes 374, 376, 379, 381.

për mjete juridike 284, 300, 312, 474, 476.

Ex officio (sipas detyrës zyrtare) 20, 27, 39, 40, 54, 84, 185, 294, 297, 319, 414, 423, 425, 430, 457.

G

Gazeta Zyrtare e Kosovës 2, 13, 52, 64, 68, 93, 96, 117, 133, 151, 170, 200, 245, 264, 280, 324, 328, 341, 345, 339, 341, 345, 349, 365, 373, 38, 389, 396, 399, 410, 423, 431, 455, 467, 472, 474, 478

Gazeta Zyrtare e RSFJ-së 103, 107

GJ

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) 23, 109,118, 119,124, 144, 146, 147, 165, 167, 169, 219, 237, 238, 301, 338, 420, 421, 437, 465

Gjykata Komunale

në Gjakovë 11, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 34, 35, 36

në Prishtinë 102, 103, 105, 112, 113, 118, 119, 120, 121, 122, 123, 124, 125, 127, 128

në Prizren

në Podujevë 432, 435, 436, 44

Gjykata e Qarkut

në Prishtinë 101

në Pejë 16

Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë 333

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës 13, 44, 46, 54, 63, 67, 75, 78, 86, 96, 98, 106, 116, 119, 151, 161, 167,169, 171, 172, 185, 193, 196, 199, 206, 214, 219, 221, 243, 246, 278, 359, 361, 363, 367, 368, 369, 370,371, 403, 410, 412, 413, 419, 429, 430, 431, 433, 438

Gjykata Supreme e Kosovës 11, 12, 13, 14, 15, 20, 21, 22, 31, 34, 38, 42, 43, 44, 71, 78, 79, 97, 98, 99, 104, 105, 107,

109, 113, 137, 138, 13, 14, 141, 142, 143, 144, 145, 147, 161, 162, 163, 164, 168, 169, 219, 220, 221, 222, 223, 225, 226, 227, 228, 229, 231, 232, 233, 235, 237, 240, 241, 242, 243, 244, 246, 247, 248, 249, 250, 251, 252, 253, 315, 316, 329, 330, 331, 332, 333, 334, 335, 336, 338, 341, 342, 343, 344, 345, 350, 355, 359, 366, 374, 375, 376, 379, 380, 381, 382, 384, 388, 389, 390, 391, 392, 393, 397, 398, 399, 402, 408, 409, 411, 412, 413, 414, 417, 425, 435, 443, 444, 449, 452, 453, 454, 455, 457, 458

Gjyqtar raportues 14, 15, 44, 48, 64, 69, 71, 96, 99, 100,117, 120,121, 134, 137, 138, 152, 155, 170, 174, 175, 200, 222, 245, 258, 260,280, 284, 285, 324,332, 345, 349, 350, 367, 370, 371, 376, 377, 387, 389, 390, 396, 399, 400, 410, 413, 414, 431, 434, 451, 455, 467, 469, 470, 472, 475, 477, 478

I

Imunitet 175, 179, 196, 229, 231

Inter alia 25, 87, 139, 191, 224, 300, 303, 310, 321, 464, 465

J

Juridiksion 109, 150, 165, 167, 171, 181, 182, 186, 252, 253, 256, 278, 279, 280, 290, 301, 304, 306, 346, 347, 362, 363, 366, 367, 373, 383, 397, 406, 408, 448, 463, 466

K

Kërkesë e paafatshme 387, 395

Kërkesë e papranueshme 23, 26, 255, 367, 368, 372, 375, 377, 385, 386, 387, 395, 396, 398, 400, 410, 412, 414, 429, 430, 431, 432, 451, 456, 467.

Kërkesë e pranueshme 49, 143, 151, 199, 201, 244, 325, 337.

Kërkesë individuale 11, 45, 118, 135, 153, 218, 329, 374, 375, 376, 384, 387, 397, 411, 432, 452, 468, 473.

Kërkesë qartazi e pabazuar 397, 452.

Kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë 104, 391.

Kërkesë e bashkuar 222, 414.

Kërkesë për rishqyrtim 402

Këshilli

i Pavarur Mbikëqyrës (KPMK) 96, 99, 100, 101, 102, 112, 113, 114, 115, 156, 158

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme 118, 120, 123, 124, 128, 130, 131, 132, 433, 436, 444, 447, 448

Kolegji shqyrtues 15, 48, 71, 100, 121, 138, 155, 175, 223, 260, 285, 332, 350, 370, 377, 390, 400, 414, 434, 456, 470, 475.

Kontratë

e punës 100, 156, 160, 166, 167.

për shitblerje 121.

Kodi i Procedurës Penale të Kosovës 141, 225, 226, 234, 247, 252, 253, 254, 394.

Kodi Penal i Kosovës (KPK)

Komuna e

Prishtinës 158, 159.

Podujevës 435.

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut 13, 47, 98, 120, 137, 155, 221, 284, 331, 389, 413, 434, 454.

Kompensim 123, 131, 139, 157, 178, 214, 215, 216, 288, 329, 332, 333, 334, 335, 341, 342, 343, 344, 432, 435, 437, 447, 475.

Kryeministri i Republikës së Kosovës 69, 70, 174, 175, 176, 178, 180, 181, 182, 189, 191,192, 194, 202, 258, 259, 260, 261, 262, 264, 265, 266, 272, 273, 349, 350, 357, 361, 365.

Kuvendi i Republikës së Kosovës 67, 68, 69, 171, 173, 174, 175, 176, 177, 178, 183, 184, 185, 189, 256, 257, 258, 259, 260, 265, 270, 275, 278, 280, 346, 349, 350, 351, 352, 357, 361. 365.

Kundërvajtje 397, 401, 404, 408.

L

për Gjykatat

për Gjykatën Kushtetuese 13, 47, 68, 99, 120, 137, 155, 174, 221, 258, 284, 331, 369, 376, 389, 399, 413, 434, 454, 469, 474

për Marrëdhëniet e Detyrimeve 30, 341.

për Procedurën Përmbarimore 19, 20.

M

Marrje e ryshfetit 452, 456, 457, 461, 464.

Masa e Përkohshme 15, 19, 25, 26.

Mbrojtja

Gjyqësore e të Drejtave 98, 105, 154, 162.

e Pronës 13, 20, 31, 120, 123, 132.

Mendim mospajtues 201, 223, 246.

Ministria (ministri)

e Financave 184, 194, 209.

Mutatis mutandis 56, 111, 115, 147, 164, 165, 193, 198, 233, 238, 242, 243, 275, 311, 316, 339, 406, 407, 410, 421, 450, 463, 477.

P

Palët/Pala e Autorizuar/a 22, 55, 86, 163, 164, 232, 268, 336, 347, 361, 366, 371, 393, 403, 419, 439, 462, 464.

Parashkrim 11, 20, 27, 30, 31, 39, 40, 457.

Parashtruesi i kërkesës 5, 42, 135, 167, 281, 409, 411, 454, 464, 468.

Parimet e Përgjithshme 32, 58, 62, 81, 98, 101, 105, 137, 142, 171, 173, 177, 180, 181, 189, 199, 201, 204, 226, 256, 258, 264, 266, 284, 307, 313, 325, 331, 336, 339, 359, 432, 434, 437, 440, 450, 452, 453, 458, 464.

Parimi i subsidiaritetit 385, 461.

Pension 6, 179, 197, 368, 369.

Person Juridik 307, 308, 336.

Pranueshmëria e kërkesës 21, 54, 86, 125, 141, 162, 190, 232, 267, 307, 336, 361, 383, 392, 419, 459, 476.

Pretendim 56, 65, 197, 231, 277, 387, 393, 408, 409, 461, 464.

Presidenti i Republikës së Kosovës 14, 48, 69, 71, 190, 191, 261, 262, 346, 348, 349, 352, 358, 359, 364, 365, 390, 400, 475.

Prima facie 56, 142, 163, 177, 191, 233, 419, 429, 430, 439.

Procedurë penale 236, 411, 466.

Prokurori Publik 20, 42.

Prokurori i Shtetit 11, 20, 42, 97, 98, 99, 104, 113, 114, 135, 139, 444.

Paluajtshmëri 448.

Q

Qeveria e Republikës së Kosovës 172, 173, 174, 176, 177, 178, 179, 181, 184, 186, 187, 189, 190, 191, 193, 194, 195, 196, 197, 198, 199, 201, 202, 203, 204, 205, 206, 207, 208, 209, 210, 211, 212, 260, 261, 266, 267, 271, 273, 274, 278

Ratione materiae 23, 181, 182, 184, 256, 257, 279, 280, 453, 454, 461, 467

Rigjykim 16, 20, 63, 102, 103, 105, 122, 139, 290, 291, 292, 293, 295, 296, 318, 320, 402, 437, 438, 460

S

Seancë dëgjimore 59, 60, 62, 226, 297, 397, 405, 407, 433, 442, 443, 444, 445, 446, 469, 471, 472, 473

Sundimi i Ligjit 32, 34, 43, 58, 81, 89, 148, 185, 188, 189, 208, 211, 212, 215, 277, 302, 314, 315, 316, 317, 322

U

UNMIK-u (Rregulloret) 101, 102, 108, 122, 126, 127, 158, 160, 164, 166, 168

V

Vepër penale 139, 144, 224, 391, 411, 414, 415, 425, 427, 453, 457, 458, 462, 465, 466

Vlerësim i

Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit 43, 119, 153, 154, 218, 220, 329, 331, 375, 388, 397, 398, 411, 453, 454

i Kushtetutshmërisë së Aktvendimit 11, 12, 97, 136

INDEKSI I NENEVE TË KUSHTETUTËS

Neni Titulli/Emërtimi Numri i faqes

KAPITULLI I
DISPOZITAT THEMELORE

5 Gjuhët

7 Vlerat

KAPITULLI II
TË DREJTAT DHE LIRITË THEMELORE

21 Parimet e përgjithshme

22 Zbatimi i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare

24 Barazia para ligjit

27 **N**dalimi i torturës, trajtimit mizor, çnjerëzor dhe poshterues

29 E drejta e lirisë dhe sigurisë

30 Të drejtat e te akuzurit

31 E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm

32 E drejta për mjete juridike

45 Te drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes

46 Mbrojtja e pronës

49 E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit

53 Interpretimi i dispozitave për të drejtat e njeriut

54 Mbrojtja gjyqësore e të drejtave

KAPITULLI III
TË DREJTAT E KOMUNITETEVE DHE PJESËTARËVE TË TYRE

58 Përgjegjësitë e shtetit

60 Keshilli Konsultativ për Komunitete

KAPITULLI VII
SISTEMI I DREJTËSISË

102 Parimet e përgjithshme të sistemit gjyqësor

108 Këshilli Gjyqësor i Kosovës

SHKELJE TË NENIT 24, 31, 46 DHE 108 TË KUSHTETUTËS

31 E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm 63, 117, 133, 151, 169, 244, 323, 345.